

**INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP**

**STUDIME
ALBANOLOGJIKE**

12

Shkup, 2015

*Kryeredaktor
Prof. Dr. Qemal Murati*

*Redaksia
Prof. Dr. Qemal Murati
Dr. Naim Halimi
Dr. Izaim Murtezani
Dr. Bukurije Mustafa
Dr. Besnik Emini*

*Sekretar i redaksisë
Dr. Besnik Emini*

*Adresa e redaksisë:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
Kutia Postare nr. 171
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë*

*Adresa elektronike:
studimealbanologjike@yahoo.com
studimealbanologjike@itsh.edu.mk*

ISSN 1857-6958
UDK 930.85
COBISS.MK-ID 82595850

PËRMBAJTJA*Naser FERRI, Eva Katarina GLAZER*KONTRIBUTI I ARKEOLOGËVE DHE I HISTORIANËVE KROATË
NË FUSHËN E ILIROLOGJISË.....7*Naim HALIMI*KOLONIZIMI I VISEVE SHQIPTARE TË MAQEDONISË NDËRMJET
DY LUFTËRAVE BOTËRORE.....29*Shpëtim ÇUÇKA*NJË JETË PËR GJUHËN E NJËSUAR (kujtimit të Androkli
Kostallarit).....37*Antonio BELLUSCI*VLERËSIMI I GJUHËS DHE I KULTURËS ARBËRESHE NË
LETËRKËMBIMIN E ANDROKLI KOSTALLARIT.....41*Eqrem ÇABEJ*VENDBANIMI I HERSHËM I SHQIPTARËVE NË GADISHULLIN
BALLKANIK NË DRITËN E GJUHËS E TË EMRAVE TË
VENDEVE.....57*Seit MANSAKU*UDHËTIM HISTORIKO-STUDIMOR NGA ILIRISHTJA TE
SHQIPJA.....65*Qemal MURATI*

BALLKANI NË NOFKA E LLAGAPE.....73

Ardian VEHBUI

ATRIBUTE FJALËSH.....91

Emil LAFE

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE.....95

Hidajete AZIZI

ANTROPONIMIA E SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË.....99

Arben HOXHA

PANTEIZMI: BAZAMENTI METAFIZIK I BALADËS “LULA E SHTATË VLLAZËNVE”.....111

Violetë BARDHI-ZEQIRI

KODI LETRAR I GJUHËS SË AGIM DEVËS.....127

Xhon KUANRUD

SHOQËRIA BIBLIKE: VEPRIMTARIA E SAJ NË SHQIPËRI GJATË SHEKULLIT XIX.....139

David HOSAFLOOK

EDITH DURHAM: “PSE U INTERESOVA PËR FATIN E SHQIPËRISË”.....147

Isamedin AZIZI

KONCESIONET E ITALISË NË SHQIPËRI.....151

Jorina VERLI

SHQIPËRIA – PRIORITET STRATEGJIK I POLITIKËS ITALIANE NË DEKADAT E PARA TË SHEK. XX.....171

Sonila BOÇI

MINORITETET NË SHQIPËRI NË NJË ANALIZË HISTORIKE-JURIDIKE.....189

Murtezan IDRIZI

KRONOLOGJIA DHE SHKAQET E DEPËRTIMIT TË ISLAMIT NË TROJET SHQIPTARE.....219

Sevdail DEMIRI

RRETH HISTORISË SË SHTYPIT SHQIPTAR NË MAQEDONI (1945-1991).....229

Marenglen KASMI

KONICA, LETRA E RRALLË PËR PRINC VIDIN: MBAJ LARG HAJDUTËT.....233

100 THËNIET MË TË BUKURA TË FAIK KONICËS.....239

<i>Niazi NELAJ</i> EMRAT E NJERËZVE DHE SIMBOLET E TYRE.....	249
<i>Tajar ZAVALANI</i> IDEALI I NJERIUT TË MËSUAR.....	253
<i>Ismet AZIZI</i> KARAGJORGJE, SHQIPTAR NGA SANXHAKU!.....	257
<i>Jovan BIZHYTI</i> VLEHTË NË HAPËSIRAT MYZEQARE.....	261
“THE NATIONAL GEOGRAPHIC” MË 1912: JA SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT (Man POGA).....	267
RECENSIONE	
VEPËR E RRALLË PËR ARBNESHËT E ZARËS (<i>Aleksandër Stipçeviq, “Kultura tradicionale e arbneshëve të Zarës”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014</i>) (Sadri FETIU).....	271
NJË STUDIM ME VLERA SHKENCORE PËR TOPONIMET DHE RITET PAGANE NË BRESANË TË OPOJËS (<i>Ismail Abazi – Milazim Garipi, Bresana në monografi, Prizren, 1999-2000, f. 212.</i>) (Bajram MEHMETAJ).....	276
KRONIKA SHKENCORE	
ITSHKSH ME REZULTATE TË LAKMUESHME SHKENCORE NË VITIN 2015 (Sefer TAHIRI).....	281
INICIATIVAT PËR UNIVERSITET SHTETËROR SHQIP NË SHKUP (Mixhait POLLOZHANI).....	289
IN MEMORIAM	
TË GJITHË MBETËM PA JORGO BULON! (Kosta BARJABA).....	293
NJERIU, DIJETARI, ATDHETARI (kujtimet të Jorgo Bulos) (Shpëtim ÇUÇKA).....	295

NASER FERRI
EVA KATARINA GLAZER

KONTRIBUTI I ARKEOLOGËVE DHE I HISTORIANËVE KROATË NË FUSHËN E ILIROLOGJISË

Territori i Kroacisë së sotme, si ai bregdetar ashtu edhe ai kontinental, gjatë parahistorisë ishte i banuar me fise të ndryshme ilire (histret, liburnet, japodet, delmatët, ditionet, kolopianet, latobikët, tauriskët, iaset, breukët, mezejet, dezidijatët, autariatët, skordiskët, andrizetet, daorsët, narensijet, ardianët, segestanët, plerejët etj.). Që nga mijëvjeçari I p.e.s. këto fise e shënuan periudhën e broncit në Ballkan, ndërsa nga mesi i mijëvjeçarit të njëjtë hasim shënime të shkruara mbi ilirët tek burimet greke. Pas pushtimit romak, territori i banuar me ilirë bëhet pjesë e Ilirikut romak.

Historiografia kroate që nga fillet e veta është marrë me studimin e ilirëve me motive të ndryshme, ndërsa në kuadër të këtyre studimeve dallohen dy faza kryesore ajo e hershme me qëllime politike pansllaviste dhe ajo me e reja e mbështetur mbi baza shkencore.

kur studiuesit kroatë kishin mbledhur të dhëna nga autorët antikë dhe kjo fazë kishte zgjatur deri në shekullin XIX kur realiteti politik dhe synimet për krijim të identitetit kombëtar e kishte sjellë interesimin për ilirët deri te njohuritë shkencore.

Është mjaft vështirë të caktohet se kur ishte përmendur për herë të parë në veprat e autorëve kroatë nocioni *ilir*, *Ilirik* apo *ilirologji*.

Vepra më e hershme e cila merret me historinë e ilirëve mund të konsiderohet “*De situ Illyriae et civitate Sibenici*” e autorit Juraj Shizhgoriq nga shekulli XV, e cila merret me pozitat gjeografike të pjesëve të Ilirikut dhe të qytetit bregdetar Shibenik me qëllim të ngritjes së patriotizmit lidhur me mbrojtjen nga turqit.

Kah mesi i shekullit XVII ishte publikuar vepra „*Memoria regum et banorum regnorum Dalmatiae, Croatiae et Slavoniae Inchoata ab origine sua, et usque ad praesentem anum MDCLII*“ e autorit Juraj Ratkaj, e cila me të drejtë konsiderohet si vepër me e lashtë sistematike mbi historinë e trojeve të banuara me kroatë.

Fillet e historiografisë shkencore kroate vështirë mund të përcaktohen me saktësi, por ndër të parët ishte autori Ivan Luçiq Lucius me veprën e tij „*De Regno Dalmatiae et Croatiae*“¹ edhe pse ky autor kishte bërë edhe ca gabime trashanike në përcaktimin e përkatësisë etnike të ilirëve duke i konsideruar si keltë.

¹ Lučić 1986.

Shekullin XVIII e kishte shënuar historiografi Pavao Ritter Vitezović i cili ishte autor i disa veprave nga fusha e historisë dhe e gjuhësisë² të cilët duke u udhëhequr nga ideja iliro-kroatomadhe kishin për qëllim bashkimin e të gjitha tokave kroate. Idetë e Lluçiqit i vazhduan Ludeviti Gaji dhe ithtarët e tij. Gaji ishte autor i veprës „*Tko su bili Iliri?*“ (*Kush ishin ilirët*), dhe njëri nga themeluesit e „*Lëvizjes ilire*“ (të cilën e kishte shfaqur Vinko Pribojeviq qysh në shekullin XVI) e cila zgjati deri më 1874 dhe e cila u identifikua me rilindjen kombëtare kroate, por e cila për qëllim e kishte pasur dëshmimin e teorisë pansllaviste sipas të cilës të gjithë sllavët ishin banorë autoktonë të Ballkanit dhe pasardhës të ilirëve. Gaji shpjegonte se „...da je naziv Ilir na sjevernoistočnoj obali mora Jadranskoga (Adrianskoga) tako staro, kako su najstarije vijesti o rodu Čovječanskom. Imenom ovim nazivahu stari gerčki i rimski pisaoci sve puke med Dunavom i morem jadranskim prebivajuće osim nekojih među Iliri naseljenih celtogalskih plemenah“ (...emri „ilir“ në bregun verilindor të Adriatikut është aq i lashtë sa edhe të dhënat më të hershme mbi njerëzimin. Me këtë emër shkrimtarët grekë e romakë i quanin të gjithë banorët që jetonin mes Danubit dhe Adriatikut pos disa fiseve keltogale të cilët ishin vendosur në mesin e ilirëve). Sipas ideatorit të kësaj lëvizjeje, sllovakut Kollar, sllavët ishin një popull i njëjtë, me gjuhë të njëjtë me 4 dialekte (ruse, çeke, polake dhe ilire) gjë e cila ishte përkrahur edhe nga Ludeviti Gaj. Në vitin 1873 poeti Ivan Mazhuraniq, kryetar i „Matica ilirska“ e ndërron emrin saj në „Matica hrvatska“, kështu që mbiemri „ilir“ u zëvendësua me mbiemrin „kroat“ me çka edhe përdoren „Lëvizja ilire“. Kjo periudhë përfundon me letrarin Matija Petar Katančić dhe gjatë saj interesimi për ilirët ishte më shumë i karakterit politik sesa shkencor.

Faza e dytë e interesimit të studjuesve kroatë për ilirët dhe për kulturën e tyre fillon gjatë shekullit XX. Ç’është e vërteta, në vitet e 60-ta të shekullit 20 arkeologët e Bosnjës Alojz Benac dhe Borivoj Čović e kishin bërë një hap të madh në ilirologji duke shfaqur teorinë e re me të cilën i kishin diskredituar mendimet e mëhershme sipas të cilëve ilirët ishin ardhacakë në trojet tona. Sipas tezës së tyre ilirët kishin qenë bashkësi autoktone të cilat në periudhën e hekurit jetonin në Ballkan dhe përkundër dyndjeve të herëpashërshme (siç ishin bie fjala dyndjet në epokën e Hallshtatit dhe përhapja e kulturës së La Tenit gjatë shekullit 4 dhe 3.p.e.s), substrati etnik i tyre nuk kishte ndryshuar rrënjësisht.³

Duke u ndërlidhur në punën e tyre edhe studiuesit kroatë kanë dhënë kontribut të rëndësishëm e të mirëfilltë shkencor gjatë shekullit 20 dhe në fillim të atij 21 në fushën e studimeve të çështjeve të ndryshme lidhur me historinë, kulturën materiale dhe atë shpirtërore të ilirëve.

Në mesin e tyre janë edhe arkeologët dhe historianët si bie fjala akademiku Aleksandër Stipčević, arkeolog i cili kishte filluar studimet e veta mbi ilirët dhe publikimin e rezultateve të tyre qysh në vitin 1959 dhe u bë i njohur si autor i veprave antologjike:

² Croatia rediviva regnante Leopoldo Magno Caesare, Ortographia Illyricana.

³ Benac e definon substratin etnik ilir nepër disa faza evolutive si para-ilirë, proto-ilirë dhe ilirë.

-Latenski predmeti iz okolice Obrovca, *Diadora* 1, Zadar, 1959, 87-94.1963.

-Arte degli Illiri,(Arti i ilirëve) Milano, 1963. (është përkthyer në gjuhën angleze në vitin 1963), -*Gli Illiri (Uomo e mito)(Ilirët, njeriu dhe miti)*, Milano, 1966. (është përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 1967, në gjuhën kroate 1974,1989,1991.

-Bibliografija antičke arheologije u Jugoslaviji (Bibliografia e arkeologjisë antike në Jugosllavi) 1-2, Sarajevo 1977,


- Kultni simboli kod Ilira. Građa i prilozii sistematizaciji(Simbolet e kultit te ilirët) Posebna izdanja ANUBiH LIV, CBI 10 , Sarajevo 1981,

-Bibliographia Illyrica, I - III. Posebna izdanja ANUBiH VI/3, XLII/8, LXXVI/12, Sarajevo 1967-1984;


-Kult divinizaranog pokojnika u ilirskoj religiji”(Kulti i të ndjerit të hyjnizuar në religionin ilir), *Simpozijum Duhovna kultura Ilira (Herceg Novi 4-6.XI.1982)*, Posebna izdanja ANUBiH LXVII, CBI 11, Sarajevo 1984, f.215-221.



Akademiku Aleksandër Stipçeviq




Ballina e librit “Ilirët” të A. Stipčevićit



Ballina e librit „Arti i ilrëve“

Mjaft herët, madje edhe para Stipčevićit, studimet shumëdisiplinare mbi ilirët i kishte filluar akademiku Duje Rendiq-Mioçević. Ai kishte filluar studimet e

veta në vitin 1948 (“*Ilirska onomastika na latinskim natpisima Dalmacije*” (*Onomastika ilire në mbishkrime latine të Dalmacisë*), *VAHD*, LII/1935-49, Prilog 3, Split 1948, f.1-67), ndërsa libri i tij i fundit “*Iliri i antički svijet*” (*Ilirët dhe bota antike*) ishte botuar në vitin 1989, pas vdekjes së tij.



Akademiku Duje Rendić Miočević

Ballina e librit “Ilirët dhe bota antike”

“*Ilirska onomastika na latinskim natpisima Dalmacije*”, *VAHD*, LII/1935-49, Prilog 3, Split 1948, 1-67.

“*Novi ilirski epigrafski spomenici iz Ridera (Municipum Riditarum)*”, *GZM*, VI, Sarajevo, 1951, 49-64.

“*Onomastička pitanja sa teritorija ilirskih Dalmata*”, *GZM*, VI, Sarajevo, 1951, 33-47.

“*Iliri u natpisima grčkih kolonija u Dalmaciji*”, *VAHD*, LIII/1950-51, Split, 1952, 25-57.

“*Ilirske pretstave Silvana na kulturnim slikama sa područja Dalmata*”, *GZM*, X, Sarajevo 1955, 5-40.

“*Onomastičke studije sa teritorije Liburna. Prilozi ilirskoj onomastici*”, *Zbornik Instituta za historijske nauke u Zadru I*, Zadar, 1955, 125-144.

“*Illvrica. Zum Problem der illvrischen onomastischen Formel in romischer Zeit*”, *Archaeologia Jugoslavica*, II, Beograd, 1956, 39-51.

“*Neue epigraphische Belege für den Namen Germanus im illvrischen Namengut Dalmatiens*”, *Germania*, 34/3—4, Frankfurt a. M., 1956, 237-243.

“La tombe illviro-romaine a la lumiere des nouvelles fouilles et decouvertes en Yougoslavie”, *Atti del VII Congresso internazionale di archeologia classica*, III, Roma-Napoli 1958, Roma 1959, 143-151.

“Iliri”, *Enciklopedija Jugoslavije* 4, Zagreb, 1960, 328-334.

“Ilirske onomastičke studije (I). Porodična i rodovska imena u onomastici balkanskih Ilira”, *Živa antika*, X/1—2, Skopje, 1960, 163-171.

“Iliri”, *Enciklopedija likovnih umjetnosti* 2, Zagreb, 1962, 663-664.

“Princeps municipi Riditarum“, Uz novi epigrafski nalaz u Danilu”, *Arheološki radovi i rasprave JAZU*, II, Zagreb, 1962, 315-334.

“Onomastique illvrienne de la Dalmatie ancienne”, *Atti e memorie del VII Congresso internazionale di scienze onomastiche*, Firenze, 1963, 273-277.

“Ballaios et Pharos. Contribution a la typologie et a l'iconographie des monnaies greco-illyriennes”, *Archaeologia Jugoslavica*, V, Beograd, 1964, 83-92.

“Ilirske onomastičke studije (II). Imena Firmus, Valens, Maximus u procesu romanizacije ilirskog onomastika”, *Živa antika*, XIII-XIV, Skopje, 1965, 101-110.

“Ilirski vladari u svjetlu epigrafskih i numizmatičkih izvora”, *Historijski zbornik*, XIX-XX, Zagreb, 1966-67, 295-310.

“Prilog emisijama srebrna novca ilirskog kralja Baleja. Uz dva neobjavljena primjerka”, *Numizmatičke vijesti*, XIV/25, Zagreb, 1967, 1-6.

“Prolegomena ilirskoj numigrafiji”, *Godišnjak Naučnog društva BiH*, III, CBI 1/1965, Sarajevo, 1967, 77-93.

“Problemi romanizacije Ilira s osobitim obzirom na kultove i onomastiku”, *Simpozijum o Ilirima u antičko doba*, Posebna izdanja ANUBiH V, CBI 2, Sarajevo, 1967, 139-156.

“Još o »medaljonu ilirskog plemena Jasa« ”, *Numizmatičke vijesti*, XV/26, Zagreb, 1968, 31-37.

“Neki problemi tipologije i kronologije novca ilirskog kralja Gencija (I dio)”, *Numizmatičke vijesti*, XVI/27, Zagreb, 1969, 1-7.

“Ilirske onomastičke studije (III)”, *Onomasticon Riditinum. Iliva antika (posvećena M. Petruševskom)*, XXI/1, Skopje, 1971, 159-174.

“Neki problemi kronologije i tipologije novca ilirskog kralja Gencija (II dio)”, *Numizmatičke vijesti*, XVII/28, Zagreb, 1971, 1-10.

“Le Municipium Riditarum en Dalmatie - Son patrimoine epigraphique et l'onomastique illvrienne”, *Studia Albanica*, 2, Tirana, 1972, 229-234.

“Ilirski vladarski novci u Arheološkom muzeju u Zagrebu”, *VAMZ*, 3., ser., sv. VI-VII, Zagreb, 1972-73, 253-265.

“Isejska naseobina u Lumbardi (Korčula) u svjetlu novih istraživanja”, *VAHD LXVIII* (1966), Split, 1973, 133-141.

“Uz nalaz doskora nepoznata labeatskog novca. Prilog ikonografiji ilirskog »plemenskog« novca”, *Numizmatičke vijesti*, XX/31, Zagreb, 1973, 9-21.

“Lika i japodska antroponimijska tradicija. Lika”, *Izdanja Hrvatskoga arheološkog društva* 1, Split, 1975, 97-106.

“Quelques aspects de la continuite des agglomerations fortifiees illvriennes preantique a l'epoque romaine”, *Utvrđena ilirska naselja*, Posebna izdanja ANUBiH XXIV, CBI 6, Sarajevo, 1975, 47-58.

“L'atelier monétaire de Rhizon et ses 'emissions”, *Kovanje i kovnice antičkog i srednjovekovnog novca*. Beograd, 1976, 35-46.

“O jednom tipu »ilirskog« nadgrobnog spomenika”. *Godišnjak ANUBiH XIII*, CBI 11, Sarajevo, 1976, 285-305.

“Intervention sur des sujets de numismatique. / *Colloque des etudes illyriennes Tirana 1972*”, *Iliria*, IV, 1, Tirana, 1976, 425-446.

“Grci i Iliri na istočnom Jadranu u svjetlu numizmatičkih izvora. Jadranska obala u protohistoriji”, *Centar za povijesne znanosti Sveučilišta u Zagrebu, Arheološki institut*, Zagreb, 1976, 185-197.

“Rider - Municipium Riditarum. Essai de reconstitution historique d'un habitat illyro-dalmate”, *Actes du Colloque international Themes de recherches sur les villes antiaues d'occident*, Strassbourg 1971, Paris, 1977, 133-145.

“L'onomastique illvrienne des tablettes cirees daces”, *Actes du VII Congres International d'epigraphie grecque et latine*, Bucuresti – Paris, 1979, 456—457.⁴

“O pitanju prekova u emisijama grčko-ilirskih kovnica na Jadranu”, *Numizmatičke vijesti*, XXII/33, Zagreb 1979, 3-12.

“Uz jedan novi izvor o kultu ilirskog Medaura”, Gunjačin zbornik, Zagreb, 1980, 51-58.

“Neki ikonografski i onomastički aspekti Silvanove »panonsko-iliričke« kultne zajednice”, *VAMZ (posvećen Z. Vinskom)*, 3. ser., sv. XII-XIII, Zagreb, 1979-80, 105-123.

“O tipologiji novca »kralja Monunija« i pitanju njegova identiteta”, *Godišnjak ANUBiH (posvećen A. Bencu) XIX*, CBI 17, Sarajevo, 1981, 97-123.

“Scupi - Istraživanja rimskog teatra 1959-61 godine”, *Antički teatar na tlu Jugoslavije*, Novi Sad, 1981, 45-51.

“Dacico-Illyrica, Neki aspekti ilirske kolonizacije Dacije u svjetlu natpisa na ceratama iz Alburnusa”, *Rad JAZU*, XX, Zagreb, 1981, 21-37.

“Iliri između barbarskog i helenskog svijeta”, *Rad JAZU*, XX, Zagreb, 1981, 1-19.

“Neke karakteristike histarske onomastike”⁵, *Histria historica* IV/2, Pula, 1981, 67-76.

“O nekim zanemarenim komponentama kod »japodskih urni«. Uz problem njihova datiranja”, *VAMZ (posvećen M. Gorencu)* 3. ser., sv. XV, Zagreb, 1982, 1-10.

“Prilog nekim neriješenim pitanjima ilirske numografije”, *Numizmatičke vijesti*, XXX/37, Zagreb, 1983, 6-15.

“I Greci in Dalmazia e i loro rapporti col mondo illirico. »Forme di contatto e processi di trasformazione nelle societa antiche«”, *Atti del convegno di Cortona, 1981, Collection de l'Ecole frangaise de Rome*, 67, Pisa-Roma, 1983, 187-198.

“Umjetnost Ilira u antičko doba”, *Simpozijum Duhovna kultura Ilira*, Posebna izdanja ANUBiH LXVII, CBI 11, Sarajevo, 1984, 65-80.

⁴ Versioni i shkurtër i publikuar i ligjërätës së mabjtur në konstancë në vitin 1977.

⁵ Shiko edhe : Građa i rasprave, X, Arheološki Muzej Istre , Pula 1982.

“Le citta greche dell'Adriatico orientale e le genti illiriche. II Crinale d'Europa. L'area illirico-danubiana nei suoi rapporti con il mondo classico. Istituto della enciclopedia italiana”, *Biblioteca internazionale di cultura*, 13, Roma 1984, 33-49.

“I territori della provincia Dalmatia nel Tardo Antico. II Crinale d'Europa. L'area illirico-danubiana nei suoi rapporti con il mondo classico. Istituto della enciclopedia italiana”, *Biblioteca internazionale di cultura*, 13, Roma 1984, 105-111.

Iliri i antički svijet, Književni krug, Split, 1989.

Krahas Rendiq Mioçeviqit prej mesit të shekullit të kaluar veprimtarinë e vetë shkencore ia kishin kushtuar historisë dhe kulturës së ilirëve edhe arkeologët: akademiku Mate Suiq, i cili prej vitit 1951 e deri në vitin 1995 kishte publikuar një numër të madh studimesh lidhur me origjinën, shtrirjen gjeografike, besimet religjioze, onomastikën e tjera të liburnëve dhe të japodëve dhe të urbanizimit të tokave të tyre.

“Liburnski nadgrobní spomenik (Liburnski cipus)”, *VAHD* 53, 1950-1951, 59-97.

“Granice Liburnije kroz stoljeća”, *RIJAZU* 2, Zadar, 1955, 273-296.

“Istočna jadranska obala u Pseudo Skilakovu Periplu”, *RAD JAZU* 306, Zagreb, 1955, 121-185.

“Mare nostrum Illyricum. Prilog poznavanju ilirske talasokracije na Jadranu”, *Glas Zadra* 254, 28.4.1956, 5 i 8.

“Prilog poznavanju odnosa Liburnije i Picenuma u starije željezno doba”, *VAHD* LV, Split, 1956, 71-101

“O granicama Autarijata”, *Istorijski zapisi*, 1-2, 1957, 115-124.

“Ilirik”, *Enciklopedija Jugoslavije* 4, Zagreb, 1960, 334-336.

“Japodi”, *Enciklopedija Jugoslavije* 4, Zagreb, 1960, 464-465.

“Tato-ilirski Deus Patrius”, *Starinar* vol.11, Beograd, 1960, 93-97

“Liburni”, *Enciklopedija Jugoslavije* 5, Zagreb 1962, 525-526.

“Liburnija”, *Enciklopedija Jugoslavije* 5, Zagreb, 1962, 526.

“Prolegomena urbanizmu antičke Liburnije”, *Radovi FFZd* 2, Zadar, 1963, 82-97.

“Liburni”, *ELU* 3, 1964, 312-313.

“Iz mediteranske baštine jadranskih Ilira”, *Radovi FFZd* 4, Zadar, 1966, 44-58.

“Nekoliko etnoloških podataka o antičkom Iliriku u djelima grčkih i rimskih pisaca”, *Iliri u antičko doba*, Posebna izdanja ANUBiH 5, CBI 2, Sarajevo, 1967, 99-110.

“Zapadne granice Ilirika u svijetlu historijskih izvora”, *Iliri u antičko doba*, Posebna izdanja ANUBiH 5, CBI 2, Sarajevo, 1967, 33-53.

“Liburnus(a), Liburius(ia) u ilirskoj onomastici”, *Diadora* 4, 1968, 93-117.


“Liburnia Tarsaticenses”, *Zbornik radova posvećen Grgi Novaku*, Arheološki Institut FFZg, Zagreb, 1970, 705-716.

“Problèmes de paléogénèse et d'urbanisation des centres illyriens”, *Studia Albanica* X72, Tirana, 1973, 105-116.

“Iliri”, *VIPS* 3, 1974, 1382-1386.

“Zadarski otoci u antici. Zadarsko otočje”, *Zbornik Zadarski Narodni muzej*, Zadar, 1974, 47-64.

- “Nekoliko pitanja u vezi s antičkim Japodima”, *Arheološka problematika Like*, znanstveni skup Otočac (22-24.IX 1974) HAD, Split, 1975, 109-117.
- “Approche scientifique et méthodes de recherche des habitats autochtones sur le territoire illyrien”, *Ilirska utvrđena naselja*, Posebna izdanja ANUBiH XXIV, CBI 6, Sarajevo, 1975, 9-34.
- “Balkansko-ilirsko područje”, *VIPS* 5, 1975, 2231-2235.
- Antički grad na istočnom Jadranu*, Liber, Zagreb, 1976.
- “Ilyrii proprie dicti”, *Godišnjak ANUBiH XIII* CBI 11, Sarajevo, 1976, 179-196.
- “Problemes de paleogenese et d’urbanisation des centres illyriens”, *Iliria* 4, Tirane, 1976, 357-367.
- “Svijet Ilira”, *VIPS* 6, 1976, 2563-2571.
- “Jadranska obala u protohistoriji i kulturni i etnički problemi”, Simpozijum održan u Dubrovniku od 19-23.X.1972, *Arheološki institut centra za povijesne znanosti Sveučilišta u Zagrebu*, Zagreb, 1978.
- “Neke historijske determinante u formiranju hrvatskog etnosa”, *Naše teme* 23, 2, Zagreb, 1979, 361-374.
- “Antička toponomastika istočnojadranskog područja: prostor i vrijeme”, *Antički temelji naše suvremenosti*, 4. Znanstveni skup Saveza društava za antičke studije Jugoslavije, Pula-Zagreb, Zagreb, 1986, 48-49.
- “Liburni”, *LEJ* II, 1987, 190-191.
- “Ilirik”, *Enciklopedija Jugoslavije* 5, Zagreb, 1988, 510-519.
- “Japodi”, *Enciklopedija Jugoslavije* 6, Zagreb, 1990, 1-2.
- “Nekoliko primjera toponomastičkih refleksa kontinuiteta i pomicanja naselja iz antičke Liburnije”, *VAMZ* 3, ser.23, 1990, 69-74.
- “Liburnarii”, *Starinar* 40-41, Beograd, 1991, 181-184.
- “Liburnija i Liburni u vrijeme velikog ustanka u Iliriku od 6. do 9. god. poslije Krista (uz CIL V. 3346)”, *VAMZ* ser. 3., XXIV-XXV (1991-92), Zagreb, 1992, 55-66.
- “Liburni”, *EHV* 1, 1995, 512-513.



Akademiku Mate Suić Ballina e librit “Qyteti antik në Adriatikon Lindor”

Bashkëkohanik i Duje Rendiq Mioçeviqit dhe Mate Suiqit ishte edhe Marin Zaninoviç i cili prej vitit 1966 merret me studime, para së gjithash mbi fisin e delmatëve, por edhe mbi histrët, liburnët, ardianët dhe fiset e tjera të cilët, gjatë parahistorisë dhe antikës, banonin buz bregut lindor të Detit Adriatik.

“Ilirsko pleme Delmati”, *Godišnjak ANUBiH IV*, CBI 2, Sarajevo, 1966, 27-92.

“Ilirsko pleme Delmati II. dio”, *Godišnjak ANUBiH V*, CBI 3, Sarajevo, 1966, 5-101.

“Burnum-castellum, municipium”, *Diadora 4*, Zadar, 1968, 119-129.

“Delminium, primjedbe uz lokaciju”, *VAHD LXIII-LXIV*, Split, 1969, 49-56.

“The Dalmate in Britain”, *Acta of the Fifth International Congress of Greek and Latin Epigraphy, Cambridge 1967*, Basil Blackqell, Oxford, 1971, 11-24.

“Kuvendi i qytetit te Salones”, *GJASSHH, IAP 2*, 1972, Prishtine, 1974, 101-102.

“Delmatsko grčki odnosi na Jadranu”, *Jadranska obala u protohistoriji: kulturni i etnički problemi, Simpozij u Dubrovniku, 19-23.X.1972*, Zagreb, 1976, 301-307.

“Iliri i vinova loza”, *Godišnjak ANUBiH XIII*, CBI 11, Alojz Benac sexagenario dicatum, Sarajevo, 1976, 261-272.

“Imena po rijeklu”, *VAHD LXXII-LXXIII*, Split, 1979, 109-120.

“Kult božice Dijane u Seniji”, *Senjski zbornik, IX*, 1981-1982, 43-52.

“The frontier between Dalmatia and Moesia Superior”, *Pulpudeva, Semains de l’histoire et de la culture Thrace, 4, Plovdiv 3-17. Octobre 1980*, Edit de l’Academie Bulgaire des Sciences, Sofia, 1983, 88-94.



Prof.dr.Marin Zaninović



Ballina e librit “Fisi ilir delmatëve”

“Two Illyro-Hellenistic Sites on the Island of Hvar (Faros)”, *Actes du VIII^e Congress de la F.I.E.C.*, vol.I, Budapest, 1983, 381-384.

“Štovanje Libera na istočnom Jadranu”, *Simpozij »Duhovna kultura Ilira« Herceg Novi 4-6.XI.1982*, Posebna izdanja ANUBiH LXVII, CBI 11, Sarajevo, 1984, 245-252.

“I Greci e gli Illiri sul Pharos adriatico 4-3 sec. av. Cr. ”, *Praktika tou XII Diethnous Synediou Klasikes Arhailogias, Athene 4-10.XI.1985*, Athene, 1985, 306-308.

“Od gradine do castruma na području Delmata”, *Obrambeni sistemi u praistoriji i antici na tlu Jugoslavije, XII Kongres arheologa Jugoslavije, Novi Sad 1984*, Materiali XXII Saveza Arheoloških Društava Jugoslavije, Novi Sad, 1986, 163-169.

“Liburnia militaris”, *Opuscula Archaeologica* 13, Zagreb, 1988, 43-67.

“Histri i Liburni prema rimskoj ekspanziji”, *Diadora* 12, Zadar, 1992, 47-64.


“Pomorstvo Ardiejaca-temelj njihove moći”, *Opuscula Archaeologica* 16, Zagreb, 1992, 103-115.

“Livanjsko polje u antici kao primjer delmatske zajednice”, *Livanjski kraj u povijesti (Zbornik radova)*, Split-Livno, 1994, 45-50.

Od Helena do Hrvata, Školska knjiga, Zagreb, 1996.

Ilirsko pleme Delmati, Gradska knjižnica “Juraj Šižgorić”, Šibenik, 2007.

Kontribut të rëndësishëm në fushën e studimit të historisë së ilirëve dhe lidhur me ndriçimin e gjuhës së tyre, dhe të raportit të gjuhës ilire me gjuhët e tjera e ka dhënë edhe gjuhëtarit dhe historiani kroat, akademiku Radoslav Katičić.



Akademiku Radosllav Katiçiq Ballina e librit “Illyricum Mythologicum”

Ky studiues me studimet e veta të çmueshme multidisplinare (nga lëmi i gjuhësisë, historisë, mitologjisë etj.) ka dhënë kontribut të veçantë në fushën e studimit të gjuhëve të lashta të Ballkanit, të fiseve të ndryshme të ilirëve dhe të ilirologjisë në përgjithësi:

“Suvremena istraživanja o jeziku starosjedilaca ilirskih provincija”, *Simpozijum o teritorijalnom i hronološkom razgraničenju Ilira u praistorijsko doba*, Sarajevo, 1964, 9-58.

“*Illyrii proprie dicti*”, *ŽA XIII-XIV*, Skoplje, 1964, 87-97.

“Zur Frage der keltischen und panonischen Namensgebieten im römischen Dalmatien”, *Godišnjak ANUBiH III*, CBI 1, Sarajevo, 1965, 53-76.

“Liburnski otoci kod antičkih pisaca”, *Zbornik: Zadarsko otočje; povremena izdanja Narodnoga muzeja u Zadru*, svezak 1, Zadar, 1974, 35-45.

“Illyro-apenninica”, *Jadranska obala u protohistoriji. Kulturni i etnički problemi, Simpozij održan u Dubrovniku 19-23.X.1972.*, Zagreb, 1976, 177-183.

Ancient languages of the Balkans, The Hague and Paris, 1976.

Illyricum mythologicum, Antibarbarus, Zagreb, 1995.

Punën e kësaj gjenerate të „sudiuesve-pionierë“ të gjysmës së dytë të shekullit 20. të cilët ia kishin vu themelet studimit shkencor të historisë dhe kulturës së ilirëve e kanë vazhduar disa shkencëtarë të cilët pjesërisht i kishin rishikuar rezultatet e paraardhësve të tyre por kishin arritur edhe rezultate të reja të

rëndësishme. Slobodan Čaće (i cili merret me historinë e liburnëve dhe japodëve dhe raportet e tyre me romakët).

“Prilozi proučavanju političkog uređenja naroda sjeverozapadnog Ilirika”, *Radovi FFZd* 18, Zadar, 1979, 43-125.

“Liburnske zajednice i njihovi teritoriji”, *Dometi* 15, Rijeka, 1982, 41-52.

“Prostorna arheologija. Primjer ilirskog kulturnog objekta”, *Dometi*, 15, Rijeka, 1982, 83-90.

Liburnija od 4. do 1. stoljeća p. n. e., doktorska disertacija, Zadar, 1985.

“Položaj rijeke Telavija i pitanje Japodskog primorja”, *Radovi FFZd* 27, Zadar, 1987-1988, 65-92.

“Rim, Liburnija i istočni Jadran u 2. st. n. e.”, *Diadora* 13, Zadar, 1991, 55-76.

“Prilozi povijesti Liburnije u 1. stoljeću prije Krista”, *Radovi Zavoda za povijesne znanosti HAZU u Zadru* 35, Zadar, 1993, 1-35.

Kontribut të rëndësishëm ka dhënë edhe Boris Olujiq, i cili po ashtu merret me studimin e çështjeve të ndryshme të historisë dhe të kulturës së japodëve e disa të tjerë.

Japodi od 5. do 1. stoljeća prije Krista. Kultura u prostoru između latenske kontinentalne i jadranske (sredozemne) civilizacije, doktorska disertacija, Zagreb, 1999.

“Ethnie, culture, identité. Problèmes de l'origine des Iapodes et des Liburniens”, *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité III: Actes du IIIe colloque international de Chantilly. (16-19.X.1996)*, De Boccard, Paris, 1999, 57-60.

“Japodi i Rim do sredine 1. stoljeća prije Krista”, *Historijski zbornik* LII, Zagreb, 1999, 1-16.

“Japodi, Apijanovi plemeniti barbari”, *OA* 23-24, Zagreb, 2000, 59-64.

“Japodski svijet mrtvih”, *Znakovi i riječi (Signa et litterae)*, *Zbornik projekta »Protohistorija i antika hrvatskog povijesnog prostora«*, Hrvatska sveučilišna naklada, Zagreb, 2002, 63-83.

“Grob kao znak i poruka”, *HA* 8, Pula, 2002, 73-84.

“Oktavijanov pohod protiv Japoda”, *Grad Otočac* 7, Otočac, 2003, 27-47.

“Nouvelles recherches sur le territoire des Iapodes”, *Actes du quatrième Colloque international sur l'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité*, De Boccard, Paris, 2004, 215-221.

“Putevi i raskršća, prioriteti i perspektive u istraživanju etničkih zajednica sjeverozapadnog Ilirika tijekom prapovijesti i antike”, *Spomenica Filipa Potrebiće*, FF Press, Zagreb, 2004, 83-92.

“U potrazi za "Sunčanim gradom", prijestolnicom Japoda?”, *Historijski zbornik* LVI-LVII, Zagreb, 2004, 1-10.

Povijest Japoda, Srednja Europa, Zagreb 2007.

Një numër i arkeologëve kroatë studimet e veta i kanë përqëndruar drejt kulturës shpirtërore të ilirëve respektivisht drejt besimeve religjioze të tyre. Në mesin e këtyre studiuesve veçohet Julian Medini i cili prej vitit 1965 e deri në vdekje më 1990 është marrë me studimin e shtrirjes gjeografike, përbërjes etnike e mbi të gjitha me besimet religjioze të fiseve ilire të historive, liburnëve dhe

japodëve e posaçërisht me kulte të hyjnive autoktone si Silvani, pastaj variantet lokale të hyjneshës Venera siç ishin Venera Iria, Venera Anzotica, Venera Flanatica\ etj.

-Kult Silvana u Makarskom primorju, *Vjesnik za arheologiju i historiju dalmatinsku*, 65- 67, Split, 1963- 65 (1972),127-135, T. 1.

-Kultovi u antici na našoj obali, *Obavijesti HAD-a*, 4, br. 2, Zagreb, 1972, 34-36.

-Antički kultovi na području ilirskih plemena Histra, Liburna i Japoda, *magistarski rad (rukopis)*, *Filozofski fakultet u Zagrebu*, Zagreb, 1974, 242 str.+ T. 1-42.

-Ordines decurionum Liburniae,*Radovi Filozofskog fakulteta u Zadru*,12(5), Zadar, 1973/1974 (1975), 27-56.

-Neki aspekti razvoja antičkih religija na području Japoda, *Arheološka problematika Like*. Znanstveni

skup, Otočac, 22-24. IX. 1974, Split, Hrvatsko arheološko društvo (*Izdanja HAD-a*, sv. 1), 1975, 85-95.

-. Etnička struktura stanovništva antičke Liburnije u svjetlu epigrafičkih izvora, *Materijali SADJ*, 15 (*Naseljavanje i naselja u antici*, X. kongres arheologa Jugoslavije, Prilep, 1976.), Beograd, 1978, 67-85.

-Provincia Liburnia, *Diadora*, 9, Zadar, 1980, 363-441 + 3 tab.



Julijan Medini

-Maloazijske religije u rimskoj provinciji Dalmaciji, *doktorska disertacija (rukopis)*, *Filozofski fakultet u Zadru*, Zadar, 1981, 674 str. + 91 t.

-Prilog poznavanju i tumačenju ikonografije božice Dijane u Iliriku, *Radovi Filozofskog fakulteta u Zadru*, 23(10), Zadar, 1983/84 (1984), 17-26.

-Latra dea Neditarum, *Duhovna kultura Ilira*, Posebna izdanja ANUBiH, 67(11), Sarajevo, 1984, 223-243, T. 1-3

-Autohtoni kultovi u razvoju antičkih religija u rimskoj provinciji Dalmaciji, *Dometi*, 17, br. 5, Rijeka, 1984, 7-32 + T. 1-5,


-Zavjetni žrtvenik iz Galovca, *Radovi Filozofskog fakulteta u Zadru*, 26(13), Zadar, 1986/1987, 125-139.

Është i rëndësishëm pa mëdyshje edhe kontributi i Vesna Girardi Jurkić, e cila është marrë me studimin e jetës shpirtërore të banorëve të lashtë të Istrës. Studimet e saja më të njohura në këtë fushë janë:

“Cults in roman Istria”(Kultet në Istren romake), *Histria Antiqua* vol. 13, Pula, 2005, 17-38.,

“Autochthonius and Sincretized deities in Roman Istria”(Hyjnitë autoktone dhe sinkretike në Istrën romake), *Illyrica Antiqua, Ob honorem Duje Rendić Miočević*, FF Pres, Zagreb, 2005, 275-282.;

“*Duhovna kultura antičke Istre*“ (*Kultura shpirtërore e Istrës antike*) vol.I., Školska knjiga, Zagreb, 2005 e disa të tjera..



Prof.dr. Vesna Girardi Jurkić Ballina e librit “Kultura shpirtërore e Istrës antike”

Në grupin stjdjesve që janë orjentuuar kah studimi i kulturës shpirtërore të ilirëve bëjnë pjesë edhe Sineva Kukoç(e cila merret me jetën shpirtërore, besimet dhe simbolizmin e japodëve dhe posaçërisht me kultin e hyjt Binda).

“Kontinuitet solarne simbolike kod Japoda”, *Radovi FFZd* 36, Zadar, 1998, 9-21.

“Grčki simboli u ilirskom svijetu”, *OA* 22, Zagreb, 1998, 7-26.

“Štovanje Binda Neptuna”, *HA* 13, Pula, 2005, 125-134.

“*Japodi-fragmenta simbolica*”, Književni krug, Split, 2009.

Është relevant patjetër edhe kontributi i Stasho Forenbaher, i cili i studjon vendet e shenjta të ilirëve,

“Nakovana Cave: an Illyrian ritual site”, *Antiquity* 75, 677-678.


Spila Nakovana: ilirsko svetište na Pelješcu, VBZ, Zagreb, 2003.

Ante Rendić Miočević, i cili merret me studimin e kulteve të hyjnive ilire (posaçërisht Dijanës dhe Silvanit)

“Sylvanus of the Delmatae and Traces of Cult Syncretism with Liber, Delmatski Silvan i tragovi kultnog sinkretizma s Liberom(Bakhom)”, *HA* 15, Pula, 2007, 33-50.

“Reljefni prikaz Dijane na košuti”, *HA* 18, Pula, 2009, 167-176.

e disa të tjerë (siç janë bie fjala Ivana Jadrić, Ljubica Perinić-Muratović) të cilët janë marrë dhe mirren me studimin e shtrirjës gjeografike të fiseve të ndryshme ilire, të kulturës, artit, onomastikës, të besimeve religjioze dhe të kulteve si dhe të çështjeve të tjera lidhur me banorët e Ilirikut.




Sineva kukoç “Japodët-fragmenta symbolica“ Boris Ollujiq “Historia e japodëve“

Krahas autorëve të cekur më heret duhet përmendur edhe një varg shkencëtarësh të cilët në mënyrë sporadike i janë qasur çështjes së studimit të ilirëve, e të cilët pa qëllime të këqija ishim të detyruar mos ti përfshim në këtë punim tonin.

Rezultatet e hulumtimeve të veta këta shkencëtarë kroat i kane botuar në revista kroate (Vjesnik Arheološkog Muzeja u Zagrebu, Opuscula Archeologica, revistë e Fakultetit Filozofik të Zagrebit, Vjesnik za Arheologiju i Historiju Dalmatinsku e Splitit, Numizmatičke vijesti e Zagrebit, Histria Antiqua dhe Histria Historica të Pulës, Diadora e Zarës), por edhe jashtë Kroacisë (Živa antika Skopje, Glasnik Zemaljskog Muzeja u Sarajevu, Godišnjak ANUBiH-a, Gjurmime Albanologjike Prishtinë, Arheološki Vestnik Ljubljana, Archaeologia Iugoslavica Beograd, Studia Albanica dhe Iliria, Tiranë e mjaft të tjera) si dhe në vepra të veçanta monografike dhe në bibliografi të specializuara të cilat e kanë promovuar ilirologjinë anëmbanë botës.

Siç shihet pra, për pjesën dërmuese të njohjes së historisë dhe të aspekteve të ndryshme të kulturës së ilirëve duhet ti falenderohemi punës së mundimshme të arkeologëve e cila vazhdon edhe sot e kësaj dite si dhe sintezave të mëdha historike të cilat janë aktuale edhe në kohën tonë dhe janë literaturë e domosdoshme për profesorët, studentët dhe për të gjithë ata të cilëve i interesojnë ilirët.

Na mbetet të shpresojmë që kjo punë e gjatë dhe e mundimshme hulumtuese, e cila gjatë disa decenive të fundit ka dhënë rezultate të frytëshme do të gjen interesim edhe ndër gjeneratat e ardhshme dhe që studimi i shtrirjes gjeografike të popujve ilirë, kulturës së tyre, artit, onomastikës, besimeve religjioze, kulteve etë ngjashme do të vazhdojë edhe më tutje.



Revista "Histia Antiqua" Pulë

Revista "Opuscula Archaeologica" Zagreb

Kontribut të rëndësishëm për studimin e historisë së ilirëve kanë dhënë shkencëtarët e shumtë kroat gjatë shekullit 20 dhe në fillim të atij 21. Për disa nga këta ishte interesante qasja etnografike ndaj kështuqë edhe studimet e para shkencore mund ti vërejmë pikërisht në segmentin linguistik siç ishte rasti bie fjala tek studimet e akademikut R. Katiçiq. Por, për pjesën dërmuese të njohjes së historisë së ilirëve duhet ti falenderohemi punës së mundimshme të arkeologëve e cila vazhdon edhe sot dhe kësaj dite si dhe sintezave të mëdha historike të cilat janë edhe sot aktuale dhe janë literaturë e domosdoshme për profesorët, studentët dhe të gjithë atyre të cilët i interesojnë ilirët.

Naser FERRI & Eva Katarina GLAZER

**CONTRIBUTION OF CROATIAN ARCHAEOLOGIST AND HISTORIANS
IN THE FIELD OF ILLYROLOGY**

(SUMMARY)

Croatian territory was inhabited by Illyrians throughout prehistory. There are plenty of archaeological remains that testify to the presence of Illyrian tribes during the Bronze age and from the middle of the 1st millennium we can trace records of them in Greek sources and afterwards from Roman sources as well. Croatian historiography dealt with the history of Illyrians from the very beginning, but we should emphasize that the results of this research must be divided in two phases. First phase of the research started early in the 16th century and lasted till the 19th century and in that period most of Croatian historians collected and published ancient sources, and the political reality (with the intellectual efforts trying to establish national identity) unfortunately took those researchers away from the scientific path by creating a mythological connection between Illyrians and Croats. But, the second phase of illyrology resulted in a scientific renaissance which put the research back on the methodological and scientific path which resulted in many archaeological investigations and research that helped in understanding the history, art and religion of Illyrians.

The earliest mention of Illyrians in Croatian historiography is hard to determine, mostly because it is hard to distinguish early historical research from literary expressions. Most probably, the earliest record of the Illyrians is the one written by Juraj Šižgorić in the 15th century. His work *De situ Illyriae et civitate Sibenici* is a geographical work about the town of Šibenik and the geography of Illyricum, but it wasn't written for the purpose of the reconstruction of history, instead it was a rather patriotic work in the time of the Turkish campaigns. During the 17th century Juraj Ratkaj published his work *Memoria regum et banorum regnorum Dalmatiae, Croatiae et Sclavoniae i Inchoata ab origine sua, et usque ad praesentem anum MDCLII*, a monumental work considered to be the earliest systematic paper about the Croatian land and people. Ivan Lučić Lucius set the foundations of Croatian historiography with his *De Regno Dalmatiae et Croatiae* published in 1666., and he is the first historian who collected and presented many classical sources in that work. The political situation in Croatia during the 17th and 18th century oriented historians to focus their research on aspects of history which can determine the connection of the Croats to the people who inhabited the land in ancient times and also to provide proof of the ownership of these lands. In the 18th century Pavao Ritter Vitezović published his work *Croatia rediviva regnante Leopoklo Magno Caesare* and with some of his other works it represented the idea of unification of all Croatian lands, a sort of "Great Croatia= Illyriana". He implanted the thought of Illyrian language as the one which will unite all Croats and his ideas found their way to Ljudevit Gaj, the founder of the Illyrian

movement. We should also note that Vinko Pribojević wrote *De origine successibusque Salvorum* in the 16th century and in it he incorporated the Illyrian myth and also the pan-Slavic myth. Ljudevit Gaj wrote numerous articles in his paper *Novine Horvatzke* (which changed their name in 1936. to *Ilirske narodne novine*) and in those papers Gaj quoted many classical authors (such as Herodotus and Livius) trying to explain who were the Illyrians and trying to establish the newborn Croatian spirit, but enabled to carry out the Illyrian movement Gaj directed the movement towards growing aspirations trying to prove the pan-Slavic theory in which all Slavs were the descendants of the ancient Illyrian tribes.

A large step forward in Croatian historiography was introduced in the 20th century. Alojz Benac and Borivoj Čović made a huge improvement in illyrology by discrediting earlier theories and by establishing a theory that Illyrians were an autochthonous groups of people who inhabited the Balkan area. By that time many archaeological excavations provided new material and better insight in Illyrian culture and from the middle of the 20th century onwards we can trace truly scientific achievements in Croatian historiography.

First of all we should mention the work of Aleksandar Stipčević. He wrote the first synthesis on Illyrian art *Arte degli Illiri*, published in 1963. in Milan in Italian language, and in 1966. *Gli Illiri (Uomo e mito)*. His comprehensive work *Iliri. Povijest, život, kultura* published in 1974. in Zagreb in Croatian became the first obligatory literature for every historian and by this day this book experienced nine editions, and was translated in four languages.

Duje Rendić Miočević is a Croatian archaeologist and historian who has done important work investigating Illyrian onomastic, history and cult and he wrote numerous works on the subject of illyrology from the period 1948. to 1989. resulting in his great masterpiece *Iliri i antički svijet* published in 1989. in Split. His fellow colleagues Mate Suić and Marin Zaninović must not be left behind. Their comprehensive work on the Illyrian tribes of Liburni, Japodi and Delmati made foundations for all the succeeding researchers.

Not only did the archaeological revelations improved the knowledge of Illyrians, there were also very important linguistical researches that provided better insight in the history of Illyrians. The most important ones were the works of Radoslav Katičić, a Croatian academic whose works such as “*Illyrii proprie dicti*”, “Zur Frage der keltischen und pannonischen Namengebieten im römischen Dalmatien”, *Ancient languages of the Balkans* and *Illyricum mythologicum* published in 1995. in Zagreb provided valuable resources for future research. Many archaeologist and historians focused their research primarily on the religious aspects of Illyrian culture and their cults. Vesna Girardi Jurkić wrote many papers on the religion of the Illyrian tribe Histri, such as “Cults in roman Istria”, “Autochthonous and Syncretised deities in Roman Istria”, and *Duhovna kultura antičke Istre I* published in 2005. in Zagreb.

Sineva Kukoč investigated solar cults in the Illyrian tribe of Japodi and her latest work is a synthesis of her early works *Japodi-fragmenta simbolica* published in 2009. in Split.

Stašo Forenbaher excavated a cave at the Pelješac peninsula with his colleague Timothy Kaiser and revealed a well preserved Illyrian sanctuary. Their results can be found in a paper “Nakovana Cave: an Illyrian ritual site” and in a book *Spila Nakovana: ilirsko svetište na Pelješcu* written both in Croatian and English and published in 2003 in Zagreb.

Many Croatian archaeologists and historians focused their research on the history of Illyrians, some of them producing valuable results in their final thesis (both MA and PhD), such as Julian Medini's MA thesis *Antički kultovi na području ilirskih plemena Histra, Liburna i Japoda* from 1974., Slobodan Čače's PhD thesis *Liburnija od 4. do 1. stoljeća p. n. e.* from 1985., Boris Olujić's PhD thesis *Japodi od 5. do 1. stoljeća prije Krista. Kultura u prostoru između latenske kontinentalne i jadranske (sredozemne) civilizacije* from 1999., Siniša Bilić Dujmušić's MA thesis *Ratne operacije u provinciji Ilirik 49.-47. pr. Kr.* from 2001. and his PhD thesis *Oktavijanova kampanja protiv Delmata 34.-33. pr. Kr.* from 2005.

Croatian scientists published their results in many relevant journals in Croatia such as VAMZ, *Opuscula Archeologica* (OA), VAHD, *Numizmatičke vijesti*, *Histria Antiqua* (HA), *Diadora*, and also many international journals such as *Živa antika*, GZM, *Godišnjak ANUBiH-a*, GJASSHH, AV, AI, *Studia Albanica*. They also organized many symposiums on the subject of illyrology and many papers were published in international proceedings of conferences and in specialized monographs and bibliographies.

It is important to note that there are plenty more Croatian historians and archaeologist who dealt with the illyrological subjects in their research but who couldn't be mentioned in this brief overview.

NAIM HALIMI

KOLONIZIMI I VISEVE SHQIPTARE TË MAQEDONISË NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Kolonizimi i viseve shqiptare që sot përfshihen në Republikën e Maqedonisë filloi në Luftën e Parë Ballkanike, atëherë kur Serbia e pushtoi Luginën e Preshevës, pjesën më të madhe të Kosovës dhe nëpërmjet tokave të Shqipërisë së mesme doli në bregdet, në Durrës, në Detin Jon, në Adriatik. Atëherë Serbia, edhe nëpërmjet tokave maqedonase, synoi të dalë në Selanik, në Detin Egje, në Mesdhe.

Shqiptarët nuk u pajtuan me pushtimin, me aneksimin, me zgjedhën e re, të Serbisë. Serbia, u detyrua të përballet me qëndresën jo vetëm të një numri të madh të popullsisë shqiptare, kompakte, por edhe luftarake e të panënshtuar, e cila nuk i ndërpreu përpjekjet për çlirim e bashkim kombëtar, përkundër terrorit të madh që u ushtrua mbi të. Për ta shtypur qëndresën dhe për ta ndryshuar gjendjen etnike të popullsisë shqiptare në favor të elementit sllav, qeveria serbe vendosi pushtetin ushtarako-policor dhe zbatoi një politikë shoviniste e gjenocidale ndaj shqiptarëve, të shpërnguljes së tyre nga trojet e të parëve dhe të kolonizimit të tokave të tyre, me familje sllave, serbe, etj. Me këto mjete dhe shumë të tjera, të karakterit ekonomik, politik, ideologjik, ushtarak, etj., qarqet drejtuese të Serbisë donin ta vendosnin përgjithmonë sundimin dhe shfrytëzimin kolonial në trevat shqiptare, kuptohet edhe në ato që sot gjenden në territorin e Republikës së Maqedonisë, me kohë të arrinin asimilimin dhe sllavizmin e tyre.

Në këtë kohë tiparin kryesor të politikës pushtuese ndaj shqiptarëve e përbën dhuna dhe terrori ushtarak deri në gjenocid, i përcjellë me grabitje të tokës dhe kolonizim. Plaçkitja e kolonizimi nisi pa ligje e shkresa, me kërkesa e urdhëresa, kush si donte, dinte e mundej. Objekt plaçke u bënë pasuritë e shqiptarëve. Në fillim për qëllime kolonizimi u përdorën kryesisht pasuritë, shtëpitë, tokat e shqiptarëve, të braktisura, të atyre shqiptarëve që u treguan aktivë në kundërshtimin e pushtimit serb dhe të atyre që ishin të dyshimtë, madje edhe të atyre që s'kishin e kishin dokumente pronësie, tapi. Nga kjo grabitje e kolonizim shumë pushtetarë e spekulantë serbë filluan të pasurohen. U krijuan komplekse ku do të vendoseshin kolonët.

Madje plaçkitja, kolonizimi dhe pasurimi i tyre u ligjësuara me Dekretligjin e vitit 1914 dhe u ndihmuara nga shteti. Shteti kolonëve tani ua caktonte kush ku duhet të vendoset dhe kur. Për këtë punë u angazhua Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ato mblidhnin të dhëna për sipërfaqen e tokës, cilësinë, etj., për interesimin e kolonëve, pranimin e tyre,

vendosjen, ndërsa punën në terren e ndiqnin rojtarët e pyjeve, nëpunësit e policisë, ekonomët, kryetarët e rretheve e të komunave, kryepleqtë e fshatrave, njerëzit e caktuar për këtë punë. Sipas këtij plani, deri më vitin 1915 u përgatitën rreth 12 mijë familje serbe për t'u vendosur në trevat shqiptare e maqedonase, duke përfshirë edhe rrethin e Shkupit e të Manastirit, të banuara me shumicë shqiptare, vatra të lëvizjes kombëtare, mirëpo fillimi i Luftës së Parë Botërore e ndërpreu përkohësisht.¹

Procesi i nisur i kolonizimit, shkombëtarizimit dhe sllavizimit të tokave shqiptare, të aneksuara përsëri nga monarkia serbe, vazhdoi me një herë pas mbarimit të luftës. Për këtë qëllim, më 1919 u shpall dhe u shfrytëzua e ashtuquajtura reformë agrare. Ajo, në vend që të ishte demokratike, u bë shoviniste e borgjezisë serbomadhe, e cila synim parësor pati kolonizimin e rajoneve të banuara me shqiptarë dhe ndryshimin e përbërjes etnike të popullsisë, në viset e përmendura, ku popullsia e fshatit, me gjithë ndryshimet që kishin ndodhur gjatë viteve 1912-1918, vazhdoi të përbënte rreth 90% shqiptarë, kundrejt 10% të pakicave sllave. Këtij qëllimi i kontribuuan dispozitat paraprake për zbatimin e reformës agrare, urdhëresa e regjentit dhe Dekretligji për kolonizimin e viseve të reja jugore i 24 shtatorit 1920. Ai doli me firmën e regjentit dhe ishte i destinuar vetëm për trevat shqiptare dhe maqedonase. Me anën e këtij dekreti, qarqet drejtuese të Beogradit synonin ta bënin kolonizimin shpronësimin e tokave private dhe të përbashkëta të fshatarëve, madje edhe të qytetarëve shqiptarë. Dekreti parashihte plotësimin e dëshirave të të gjitha shtresave të shoqërisë serbe, e në rend të parë “atyre që kishin merita për çështjen jugosllave”, në fakt “vullnetarëve”, çetnikëve, optantëve, emigrantëve, nëpunësve, ushtarakeve, etj., si dhe të tjerëve që merreshin e s'merreshin me bujqësi dhe zejтари. Toka parashihej edhe për kooperativat agrare, organizatat ekonomike, entet shtetërore, civile, ushtarake, fetare ortodokse, etj. Duke pasur përkrahjen e regjimit, tokë e pasuri tjera fituan edhe pakicat serbe e maqedonase që jetonin në trevat shqiptare. Dekreti parashihte edhe shumë favore për kolonët, ndërsa afrimin, shoqërimin, miqësimin me shqiptarët e ndalonte, e konsideronte tradhti. Si me këto, ashtu edhe me ligjet tjera, shqiptarët në Mbretërinë SKS-ë dhe atë Jugosllave konsideroheshin element i padëshiruar, antishtetëror dhe si i tillë duhej asimiluar dhe dëbuar.

Për zbatimin e reformës agrare u formuan edhe organet e saj. Më parë në Beograd u krijua “Zyra shtetërore për reformën agrare”, në vartësi të së cilës në Shkup vepronte Drejtorja e Kolonizimit, pastaj “Ministria e Reformës Agrare”. Për kolonizimin e trevave shqiptare në Shkup, më 1920, u ngrit Drejtorja apo Zyra e Lartë Agrare, në vartësinë e të cilave ishin zyrat e qarqeve, rretheve dhe komunave,

¹ .Hakif Bajrami, Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë 1918-1941, Prishtinë, 1981, f.10-20. Liman Rushiti, Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918, Prishtinë, 1986, f.100-140. S.Martinoviq, Qëndrimi i ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve në viset e pushtuara në vitet 1912-1913, në, Gjurmime albanologjike”nr. VII, Prishtinë, 1978, f.250-260. Gjorgje Krstiq, Kolonizacija na Juzhnoj Serbiji, Sarajevo, 1928, f.5-7. M.Obradoviq, Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovo 1918-1941, Prishtinë, f.100-105. Aleksandar Apostolov, Kolonizacija na Makedonija vo stara Jugoslavija, Shkup, 1966, f. 35-40.

me organet e tyre. Për nevojat e kolonëve në Shkup u formua edhe “bashkësia agrare”, ku kolonët anëtarësoheshin dhe i merrnin ndihmat e nevojshme. Në Shkup themelohet edhe “Gjykata e Lartë Agrare”. Sipas ligjit për kolonizimin (11.6.1931), qendra të drejtorive agrare në trevat shqiptare, ku sot jetojnë shqiptarët në Maqedoni, ishin: Shkupi (për rrethet e Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kumanovës, Preshevës, etj.), Manastiri (për rrethet e Manastirit, Ohrit, Strugës, Dibrës, Kërçovës, Prilepit, Velesit, etj.)²

Qëllimi që donte të arrinte borgjezia serbomadhe, me kolonizimin e tokave shqiptare, shihej jo vetëm në legjislacion, por edhe në programet e partive politike, në shoqata, organizata, personalitete dhe te intelektualët e saj. Të gjithë ata e konsideronin normal, madje edhe të domosdoshëm, shkombëtarizimin e trevave shqiptare, madje dhe si mjet të përshtatshëm për shuarjen e LKSH-së. Pra, të gjithë qëllimin e kishin të njëjtë, vetëm metodat, mjetet dhe koha mund të ndryshonin. Ngjashëm, mendonte Partia Demokrate dhe ajo Radikale, madje kjo e fundit, me Nikolla Pashiqin, e para e kishte filluar kolonizimin serb të viseve shqiptare. Që të dyja, shqiptarët i konsideronin si “një grusht turqish të kolonizuar, që duhej sa ma shpejt të shpërngulen në Turqi”. Si këto, po thuaj mendonte dhe vepronte edhe Socialdemokracia e djathtë serbe, madje këta i ngarkonin kolonëve edhe misionin e “qytetërimit” të shqiptarëve. Me kolonizimin e tokave shqiptare u morën pothuajse të gjithë funksionarët e lartë të Mbretërisë SKS dhe asaj Jugosllave, si Sretan Vukosavleviqi, i plotfuqishmi i parë i lartë agrar për trevat shqiptare e maqedonase, në Shkup, Gjorgje Krstiqi, ministri i punëve të brendshme Millorad Vujiqiqi, kryeministri Nikola Pashiqi, etj. Kësaj politike i shërbente edhe gazeta “Politika”, revista Policija”, broshura “Kolonizimi i Serbisë Jugore”, “Klubi serb i kulturës”, etj. Kësaj çështjeje antishqiptare shumë i ndihmuan edhe dr. Atanasie Urosheviqi (pseudo)shkencëtar, gjenerali Çemerkiqi, Millan Jeçmeniçi, Gjoko Perina, deputeti i opozitës Orestie Krstiqi, dhe mbi të gjithë Vasa Çubrilloviqi, i cili përpunoi projektin për shkombëtarizimin e shpejtë të trojeve shqiptare, e që u vlerësua më i miri.³

Pavarësisht nga këto dhe ndryshimet që kishin ndodhur, popullsia shqiptare, fshatare dhe qytetare në përgjithësi i mbronin fortë tokat, pronat e tyre. Ata nuk ishin kundër reformës agrare, por kundër kolonizimit, kundër ardhjes së sllavëve, serbëve e të tjerëve dhe marrjes së tokave, vendosjes në tokat e tyre. Shqiptarët me të drejtë i konsideronin tokat dhe pasurit e tyre jo vetëm si mjet

² .Urdhëresa e regjentit dt.27.7.1919,A.Apostolov,vep.e përm.f.90-100.M.Obradoviq,vep.e përm.f.105-115.Zakon o naselavanje juzhnih krajeva.1931.Agrarna reforma-uredbe,naredbe i zapisi,Zagreb,1921,f.10-15.AQSH,Fondi 266,viti 1942,dos.105,fl.5.AQSH,Fondi 251,viti 1932,dos.42,fl.99-100.Ligji mbi kolonizimin i 11.6.1931.AQSH,Fondi 252,viti 1919,dos.8,fl.345.Ali Hadri,Gjakova prej themelimit deri në vitin1941,në„Kosova’nr.1,Prishtinë,1972,f.424.

³ .Zekiria Cana,Çështja shqiptare në shtypin e Socialdemokracisë serbe 1908-1912,në„Përparimi’’,Prishtinë,1976,f.298-300.AQSH.Fondi 251,viti 1924,dos.276,fl.1-5.Deklarat e min.të pun.brendëshme M.Cemoviq dhënë shtypit të Beogradit 1924.Gjorgje Krstiq,Kolonizacija na Juzhnoj Serbije,Sarajevë,1928,f.40-45.Vasa Çubrilloviqi,Iselavanje arnauta.Elaborat i mbajtur në „Klubin serb të kulturës’’,në Beograd,më 7 mars 1937.

jetese, por edhe si trojet e të parëve të tyre, si pjesë të atdheut, që nuk mund t'ia lëshonin armikut.

Qarqet drejtuese të Beogradit, nuk u përmbajtën në drejtësi dhe fqinjësi të mirë. Vazhduan, madje edhe e shtuan, kohë pas kohe, rrëmbimin e tokave shqiptare, çdo kund ku kishte shqiptarë. Këta keqbërës nuk u kënaqën vetëm me konfiskimin e pasurisë, së kundërshtarëve politikë “kaçakëve”, siç i quanin ata, me djegien e shtëpive, internimin e familjeve të tyre, etj., por ngjashëm vepruan edhe me përkrahësit, madje edhe me tërë vendbanimin që organizonin rezistencë. Plaçkitja, djegia e pasurive, shtëpive dhe dëbimi i shqiptarëve, për të vendosur në tokat e tyre kolonë sllavë, u bë përditshmëri, në shumë fshatra e qytete shqiptare, në jug të Karadakut e Sharrit, madje edhe në trevat maqedonase. Popullsia shqiptare, pa marrë asgjë nga pasuria, u detyrua të ikë, për të shpëtuar kokën. Kështu, terroristi P. Raçiq, njeri i besuar i oborrit dhe qeverisë, përveç të tjerave mori edhe 50 ha tokë në rajonin e Malit të Zi të Shkupit dhe shumë të tjera në rrethin e Ohrit. U pasurua edhe vojvoda i Velesit, Vasilie Tërbiqi, nëpunës i Drejtorisë së Lartë Agrare të Shkupit, duke marrë shumë toka të shqiptarëve, në qarkun e Shkupit, Tetovës, Prilepit e Manastirit. Ky i fundit, me toka të shqiptarëve i shpërbleu edhe çetnikët e tij dhe njerëzit e besuar të pushtetit. Përveç këtyre, sekuestrimet arbitrave vazhduan edhe në vende tjera. Nëpunësit agrarë u dukën edhe në fshatrat e rrethit të Prespës. Në fshatrat Bellocërkë të Siperme e të Poshtme, Kozjak, etj., fshatarëve shqiptarë ua grabitën tokën sa deshën dhe ia dhanë elementit sllav, maqedonas. Deputeti i Resnjës Popoviq, në këtë kohë, deklaronte se çdo përpjekje për ta ndalur këtë padrejtësi ishte e kotë, sepse kështu kishin vendosur organet më lart, që kishin qëllim 25 km. larg kufirit me Shqipërinë ta largojnë popullatën muhamedane, kuptohet edhe shqiptare. Ngjashëm deklarorin edhe deputetët e tjerë nga Resnja, Prespa dhe Ohri. Gjatë qershorit, thuhet në raport, organet kolonizuese u dukën përsëri në rrethet e Manastirit, në fshatin Ostrec dhe në 25 fshatra të tjerë që ishin me popullsi shqiptare dhe të Prilepit, në katundet Aldencë, Nerovë, Lllazar, Dobrishtë, ku komisionet, agrare duke ua sekuestrua tokën fshatarëve shqiptarë, u kishin thënë që sa ma shpejt të larghen, sepse Jugosllavia nuk ka vend për ta. Edhe fshatrat e rrethit të Strugës, Dibrës, Kërçovës, Gostivarit e Tetovës, mbetën nën goditjen e organeve agrare, ndërsa ankesat, si gjithmonë, nuk dhanë rezultate.⁴

Tokat që ua morën shqiptarëve ua dhanë kolonëve serbë që ishin e s'ishin bujq. Kështu u veprua edhe ndaj bujqve shqiptarë të rrethit të Shkupit. Ekzistojnë të dhëna se kolonët serbë, që i morën tokat e shqiptarëve, u kthyen në pronarë edhe më të egër se çifligarët e dikurshëm. Kishte raste kur pronari shqiptar i kthyer në rrogëtar, bujk fshatar, punonte me muaj të tërë te koloni, zotëria i ri “gazda” dhe në fund, në vend të pagës merrte dajak prej tij ose xhandarit.

⁴ .A.Apostolov, vep. e përm.f.180-190. Ali Hadri, art. i përm.f.175-180. Gazeta, „Shqipëria e Re” Kostancë, 5.2.1931. Protestë e H. Prishtinës drejtuar Lidhjes së Kombeve. AQSH, Fondi, 151, dos.107, fl.22-22. M. Verli, vep. e përm.f.77-78. M. Obradoviq, vep. e përm.f. 110-15., „Lirija kombëtare”, Gjenevë, 11.3.1929. H. Bajrami, vep. e përm.f.15-35. AqSH, Fondi 252, viti 1930, dos.194. fl.355.

Duhet theksuar edhe atë se, për të dobësuar unitetin e fshatarësisë shqiptare, organet agrare kolonizuese e përqendruan goditjen ndaj bujqve të besimit mysliman, kurse shqiptarët katolikë, që ishin në numër më të vogël, u prekën më pak, ndërsa te ata ortodoksë edhe më pak, sepse regjimi besonte se ata mund të asimiloheshin më lehtë me ndihmën e fesë ortodokse serbe. Me këtë, siç vërtetojnë pothuaj të gjitha burimet, qarqet sunduese të borgjezisë serbomadhe donin të tregonin sesa reforma agrare kolonizuese është demokratike, e, në fakt, tërë popullsisë shqiptare i kishte shpallur luftë, pa marrë parasysh cilës fe apo shtrese shoqërore i takonte.

Pos shpronësimeve, popullsia shqiptare njohu edhe forma të tjera presioni e plaçkitjeje, si p.sh. ajo u vu edhe përballë një fushate të egër për rekuizimin e drithit, kudo që e gjente, në treg, në hambar apo në arë.

Beogradi ndoqi një politikë të egër edhe me pronat e institucioneve fetare, myslimane dhe katolike, të cilat ishin në shërbim të besimtarëve shqiptarë. Kështu u konfiskuan pronat e disa xhamive në rrethin e Shkup, që kishin nga disa fshatra, madje edhe në qytet, pa asnjë dëmshpërblim, si Xhamia e Madhe “Burmali”, pasuria e xhamisë Mustafa Pasha, etj., tokat e Teqesë së Tetovës rreth 1.000 he, pasuritë e varrezave në Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe shumë “vakëfe” anë e kënd vendit, ku u vendosën shumë koloni dhe kolonë, të cilët siguruan pozitë sunduese të privilegjuar.

Qarqet drejtuese të Beogradit synonin të krijonin për shqiptarët gjendje të padurueshme dhe t’u impononin atyre shpërnguljen. Organet kolonizuese së bashku me ato policore e ushtarake, vazhduan t’i furnizonin kolonët edhe me armë e municion, ndërsa shqiptarët i çarmatosnin. I gjithë pushteti ushtarako-policor u aktivizua për të vendosur kolonë sllavë në tokat e pasura të punueshme të shqiptarëve. Me të madhe reklamuan tokat dhe klimën e favorshme. Kështu nga viset malore të Kozjakut, Pçinjës, Karadakut e Sharrit, fshatarët serbë zbrisnin për të marrë tokë, e merrnin në luginat e rrafshinat, më të afërta të Preshevës, Kumanovës, Shkupit e Tetovës. Qarqet sunduese të Beogradit, me ndihmën e kolonëve, kishin për qëllim të siguronin nyjat e komunikacionit dhe pikat më të rëndësishme strategjike në trevat shqiptare, si rreth vijave hekurudhore, rrugëve kryesore, që e lidhnin vendin me vise tjera, rreth lumenjve, liqeneve, në fushat pjellore të Preshevës, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës, Ohrit, Manastirit, Prilepit, Velesit e Ovçepoles. Sipas planit urbanistik, vendbanimet e kolonëve, të ardhur nga vise të ndryshme, veçmas e në grupe, kryesisht u ngritën të ndara nga ato të vjetrat, por kishte edhe të përziera, madje kishte raste kur koloni kishte hyrë në shtëpinë e shqiptarit dhe jetonte në katin e parë apo të dytë, ku i konvenonte atij. Kështu, 380 familje kolonësh, kryesisht serbë, nga Lika e Banati u vendosën në qarkun e Kumanovës, në Tabanoc, Umindoll, Lubodrag. Tokë pjellore morën edhe serbët vendas të 10 fshatrave në jug të Shkupit. Si kolonë përfituan edhe banorët e Poreçit dhe Kriva-Pallankës. Në rrethin e Tetovës, përveç kolonisë së vjetër të Rapatovës, u ngrit edhe kolonia e Bervenices dhe disa koloni të tjera, ku u vendosën elementë çetnikë, nga Llapova (Serbi), Hercegovina dhe Tetova. Autoritetet agrare kishin planifikuar, projektuar edhe kolonizimin gjatë vijës hekurudhore Tetovë-Gostivar. Një koloni ruse u

themelua në rrethin e Kërçovës. Kolonizimi kishte përfshirë edhe viset e Strugës, Ohrit, Resnjes dhe Manastirit, ku përveç kolonistëve ardhacakë, pasuri përfituan edhe disa familje vendase maqedonase “të besuara”.⁵

Kolonët ishin në shërbim të shtetit, përkrah tyre, madje edhe roje të pa paguara. Përveç kolonëve që vinin në mënyrë të organizuar, burimet e kohës njoftojnë se eprorët ushtarakë dhe ata që ishin të fortë me shtetin, në këto vise, sillnin krye në vete kolonë duke ua mundësuar atyre të vendoseshin ku të donin. I vetmi shkak që i pengonte ata ishte rritja dhe kompaktësimi i qëndresës së popullsisë shqiptare në këto vise.

Megjithatë, kolonizimi i viseve shqiptare nuk u ndalua, vazhdoi nga viti në vit dhe nga njëri vend në tjetrin. Në kolonizim, shpronësimin e tokave shqiptare, morën pjesë të gjitha shtresat e shoqërisë sllave, para së gjithash serbe, të varfër e të pasur, nëpunës civilë dhe ushtarakë. Një pjesë e madhe e tyre, veçanërisht me origjinë serbe, ishin “vullnetarë” të luftërave të mëparshme, çetnikë e familjarë të tyre, fshatarë e spekulantë të llojllojshëm dhe njerëz të diskredituar në vendin e tyre, hajdutë e familje hajdutësh, të dënuar me burg e të liruar, etj., me fjalë të tjera njerëz pa ndjenja, pa shpirt, të poshtër, të cilët ishin më të përshtatshëm për ta terrorizuar popullatën shqiptare. Këtë e dëshmojnë edhe njerëz të besuar të shtetit, si Gjorgje Krstiqi, i plotfuqishmi i lartë agrar në Shkup, i cili për vete mori një pronë të madhe në afërsi të Shkupit. Kjo dorë kolonësh në përgjithësi, të pasuruar e të privilegjuar, arriti një standard jete më të mirë se vendësit, e shumë herë më të mirë se shqiptarët, të cilët në të gjitha aspektet poshtëroheshin, varfëroheshin dhe përziheshin nga vendet e tyre. Kjo gjendje vazhdoi pa ndërprerje deri ditën e shkatërrimit të Mbretërisë Jugosllave.

Kuptohet, tokat e grabitura arbitrarisht mund të mbaheshin vetëm me dhunë, forcë, armë. Borgjezia serbe diti ta shfrytëzojë këtë fakt për t'i përdorur kolonët si forca të gatshme ushtarake kundër shqiptarëve. Kolonët herë vetë e herë së bashku me xhandarmërinë, i sulmuan fshatarët shqiptarë deri në arat apo pasuritë ku punonin, por shpeshherë ndeshën në qëndresë të fortë, e cila u kthye në përleshje të ashpër, që i ngjante luftës. Me qëndrimin antishqiptar që patën kolonët në përgjithësi, e komprometuan veten si vegla të qarqeve sunduese të Beogradit. Kolonistëve krahë të fortë u dhanë edhe organizatat terroriste “Narodna odbrana” dhe “Bella ruka”. Si rezultat i gjithë asaj, në trevat shqiptare në jug të Karadakut e Sharrit ose më mirë në trevat shqiptare që sot përfshihen në R. e Maqedonisë dhe në të gjitha trevat maqedonase të asaj kohe në Jugosllavi të marra së bashku u instaluan rreth 4,127 familje kolonësh. Rezultati nuk kërkon koment. Në trevat shqiptare hodhën themelet 7 herë më shumë shtëpi për kolonët se në trevat maqedonase. Statistikat jugosllave të kohës përmendin 280 koloni në trevat shqiptare në jug të Karadakut e Sharrit dhe në trevat maqedonase, shumica e këtyre

⁵ .H.Bajrami,vep. e përm.f.50-60.A.Apostolov,vep.e përm.f.115-120.A.Hadri,art. i përm.f.590-595.Gj.Krstiq,pun. I pëm.f.1-5.A.Apostolov,vep.e përm.f.115-120.AQSH.Fondi 251,dos.93,viti 1932,fl.60-65.M.Obradoviq,vep. e përm.f.160-170.H.Islami,e vërteta mbi shqiptarët në disa vepra antropogjeografike, në, „Dituria”nr.1,Prishtinë,1971,f.80-85.H.Kokollari,vep.e përm.265-280.AQSH.Fondi 251,viti1928,dos,152,fl.50-55.

u përkiste viseve ku ishte e pranishme shumicë e në masë të konsiderueshme popullsia shqiptare. Kjo e bën të kuptueshme se në trevat shqiptare kolonët shtinë në dorë shumë herë më tepër tokë se në trevat maqedonase.

Kolonitë dhe numri i kolonëve rritet shumë edhe në qytete. Pothuajse nuk kishte qytet ku banorin shqiptarët që nuk ishte ngritur së paku një koloni sllave, serbe. Si rezultat i këtyre rritet edhe numri i banorëve. Kështu, vetëm në Shkup, në vitin 1936 numëroheshin 30 mijë banorë “serbë jo vendas”, të cilët përbënin më shumë se 40% të popullsisë së qytetit, kurse në periferi të qytetit ishin vendosur rreth 10 mijë veta. Pothuajse e ngjashme ishte gjendja edhe në qytete e tjera.⁶

E gjithë politika agrare kolonizuese për popullsinë shqiptare pati pasoja të mëdha. Ajo u shpronësua në masë e u varfërua si asnjëherë më parë. Dhjetëra mija familje u detyruan të shpërngulen nga atdheu i tyre për t’u hapur vend kolonëve të ardhur sllavë. Ekonomia pësoi humbje për shumë kohë. Marrëdhëniet ndërnacionale u acaruan.

Synimi kryesor i kësaj politike kolonizuese dështoi. Popullsia shqiptare, fshatare dhe qytetare, nuk u nënshtrua, dhe trevat e saj etnikisht kompakte, nuk u shkombëtarizuan. Regjimi i Beogradit arriti diçka ta ndryshojë përbërjen etnike të popullsisë shqiptare në këtë trevë, por jo në shkallën që ajo donte, shqiptarët, si përherë mbetën shumicë dhe vazhduan jetesën, qëndresën, lëvizjen kombëtare.

Lëvizja e shqiptarëve për tokë e liri qe masive dhe revolucionare. Ashpërsia u shtua sipas shtrirjes së reformës, ku morën pjesë të gjitha shtresat e popullsisë, e sidomos ajo e varfër dhe e mesme, ndërsa udhëheqëse qe shtresa e pasur. Shtresa e pasur, duke qenë në krye të lëvizjes, përpunoi kërkesat e shqiptarëve dhe siguroi përkrahjen e jashtme të Fuqive të Mëdha. Lëvizja që nga fillimi nisi të zhvillohet fuqishëm. Si duket, te ajo ndikoi fryma kombëtare e Kongresit të Lushnjës dhe Lufta e Vlorës, thelbi i së cilës ishte bashkimi i të gjitha trevave shqiptare në një shtet të vetëm kombëtar, të pavarur. Lëvizja e kishte nismën, në odat e miqve, në shtëpitë e shqiptarëve, të cilat ishin institucione tradicionale me rëndësi shumë të madhe për çështjen kombëtare, aty ku burrat kuvendonin, merrnin mësim dhe pajiseshin me ndjenja e vetëdije kombëtare gjeneratat e reja.

Lëvizja nisi duke iu kundërvënë e likuiduar ata që bashkëpunonin me pushtuesin dhe me ata që pajtoheshin t’i merrnin pasuritë e luftëtarëve shqiptarë dhe të prijësve të tyre. U krijuan pothuajse në të gjitha zonat çeta të luftëtarëve shqiptarë, të cilët luftonin për t’i dalë zot vendit e popullit. Çetat patriotike, si ajo e Xhel Gurit në Karadak e Kalosh Dan-Zajazit në Kërçovë, e shumë të tjera, përveç luftës me xhandarë e ushtarë, sulmonin e vrisnin edhe nëpunës e kolonë, agresivë, që shquheshin për keqtrajtimin e popullit shqiptar. Drejtues të këtyre çetave patën bashkëpunim të fortë me grupet atdhetare të Xhemijetit dhe Komitet MKK. Nga atdhetarë të shquar të kombit e të përkrahur nga populli, në këtë kohë, u organizuan shumë protesta e mitingje dhe u shkruan memorandume, siç ishte mitingu i Dibrës

⁶ .A.Apostolov, vep. e përm.f.90-10.AQSH,fondi 251,viti1921,dos.93fl.20-30.H.Bajrami,vep.e përm.f.20-65.Gj.Krstiq,pun.i përm. f.5-10.AQSH. Fondi 249,viti 1922,dos.III-389,fl.1-10.M.Obradoviç,vep.e përm.f.190-200.L.Rushiti,vep. e përm.f.30-40.A.Hadri,pun.i përm.f.165-170.AQSH,Fondi 261,viti 1941,dos.99.fl.8-10.

(1922), memorandumet dorëzuar kryeministrit Stojadinoviq në Shkup (1936,1938), etj. Po në këtë kohë fshatarësia shqiptare nga qarku i Dibrës, Strugës dhe Ohrit, dërgoi një delegacion në Shkup për të kërkuar ndërprerjen e veprimeve të organeve agrare. Kështu vepruan edhe fshatarët shqiptarë të rrethit të Manastirit. Për gjendjen e rënd të popullsisë shqiptare e ngriti zërin edhe senatori tetovar Xhafer Sulejmani, deputeti i Gostivarit Kadri Saliu, dhe senatori nga Dibra Muhamet Zllatku. Mbi veprimtarinë e autoriteteve agrare kolonizuese, në emër të popullsisë së rrethit të Tetovës, një delegacion prej 50 vetash, protestoi në Beograd. Si rezultat i këtyre dhe veprimeve të tjera të shumta, thuhet se kryeministri Stojadinoviq dhe regjenti Pavle pranuan kërkesat dhe premtuan se “do t’u ndalonin marrjen e tokës dhe dëbimin e shqiptarëve në Turqi”.⁷

Kjo qëndresë ishte faktori kryesor që çoi në disfatë, atëherë edhe më vonë, projektin e sllavizimit, serbizimit të këtyre viseve, trevave kompakte shqiptare.

⁷ .Mark Krasniqi,Gjurmë e gjurmime’’Tiranë,1982,f.450-460.AQSH.Fondo 252,viti 1922,dos.86,fl.1-5.Gj.Krstiq,pun.i përm. f. 1-5. AQSH, Fondi 286, viti 1921,dos.33/1.H.Bajrami, vep.e përm. F. 125-130.AQSH. Fondi 251, viti 1924,dos.101,fl.50-55. „Liria Kombëtare’’Gjenevë,1 janar 1928,f.4. M.Piraku,vep.e përm.f.360-365.AQSH. Fondi 252, viti 1936, dos. 126, fl. 90-100. AQSH, Fondi, 251, viti 1936, dos. 165.fl.11.M.Verli,vep.e përm.f.170.AQSH.Fondi,251,viti 1938,dos.107/1,fl.215-220.

SHPËTIM ÇUÇKA**NJË JETË PËR GJUHËN E NJËSUAR**

(kujtimit të Androkli Kostallarit)

*Sot varret tuaj s'dihet se
ku janë dhe dija shpesh
(sa shpesh!) me vesin
puqet.
E mira juaj rron diku
mënjandë,
siç rrojnë dhe të gjorat
lulëkuqe.
("Dëshmorëve të shqipes")*

Një valëzim mendimesh më zgjon sa herë figura e gjuhëtarit Androkli Kostallari.

Për shembull. Duket sikur në shkencë nuk do të duhej të kishte kurrfarë fërkimesh lidhur me vlerat. Mirëpo, po të merret në shqyrtim veprimtaria shkencore e Androkli Kostallarit dhe gjithë ato që janë thënë e shkruar rreth saj, të krijohet përshtypja se gjykimet negative kanë qenë aq më të zjarrta e më të fuqishme se vlerësimet pozitive, sa praktikisht i kanë mbytur këto të fundit. Në cilën anë qëndron e vërteta, domethënë shkenca: në anën e atyre që e hedhin poshtë veprën e A. Kostallarit apo në anën e këtij, në anën e veprës së tij?

Ose. A është e vërtetë që në shkencë, si edhe në shoqëri, figurat më të shquara e më me merita janë ata, për të cilët të gjithë flasin e shkruajnë vetëm mirë? Androkli Kostallari nuk bën pjesë në radhët e këtyre figurave, nuk ka bërë pjesë as edhe një ditë. A flet kjo kundër veprës së tij shkencore apo në të mirë të saj?

Ose. Ç'përfaqëson vdekja në kapitullin e jetës së një njeriu: fundin e saj? Ç'loj fundi: të pamerituar apo të merituar; të padenjë apo të denjë? Apo vdekja përfaqëson një vazhdim të kësaj jete, një vazhdim në trajtën më të lartë: atë të ruajtjes së veprës së njeriut që ndahet nga jeta?

Të hënën paradite, më 23 mars 1992, Androkli Kostallari hynte – në mënyrë të zakonshme për të, pra, në orarin e caktuar – në oborrin dhe ndërtesën e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë. Hynte për të kryer detyrimin si mësues. Por oborri dhe ndërtesa ishin të shkretë. Në to nuk kishte as studentë dhe as nëpunës. Dhe fill pas kësaj ngjarjeje në dukje fare të parëndësishme, fare të rëndomtë, ai u

nda nga jeta. Fundi i jetës e gjeti praktikisht në krye të një detyre shoqërore. Ishte 70 vjeç.

Ç’kuptim fiton qoftë edhe vetëm nga kjo ngjarje vdekja e këtij njeriu? A është e vërtetë se sa më të shumta kurorat për një të vdekur, aq më e madhe vlera e tij shoqërore? Dhe, anasjellas: sa më të pakta kurorat, aq më të pakta e më të vogla vlerat e tij, meritat, të mirat?

E vërteta është që në shkencë nuk ka dhe nuk mund të ketë – logjikisht e parimisht – debate, kundërshtime, sulme. Shkenca, domethënë dija, është zbulimi dhe pohimi i së vërtetës. Dhe e vërteta nuk është pronë e askujt, ndonëse të shumtë kanë qenë e janë njerëzit dhe grupimet, që janë përpjekur me çdo mënyrë e me çdo mjet ta pronësojnë të vërtetën, ta nënshtrajnë atë. E vërteta nuk provohet nëpërmjet debateve. Ajo vërtetohet nga jeta. Kaq. Ai që e do të vërtetën, e gjen atë, e pohon, e argumenton, e mbron, e mbështet. Kurse debatet, kundërshtimet, sulmet vijnë kurdoherë nga ana e atyre që i kundërvihen shkencës, dijës, të vërtetës, vijnë nga ana e mbrojtësve të paditurisë.

U bënë pothuaj njëzet e pesë vjet, një çerek shekulli, që Androkli Kostallari nuk është gjallë. Ai nuk mund ta mbrojë veten përballë atyre gjykimeve negative që thuhet e shkruhet për të. Ai nuk mund ta mbrojë veten dhe veprën nga mohuesit e veprës së tij, nga poshtëruesit e tij teorikë dhe praktikë.

Madje nuk i dihet nëse ai do të merrte mundimin t’u përgjigjej sulmeve dhe mohuesve. Thjesht për arsye parimore: kush punon për shoqërinë, kush ia kushton asaj mundin e vet, ai ia ka lënë kësaj shoqërie edhe detyrimin për mbrojtjen e veprës dhe mundit të tij, në rast se kjo vepër e ky mund kanë vlerë shoqërore.

* * *

Çonju, shqypetarë, prej gjumit çonju!

E, pra, ato që kanë ndodhur pas ndarjes nga jeta të Androkli Kostallarit – jo vetëm në fushën e gjuhësisë, por edhe në fushat e tjera të jetës shoqërore; jo vetëm me gjuhën e njësuar, pra, me gjuhën shqipe, por me të gjitha vlerat e kulturës sonë – kanë qenë objektivisht më se të mjaftueshme për të kuptuar se ç’përfaqëson Androkli Kostallari, ç’përbën veprimtaria e tij shkencore për shkencën tonë, për kulturën tonë, për historinë tonë duke filluar nga mesi i shekullit të kaluar, në të vërtetë për gjithë historinë e Shqipërisë.

Dhe, nëse pothuaj askush nuk merr guximin t’i quajë gjërat me emrin e tyre (këtu nuk është fjala për atë lloj guximi që në traditën tonë njihet si “guximi i budallait”), kjo edhe një herë vërteton mësimin e njohur se në histori rrallë ka qëlluar që trimi i mirë të ketë shokë shumë; ose – që është e njëjta gjë – se e vërteta më të shumtën e herës është e pambrojtur, e braktisur, e goditur, e mallkuar.

Androkli Kostallari hyn plotësisht në këtë grup njerëzish, në grupin e trimave pa miq, ashtu si vepra e tij hyn në kategorinë e të vërtetave të anatemuara.

Ç'vlerë ka pasur Androkli Kostallari për shkencën shqiptare? A ka merita ai në historinë e gjuhësisë, shkencës dhe kulturës shqiptare? Ç'jeton sot prej tij? A vazhdon të rrojë vepra e tij?

Androkli Kostallari, në dallim nga gjuhëtarët pararendës, e pa shkencën gjuhësore shqiptare jo vetëm të pavarur, të mëvetësishme nga qendrat akademike dhe studimore të huaja, ku shqipja dhe historia e Shqipërisë studioheshin në funksion të gjuhëve dhe historive të vendeve të tjera, në funksion të gjuhësisë së përgjithshme dhe të historisë së përbotshme, por edhe si mekanizmin qendror, të vetëm, të vërtetë politiko-kulturor dhe metodologjike-shkencor, të studimit të historisë së shqipes dhe të sistemit të saj strukturor në funksion të plotësimit të detyrave të mëdha praktike që shoqëria e re shqiptare shtronte përpara kësaj shkence gjuhësore, përpara këtij mekanizmi tejet të rëndësishëm dhe delikat.

Për kryerjen e këtyre detyrave të mëdha, që shoqëria jonë shtronte përpara gjuhësisë shqiptare dhe që nuk mund t'i përmbushnin të gjithë gjuhëtarët e huaj të marrë së bashku, duheshin plotësuar disa kushte: e para, të fuqizohej trupi i gjuhëtarëve tanë, i cili do të përballlej me detyrat madhore; e dyta, të përgatitej baza metodologjike-shkencore, mbi të cilën do të mbështetej veprimtaria shkencore e gjuhëtarëve; e treta, të përvijohet skema e organizimit të kësaj veprimtarie.

U takon studiuesve të historisë së zhvillimit të shkencës gjuhësore shqiptare që mbështetur mbi dokumente arkivore të përcaktojnë se si u kryen të gjitha etapat e punës konkrete të kësaj shkence për përmbushjen e detyrave konkrete; u takon atyre të saktësojnë marrëdhëniet konkrete dhe ndërvepruese ndërmjet porosisë politike për detyrat e shkencës sonë gjuhësore nga njëra anë dhe rolit të trupit të gjuhëtarëve në përcaktimin sa më shkencor të vetë këtyre detyrave si dhe në përcaktimin e kushteve dhe afateve më të mira të realizimit të tyre nga ana tjetër.

Por një gjë është fare e qartë: në vitin 1958 A. Kostallarin e emërojnë në krye të Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë. Në vitin 1972 bota shqiptare bëhet – më në fund e për herë të parë në historinë e saj – me gjuhë të njëjësuar letrare, një gjuhë të njëjësuar mbi parime rreptësisht shkencore.

Kjo, ndër të tjera, do të thotë se në përcaktimin e sistemit të normave themelore drejtshkrimore të gjuhës së njëjësuar, praktikisht të sistemit të normave bazë të gjuhës së njëjësuar (të cilat mbështeten pikërisht mbi normat drejtshkrimore) meritat metodologjike-shkencore, organizative dhe gjuhësore të A. Kostallarit janë jo vetëm tejet të rëndësishme, por praktikisht vendimtare. Këto merita janë të tilla, sa e bëjnë plotësisht të logjikshëm, të përligjur, të vetëkuptueshëm, pohimin se asnjë drejtues tjetër nuk do të mund të kishte arritur brenda të njëjtës kohë e me atë shkallë përsosurie rezultatin e arritur nga ekipi i madh i gjuhëtarëve tanë të udhëhequr nga A. Kostallari.

Kështu, pra, në vitin 1972 bota shqiptare u bë me gjuhë letrare të njëjësuar shkencërisht. Në të njëjtën kohë e me të njëjtin proces gjuhësia shqiptare u kthye në shkencë gjithanshmërisht të konsoliduar, të aftë për të përballuar – sikurse edhe përballoi – edhe dy detyra të tjera të mëdha: hartimin e teksteve akademike të gjuhës shqipe dhe përgatitjen e fjalorit të parë themelor shpjegues të gjuhës së njëjësuar. Dhe, së treti: punimet plotësisht të suksesshme të Kongresit të

Drejtshtkrimi shënuan përfundimin e procesit të paçmuar të krijimit të trupit të gjuhëtarëve shqiptarë, gjë që mund të cilësohet si një ndër arritjet dhe krenaritë më të mëdha të zhvillimit të shkencës në Shqipëri, të historisë së Shqipërisë në tërësi. Në të gjitha këto arritje roli i A. Kostallarit është jo vetëm i pamohueshëm, jo vetëm i dorës së parë, por – në kuptimin e mirëfilltë të fjalës – historik.

Për këtë rol historik të A. Kostallarit në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare nuk dëshmon vetëm e djeshmja, vetëm koha kur ai veproi, vetëm vepra e tij. Vlera historike e veprimtarisë së A. Kostallarit nuk është thjesht rrethana, kalimtare. Ajo që dëshmon edhe më shumë për vlerën e saj përtërrrethore, përtëjkohore, është vetë gjendja e sotme e gjuhës së njësuar, mënyra e përdorimit të saj sot, ashtu si edhe gjendja e sotme e gjuhësisë shqiptare, e trupit të gjuhëtarëve tanë, në përgjithësi shkalla e përkujdesjes dhe e mbrojtjes së gjuhës së njësuar.

Kjo e sotme flet njëherësh për disa gjëra: 1) që gjuha e njësuar është dëshmi e një shkence të fuqishme realiste dhe një organizëm praktikisht i përsosur e i pazëvendësueshëm për komunikimin shoqëror, pra, edhe për përparimin e kulturës dhe të vetë shoqërisë; 2) që forca e jashtëzakonshme, jetësore, e këtij organizmi vazhdon të dëshmohet përkundër përdorimit të keq publik që i bëhet atij në të gjitha institucionet dhe në të gjitha fushat, përkundër shkërmoqjes së trupit të gjuhëtarëve tanë, përkundër mpirjes dhe shterjes së gjuhësisë shqiptare, përkundër lënies së gjuhës së njësuar pa përkujdesjen dhe pa mbrojtjen e shtetit, shkurt, vazhdon të dëshmohet edhe në kushtet më kundërshtuese të jetës së tij; 3) që ata, të cilët goditën dhe godasin, përbaltën dhe përbaltin, mohuan dhe mohojnë gjuhën e njësuar dhe udhëheqësin e veprimtarisë së madhe për strukturimin e saj, Androkli Kostallarin, nuk kanë dëshmuar dot me sulmet e tyre – dhe kjo ishte e parashikueshme ashtu si është i parashikueshëm përfundimi i përbashkës së kundërshtuesës me shkencën – veçse shterpësi ideore. Ky fakt e bën historikisht të pafalshëm veprimin e tyre.

Gjuhëtari dhe shqiptari i madh A. Kostallari rron me mënyrën e vetme, me anë të së cilës rron e vërteta: me anë të realitetit të veprës së tij. Ia vlen të sillen këtu dy vlerësime domethënëse dhe përfaqësuese rreth veprës së gjuhëtarëve tanë të brezit të kaluar të udhëhequr nga A. Kostallari:

“Unë besoj se rregullat e reja do të jenë dhurata më e vyer që deri më sot me shekuj ka pritur gjuha shqipe” (P. Janura).

“Për ne, arsimtarët e brezit të vjetër, që e kemi nisur punën në rrethana të vështira historike të jetës së popullit e të shkollës shqiptare, është një gëzim i madh që shohim sot të realizohet dëshira shekullore e gjithë shqiptarëve për të pasur një gjuhë letrare kombëtare të njësuar” (K. Koci).

Në kushtet kur ne nuk kemi më një platformë të përbashkët ideore e politike për zhvillimin e vendit, rrjedhimisht, nuk kemi as përbashkësi shpirtërore e kulturore, gjuha e njësuar mbetet e vetmja vlerë që na bashkon pa dallim feje, krahine dhe ideje. E vetmja.

Bota shqiptare mund të bëjë detyrën e saj: ta ruajë dhe zhvillojë këtë vepër të pashoqe. Në këtë mënyrë mund të ruajë nderin e vet para pasardhësve, para historisë. Por ajo do të jetë plotësisht fajtoare, nëse nuk do ta përmbushë deri në një këtë detyrë të shenjtë.

ANTONIO BELLUSCI

VLERËSIMI I GJUHËS DHE I KULTURËS ARBËRESHE NË LETËRKËMBIMIN E ANDROKLI KOSTALLARIT

Hyrje

Në moshën time tetëdhjetenjëvjeçare¹, unë prift arbëresh me gjuhën arbëreshe dhe ritin bizantin-grek të trashëguar që nga shekulli XV deri sot nga prindërit e mi², që kanë jetuar në katundet arbëreshe në Kalabri sot nën juridiksionin të episkopit arbëresh mons. Donato Oliverio në Unger³, i nderuar me shtetësinë shqiptare⁴, u nisa e vajta vetë në Shqipëri, Atdheu i Atrave dhe i Tatmadhëve tanë, ku mora pjesë në zgjidhjet bashkiake në ditën 21 korrik 2015⁵. Kjo ditë ka qenë për mua e pathënëshme, sepse, unë arbëresh, votova, bashkë me gjithë vëllezërit shqiptarë. Pata vërtet shumë emocione në zemër e në shpirt.

Dhe ndihem krenar se pata fatin dhe dhuratën nga Zoti të bëja këtë detyrë kombëtare për përparimin e Shqipërisë, sot në liri e në demokraci. Bashkë me mua e kam ndier fort praninë e shpirtit të pavdekshëm arbëreshë të së kaluarës, të cilët kanë shkruar, punuar dhe luftuar për liri dhe pavarësi, ashtu si na tregojnë mirë edhe rapsoditë tona shekullore. Me gjithë se jemi të shpërndarë në botë, arbëreshi

¹A. Bellusci i lindur në vitin 1934 nga prindërit e mi Jani i biri Ndonit Bellusci dhe Resja e bila Tumazit Policastro në katundin arbëresh Frascineto/Frasnita (Cosenza) në Kalabri.

²Të emigruar në Kalabri pas Konkilit e Bashkimit e Kishave të Krishtere perendimore dhe lindore në Firenze (1439) dhe pas Kuvendin e Lezhes (1444) nga gadishulli ballkanik, pse ish lufta kundër sundimin otoman. Emigrimet në Itali në shekullin XV kishen si kapedanra dhe udhëheqës priftrat shqiptarë me ritin bizantin-grek, që ishen nën juridiksionin kishtarë të Mitropolitit Orthodhoks në Oher, i cili, me lejen e Papës e Romes, mbajti lidhje me arbëreshët e Kalabrisë deri në Konkilin e Trento-s (1559).

³Eparkia arbëreshe etnike ka selinë në katundin arbëresh Unger në Kalabri, dhe ka qenë e themeluar në vitin 1919 nga Papa i Romes Benedhikti XV. Episkopi Donato Oliverio ka juridiksion mbi 30 famulli arbëreshe bizantine dhe me 50.000 besimtarë. Te gjithë katundet arbëreshë, që nga viti 1968, thuhet e këndohet liturgjia bizantine në një gjuhë arbëreshe, e përgatitur nga një komision dhe e pranuar nga Selia e Shëjte. Megjithëse kemi shumë të folme arbëreshe sot ne kemi një gjuhë liturgjike e kodifikuar, që është një fuqi e madhe shpirtërore për gjithë ne arbëreshë.

⁴“Republika e Shqipërisë - Gabineti i Presidentit. Z. Antonio Bellusci, me dekretin nr.754, datë 13. 01. 1994 juve ju miratua dhënia e shtetësisë shqiptare. Paraqituni pranë organeve kompetente për të kryer veprimet e nevojshme. Edmond Scfcri”. A. Bellusci, *Krenaria e shtetësisë shqiptare*, Lidhja, Cosenza, 31, 1994, 1071.

⁵Votova në Tiranë te Shkollja “Deshmoret e Lirisë” tek njësia bashkiake nr. 5.

kur sot vjen dhe puthën tokën e Atdheut ndihet një vëlla me popullin shqiptar, i cili sot, që nga viti 1972, ka edhe një gjuhë dhe letërsi kombëtare, që na bashkon më shumë e më thellë dhe na nderon kudo shkojmë e bisedojmë.

1. Vizita në Akademinë e Shkencave në Tiranë

Në Tiranë vajta e bëra një vizitë tek Akademia e Shkencave, bashkë me adv. Ilirjan Celibashin, i mirëpritur nga anëtarët e Akademisë prof. dr. M. Korkuti, prof. dr. Floresha Dado, prof. dr. Pllumb Xhufi dhe prof. dr. Jorgo Bulo. Kemi kujtuar disa momente historike të letërsisë arbëreshe lidhur me shkrimtarët që sot punojnë në Arbërinë tonë. Më dhuruan gjithë veprat e J. De Radës, të botuara nga kjo Akademi para një viti.

Kjo Akademi, më 9 15 maj 1995, më ka dhënë titillin nderi "*Laurea honoris causa në Etnologji*" për veprën time "*Kërkime dhe studime ndër arbërorët të Elladhes*" me këtë motivacion: "*Për ndihmesën e veçantë që ka sjellë në mbledhjen, sistemimin, studimin dhe botimin e etnologjisë dhe folklorit të arbëreshëve të Italisë dhe të arbërorëve të Greqisë*"⁶. Te biblioteka ime në Frasnitë Akademia e Shkencave e Tiranës është e gjallë me mijëra libra dhe revista, të botuara nga shkencëtarët e saj, u shpreha anëtarëve të nderuar të Akademisë gjithë mirënjohjen time.

Shkova dhe te Biblioteka Kombëtare e Tiranës, ku prof. dr. Persida Asllani më buthtoi gjithë botimet etnografike të mia dhe gjithë katalogu i revistës "*Vatra Jonë*" (1965-1870) dhe "*Lidhja*" (1980-2010), që gjenden te kjo Bibliotekë për studiuesit.

2. Vizita në Institutin Albanologjik në Prishtinë

Shkova e vajta edhe në Prishtinë, ku dr. Arsim Bajram, ministër i Arsimit, më ka dhënë një mirënjohje kulturore⁷, bashkë me dr. Edita Tahiri, ministre për dialogun. Vajta dhe në Zym të Hasit, ku ditën 27 qershor, u mbajt një Kuvend mbi veprën e Pjetër Bogdanit, organizuar nga dom Ndue Kajtari, famullitari katolik në Gjakovë⁸. Kam bërë po ashtu një vizitë edhe dhe tek Institutin Albanologjik i

⁶ Prof. M. Konomi, kryetar i komisionit i kualifikimit shkencor, dhe prof. Sh. Demiraj, kryetar i Akademisë së Shkencave më kanë dhënë titullin personalisht për veprën "*Kërkime dhe studime arbërorët e Elladhes*". Mbi këtë ceremoni akademike kanë mbajtur referata prof. dr. Sh. Demiraj, *Vepra do t'u shërbej shkencëtarëve*; prof. dr. Clirim Bidollari, *Vepra është një document historic për arbërorët e Greqisë*"; prof. dr. B. Beci, *Një libër i shkruar me zemër në shërbim të shkencëtarëve*, prof. dr. Ahmet Kondo, *Vepra mbetet document i gjallë për arbërorët e Greqisë*, të botuara në revistën arbëreshe Lidhja, Cosenza, 33, 1995, 1159-1162.

⁷ "*Për kontribut të jashtëzakonshëm në hulumtimin e thelluar rreth kulturës shqiptare në shtrirje gjithëkombëtare, si dhe për kontribut të veçantë në veprën "Arbërorët-Arvanitë një popull i padukshëm"*, Prishtinë 25 qershor 2015.

⁸ Relatorët ishen prof. Ndue Ukaj, prof. Migjena Arlati, prof. Gjok Berisha, e prof. Frok Kristoj. Kemi vizituar dhe varresen e at Shtjefen Gjeçovi, ku kam bërë një lutje arbërisht për shpirtin e tij të pavdekshëm. Prana u kemi ngjitur deri te "Shtëpia Bitiçi" ku u shtrua

Prishtinës, ku bisedova me prof. dr. Qemal Muratin, këshilltar shkencor, i cili, duke folur mbi gjuhën letrare shqipe, më tregoi edhe për një projekt për të botuar gjithë veprat dhe shkrimet e akademikut prof. dr. Androkli Kostallari⁹.

“Me shumë vonesë, por erdhi hera të nderojmë gjithë bashkë këtë shkencëtar të madh, që punoi dhe i kushtoi jetën e tij gjuhës shqipe, një, dhe kombit shqiptar, një. Këtu është madhështia e tij. Me këtë botim duhet t’i shprehim gjithë së bashku mirënjohjen tonë si shqiptarë, si letrarë, si atdhetarë”, kështu i thashë prof. Muratit me një gëzim të madh. Edhe sepse kisha njohur personalisht prof. A. Kostallarin që në vitin 1972 bë Tiranë. Kostallari kishte studiuar vazhdimisht, mirë e thellë, botimet e mia etnografike mbi arbëreshët e Italisë dhe mbi arbërorët e Greqisë¹⁰.

Prof. Muratit i thashë edhe se kisha disa letra të bukura që Kostallari më kishte shkruar mua që nga viti 1972, kur më ftoi të merrja pjesë te Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe në Tiranë¹¹ deri në vitin 1992.

darkka me gjithë pjesëmarrësit. Ish edhe Rexha Xhakli nga New York. Te Sheshi Shtëpisë Monumentale e Lidhjes së Prizrenit, mbrëmanet, zonja Shpresa Xhaklli mbajti një kuvend mbi situatë në Kosovë e familjëve, të cilat kanë një fëmil të sëmurë “me autizëm” në shtëpi.

⁹ A. Kostallari (1922-1992), gjuhëtar, profesor, akademik, mësues i popullit. Shih Jani Thomaj, që shkruajti biografinë e tij në Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. II, Tiranë 2008, f. 1324. Kam përpara meje gazetën shqiptare “Mësuesi”, e shtunë 4 prill 1992, që shkruan: “Me vdekjen e tij shkenca shqiptare jumbi një nga përfaqësuesit e shquar të saj”.

¹⁰ G. Ciampi, *Le sedi dei greci arvaniti*, Rivista Geografica Italiana, fascicolo 2, giugno 1985; Sh. Raça, *Shtegtimet dhe ngulimet e shqiptarëve në Greqi shek. XIII-XVI*, Prishtinë 2004.

¹¹ **Me një letër, 10 tetor 1972, A. Kostallari më shkruan:**

“I nderuar Koleg!

Meiniciativën të Institutit të gjuhësisë dhe i letërsisë të Universitetit shtetëror të Tiranës, nga 120-25.XI.1972 do të mbledhet në Tiranë Kongresi i dejtshkrimit të gjuhës shqipe. Siç e dini. Në 1967, u botua një projekt i rregullave të drejtshkrimit (ortografisë) të gjuhës shqipe, rreth të cilit u zhvilluan diskutime të gjera, si në shtyp ashtu edhe në mbledhje e konsulta të posaçme. Duke mbyllur këto diskutime, Kongresi i drejtshkrimit i gjuhës shqipe do të rorëzojë përpjeqet e pareshtuara që janë bërë nga përfaqësuesit më të përparuar të mendimit shkencor, ansimo dhe kulturor shqiptar për njësimin e drejtshkrimit të shqipes dhe, me një plan më të gjerë, për njësimin e gjuhës sotme letrare kombëtare.. Kongresi, nëpërmjet referatesh, kumtesash dhe diskutimesh shkencore, do të bëjë një analizë të thelluar të problemeve kryesore të drejtshkrimit të shqipes dhe do të përcaktojë vijat themelore për hartimin përfundimtar të tij në dritën e shkallës së sotme të kristalizimit të gjuhës sonë letrare kombëtare dhe të prirjeve të zhvillimit të mëtejshëm.

Duke pasur parasysh interesimin tuaj për drejtshkrimin e gjuhës sonë antare dhe për problemet shkencore të zhvillimit të gjuhës letrare shqipe, në emër të Komisionit Organizues, kam nderin t’ju ftoj të ndiqni punimet e Kongresit. Shpenzimet për biletat e udhëtimit dhe për qëndrimin tuaj në Shqipëri do të jenë në ngarkimin tonë. Duke prituar shprehjen e pëlqimit tuaj, ju dergojmë, i nderuar profesor, përshëndetjen tona të përzemërta. Për Komisioni organizues të Kongresit të drejtshkrimit Kryetari prof. Androkli Kostallari”. Unë kisha shkruar në Tiranë në shtator 1972 te Kuvendi për Illirët, dhe kështu që e veshtirë dhe e pamundshme për mua të shkoja në Tiranë dhe në nëntor te Kongresi i drejtshkrimit.

Letrën e fundit Kostallari ma shkroi jo vetëm me dorën e me pendën e tij, por edhe me zemrën e me shpirtin e tij ditën 23 shkurt 1992. Ai, ditën 23 mars 1992, lëshoi këtë jetë. Dhe kjo letër-dokument-amanet qëndron në historinë e gjuhës letrare kombëtare shqipe. Kjo letër tregon se gjuha letrare e sotme ka rrënjët e saj në diasporën e bijve të Skënderbeut, ku gjuha amtare u mbajt nëpër shekuj e thjeshtë, e shkëlqyer dhe e pasuruar nga veprimtaria e Rilindësve. Shprehjet të folmeve arbëreshe janë mijëra, po gjuha shqipe është një, dhe na bashkon dhe na gëzon në bisedat tona. Është një amanet-dokument i jashtëzakonshëm për atë që më shkruan edhe të gjitha ato që më shpreh me zemrën e tij bujare dhe me ndjenjat e tij shpirtërore më të larta¹².

3. Njohja e A. Kostallarit

Prof. Setfanaq Pollo më stati të vitit 1972 më ftoi të merrja pjesë me një kumtesë në Kuvendin ndërkombëtar për Ilirët¹³. Më përpara se unë dy priftërinj studiues dhe të njohur në albanologji si Zoti Manuil Giodano, famullitar në Ejanina¹⁴, dhe Zoti Josif Ferrari, famullitar në Frascineto¹⁵, kishin shkuar në Atdhe për herë t'parë.

Në drekë dhe në darkë kishim mundësi të ulshim e të bisedojmë me njerëzit që dëshirojmë. Dhe kështu shumë herë kam biseduar me Kostallarin bashkë me të tjerët. Ai ishte gjithmonë shumë me respekt për mua prift studiues arbëresh, si edhe prof. Shaban Demiraj dhe prof. Benjamin Kruta, që më kanë shoqëruar çdo ditë gjatë gjithë ditëve të Kuvendit. Unë kam takuar dhe biseduar me Kostallarin edhe në vitin 1985 në një Kongres të Hora e Arbëreshëve (Palermo), ku ai mbajti dhe një kumtesë¹⁶.

Këtu kisha kuptuar se gjithë studiuesit shqiptarë dëshirojnë shumë të mbajnë lidhje kulturore dhe miqësore me mua arbëresh. Takime kulturore që japin shpresa dhe hapin horizonte të gjera, me bindje se politika moniste që mbretëronte në Shqipëri nuk ishte e përjetshme. Dhe kështu zura fill e i shkruajta vazhdimisht Kostallarit për të më botuar artikuj mbi kulturën popullore arbëreshe në revistat e tyre shkencore si edhe për këshilla mbi zbulimet e mia etnografike.

¹² Letra-amanet-dorësgkrim i A. Kostallarit ka datën Tiranë, 23. 2.1992, dhe përmbanë 7 faqe (cm 15 për 21) të gjitha të shkruajtura me dorën e tij pa asnjë korregjim.

¹³ Tiranë 15-20 shtator 1972. Shkova në Tiranë me automolin tim duke bërë rrugën Bari-Dubrovnik-Hani i Hotit-Shkodher-Tirana, dhe ishem gjithë të vendosur në Hote "Dajti". Shih A. Bellusci, *I° convegno di studi illirici a Tirana, Zëri i Arbëreshëve*, Ejanina, 4, 1972, 36-38.

¹⁴ E. Giordano, *Viaggio in Albania* (4-8.X.1966), *Zgjimi*, Marri, 7-12, 1966, 32.

¹⁵ G. Ferrari, *Un italo-albanese in Albania*, *Zjimi*, Marri, 4-6, 1965, 23. Shih edhe në revistën "Drita", Tirana, 30, maj 1965. Papàs G. Ferri muar pjesë dhe te Kuvendi i drejtshkrimit, shih Kongresi i drejtshkrimit i gjuhës shqipe (20-25 nëntor 1972, *Studime Filologjike*, Tirana, 1, 1973, 19.

¹⁶ A. Kostallari, *La diaspora albanese, il dialetto e la lingua letteraria nazionale unificata*, në Hora e Arbëreshëve (Palermo), *Le minoranze etniche linguistiche*. Atti del I congresso internazionale, Piana degli Albanesi, 4-7 dicembre 1985, 163-169.

Qindra e qindra letërkëmbime me shumë akademikë, profesorë, studiues dhe miq e vëllezër shqiptarë, të cilët, në raste të vështira, kanë ardhur edhe në Frasnitë te biblioteka ime dhe kanë mbetur në darkë bashkë me mua dhe me motrën time Rina. Më se njohja ime për Kostallarin, është njohja e thellë e Kostallarit për mua, që më lëshon i çuditëm. Kur ai më shkruan mua më duket se ai komunikon me tjetër jetë, që sot është larg, po nesër do të jetë afër.

Në tekstet popullore të mbledhura dhe të botuara nga ne mbi jetën, zakonet, besimet e arbëreshëve të Italisë dhe të arbërorëve të Greqisë, që studionte aq shumë bukur, Kostallari na njësonte gjithë neve si një popull me një gjuhë, ku të gjitha veçoritë dhe shprehjet dhe kuptimet nuk ishin të shkelura dhe të humbura por mbajnë lulëzimin dhe bukurinë e tyre.

Nuk është një gjë e drejtë dhe e urtë kur thuhet dhe shkruhet se “djepi” i gjuhës dhe i kulturës shqiptare është në këtë vend të veriut ose në atë vend të jugut të Shqipërisë së sotme, duke harruar letërsinë e vjetër të diasporës shqiptare në Itali, në Greqi, në Rumani. Pse futet ky problem? Ne gjuhën që kemi sot duhet ta duam më shumë, duke e pasuruar dhe zbukuruar si një nuse mbretëreshë ilire.

Populli ynë, në Shqipëri dhe kudo në Gadishullin Ballkanik si edhe në Arbëri, është “djepi” i vërtet, që mbajti dhe mban të gjallë gjuhën dhe të gjitha. Kostallari e pati në shpirt këtë hapje kulturore, dhe si shkencëtar vuri gjuhën e njësuar në shërbim të kombit, i cili, siç dihet, ishte në rrezik në atë kohë politikisht shumë të vështirë të luftës e ftohtë. A. Kostallari, dhe veprat e tij, që zbukurojnë te biblioteka ime¹⁷, bashkë me shumë libra të tjerë të shkruar në bashkëpunim.

Falënderoj përzemërsisht prof. dr. Qemal Muratin dhe dhe prof. dr. Kujtim Kapllanin që më ftuan në këtë rast të lumtur kujtimor. Ashtu edhe unë pata mundësi të bashkohesha me ju, vëllezër shqiptarë, për të nderuar me zemër dhe me respekt shkencëtarin dhe gjuhëtarin A. Kostallarin, i cili pati këtë ide gjeniale për të njësuar gjuhën dhe e realizoj për shpëtimin e për të mirën e Shqipërisë.

Botoj këtu disa letra që A. Kostallari më ka dërguar (1972-1992). Duket mirë se miqësia jonë ka qenë gjithmonë bujare dhe e ndershme. Dhe kjo miqësi dhe kjo vëllazëri në vitrat u bë më e fortë. Dera ime këtu në Frasnitë ka qenë gjithmonë e haptë për gjithë shqiptarët, ashtu si edhe Shqipëria, edhe në vitin 1972, u hap për mua arbëresh. Komunikimi dhe veprimi im në mbledhjen në terren të kulturës popullore arbërore-arbërore forcoi lidhjet tona kulturore dhe shpirtërore.

Dhe ai me këto letra më jep këshilla, më ndihmon dhe më shton fuqitë kur Ai më vlerësonte edhe me botimin në Studime Filologjike. Unë arbëresh, në këto letra, duket se jam një anëtar, një bir i privilegjuar i Akademisë së Shkencave dhe një nxënës i Institutit të gjuhësisë dhe letërsisë.

Ardiani, i biri i Androkliut, që deri sot nuk e njoh personalisht, kur lexoi shkrimin tim për të kujtuar babin të vdekur, më shkroi dhe ai një letër shumë emocionante. Kështu mbaroi lidhja ime me familjen e Kostallarit.

Pas botimit të këtij letërkëmbimi dhe pastaj 33 vitra, që kur na lëshoi Androkli, në herën e ardhshme, shpresoj të shkoj në Tiranë për të vete personalisht te varri tij për t’i kumbisen përgjunjaz nënd lule të mbledhura në katundet tanë në Kalabri.

¹⁷ A. Kostallari, Gjuha e sotme letrare shqipe, Tiranë 1973.

Aroma dhe bukuria e këtyre luleve arbëreshe, mbi varrin të Androkli Kostallarit, do të transfigurohen në trupin e në shpirtin e gjuhës sonë shqipe: një, kombëtare dhe e pavdekshme.

Leterkëmbim - Kostallarit i shkruan A. Bellusci-t

Letra nr. 1

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

Akademia e Shkencave

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë –

Tirana

Tiranë, më 30.III. 1979

Prof. Antonio Bellusci

87030 Falconara Albanese¹⁸

Morëm revistën tuaj të datës 15.01.1979 si dhe materialet që na dërgonit së bashku me të. Ju falënderojmë përzemërsisht për bashkëpunim. Shprehim bindjen se ju, bashkë me studiues të tjerë arbëreshë, me punën tuaj të palodhur e të vazhdueshme, do të ndihmoni pa ndërprerje që gjuha shqipe të rrojë e gjallë tek arbëreshët e Italisë. Artikullin juaj “*Udhëtim në More*”¹⁹ ia dërguam për botim revistës “*Nëntori*”. Ndërsa materialin leksikor do ta përgatisim për ta botuar në një nga numrat e revistes sonë “*Studime Filologjike*” të vitit 1979²⁰. Duke ju falënderuar edhe një herë për bashkëpunim tuaj, ju urojmë punë të mbarë e të frytshme në studimet tuaja.

Të fala miqësore

Prof. Androkli Kostallari

¹⁸ Falconara Albanese (Cosenza) është një katund arbëresh. Në shekullin XV kish ritin bizantin-grek, por në shekullin XVII shkoi te riti latin-roman. Në 1973, bashkia dhe gjithë katundi u pruar njeter herë në ritin bizantin-grek e të parëve të tyre. Që nga viti 1973 deri në vitin 1979 u mbeta dhe punova te ky katund si famullitar, I dërguar nga episkopi arbëresh i Ungërës (Cosenza). Shih A. Bellusci, *Kënga epike dhe lirike popullore nga Falkunara Arbëreshe (1973-1070)*, Lidhja, Frascineto, 56, 2006, 1886-1890. Kjo do t’thotë se populli arbëresh këtu në Kalabri muk mund jetoi mirë ndëse s’ka këto dy veçori etnike shekullore që e identifikojnë. Gjuha arbëreshe dhe riti bizantin-grek.

¹⁹ A. Bellusci, *Udhëtim në More – Në mes të vëllezërve e Moresë*, Vatra Jonë, Shën Kostandin Arbëresh, IV, 1969, 2; idem, *Një arbëresh me arvanitët e Korinthisë*, Shejzat, Roma, 4, 1970, 131-147; idem, *Katundi arbëror Kaparelli Thivon*, Zjimi, Marri, 3, 1972, 64-70; idem, *Udhëtim në More – Malet e Shqipërisë nga kerkyra*, Katundi Ynë, Civita, 23, 1877, 6-7; idem, *Katundet arbëror në More*, Katundi Ynë, Civita, 27, 1978, 9-10; idem, *Arbëroret këndojnë në More*, Katundi ynë, Ci vita, 27, 1978, 9-10; idem, *Kjo gluhë arbërishte*, Katundi Ynë, Civita, 28, 1978, 12-13; idem, *Tekste popullore nga Morea*, Katundi Ynë, Civita, 32, 1980, 23-24.

²⁰ A. Bellusci, *Fjalë dhe shprehje të arbërisatës së Shën Kostandin Arbëresh*, Studime Filologjike, Tiranë, nr. 4, 1978, 173-175, dhe Studime Filologjike, Tirana, nr. 4, 1979, 165-168. Maateriali është redaktuar nga prof. Miço Samara. Është e para herë në histori që material etnografik, i bledhur në një katund arbëresh në krahinen e Bazilikatës, botohen në revistën “*Studime Filogjike*”.

Letra nr. 2

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

Akademia e Shkencave

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Tirana

Tiranë, më 30.IV. 1979

Prof. Antonio Bellusci

87030 Falconara Albanese

Me kënaqësi ju njoftojmë se materialet që ju i kini postuar më 19.02.1979 i morëm këto ditë. Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe ju urojmë që ta vazhdoni ashtu si deri në sot me dashuri dhe pasion këtë punë që vë në dritë kulturën tonë arbëreshe të lashtë e të ruajtur mirë.

Pasi i pamë të gjitha ç'na dërguat kësaj herë, ne duan që të botojmë në revistën "Studime Filologjike" tekstet e pabotuara për blegtorinë²¹ dhe avlëmendin²², të mbledhura prej jush në Shën Pal Arbëresh (Potenza)²³.

Qëllimi i botimit të këtyre teksteve do të jetë thjesht për gjuhën, për të folmen arbëreshe të Shën Palit. Duke u nisur nga ky qëllim, do të përpiqemi që t'i pajisim vetë ato me shpjegime e me ndonjë shënim të nevojshëm, por nuk dimë nëse do të mundim ta bëjmë këtë ashtu si duhet.

Prandaj do t'ju luteshim që herët e tjera, në qoftë se do të na dërgonit material të kësaj natyre, t'i pajisnit ju vetë me shënime dhe shpjegime të këtilla, pasi ju veçoritë gjuhësore të atjeshme i njihni më mirë se kushdo tjetër. Përmbajtjen e punimit tuaj "*La pastorizia a Frascineto*" po ia dërgojmë Institutit të Kulturës Popullore (ish- Institutit të Folklorit) për ta parë ata nëse mund të plotësohet dëshira juaj për botimin e tij. Kërkesën tuaj për disa numra të revistave tona po ia dërgojmë Bibliotekës Shkencore të Akademisë me porosi që t'ju nisim po t'i kenë në fondet e tyre²⁴. Edhe një herë ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe ju urojmë shëndet të plotë e përparime të reja në kërkimet shkencore albanologjike.

²¹ A. Bellusci *Blegtoria ndër tekstet originale arbëreshë të Frasinës* -Qendër Kërkinor G. Kastrioti, Frascineto, 1971. Shumë artikuj janë të botuara dhe në revistën "Shejzat", Roma, nirat 1964-1971, e drejtura nga E. Koliqi.

²² A. Bellusci, *Argalia ndër tekstet originale arbëreshë të Frasinës*, Cosenza 1977.

²³ Shën Pal Arbëresh (Potenza) është një katund arbëresh me ritin bizantin-grek në Bazilikata. Gjendet mbi një mal nëndqind metra. Kam punuar atje sipërfamullitar në vitrat 1978-1980. Bën pjesë tek eparkia arbëreshe e Ungërës.

²⁴ Biblioteka ndërkombëtare shqiptare, e themeluar na unë që në vitin 1960, u zhvillua dhe u pasurua deri sot edhe me ndihmen dhe me përkrahjen të madhe që më dha A. Kostallari, duke më dërguar libra e revista, që sot sjellin dritë në atë kohë e veçante. Këtu janë të mbledhura dhe të ruajtura me kujdes të gjitha numrat e revistave arbëreshe, shqiptare dhe të diasporas si Zgjimi, Vatra Jonë, Katundi Ynë, Zjarri, Zëri I Arbëreshëve, Lidhja, Shejzat, Bazilikata Arbëreshe, Mondo Albanese, Pranvera, Lajme, Nëntori, Studime Filologjike, Studime Historike, Ylli, Drita, Fjala, Dielli, Illyria, Arvanon, Dialogoi etj. Shumë shkeccetarë, shkrimtar, poetë dhe studius nga gjithë bota kanë ardhur e vizituar këtë Bibliotekë, që nderon Kombin dhe mban të gjallë "Spirtin e Arbërit".

Me urimet më të mira

Prof. Androkli Kostallari

Letra nr. 3

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

Akademia e Shkencave

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Tirana

Tiranë, më 20.11.1979

Prof. Antonio Bellusci

Etnograf Arbëresh

Via pollino, 90 - 87010 Frascineto

Ju njoftojmë se letrën tuaj të dt. 16.05.1979 e morëm së bashku me materialin leksikor të mbledhur në Shën Kostandin Arbëresh (Potenza)²⁵.

Puna që keni bërë duke mbledhur fjalë e shprehje në popull është e vlefshme dhe me rëndësi të madhe për të mos lënë të humbasë thesari leksikor i gjuhës shqipe, prandaj duhet të vazhdoni këtë punë duke aktivizuar edhe dashamirës të tjerë të gjuhës, më të rinj me moshë.

Me këtë rast po ju dërgojmë edhe një “*udhëzues*” të ri, ku tregohet si duhet punuar për të mbledhur material leksikor, frazeologjik dhe onomastik nga goja e popullit, që ju ta mbani parasysh në punën tuaj të ardhshme. Në materialin e fundit që na keni dërguar përmendni disa lloj dardhash si *piklorje*, *rrotullorez*, *ruzurele* etj., të cilat duhen shpjeguar mirë, duke dhënë karakteristikat e përgjithshme të frutit për secilin lloj.

Do të ishte më mirë që të gjithë materialin që keni mbledhur të na e dërgoni pasi ta keni vështruar edhe njëherë në përputhje me udhëzimet që jepen me “*Udhëzuesin*” që po ju dërgojmë. Në qoftë se nuk keni mundësi ta bëni gati të gjithë materialin menjëherë, na e dërgoni një pjesë me të dhëna si këto që na keni dërguar. Në këtë mënyrë redaktimi bëhet më lehtë e më mirë. Materiali që keni dërguar do të botohet në numrin 4 të revistës “*Studime Filologjike*”, 4, 1979. Ju urojmë shëndet dhe sukses në këtë punë të vlefshme.

Drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë

Androkli Kostallari

Letra nr. 4

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë

²⁵ Shën Kostandin Arbëresh (Potenza) është një katund arbëresh me ritin bizantin që gjendet në Bazilikata dhe bën pjesë tek eparkia arbëreshe e Ungrës. Kam punuar këtu si prift famullitar në vitrat 1965-1973. Dhe këtu kam themeluar dhe reveistën arbëreshe “*Vatra Jonë*”, dhe kanë dalur kater numra. Në të gjitha këto tetë vitra, çdo ditë shtëpi për shtëpi, kam mbledhur shumë material etnografike dhe i kam botuar. A. Bellusci, *Martesa në Shën Kostandin Arbëresh*, Lidhja, 55, 2006, 1853-1855; idem, *Përrallaz për t'vigliit ka Shëm Kostandini Arbëresh*, Lidhja, Frascineto, 56, 2006, 1896.

Akademia e Shkencave
 Instituti i Ghuhësisë dhe i Letërsisë
 Tirana

Tiranë, më 24.IV.1988

Prof. Antonio Bellusci

Corso Plebiscito, 22 - 87100 Cosenza²⁶

I dashur bashkatdhetar e koleg Anton!

Me kënaqësi të veçantë mora numrat Lidhja, 14/1986²⁷, Lidhja, 15/1986²⁸, Lidhja, 16/1987²⁹, Lidhja, 17/18/1987 të "Lidhjes" suaj, e cila po bëhet çdo vit më tjetër një revistë kulturore me rrezatim të gjerë në botën shqiptare. Ju njoftoj, gjithashtu, se ua dorëzova të gjithë të interesuarve numrat përkatës të "Lidhjes" sipas shënimeve që jepeshin në letrën tuaj. Si për ta, ashtu edhe për vete ju falenderoj nga zemra dhe ju uroj përparime e arritje të reja në punën tuaj sa të vështirë e të lodhshme, aq edhe të rëndësishme e fisnike.

Revista "Lidhja", e themeluar dhe e drejtuar prej jush, po i përgjigjet çdo ditë e më mirë emrit që ka, duke bërë përpjekje të lidhë edhe traditat shekullore arbëreshe, edhe njerëzit arbërorë të shpërndarë nëpër botë nga valët e historisë. Revista "Lidhja" dhe botimet e tjera me vlerë, siç janë "Zjarri"³⁰ së bashku me shtojcat e rëndësishme "Quaderni di Zjarri" e "Cronache culturali", "Zëri i Arbëreshëve"³¹, "Katundi Ynë"³², "Pranvera"³³ etj. po sjellin ndihmesa të reja e të pazëvendësueshme shkencore për jetën e arbëreshëve në të kaluerën e në të

²⁶ Kam punuar si prift famullitar i komunitetit arbëresh në Cosenza që nga viti 1979 deri në vitin 2000. Këtu në vitin 1980 themellova dhe revisten arbëreshe "Lidhja". Në Cosenza kanë ardhur te shtëpia ime shumë profesorë të Universitetit të Tiranës, të cilët lanë përshtypjet e tyre në librin e bibliotekës.

²⁷ Në revistën arbëreshe Lidhja, Cosenza, 14, 1986 është një dossier mbi udhëtimin që episkopi i Hores Arbëreshe (Palermo), më 18-24 korrik 1985, nashkë me një grup me 55 arbëreshë, bëri te katundi arbëror-arvanit Kaskaveli, ku lindi Aristidhi Kolljas. Këtu kanë ardhur gjithë kryetaret dhe priftrat të katundëve arbërorë. Në Lidhja janë botuara fjalimet arbërisht të episkopit E. Lupinacci dhe të A. Kollja.

²⁸ A. Bellusci, *Te vatra arbërore lepsinjote – Intervistë me V. Lkapis, etnolog*, Lidhja, Cosenza, 15, 1986, 401-403. Në këtë leter botole letra të derguara nga Dhimiter Shuteriqi, Mark Tirta, Valdete Sala.

²⁹ Në këtë numer kemi botuat letra me shkrime dhe me urime të derguara nga M. Tirta, Gj. Shkurtaj, A. Uçi, Z. Shkodra, A. Kostallari, Q. Haxhihasani, J. Bulo, E. Lafe, M. Domi, K. Kodra, J. Bulo e Ferid Hadhri.

³⁰ Revista arbëreshe "Zjarri", e themeluar në vitin 1970 nga prifti arbëresh Giuseppe Faraco (1937-1998), i lindur në Vaccarizzo Albanese, dhe prift famullitar në Shë Miter Korone.

³¹ Revista arbëreshe "Zëri i Arbëreshëve", Ejanina, i themeluar nga prifti arbëresh Manuil Giordano (1920-2015).

³² Revista arbëreshe "Katundi Ynë", Civita, e themeluar nga prof. Dhimiter Emmanule në vitin 1970 dhe botohet deri sot.

³³ Revista arbëreshe "Pranvera", Piana degli Albanesi, e themeluar nga prof. Di Modica në vitin 1973.

sotmen, për gjuhën e për kulturën e tyre origjinale. Ato janë një dëshmi e qartë se “Shpirti i Arbrit” rron e ripërtërihet dhe se rrënjët e gjuhës shqipe, -e shprehjes më të përqendruar të këtij shpirti- siç thotë në vjershën e tij villai e kolegu ynë i nderuar Aristidh Kollja, janë “rrënjë të forta e të argjendta”, që “çajnë gurin” e vijojnë të nxjerrin “lule e fjeta”³⁴.

Kërkimet shkencore që ju, i dashur Andon, po bëni me aq përkushtim në ngulimet arbërore të Greqisë³⁵, fshat më fshat – në Atikë, në Beoti, në Argolidhë, në Eube³⁶ e gjetiu – po sjellin një lëndë të panjohur, mjaft të pasur e të larmishme jo vetëm për studimet gjuhësore e onomastike por edhe për studimet në fushën e historisë, të etnografisë e të folkloristikës, të sociologjisë, të së drejtës zakonore e të psikologjisë popullore. Kjo lëndë e përmbledhur me vëzhgime të drejtpërdrejta *in situ* dhe *in vivo* është një pasqyrë e gjallë e jetës së vëllezërve arbërorë, e botës së tyre të thellë shpirtërore, e aftësive të tyre krijuese që të mahnitin e që dëshmojnë se populli ynë ka qenë dhe mbetet kurdoherë jo vetëm një popull shumë i lashtë e njëkohësisht shumë i ri, por edhe një Poet i madh.

Gjurmimet e botimet tuaja etnogjuhësore, krahas botimeve shumë të çmuara të Jani Gjikes³⁷, Vangjel Ljapit³⁸, Aristidhi Kolës³⁹, Nikos Saltarit⁴⁰, Jorgo Marugas⁴¹, “veprave” të Kristo Petro Mesogjiti⁴², e të tjerëve, shënojnë, pa dyshim, një hap cilësor përpara në njohjen e thelluar sistematike të gjuhës e të kulturës së arbëreshëve të Greqisë nga vetë studiuesit arbëreshë. Nga ky gërshetim krijues i përvojës tradicionale të re të arbëreshëve të Italisë e të

³⁴ A. Kollja, *Rrënja jonë arbërore*, shih A. Bellusci, *Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Elladhes*, Cosenza 1994, 463-464.

³⁵ A. Bellusci, *Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Elladhes*, Cosenza 1994, 463-464; idem, *Këngë arbërore nga Kranidhi në Argolidhë (Greqi)*, Lidhja, Cosenza, 8, 1983, 169.

³⁶ A. Bellusci, *Arbërorët-Arvanitë një popull i padukshëm*, Frascineto 2004.

³⁷

Γιαννης Π. Γικας, *Οι αρβανιτες και το αρβανιτικο τραγουδι στην Ελλάδα*, Αθηνά 1962. Ish me origjinë sh nga Eubea, ku janë shumë katunde arbërorë, mbi të cilet ka botuar shumë vepra etnografike

³⁸ Βαγγελι Π. Λιαπη, *Αρβανιτικο μοιρολογοι*, Αθηνά 1985. Ish nga Elefsina dhepunonte si advokat. Botoi shumë vepra etnografike shumë të vlerëshme.

³⁹ A. Bellusci, *Aristidhi Kollia një figurë e ndritur arbërore (1950-2000)*, Ura, Prishtinë, maj 2003, 4-6.

A. Κολλια, *Αρβανιτες και η καταγωγή των Ελληνων*, Αθηνά 1983; A. Κολλια, *Η γλωσσα των Θεων*, Αθηνά 1989.

⁴⁰ Νικου Ιω. Σαλταρη, *Η ζωή των αρβανιτων*, Εκδοσεις Γερου, Αθηνά 1986.

⁴¹ J. Marougas, *Grecia e Albania: terra di confine*, Lidhja, Cosenza, 11. 1984, 275; idem, Anastas Kullurioti, Lidhja, Cosenza, 9, 1983, 193; idem, *Mëma arbërore gëzohet – Poezi*, Lidhja, Cosenza, 11, 1984, 276.

A. Bellusci, *Jorgo Marougas figurë e ndritur arbërore (1935-1985)*, Ura, Prishtinë, qershor 2003, 6-7; idem, *Në kujtim të J. Marougas-it*, Lidhja, Cosenza, 12, 1985, 315; A. Kollja, *Vdekja e J. Marougas-it*, Besa, Atene, 7, 1985, 311.

⁴² A. Kostallari, *Një dëshmi e ëanjuhur e shkrimit të arbërisate së Greqisë në shekullin XIX*, Studime Filologjike, Tirana, 2, 1987, 89-105.

Grequisë pasurohen e gjallërohen jo vetëm studimet albanologjike, por edhe ballkanistika.

Lëndën e botuar prej jush e kam shfrytëzuar me kujdes në disa studime të miat në kohët e fundit dhe për këtë ju jam mirënjohës⁴³.

Në këtë të fundit kam cituar si dëshmi gjuhësore edhe disa pjesë nga ligjërata e E. Lupinacci-t⁴⁴ në Kackavel Leontarjon të Tebës, ligjëratë që ju e botuat të “Lidhja” krahas fjalimit të gjatë historik të Aristidh Kolës⁴⁵. Disa nga këto studime jua kam dërguar me kohë si separate. Po të mos i keni marrë, ju lutem të më njoftoni. Do të kujdesem që botimet tona shkencore t’ju dërgohen rregullisht.

Ju lutem, me këtë rast, i dashur Andon, t’u jepni të falat e mia më të përzemërta të afërme e dashamirëve tuaj dhe gjithë bashkatdhetarëve të nderuar, që u janë kushtuar me aq dashuri e përkushtim studimeve për gjuhën e për kulturën e Arbërit.

Me ndjenja vëllazërore

Androkli Kostallari

Letra nr. 5

Tiranë, më 23. II. 1992

Prof. Antonio Bellusci

Coraso Plebiscito, 22 - 87100 Cosenza

I dashur Andon,

kam kohë që s’të kam shkruar, por të kam gjithnjë në zemër e në mendje. Kam ndjekur me kënaqësi të veçantë veprimtarinë shumë të dendur e të vlershme për të ndihmuar mërgimtarët shqiptarë⁴⁶.

Jam çmallur edhe me fytyrën tënde vëllazërore sa herë që ajo shfaqej në emisionet RAI-TV. Në këto çaste të rënda e të ndërlikuara të historisë së popullit tonë, ka ndritur edhe një herë zemra arbërore, humanizmi arbëror e njerëzor. Ka ndritur qartë sidomos dashuria e shqiptarëve për lirinë. Dhe më vjen shumë mirë që kjo dashuri, me punën tënde të palodhur, është e pasqyruar gjerë edhe në faqet e revistës “Lidhja”⁴⁷.

⁴³ A. Kostallari, *Diaspora e sotme shqiptare dhe gjuha letrare kombëtare njësuar*, Studime Filologjike, Tirana, 3, 1986, 3-73, dhe A. Kostallari, *Një dëshmi e e panjohur e shkrimit të arbërisate së Grequisë në shekullin XIX*, Studime Filologjike, Tirana, 2, 1987, 89-105.

⁴⁴ E. Lupinacci, *Vëllezër të dashur, Lidhja*, Cosenza, 14, 1986, 361-362.

⁴⁵ Aristidhis Kollja, *Me vërtetë e mallengjyshëm ky minut, Lidhja*, Cosenza, 14, 1986, 359-360.

⁴⁶ A. Bellusci, *Bijtë e Shqiponjes fluturojnë në Evropë duke kërkuar punë dhe demokraci*, Lidhja, Cosenza, 24, 1990, 754-762, dhe, idem, *Studio dossier mbi mërgimtarët shqiptarë në Brindisi*, Lidhja, Cosenza, 25, 1991, 791-795.

⁴⁷ Revista arbëreshe “Lidhja”, e themeluar nga unë në vitin 1980 në Kozenca (Kalabri-Itali), ku peshkopi i Ungrës më ka dërguar atje si famullitar për arbëreshët me ritin bizantin të emigruar në Kozenxa. Revista është gjashtë mujore. Kanë të botuara 60 numra me 2200 faqe.

Kjo, pa dyshim, e ka gjallëruar këtë revistë, e ka zgjeruar mjaft rrezën e veprimit të saj, e ke afruar ajo jo vetëm me intelektualët, por edhe me shumë njerëz të thjeshtë shqiptarë, kudo që jetojnë.

“Lidhja” po vijon t’i bashkojë e t’i lidhë gjithë më shumë bijtë e Arbërit, duke vënë si bosht qendror të këtij bashkimi dhe vëllazërimi idenë e madhe të kombit të njëjtë, gjithnjë të gjallë e të ri, idenë e gjuhës kombëtare, që është shfaqja më e përqendruar e më besnike e vlerave shpirtërore e kulturore të këtij kombi.

Këtu e kanë gjetur dhe gjejnë e frymëzojnë dhe njerëzit e mëdhenj, dhe njerëzit e thjeshtë të Arbërit të pavdekshëm. Puna që bën ti dhe kolegët e tu, puna e shkëlqyer e kuadrove të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Kozenca, Palermo, Napoli e Romë; puna e të gjithë veprimtarëve arbëreshë në Kalabri, Sicili e gjetiu, ashtu edhe në diasporën e re, puna vetëmohuese e Aristidh Kolljas⁴⁸, Jorgo Gerou⁴⁹ e shumë arbërorëve⁵⁰ (arvanitëve) të tjerë të Greqisë i japin një impuls të ri kulturës shqiptare, gjuhës shqipe, shpirtit arbëror, gjithë botës shqiptare.

Kjo veprimtari, pa dyshim, do mbetet në histori si një faqe e ndritur e bëmave të bijve të Arbërit, si një Rilindje e re⁵¹, që po përsërit në gjirin e një Evrope të ringjallur e të bashkuar lepre madhështore të viganëve të mendimit e të shpirti poetik kombëtar shqiptar të shekullit XIX e të fillimeve të shekullit XX. Vepra e J. De Radës⁵² e Naim Frashërit⁵³, e Fam S. Nolit⁵⁴ po shkëlqen sot me një dritë të re. Emra të rinj vendesh e njerzish në botën arbërore po fitojnë tani një vlerë e bukuri e veçantë. Këtë brerore po ua jep atyre vetë historia. Ndër këta emra unë shoh me nderim të thellë edhe Frasnitën, ndulin e dashur të F. Solano-s⁵⁵, Vorea Ujko-s⁵⁶, Josif Ferrari-t⁵⁷, Manol Giordano-s⁵⁸, Antonio Bellusci-t⁵⁹ e të shokëve të tyre me zemër të zjarhtë.

⁴⁸ A. Bellusci, *Aristidyhi Kollja një hero bashkëkohor i diasporës arvanite-arbërore* (1955-2000), Lidhja, Frascineto, 44-45, 2000-2001, 1507-1511.

⁴⁹ Jorgo Gerou, inxhener, jeton në Athinë. Krytar i revistës arbërore “Besa”, organ i sgoqates kulturore “Mark Bocari”, e botuar në vitrat 1883-1995 në Athinë.

⁵⁰ “*Neve thuhemi arbërorë, dhe jo arvanitë si na thonë grekët*”, kështu mua më kanë shjpehura shumë burra dhe gra në intervistat që i kam bërë atyre në gjuhën tonë amtare.

⁵¹ Kjo Rilindje e re filloi tek ne arbëreshë në Itali me revistat “Shejzat” (Roma) të E. Koliqi në vitin 1957, “Zgjimi” (Marri) të A. Greco në vitin 1962, “Vatra Jonë” (Shën Kostandin Arbëresh) të A. Bellusci në vitin 1965, “katundi Ynë” (Civita) të D. Emmanuele) në vitin 1970. Tek arbëroret e Greqisë filloi me revisten “Besa” (Athina) në vitin 1983 dhe me A. Kollja, Jorgo Marouga, V. Ljapi.

⁵² Jeronim De Rada (1814-1903) shih Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 422. Akademia e Shkencave e Tiranës më vitin 2014 ka botuar gjithë vera e tija.

⁵³ Naim Frashëri (1846-1900).

⁵⁴ Fan Noli (1882-1965).

⁵⁵ Francesci Solano (1914-Frasnita-1999), shih Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. III, Tiranë 2009, 2370. 206. Ka botuar shumë vepra mbi të folmet arbëreshë.

⁵⁶ Domenico Bellizzi (Vorea Ujko) (1918-Frasnita-1989). Poeti më i madh në Arbëri.

⁵⁷ Giuseppe Ferrari (1913-Frasnita -1990) shih Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008, 660. Botoi shumë vepra albanologjike dhe bizantinologjike.

Me kënaqësi të posaçme vë re në numrat e “Lidhjes” se ti vazhdon punën tënde në gjirin e arbërorëve të Greqisë.

Më pëlqeu shumë sidomos organizimi i një grupi studimor nga Komiteti Evropian, nën drejtimin tënd, për të parë gjendjen e gjuhës shqipe tek arbërorët e Greqisë. Nga njoftimet që jepen në numrin 25/1991 të “Lidhjes” duket se nga institucionet zyrtare të Greqisë ose nuk njihet fare gjendja ose mbahet një qëndrim mohues a mospërfillës. Por edhe në Greqi ka faren përparimtare⁶⁰, intelektuale të shquar që e kuptojnë e do ta kuptojnë edhe më mirë se përkrahja e kulturës, e gjuhës së arvanitëve i sjell të mira vetë popullit grek, sepse ruan në Greqi vlera kulturore të lashta e të shëndosha, që e pasurojnë, e zbkurojnë gjithë kulturën e Greqisë. Grupi studimor, Komuniteti Evropian më duket se bëri një hap të parë për ta thyer akullin. Jam i bindur se do të bëhen hapa të tjerë. Greqia e sotme nuk është Greqia e djeshme, ajo rron e do të rrojë gjithnjë më shumë në frymën e demokracisë evropiane.

Do të isha shumë mirënjohës sikur të më dërgoje një kopje të relacionit të tillë të grupit tuaj për vizitën studimore tek arvanitët e Greqisë më 4 -10 tetor 11987 dhe njoftime për fatin e mëtejshëm të këtij relacioni ⁶¹.

Kohët e fundit kam marrë vesh me kënaqësi se albanologu i mirënjohur T. Johalas⁶² ka publikuar një libër shumë të gjerë për të folmet e arbëreshëve dhe i është përveshur me këmbëngulje një sistemi tekstor të tyre. Ai është një gjuhëtar e tekstolog shumë i mirë i kualifikuar dhe shpresoj se nga penda e tij do të dalë një vepër e re e shkencëtarisht se veprat që janë botuar deri më këtë rast nga njerëz që nuk e njohin mirë gjuhën shqipe dhe jetën e arvanitëve. Këto studime objektivisht nuk lirojnë për të sqaruar e vlerësuar drejt identitetin dhe prestigjin historik-shoqëror të arbërorëve të Greqisë, të gjuhës e të kulturës së tyre⁶³.

⁵⁸ Emmanuele Giordano (1920-2015). Në revisten “Jeta Arbëreshe”m korrik 2015, i nipi Gustub Giordano, botoi një numer të veçantë për këtë prift albanolog shumë i shquar.

⁵⁹FA. Bellusci (1934 -) shih Fjalor Enciklopedik Shqiptar, v. I, Tiranë 2008. 206.

⁶⁰ M. Tirta, *Copëza etnokulturore në arbërpriet e Greqisë*, Lidhja, Cosenza, 13, 1985, 330-331. Gjithë numrat e revistës arbëreshe “KUdhja”, nr. 1-60 (1980-2019) janë te Biblioteka Kombëtare e Tiranës dhe te Biblioteka kombëtare e Kosovës.

⁶¹ A. Bellusci, *Relazine sugli albanesi di Grecia alla Commissione delle Comunità Europee*, Lidhja, Cosenza, 25, 1991, 798-800.

⁶² T. Π. Γιουχαλας, *Αλβανολογία και ερασιτεχνισμός*, Αθήνα 1988. *Në këtë liber kunder meje shihet mirë reagimi i zbërthyr dhe qesharak i Johales, i cili duket një rrobëlarës dhe jo një studiues.*

Shih dhe A. Bellusci, *Lo “scenziato” T. Jochalas al servizio della politica*, Lidhja, Cosenza, 24, 1990, 782, dhe

A. Κολλφα, *Η καταντια ενος επιστημιομα*, Μβεσα, Αθηνα, 12, 1989, 484; A.

Bellusci. *Da radici arbëreshe a matrici arbërore*. Lidhja, Cosenza, 10, 1984, 205-217, dhe A. Bellusci, *Trashegintaret e Skënderbeut në Eube – Dossier mbi arbërorët në Eube*, Lidhja, Cosenza, 12, 1985, 286-301.

⁶³Γιονα Μικε Παιδουσι, *Τα Βιλια του Κιθερωνα και τα αρβανιτικα τραγυδια τους*, Αθηνα 1980. disa letra, Gjithë këngat te ky liber janë shkruar arbërisht me alfabetin e Monastirit, dhe me përkthimin në gjuhën greqishte popullore. Botimet e tjera janë me tekste

Në një letër e kam shumë vështirë të të shfaq mendimet dhe ndjenjat që më ziejnë në mendje e në zemër. Duhet të rrimë bashkë ditë e net të tëra që të kuvendojmë e të çmallemi. Por këtu dua të theksoj një rast që më ka prekur thellë e më ka mallëngjyer. Në letrën që ke botuar në “Lidhja”, nr. 25, 1991, faqe 825, Thanas Moroitis thotë: ”Dua, kur mëma ime do vdesë, të këndonjë Liturgjinë në atë gluhë”⁶⁴. A ka dëshmi më të qartë se kjo për të parë sa thellë rron akoma në shpirtin arbëror gjuha shqipe, gjuha e nënës? A ka intelektual të vërtetë demokrat e përparimtar që nuk sheh te kjo dëshmi një thirrje të shenjtë të mos e lënë këtë gjuhë të shuhet?

Dashuria për nënën dhe dashuri për “gluhën” amtare shkrihen në një të vetme; dhe futja e kësaj gluhë” në Liturgji⁶⁵ i jep asaj një karatë të lartë simbolike, duke e bërë simbol të përjetësisë, të lidhjes së pandërprerë të brezave të paharruar të të parëve tanë.

Të përgëzoj nga zemra, i dashur Anton, për këta margaritarë të çmuar që boton te “Lidhja”. Këto dëshmi, në raste të tilla, kanë vlerë më të madhe se një artikull i gjatë ose dhe vepra të tëra. Nga çilësia e një copëzë ari që gjen gjeologu kupton se ç’pasuri e madhe fshihet në gjirin e dheut!

Shumë të fala të gjithve të afërmye e dashamirëve, të gjithë kolegëve e miqve të njohur, të gjithë banorëve të Frasnitës e veçanerisht të rinjve, që ruajnë e nderojnë gjuhën e doket e të parëve⁶⁶.

Urime e përgëzime të çiltra edhe për veprën tënde të vyer “*Dizionario fraseologico degli Albanesi d’Italia e di Grecia*”⁶⁷ për të cilën botova një recension

arbërore shumë të bukura por, mjerisht, janë shkruar me alfabetin grek, i cili fonetiki nuk mund të shpreh mirë arbërisate. Lufta ime e përditshme me vëllezërit shkrimtarë arbërorë ish t’i bija të bindur në alfabetin e Monastirit. Dhe J. Marougas në numrin e fundit të revistes “*Dialogoi*” dhe V. Ljapi në lepre e tij “*Moirologa/Vajtime*” më kanë dehjuar e kanë pranuar alfabetin e Monastirit.

⁶⁴ Thanas Moroitis më shkruajti disa letra, që janë të botuara në të folmen arbërore në librin tim Kërkime dhe studime ndër arbërorët e Elladhes, Cosenza, 1994, 458-459. Miku prift Pavlos Apostolopoulos, arbëror, para disa muaj më sjell në Bibliotekë këtë ceper etnomuzikolore ku ai boton 140 tekste popullore në të folmet arbërore edhe në gjuhën greke. Rë ghitha kënet popullore kanë transkriptimin në muzik në pentagrammaperendimor: Θανασης Μοραιτης, Ανθολογια αρπανιτικων τραγουδιων της Ελλαδας, Αθηνα 2002.

⁶⁵ G. Stamati, *Decreto di adozione della lingua parlata nella Liturgia*, Bollettino Ecclesiastico di Lungro, 3, 1968, 14-16.

⁶⁶ Në këtë përshëndetje popullit e Frasnitës dhe rinisë, kur e lexoj, u qindroj pa frymë. Kostallari ish po t’nisej për një udhëtim pa kthim. Dhe Ai më mendoj mua e më shkruajti këtë leter të gjatë. Cë ndodhi në ato ditë, në shkurt 1992, që Kostallari u zëmërua kështu fort? Pse Ai më bëri dhe më dërgoi mua këtë amanet kështu i madh, kështu i thellë, kështu i ëmbel, kështu bular e i ndershëm? Pse Ai zëmren e tij dishte t’e kllit mbënda zëmres time? Këto pyetje më grryejen mende. Kam dhe t’thom se kur shkova tek Instituti Albanologjik i Prishtinës nuk ishte asnjë profesor. Ish mjezdita. Dhe kur isha te dera për të dalur, m’thotë nj’grua:”Ja po erdhi prof. Qemal Murati, mund të bisedoni me atë”. Më qelli te zyra e tij, biseduam për Kostallarën dhe erdhi edhe ky shkrim!

⁶⁷ A. Bellusci, *Dizionario fraseologico degli albanesi d’Italia e di Grecia*, Cosenza 1996.

të gjatë vlerësues e miqësor edhe në revisten “*Studime Filologjike*”. Vijo në këtë rrugë, i dashur Andon, dhe pena të shkoftë gjithnjë mbarë!

Duke ruajtur gjithnjë ndjenjat më të ngrohta për ty dhe nderimin më të madh për punën tënde atdhetare, të përfaqoj vëllazërisht

Prof. Dr. Androkli Kostallari

P.S. Shumë të fala dhe nderime edhe nga fëmijët e mi Irina dhe Adriani⁶⁸.

6 - Përfundim

“*Me vdekjen e tij, shkruante akademiku M. Domi, shkenca shqiptare humbi një nga përfaqësuesit e shquar të saj*”⁶⁹. Duken fjalë të nevojshme, ashtu si bëhet për të gjithë të vdekurit. Por A. Kostallari, me veprimtarinë e tij madhështore në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë për aq vjet është përfaqësuesi më i shquar dhe më i lartë i Shkences shqiptare. Nën drejtimin e kujdesin e tij të dritësuar nga urtësia dhe dituria e tij e madhe, u themelua gjuha letrare shqipe kombëtare me gjithë tekstet që sot kemi, mbajti lidhje të ngushta me albanologët në botë si edhe me intelektualët arbëreshë. Dhe ne të gjithë me këtë gjuhë kombëtare duhet të fluturojmë lart në qiell ashtu si Shqiponja flamureshë.

“*Burra si A. Kostallari, kam shkruar në rast të vdekjes së tij* ⁷⁰, *i urtë, me humanizëm, me buzëqeshje, punëtor, dashnor i kombit shqiptar, bëjnë pjesë në kategorinë e legjendës” të Popullit e Shqipërisë, si Çabej dhe Q. Haxhihasani. Navigatori të guzihëm, shumë herë pak të kuptuar dhe të izoluar, të cilët edhe në situata politike shumë të vështira, kanë ditur të angazhoheshin për t’i dhënë nder kombit.*

Gjuha letrare shqiptare e sotme, e përdorur nga të gjithë, populli dhe studiues, na jep mundësi të kuptohemi e të bisedojmë në mënyrë të drejtë dhe në një kohë reale. Për këtë duhet të vëmi m’njandë mendime dhe situata politike, që asaj gjuhe i dhanë mundësi të krijohet. Arbëreshë, kosovarë, shqiptarë, arbërorë, shqiptarë në diasporë, kudo gjendemi në jetë, duke folur në gjuhën shqipe kombëtare e njëshme “unificata”, e themeluar mbi parimet dhe mbi kriteret të A. Kostallarit e të tjerëve, ne ndihemi më shumë me ndjenja shqiptare dhe të bashkuar më shumë. Linguistika shqipe bier sot një ndër më të mëdhenjtë specialit në botë”.

Ne të gjithë, pa paragjykime politike ose ideologjike, duhet të nderojmë A. Kostallarin me zemër e me mirënjohje. Dhe kështu nderojmë dhe Kombin, për të cilin Ai dha jetën e tij.

I dërgova numrin “**Lidhja, 27, 1992**” të birit **Ardjan Kostallarit** në Tiranë, i cili, me shumë mirënjohje, më falënderon në këtë letër shumë të bukur për mua⁷¹.

⁶⁸ Leter e botuar me një fotografi në Lidhja, Cosenza, 28, 1992, 962-963.

⁶⁹ M. Domi. Në kujtim të A. Kostallari-t, Studime Filologjike, Tiranë, 1, 1992, 186.

⁷⁰ A. Bellusci, *Në kujtim të A. Kostallarit*, Lidhja, Cosenza, 27, 1992, 1992.

⁷¹ **Tiranë, më 24 qershor 1992** - Prof. Antonio Bellusci. Corso Plebiscito, 22 -87100 Cosenza.

Me botimin e shkrimeve të Kostallarit plotësohet edhe dëshira e Ardianit, i biri. Çdo njeri shqiptar duhet të kuptojë këtë fenomen të madh: sot gjithë Universitetet e botës kanë pranuar gjuhën kombëtare të njësuar shqipe, si edhe në të gjitha institucionet shkruhet shqip me rregullat të drejtshkrimit, si edhe studiuesit më të pjekur e më të dritshëm.

Një Komb një Gjuhë, këtu është dhe qëndron madhështia të A. Kostallarit si edhe të gjithë të tjerëve shkencëtarë, shkrimtarë, poetë që e kanë përkrahur dhe ndihmuar dhe realizuar një situatë kështu e shkëlqyeshme dhe kombëtare.

Frasnita (Cosenza), më 11 korrik 2015

(Antonio Bellusci është prift arbëresh me ritin bizantin-grek në eparkinë e Ungres (Cosenza) dhe me shtetësi shqiptare. Themelues dhe drejtor i Bibliotekës Ndërkombëtare shqiptare “A. Bellusci” në Frascineto (Cosenza) dhe i revistës arbëreshe “Lidhja”, Frascineto. Shkrimtar, udhëtar, etnolog. Adresa: A. Bellusci – Via Pollino, 65 – 87010 Frascineto (Cosenza) papas.abellusci@bibliotecabellusci.com

Shumë i dashur dhe i nderuar Papàs Bellusci!

E mora revisten “Lidhja” që patet mirësinë të më dergonit. Gjithashtu e lexova edhe profilin e hartuar nga ju vete për babain tim. Prandaj, me këtë rast, më lejoni t’ju shpreh mirënjohjen më të thellë për vlerësimin e lartë që i kini bërë jetes dhe lepre së babait tim, njerez si Androkli Kostallari vërtet që i perkasin leggjendes së popullit shqiptar. Për fat të keq, po këta njerez vuajtën pasojat më të rënda të izolimit dhe injorances që i rrethonet nga të kater anet e që nuk i lini nata të merrin fryme lirisht. E si për ironi të fatit, edhe babai im vdiq nga mungesa dhe dhe zenia e frymes. Njerez si Ai, anëtar nderi të shumë shoqatave shkencore me fame, të nderuar me titullin “Doktor honoris causa” nga Universiteti i Goteborgut në Suedi, Njerez, të cileve shoqata amerikane”Markus”.

Ka kerkuar biografinë për t’ua botuar si duhet nga njerezit e shquar që kanë dal nga gjiri i saj, sepse po t’i kishte vlerësuar, ajo nuk do të ndodhej në këtë gjëndje në të cilën ndodhet sot; do t’i kishte vlerësuar, babai im do të ishte akoma i gjallë.

Babai im kishte probleme të mëdha për të ardhmen, realizimi i këtyre planeve do t’i jepte akoma më shumë prestigj kombit shqiptar. Pjesën më të rëndësishme të këtyre planeve e përbente botimi i vlerave të plota të tij, vepra të cilat i fjanë Atij fame botërore. Për fat të keq, perspektiva e botimit të tyre në Shqipëri është teper e zymte, e kjo për arsye që ju i dini mjaft mirë. Prandaj edhe po kerkoj mundësi për botimin e tyre jashtë shtetit. A mund të më ndihmoni? Ju kini mjaft lidhje me diasporën shqiptare, kudo që ajo ndodhet dhe unë jam i sigurt se çdo shqiptar do ta kishte për nder, që emri i Androkli Kostallarit të tingëllonte po aq i fuqishëm edhe pas vdekjes, njësoj si kur Ai ishte i gjallë. Veprat e tij duhet të shohin patjetër dritën e botimit, ndryshe ato rrezikohen të geliten nga erresira e injorances dhe padijes shkencore, e cilla është akoma e pranishme në qiellin shqiptar. I vetmi shpërnlim imi do t’ishte t’i shija vera e tij të botuara, duke qenë i ndërgjegjshëm, në këtë menyre, se ka akoma njerez ky komb, që dinë të vlerësojnë shkencëtarët e shquar.

*Në pritje të një përgjigje sa me shpresëdhënëse nga ana juaj, mbetem sinqersisht I juaji
Adrian A. Kostallari*

EQREM ÇABEJ

VENDBANIMI I HERSHËM I SHQIPTARËVE NË GADISHULLIN BALLKANIK NË DRITËN E GJUHËS E TË EMRAVE TË VENDEVE

Çështja se ku ka qenë djepi ballkanik i shqiptarëve, në cilën pjesë të gadishullit, pra, kanë banuar në kohën antike të parët e tyre, përbën një problem që u përket në të njëjtën masë si historianëve ashtu dhe gjuhëtarëve. Historianët ndërkaq, me sa duket, për punë të mungesës së burimeve për historinë e lashtë të popullit, këtë çështje me kohë ua kanë lënë gjuhëtarëve, dhe gjuhëtarët kanë ndërmarrë ta zgjidhin me mjetet e metodat e veta.

Për brezin e vjetër të dijetarëve, me Johan Thunmanin (1774), Hahnin (1854) e të tjerë, shqiptarët edhe vetë për arsye historike janë autoktonë ilirë, sepse ata banojnë atje ku në kohën antike kanë jetuar fise ilire, edhe sepse për këto vise për një kohë më të vonë, përveç ardhjes së sllavëve nuk vërtetohet ndonjë imigrim. Gjuhëtarë të tillë si Kreçmer, Pedersen, Ribeco e historianë si Milan Shufraj i kanë dalë zot autoktonisë së shqiptarëve dhe e kanë mbështetur këtë tezë me argumente të reja, të karakterit gjuhësor e historik.

Teza e burimit trak të gjuhës shqipe, duke përjashtuar ilirishten, tezë që nisi në kapërcyell të shekullit kryesisht me Karl Paulin e Hirtin, solli me vete mendimin e një djepi më lindor të popullit shqiptar, prandaj, ajo sa kohë që kishte kërkesa që të zinte vend, duhej të hidhte poshtë argumentet e autoktonisë së tij. Kjo u bë në këtë mënyrë, që në mungesë argumentesh historike u sollëm një varg arsyesh gjuhësore, të cilat do të vërtetonin një shtegtim të shqiptarëve prej visesh më në lindje për në trevat e Adriatikut, aty nga mbarimi i kohës antike ose në mesjetën e parë. Nga përfaqësuesit e kësaj teorie, Gustav Vajgandit pa dyshim i bie merita që arsyet që flasin në të mirë të këtij mendimi i ka parë në tërësinë e tyre dhe i ka rrahur me hollësi, prandaj një diskutim i argumenteve të tij do të thotë njëkohësisht dhe një të marrë qëndrim ndaj tezave kryesore të këtij drejtimi kërkimor. Së pari, do shënuar së vija e ideve të Vajgandit na del më përpara, në argumentim e në rezultat, pjesërisht që te Norbert Jokli e Petar Skoku[1]. Ndërkaq, në lidhje me Joklin duhet të shënojmë se me gjykimin e këtij kompleksi çështjesh te ky dijetar vihet re një zhvillim i brendshëm. Ndërsa ai më parë kishte menduar që veriperëndimi i truallit të sotëm gjuhësor të shqipes për një kohe më të lashtë nuk vjen në vështrim si vendbanimi dhe që mendimi i tij piqet me tezën e Jireçekut, sipas të cilit të parët e shqiptarëve gjatë shtegtimin të popujve u shtynë

me në jug duke ardhur prej visesh më verore, më vonë ai arrin në përfundimin që shqiptaret, duke ardhur prej visesh më në lindje, e kishin arritur trevën e Prevalitanës, pra veriperëndimin e vendit të tyre të sotëm, në çdo rast që në kohën latine, megjithëse mbase aty nga mbarimi i saj, dhe që Sllavët, kur u shtynë në anët e bregdetit në Aiersitë e Buenës, gjetën aty një popullsi shqiptare. Me këtë përfundim bashkohet në kohët e funait edhe H. Bariçi¹.

Po të shikojmë tani më për së afërmi tezat e Vajgandit, shohim se në argumentet kryesore të tij bën pjesë dhe toponomastika, dhe kjo në një pikëpamje dyshe. Së pari, sipas tij, «emrat latinë të vendeve nuk paraqiten me trajtën shqiptare, po me trajtën latino-dalmate». Së dyti, po të kishin banuar shqiptarët gjithmonë në Shqipërinë e sotme, emrat e vendeve që burojnë prej kohës antike, duhet të kishin kryer zhvillimin fonetik të shqipes po shihet menjëherë që kjo nuk është kështu, se këta emra paraqesin qartë karakterin sllav, e në viset detare karakterin italian-venecian, përkatësisht dalmat.

Le t'i shqyrtojmë shkurt këto teza:

Në elementin dalmat të toponimisë shqiptare Vajgandi përfshin emrat Valbona, Domni, Patosa, Surella, Kapra, Oblika, Petrosa që dëshmojnë në burimet mesjetare, e më në fund emrat e maleve Durmitor e Visitor në Mal të Zi. Kush i kqyr këta emra nga pikëpamja e dalmatishtes dhe të ketë parasysh diftongimin gati të përgjithshëm të vokaleve të shkurtra e të gjata në atë gjuhë, sidomos në silabë të lirë, mund të përfytyrojë afërsisht se çdo të kishin dhënë atje bazat latine të këtyre emrave. Një gjë është e sigurt që reflekset dalmate do të paraqiteshin me një trajtë fare ndryshe nga trajta me të cilat dalin realisht këta emra. Kështu kjo tezë, të cilën e ka përsëritur dhe ndonjë tjetër dijetar, nuk mund t'i bëjë ballë gjendjes reale.

Për sa i përket tezës së dytë të Vajgandit, unë ka vjet që kam arritur në bindjen se toponomastika historike jo vetëm që nuk flet kundër autoktonisë, po që përkundrazi dëshmon bash në të mirë të saj^[3]. Vajgandi ka rënë në këtë gabim në metodë, që ai të gjitha emrat topikë i mat me të njëjtën masë, format antike, mesjetaret e të kohës së re i shikon sikur të ishin me vlerë të barabartë. Kështu, përveç disa çiftesh të vjetra e të reja, si Scodra: Shkodër., Lissus: Lesh, Dyrrhachium; Durrës, ai pas shembullit të Skokut, ka marrë në shqyrtim edhe hartën gjeografike, dhe kështu nga krahina rreth liqenit të Shkodrës dhe nga zona e Tomoricës. në Shqipëri të Mesme ka cituar e interpretuar masën e madhe të emrave të huaj (sllavë, turkë e të tjera) dhe numrin e paktë të emrave anas. Për këtë mënyrë procedimi është për të vënë re në parim që emrat topikë, që rrjedhin nga koha e mesme dhe nga «e reja, nuk janë aspak relevantë për punën e autoktonisë. Sidomos nuk vijnë në vështrim emrat e katundeve. Ngulimet fshatare në Ballkan, në këtë trevë të përshkuar pareshtur prej luftërash, nuk kanë pasur kurrë jetë të gjatë, prandaj edhe emrat e tyre nuk ka si të burojnë prej një kohe së lashtë. Përkundrazi, qytetet, si kudo gjetkë, dhe këtu kanë formuar një traditë në

rrethinat e tyre. Emrat e tyre i kanë shpëtuar kohës, edhe atëherë kur popullsia ka lënë trojet e u shkul ose u shpërngul gjetkë, ose kur qyteti vetë ka ndryshuar vendin e vet, ka ndodhur bile që emri i një qyteti të ketë mbetur gjallë në krahinën e tij edhe mbasi ai të jetë rrënuar. Po aq jetëgjatë sa emrat e qyteteve janë zakonisht dhe emrat e maleve e të lumenjve kryesorë. Në rrethana të tilla shtrohet në pikëpamje metodike kriteri që në studimin e emrave të vendeve me mjetet e gjuhësisë historike, duhet të kryhet një farë shtresimi përbrenda tyre. Prandaj, në çështjen e autoktonisë e vetmja rrugë që do të ndiqet është kjo, që, duke lënë jashtë të gjitha shtresat më të vona, emrat që kemi nga koha antike të merren e të krahasohen me trajtat përkatëse që rrojnë sot në gjuhë të popullit, e të shikohet a shpjegohen këto të fundit nga ato të parat me rregullat e fonetikës historike të shqipes. Në rasën e parë mbetet i vërtetuar kontinuiteti i elementit shqiptar në viset historike të tij. Në rasën e kundërt ky ato emra i ka marrë nëpërmes një gjuhe tjetër. Kjo do të thoshte që ky element nuk është autokton, po është i ardhur prej visesh të tjera.

Duke u nisur nga veriu i vendit, do të shënojmë se mendimi që emri i sotëm i qytetit Shkodër, e shquar Shkodra, në kohën latine (te Titus Livius) Scodra, të ketë rrojtur në gojën shqiptare vazhdimisht që prej kohës pararomake gjer më sot, pas N. Joklit nuk pajton me përfundimet e fonetikës historike të shqipes, për punë të tingujve nistorë të fjalës e të grupit konsonantik në trup të saj. Kundër kësaj do thënë se ndërrimi *sk-* në *h*, që postulohet me këto fjalë për në ballë të emrit, nuk vjen në vështrim këtu: ky ndërrim ishte kryer që ne periudhën prehistorike, mbase që hë periudhën paraballkanike të shqipes; kurse çështja e autoktonisë ka të bëjë me shkallën antike të kësaj gjuhe. Për këtë shkallë, zhvillimi historik i këtij emri ka shkuar kryekrejt në vijën e fonetikës shqiptare, sikundër tregon krahasimi me trajtimin e huazimeve të shqipes nga greqishtja e vjetër e nga latinishtja. Për ballin e fjalës le të krahasojmë shkamb nga lat. *seamnum*; për grupin e konsonanteve në trup të fjalës *kulshedër* nga lat. *chersydrus*; kjo prej greqishtes e balladër «ujvarë» nga lat. *barathrum*, greqishte e vjetër βαπαδρῶν. Pyetjes se nga e rimorën shqiptarët formën e moçme Skodra nuk mund t'i jepet përgjigje me fjalët e Vajgandit «prej dalmatinëve ose italianëve të atjeshëm»: italisht këtij qyteti dihet se i thonë Scutari e në dalmatishten Scodra do të kishte dhënë diçka tjetër. Forma e sotme Shkodër është vijimi i rregullt nga pikëpamja e shqipes i Scodra-s së vjetër, .po ashtu siç është Shkup-i i sotëm vijimi i Scupi-t të vjetër; sllavishtja Scoplje me-o-në e saj rrjedh nga forma e një dialekti lindor të gjuhës shqipe[4]. Në lidhje me këto edhe emri josllav Rogami, i cili dëshmohet për disa vise të Shqipërisë Veriore e të Malit të Zi, nuk mund të sillet, me Joklin, si argument kundër një tradite gjuhësore të pakëputur të shqiptarëve, (per punë të -g-së intervokaliqe. Në të vërtetë këtu kemi të bëjmë me një formim të brendshëm e relativ të ri të shqipes, me një zgjerim të fjalës roge «vend në bjeshkë me bar e pa lisa, rudinë» (që shkon me rruaj) me anë të sufiksit *ame*, e cila gjen shoqen e saj te degame zënkë, shamatë», nga degë. Më në jug Lesh është zhvillimi, i rregullt nga pikëpamja e shqipes, i Lissus të kohës së vjetër, me po atë reflektim të i-së së shkurtër e të hapët (përpara konsonantit dyfish) siç shihet dhe në apelativa si meshë mjeshtër peshk

nga lat. missa, magister, piscis, te suffiksi i mocionit -eshë nga lat. -issa e te adverbijesh nga spissus. Vërtet se Vajgandi thotë: «Nga Lessium ka dalë serb. Ljes, nga kjo shq. Lesh ose anasjelltas, gjë që s'ndahet dot fonetikisht» po ne do të themi se fonetika historike e shqipes është në gjendje fort mirë ta ndajë këtë punë. Nga emrat e të tjerëve qytete, emri i sotëm shqip Durrës pas mendimit të përgjithshëm nuk merret si vazhdim i drejtpërdrejtë i emrit antik Dyrhachium, dhe me larminë e emrave të këtij qyteti lat. e mesme Duracium, dalm e vj. Durrazu, fngj. e vj. Duras, it. Durazzo, sllav. turq. Draç etj. Çështja se nga buron trajta shqiptare mund të thuhet se ka mbetur e hapët. Po të rrokem mirë rrethanat e aksentit të ky e të tjerë emra topikë trisilabash të trevës gjuhësore të ilirishtes, pas mendimit tim hapet shtegu për një lexim të drejtë të këtyre emrave; dhe për kuptimin e zhvillimit të tyre gjërë te trajtat e sotme të shqipes. Në këtë mes mendimi i Hams Krahes që ilirishtja ka zbatuar aksentin nistor ashtu si gjermanikishtia e përbashkët, italikishtja e keltishtja), duhet të çmohet si një konstatim i vlefshëm dhe të shtihet në punë në çështjen sesi duhen shqiptuar të tillë emra vendesh të ilirishtes. Me këtë mënyrë procedimi e cila pjesërisht ka qenë zbatuar më parë prej Petar Skokut, për emrin e qytetit Drivastum e për emrin «e lumit Isamnus që dëshmon Vibius Sequester, dalin leximet Drivastum e Tsamnus, e këto lexime vërtetohen më së miri me Drisht e *Ishëm Ishm* (ky emër lumi e emër qyteti) të shqipes së sotme. Po kjo gjë vlen edhe për Durrës, në bazë të të cilit qëndron një formë e vjetër vendase Durachion, Durrachium, me shqiptim të v-së si u në një fazë më të mëtejme të greqishtes së vjetër e në greqishten veriperëndimore. Në lidhje me këto nuk duket të jetë një gjë e rastit që në anët bregdetare të Apulisë përkundrejt këtyre, në dhenë e mëtejme të mesapëve. emrave latinë Tarentum, Brundisium, Hydruntum u përgjigjen sot Taranto, Brindisi, Otranto. Në veri të Ishmit derdhet në Adriatik Mati. Emri i këtij lumi është reflektimi i rregullt për gjuhën shqipe, i Mathis fluvius që ka Vibius Sequester. Ky barazim është aq më i shënueshëm, kur të kemi parasysh që ky emër lumi gjen shpjegimin e tij përbrenda shqipes, ku mat do të thotë buzë deti a lumi». Prandaj ka shumë të ngjarë që emri i sotëm i lumit të jetë vazhdim i atij të vjetrit, që pra me fjalë të tjera, ata që i vunë emrin të kenë qenë te parët antikë të shqiptarëve. Fjalën shqip mat unë e bashkoj etimologjikisht me irlandishten math -«rërë, kum; përdorimi i një fjale me kuptimin «breg deti a lumi* për t'i dhënë emrin një lumi sqarohet p.sh. me frëngj. riviëre (lumë) nga rive (breg) pa arsye mihon Vajgandi dhe burimin e pandërmjetmë të emrit shqip të lumit Shkum(b)i ! Shkumi(b)ini nga lat. Scampinus (prej Scampa), duke e çuar trajtën e shqipes të një bazë sllave.[5] Skompin të pa dokumentuar, refleks i pretenduar i emrit latin të këtij lumi: emri latin në Shqipëri të Mesme nuk ka si të çonte në një përfundim të ndryshëm nga ai që ekziston sot, sepse në këtë dialekt ë-ja në pozicion përpara theksit kthehet në dhe grupi mb jep rregullisht m me anë të një asimilimi progresiv. Një ndërmjetësi gjuhësore të sllavishtes mendon Vajgandi dhe për emrin shqip të qytetit të Vlorës, Vlon Vlorë, te Ptolemeu, ndërmjetësi të cilën ndërkaq Maks Vasmeri e quan të pasigurtë[6]. Dhe me të vërtetë, një bazë origjinale Avlona në gojë të sllavëve, pas fjalëve të vetë Vajgandit, duhej të kishte dhënë* Valinb, prandaj ky dijetar e sheh veten të detyruar që kalimin e këtij emri të sllavët ta zbrësë kronologjikisht, e pikërisht ta çojë gjërë në kohën e Simeonit të

Madh. Shihet qartë se me një caktim kohe të tillë mbetet një vakuum (një zbrazëtirë) prej disa shekujsh, e cila në të vërtetë nuk mbushet me asgjë. Përkundrazi, po të shtrojmë barazimin greqisht e vjetër e vonë Avlon: shqip Vlonë Vlorë, qëndrojmë në truall të realitetit historik gjuhësor; afereza e a-së është po aq e rregullt sa te amicus: mik; i rregullt është dhe rotacizmi i toskërishtes te Vlorë. — Në anën më jugore të truallit gjuhësor të shqipes Martin Lik, te emri shqiptar i krahinës Çamëria që në vitin 1814,[7] kishte gjetur emrin antik të lumit Thyamis (sot Kallama) emër që te popullsia greke e asaj ane nuk ruhet gjëkund. Më në jug raporti historik i emrit antik "Apaxiroç ndaj të sotmit Arta *paitonme* rregullat e fonetikës historike të shqipes (kt: ht: t). Po të sillemi përsëri nga veriu i truallit gjuhësor të shqipes e nga deçet e tij verilindore e veriperëndimore, pas konstatimeve të N. Joklit, H. Bariçit e të disa të tjerëve dijetarë, te raporti midis Naissus-It antik e të sotmit Nish e te raporti midis Astribus e Shtip neve na shfaqet ndërmjetësia gjuhësore e shqipes. E njëjta gjë do pranuar tani për Scardus *mons*, sot Sharr. Edhe te ky par emrash mungon zhvillimi sllav me metatezën e likuidave që është karakteristike për të, zhvillim që nga ana tjetër vihet re te Scardona: Skradin në Dalmaci. Andej nga veriperëndimi po të merret emri i Raguzës, Ragusium, i cili shfaqet që nga viti 614 i erës sonë, e të shikohet në raportin e tij ndajemrit të hershëm të këtij qyteti te shqiptarët (si te P. Bogdani 1685) që është Rush, ky emër paraqet në vetvete gjithë shenjat e zhvillimit fonetik të shqipes, hiferezën e vokalit paratheksor zhdukjen e g-së intervokalike, ndërrimin e s-së në sh, dhe vetë ky emër bashkë me atë të qytetit Ragusa në Siçeli, përmban pas gjithë gjasësh shkallën e përparme të fjalës shqipe rrush, kjo nga një bazë ragus-«kokë rrushi». Kështu, pra, ky emër vendi, së bashku me Shkodër, Drisht, Lesh, Mat, Ishm, Durrës, Shkumbin, Vlonë Vlorë, Çamëri, Arta e ndonjë tjetër, tregon se Adriatiku jugor e Joniku verior kanë bërë pjesë qëmoti në atdheun e popullit shqiptar. Në punën e këtij atdheu një rëndësi të veçantë i kanë dhënë terminologjisë detare të shqipes. Pas mendimit të përgjithshëm fjalët që i përkasin lundrimit e peshkatarisë janë të marra prej gjuhëve fqinje, e kjo zihet prapë si një argument kundër një banimi të vjetër në brigjet e Adriatikut. Ky mendim burimin në themel e ka në Norbert Jokli, veçse për sqarim të gjithë gjendjes duhet shënuar se ky gjuhëtar më vonë këtë e ka dobësuar ai vetë me kundërargumente. Kështu ai vë në pah kundër Vajgandit faktin që gjermanishtja e lartë mjë pjesë të madhe të termave të saj nga jeta e detarisë i ka marrë prej gjermanishtes së ulët, e megjithatë, është gjë e ditur që gjermanishtja e lartë është gjuhë gjermanike dhe që popujt gjermanikë kanë qenë që- moti anadetas e detarë[8]. Sipas Vajgandit; shqiptarët, «po të kishin banuar gjithmonë në Iliri, duhet të kishin shpëtuar disa nga më të zakonshmet terma nga të leksikut autokton të trashëguar, si ndonjë fjalë për lundër, anije, lopatë, timon, shul, vel si dhe emra peshqish etj. Kjo tezë, të cilën e kanë përsëritur disa dijetarë, është hedhur edhe kjo tepër ngutshëm, sepse nuk pajtohet me të dhënat e gjuhës. Askush nuk e mohon që leksiku detar i shqipes së sotme në pjesën e tij më të madhe është i burimit të huaj; veçse edhe këtu, ashtu si në lëmin e toponomastikës, duhet të bëhen dallime cilësore. Të huaja janë termat teknike të lundrimit e të peshkatarisë, sikundër janë në pjesën e tyre më të madhe emrat e mjeteve të lundrimit e të pjesëve të tyre, më të shumtat emërtime të llojeve të

peshqve e të veglave të peshkimit. Po krahas me këto shqipja ka ruajtur një pjesë jo dhe të paktë me fjalë vendi, që janë të fondit autokton të fjalorit të saj, hyjnë aty ndër të tjera det (me kuptimin bazë «thellësi», bashkë me bregdet e detar që janë dokumentuar mjaft herët e me denik «erë e fortë me shi», që në thelb është «erë e detit» (detnik). Ka pastaj va, që vjen prej latinishtes, e që në shumësin vana shënon «ato të hyrat më të cekëta ose më të thella, të detit më breg, sipas madhësisë më të paktë a më të shumtë të enëve të lundrimit, të hyra që u shërbejnë këtyre enëve si vende ndalimi e pushimi e që janë prona e një grup familjesh, e një lagjeje ose e mbarë katundit. Vijnë pastaj mat «buzë deti a lumi», grykë (deti), valë, shkullm, «dallgë, suvalë ujë amull «ujë të ndejtur e ndonië tjetër. Nga emërtimet e mjeteve të lundrimit emri gjenerik ani anije dihet se ka lidhje me an anë «emë», pra nga kjo anë mund të krahasohet me gjerm. Schiff «aniie» që vien nga gjerm. e lartë e vietër scif «enë», e me frengj. vaisseau, it. vascello «anije» nga lat. vasoellum «enë e vogël». Edhe vetë shumësi i fjalës an anë, që është enë, përdoret. për «mjet lundrimi», enët e mëdhaja, enët e vogla. Megjithëse mjetet e sotme të lundrimit kanë pothuajse të gjitha emra të burimit të huaj, nuk kanë munguar as këtu emërtime të vendit, kështu për vitin 1403 gjendet e dëshmuar për Shqipërinë Jugore gripareas «barka kripe një rrjedhojë e fjalës kripë[9]. Nga emrat e pjesëve e të pajisjes së anijeve janë me burim vendi ndër të tjera emri i pjesës së përparmë të anijes (ballës), ai i dërrasave të fundit që qëndron në ujë (terzha), pastaj emri i velit (pëlhurë), i shulit (shul), i lopatës (lugatë—lugë + lopatë), i -shulit të gjatë për të shtyrë (shtizë); khs. edhe ena ujtis «ena tërheq, thith ujët», nga fjala ujë. Është e vërtetë ndërkaq që kjo terminologji e vjetër është mbajtur vetëm në disa dialekte të mënjanuara të bregdetit, përveç kësaj këto nuk janë studiuar sistematikisht nga kjo anë. Duke kaluar tani tek emrat e peshqve e të tjerave shtazë detare, edhe këtu krahas me shumicën dërrmuese të emrave të huaj gjejmë një sasi të konsiderueshme me emra vendi. Hyn këtu pikë së pari likurishtë «polip» që vjen nga likurë. E mbarë gjuhës është fjala ngjalë që nuk mund të rrjedhë as nga greqishtja e vjetër, as nga latinishtja anguilla po që si refleksi i një baze autoktone engella lidhet me emrin e fisit ilir në brigjet e liqenit të Lychnitis (Ohrit), emër të cilin Paul Kreçmeri e merr me të drejtë si «njerëzit e ngjalës». Ndër emra peshqish që janë formuar me mjete vetjake të gjuhës le të përmendim haltuk, barkgjerë, harkulec, bercak, bishtimizë, bishtmi, buztak, dac deti, dallëndyshe, dhelpen deti, ferracak, gjanës, gjarpën deti, gjuhçë, gjylpanëz, hanë hanëz; kryemadhe, kryeprefët, knqrrak, laraman, larëz, pëndkuq, pluhn, slxyt, shtyëz, veshflori, vesh- verdhë, vioç. Emri i peshkut kubël «Clupea alosa» me trajtën e tij afrohet me serbokl, kobla që rrjedh prej dalmatishtes, gjë që edhe kjo nuk flet në të mirë të tezës së Vajgandit, sipas së cilës marrëdhënie shqiptaro-dalmate nuk ka. Nga pjesët e trupit përveç halës hyjnë këtu krehër «skeleti i peshkut» e verzën «organi i frymëmarrjes, veshi i peshkut». Fjala gjuaj vlen dhe për të peshkuarit. Nga veglat e peshkimit të të përmendim rrahçë «vegël. peshkimi në trajtë koni» (rrah) njicë «rrjetë e madhe peshkimi» (njis ngjis), palcuer «purtekë e gjatë e rrjetës (palcë) e shularë» «purtekat e gjata të rrjetës» (shul). Në këto rrethana për nomenklaturën e degës së detarisë e të peshkatarisë na del përpara një gjendje, e cila në raportin e leksikut të huaj ndaj leksikut të vendit nuk është qenësisht e

ndryshme nga ajo e disa sferave materiale të tjera, siç janë bie fjala bujqësia e zejtaria. Më anë tjetër, në burinë e fjalëve të huaja, sidomos veneciane e turke, në terminologjinë e detarisë e të peshkimit, shqipja ecën bashkë me t-ë tjera gjuhë të Ballkanit, sidomos me greqishten e re e me serbokroatishten.

Nuk është vendi këtu të hyjmë në punën e përmendjes së vonë të shqiptarëve në histori, në marrëdhëniet e shqipes me rumanishten dhe në konkordancat shqiptaro-trake, rrethana që shfrytëzohen shpesh herë si argumente kundër autoktonisë. Për konkordancat shqiptaro-trake (ose shqiptaro-dake) në leksik e në sistemin fonetik le të shënojmë vetëm këtë, që përkrah këtyre ka po të tilla. mbase edhe më të qarta, midis shqipes e ilirishtes (ose veçanërisht midis shqipes e mesanishtes). Edhe këtu, pra, interpretimi historik i lëndës gjuhësore është fare i njëanshëm dhe si i tillë fort i kontestueshëm. Më në fund si tregues negativ për autoktoninë zihet, që prej Norbert Joklit e këtej, dhe sasia relativisht e paktë e huazimeve të shqipes nga greqishtja e vjetër. Ndaj kësaj teze po mbajmë shkurt qëndrim këtu, meqenëse është me rëndësi për këtë çështje. Pjesa e vogël që ka greqishtja e vjetër në formim të leksikut të shqipes, në krahasim me latinishten. është një fakt i pamohueshëm, po në ka shpjegimin e vet. Kjo gjë ka arsye e saj historike e gjeografike dhe arsye të qarkullimit, se dihet mirëfilli që një masë vargmalesh e ndajnë Shqipërinë me Greqinë. Kështu shpjegohet pse gjuha shqipe në gjithë historinë e saj paraqitet me fytyrë të larguar prej greqishtes. Kjo shihet edhe aty, që edhe për kohën e mesme edhe të renë, periudha të historisë, për të cilat praninë e shqiptarëve në viset historike nuk do të ketë njeri që ta dyshojë, ndikimi i italishtes është shumë më i madh nga ai i greqishtes së mesme e i së resë, kuptohet kur kemi parasysh huazime që f ka mbarë shqipja. Mbase të jetë vendosur një herë mirë kjo bazë parimore, huazimet nga greqishtja e vjetër paraqiten të tilla, që dëshmojnë më fort për karakterin autokton të shqiptarëve sesa kundër atij. Edhe po të lihet mënjanë rrethana që numri i këtyre huazimeve vërtetohet se është më i madh nga ea mendohet, ka më këtë mes një send që në karakterin e tij cilësor gjer më sot nuk është vënë re sa duhet. Sikundër dihet që nga S. Buge, A. Thumbi, N. Jokli, K. Sandfeldi e të tjerë gjuhëtarë, në gjuhën shqipe ka disa huazime dorike-greke veriperëndimore, si mokën mokër **drapën drapër** më pak e sigurt mollë, meqë këtu mund të kemi të bëjmë edhe me një huazim drejtpërdrejt nga substrati mesdhetar. Ky leksik huazimesh përfshin dhe të tjera rasa. Aty hyjnë **kumbull**, **kokkumalon**, **brukë** «**Tamfyrix gallica**» (Shqipëria e Mesme e Myzeqeja) trumzë Thymuus» (Shqipëria Veriore) «Satureja thymbra»-, *qull*, kum shumësi kuma dallgë, tallaz (Ulqini) tallaz, valë». Në pajtim me rrethanat e gjuhësisë historike e të gjeografisë ka shumë më të ngjarë që të kemi të bëjmë me huazime dorike-greke veri-perëndimore të kohës klasike sesa me huazime nga një periudhë më e lashtë e greqishtes. Është një gjë që meriton të vihet re, e jo pa rëndësi për historinë e shqipes, po edhe të greqishtes vetë e të dialekteve të saj, që këto fjalë na dalin me një trajtë të afërt në greqishten e Italisë Jugore që ka studiuar Gerhard Rohlfsi. Kështu shqipes kumbull i përgjigjet prej atyre dialekteve kukkumile kukkumila; shqipes brukë forma të tilla si bruka, **abbruka**, **vruka**; **trumzë**-sotrant. trumba, **tromba** «Thymus». Meqenëse për një shtegtim fjalësh dialektore nga të Italisë së

Jugut në shqipen nuk ka asnjë mbështesë, këtu do të pranohen lidhje të lashta, të eilat në të dy brigjet e detit e në mënyrë të pavarur rrjedhin prej greçitetit dorik. Për shqipen ka rëndësi në këtë mes rruga e huazimit. Pas gjithë gjendjes historike këtu ka vetëm dy rrugë në të cilat këto huazime kanë depërtuar në fazën antike të gjuhës shqipe më një anë nëpër dialektet veriperëndimorë të Greqisë Veriore, më anë tjetër nëpërmes të kolonive dorike në brigjet e Adriatikut, si Lissos, Epidamnos, Dvrrhachium, Apolonia «pikënisje rrugësh tregtare shumë të lashta, që shpinin brenda në terë»[10]. Kryesisht me këto dy rrugë kanë hyrë më shqipen dhe të tjera huazime nga greqishtja e vjetër. Vetëm se këto në dorishten (ose në greqishten veriperëndimore) në formën e tyre nuk kanë qenë të dalluara ashtu si këto që sapo u zunë në gojë, prandaj dhe është e pamundur të jepet burimi më i saktë për shqipen. Po të nxjerrim prej këtij arsytimi pasojat për gjuhën shqipe. duhet të pranojmë në kohën kur ekzistonin dialektet dorike greke veriperëndimore, përpara fillimit të erës së re, të parët e shqiptarëve kanë qenë në Shqipëri të sotme, ku edhe morën huazimet e përmendura më sipër.

Duke shikuar me një vështrim këto që shtruan këtu, do të themi se emrat topikë të Shqipërisë, që njihet prej kohës antike e këtej, së bashku me terminologjinë detare të shqipes e me huazimet dorike greke veriperëndimore që ruhen në këtë gjuhë, dëshmojnë që viset bregdetare të Adriatikut bëjnë pjesë qëmoti, së paku që prej epokës greko-romake, në atdheun ballkanik të shqiptarëve. Edhe në qoftë se nga pushtuesit e huaj u shty duke u tërhequr për disa kohë nëpër zonat malore, ky element etnik nuk u largua kurrë ndonjëherë nga horizonti i Adriatikut, sikundër vërteton një varg emrash topikë të lashtë, e sikundër tregon dhe karakteri arkaik i huazimeve latine. Kështu, pra, vendbanimi i tij nga koha antike e këtej s'ka pësuar ndonjë dislokacion qenësor. Kjo tezë e paraqitur këtu në vijat kryesore duhej shtjelluar në hollësi. Aty duhet të merreshin parasysht dhe shtresat e mëvona të emrave topikë, të cilat janë një dëshmi për dyndjet e huaja gjatë historisë shqiptare.

**) Reallexikon der Vorgechiche I 91v.-Zeitschrift fur Ortsnamenfortschung IV 205, Zeitschrift fur romanische Philologie 45, 180 vv. *)Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, 43. *)Khs tani së fundi «Buletini i Universitetit të Tiranës», seria e shkencaveshoqërore; 2 (1958) 54 vv. * Studii si Cercetari lingvistice X-4 (1959) 530. [5] Indogermanische Sprachwissenschaft (1943)34. [6] Zeitschrift fur slavische Philologie V 288. [7] Researches in Greece 13. [8] Indogermanische Forschungen 46, 383. [9] Acta et diplomata res Albaniae mediae aeratis illustrantia, II, 742. [10] Sufflay, Stade und Burgen Albaniens hauptsachlich wahrend des Mittelalters 12*

SEIT MANSAKU**UDHËTIM HISTORIKO-STUDIMOR NGA
ILIRISHTJA TE SHQIPJA**

Ilirishtja dhe shqipja, një ekuacion, një përballje midis dy gjendjeve etniko-gjuhësore, midis dy realiteteve etniko-gjuhësore të periudhave të ndryshme, midis antikitetit nga njëra anë dhe kohëve moderne nga ana tjetër, një barazim që shpreh një marrëdhënie afrie filiacioni, apo një barazim që i bashkon thjesht faktori hitoriko- gjeografik, fakti që Ilirët dhe Shqiptarët u gjendën në një truall të përbashkët këtu në perëndim të Gadishullit të Ballkanit, të parët në lashtësi dhe të dytët në mesjetë dhe në kohët moderne. Është ky një debat shkencor që mban të mbërthyer albanologët e ballkanologët që prej dy shekujsh.

Si mund të përcaktohet se shqipja është vazhde e ilirishtes?

Nga ana gjuhësore, për shkak të njohjes së mangët të gjuhës ilire, është pa dyshim një ekuacion i vështirë për t'u vërtetuar me metoda shkencore në mënyrë të pakundërshtueshme, por ndoshta më i mundshmi, më i ngjashmi me burimet dhe mjetet që kanë në dispozicion shkencat historike e gjuhësore në kohën tonë. Shkalla krejt e pamjaftueshme e njohjes së ilirishtes dhe dokumentimi i vonë dhe në një stad të evoluar i shqipes, kanë krijuar një hendek në marrëdhëniet e filiacionit midis këtyre dy gjuhëve, por megjithatë rrethanat historike e kulturore dhe ato pak dëshmi gjuhësore e bëjnë të mundur lidhjen e fijeve të këputura nëpër shekuj dhe vendosjen e marrëdhënieve farefisnore midis këtyre dy gjendjeve etniko-gjuhësore. Marrëdhëniet e shqipes me ilirishten besoj se mund të vështrohen në tre rrafsh kryesore: Në rrafshin dialektologjik indoeuropian, në rrafshin ballkanik mesdhetar dhe në rrafshin e lidhjeve farefisnore midis dy gjuhëve, rrafsh të cilat nuk janë të ndara me thikë. Përkundrazi janë të gërshetuara e të ndërthurura njeri me tjetrin dhe ndihmojnë për të ndriçuar njeri tjetrin.

Le të flasim në rrafshin indoeuropian?

Edhe pse struktura gramatikore e ilirishtes është pothuajse e panjohur, karakteri indoeuropian i saj nuk është vënë dhe nuk vihet në dyshim në studimet serioze të kësaj fushe. Ajo ka qenë një gjuhë e veçantë në këtë familje gjuhësore. Prej saj nuk buron asnjë gjuhë tjetër moderne, përveçse, me shumë gjasë, gjuha shqipe. Duke e marrë këtë si të mirëqenë, ka më se një shekull që gjuhëtarët përpiqen të përcaktojnë vendin e saj në rrethin e gjuhëve indoeuropiane. Për vendin e saj në dy ndarjet e mëdha në gjuhë *kentum* ose perëndimore dhe në gjuhë *satem* ose lindore, studiuesit nuk kanë qenë të një mendjeje. Në gjysmën e

dytë të shekullit XIX, kur gjuhësia historike krahasuese bëri këtë ndarje në bazë të një izoglose fonetike, të trajtimit të grykoreve indoeuropiane, shqipja u përfshi në gjuhët satem, kurse për ilirishten gjuhëtarët gjermanë Karl Pauli dhe Herman Hirti hodhën tezën se ilirishtja ka qenë gjuhë kentum dhe kjo tezë u ndoq edhe nga disa studiues të tjerë dhe shërbeu dhe shërben ende, për ta ndarë shqipen nga ilirishtja dhe për ta afruar me trakishten, e cila është përcaktuar si gjuhë satem. Në këtë kuadër gjuhësor ka lindur teza e prejardhjes trake të gjuhës shqipe. Arsyetimi ishte i thjeshtë : shqipja është gjuhë satem, ilirishtja gjuhë kentum trakishtja gjuhë satem, prandaj shqipja nuk mund ta ketë burimin nga ilirishtja që, tipologjikisht është e ndryshme nga ajo, por e ka nga takishtja.

Po në shekullin XX-të?

Në shekullin XX karakteri kentum u ilirishtes u vu në dyshim dhe u kundërshtua nga shumë gjuhëtarë si N. Jokli, Francesco Ribezzo, W. Çimohovski, I. Russu etj, Së pari, me zbulimin dhe interpretimin e hetitishes në Azi të Vogël dhe të tokarishtes në Turkestanin lindor në fillim të shekullit XX, të cilat edhe pse ishin gjeografikisht gjuhë lindore, gjuhësisht rezultuan të ishin gjuhë kentum, perëndimore, vetë ndarja në gjuhë kentum dhe satem pësoi një tronditje dhe e humbi rëndësinë e mëparshme. Së dyti, në gjysmën e dytë të shekullit XX, trualli gjuhësor i ilirishtes u ridimensionua dhe u kufizua, kërkimet shkencore u përqendruan në trojet e ilirëve të jugut. Venetët dhe venetishtja që mbaheshin si pjesë e botës dhe e gjuhës ilire, duke u mbështetur kryesisht në një dëshmi të Herodotit I, 196 Ἰλίριον Ἐνετοί, rezultoi se nuk ishin të tilla dhe se i përkisnin grupit të popujve dhe gjuhëve italice. Kështu që disa shembuj që ishin marrë e analizuar nga gjuha e venetëve për të vërtetuar karakterin kentum të ilirishtes, e humbën vlerën e tyre për të përcaktuar tipologjinë gjuhësore të saj.

Për të vërtetuar karakterin kentum të ilirishtes janë sjellë si shembuj edhe emri i lashtë i lumit të Shkumbinit *Genusus* dhe emri vetiak ilir *Gentius* të cilët, sipas disa studiuesve, grykorja qiellëzore *g'* është shndërruar në velare të thjeshtë, ashtu si në gjuhët kentum. Por, siç ka vërejtur me të drejtë prof. Shaban Demiraj, Gj. B. 44, nuk mund të pohohet me siguri që *g-* nistore në këta emra ka qenë grykore palatale. Më në fund në pikëpamje teorike, në teorinë e evoluimit të gjuhëve ndarja e gjuhëve në kentum dhe satem nuk është vetëm një çështje gjenealogjike, por edhe një çështje kronologjike dhe pranohet se një gjuhë në origjinë kentum mund të evoluojë dhe të marrë tipare satem. Kjo do të thotë se edhe sikur ilirishtja të ketë qenë gjuhë kentum dhe shqipja është gjuhë satem, kjo nuk e përjashton mundësinë e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe. Shumë gjuhëtarë sot mendojnë se ilirishtja ka qenë gjuhë satem, ose një gjuhë e përzier me tipare satem dhe tipare kentum. Një albanolog i njohur polak, Vaclav Çimohovski, që është marrë me pozicionin gjuhësor të ilirishtes ballkanike, pas një analize mjaft të imtë nga ana fonologjike të lëndës gjuhësore të ilirishtes në krahasim edhe me shqipen ka arritur në përfundimin se “ilirishtja ballkanike nuk ka qenë as gjuhë satem, as gjuhë kentum; përkundrazi ajo duhet përjashtuar nga ky grupim tradicional. Ajo

formom një grup të mëvetësishëm, në të cilin renditet edhe shqipja, se dhe kjo shfaq tipare të ngjashme në sistemin e saj fonologjik.” Edhe prof. Shaban Demiraj është shprehur se mendimi që ilirishtja të ketë qenë gjuhë e tipit kentum nuk del i mbështetur. Kurse mendimi i përkundërt që ajo të ketë qenë e tipit satem gjen një farë mbështetje edhe në faktin që mesapishtja, e cila mendohet se ka qenë një dialekt ilir, mbahet me shumë gjasë si gjuhë e tipit satem”.

Në rrafshin ballkanik....

Në rrafshin ballkanik çështja shtrohet se me cilën nga gjuhët e lashta të Ballkanit mund të identifikohet shqipja e sotme, ç’ pozicion kishte ilirishtja në këtë kontekst etniko- gjuhësor? Është një përfundim logjik i pranuar gjerësisht në rrethet shkencore që nga mesi i shekullit XIX se shqipja e sotme është e lidhur gjenetikisht me njërin prej gjuhëve të lashta që janë folur të paktën që nga mijëvjeçari i parë para erës sonë në Gadishullin e Ballkanit. Nga ana tjetër, është një gjë e mirënjohur nga burime historike se në periudhën antike në këtë Gadishull fliteshin katër gjuhë kryesore: ilirishtja në perëndim, greqishtja në jug, trakishtja në lindje dhe makedonishtja në qendër, midis trakishtes, ilirishtes dhe greqishtes. Rrjedhimisht, është logjike dhe shkencore që në njërin prej këtyre gjuhëve duhet kërkuar prejardhja e gjuhës shqipe. Për arsye gjeografike, por edhe për arsye gjuhësore greqishtja nuk vjen në vështrim për prejardhjen e gjuhës shqipe. Për arsye gjeografike se trualli ku flitej e flitet greqishtja nuk përputhet me truallin gjuhësor të ilirishtes e të shqipes. Për arsye gjuhësore, sepse greqishtja dhe shqipja janë gjuhë krejt të ndryshme nga ana tipologjike gjuhësore. Po kështu edhe makedonishtja përjashtohet si mundësi për të qenë burim i gjuhës shqipe, jo vetëm sepse ajo shtrihet në lindje të Gadishullit, por edhe se makedonishtja u greqizua (u helenizua) shpejt dhe u zhduk si gjuhë e veçantë. Kështu që dy gjuhët nga të cilat ka gjasë ta ketë prejardhjen gjuha shqipe janë ilirishtja dhe trakishtja, dy gjuhë të veçanta fqinje, të cilat nuk njihen mirë, por nga ato pak burime gjuhësore që na kanë arritur prej tyre, duket se kanë pasur elemente të përbashkëta në leksik dhe në onomastikë, elemente që mund të shpjegohen qoftë nga trashëgimia e përbashkët indoeuropiane, qoftë nga kontaktet deri në përzierje fisesh në Gadishull të Ballkanit. Një nga krahinat ilire ku realizoheshin këto takime ka qenë Dardania. Me këtë mund të shpjegohen analogjitë tripalëshe midis ilirishtes, trakishtes dhe shqipes dhe përkimet e shqipes me rumanishten, pa qenë nevoja ta zhvendosësh djepin e shqiptarëve në lindje të Gadishullit të Ballkanit, pranë rumunëve, në trekëndëshin Nish-Sofje-Shkup, siç bënte Gustav Weigand dhe pasuesit e tezës së tij. Pikërisht, duke u nisur nga kjo situatë etnike e gjuhësore e Gadishullit të Ballkanit dy janë tezat kryesore që janë hedhur dhe mbrojtur nga studiuesit për prejardhjen e gjuhës shqipe, teza ilire, teza trake dhe si sintezë e këtyre dy tezave ka dalë edhe sinteza trako-ilire ose iliro-trake. Ekziston edhe një hipotezë më e vonë e mbrojtur nga akademiku bullgar Vladimir Georgiev, hipoteza dako-myze, e cila ka mbetur e izoluar e pa përkrahje. Teza më e vjetër në kohë dhe me mbështetje më të gjerë historike, gjeografike dhe etnogjuhësore është teza ilire. Ajo është hedhur që në fund të shekullit XVIII dhe ka lindur së pari në rrethin e

historianëve dhe më pas është mbështetur edhe nga gjuhëtarë, etnologë e antropologë. Historiani i njohur suedez Johann Thunman në veprën e tij *Kërkime në historinë e popujve të Evropës Lindore*, botuar në vitin 1774, pas një shqyrtimi të burimeve historike antike dhe gjendjes etnike e gjuhësore të Gadishullit të Ballkanit në periudhën antike, duke trajtuar historinë e shqiptarëve në një kontekst të gjerë ballkanik, do të arrinte në përfundimin se “Në historinë e tyre nuk kam gjetur gjurmë të ndonjë shtegtimi të mëvonshëm; gjuha e tyre na ka dhënë të tilla dëshmi për fatin e popullit që unë nuk mund të mos njoh te ky popull fqinjët e lashtë të grekëve dhe dhe të nënshtruarit e Romës së vjetër. Të dyja këto më çojnë te Ilirët”. Në mesin e shekullit XIX Georg von Hahn në veprën e tij “Studime shqiptare”, botuar në vitin 1854, duke u përpjekur t’u japë përgjigje pyetjeve të shtruarra prej tij: Kush janë shqiptarët? Rrjedhin këta prej banorëve të lashtë të vendit...apo kanë ardhur këtu në kohët historike? Midis të tjerash pohon: “ Me që shqiptarët nuk janë sllavë dhe nuk kanë lidhje farefisnie me asnjë popull të njohur dhe me që burimet e pakta nuk lajmërojnë tjetër shtegtim, përveç atij të sllavëve, atëherë duhet të pranojmë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë të vendit, që kanë qenë këtu para se të vinin sllavët.” Në një mënyrë të ngjashme me këta dijetarë shprehet nga ana gjuhësore edhe Paul Kretchmer, i cili pohon: “Mendimi që gjuha shqipe paraqet fazën më të re të ilirishtes, ose, siç shprehet më saktë Gustav Mayer, të një dialekti ilir, është në bazë të të gjithave rrethanave aq afër mendsh, sa njeriu duhej të sillte arsye shumë të rëndësishme për ta hedhur poshtë, sepse shqiptarët banojnë atje ku në kohën antike rronin popuj ilirë”. Një indoeuropianist i njohur si Vittore Pisani pohon të njëjtën gjë kur shkruan se: “Në qoftë se në Shqipëri është folur në kohën antike një gjuhë ilire, nuk shoh ndonjë arsye që popullsia e Shqipërisë ta ketë zëvendësuar këtë gjuhë me trakishten”. Gjuhëtari i njohur kroat Radoslav Katičić në Kuvendin I të studimeve ilire do të pohonte se “nuk ekziston vend tjetër truall i të cilit të jetë i lidhur më ngushtë se ky me botën e vjetër ilire në vështrimin e saj më të mirëfilltë”. Këto ishin disa konsiderata të përgjithshme parimore që përbëjnë bazën historike e gjeografike ku zë fill e mbështetet teza e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe.

Përveç këtyre ka edhe një varg argumentesh konkrete gjuhësore që i mbështesin ato. Në kushtet e mungesës së mbishkrimeve nga ilirishtja ballkanike, argumentet themelore vijnë nga fusha e onomastikës:

Së pari, janë një varg emrash vetjakë, emra fisesh, emra vendesh etj. të identifikuar tashmë si të botës ilire, të cilët ose gjejnë analogji me emra dhe fjalë të shqipes, ose që janë bërë pjesë e traditës iliro- shqiptare. Të tillë janë p.sh. emrat *Barduli*, *Bardhyl* që lidhet me fjalën *bardhë* të shqipes, nga një rrënjë i.e.* *bhrego*. *Dimal* që është shpjeguar me shqipen “dy male”, *Dardan* që është afruar me shqipen *dardhë* etj. *Dalmatia*, *Delmatia* dhe *Delminium* janë afruar me shqipen *dele*, *delmer*, lat. *Ulcinium*, greq. *Oulkinion*, shqip *ulk*, *ujk*. Këta janë disa nga barazimet më të mundshme në emra të përveçëm midis ilirishtes dhe shqipes. Por besoj se nuk është ky argumenti më i qëndrueshëm në fushë të onomastikës për lidhjet e ilirishtes me shqipen, sepse etimologjia e emrave të përveçëm është shumë

e brishtë. Argumenti më i qëndrueshëm për vazhdimësinë etniko-gjuhësore iliro-shqiptare në fushë të onomastikës është fakti se një pjesë e mirë e emrave të qyteteve, të lumenjve, të maleve etj., të dëshmuara në burimet antike e mesjetare të krahasuar me trajtat e sotme përkatëse, siç e ka vërtetuar shumë herë E. Çabej, tregojnë se ato janë zhvilluar në pajtim me rregullat e fonetikës historike të shqipes, çka tregon se ata kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse. Është për t'u vënë në dukje se E. Çabej dhe në përgjithësi studiuesit seriozë i kushtojnë rëndësi pikërisht këtij aspekti të analizës së toponimeve dhe jo etimologjive të tyre që shpesh janë të dyshimta. E rëndësishme p.sh. është që emri antik *Scodra*, i krahasuar me trajtën e sotme *Shkodër* dëshmon se ai është zhvilluar fonetikisht dhe morfologjikisht sipas natyrës së shqipes, Ky emër p. sh. në sllavishte del me trajtën *Skadar*, në italisht *Skutari*. Pra, zhvillimi nga trajta antike ilire në trajtën e sotme është specifik për shqipen. Po kështu barazimi *Isamnus* : *Ishëm* dëshmon se emri antik i këtij lumi ka qenë i theksuar në rrokjen fillestare që, sipas Hans Krahes, pranuar edhe nga gjuhëtarë të tjerë, ka qenë një tipar fonetik i ilirishtes. Një gjë e tillë vërehet edhe te barazimi *Durrachium*: *Durrës*, ashtu si edhe në mjaft fjalë të leksikut të përgjithshëm të shqipes. Khs. *emënë* : *emër*; *dimënë*: *dimër*, *gjarpënë*: *gjarpër*, nga një bazë i-e *serpono. Nga fusha e onomastikës me vlerë argumentuese, ndonëse jo pa kundërshtime, është edhe ruajtja e emrit të fisit ilir *Albanoi* dhe qytetit të tyre *Albanopolis* që shënohen në shekullin II të erës sonë në hartën botërore të Klod Ptolemeut si emër etnik i shqiptarëve dhe vendit të tyre dhe si toponim në shumë vise shqiptare Arbana, fshat afër Tiranës, Arbneshi i Krajës etj. Një fushë tjetër e rëndësishme ku shfaqen analogji mjaft të dukshme midis ilirishtes dhe shqipes është fjalëformimi. Prej kohësh ata që janë marrë studime ilire, kanë identifikuar disa prapashtesa të ilirishtes që kanë përgjegjëset e tyre edhe në shqipe. P.sh. prapashtesës ilire *-esta, -este, -ist*, që del në emra vendesh të territoreve ilire si: *Ladesta, Tergeste, Palaeste* i përgjigjet në shqip prapashtesa *-(e)sht* që del në emra që shënojnë vend si: *vnesht vresht, bresht, kopsht* etj. dhe në emra fshatrash si *Fishtë, Ashtë* etj. Po kështu prapashtesës ilire *-atae, -atesme* të cilat formoheshin në ilirishte emra banorësh të fiseve ilire si *Dalmatae, Dokleatae, Labeates* i përgjigjet në shqip prapashtesa *-at*, që shërben për të formuar emra fshatrash si *Progonat, Filat, Bushat, Dukat, Luzat* etj. dhe emra fisesh e vëllezërish si: *Rushat, Zekat, Demat* etj. (Një paraqitje sintetike të analogjive ilire-shqipe në fushën e fjalëformimit ka dhënë prof. Mahir Domi në kumtesën e tij të mbajtur në Kuvendin I të studimeve ilire, Tiranë 1972).

A ka marrëdhënie midis shqipes dhe dy gjuhëve klasike me greqishten e vjetër dhe me latinishten?

Dëshmi e rëndësishme për prejardhjen ilire të shqipes dhe për autoktoninë e shqiptarëve në trojet e tyre sjellin pa dyshim marrëdhëniet shqipes me dy gjuhët klasike me greqishten e vjetër dhe me latinishten. Huazimet nga greqishtja në gjuhën shqipe pasqyrojnë të gjitha etapat e zhvillimeve gjuhësore të greqishtes; të greqishtes së vjetër, të greqishtes së mesme dhe të greqishtes së re. Studimet

etimologjike të E. Çabejt sjellin të dhëna të reja për numrin e huazimeve nga greqishtja e vjetër, për trajtat dorike të disave prej tyre. Numri i huazimeve nga greqishtja e vjetër rezulton të jetë më i madh nga ç' mendonte Albert Thumb-i në fillim të shekullit XX. Trajta dorike gjenden edhe më emrat e përveçëm të mbishkrimeve greke të Durrachium-it. Sa për të dhënë ndonjë shembull nga këto mbishkrime përmendim emrin vetjak *Eirana* në vend të trajtës *Eirene* "paqe". Huazimet nga greqishtja e vjetër nga sfera e bimëve të kuzhinës, e pemëve frytore dhe a veglave të punës si: *malon: mollë, lachanon: lakër, prason: presh, kokymelon kumbull, kerala: qersh, drapanon: draper* etj, dëshmojnë se ato janë përfutur në kushte kontakti të drejtpërdrejtë me grekët. Zhvillimet fonetike që vërehen nga krahasimi i trajtave të fjalëve burimore greke me trajtat shqipe vërtetojnë se janë huazime të vjetra, prandaj kanë pësuar ndryshime fonetike që janë karakteristike edhe për fondin e leksikut të trashëguar: khs *malon: mollë*, me shndërrim të *a-së* së gjatë me *o* etj. Kështu ndodh edhe me huazimet latine të tipt *pomum: pemë, hora: herë* etj. Huazimet e shumta latine në shqipe shtresat e ndryshme kronologjike, leksiku i terminologjisë së krishterë, emrat paleokristianë të tipt *Shënpal, Shëngjon, Shëngjin Shënmëri*, që dëshmojnë për depërtimin e hershëm të besimit të krishterë te iliro-arbërit dhe paraqesin lashtësinë dhe shtrirjen në kohë dhe tërë kompleksin e marrëdhënieve historike e kulturore të iliro-shqiptarëve me botën latino-romane. Të gjitha këto flasin për një fqinjësi të hershme të ilirëve me grekët dhe me romakët. Duke ndjekur kronologjinë e depërtimit të elementeve leksikore të huaja në gjuhën shqipe, rezulton se shumë huazime greke e latine në shqipen e sotme i janë transmetuar shqipes përmes ilirishtes, pra kanë depërtuar në ilirishte që në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të parë të erës sonë dhe prej ilirishtes i janë përcjellë arbërishtes dhe shqipes. Shaban Demiraj në botimin e tij *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, kur trajton elementet e huaja në gjuhën shqipe ka dalluar nga pikëpamja kronologjike dy kategori kryesore: elemente të huaja që shqipja i ka trashëguar nga "nëna" e saj ilirishtja dhe huazime të vetë shqipes nga kontaktet e drejtpërdrejta të saj me gjuhë të tjera. Sipas tij, kufiri kronologjik që ndan ilirishten nga shqipja mund të vendoset aty nga shekulli VI kur shqipja ishte formuar si gjuhë e veçantë e dalë nga ilirishtja.

Cili është mendimi i Milan von Sufflay?

Studimi i thelluar i zhvillimeve fonetike dhe semantike të lashta të trashëguara nga ilirishtja duke krahasuar trajtat burimore nga gjuhët përkatëse me reflekset e tyre në shqipen e sotme, mënyra se si janë përshtatur ato në gjuhën marrëse mund të hedhë dritë mbi tipare të ilirishtes dhe të shqipes mesjetare dhe mbi marrëdhëniet në mes tyre. Me të drejt një historian i mirënjohur dhe i shquar i historisë shqiptare dhe ballkanike si Milan von Sufflay pati pohuar se edhe sikur të mos kishte njoftime historike, siç është ai i Ptolemeut për fisin Albanoi, vetë gjurmët e ndikimit gjuhësor të latinishtes në gjuhën shqipe do të mjaftonin për t'i vendosur vendbanimet e shqiptarëve mu në brigjet e Adriatikut. Duke përfunduar do të thosha se historia e ilirëve dhe e ilirishtes është pjesë e pandarë e prehistorisë dhe e historisë së lashtë popullit shqiptar dhe e gjuhës shqipe. Nëse do të bënim një

periodizim dhe emërtim me terma etnikë të gjendjes gjuhësore të trevave iliro-shqiptare nga lashtësia deri në ditët tona, do të dallonim tri ndarje të mëdha si vijim të njëra tjetrës: *ilirishtja* që nga lashtësia deri në shekujt VI-VII të erës sonë, kur Ilirët nuk shfaqen më në burimet historike dhe gjuha e tyre kaloi në shkallë të re evoluimi. *Arbërishtja* nga shekujt VII-VIII të erës sonë deri në shekullin XV kur kemi dëshminë e parë të shkruar në gjuhën shqipe dhe *shqipja* nga shekulli XVI kur shfaqet për herë të parë fjala shqip në “Mesharin e Gjon Buzukut (1555). Nga këto tri periudha kjo e fundit është sigurisht periudha më e njohur e gjuhës shqipe, periudha e funksionimit të saj si gjuhë e folur dhe si gjuhë e shkruar. Periudha e dytë, *arbërishtja* ose shqipja mesjetare ka si pikëmbërritje gjuhën e “Mesharit” të Gjon Buzukut nëpërmjet së cilës mund të hidhet dritë mbi fazat parashkimore. Më e panjohura është, pa dyshim, periudha e parë, ilirishtja, ose shqipja e lashtësisë, që disa studiues e quajnë protoshqipe. Për ndriçimin e saj mbetet shumë punë për të bërë. Ndoshta më shumë vëmendje u duhet kushtuar mbishkrimeve mesape, si të vetmet mbishkrime nga ilirishtja e Italisë dhe marrëdhënieve të hershme të shqiptarëve dhe të shqipes me botën greko-romake

QEMAL MURATI

BALLKANI NË NOFKA E LLAGAPE

Popujt e Ballkanit kanë krijuar për njëri-tjetrin një emërtesë të tërë me semantikë pezhorative, mbi baza etnokulturore, rajonale, racore, fetare, etj. “Turlitava gjuhësore” ballkanike përmes ofiqeve e nofkave na flet qartë dhe për vetë psikologjinë dhe “etnografinë e të folurit” të atyre popujve, për urrejtjen dhe smirën që kanë krijuar ndër shekuj dhe ruajnë ende në raportet e ndërsjella të tyre. Si shprehje e një arkaizmi provincial, ballkanasit kanë krijuar gjithë atë mal nofkash në gjuhët e tyre, ku në Ballkan njerëzit dhe grupet e njerëzve ende shikohen përmes stereotipave.

I. Të bashkëjetosh me tjetrin përmes nofkash

Egzonimet – emrat tek një popull ose grup social, me të cilët i referohen një populli tjetër ose grupi social, kryesisht që kanë në fqinjësi të drejtpërdrejtë, për identifikim, përkatësisht për diferencimin e tyre, me pezhorizim semantik, janë një dukuri mjaft e shpeshtë dhe interesante sidomos në etnografinë e të shprehurit të popujt e Ballkanit.

Si të tilla, *ofiqet a nofkat* – emri i dytë që i vihet dikujt për tallje, për shaka e përkëdhelje, duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a nga ndonjë tipar dallues – paraqesin një kategori të posaçme socialinguistike që meritojnë kujdes të studiohen. Mendjet primitive dhe provinciale kanë krijuar shprehjet më fyese për tjetrin, qoftë brenda grupeve të komunitetit të tyre e qoftë për popuj të tjerë, grupet fetare etj., me cilësime nga më të ndryshmet.

Në hapësirat ballkanike hasim një numër jo të pakët egzonimesh, formuar me anë të nofkave, që u jepen grupeve të ndryshme sociale, me kuptim përçmimi, si: *çoban, torbesh, cincar, pomak, shka/shja, shkavell, shkinulkë, xhyp, xhypkë, maxhosk*, etj. Kjo dukuri e karakterit sociolinguistik në Gadishullin e Ballkanit, një territor ku kanë bashkëjetuar shumë popuj të ndryshëm e janë pleksur e sinkretizuar gjuhët e kulturat e tyre, parqet interes të posaçëm për ta vëzhguar në një pamje sa më të plotë.

Emërtimet a cilësimet me anë të nofkave tek një grup social ndaj një tjetri janë me bollëk në këto hapësira ballkanike, e sidomos në truallin e Maqedonisë, formuar mbi baza historike, gjeografike, linguistike, ose elementeve të ndryshme konfesionale. Ndonjëherë ato reflektojnë dhe disa nga veçantitë dhe karakteristikat të vetë etnosit, grupit ose bashkësisë shoqërore. Fqinjët, si egzonim për identifikim të posaçëm etnik të komshiut të parë, shpeshherë përdorin fjalë që pak a shumë kanë karakter pezhorativ, fytes, qesharak. Kësisoj, në hapësirat e Maqedonisë

përdoren egzonimet: *Torbeshët, Apovcët, Kurkët, Shopët, Torlacët, Çitakët, Ullufët, Keckarët, Shkretët*. Karakteristike është kuptimi i etnonimit/egzonimit të emrit *Shop*. Kur përdoret sot emri “*Shopët*”, kjo bëhet me qëllim që të identifikohen dofarë “malësorësh”, “barinjsh”, “njerëz të thjeshtë”, pra në aspekt pezhorativ (Mirčevska 2007: 160).

Cilësime të tilla dalluese bëhen edhe përbrenda të njëjtit komunitet etnik, kur njëri grup e ngre veten mbi tjetrin. Kështu, serbët e Vojvodinës e quajnë veten *Serbi*, por i cilësojnë si *Serbijanci* bashkëkombësit e tyre në Jug të Savës dhe Danubit, duke i shikuar si nga lart (Lory 2007: 211).

Ndërkaq, te shqiptarët jo rrallë përdoret cilësimi *shqiptar* për të emëruar një njeri të trashë, që s’merri vesh: *O shqiptar!*

Në një mënyrë plastike ja si e karakterizon *gjuhën e urrejtjes* në hapësirat ballkanike intelektuali dhe publicisti Agim Isaku:

“Tashmë nuk është e re të përsëritet që rajoni ynë posaçërisht ka vuajtur nga paragjykimet e pafundme për njëri-tjetrin. Një gjuhë urrejtje lëvri ndaç në tekstet që përbëjnë fundamentet e kulturave nacionale, ndaç në librat shkollorë. Stereotipat gjallërohen thujse anekdoteskë. Sipas tyre, *turku është vetëm i prapambetur. Greku vetëm i pabesë dhe hılanjuz. Serbi gjakatar. Bullgari dhe maqedonasi* (që mendësia popullore nuk i ndan dot) *kokëmushka. Shqiptari "bari e burekxhi"...*Kjo "marria" e të vetëdistancuarit përmes klasifikimeve të të tjerëve si të padenjë dhe inferiorë, delegimi i problemeve të brendshme në "oborr të fqinjit", nuk janë as më shumë e as më pak, por një provë direkte e paaftësisë sonë për të bashkëjetuar me të ndryshmin, për të ndarë me të vlera. E, shoqëria ku ne pretendojmë se kemi hyrë, ndryshe konsiderohet edhe shoqëri e ndarjes së vlerave” (*Gazeta Shqip*, 30. 9. 2009).

Shprehje që qarkullonin mes shqiptarëve dhe te popujt fqinjë për shqiptarët

Këtu më poshtë do të marrim në vështrim disa prej nofkave, që popujt fqinjë i kanë dhënë njëri-tjetrit, me një tipologji të gjerë të emërtimit.

Shqiptar - vetë emri i sotëm etnik *shqiptar*, i cili zëvendësoi atë *Arban/Arbër*, në zanafillë duhet të jetë përdorur me kuptim peshorativ nga të tjerët, që më vonë e humbi këtë kuptim dhe u përgjithësua për gjithë popullin.

Tek emri i sotëm shqiptar sigurisht kemi të bëjmë me ndonjë ofiq a nofkë që na e dhanë të huajt, përdorur së pari si emër familjeje. Motivimi i këtij emri me kohë ka marrë e është zvetënuar, është demotivuar, kështu që sot ka humbur kuptimi i primitivit. Por një gjë këtu mund të zbërthehet, që fjala “*shqiptar*” në gojën e të huajve kishte një kuptim tepër fyes, siç del të dëshmohet kjo dhe në një dokument arkivor në vitin 1461 në Fano të Italisë qendrore, ku sipas atij teksti një zonjë padit dikë që ka fyer shërbyesën e saj si “*shqiptare*” (Duceiller 1996: 87).

Edhe për popujt e tjerë emrat e tyre nacionalë kanë kryesisht kuptime

keqësuese apo cilësime të vetive të tyre, khs. këtu p.sh. dhe termin *Shule* për minoritetin etnik sllav në Shqipëri (sajuar nga një leksemë e sll. vj. *sělě* “shërbëtor”), pastaj *Çoban*, *Çobenj* për arumunët në Shqipëri; *Taushan* – turqit kështu i thërrasin grekët e ujdhesave të arkipelagut, për shkak se janë të shpejtë dhe të lëvizshëm si lepujt (Polenaković 2007: 182), etj.

Si përfundim, emri *shqiptar* nuk mund të barazohet me “ai që kupton, ashtu sikurse edhe emri *sllav*, *slovenin* që nuk mund të lidhet me *slovo* ”fjalë”, “ai që flet e kupton”. Ky i fundit *Slaven*, bashkë me rrjedhojat *Slavan*, *Slavjan*, *Slavin*, *Sloven*, *Slovin*, *Slovak* në thelb ka karakter gjeografik të vendit *Slave*, *Slavisko* në Sarmati e në Dnjepër, prej nga u shkulën dhe u derdhën në Gadishullin Ballkanik. Ky emër, pra nuk shkon me *slave* (*gloria*), siç është menduar dikur, apo *slova* (*logos*), sikundër mund të mendojë sot dikush (J. Dragashević, *Makedonski sloveni* 16). Karakter të këtillë gjeografik ka edhe emri i sotëm nacional *serb*, që reflekton në thelb edhe topikun *Sarbske* në bregun e Detit Baltik dhe pranë liqenit *Sarbskesche See*, prej nga janë të ardhur në truallin ilirik (J. Dragašević, *Makedonski sloveni* 24). Kur u shpërngulën prej atdheut të tyre të parë për në Ballkan, sllavët morën me vete si kujtim edhe emrat e vendeve që i braktisën dhe i shartuan ato në truallin e ri ilirik.

Shqiptarët veten e tyre e quajnë *shqiptar* (dial. *shyptar*), kurse te popujt fqinjë njihen si *Arbanasi/Albanci* (te sllavët), *Albanais* te francezët, *Albanischen* te gjermanët, *Arvanitis* (te grekët), *Arnauti* (te turqit), *Çibanho* (te romët), *Šiptari*, *Šiftari* (te serbët e maqedonasit), *Gatikari* (te torbeshët). Por fjala *shiptar* në gojën e maqedonasve apo serbëve ka një konotacion fyes, pezhorativ, pra përdoret gjithmonë në perceptim negativ. ‘*Šiptari*’ - emërtimi fyes i serbëve për shqiptarët ishte më shumë profesion se përkatësi etnike, sepse ‘shiptari’ bartte dru e qymyr... Edhe te gjermanët ekziston emërtimi *polak* (për polakët), në një version fyes në gjuhën gjermane.

Popujt me të cilët kanë bashkëjetuar e kanë qenë në kontakt shqiptarët gjatë epokave e mijëvjeçarëve të ndryshëm: grekët, turqit, bullgarët, serbët, maqedonasit, vllëhtë, italianët, francezët, anglezët, gjermanët, amerikanët etj., kanë krijuar shprehje të ndryshme proverbiale për t’i cilësuar e kategorizuar ata, kryesisht në kontekstin negativ. Këtu më poshtë do të sjellim disa prej atyre shprehjeve proverbiale me të cilat janë tipizuar shqiptarët, si:

Arnaut ose *Šiptar* – në vitet 60 të shek. 20 te serbët në Beograd këto emërtime janë përdorur si sinonime për “sharrëxhinj” të druve (sh. *Simpozium o srednjovekovnom katunu*, Sarajevo, 1963, 52).

Albanska – atribut përdorur në zhargonin e kroatishes me ironi, si cilësim negativ për diçka që është e pavlerë, e prapambetur: */to ti je albanska tehnologija/* (*Hrvatski enciklopedijski rječnik*, Zagreb, 2003).

Bilit, pl. *Bilits* ‘rrethprerë’ – ofiq për turqit, shqiptarët dhe mysimanët e tjerë të bërë synet: *omlu-i di bilitslji* = njeri rrethprerë, i bërë synet (Cuvata 2006: 103).

Ghusmāpingā, pl. *Ghusmāpinganji* – ‘gjysmopingë’, nofke që arumunët ua jepnin shqiptarëve: *Arbineslu-i ghusmāpingā* = shqiptari është gjysmopingë (Cuvata 2006, 266).

Ljeap, pl. *ljepanji* – ‘lakmues/ kusar shqiptar’ (Cuvata 2006: 316). Sigurisht arumunët e lidhin me shqiptarët e Jugut – *labët*.

Cap di Ghegan = *kokë shqiptari* “kokëfortë” (Cuvata 2006, 117). Khs. këtu dhe *Cap di Iuruc* = kokë juruku, kokë inati (Cuvata 2006: 117).

Belokapec – ‘prekar za šiptar’, që e sjell Fjalori i gjuhës maqedonase (RMJ I 1979: 30) – nofke për ‘shqiptar’, sipas asaj se shqiptarët mbanin kësulë të bardhë.

Belokapovski (Shkup). Mbiemër familjar që përdoret si ofiq bashkë dhe me format *Belokapa* (Manastir) e *Belokapovska* (Shkup), nga *belo kapa* “kësulë e bardhë”, me kuptim të figurshëm përbuzës për shqiptarin, i cili mban kësulë të bardhë.

Arnaud`i unud, turq. – shqiptari kokëfortë.

Arnautligi tuttu, turq. flet ose vepron siç bën zakonisht një shqiptar. E ka një dell temperamentin shqiptar. E ka në gjak natyrën e shqiptarit.

Arnautska čuška, bullg. – inatçor, njeri i mallkuar. *Gledaš go taka čovek kato čovek, no dokaži li se, razbiraš kakva arnautka čuška e* (*Malëk frazeologičen rečnik na bëlgarski ezik*, Veliko Terno, 1998).

Arnautin, fig. bullg. këmbëngulës, njeri punëtor. *Too sin-ti kak zarabote alis Arnautin, na-mojš do smiriš* (Kukush) (Peev 1999).

Arnautče zane drugo patče – shqiptari di tjetër rrugë (Makedonski narodnik poslovice, Skopje 1991).

Në fjalorin frazeologjik të gjuhës bullgare hasim këto etnofrazeologjizma për shqiptarin:

Арбанайко стухъо dial. 1. i fryrë, i panështruar, i papërkultur, 2. njeri i papërshtatshëm, hairsëz (Ничева 1974: 82).

Арнаутска пиперка – shumë i fryrë, njeri shpirtlig. *Жена ту е една арнаутска пиперка, никога не тожеш да се разбереш с неја* (Ничева 1974: 82).

Арнаутска чушка sh. Арнаутска пиперка (Ничева 1974, 82).

Far albanese, it. – të hiqesh si shqiptar, shtiresh si shqiptar.

Fier comme une Albanais – krenar si një shqiptar (Murati 2001).

Shkreta - në një lagje të quajtur Durtlllok të Gostivarit, të populluar kryesisht me rekalinj ortodoksë nga të kësaj krahine, maqedonasit atyre u thonë si me përbuzje *Shkreta/ Shkreti: Kaj si bre škreta*, me cilësimin pezhorativ “shqiptarë të shkretë, që kanë ardhur nga një krahinë e shkretë, njerëz viranë”.

II. Egzonime te shqiptarët për shqiptarët si shprehje e “racizmit kulturor krahinarist”

Edhe vetë shqiptarët përdorin një varg nofkash për pjesëtarin tjetër të këtij komuniteti mbi baza të ndryshme krahinore, fetare, kulturore, qytetare, fshatare, etj.

Racizmi ynë si popull as nuk fillon e as mbaron me jevgjit. Ne kemi shpikur termin "*çeçen*" për gjysmën e popullsisë. Ne i quajmë "*skocezë*", me ironi ata që vijnë nga Skrapari. Ne i quajmë me përbuzje "*turq*" myslimanët e Shkodrës, dhe themi "*grekët e ****t*" për saradiotët. Ne, tropojanëve u themi ligësisht "*malokë*". Në 97'n në jug të bënin provën e gjuhës së "malokut": po ta shqiptojë "*xhashtë*" në vend të *gjashtë*, mund të haje plumbin. Sepse, urrejtja ndaj një personi ishte shndërruar në racizëm ndaj krahinës prej nga vinte (Koloreto Cukali, *Racës sime*, Gazeta Shekulli, 13. 3. 2011).

a) Mbi baza të tjera krahinore e dialektore:

Bac – përdorur nga shqiptarët e Maqedonisë për bashkëkombësit e tyre të Kosovës, mbi bazën e asaj se në Kosovë përdoret shumë kjo fjalë në shenjë respekti për persona më të moshuar.

Loçkë – nofkë për shqiptarët e Kosovës që ua japin shqiptarët e Maqedonisë, për shkak se ata e përdorin shpesh fjalën *loçkë*.

Majucka f. zharg. plisi me majë i kosovarëve, në formë të konit. 2. ffig. kosovari që mban këtë plis. Struganët që shkonin të punonin në Kosovë, thoshin: *kur dë shkojmë te majuckat? Erdhi vakti të shkojmë te majuckat* (Zag.).

Edhe në fjalorin e të folmes së Shlegovës përdoret: *Ljoçki* – Albanci, dhe *Prki* – Albanci, nga përç “cjav” (*Prkite matet tegavo od vrekani* – Albancite jadat meso od kozi, I. Filipovski – I. Kitanovski, Šlegovski ot taen (fornički) govor, “Makedonistika”, 3, Skopje, 1983).

Puiçi, puçat – nofkë për tetovarët nga ana e kërçovarëve, sepse kështu thirret atje vëllai më i madh nga vëllai dhe motra më e vogël.

Specat – përdoruar për tetovarët nga shqiptarët e Kosovës me cilësimin “njerëz të paditur, që merren vetëm me kultivimin e specave”.

Datet – kështu i quajnë shqiptarët e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës ata të rrethinës së Zajazit, për arsye se këta të fundit në fjalorin e tyre përdorin shpesh cilësimin *dat-e* për vëllanë e madh. *Date Lush. Date Zeno*.

Lap – për shqiptarët në veri të Çamërisë, përdorur me kuptim keqësues “i prapambetur, që nuk është i mirë si çamët” (Prevezë, Çamëri).

Kusiçka - në bashkëbisedimin e përditshëm kur dikush të pyet -Prej nga je? Dhe ti i përgjigjesh nga Devolli, më të mëdhenjtë ta kthejnë: -Oh , ti je nga *kusiçka, tepsicëka*, apo je pe Devolli, disi me humor e për shaka, për shkak se e

folura dialektore e Devollit, në dallimin nga gjuha letrare përdor mbaresat zvogëluese: *tepsičkë* (për tepsi), *kusičkë* (kusi); *deričkë* (derë) (Luan Klana).

Xhipolka – përdorur për korçarët nga ana e pogradecarëve: *Xhipolka pre (pe) Korçe!* – “dorështrënguar, koprrac, shpirtngushtë”.

Studiuesi Mustafa Ibrahimimi (Ibrahimimi 2008: 236) ka vënë re se pothuajse të gjitha fshatrat e Prilepit dhe Krushevës kanë emërtime fyese ndërmjet veti. Kështu, banorët e fshatit Alldançe emërtohen *laknaxhi*; banorët e fshatit Debresh “*pomak*” dhe “*torbesh*”; ata të Nerovës “*babajkovci*”. Banorët e fshatit Cërnilishtë nga desovarët quhen “*d’buçallës*” (sipas topikut Buçallë në Cërnilishtë), kurse cërnilishtasit ua kthejnë “*d’gollanës*” (sipas topikut Gollanë në Desovë). Banorët e Cërnilishtës nga debreshtasit quhen “*gërk*” (sepse nuk i kuptojnë kur flasin shqip), kurse cërnilishtasit ua kthejnë “*bugar*” (sepse flasin maqedonisht).

b) Mbi bazë etnokulturore e rajonale:

Capallar – ofiq me të cilin banorët e qytetit të Gostivarit përbuzin ata të malësisë (krahasimi me *cap, cjav*).

Lalë – emër i lashtë i banorëve të Myzeqesë, me të cilin thërrisnin me përbuzje fshatarin e varfër të kësaj krahine (FGJSSH).

Lugu i defave – kështu janë quajtur fshatrat e Lugut të Drinit, Lugut të Baranit e Lugut të Leshanit, që e përdornin defin e gabelicat në odën e burrave, nga ana e rajonit të Drenicës.

Malok, katundar, shpellar, etj. – përdorur kryesisht në Shqipëri për ta cilësuar dikë tjetër si të paditur dhe të paqytetëruar.

Edhe në regjionin e Shkupit, përpos ndasive sipas lagjeve, shqiptarët shkupjanë mbase si çdo kund në këtë pjesë të botës, ndahen edhe në “*zorraxhinj*” dhe “*katunarë*” (Mehmeti 2011: 230).

Malok – emër me të cilin e quajnë veten shqiptarët malësorë të Veriut. Në vitin 1376 është përdorur në Ulqin si emër familjar *Lazarus Malliocus*, noter qyteti. Kjo fjalë sot përdoret si llogar përbuzës dhe për gegët e Beratit, që do të thotë “i marrë” (Shufflay 1968: 31, Meyer 2007: 300).

Bugart e Rahovecit – kështu i quajnë banorët e rrethinës së Rahovecit ata të qytetit të Rahovecit, ngaqë flasin një shqipe të përzier me elemente të bullgarishtes. P.sh. vajzës i thonë *çora. Jam flladit* e përdorin me kuptimin “jam ftohur”.

Lunga – rahovecjanët e qytetit kështu i quajnë banorët e rrethinave të Rahovecit, me kuptim fyes a përçmues: *Ajde be, lungo eden*.

Jahudi – 1. Njeri shumë i zoti, që punon shumë. 2. Vetjak.

Çitakë-t – kështu quhen banorët e Drogomishtit të Madh të Kërçovës, të cilët kanë folur deri vonë maqedonisht, nga ana e atyre të Zajazit, ofiq nga arum. *citak* (çitak) “njeri i poshtër, tinzar, faqezi, i pandershëm” (Cuvata 2006: 167).

Ndërkaq, *Drogomishti i Madh* është quajtur ndryshe dhe “*Drogomishti pa lā*” (që nuk janë larë, të papastër, kur kanë qenë të konfesionit të krishterë), për ta dalluar nga *Drogomishti i Vogël* (“*Drogomishti i la*”, *i larë, i pastër*).

Çitaket përdoret dhe si ofiq familjar në Opajë të Kumanovës, kurse në Kosovë si vendbanim *Çitak* në Drenicë dhe mbiemër familjar *Çitaku*.

Çitak mb. Njeri koprrac dhe dorështrënguar. *A çitaki qe isha ti bre! Çitejk* fem. e *Çitak* (Gjakovë).

Çifut - fjalë e përmendur prej turqve anadollakë për hebrejtë, e cila te ky popull merret si fyerje. Në shqipen kjo fjalë përdoret me disa kuptime: 1. hebre “Çifutët në Shqipëri”, 2. fig. njeri i zgjuar, koprrac.

Kromidarët – kështu janë quajtur banorët e Drogomishtit të Vogël nga vendbanimet fqinje të Kërçovës, mbase për shkak se do të kenë mbjellë më së shumti qepë.

Gabel – shprehje mospërfillësi për dikë, me cilësimin “maxhup” (Kosovë, Plavë e Guci).

Gabelicë - shprehje mospërfillësi për dikë, me cilësimin “maxhupë” (Kosovë, Plavë e Guci).

Shkinulkë – me kuptim keqësues (Kosovë).

Fanë – për shqiptarin katolik malësor. *Ah Fana, ajo. Ah Fana i thiu, Mar Fânë!* (Gjakovë, Prizren).

Fonece – grua katolike. *Fonecja e shtrâmt!* (Gjakovë).

Laraman – personi katolik i konvertuar në fenë myslimane, që i mban të dy fetë.

Xhup - shprehje mospërfillësi për dikë, me cilësimin “maxhup” (Kërçovë).

Batallet – emër familjeje në Tuhin të Kërçovës. Nga turq. *batall* “i trashë, i ngathët, që nuk hyn në punë”.

Katunar – ky cilësim përdoret sidomos në Gjakovë, si një tipar dallues ndërmjet “qytetarit” (njeriut të kulturuar) dhe “katunarit” (njeriut të pakulturuar). Në qytetin e Gjakovës “qytetarët” përdorin madje një cilësim kaq të rëndë: *Katunarin 100 vjet zije n’sherbet, katunar se katunar. Apo hajde t’lujna shqiptarët me katunarët*. Në Gjakovë dhe në Prizren “qytetarët” madje kanë folur dhe turqisht vetëm për të mos u identifikuar me “katunarët”.

Sipas kategorive sociale, edhe për të emërtuar vllhtë bëhet një distinkcion i tillë: *cincar* (për urbano vllhtë, që janë marrë me zanate të ndryshme në qytet), dhe *aromân* (për vllhtë nomadë, çobenjtë, që kanë pasur ngulime të përkohshme baritore).

Mbi bazën e ofiqeve në Gjakovë janë formuar shumë emra familjesh, si: *Pula, Knusi* (nga emra shpezësh), etj.

d) Nofka me bazë fetare:

Në Pogradec, popullsia shqiptare ortodokse i quan myslimanët *Skurë: Ik ore Skurë!*, kurse ajo myslimane ortodoksët *kaur: Kauri derit!*

Llatin – i pafë, që ka devijuar nga feja (Tetovë.).

Kaurr – 1. maqedonas. 2. i pafë (Strugë, Gostivar). Në çamërishten *kaurr* është sinonim i fjalës “kristian” (Prevezë).

dh) Nofka të tjera

Dylbera - fig. homoseksual, mashkulli që me bukurinë e tij josh meshkujt e tjerë, në kuptimin e sotëm modern *gay*.

Bythç, bythaxhi – homoseksual (Lugu i Baranit).

dh) Në frazeologji

Edhe në lëmin e frazeologjisë ndeshim po kështu shumë cilësime fyese që shqiptarët përdorin për bashkëkombësit e tyre të një krahine fqinje:

Burrë Dibre – shprehje që e përdor Struga me cilësimin “burrë me tipare të këqija”.

Mik Gostivari – “mik jo i mirë” (kështu shprehen në anë të Kërçovës).

Magjar (gomar) Struge – kur e shajmë dikë (Kërçovë).

Pezhorativat dhe nofkat etnike në arealin e Kosovës

Fjalësi i të folmeve të Kosovës është i pasur dhe me pezhorativa e nofka etnike, që shqiptarët kanë krijuar për romët, serbët, turqit etj., ashtu sikurse dhe këta që kanë krijuar për shqiptarët. Por nuk mungojnë dhe nofkat që ka krijuar popullata e Kosovës për të cilësuar dikë me tipare të këqija sipas krahinave të ndryshme.

a) Cilësime mbi baza etnike

Romët për shqiptarët janë: *gabelë, arixhinj, jevgj, ciganë* (në Shqipëri), *gabelë, maxhupë* (në Kosovë), *xhyphsh* (në Maqedoni). Nga shprehjet e tilla, në fjalor kemi evidentuar:

Gabel - shprehje mospërfillësi për dikë, me cilësimin “maxhup”.

Gabel - maxhup, i zi, i fëlliqur (Pet.).

Gabelic - Shprehje mospërfillësi për dikë, me cilësimin “maxhup”.

Gabelisht ndajf. - flas keq, si në gjuhën e gabelëve. *Po flet si me fol gabelisht. 2. Ti e meriton ni shupla:k gabelisht* (RGjak.).

Gabelisht ndajf. - punë jo e mbarë; punë e ndytë moralisht. *Po flet fja:l gabelisht* - po flet fjalë të ndyta, të pamoralshme; *gabelisht, euf.* për aktin seksual midis partnerëve (burrë-grua) (Deç.).

Maxhup - shprehje mospërfillësi për dikë.

Për shqiptarët e Kosovës serbët janë cilësuar:

Gëxh - shprehje keqësuese për serbët e Serbisë jugore, të Shumadisë.

Shkau i Velikës - malazez, të quajtur kështu sipas vendit Velika në Mal të Zi.

Shka i Gorozhdecit - shka i keq. Gorozhdecit fshat i rrethinës së Pejës i banuar me malazias.

Raje -t - kështu quhen serbët e vendit në Kosovë, vendallinj, për t'i dalluar nga kolonistët, ardhacakët.

Shkinülk - me kuptim keqësues.

b) Cilësime mbi baza dialekt-gjeografike

Bugart e Rahovecit - kështu i quajnë banorët e rrethinës së Rahovecit ata të qytetit të Rahovecit, ngaqë flasin një shqipe të përzier me elemente të bullgarishtes. P.sh. vajzës i thonë *çora*. *Jam flladit* e përdorin me kuptimin “jam ftohur”.

Lunga - rahovecjanët e qytetit kështu i quajnë banorët e rrethinave të Rahovecit, me kuptim fyes a përçmues: *Ajde be, lungo eden*.

Lupovac – kështu i quajnë serbët qytetarët jo serbë të Rahovecit, me kuptimin “i prapambetur, i paditur”.

c) Emërtime dhe cilësime mbi baza fetare:

Fân - për shqiptarin katolik malësor. *Ah Fana, ajo. Ah Fana i thiut, Mar Fânë!* (Gjak., Pz.).

Fonece - grua katolike. *Fonecja e shtrâmt!* (Gjak.).

Laraman - personi katolik i konvertuar në fenë myslimane, që i mban të dy fetë.

ç) Cilësime mbi baza sociale

Katunar - cilësim që përdoret sidomos në Gjakovë, si një tipar dallues ndërmjet “qytetari” (njeriut të kulturuar) dhe “katunari” (njeriut të pakulturuar). Në qytetin e Gjakovës “qytetarët” përdorin madje një cilësim të tillë: *Katunarin 100 vjet zije n'sherbet, katunar se katunar*. Apo *hajde t'lujna shqiptarët me katunarët*. Në Gjakovë dhe në Prizren “qytetarët” madje kanë folur dhe turqisht vetëm për të mos u identifikuar me “katunarët”. Sipas kategorive sociale, edhe për të emërtuar vllëhtë bëhet një distinkcion i tillë: *cincar* (për *urbano vllëhtë*, që janë marrë me zanate të ndryshme në qytet), dhe *aromân* (për *vllëhtë nomadë, çobenjtë*, që kanë pasur ngulime të përkohshme baritore).

III. Paralele ballkanike tek emrat e familjeve mbi bazë nofkash dhe llagapesh

Shumë emra të përveçëm të familjeve kanë qenë në fillim nofka dhe llagape, përmes individualizimit të ndonjë tipari keqësues (afektiv) të bartësve të tyre a të kryefamiljarëve. Kësisoj, në vise të Kosovës hasim emra familjesh me cilësime të tilla, si:

Baçi “bari”
Gomari “gomar”
Pela “pelë”
Knusi “këndues, gjel”
Pula “pulë” (*Ymer Pula*),
Zogu, Zogaj “zog”
Qorra
Bajraktari,
Gexha, etj.

Edhe në fjalorin antroponimik dhe patronimik maqedonas hasim një numër të madh emrash vetjakë dhe mbiemrash familjarë me burim nga shqipja, si rezultat i procesit të asimilimit të elementit shqiptar në atë sllavomaqedonas në rrymë të moteve.

Emrat e tillë personale dhe familjarë u përkasin sferave të ndryshme të leksikut të shqipes të periodes mesjetare, sidomos *leksikut përçmues (ofiqeve)*:

Belokapovski/Belokapovska (nga *belo kapa* “kësulë e bardhë”, me kuptim të figurnshëm përbuzës për shqiptarin, i cili mban kësulë të bardhë), *Bungurovski* (nga *bungur, bollgur*),

Kunguloski/Kungulov (nga *kungull* “tikva”, khs. sikurse dhe *Tikvarov* nga sll. *tikva*);

Pilafova (pilaf);
Pampurov (pampur);
Partaloski (partall);
Pulevci, Puleski (pulë);

Škreti – etnonim/egzonim me të cilin identifikohen banorët e Rekës së Epërme nga ata të Rekës së Poshtme (sipas disa autorëve nga shq. *shkret* – rajon i shkretë, në të cilin vështirë mund të jetohet) (Mirčevska 2007: 162).

Urdarovski (urda “gjizë”);
Utevski (hut); dhe
Leksikut moral:
Besovski (besë),

Bujarovski (bujar);

Leksikut të mjeshtrëve a të profesionit:

Çobanov (çoban),

Loparski (lopar);

Paralele të ngjashme hasim dhe te popullsia rumune dhe arumunne e Ballkanit. Po japim disa shembuj mbiemrash familjarë me ofiqe a nofka të tilla, me korrespondente dhe te shqiptarët:

Albu – Bardhi

Bišta (mbiemër familjar tek arumunët e Magarevës, në Manastir, rrjedhur nga shq. “bisht”, përkatësisht i elementit shqiptar të cicarizuar, Skok 1933: 215).

Negru – Ziu

Roşu – Kuqi

Galbenu – Verdhi

Micu – Vogli

Scurtu – Shkurti

Lungu – Gjati

Râu – Ligu (Brânkuş 2009: 191).

IV. Egzonime te shqiptarët për të tjerët

Edhe shqiptarët përmes nofkave dhe shprehjeve proverbiale kanë reflektuar të kaluarën për fqinjët e tyre, e kaluar që shpeshherë ka qenë e hidhur më shumë se e lumtur për shkak të lakmive e hileve djallëzore që kanë ushqyer gjitonët (komshinjtë).

Shqiptarët për maqedonasit dhe për sllavët përgjithësisht përdorin nofkat:

Shqa, shqe, thjesht.ligj. *shja*, pl. *shie, shiet* (Kërçovë), *shka, shkie-t* (Kosovë), “sllav i jugut, sllavishtfolës” (nga lat. *sclavus* ‘shërbëtor’). Për femrat: *shkejnë* (Kërçovë), *shkinë, shkinulkë* (Kosovë). Emrat e tillë përdoren si nofka edhe për vetë bashkëkombësit shqiptarë kur përqeshen: *Shja Poreçje, Shkejnë Poreçje* (sipas krahinës së Poreçes të populluar me serbë, Kërçovë). Krahas këtyre për serbët në Kosovë përdoren dhe: *shkavell e shkinulkë: shkinulkë e flliçit*.

Për maqedonasit përdorin dhe *Shule* – kështu i quajnë me përçmim shqiptarët e Korçës maqedonasit e Prespës së Vogël (Gure Duma, *Mala Prespa*, Filološki fakultet “Blaže Koneski”, Skopje, 2007: 120). Në këtë sens, ata përdorin dhe një shprehje të fortë negative: *Shulja më i mirë ka qirë të ëmën!* (Tushemisht, Pogradec).

Mbi baza fetare përdorin dhe:

Kaurr – 1. maqedonas. 2. i pafë (Strugë, Gostivar).

Poturr – torbesh (maqedonas mysliman, nga *poturçenjak*). Shprehje që përdoret në Strugë.

Torbesh - 1. emër me kuptim përçmues për një komunitet etnik që deklarohen si *maqedonas myslimanë*, si dhe për shqiptarë, turq dhe të tjerë që flasin maqedonisht. 2. kështu quhen nga të tjerët shqiptarët dhe sllavët e islamizuar, me kuptim keqësues.

Tërbeshë – shqiptarët e Gllumovës së Shkupit, që për nga diakti dallohen nga ata të Nerezit, Gërçecit e Krushopekut, duke i vënë në thumb këta të fundit, i quajnë *Tërbeshë*. Këta, nga ana tjetër, për të nxjerrë hakun, të gjithë shqiptarët e Dervenit deri në Pollog i quajnë me fjalën sllave *golëc* “goljo”. Të dy emërtimet, edhe *golëc*, edhe *toresh* lidhen vetëm me tirqit. Katundet e Dervenit e deri në Pollog mbajnë tirq të shkurtër. Kur ulen duhet t’i mbajnë tirqit që të mos u bien. Së këndejmi u krijua edhe llagapi *golëc* (Skok 1941: 85).

Shop – kështu i thuhet dikujt për përçmim. *Shop i keç* (Kërçovë).

Pomakët - bullgarë të konvertuar në Islam në kohën e pushtimit otoman. “Kjo pakicë, llogaritet në 900.000 veta para rënies së komunizmit, ishte viktimë e një politike të asimilimit të detyrueshëm që arriti kulmin në fund të viteve 1980. 350,000 pomakë kanë ikur për në Turqi si refugjatë.

Për arumunët shqiptarët përdorin: Çoban, sh. çobenj – krahas kuptimit të parë ‘ai që ruan bagëtinë’, kjo fjalë në gjuhën bisedore përdoret dhe për ‘vllah, vllëhtë’ (FGJSSH), sipas mjeshtërisë a proesionit të tyre që kanë ushtruar duke ruajtur bagëtinë. Shprehjen peshoative *çoban* “vllah” shqiptarët e kanë huazuar nga turqit (Popvasileva 1987: 10).

Gogë – ofiq i arumunëve të shqiptarët, me cilësimin “murator”. Vllëhtë, kur janë sedentarë, ushtrojnë më së shumti zanatin e muratorit (G. Meyer 2007: 173).

Për *çobenjë*t (vllëhtë) përdorin dhe *Llauc: Ik ore llauc!* (Tushemisht, Pogradec).

Llacifac – emërtimk popullor për arumunët, vllëhtë, ngaqë ata përdorin dendur *cefac* “bëj”, pra “ata që thënë cefac” (Gj. Shkurtaç, Sociolinguistikë e shqipes: Nga dialektologjia të etnografia e të folurit, f. 111).

Për grekët *Kacidhjari* – qeros, tullac (Korçë). Fraz. *Nxori kacihjari lesh, gjithë botn’ e përqesh; Zuri kacidhjari lesh, nxori kokënë në shesh* (Fjalë të urta nga Preveza).

Manarko – (Korçë).

Grek i ndyrë! Grek i qalbur! (Tushemisht, Pogradec).

Për vllëhtë: Llacifaci – kështu quhen vllëhtë në rrethinën e Korçës, nga *llaci* ‘flas kot’ dhe *faci* ‘bën’, ai që flet kot.

Në Korçë kemi regjistruar edhe këtë thënie: *çek, çam, çifut, çoban – ik larg prej tyre, dhe Të çaftë morri i serbit* – nëmë për dikë.

Për turqit: në gjuhën bisedore të Maqedonisë për të përçmuar turqit përdoret një shprehje e tillë: *Turk elhamdulila* ‘turk që vetëm di të falet, që merret vetëm me fenë’ (Kërçovë), dhe *mall turku* – për prodhimet nga Turqia që konsiderohen pa vlerë.

Për evgjitët (romët):

Arixhinj – ciganët e Shqipërisë; “Nga kjo pikë, ky veprimtari kish të drejtë, pasi zor se gjendet në Shqipëri shtresë më e përvuajtur dhe e përbuzur sesa ciganët a *arixhinjtë*... Në fund të fundit, ne i quajmë “*arixhinj*” e ata na i marrin hakën duke na quajtur “*gaxhinj*”, barazim një me një dalim (Artan Lame, Shqip, 12. 10. 2011). Në Shqipëri *Arixhinj* – janë quajtur pjesa nomadike, kurse *jevshinj* – pjesa urbane.

Në Pogradec *Pac*: *Ik ore pac!*

Për magjupët përdoren po kështu pezhorativa të shumtë:

Xhyp, *xhypkë* sh. *xhypsh* (për romët urbanë), e *çergar* (për romët nomadë, Kërçovë). Në trevën e Kërçovës edhe në frazeologji: *Në jem i zi, xhyp nuk jem* – ‘nuk jam shumë i keq’.

Maxhoskë mb. – kështu cilësohet shqiptari që i përngjan madhuit, me tipare si të maxhupit. *A maxhosku ç'i ish* (Kosovë).

Kurbat – romë që e kanë gjuhën e vet, e dinë shqipen, por nuk flasin shqip (Tushemisht, Pogradec).

(*H*)*alahuq* – fjalë e ligë për evgjitët që jetonin në tenda (Prevezë, Çamëri).

Për italianët dhe për grekët- këto më së miri i vërejmë te shprehjet proverbiale të arbëreshëve të Italisë dhe të Greqisë (Bellushi 1989).

1. *Derk e lëti mos e klla mbë shpi, pra vëhu prapa derës, mirr nj`dru e ndaji çeren* (Mbuzati – Kozencë).

2. *Derk e lëti mos e fidho ndë shpi, se t`çan poçe e kusi, e t`mbjon me bri* (Shën Murtiri – Kozencë).

3. *Derk e lëti (latin, italian) mos e qas mb`shpi* (Vakarici – Koencë).

4. *Ndë she ulkun e grekun, vrahj grekun e le ulkun* (Vina – Katanzaro).

V. Egzonime te vllehtë për të tjerët

Edhe vllehtë kanë krijuar dhe përdorin shumë nofka për popujt e tjerë që i rrethojnë, me të cilët kanë pasur dallime dhe marrëdhënie shpeshherë dhe jo miqësore, që reflektohet kjo dhe në nofkat që u kanë ngjitur atyre.

Cap di Ghegan = kokë shqiptari “kokëfortë”; *Cap di Iuruc* = kokë juruku, kokë inat (Cuvata 2006: 117).

Elin, *elinã*, pl. *elinji*, *elini* – 1. pagan, 2. antikrisht, i pafe, që nuk beson në zot. 3. fig. njeri i keq, i pamëshirshëm (Cuvata 2006: 219).

Gagan, pl. *gaganji* – ofiq me të cilin arumunët i quajnë grekët, duke i cilësuar ata si poltronë, llokmaxhi e parazitë (Cuvata 2006: 247).

Vãrgarã pl. *Vãrgari* – bullgar ose maqedonas (në të folurit e thjeshtë te arumunët) (Cuvata 2006: 564). Përdorur si metaforë mbase nga një leksemë e blegtorisë *vargër* – dash a cjan i patredhur, që mbahet për ndërzim (FGJSSH).

VI. Egzonime të grupeve të tjera sociale për vllehtë

Popullsia arumune në Ballkan veten e quajnë *Armãn*, kurse te popujt e tjerë njihet me shumë emra: *arumunë, vlleh, cicnar, karavllah, çobenj*, etj.

Cãciunã, pl. *Cãciunji* – nofkë për arumunët e Epirit që ua japin arumunët e Manastirit (Cuvata 2006: 123).

Cincar – përqeshje për arumunët të cilët e shqiptojnë numrin “pesë” *cinc* në vend të “*çinç*”.

Çobenj – kështu arumunët i thërrasin në Shqipërinë Jugore, ngase janë marrë kryesisht me blegtori.

Karavllah (maq. *karavlasì*) – kështu quhen te maqedonasit dhe te bullgarët, për shkak se barinjët arumunë kultivonin dhe mbanin racën e deleve të zeza ‘*karakaçanka*’ (sojin e vjetër), të imta, sepse ato mund të kullotnin kudo.

Kucovllah – nofkë fyese me të cilën grekët i quajnë arumunët (Cuvata 2006: 161), mbase në bazë të fjalës që ata përdorin në idiomën e tyre *kutsar* ‘trung’, fig. ‘njeri i paditur’.

Motsan – nofkë me të cilën i quajnë arumunët banorët e rrethinës Aminçu dhe disa lokaliteteve të tjera të Maqedonisë Veriore, tani në Greqi (Cuvata 2006: 354). Mbase nga emërtimi nga ana e tyre *motcã* “shkop” i sferës së blegtorisë.

VII. Egzonime te maqedonasit për grekët dhe vllehtë

Maqedonasit kanë krijuar shumë shprehje fyese për armiqtë e tyre shekullorë – grekët, ku fjalori popullor i kësaj gjuhe “vlon” me shprehje të tilla, në një të ashtuquajtur “*turlitavë gjuhësore*”. Nga shprehjet e tilla bie në sy këtu besimi që nuk kanë te greku, pra që i konsiderojnë njerëz të pabesë:

Greka fides – nula fides/ Verba vo Grk, nikakva verba (Stefanija-Miodonjska 2008) - *Besimi te greku, kurrfarë besimi*.

Koj gi ima Grcite za prijateli, nemu dušman ne mu treba (Stefanija-Miodonjska 2008) – *kush i ka grekët fqinjë, atyre nuk u duhen armiq*.

Për *gjuhën greke* maqedonasit përdorin cilësimet më pezhorative, duke e krahasuar atë me “pordhët”:

Jadi grav za da zborviš grčki! (Stefanija-Miodonjska 2008) - *ha groshë, që të flasësh greqisht!*

Sedi, sedi na kamen ako sakaš da zborviš grčki! (Stefanija-Miodonjska 2008) - *Rri ulur mbi gur, nëse do të flasësh greqisht!*

Toj zborvit grčki (ako nekoj e nastinat i prdi) (Stefanija-Miodonjska 2008) – *Ai flet greqisht (nëse dikush ka grip dhe pjerdh)*.

Ndërkaq, me vllhtë nuk kanë dashur të kenë kurrfarë marrëdhëniesh për shkak të pozitës së tyre sociale më të ulët:

Od Vlav ni zukem ne se zemat (Stefanija-Miodonjska 2008) – *Vllehu as gripin nuk ta jep hua*.

VIII. Ofiqe te maqedonasit me fjalë shqipe

Cubaleski/ Cubaleska – mbiemër familjar në Galiçnik të Rekës së Dibrës, të cilin e mban dhe gjuhëtarja *Meri Cubaleska*, e martuar në këto anë. Përdorur mbase si ofiq nga *cub, cubel* “hajdut, kusar”, një fjalë vendi e shqipes me karakter krahinor (Çabej SGJ IX 1989: 60).

Kunguloski – ofiq familjar nga apelativi i shqipes *kungull* (Murati 1993: 74).

Ljamevci – ofiq për llazaropolasit e Rekës së Dibrës dhe mbiemër familjar i patriarkut të kulturës dhe të shkencës maqedonase *Bllazhe Koneski*, dikur *Blagoja Ljameski* (Andreeski 1992: 23). Rrjedhur nga emri vetjak shqiptar *Lame* (Murati 1994: 190).

Loparski – ofiq familjar që rrjedh nga apelativi i shqipes *lopë, lopar* (Murati 1993: 75).

Šitkata – përdorur si ofiq në fsh. Bojançishte të Kavadarit (*Kamçe Šitkata* – nga shq. shit “prodava”). Ky ofiq është bartur dhe tek i biri *Cando Šitka*, dhe ka shkuar të përdoret madje dhe si emër familjar *Šitkovite* (Velkovska 2011: 106).

Ljočki arg. Albanci, në të folmen e fshehtë maqedonase të Shlegovës në Kratovë (Filipovski-Kitanovski 1983).

Egzonime të tjera

Pau – serb, rashanin (*rascan*), njeri nga Rashka, Serbia e Vjetër; 1. E përdorin romët si emër fyes për serbët, ndonëse në thelb është emër i drejtë dhe për këtë nuk duhet ta hanë veten (në fjalorin e Sremit).

Potur - si emër nënçmues në Kosovë është përdorur nga populli serb dhe shqiptarë për t'i emëruar fshatarët ortodoksë (qofshin serbë, vllhë, bullgarë ose shqiptarë), të cilët kanë kaluar në fenë islame. Një pjesë e tyre deri vonë kanë folur gjuhën serbe. Fjala *Poture* rrjedh nga sll. “*Poturci*”, që do të thotë “proturq”, për ata që kanë pranuar fenë islame. Në rajonin e Anadrinisë janë dy ose tre fshatra që populli edhe sot e kësaj dite i quan *Potura*.

Në fjalorin e torbeshëve:

***Gatikari* = Albanci**

***Piperkari* = Makedonci**

***Golubi ili Pecivari* = Romi**

***Sajkaci* = Srbi**

(Торбешки речник [Архива] - ИЦ форум - Исламски Центар)

Shprehje me ngarkesë të rëndë pezhorative

Popujt e Ballkanit kanë krijuar edhe shprehje të tjera me ngarkesë të rëndë pezhorative, që përdorin për të cilësuar njëri-tjetrin. Kështu p.sh. shqiptarët për “pushon së jetuari” përdorin: *vdes* (për njerëzit), dhe *ngordh* e *cof* (për kafshët). Këto foljet e fundit *ngordh* e *cof* përdoren edhe për njerëzit vetëm me kuptim keqësues, ashtu siç përdoren dhe për njerëzit e komunitetit të besimit jomysliman: *Ka cof nji shja!* (Kërçovë).

“*Turlitava gjuhësore*” e popujve të Ballkanit është me shumë interes po të gjurmohet dhe vëzhgohet në plotësinë e saj, sepse kjo na flet dhe për vetë psikologjinë dhe “*etnografinë e të folurit*” të këtyre popujve, për urrejtjen dhe smirën që kanë pasur ndër shekuj dhe kanë ende në raportet me njëri-tjetrin. Popujt e Ballkanit janë xhelozë, prandaj është lehtë t’i futësh në grindje njërin me tjetrin. Për këtë arsye ata kanë krijuar dhe gjithë atë mal nofkash në gjuhët e tyre. Në Ballkan njerëzit dhe grupet e njerëzve ende shikohen përmes stereotipave. Ne akuzojmë grekët se i shohin shqiptarët përmes stereotipave: *mafiozë, keqbërës*, etj. Madje ksenofobia greke shprehet dhe në forma zyrtare (p.sh. parada ushtarake). Kurse shqiptari i sheh grekët përmes stereotipave *racist, i pabesë*, etj.

Egzonimet (epitetet fyese) negative që i japin njëri-tjetrit si pjesë thelbësore e komunikimit të acaruar shekullor, që reflektojnë një kulturë sjelljeje tepër primitive, nuk i gjen kund në hapësira të tjera sociolinguistike.

Ndjenja e poshtërimit ndaj tjetrit (të huajit) duket se askund nuk është më e fortë se në Ballkan, ku popujt të ndryshëm fabrikojnë orgjinën e tyre dhe mohojnë çfarëdolloj lidhje të vlefshme me qytetërimin për të tjerët.

BIBLIOGRAFIA

- Andreeski 1992 = Andreeski, Cane, *Razgovori so Koneski*, Skopje, 1992.
- Bellushi 1989 = Bellushi, A., *Dizionario fraseologico degli albanesi d'Italia et Grecia*, Cosenza, 1989.
- Brâncuș 2009 = Brâncuș, Grigore, *Kërkime mbi fondin trako-dak të gjuhës rumune*, Instituti rumun i trakologjisë, Biblioteka trakologjike VIII. Përktheu nga rumanishtja Luan Topçiu, bot. Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2009.
- Cuvata 2006 = Cuvata 2006 = Dina Cuvata/Dimo N. Dimčev, *Dictsionar armaneascu-machidunesku / Rečnik vlaško-makedonski*, Skopia, 2006.
- Duceiller 1996 = Ducellier, Alain, *Shqiptarët në Italinë qendrore të mesjetës: nga emigrimi te integrimi*, "Përpjekja" 9, Tiranë, 1996.
- Elezović 1932 = Elezović, Gligorije Gliša, *Rečnik Kosovsko-Metohistog dijalekta*, Srpska Kraljevska Akademija, Beograd, 1932.
- Ibrahimi 2008 = Ibrahimi, Mustafa, *Paragjykimet midis popujve, gjuhëve dhe kulturave të ndryshme*, te "Studime folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni", Universiteti i EJL, Tetovë, 2008.
- Kore 2010 = Karagozi-Kore-Karagozi, Mimoza, *Kontaktet e lashta të shqipes me arumanishten*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 29/1, Prishtinë, 2010.
- Lory 2007 = Lory, Bernard, *Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona*, Shtëpia Botuese DITURIA, Tiranë, 2007.
- Mehmeti 2011 = Mehmeti, Kim, *Shkupi*, Logos-A, Shkup, 2011.
- Meyer 2007 = Meyer, Gustav. *Fjalor etimologjik i gjuhës shqipe*, Botime Çabej 2007.
- Mirčevska 2007 = Mirjana P. Mirčevska, *Verbalni i neverbalni etnički simboli vo Gorna Reka*, Institut za etnologija i antropologija, Specijalni izdaniya, kn. 2, PMF, Skopje, 2007.
- Murati 2001 = Murati 2001 = Murati, Qemal, *Kokrra urtësie për gjuhën*, Tetovë, 2001.
- Ничева 1974 = К. Ничева, С. Срасова-Михайлова, Кр. Чолакова, *Фразеологичен речник на българският език*, Българска Академия на Науките, Institut za български език, Софиа, 1974.
- Peev 1999 = Peev, Kosta, *Rečnik na makedonskite gojori vo jugoistočniot egejski del*, Skopje 1999.
- Polenaković 2007 = Polenaković Haralampie, *Turskite elementi vo aromanskiot*, Makedonska Akademija na Naukite i Umetnostite, Skopje, 2007.
- Popvasileva 1987 = Popvasileva, Aleksandra, *Dvojazičното raskažuvanja na narodni prikazni (Vlaško-makedonski i makedonski-vlaški relacii*, Institut za folklor 'Marko Cepenkov', Skopje 1987.
- RMJ I 1979 = *Rečnik na makedonskiot jazik I*, Skopje, 1979.
- Skok 1941 = Petar Skok, *Hulumtime gjuhësore te popullsitë josllave të Luginës së Shkupit (Lingvistička proučavanja neslovenskog stanovništva Skopske kotline, Godišnjak Muzeja Južne Srbije*, Skopje, 1/1941.
- Stefanija-Miodonjska 2008 = Dragi Pop Stefanija – Liljana Miodonjska, *Jazična turlitava*, Ohrid, 2008.
- Shufflay 1968 = Shufflay, dr. Milan, *Serbët dhe shqiptarët*, Rilindja, Prishtinë, 1968.

ARDIAN VEHBIU

ATTRIBUTE FJALËSH

Etiketa: arkaizmat, barbarizmat, estetika leksikore, fjalët e huaja, fjalët e rralla, huazimet, purizmi, racizmi leksikor

Atributet e fjalës të gjithë i njohim dhe i përdorim, shpesh pa e vrarë mendjen se çfarë po themi dhe me ç'logjikë.

Ndarja e parë e madhe, në fjalë **shqipe** dhe **joshqipe**, na është sugjeruar që nga Rilindja e këtej; edhe pse me të fundit kemi parasysh zakonisht fjalët e huazuara – që këtej jo vetëm purizmi, pastrimi i gjuhës, përndjekja e fjalëve për shkak të origjinës (ose gjuhësia policore) dhe varfërimi i gjuhës; por edhe vetë kultivimi i një vetëdijeje diakronike ndër ligjëruesit, të cilëve u bëhet natyrë e dytë të marrin në pyetje fjalën, për të mësuar nga vjen (*e kujt je ti, moj bijë?*).

Fjalë shqipe është jo vetëm ajo që e kuptojnë “të gjithë”, por edhe ajo me origjinë të pastër, “ariane”; ose me gjak të papërzier. Përndryshe, fjala e huaj nuk meriton tjetër, veçse dëbim nga gjuha; mundësisht internim dhe shfarosje.

Po si do ta dallojë zelltari fjalën e huaj, që pastaj ta dëbojë nga ligjërimi? Meqë jo të gjithë ideologët kanë bërë kurse të historisë leksikore ose njohin me rrënjë gjuhët me të cilët ka pasur marrëdhënie shqipja, atëherë vendin e ekspertizës e zë analogjia ose profilizimi: turqizma si *babaxhan, allish-verish, matrapaz, kallaballëk* e kanë të shkruar në ballë tjetërsinë, ndërsa turqizma të tjerë, si *zarf* ose *dyshek*, kanë shpëtuar paq, duke u kamufluar si fjalë joturke. Ndonjë ditë do të nisim të qëmtojmë, ndër shqiptarët patriotë, për familje që shpëtuan kaq e kaq turqizma nga inkuizicioni, pasi u dhanë besën; por tani për tani sezoni i gjahut mbetet i hapur.

Deri më sot, ndaj fjalëve të huaja të panevojshme është mbajtur një qëndrim, në thelb, policor: këto në fillim identifikohen, pastaj largohen nga ligjërimi me forcë. Me përjashtim të turqizmave, largimin e të cilave nga leksiku i shqipes e katalizoi edhe konteksti historik, ky qëndrim, e kotë ta them, ka dështuar, madje edhe atëherë kur dihet se për fjalën e huaj nuk ka pasur arsye gjuhësore për t'u futur. Kështu, *implementoj* nuk i shton gjë përdorimit në krahasim me alternativat *zbatoj, vë në jetë, vë në zbatim, realizoj, vë në praktikë* etj.; por ai që e përdor, zakonisht e bën këtë sepse konceptin në kokë e ka formuluar në gjuhë të huaj dhe, çka është edhe më e rëndësishme, kodi gjuhësor që ka përvetësuar ia lejon këtë.

Për këtë arsye, lufta ndaj kaosit leksikor dhe dyndjes së fjalëve të huaja në shqipen mund të fitohet vetëm në lëmin **profilaktik**, jo në atë klinik; ose duke i stërvitur ligjëruesit që jo vetëm ta njohin fjalën joshqipe nga fjala shqipe, por edhe

që t'i zotërojnë aktivisht fjalët shqipe përkatëse, aq aktivisht sa të mos u vejë mendja për fjalën e huaj.

Kujtoj këtu edhe se asnjë prej virtuozëve të fjalëve të huaja në ligjërimin shqip, nuk gabon të përdorë tek-tuk fjalë shqipe, kur komunikon me të huajt në gjuhët e mëdha si anglishtja dhe frëngjishtja; çka vërteton, besoj unë, se problemi nuk ka të bëjë me kompetencën gjuhësore, por është i natyrës sociologjike.

Përndryshe, atributet e fjalës shqipe janë kryesisht dy: ajo është e **bukur** dhe e **vjetër**. Asnjë nga këto veti, në vetvete, nuk është intuitive; përtej disa lodrave fonetike që kanë të bëjnë me tinguj likuidë dhe bukurtingëllues, **bukuria** e fjalës shqipe lidhet drejtpërdrejt me të qenit e saj fjalë *shqipe*, ose më mirë akoma, jo e huaj. Ndryshe qëndron puna me fjalët e **shëmtuara**, të cilat ndonjëherë janë përnjëmend të vështira për t'u shqiptuar, ose përmbajnë shumë bashkëtingëllore në trup (p.sh. për shumë nga ne *flutur* është më e bukur si fjalë se *bretk*; *laureshë* më e bukur se *cinxërr*).

Megjithatë, estetika në leksik mbetet një nocion në kufi të manipulimit; ka më shumë kuptim të flitet për përdorime të bukura të fjalës, sesa për fjalë të bukura; përndryshe, *fjalë e bukur* s' do të thotë asgjë më tepër sesa *fjalë ideologjikisht e pranueshme* (e *miratueshme*); dhe shprehja *fjalë e bukur shqipe* i përket sferës së demagogjisë – në kuptimin që kur e përdor tjetri, debati ka mbaruar. Kjo, pavarësisht nga abuzimi që është bërë me “bukurinë e fjalës” në tekstet didaktike të Rilindjes, të cilat, për më tepër, u drejtohen fëmijëve të shkollave, të cilët e kanë më kollaj t'u qasen koncepteve me kritere estetike. Por nuk duhet të gabojmë e t'i vëmë disa vjershëza të poetëve kombëtarë në themelet e filozofisë gjuhësore, megjithë zellin e pashembullt të ideologëve.

Më anë tjetër, fjalë e *shëmtuar* është edhe ajo që na tërheq vëmendjen pa arsye; që bie në sy mes shoqeve, duke e ndërprerë rrjedhën e natyrshme të ligjërimin. Një fjalë e huaj, e sjellë në ligjërim pa nevojë, veçanërisht për të treguar orientimin kozmopolit të përdoruesit është vetvetiu e shëmtuar; po aq e shëmtuar sa edhe një neologjizëm, të cilën dëgjuesi ose lexuesi duhet ta deshifrojë më vete e që, në një farë mënyre, tregon me gisht autorin e saj.

Sa për fjalën shqipe si fjalë e vjetër, kjo bindje pasqyron drejtpërdrejt idenë se gjuha shqipe është **gjuhë e vjetër** – e cila nuk është shkencore, por ideologjike dhe, në thelb, irracionale. Çuditërisht, fjala e vjetër nuk duhet ngatërruar me fjalën e *vjetruar*; e para funksionon për bukuri dhe pranohet prej të gjithëve, meqë vjetërsia shërben si kriter vlerësimi pozitiv; e dyta tashmë nuk mund të përdoret më lirisht, ka dalë nga përdorimi, si një sahat me kurdisje ose një shpatë. Madje një fjalë, nëse është vjetruar, ka pasur një arsye për t'u vjetruar – folësit e kanë zëvendësuar, mundësisht me një fjalë shqipe.

Për gjuhëtarin, fjala e vjetër do të ishte e fondit indo-europian të shqipes, ose fundja edhe huazim nga greqishtja e lashtë ose latinishtja; përkundrazi, huazime të tjera, nga greqishtja e mesme dhe e re, gjuhët sllave, italishtja, turqishtja, gjuhët neolatine dhe tani së voni anglishtja nuk hyjnë në këtë kategori.

Mirëpo fjala nuk e bart me vete moshën e saj, as e tregon gjëkund. Fjalët e vjetra shqipe, si *gisht*, *dorë*, *qep*, *gjuaj*, *i mirë*, *gjej* janë edhe më të përdorshmet, ndryshe nga fjalët e vjetëruara, të cilave u ka mbaruar fryma. Mund të thuhet, në këtë

kontekst, se fjalët e vjetra e kanë treguar veten në kohë dhe meritojnë respekt; por e vetmja mënyrë si t'ua tregosh fjalëve, edhe fjalëve të vjetra, respektin është t'i përdorësh saktë.

Fjalëve të vjetra u kundërvihen, logjikisht, fjalët e **reja** ose neologjizmat (e krijuara rishtas; edhe pse jo çdo neologjizëm është doemos i krijuar rishtas); këto përdoruesi ideal gjithnjë i pret keq në fillim, i përqesh, nuk i pranon lehtë në ligjërim dhe i përshëndet vetëm kur ia shpjegojnë se janë sjellë për të zëvendësuar ndonjë fjalë të shpallur si të padëshiruar dhe në kërkim. Në këtë rast të fundit, fjala e re është kuadri i ri dhe i besuar, që merret në punë me porosi nga lart, në vend të një eksperti ideologjikisht të dyshimtë, që nuk dihet nëse punon për ne, apo për armikun.

Çfarë na intereson zakonisht te fjala *e re* nuk është mosha e saj, por roli i saj në aktin zëvendësues, ose censurimin militant të leksikut. Prandaj edhe ia falim moshën e njomë dhe shëmtinë, meqë jemi të vetëdijshëm se gjendet aty për të përmbushur një mision të shenjtë: **purifikimin**.

Fjalët shqipe mund të jenë edhe të **rralla**; fjalët e rralla ndonjëherë sistemohen e mirëmbahen në fjalorë të posaçëm dhe blihen nga terjaqinj të kulturës kombëtare, të cilët ndonjëherë përnjëmend shpresojnë se mund t'i ndihmojnë këto fjalë të bëhen një ditë të zakonshme, edhe pse me dhimbje. Mirëpo fjalët e rralla e kanë edhe ato një arsye praktike pse janë të tilla; dhe kjo arsye ka shpesh të bëjë me funksionin e tyre në ligjërim dhe nevojat që plotësojnë për emërtime. Emrat e bimëve medicinale ose të dhive sipas ngjyrës vështirë se mund të bëhen ndonjëherë pjesë e bagazhit leksikor të cyber-qytetarit post-modern që e kalon kohën e lirë në Facebook.

Mirëpo promovuesit e fjalës *së rrallë* kanë një koncept të veçantë për fjalët, të cilat i koleksionojnë si të ishin pulla poste ose flutura. Vetë themelore e objekteve, në koleksione të tilla, është se kanë dalë nga përdorimi ose kanë vdekur; pullat e postës janë anuluar nga vula përkatëse, fluturat e kanë nga një thumb që u shkon mes përmes gjoksit dhe nuk fluturojnë dot më.

Ekziston edhe një përshoqërim i çuditshëm mes fjalës *së rrallë* dhe fjalës *shqipe*; sipas të cilit fjalët e rralla janë *më* shqipe se të tjerat, meqë janë ruajtur në skutat e gjuhës njëloj siç janë ruajtur shqiptarët e lashtë në malet. Ky koncept është fund e krye mitik dhe, ndryshe nga koncepti tjetër, për historinë e të parëve tanë, as që i përgjigjet realitetit. Një fjalë *e rrallë* është e tillë sepse nuk përdoret e nuk njihet nga shumica e përdoruesve, jo sepse është ruajtur me sakrificë nga ndonjë i apasionuar në provincë.

Lokalistët kanë sjellë në qendër të vëmendjes edhe një çift të ri atributësh të fjalës: fjalë *toske* dhe fjalë *gege*; madje kjo ndarje qëndron në bazë të ankimit se shumë fjalë gege janë lënë jashtë standardit leksikor dhe se kjo padrejtësi, që nuk është pa lidhje me qëndresën që iu bë komunizmit në Shqipëri të Veriut, tashmë duhet vënë në vend, madje pa vonesë. Çështja këtu është te mënyra si do ta dallojmë një fjalë nëse është gege ose toske, në mungesë studimesh dialektore të hollësishme. Dijetarët e gjuhës prej kohësh na kanë shpjeguar si shumë fjalë shqipe janë të përbashkëta për të dy dialektet; dhe se një fjalë si *kangë* nuk është doemos

gege, vetëm forma e saj fonetike është – meqë fjala ekziston edhe në toskërishte: *këngë*.

Më anë tjetër, populistët kanë promovuar atributin e fjalëve **të mëdha**, për t'i dalluar nga fjalët e thjeshta, popullore, shpesh të vjetra dhe shqipe safi. Fjalët e mëdha i përdor intelektual, ai që kërkon të hiqet si i ditur ose si ekspert e që ashtu t'u imponohet të tjerëve; më keq akoma, ai që kërkon të përcjellë idenë se është më i mirë dhe më i zoti se ty. Me nënkuptim, fjalët e mëdha janë fjalë të huaja, zakonisht të huazuara nga italishtja, frëngjishtja dhe anglishtja; folësi i përdor sepse është i vetëdijshëm që të tjerët nuk do t'ua dinë kuptimin. Me fjalë të tjera, fjalët e **mëdha** janë antidemokratike dhe kultivojnë intelektualizëm dhe individualizëm, prandaj edhe ato duhen dëbuar sa më parë nga gjuha. Edhe këtu, nuk ka arsye pse të trajtohen së bashku nevoja për sofistikim të ligjëratës, në kontekste të caktuara, dhe snobizmi leksikor; e para përlligjet gjuhësisht, i dyti jo.

Të gjitha atributet e mësipërme i referohen, në një mënyrë ose në një tjetër, përmasës diakronike, ose shtrirjes së gjuhës në kohë; në një kohë që përdorimi i gjuhës është gjithnjë i tashëm. Kjo kundërvënie ka të bëjë me vetë origjinën e attributeve, në ideologji romantike të Rilindjes, e cila ishte e tëra e zhytur në historizëm. Sot arsyet për ta mbajtur gjallë këtë ideologji, edhe nëse ekzistojnë, nuk mjaftojnë për t'i përlligjur atributet vetë dhe për t'ua ruajtur këtyre vlerën praktike.

EMIL LAFE

KONGRESI I DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Në prag të festave tona të mëdha kombëtare, zhvilloi punimet në Tiranë Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, i thirrur me iniciativën e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Universitetit Shtetëror të Tiranës.

Çështja e formimit të një gjuhe letrare kombëtare të njësuar ka qenë pjesë e pandarë e jetës politike, shoqërore e kulturore të popullit tonë që nga Rilindja e këtej. Në këtë çështje të madhe caktimi i alfabetit të sotëm nga Kongresi i Manastirit më 1908 dhe vendosja e rregullave përfundimtare të drejtshkrimit nga Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe përbëjnë dy momente shumë të rëndësishme, dy ngjarje historike. Të dyja këto ngjarje janë kurorëzimi i përpjekjeve të pareshtura të shumë brezave që punuan e luftuan me besim të plotë se gjuha jonë e ëmbël dhe e gjerë, e lehtë dhe e lirë, e bukur dhe e mirë do të kishte një të ardhme të madhe, të ndritur.

Duke qenë se drejtshkrimi përbën tiparin dallues themelor të një gjuhe letrare të përpunuar, diskutimet rreth tij, përpjekjet për hartimin e një drejtshkrimi sa më të njësuar, kanë zënë një vend qendror në diskutimet dhe debatet rreth çështjes së gjuhës letrare në përgjithësi. Që më 1905 Luigj Gurakuqi thoshte se drejtshkrimi “ka një rëndësi të madhe fort për themelimin të një gjuhe letrare shqipe, sa mund të themi se nuk do të arrijmë kurrë këtu po të mos zgjedhim e po të mos caktojmë një mënyrë të posaçme e të veçantë për të shkruar një fjalë si toskërisht, si gegërisht”. Pikërisht duke u nisur nga kjo e vërtetë e padiskutueshme, Komisia Letrare e Shkodrës, në të cilën bashkë me L. Gurakuqin bënin pjesë edhe S. Peci, N. Mjeda, Gj. Pekmezi, M. Logoreci, A. Xhuvani etj., me rregullat ortografike që botoi më 1917 bëri me sukses një afrim të mëtejshëm të gegërishtes së shkruar me toskërishten.

Ato rregulla patën një rëndësi historike për konvergencën e mëvonshme të dy varianteve, verior e jugor, të shqipes letrare, megjithëse për gati tridhjetë vjet rresht puna e Komisionit Letrarë jo vetëm nuk u çua përpara në një mënyrë më të organizuar e më të studiuar, por edhe u kundërshtua ose u la në harresë të plotë nga klasat sunduese e nga kleri katolik. Kjo solli që para çlirimit të mbretëronte një kaos ortografik. “Të gjithë e dimë, - shkruante A. Xhuvani, duke karakterizuar atë gjendje, - se ortografia e shqipes nuk është e ngulme saqë të quhet e unifikuar dhe të përdoret po në atë mënyrë prej të gjithë atyre që marrin pendën e shkruajnë ose shkarravisin gjësendi; por lëkundet kjo ortografi jona në mes shumë fluktacionesh, saqë çdo shkrimtar a auctor ka një mënyrë më vete ortografie, ashtu si ia ka rrokur mendja e tij, ose shkon mbas ortografisë së njërit a tjetrit shkrimtar të mëparshëm. Veç kësaj, edhe çdo shkrimtar ose auctor tjetër që thuhet se ka

formuar një farë mënyre shkrimi, nuk është konsekuent në punë të ortografisë së vet, por ka një fluktacion në shkrimet e veta, duke përdorur trajta të ndryshme fjalësh”.

Në Shqipërinë e re demokratike dhe popullore çështjes së gjuhës letrare iu kushtua menjëherë kujdesi i duhur. Një nga punët e para që kreu Instituti i Shkencave, i themeluar më 1947, ishte hartimi i një ortografie të re, që të merrte parasysh zhvillimin e gjuhës letrare shqipe gjatë tridhjetë vjetëve që kishin kaluar që nga koha e Komisionit Letrare të Shkodrës. Kjo ortografi u botua në Buletinin e vitit 1948 të atij Instituti dhe pastaj, e ripunuar, doli si libër i veçantë më 1951. Pas një konference shkencore të posaçme që u thirr për të diskutuar rreth ortografisë, më 1956 u hartuan dhe u botuan rregulla të reja ortografike, më të plota dhe më të njësuara se të mëparshmet.

Zhvillimi i vullshëm i kulturës, i arsimit, i veprimtarisë së institucioneve shkencore, i letërsisë, i artit, i publicistikës në periudhën pas vitit 1956 shtroi si një nevojë praktike të ngutshme njësimin e gjuhës letrare dhe e shpejtoi në mënyrë të dukshme procesin e konvergencës gjuhësore. Gjuha letrare shqipe, në të gjitha fushat e zbatimit të saj, filloi kështu të funksionojë në një trajtë të vetme, të formuar si rezultat i një procesi të gjatë afrimi të dy varianteve letrare kryesore të saj. Gjuhësia shqiptare, me sukseset e rëndësishme që arriti pas çlirimit, dha një ndihmë të madhe për drejtimin dhe shpejtimin e këtij procesi objektiv dhe për përcaktimin e zgjedhjen e trajtave gjuhësore të drejta, ose, siç thuhet, për kodifikimin e normës së gjuhës letrare.

Në këtë mes një vend qendror zë puna me drejtshkrimin, pasi, ndryshe nga disa gjuhë, në drejtshkrimin e të cilave vendin kryesor e zënë rregullat që tregojnë se me ç’shkronja ose me ç’kombinime shkronjash shënohen këta ose ata tinguj, drejtshkrimi i shqipes, përkundrazi, lidhet ngushtë me tërë strukturën gramatikore e leksikore të gjuhës. Për t’iu përgjigjur kësaj gjendjeje të re cilësore të gjuhës letrare në shkurt 1967 u botuan “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”, hartuar si projekt për diskutim nga një komision i posaçëm i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, me synimin që në të ardhmen, në bazë të tyre të hartohej drejtshkrimi i shqipes në trajtë përfundimtare.

Projekti i vitit 1967 iu shtrua menjëherë një diskutimi të gjerë si në shtypin shkencor e periodik, ashtu edhe në mbledhje e konsulta të posaçme që u organizuan në njëzet e një rrethe të vendit e në disa institucione kulturore-shkencore të kryeqytetit.

Parimet e hartimit të këtij projekti dhe rregullat kryesore të tij gjetën një miratim të përgjithshëm në opinionin shkencor-arsimor të vendit. Zbatimi i këtij projekti solli një përmirësim të dukshëm të gjuhës së të gjitha botimeve tona. Që nga prilli i vitit 1968, me vendim të Konsultës Gjuhësore të përfaqësuesve të të gjithë shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, ky projekt po zbatohet me sukses në të gjitha botimet e atjeshme. Përpjekje të ngjashme janë bërë edhe nga arbëreshët e Italisë.

Pas një periudhe prej pesë vjetësh, gjatë së cilës projekti u diskutua e u zbatua gjerësisht, Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë i USHT mori iniciativën për të mbledhur një Kongres të Drejtshkrimit, si forumin më të lartë shkencor kombëtar,

që do të diskutonte përfundimisht çështjet teorike e praktike, të përgjithshme e të veçanta, të drejtshkrimit të shqipes dhe do të përcaktonte parimet dhe vijat themelore për hartimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe në trajtë përfundimtare.

Kongresi u mbledh në Tiranë nga 20 deri më 25 nëntor 1972. Në Kongres morën pjesë si delegatë e si të ftuar përfaqësues të dalluar të gjuhësisë shqiptare, të shkollës shqipe e të kulturës sonë kombëtare. Ndër ta ishin edhe studiues të shqipes e punonjës të arsimit e të kulturës nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe nga arbëreshët e Italisë.

Në Kongres Androkli Kostallari, drejtor i Institutit të Historisë e të Gjuhësisë, mbajti një referat kryesor me temë: *“Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme të drejtshkrimit të saj”* dhe rreth 180 kumtesa e diskutime, në të cilat u bë një rrahje e gjerë krijuese e pikëpamjeve shkencore për të gjitha çështjet e drejtshkrimit të shqipes. Kongresi i zhvilloi punimet mbi baza të shëndosha shkencore dhe në përputhje me fazën e sotme të zhvillimit të gjuhës letrare. Ai tregoi jo vetëm përparimet e arritura nga gjuhësia jonë në fushën e studimit të gjuhës letrare, por edhe karakterin e saj masiv, interesimin e vazhdueshëm për gjuhën të arsimtarëve, letrarëve, punonjësve të shtypit, të artit, të kulturës etj. Një kontribut të rëndësishëm dhanë në punimet e Kongresit edhe delegatët e të ftuarit nga shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe nga arbëreshët e Italisë. Në përfundim të punimeve Kongresi diskutoi dhe aprovoi njëzëri një rezolutë, e cila u nënshkrua nga tetëdhjetë e shtatë delegatët e Kongresit, dhe përbën kështu një dokument kombëtar historik. Në këtë rezolutë bëhet vlerësimi i gjendjes së sotme të gjuhës letrare shqipe, duke u theksuar se ajo sot funksionon si gjuha letrare e njësuar e gjithë popullit shqiptar, vihet në dukje se kjo arritje e madhe u detyrohet përpjekjeve të pareshtura të popullit tonë arsimdashës që nga Rilindja e këtej, e sidomos kushteve të reja shoqërore-historike që u krijuan pas çlirimit; më tej në rezolutë parashtrohen një varg kërkesash të Kongresit, në bazë të të cilave do të bëhet hartimi përfundimtar i *“Rregullave të drejtshkrimit të shqipes”* dhe u bëhet thirrje shkollës shqiptare, shkrimtarëve, institucioneve botuese, shtypit, enteve shtetërore, radio-televizionit, teatrit, kinematografisë etj., që ta përvetësojnë dhe ta zbatojnë me këmbëngulje drejtshkrimin e ri që do të hartohet në bazë të kësaj rezolute brenda vitit 1973.

Ky drejtshkrim do të jetë pa dyshim më konsekuent, më objektiv, më sistematik dhe më i thjeshtë se projekti i 1967-ës. Por nuk duhet të kemi iluzione se ai do të jetë fare i lehtë dhe se do të mësohet pa mundim. Drejtshkrimi është i lidhur me gjuhën dhe nuk mund të mësohet mirë po të mos mësohet mirë vetë gjuha. Prandaj sistemi i rregullave drejtshkrimore në tërësinë e tij nuk mund të përvetësohet plotësisht pa zotëruar mirë gramatikën. Shkrimi i drejtë i qindra dhe mijëra fjalëve varet nga njohja e mirë e funksioneve të tyre gramatikore. Kultura drejtshkrimore lidhet ngushtë me kulturën gjuhës dhe nuk mund të ndahet nga ajo. Kështu që njëkohësisht me zgjidhjen përfundimtare të çështjes së drejtshkrimit ne duhet të marrim të gjitha masat për ngritjen e përgjithshme të kulturës gjuhësore, duke u udhëhequr nga roli dhe rëndësia e gjuhës letrare për zhvillimin e jetës mendore dhe për forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

Para gjuhësisë shqiptare hapet një fushë e gjerë pune me rëndësi dhe përgjegjësi historike. Në rezolutën e Kongresit thuhet se në vitet e ardhshme duhet të hartohet Fjalori drejtshkrimor, Rregullat e drejtshkrimit, Rregullat e pikësimit dhe një varg librash për të çuar në masat rezultatet e studimeve shkencore në fushën e normës së gjuhës letrare, të cilat do të zgjerohen e njëkohësisht do të thellohen gjithnjë e më shumë. një rëndësi të madhe shoqërore merr tani edhe puna për hartimin e “Gramatikës së gjuhës letrare shqipe”.

Vlerësimi i lartë që i bëri shoku Enver Kongresit të Drejtshkrimit si një fitore e pallogaritshme në mes të aq fitoreve që ka korrur populli ynë me luftë, me përpjekje e me zotësi është një frymëzim i madh për punonjësit e gjuhësisë, të shkollës, të letërsisë e të shtypit shqiptar. Veçanërisht shkrimtarët e poetët tanë duhet të luajnë një rol edhe më madh se gjer tani për ta bërë gjuhën shqipe më të pasur, më të bukur, më shprehëse, për t’i dhënë një shkëlqim të ri këtij thesari të madh që populli e ruajti në shekuj si pjesë të pandarë të qenies së tij kombëtare.

HIDAJETE AZIZI**ANTROPONIMIA E SHQIPTARËVE TË
MAQEDONISË**

Antroponimia e shqiptarëve të Maqedonisë është e pasur dhe e llojllojshme. Emrat vetjakë, si: *Iliri, Teuta, Bardhi, Uka, Zoga, Pajtimi, Atdheu, Luftimja, Saranda, Kosovarja, Shqipëria, Dua, Arrita; Islami e Osmani, Kristiani, Niku e Mihali; Shkurta, Mjaftimja e Fundimja*, si dhe shumë të tjerë, paraqesin një ditar, ku shohim të dalin në sipërfaqe periudha kohore nga më të hershmet e deri te më të vonat, ku shohim të gërshetohen ngjarje, nga më të rëndësishmet e deri tek ato më pak të rëndësishme, nga më të mëdhatë e deri tek ato më të voglat. Aty shohim fate njerëzore, shohim të nxjerrin krye perandori, kultura e civilizime, besime e besëtytni, shohim të shpërfaqen edhe shije individuale e estetike, herë artistike e mbresëlënëse, herë edhe të çuditshme, por me vlerë për ata që janë përcaktuar për përdorimin e tyre. Se si do të vlerësoheshin në bazë të shijes estetike këta emra, si: *Lule, Dallëndyshe, Trëndelinë, Hënë, Keqe, Mbarime, Shkurte, Ymigjylsime, Gjylferije, Gjuzibe, Xhulasfije, Myzever, Seraxhedin* e të ngjashëm, mund të na thonë vetëm ata që kanë vendosur t'ua trashëgojnë më të dashurve të tyre këta emra.

Parashtrohet pyetja: sa është trajtuar kjo lëndë kaq e pasur dhe e larmishme? Duke konsultuar të arriturat studimore onomastike, ose më saktë ato të fushës së antroponimisë shqiptare për arealin e Maqedonisë, shohim se kjo lëndë, megjithëse mjaft e pasur e e larmishme, deri më sot nuk është trajtuar mjaftueshëm. Po qe se i anashkalojmë të arriturat e përgjithshme studimore në fushën e onomastikës për arealin e Maqedonisë, si ato për toponiminë, mikrotoponiminë etj., fusha këto të cilat megjithatë janë prekur pak a shumë nga dora e onomasticientit, mund të themi se të paktë janë artikujt që kanë trajtuar problematikën e antroponimisë, e edhe më të paktë punimet a monografitë,¹ që do të duhej të trajtonin më thellë këtë problematikë, si për rajone të veçanta të Maqedonisë të banuara me shqiptarë, ashtu edhe për tërësinë territoriale të saj. Po kaq të pakta janë edhe punimet që vënë në spikamë a prekin problematikën e patronimisë së këtyre viseve, sidomos problematikën që lidhet me etimologjinë e tyre, problematikë kjo, akoma më e ndërlikuar se sa çështjet antroponimike. Duke qenë gjendja e këtillë,

¹ Qemal Murati, *Emrat vetjakë mesjetarë të shqiptarët e Maqedonisë në dritën e defterëve turke të shekullit XV*, Jehona. 2-3 (1992):15; Asllan Hamiti, *Antroponimet e shqiptarëve të Maqedonisë*, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2007; Ramiz Abdyl, *Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve të shekullit XV-XVI*, Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup, 1994; Izmit Durmishi, *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit: Gostivar : Taulant, 2008 etj.*

hulumtimi në vijim ka për synim vetëm përmbledhjen dhe ngritjen e këtyre problemeve si teza apo çështje, të cilat presin të studiohen më thellë e të saktësohen në të ardhmen.

Një punë disavjeçare rreth çështjeve antroponimike e patronimike, vënia në pah e pasurisë, llojllojshmërisë dhe e mundësive të shumta fjalëformuese, strukturore dhe semantike të cilat e karakterizojnë onomastikën, përkatësisht antroponiminë e patroniminë e viseve të Maqedonisë të banuara me shqiptarë, ka nxjerrë në pah segmente të cilat do të konsiderohen të përbashkëta për tërë onomastikën shqiptare, përkatësisht segmente mbarëshqiptare, si bie fjala, praninë e elementit vendës në onomastikën e këtij rajoni, element ky i përbashkët për të gjitha trojet etnike shqiptare, si dhe segmente të cilat konsiderohen të veçanta për arealin e Maqedonisë, si bie fjala, ekzistencën e një numri jashtëzakonisht të madh të elementit oriental në antroponimi e patronimi, por edhe të elementit sllav në patronimi, element ky i cili tjetërsoi një numër të konsiderueshëm të patronimeve² shqiptare me anë të shtimit të prapashtesave sllave dhe i cili u shtresua si rezultat i ndërhyrjes shtetërore e administrative, për qëllime të caktuara, elemente këto të cilat dukshëm e dallojnë sistemin antroponimik të shqiptarëve të Maqedonisë nga sistemet e rajoneve të tjera, e sidomos nga ai i Shqipërisë.

Për të arritur deri te këto të dhëna, materiali antroponimik është përpunuar në dy rrafshet e studimit, në atë diakronik, i cili përfshin studimin e natyrës etimologjike, dhe në atë sinkronik, i cili përmbledh studimet e natyrës strukturore, përkatësisht dukuritë gjuhësore, fonetike-morfologjike e fjalëformuese si dhe studimet e natyrës semantike. Njëkohësisht është konsultuar edhe ligji për emrin vetjak në R. e Maqedonisë.

Materiali antroponimik, i cili është bërë objekt i studimit tonë, është vjelë në terren, kryesisht nga dokumente të shkruara.³ Për analizë, herë-herë është përdorur edhe material i mbledhur nga studiues të tjerë⁴ e më rrallë edhe material nga media dhe nga terreni, i fituar me anë të kontakteve të drejtpërdrejta me njerëz. Materiali i vjelë nga dokumente të shkruara i takon harkut kohor nga viti 1900⁵-2010 i cili është klasifikuar në pesë periudha (1900-1970; 1970-1980; 1980-1990; 1990-2000; 2000-2010) dhe i njëjti numëron 10 592 njësi antroponimike. Këto njësi antroponimike janë vjelë nga rajone urbane e rurale të një numri të madh të viseve të Maqedonisë të banuara me shqiptarë, për të dalë me një pasqyrë sa më të përgjithshme për antroponiminë e shqiptarëve të Maqedonisë dhe për ta krahasuar pastaj, me aq sa është e mundur, me antroponiminë e shqiptarëve të viseve të tjera jashtë territorit të Maqedonisë.

² Në këtë artikull do të trajtohen përmbledhtas vetëm çështjet antroponimike, ndërkaq ato patronimike, do të trajtohen në ndonjë artikull të radhës.

³ Nga libra amzë të të lindurve të zyrave të regjistrimeve civile, nga libra amzë të institucioneve shkollore etj.

⁴ Material nga defterë të regjistrimeve, kryesisht ato osmane, të cilat janë shfrytëzuar për të bërë krahasime me periudha më të hershme; material nga monografi të ndryshme të shkruara për rajone të ndryshme të Maqedonisë etj.

⁵ Atëherë edhe kur janë bërë regjistrimet e para administrative shtetërore nëpër libra amzë.

Pas konsultimit të ligjit për emrin vetjak në R. e Maqedonisë,⁶ kuptojmë se sistemi i emërimit këtu, ashtu si edhe në vendet e tjera, është i rregulluar juridikisht dhe i stabilizuar e i obliguar në përdorim zyrtar, me strukturë dypjesëshe të emërimit, pra emër dhe mbiemër. Ndër të tjera, është konstatuar edhe fakti se sot në R. e Maqedonisë ekziston liri dhe tolerancë në përzgjedhjen e emrit vetjak, për dallim nga disa periudha kohore në të kaluarën, sidomos në kohën e komunizmit, kur për shqiptarët e Maqedonisë ka pasur kufizime të natyrave të ndryshme për sa i përket përzgjedhjes së emrit vetjak, por edhe për sa i takon përdorimit të emrave toponomastikë. Por, liria në përzgjedhjen e emrit vetjak këtu në Maqedoni nuk nënkupton edhe liri të plotë gjatë procesit të regjistrimit të të sapolindurve. Me ligj, ata regjistrohen vetëm në gjuhën e administratës shtetërore, përkatësisht me alfabetin e gjuhës maqedonase, dhe jo edhe me alfabetin latin të gjuhëve të etnive të tjera. Ky rregull shkakton çrregullime e huti të mëdha. Emrat e shqiptarëve, të cilët përdorin alfabetin latin, shtrembërohen nga administrata maqedonase me përdorimin e alfabetit cirilik deri në atë shkallë, sa që emri i regjistruar nuk i ngjason aspak emrit origjinal për të cilin janë vendosur prindërit shqiptarë. Ja vetëm disa emra të tillë vetjakë të cilët kështu regjistrohen e lexohen nga ana e administratës shtetërore, emra këta të cilët sot e gjithë ditës i kemi të regjistruar në certifikatat tona të lindjes: *Bardul (Bardhyl)*, *Durate (Dhuratë)*, *Ill (Yll)*, *Engel (Engjëll)*, *Atde (Atdhe)*, *Ilke (Yllkë)*, *Ender (Ëndërr)* e të ngjashëm.

Marrë në përgjithësi, fondi antroponimik i vjelë në terren i shqiptarëve të Maqedonisë, paraqet jo vetëm dëshmi të jetës ekonomike, shoqërore e kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë, por, edhe një identitet shpirtëror që lidhet ngushtë me besimin fetar e me ndikimin e besëtytnive në periudha të caktuara. Dhe jo vetëm kaq. Ky fond, siç e thamë edhe më herët, nga njëra anë paraqet karakteristika të veçanta që lidhen me vendin ku jetojnë shqiptarët e Maqedonisë dhe me zhvillimet historike karakteristike për këtë vend, dhe nga ana tjetër, në vetvete gërsheton edhe emra vetjakë që janë karakteristikë për të gjithë shqiptarët në trojet e tyre etnike, pavarësisht kufijve të sotëm administrativë. Si i tillë, repertori i emrave vetjakë të shqiptarëve të Maqedonisë paraqet një katalog të emrave vetjakë të përdorur nëpër histori nga ana e shqiptarëve kudo që janë, ku shohim të kryqëzohet elementi shqiptar me atë të huajin, element ky i cili është mbishtresuar nga kultura, sundime e udhëheqje të ndryshme administrative dhe i cili, në fillim del në sipërfaqe përmes emrave fetarë të nomenklaturës katolike e ortodokse, për të vazhduar pastaj me ata të nomenklaturës islame, kurse aktualisht edhe me emra të huaj laikë e fetarë “modernë”. Karakteristikat të cilat mendojmë se mund të jenë të veçanta për fondin emëror të shqiptarëve të Maqedonisë dhe ato të cilat janë të përbashkëta me fondin emëror të arealit shqiptar në përgjithësi, dalin në pah më së miri përmes një kronologjie, sado e shkurtër dhe përmbledhëse, e vetë historisë së popullit shqiptar. Duke u mbështetur në këtë kronologji, është dhënë përmbledhtas edhe kronologjia

⁶ www.pravo.org.mk Zakon za licnoto ime. Sl. Vesnik na R. Makedonija, nr. 08/95, 15.02.1995

e emrave vetjakë të përdorur nga ana e shqiptarëve në trojet e tyre etnike, me ç' rast kemi klasifikuar katër periudha. Periudha e parë e cila përfshin ngjarje historike që nga kohërat më të lashta e deri në shekullin XX, përkatësisht deri në pavarësinë e Shqipërisë, është e vetmja periudhë e cila mund të thuhet se është e përbashkët për të gjithë shqiptarët kudo që janë në trojet e tyre etnike. Kontaktet e popullit shqiptar me pushtues të ndryshëm, udhëheqje administrative, me civilizime të ndryshme, popuj, kultura dhe gjuhë, bënë që antroponimia e shqiptarëve në këtë periudhë, përveç emrave shqiptarë a ilirë, si: *Bardh, Ukë, Fatmir, Kalosh, Mirash, Zoge* etj., të përfshijë edhe elementin e huaj të botës krishtere (nën ndikimin e sundimit e të udhëheqjes administrative të Perandorisë Romake e Bizantine), si: *Nikë, Pal, Gjergj, Tringë; Mihal, Ilija, Jorgo* etj., dhe të botës myslimane (nën ndikimin e sundimit e të udhëheqjes administrative të Perandorisë Osmane), si: *Abdullah, Musa, Jusuf, Ramadan, Hatixhe* etj., dhe atë me karakter laik, si: *Albert, Eduard, Elizabeta, Erda, Leonora* etj. Periudha e dytë përfshin ngjarje historike të gjysmës së parë të shekullit XX. Me mbetjen e territoreve të tëra shqiptare jashtë kufirit të sotëm administrativ të Shqipërisë, sistemi i përgjithshëm antroponimik i shqiptarëve, varësisht nga vendi ku jetojnë, merr kahe të ndryshme në ecurinë e zhvillimit të tij dhe krijon paradigmë të vetën duke u ndikuar nga situata të ndryshme shoqërore e politike që e përcjellin në rrjedhë të moteve. Në Shqipëri⁷, sistemi antroponimik, fillon të pastrohet nga fjalori i huaj (nënkuptojmë këtu sidomos emrat e huaj të burimit oriental), dhe të pasurohet me një hov më të madh me emra të brumit shqip, si: *Agim, Vullnet, Besnik, Gëzim, Dritë, Pranverë* e shumë të tjerë, nga njëra anë, ndërkohë që fillon të ndikohet, kuptohet në përmasa më të vogla, nga presioni politik e kulturor i Italisë gjatë viteve të 30-ta, me emra, si: *Anita, Nikolina* etj., dhe i Gjermanisë gjatë LDB-së, me emra, si: *Ingrid, Adolf, Fric, Frida* etj., nga ana tjetër. Në Kosovë, Maqedoni e gjetkë, ndikim të madh patën shtetet e mëvonshme sllave, sidomos me krijimin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, e më vonë edhe të Mbretërisë së Jugosllavisë, të cilat, më shumë se në fushat e tjera, lanë gjurmë në onomastikë në përgjithësi e në patronimi në veçanti, duke u shtuar këtyre në mënyrë të detyrueshme prapashtesat sllave *-iç, -viç* etj. Për shqiptarët e trojeve jashtë Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, fondi antroponimik del i ngarkuar tej mase me emra të huaj me karakter fetar, e sidomos me ato të botës orientale sepse përqindja më e madhe e popullatës në këto territore i takojnë besimit islam. Përderisa në Kosovë, sipas Sh. Sejdiut,⁸ edhe pse në numër jo shumë të madh, krijohen paradigma e sisteme onomastike të mbështetura mbi baza onomasiologjike nga hapësira shqiptare, nga e kaluara dhe e tashmja kombëtare, në Maqedoni vërehen lëvizje fare të vogla në drejtim të pastrimit të fondit emëror nga ndikimi oriental nga i cili, siç e thamë, ky fond na del i ngarkuar në masë të madhe. Sa për ilustrim, do të japim këto shifra të cilat dalin nga analiza e fondit të përgjithshëm emëror: nga 2789 emra vetjakë për tërë territorin e Maqedonisë, vetëm 294 emra dalin me burim të shqipes, ndërsa të tjerët, 2480, ose shprehur me

⁷ Gjovalin Shkurtaj, *Onomastikë e etnolinguistikë*. Tiranë: SHBLU, 2000, f. 244; Jusuf Shpuza, *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve*. Shkodër: Idromeno, 1998, f. 147

⁸ Shefki Sejdiu, *Sisteme strukrura raporte (Etnolinguistikë)*. Prishtinë: Era, 2002, f. 90

përçindje, rreth 98% e emrave, janë kryesisht me burim oriental, mbase, fetarisht të motivuar. Periudha e tretë përfshin harkun kohor nga gjysma e dytë e shekullit XX e deri në vitet e '90-ta. Në këtë periudhë, duke iu referuar të dhënave që jep J. Shpuza,⁹ në Shqipëri paraqiten dy dukuri. Dukuria e parë, sipas autorit në fjalë, ka të bëjë me izolimin nga Lindja e Perëndimi, dhe sidomos me izolimin ndaj fesë, me ç'rast lind një orientim drejt antroponimisë ilire, me emrat, si: *Genc, Brikena, Enkelejda* etj., që në vetvete paraqet luftën më të hapur kundër ideologjisë fetare¹⁰, si dhe një orientim drejt antroponimisë shqiptare, duke nxjerrë në dritë emra që paraqesin mbështetje ideore që lidhej me LNC-në: *Çlirim, Liri, Lirim, Fitor Partizan, Çetë, Proletar* etj., si dhe emra komunistë e socialistë, si: *Kushtetutë, Kongres, Marenglen, Fatos* etj. Dukuria tjetër ka të bëjë me orientimin drejt antroponimisë sllave, me emrat, si: *Aleksej, Tamara, Tanja, Natasha* etj., si fryt i miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Në Kosovë, gjithashtu vërehen dy orientime në procesin e emërvënies. Orientimi i parë, i cili lind si rrjedhojë e rrethanave politike shoqërore të krijuara në Kosovë, e me këtë, edhe e rritjes së lartë e ndërgjegjësimit kombëtar dhe ndikimit nga Shqipëria,¹¹ shkon drejt antroponimisë shqiptare me karakter kombëtar. Kjo antroponimi nënkupton sidomos emrat me origjinë topike të trevave të Shqipërisë të cilët nuk ishin të zakonshëm edhe për shqiptarët e Shqipërisë, si: *Vlora, Shkodran, Saranda, Milot, Korab, Shkëlzen, Tomor, Drin, Shkumbin, Vjosa, Valbona* e të ngjashme. Orientimi i dytë lidhet me komunizmin dhe proklamimin e bashkim-vëllazërimit nga ana e politikës Jugosllave, me emrat, si: *Fatos, Fadil* (për *Fadil Hoxhën*), *Enver* (për *Enver Hoxhën*), *Bashkim, Vllaznim* e të ngjashëm. Për dallim nga Kosova, në Maqedoni, përveç disa lëvizjeve të vogla që u bënë falë ndikimit nga Kosova e Shqipëria, që arrihej, ndër të tjera, edhe përmes Televizionit Shqiptar dhe arsimtarëve të ardhur nga Shqipëria menjëherë pas LDB-së, nuk vërehet ndonjë zhvillim që do të shënonte ngritje të ndërgjegjësimit onomastik të shqiptarët e Maqedonisë. Ndërkohë që sistemi antroponimik shqiptar vazhdon të karakterizohet me një mbingarkesë të elementit oriental, ku më të shpeshtë na dalin emra, si: *Ramadan, Bajram, Naim, Muhamed, Emine* e të ngjashëm. Një dukuri që ia vlen të përmendet në këtë periudhë për shqiptarët e Maqedonisë është censurimi i emrave kombëtarë shqiptarë, si: *Kushtrim, Liridon, Kastriot, Arbëresha, Alban, Albana, Valon, Shkodran* e të ngjashëm,¹² nga ana e administratës shtetërore me anë të ligjit¹³ për emrin personal.

⁹ Jusuf Shpuza, *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve*. Shkodër: Idromeno, 1998, f. 149

¹⁰ E që realizohej me anë të masave administrative që u ndërrmorën atë kohë gjatë regjistrimit të emrave vetjakë në zyrat e gjendjes civile, duke shfaqur një *Listë për zgjedhjen e emrit vetjak*, nga e cila ishin përjashtuar emrat me burim të huaj dhe sidomos ata të burimit oriental. Shih për këtë: Palok Daka, *'Emrat e njerëzve në gjuhën tonë'*, Gjuha jonë 1 (1981), f. 110 dhe Nebi Caka & Ali Caka, *'Motivimi i emërtimit të fëmijëve në Kosovë 1912-2008'*, Alb Shkenca Aktet, vol. III. 4 (2010), f. 555.

¹¹ Shefki Sejdiu, *vep. e cit.* f. 90

¹² Një të dhënë të tillë na e jep Qerim Lita, në: *'Pozita e shqiptarëve në RS të Maqedonisë gjatë viteve 1986-1988'*, Studime albanologjike 3 (2011), f. 74, marrë nga Arkivi Shtetëror i RM-së (ДАРМ -ДРЖАВЕН АХИВ НА РМ) 1.427.520.33/285-304, Закон за именување

Periudha e katërt, pas formimit të Maqedonisë së re, përkatësisht pas viteve të 90-ta, me rënien e komunizmit në Shqipëri e me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë e deri më sot, karakterizohet me një liri më të madhe në fushën e emërvënies. Në Shqipëri¹⁴, liria në fushën e emërvënies, hap rrugën e përdorimit të emrave të ndaluar në kohën e komunizmit, si të atyre me përmbajtje fetare, ashtu edhe të emrave të huaj evropianë e amerikanë, si: *Rihana, Xhoana, Kevin, Leonard, Dajana, Majkëll* etj. Si rezultat i kësaj, fondi emëror shqiptar në Shqipëri, sidomos viteve të fundit me emrat, si: *Amelia, Noemi, Melisa, Noel, Joel, Mateo* etj., krijon përshtypjen e një paradigme të një fondi të huaj, joshqiptar. Në Kosovë, situata shoqërore-politike bëri që fenomeni i emërvënies së fëmijëve të marrë kahe e karakter shumë më të ndryshëm nga ai i Shqipërisë. Këtu, më shumë se kudo në mjediset e tjera shqiptare, përfshirë edhe Maqedoninë, përdoren emrat shqiptarë dhe vijon, ajo që Gj. Shkurtaj¹⁵ e quan, ‘*moda atdhetare*’ e emrave vetjakë. Ndërkaq, në arealin e trojeve shqiptare të territorit të Maqedonisë, gjendja e tanishme e fondit emëror këtu, zbulon prezencën gjithnjë e më të madhe të emrave me burim nga shqipja, që do të thotë se gradualisht ka ardhur duke u rritur vetëdija kombëtare në lidhje me përdorimin e emrave vetjakë shqiptarë, por asnjëherë deri në atë nivel sa ka arritur, për shembull në Kosovë. Këtu, shqiptarët akoma vazhdojnë me të madhe të përdorin emra të burimit oriental, si: *Tuana, Kanita, Sara, Amra, Tiara* e shumë të tjerë, të cilët në të shumtën e rasteve konceptohen si emra *modernë* fetarë, edhe në raste kur semantika e tyre nuk ka asnjë pikë takimi me çështje fetare.

Studimet e rrafshit diakronik kanë nxjerrë në pah të dhënat se, emrat vetjakë që përdorin shqiptarët e Maqedonisë, ashtu si edhe shqiptarët e trojeve të tjera, sipas burimit a etimologjisë, i takojnë dy grupeve të mëdha: emra me burim të huaj dhe emra me burim nga shqipja. Përrjashtim bëjnë një numër shumë i vogël i emrave të cilët nuk kemi arritur t’ua shpjegojmë etimologjinë, e të cilët mbase mund të jenë edhe sajime të rastit, përngjitje fonemash a inicialesh e të cilët mund të jenë të motivuar nga situata të ndryshme të panjohura e të pashpjeguara nga ne.

и дополнување на Законот за личното име “Сл. Весник на СРМ“ бр. 41/85, ku thuhet: ‘*Në librin amzë të lindjes nuk mund të regjistrohet emri personal me të cilin nxitet urrejtja apo jotoleranca nacionale apo fetare apo me të cilin ofendohet morali publik*’. Në një dokument tjetër (ДАРМ. 1.427.515.16/300-331), thuhet: ‘... janë shfrytëzuar edhe forma perfide për manifestimin e nacionalizmit dhe seperatizmit shqiptar. Kështu për shembull me emërtimin e foshnjës së posalindur që asocion në qytete, male dhe lumenj të Shqipërisë (*Berat, Valon, Shkodran, Labinot*), në simbole nacionale (*Flamur, Shqipe*) dhe në heronj kombëtar (*Martanesh, Kastriot*), ndërsa hasen edhe kësi emrash: *Kushtrim, Liridon, Arbnesha-Arbëresha, Alban-a, të cilët nxisin nacionalizëm dhe në njëfarë mënyre i përshkruajnë ngjarjet dhe figurat karakteristike nga historia e Shqipërisë...*’.

¹³ Закон за именување и дополнување на Законот за личното име “Сл. Весник на СРМ“ бр. 41/85

¹⁴ Jusuf Shpuza, *vep. e cit.* f. 150

¹⁵ *Vep. e cit.* f. 245

Grupi i parë, më i madhi në numër,¹⁶ përfshin emrat me burim të huaj me karakter fetar. Pjesa dërmuese e tyre janë emra të nomenklaturës islame, si:¹⁷ *Muhamed, Fatime, Emine, Ramadan, Ismail, Ibrahim* etj., ndërsa pjesa tjetër e emrave, që në korpusin tonë të vjelë rezultoi me një numër tejet simbolik, janë emra të nomenklaturës kishtarë, si: *Anton, Ndue, Gjon, Hilë, Ndre, Jak, Nikollë* etj. Në grupin e emrave me burim të huaj hynë edhe emrat me karakter laik, të cilët, kundrejt emrave me karakter fetar, dalin me një përqindje bindshëm më të ulët dhe të njëjtë, herë konceptohen si emra që lidhen me botën e mitologjisë greke e romake, si: *Diana, Venera, Afërdita, Dion* etj., e herë edhe si emra modernë, të depërtuar nga jashtë, si: *Albert, Leonora, Adelina, Luiza, Edmond* e të ngjashëm.

Grupi i dytë i emrave vetjakë përfshin emrat me burim vendës. Në të vërtetë, këta janë emra vetjakë të cilët i takojmë në arealin e përgjithshëm truallsor të shqipërisë, brenda e jashtë territorit të Maqedonisë së sotme. Një pjesë e këtyre emrave kanë ruajtur edhe vijimësinë që nga koha ilire. Për këtë arsye, antroponimet me burim vendës janë klasifikuar më tutje në tri grupe: antroponime ilire, si: *Bardh, Dardan, Teuta, Shkodran, Ilir* etj.; antroponime të moçme shqiptare, si: *Kalosh, Mirash, Luli, Bukurie* etj.; dhe antroponime më të reja, të sajuara nga leksiku i sotëm i gjuhës shqipe, si: *Agim, Bekim, Meritë, Jetë* e të ngjashëm.

Studimet e rrafshit sinkronik kanë trajtuar semantikën e emrave vetjakë me burim nga shqipja. Këto studime kanë nxjerrë në pah se për nga kuptimi që kanë, emrat vetjakë me burim nga shqipja janë të larmishëm e të pasur. Është e natyrshme që semantika e tyre të lidhet me sfera të ndryshme të jetës materiale e shpirtërore të botës shqiptare në përgjithësi, e të botës së shqiptarëve të Maqedonisë, në veçanti. Vetë jeta, zhvillimi shoqëror, botëkuptimet si dhe shijet estetike të njerëzve të kësaj ane janë strumbullari e pjesë e pandashme e asaj që përbën semantikën e këtyre emrave.

Vatra semantike e numrit më të madh të tyre ka të bëjë sidomos me dëshirat e ndjenjat nga më të ndryshme të cilat shprehin prindërit kundrejt fëmijëve të tyre. Ndjenjat e gëzimit, lumturisë e haresë që shprehen me aktin e lindjes së fëmijës si dhe ndjenja e dashurisë për të, nga njëra anë, dhe ndjenjat lridashëse-patriotike, nga ana tjetër, janë më se të shpeshta në procesin e emërvënies. Ndërkaq që, dëshirat e shumta që shprehen me anë të emrave vetjakë dhe shpresat që shprehen nga ana e pagëzuesve kundrejt bartësve të këtyre emrave janë nga më të ndryshmet. Nga to dominojnë dëshira e shpresa për jetë të gjatë, të mirë e me fat, dëshira për përparim e arsim, për virtyte, për të bukurën si dhe dëshira për lindjen e fëmijëve meshkuj, në ato familje ku takojmë lindjen e njëpasnjëshme të vajzave. Sipas kësaj, pjesa dërmuese e emrave vetjakë rezultojnë të jenë emra përshkrues a dëshirorë, pra, emra me anë të të cilëve shprehen dëshirat e ndjenjat e prindërve,

¹⁶ Kjo, sa i takon arealit të përgjithshëm të Maqedonisë sepse nga rajoni në rajon gjendja ndryshon në përmasa të mëdha. Pra, se cilët emra do të dominojnë, ata me burim nga shqipja apo me burim të huaj, parasëgjithash, varet nga shtrirja rajonale si dhe nga shtrirja e tyre në zona rurale e urbane.

¹⁷ Po japim disa emra të cilët, sipas dendurisë së përdorimit, i prijnë listës së emrave të vjelë në terren.

përfshirë edhe ato kombëtare. Një numër më i vogël i fondit të përgjithshëm të emrave vetjakë mund të konceptohen edhe si emra besëtytnorë që lidhen me besimin se emri ka fuqi për të përcaktuar fatin e fëmijës, përkatësisht për ta mbrojtur atë nga forcat e këqija. Këtu te ne në Maqedoni, emrat besëtytnorë më shumë lidhen me besimin në fuqinë e emrit për të ndërprerë procesin e lindjes së njëpasnjëshme të foshnjave vajza në një familje, sesa me besimin për tu mbrojtur nga forcat e këqija.

Edhe sferat e leksikut, nga të cilat janë formuar emrat vetjakë që përdorin shqiptarët e Maqedonisë, janë të ndryshme. Ky leksik, (i përgjithshëm (konkret e abstrakt) e i përveçëm), te numri më i madh i emrave vetjakë lidhet me natyrën (dukuritë natyrore, florën, faunën, konfiguracionin etj.), me historinë kombëtare e gjeografinë shqiptare (toponime, hidronime, oronime, ojkonime) dhe me mitologjinë shqiptare e të huaj.

Nga të dhënat e parashtruara dhe nga informacionet e shumta të mbledhura në terren nga kontakte të drejtpërdrejta me njerëz, mund të supozohen edhe motivet më të shpeshta nga të cilat janë nisur përdoruesit e këtyre emrave, edhe pse, siç thotë edhe R. Ismajli,¹⁸ *akti i zgjedhjes së emrit është gjithmonë vetëm individual, psikologjik*. Pra, sa i takon motivimit, secili emër është rast i veçantë sepse një emër mund të ketë më shumë motivime dhe më shumë emra të ndryshëm mund të kenë vetëm një motivim të përbashkët. Prandaj, motivimi gjatë emërtimit shpeshherë mund të jetë edhe i panjohur. Megjithatë, vështrimet që dalin nga analiza e bërë tregojnë se ndër motivet bazë për përcaktimin e emrit të foshnjës në antroponiminë shqiptare të Maqedonisë është qëllimi që me anë të tyre të përcillet a të trashëgohet një identitet, qoftë ai fetar (përmes trashëgimisë së emrave fetarë), kombëtar (përmes trashëgimisë së emrave me karakter kombëtar) a familjar (përmes trashëgimisë së emrave të të parëve në zinxhirin familjar) e të cilat i kemi quajtur antroponime identitare; motivi që mbështetet në shijet individuale e që shpeshherë nënkuptojnë bukurtingëllimin, modën etj.; motivi që mbështetet në situata momentale; dhe së fundi, motivi besëtytnor. Nga të gjitha këto motive, në bazë të llojit të emrave që dominojnë në fondin e vjelë në terren, mendojmë se motivi fetar ka zënë vendin kryesor, megjithëse, nga periudha në periudhë ka humbur gjithnjë e më tepër rëndësinë e tij, por, për të mbizotëruar sërish në periudhën e fundit.

Rrafshi sinkronik, përveç tjerash, ka përmbledhur edhe studimet e natyrës gjuhësore, ato morfologjike e fjalëformuese dhe veçoritë fonetike-fonologjike të emrave vetjakë.

Nga pikëpamja e strukturës morfologjike, ashtu sikur edhe fjalët e leksikut të përgjithshëm të gjuhës shqipe, edhe antroponimet na paraqiten mjaft të larmishme. Nga analiza strukturore-morfologjike që iu bë korpusit të antroponimeve, dallojmë dy lloje të tyre: antroponime të thjeshta (në përbërjen e të cilave takojmë rrënjë nga më të ndryshme, si ato: emërore, mbiemërore, rrënjë të shprehur me pjesëz etj.), të cilave mund t'u shtohet ose jo edhe ndonjë morfemë

¹⁸ Rexhep Ismajli, *Gjuhë dhe etni, artikuj dhe ese*. Prishtinë: Rilindja, 1991, f. 403

ndajshesore trajtëformuese a fjalëformuese,¹⁹ dhe antroponime të përbëra (në përbërjen e të cilave takojmë dy morfema rrënjore të shprehura me emër, mbiemër, folje, ndajfolje etj.) të cilat, kundrejt antroponimeve të thjeshta, dalin me një numër dukshëm më të vogël.

Nga pikëpamja e strukturës fjalëformuese, përkatësisht mënyrës se si leksiku i përgjithshëm a apelativët kanë kaluar në kategorinë e emrave vetjakë, antroponimet janë klasifikuar në emra primarë dhe sekondarë. Për antroponime primare janë trajtuar emrat vetjakë të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë, si të gatshëm dhe pa pësuar ndryshime janë marrë nga fjalë të leksikut të përgjithshëm të gjuhës shqipe me të cilat shprehet një nocion, i cili në fakt paraqet një njësi leksiko-gramatikore. Sekondare janë trajtuar antroponimet që janë formime të reja e të cilët, si të tillë, nuk i gjejmë në fondin e leksikut të përgjithshëm të gjuhës shqipe si nocione a si njësi leksiko-gramatikore, d.m.th., që nuk janë marrë në mënyrë të drejtpërdrejt nga leksiku i përgjithshëm i gjuhës shqipe, por në mënyrë të tërthortë, ose me anë të ndërrimit të gjinisë a trajtës, ose me anë të krijimit të një ngjyrimi ekspresiv me anë të prapashtesave hipokoristike, ose edhe me anë të sajimeve të reja të cilat nuk gjejnë përputhshmëri me fjalë nga leksiku i përgjithshëm a me njësi leksiko-gramatikore me të cilat do të shprehej një nocion. Të njëjtit, formohen me anë të prejardhjes, duke u bashkangjitur prapashtesa të ndryshme ose me anë të përngjitjes a kompozimit, bashkimi i të cilave nuk krijon një nocion të ri në leksikon e përgjithshëm të gjuhës shqipe.²⁰

Edhe nga aspekti i veçorive fonetike-fonologjike të emrave vetjakë të shqiptarëve të Maqedonisë është konstatuar se fondi emëror në fjalë, përveç dukurive që përkojnë me normat e standardit të gjuhës shqipe, përmban edhe dukuri dialektore që përkojnë me të folmet vendore.²¹ Nga veçoritë fonetike e morfologjike që i karakterizojnë pjesën më të madhe të të folmeve të gegërishtes, përkatësisht arealin e gegërishtes qendrore e që përfshin pjesën dërrmuese të territorit të Maqedonisë, do të përmendim vetëm disa, si: rënien e [ë]-së së patheksuar në pozicion fundor: *Arijet (Arijetë)*, dhe në pjesën më të madhe në

¹⁹ Antroponimet e thjeshta të cilave u shtohen morfema ndajshesore fjalëformuese i kemi quajtur antroponime të prejardhura, të cilat na rezultojnë me numër bindshëm më të madh krahasuar me antroponimet e thjeshta pa morfema ndajshesore e me morfema ndajshesore trajtëformuese si dhe me antroponimet e përbëra.

²⁰ Për një klasifikim të tillë jemi mbështetur edhe në literaturën onomastike sllave ku një klasifikim i tillë është i zakonshëm. Shih për më tepër: Коробар-Белчева, Марија, *Деривација на македонските лични имиња*, ЛЗБ (1982,29/3 : 55-67), e cila mbështet sidomos mendimet e S. Rospond në *Struktura i klasifikacija slowianskih antroponimow*, Biullyn PTJ, XXIV (1962 : 211) sipas të cilëve emrat primarë janë emra të thjeshtë e të përbërë të ardhur nga apelativë, për të cilët mendohet se janë formime fillestare, ndërsa sekondarë janë emra që janë formuar nga emrat primarë.

²¹ Për ndarjen dialektore dhe karakteristikat me të cilat na dalin këto dialekte në gjuhën shqipe është konsultuar kjo literaturë: Z. Osmani, *E folmja shqipe e Manastirit dhe e qarkut të tij*, 1997; Z. Osmani, *E folmja shqipe e Prespës*, 1996; R. Nesimi, *E folmja e Dervenit (disertacion doktorate)*, 1988; H. Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, 1997 etj.

pozicion paratheksor: *Gzim (Gëzim)*; zh buzorëzimin e [y]-së në [i]: *Ilber (Ylber)*; buzorëzimin e [a]-së hundore në [o]: *Ekuron (Hekuran)*; afrikatizimin e mesgjuhoreve [q] dhe [gj]: *Çefajete, Xhytne (Qefajete, Gjyltene)*; asimilimin e grupeve [nd] dhe [mb] në [n], [m]: *Gazmen, Pllum (Gazmend, Pëllumb)*; monoftongimin e grupeve të zanoreve [ie] në [i]: *Mieser (Miser)*; shndërrimi i bashkëtingëllores [r] në pozicion ndërzanor në bashkëtingëlloren hundore [n]: *Dituni (Dituri)* e të tjera. Ndërsa, nga veçoritë me të cilat karakterizohen të folmet e toskërishtes, përkatësisht areali i toskërishtes veriore, do të përmendim shurdhimin e disa bashkëtingëlloreve, si: [b] në [p]: *Pëllump (Pëllumb)*; [z] në [s]: *Idris, Naslie (Idriz, Nazlie)*; [rr] në [r]: *Raim (Rrahim) etj.*

Nga aspekti i veçorive gramatikore-morfologjike është konstatuar se kategoria gramatikore e shquarsisë është ajo e cila paraqet lëkundjet më të mëdha sa i takon përdorimit të drejtë të emrave vetjakë. Një pjesë e mirë e emrave vetjakë, në rastet më të shpeshta, ata të gjinisë femërore që në të pashquarën mbarojnë me – ë të patheksuar, si: *Dritë, Vlerë, Jehonë* e të ngjashëm, në vend të trajtës së pashquar, ashtu siç do të duhej të përdroreshin në përputhje me rregullat gramatikore të gjuhës shqipe, përdoren në trajtën e shquar, si: *Drita, Vlera e Jehona*. Faktorët që kanë ndikuar në përdorimin e trajtës së shquar në vend të së pashquarës mund të jenë të shumtë e të natyrave të ndryshme, ndër të cilët po përmendim: faktorët e natyrës morfonologjike;²² semantika e emrave vetjakë;²³ administrata në gjuhë të huaj.²⁴

²² Si pasojë e dobësimit të ë-së së patheksuar, në përgjithësi në gjuhën shqipe, e veçmas e rënies së saj në pozicion fundor (dhe në pozicione të tjera) në gegërishte.

²³ Nëse kihet parasysh fakti që semantika e emrave vetjakë dallon nga semantika e emrave të përgjithshëm.

²⁴ Nënkuptomë këtu regjistrimin e emrave në certifikatat e lindjes i cili në administratën shtetërore realizohet vetëm në gjuhën maqedonase me alfabetin e saj cirilik, alfabet ky i cili nuk e mbulon ortografinë e gjuhës shqipe për shkak të mungesës së ë-së.

LITERATURA:

Abdyli, Ramiz. *Shqiptarët e Maqedonisë sipas të dhënave të defterëve të shekullit XV-XVI*, Shqiptarët e Maqedonisë. Shkup, 1994.

Caka, Nebi & Caka, Ali. *'Motivimi i emërimit të fëmijëve në Kosovë 1912-2008'*, Alb

Shkenca Aktet, vol. III. 4 (2010).

Daka, Palok. *'Emrat e njerëzve në gjuhën tonë'*, Gjuha jonë 1 (1981).

Durmishi, Izmit. *Vëzhgime gjuhësore mbi toponiminë dhe antroponiminë e Pollogut të Epërm të Gostivarit*, Gostivar: Taulant, 2008.

Hamiti, Asllan. *Antroponimet e shqiptarëve të Maqedonisë*, Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, USHT, 2007.

Ismajli, Rexhep. *Gjuhë dhe etni, artikuj dhe ese*. Prishtinë: Rilindja, 1991.

Коробар-Белчева, Марија, *Деривација на македонските лични имиња*, Лзб XXIX 3 (1982).

Lita, Qerim. *Pozita e shqiptarëve në RS të Maqedonisë gjatë viteve 1986-1988*, Studime albanologjike 3 (2011).

Murati, Qemal. *Emrat vetjakë mesjetarë te shqiptarët e Maqedonisë në dritën e defterëve turke të shekullit XV*, Jehona. 2-3 (1992).

Nesimi, Remzi. *E folmja e Dervenit (disertacioni doktorate)*, 1988.

Osmani, Zihni. *E folmja shqipe e Prespës*. Shkup: Flaka e vëllazërimit, 1996.

Osmani, Zihni. *E folmja shqipe e Manastiri dhe e qarkut të tij*. Shkup: Logos A, 1997.

Sejdiu, Shefki. *Sisteme struktura raporte (Etnolinguistikë)*. Prishtinë: Era, 2002.

Shkurtaj, Gjovalin. *Onomastikë e etnolinguistikë*. Tiranë: SHBLU, 2000.

Shpuza, Jusuf. *Vëzhgim për emrat familjarë të shqiptarëve*. Shkodër: Idromeno, 1998.

Ymeri, Haki. *E folmja shqipe e Karshiakës*. Shkup: Shkupi, 1997.

ARBEN HOXHA

PANTEIZMI: BAZAMENTI METAFIZIK I BALADËS “LULA E SHTATË VLLAZËNVE”

Abstrakt: Në këtë punim do të përpiqemi që ta shpjegojmë dhe argumentojmë bazën panteiste të strukturës përmbajtjesore të baladës “Lula e shtatë vllazënve”. Besa, si koncept, përbën një nga elementet konstituive të botëkuptimit panteist në baladën “Lula e shtatë vllazënve”.

Nëpërmjet disiplinës së antropologjisë sociale, besën në baladën shqiptare “Lula e shtatë vllazënve” do ta interpretojmë si kategori e të drejtës zakonore shqiptare, ndërsa përmes antropologjisë filozofike besën do ta trajtojmë si koncept që e përcakton qenien dhe pozitën e njeriut në raport me zotin dhe botën. Si kategori e drejtës zakonore shqiptare, besën do ta vështrojmë në përqsasje me përkufizimin që asaj i bën Kanuni i Lekë Dukagjinit, ndërsa si koncept botëkuptimor atë do ta vështrojmë në përqsasje me doktrinën panteizmit të lashtë dhe panteizmit të Spinozës, i cili (për shkak se është i përafërt me të parin) realitetin nuk e interpreton me konceptin e hyjnore ashtu siç e hasim në besimet monoteiste.

Në një kryqëzim të tillë qasjesh interdisiplinare do ta shpjegojmë *paradoksin e mundësisë* që vëllai i vogël, Halili, për së gjalli do ta shkelë besën e dhënë, ndërsa do ta përmbushë atë duke u ngritur për së vdekuri nga varri.

Në këtë punim përmes semiotikës do të përpiqemi të shpjegojmë kuptimet e simboleve dhe shenjave të veçanta, si: të shpirtit, të varrit, të Lules dhe të kalit, të cilat e mishërojnë vizionin panteist për botën në baladën shqiptare të ringjalljes “Lula e shtatë vllazënve”.

Fjalët çelës: balada, besa, panteizmi, substanca, Uniteti panteist, Njëshi teist etj.

Hyrje

Si dukuri universale me natyrë etno-morale dhe etnojuridike në jetën e popujve të shumtë të lashtësisë¹, besa, gjithashtu, është një nga përbërësit e rëndësishëm të strukturës etike dhe të së drejtës dokesore shqiptare. Besa është kod moral që e ka rregulluar rendin në familjen dhe shoqërinë tradicionale shqiptare pa autoritet shtetëror. Origjina e kultit të fjalës së dhënë, si përbërës i etikës dokesore

¹ Mark Tirta, *Etnologjia e shqiptarëve*, GEER, Tiranë, 2006, fq. 337

shqiptare, buron nga nevoja për solidaritet dhe ruajtje të rendit shoqëror në bashkësinë fisnore të paorganizuar në shtet².

Në baladën shqiptare me motivin e ringjalljes, besa përbën një nga përbërësit qendror të strukturës syzheike-kompozicionale, në të cilën mishërohet vetëdija për idenë e raportit të pandarë që ekziston midis trupit dhe shpirtit, jetës dhe vdekjes, përkohshmërisë dhe përjetësisë etj.

Besa është e pranishme edhe në baladën popullore “Lula e shtatë vllazënve”. Kjo baladë, është një variant i baladës me motivin e ringjalljes e mbledhur në Grudë, krahinë kjo në pjesën veriore të Shqipërisë. Studiuesi i poetikës së baladës shqiptare Sadri Fetiu, baladën “Lula e shtatë vllazënve” tipologjikisht e klasifikon si baladë të zonës epike, e cila në strukturën kompozicionale përmban shumë elementë të këngëve epike të ciklit të kreshnikëve, si rezultat i bashkëjetesës ndërmjet tyre në këto zona³.

Besa në baladën “Lula e shtatë vllazënve” shfaqet në ndërlidhje me kategorinë etike të hakmarrjes, të mirës dhe të keqes. Në baladën e ringjalljes “Lula e shtatë vllazënve”, besa shfaqet si një instrument i domosdoshëm etik dhe antropologjik, si një mjet që e krijon harmoninë midis trupit dhe shpirtit. Brenda bashkësisë (fisit, familjes), besa e vendos rendin social, përderisa në kontekstin kozmik, ajo e krijon balancën midis rendit të botës njerëzore me atë të botës së përtejme.

Nëpërmjet antropologjisë sociale dhe antropologjisë filozofike në punimin tonë do të bëjmë përpjekje që ta shpjegojmë fenomenin “paradoksal” të besës në baladën “Lula e shtatë vllazënve”, me ç’rast heroi, deri sa është gjallë, e shkelë besën, ndërsa pas vdekjes e përmbush atë duke u ngritur edhe nga varri.

Besa dhe pushteti

Si institucion ligjor në shoqërinë pa autoritet shtetëror, besa në shoqërinë shqiptare do ta përcaktojë autoritetin moral qoftë të individit qoftë të fisit. Besa do ta përcaktojë autoritetin moral të individit si dhe do ta bëjë të cenueshëm autoritetin që e shpërfill atë.

Antropologu i politikës Pierre Clastres, në veprën e tij “Shoqëria kundër shtetit” e bën dallimin në mes të raportit që ka fjala me pushtetin në shoqëritë që i nënshtrohen autoritetit shtetëror dhe raportit të fjalës me pushtetin në shoqëritë pa autoritet shtetëror. Ai konstaton se:

“Nëse në rastin e shoqërive me shtet, fjala është *një e drejtë* që zotëron pushteti, te shoqëritë pa shtet, përkundrazi fjala është *një detyrë* që i takon pushtetit...shoqëritë indiane nuk i njohin të drejtën e fjalës prijësit ngaqë se është prijës: ato kërkojnë dhe presin nga njeriu që pritet të ketë pushtetin, që ky të japë prova të aftësisë për të zotëruar fjalët.”⁴

²Mark Tirta, *Po aty*, fq.337.

³ Sadri Fetiu, *Poetika e baladës popullore shqiptare*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987, fq.97.

⁴ Pierre Clastres: *Shoqëria kundër shtetit: kërkime në antropologji politike* (përkthyer nga frengjishtja: Orgest Azizi, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2014, fq. 182-183.

Kanuni i Lekë Dukagjinit⁵ duke qenë tërësi normash juridike për rregullimin dhe organizmin e shoqërisë shqiptare në gjendjen pa shtet, të drejtën e pushtetit të fjalës së dhënë do t'ia atribuojë mbizotërueshëm gjinisë mashkullore. Në të vërtetë sipas Kanunit, fëmijët dhe gratë janë të privuar prej të drejtës për të dhënë fjalën. Në Nenin 561 të Kreut 92-të të Librit të 6-të të Kanunit të Lekë Dukagjinit shprehimisht thuhet:

“Prej çdo beje granija e fmija janë të jashtuem prej kanunit”.⁶

Një ligj i tillë zakonor, që e përjashton gruan nga e drejta për të dhënë fjalën, është materializuar edhe në baladat shqiptare që për motiv kanë *besën*. Në baladën “Lula e shtatë vllaznëve”, besa del si një detyrë e zotimit dhe e përmbushjes që i takon pushtetit mashkullor. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit vajza nuk ka të drejtë të mendojë për martesën e vet. Të drejtën për të vendosur për martesën e saj, në rast se ajo nuk i ka prindërit, e kanë vëllezërit dhe kushërinjtë e saj.

“Vajza, edhe në mos pasët prindt, ajo s’ka tager (të drejtë – A. H.)me mendue per martesë te vet, tagri asht në dorë të vllazenve a të kushrijve”⁷.

Mospërmbushja e zotimit të dhënë nga ana e përgjegjësve të së drejtës për ta dhënë fjalën, manifestohet si fatalitet për tërë bashkësinë familjare.

Në baladën “Lula e shtatë vllaznëve”, të shtatë vëllezërit besatohen para të vetmes motër se nuk do ta martojnë, dhe se ajo do të jetojë gjithnjë pranë tyre. Në rrethanat kur kryefamiljari është i vdekur, janë vëllezërit e Lules që e kanë pushtetin për ta dhënë fjalën për martesën e saj ose jo. Lulja do ta njohë pushtetin e fjalës së dhënë të vëllezërve të saj dhe do t’i bindet atij pushteti, sado që edhe ajo më shumë është e interesuar që të jetë e rrethuar me përkushtimin dhe dashurinë vëllazërore se sa të martohet. Megjithatë, në momentin e shkeljes së fjalës së dhënë nga vëllai i vogël Halili, i cili, pa dijeninë dhe miratimin e vëllezërve të tjerë, mikut të ri të sapo njohur, Allaj Begut, i premtun se do t’ia japë për nuse të motrën, Lulja do ta shfaqë mospajtimin. Besthyerja e Halilit përbën momentin e “fajit tragjik” – si përbërës i kategorisë tragjike të baladës – i cili shkaktohet nga përplasje antagonistike ndërmjet lirisë individuale dhe domosdoshmërisë të drejtës zakonore: midis dëshirës subjektive të heroit tragjik, Halilit, për të pasur miqësi me një familje të pasur e të fuqishme, dhe të drejtës zakonore, e cila nuk e parasheh në asnjë rrethanë mundësinë e dhënies së fjalës për martesë të bijës së shtëpisë pa mesitni (ndërmjetësues) dhe jashtë shtëpisë. Hyrja e heroit në një zonë të tillë të konfliktit e bënë të pashmangshme tragjedinë.

⁵ Kanunin e Lekë Dukagjinit përbën tërësinë e normave juridike të pashkruara të së drejtës zakonore të shqiptarëve, që janë përcjell në traditën gojore të malësorëve dhe janë mbledhura drejtpërdrejtë nga goja e popullit nga At Shtjefën Gjeçovi në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Kanuni i Lekë Dukagjinit përmban 12 libra, 24, krerë, 199 nene dhe 1263 paragraf.

⁶ Shtjefën Gjeçovi, *Vepra I, Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (përgatitur nga Ramiz Kelmendi dhe Faheredin Gunga), Rilindja, Prishtinë, 1985, fq.106.

⁷ Shtjefën Gjeçovi, *Po aty*, fq. 55.

Me t'u kthyer në shtëpi, Halili i njofton vëllezërit se ia ka dhënë fjalën mikut të ri për martesën e tij me të motrën, dhe për pasojë, ai i vë në dijeni ata se e ka shkelur besën që i kanë dhënë njëri tjetrit për të mos e martuar atë. Vëllezërit janë të vetëdijshëm për pasojat e besës së shkelur:

“ – Mo, Halilo, keq paske punua! / po ti Lulën si na e ke fejua, / po si don, ti Lulën m'e martua, / po ti a e din se ç'besë i kem pa dhanë? / Ka m'na vra ne besa ç'i kem dhanë / lot' e Lulës kanë me na ranua, / as n'at jetë rahat s'kanë me na lanë. ”⁸

Megjithatë, për t'iu shmangur rreziqeve që dalin nga detyrimet që bart besa e dhënë kundrejt të huajit (Allaj Begut), të gjashtë vëllezërit më të mëdhenj, në mënyrë pragmatike, do t'i pranojnë arsyetimet e vëllait të tyre të vogël, Halilit, sipas të cilit Lulja duhet martuar sepse është dhënë në derë të fisshme dhe se jeta e saj në martesë do të jetë pa brenga.

Por, të njëjtat arsyetime nuk vlejnë për Lulen. Për Lulen besa e shkelur nuk mund të arsyetohet ,me faktin se ajo do t'i sjellë siguri dhe mirëqenie personale në jetën e saj. Lulja, me të kuptuar shkeljen e besës, i mallkon të gjithë vëllezërit, e edhe nënën e saj.

“A imen, vllazën, më keni fejua?.../ Po ju a dini ç'besë ç'i m'kini pa dhanë? Ju vraftë besa ç'i m'kini pa dhanë! / Po ju vrfatë hyzmeti ç'i u kam ba! /...Qysh sahatit, thot-o, ç'i u largosha, sarillëkun zoti po ua çoftë, / për i sahat tanë, vllazën ju maroshit! / Po edhe nanës syt-o ju qorrofshin...”⁹

Pra, Lula nuk i nënshtrohet pakusht dhe pafundësisht pushtetit të fjalës së dhënë të vëllezërve të saj. Ajo tregohet e pakursyer ndaj tyre në momentin kur ata japin prova të mjaftueshme kundrejt saj se nuk janë të aftë për ta zotëruar fjalën dhënë. Ata, në sy të saj, e humbin autoritetin. Ajo i mallkon me mortajë. Dhe te zhveshur nga mburoja e autoritetit, tashmë të rrënuar, ata të gjithë vdesin. Besa e shkelur e prishë ekuilibrin e rendit familjar (fisnor) deri në asgjësim të plotë.

Si është e mundur që një mallkimi i Lules të përmbushet dhe të bëhet aq lehtë dhe aq shpejtë realitet? A mos kemi të bëjë me ndonjë fuqi misterioze, mbinjerëzore të Lules?

Besa dhe mallkimi

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, i cili përbën tërësinë e normave juridike të pashkruara të së drejtës zakonore të shqiptarëve, një vend të rëndësishëm së veçantë zë edhe besa. Libri i gjashtë i Kanunit për temë ka fjalën e dhënë, prandaj edhe është emërtuar “Fjala e gojës”¹⁰. Koncepti i besës dhe koncepti i “fjalës së dhënë” këtu nuk dalin të veçuar, por reciprokisht janë të lidhur mes tyre. Në Librin e Dhjetë, Kreu 122, Neni 854 të Kanunit të Lekë Dukagjinit, Besa përkufizohet si më poshtë:

⁸ *Balada dhe legjenda*, (përgatitur nga Anton Çetta), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972, fq. 27

⁹ *Balada dhe legjenda*, *Po aty*, fq. 28.

¹⁰ Shtjefën Gjeçovi, *Vepra I, Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (përgatitur nga Ramiz Kelmendi dhe Faheredin Gunga), Rilindja, Prishtinë, 1985, fq.103-108.

“Besa është një vade lirije e sigurimi, qi shpija e të vramit i ep dorërasit e shpijarvet të tij, tuj mos i ndejkë për gjak përkohsisht e mje në vade të caktueme”¹¹.

Në këtë përkufizim, besa trajtohet si kategori e “detyrimit juridik” në ndërlidhje reciproke me kategorinë e gjakmarrjes në shoqërinë shqiptare pa autoritet shtetëror; ndërsa në kontekstin e baladës që e kemi për objekt interpretimi, besa trajtohet si kategori e së “drejtës morale” në ndërlidhje reciproke me fjalën e dhënë. Në aspektin formal të procedurës zakonore, në rastin e parë, besa është detyrim sanksionuese si *rrjedhim (pasojë)* e aktit të gjakmarrjes, ndërsa në rastin e dytë, besa del si *shkak* i prishjes së detyrimeve morale të marra nga palët, të cilat, për pasojë, mund të riparohen vetëm pas veprimeve sanksionuese zakonore.

Studiuesi japonez Kazuhiko Yamamoto duke bërë fjalë për konceptin e besës në etikën e shoqërisë homerike përveçon tri modele të besës: modeli i parë është *mbajtja e premtimit të dhënë*; modeli i dytë është *betimi për të dhënë të vërtetën*; dhe modeli i tretë është *betimi që siguron tërësisht mbajtjen apo përmbushjen e premtimit të dhënë*¹².

Në Librin e gjashtë me titull “Fjala e gojes” të Kanunit të Lekë Dukagjinit, fjala e dhënë, betimi, besa, si kategori e të drejtës morale, përmban dy aspekte kategoriale : “ a) aspektin premtues - thirrja në Perëndinë për dëshmi të së vërtetës, dhe b) aspektin ndëshkues – nënshtrimi rëndues i mohuesit të premtimit (betimit të dhënë) me ndëshkim të përjetshëm.

“Beja e Shqiptarit ka dy punë para sysh: a) thret Perendin në dishmi të së vërtetës; b) i nënshtrorhet randimit të ndëshkimeve të përjetshme e gjobes së kohshme kah kanuja”¹³

Në aspektin e saj të parë, Perëndia shfaqet si instancë me e lartë garantuese, disiplinuese për fjalëdhënësin dhe fjalën e dhënë, ndërsa në aspektin e saj të dytë del si fuqi ndëshkuese e mohuesit të fjalës së dhënë. Perëndia si dëshmitare, është garantuese e premtimit të dhënë si dhe bartëse e ndëshkimit për fjalën e shkelur. Njeriu që e jep besën, njeriu që e jep fjalën për diçka, ai merr veçori hyjnore, hyjnohet dhe, në të kundërtën, kur e shkel fjalën e dhënë ai, e humbë hyjnimin, dëmtohet si qenie njerëzore¹⁴. Pushteti hyjnor dhe pushteti i fjalës së dhënë na del të jetë i pandashëm.

Për mos përmbushjen e premtimit, Kanuni i Lekë Dukagjinit dallon dy tipa ndëshkimi: ndëshkimin hyjnor “ndëshkimin e përjetshëm”, metafizik, dhe ndëshkimin juridik zakonor “gjobën” sipas dëmit të shkaktuar që parasheh Kanuni.

¹¹ *Po aty*, fq. 127.

¹² Prof. Dr. Kazuhiko Yamamoto, “Struktura etike e shoqërisë homerike”, në *Gjurmime albanologjike (seria Folklor&Etnologji)*, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2004, nr.31-2001, fq. 55.

¹³ Shtjefën Gjeçovi, *Vepra 1, Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (përgatitur nga Ramiz Kelmendi dhe Faheredin Gunga), Rilindja, Prishtinë, 1985, fq.104.

¹⁴ Kazuhiko Yamamoto, “Struktura etike e kanunit: a e përbën ai formën fillestare në shoqërinë njerëzore”, në *Gjurmime Albanologjike (seria Folklor&Etnologji)*, Nr. 37/2007, Prishtinë, 2008, fq. 72.

Të shtatë vëllezërit vendosen në situatën dramatike të zgjedhjes ekzistencialiste: të përballen me mallkimin e të motrës, apo me kërcënimin për hakmarrje që mund të vijë nga një person i fuqishëm, siç është Allaj Begu, në qoftë se do ta shkelnin besën kundrejt tij? Pra, ata janë përballë ndëshkimit juridiko-zakonor – gjobës, dhe “ndëshkimit të përjetshëm” - ndëshkimit hyjnor. Duke iu shmangur ndëshkimit me “gjobë” që parashikon kanuni për besën eventuale të shkelur kundrejt Allaj Begut, ata do të bien “në grackën” e hakmarrjes së perëndisë që nxitet nga mallkimi i Lules kundrejt tyre dhe nënës së saj. Mallkimi i Lules është paralajmërimi i perëndisë për aktin e hakmarrjes që do të pasojë. Mallkimi është paralajmërimi i ndëshkimit metafizik që do të pësojë në familjen e Lules.

“(I) gjysë sahati, tha, (krushqit) nuk kjenë largua, / ah ç’hyqmet zoti ki pa punua! / Nama e Lulës vllaznëve u ka ra - / sarillëkun (murtajën) zoti ua ki çua, / per i sahat janë dekë e marua, po edhe nans sytë i janë qorrua, /qysh se djemt në vorr- o ja kanë mlua”¹⁵

Harku kohor nga momenti kur Lulja e shqipton mallkimin deri te përmbushja tij nga ana e zotit, është një orë. Lulja është e vetëdijshme për mallkimin që e shqipton me gojë të vetë, por jo edhe për përmbushjen e tij që realizohet përmes veprimit të zotit. Bile, Lulja pasi ta kuptojë përmbushjen e mallkimit të saj, nga dëshpërimi dhe dhembja, në fund të baladës, bashkë me nënën e saj, vdes mbi varret e vëllezërve të saj.

A do të thotë kjo se fabula e baladës nuk është strukturuar mbi një linjë të drejtë logjike shkak-pasojë të situatave dhe veprimeve të personazheve? A mos ka ndonjë raport alogjik në mes të asaj që mendohet përmes personazhit dhe asaj që jepet si veprim i zotit? Si është e mundur që Lulja të mallkojë pa besimin se zoti me veprimin e tij do ta përmbush mallkimin e saj? Si është e mundur përgjigjja aq e shpejtë e zotit për ta përmbushur mallkimin e Lules?

Zotërimi i këtyre pyetjeve do të ishte i pamundur sikur ato t’i vështronim në partikularitetin e situatave dhe jashtë kuadri universal botëkuptimor në të cilat ato partikularitete bazohen dhe marrin orientim. Për këtë arsye konsiderojmë se një kuadër i qëndrueshëm teorik-konceptual panteist për rolin e besës në krijimin e raportit të njeriut me botën dhe me zotin mund të na japë një shpjegim të qëndrueshëm për ekzistencën e koherencës së tërësisë së koncepteve, të situatave, të arsytimeve, të mendimeve, të veprimeve dhe pasojave që u vijnë personazheve nga shkelja e besës në baladën “Lula e shtatë vllazënve”.

Botëkuptimi panteist

Mallkimi i Lules dhe drejtësia e vendosur nga zoti, nuk janë dy gjëra të ndryshme dhe të palidhura njëra me tjetrën. Përkundrazi, ato janë dy mënyra të shfaqjes së Zotit.

Pse themi kështu?

¹⁵ *Balada dhe legjenda*, (përgatitur nga Anton Çetta), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972, fq.29.

Në baladën “Lula e shtatë vllazënve” ndëshkimi për besën e shkelur nuk vjen nga zoti që bazohet në konceptin teist “Perëndia person”, ku perëndia është transcendentë e botës, siç ndodhë në besimet monotesite. Ndëshkimi për besën e shkelur në baladën shqiptare nuk bazohet as në konceptin e Dekartit për realitetin që përbëhet nga dy Substanca të ndryshme, “gjë kjo që atë e çoi më tej në pohimin e dualizmit mendje- trup”¹⁶, dhe në fuqizimin e subjektit, si faktor thelbësor në njohjen e botës. Në baladë, natyra njerëzore jepet si modus i zotit dhe pjesë e ligjeve të natyrës. Ngjarjet, veprimet dhe raportet mes personazheve nuk përcaktohen nga vetëdija e subjektit, por nga kushtet edhe marrëdhëniet që ai ka me natyrën e tij, me botën dhe me zotin. Prandaj, mund të themi se logjika kontradiktore e situatave, e përjetimeve, e veprimeve dhe marrëdhënieve të personazheve me zotin që përmban balada “Lula e shtatë vllazënve” nuk mund të zotërohet përmes “këndvështrimit të subjektit” karteziqan, por përmes “këndvështrimit të zotit”, si subjekt i vetëm mendues.

Pse themi kështu?

Në baladën “Lula e shtatë vllazënve” raportet e njeriut me botën dhe zotin janë ndërtuar mbi bazën e konceptit monist-panteist të uniteti të zotit me kozmosin. Ky unitet – në baladën që kemi si objekt trajtimi – materializohet përmes tipit të identitetit ontologjik dhe atij dialektik apo identitetit në ndryshim, ku zoti është njëkohësisht identik dhe i ndryshëm me natyrën, kozmosin¹⁷. Sipas Michael Levine, “Njëshi” monist-teist nuk është ekuivalent me Unitetit panteist¹⁸. Në rastin e parë rendi i gjërave bazohet në konceptin e zotit si Njësh, i cili është esencë transcendentale jashtë dhe kundruall botës. Ndërsa në rastin e dytë rendi i gjërave bazohet në konceptin e *unitetit të transcendentës dhe imanentes*. Në baladën “Lula e shtatë vllazënve” ndëshkimi vjen nga zoti i konceptit panteist, e cili nuk ka ndonjë dallim ontologjik nga bota dhe gjërat në të, sepse ai nuk është jashtë tyre, por esencialisht është në to dhe përmes tyre. Në baladën “Lula e shtatë vllazënve”, zoti nuk e përfaqëson “Njëshin” monist-teist, por “Unitetin panteist”, i cili e njëson lutjen e Lules me besën e Halilit; e njëson jetën e të gjallëve me atë të të vdekurve; e njëson transcendentën me imanenten.

Një koncept të tillë pantesit, antiskolastik, që shpreh idenë e unitetit të perëndisë me botën, e hasim edhe te Gjordano Bruno. Bruno, në njërën anë, zotin e koncepton *si parim të parë*, për shkak se çdo gjë vjen prej tij dhe, nga ana tjetër, *si shkak* sepse të gjitha gjëra ndryshojnë prej tij¹⁹.

Në këtë linjë antiskolastike të të menduarit panteist për raportin e zotit me botën, të transcendentës dhe imanentes, qëndron fuqishëm Spinoza.

¹⁶ Samuel Enoch Stumpf, *Filozofia: Historia&Problemet*, (Përktheu: Kastriot Myftiu dhe Paqsor Shehu), Teoena, Tiranë,

¹⁷ <http://plato.stanford.edu/entries/pantheism/>

¹⁸ Michael P. Levine, *Pantheism: A non-theistic concept of deity*, ROUTLEDGE, London New York, 2003, fq. 85.

¹⁹ Gjordano Bruno, *Optimizmi i mendimit të lirë*, (përkth. Vehap Shita,) Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 80

“Gjërat e përveçme nuk janë gjë tjetër veçse afektive të attributeve të Zotit, thënë ndryshe, modose përmes të cilëve atributet e Zotit shprehen në një mënyrë të përpiktë dhe të determinuar”²⁰

Lulja nuk është e vetëdijshme se mallkimi mund të përmbushet nga zoti, dhe atë në një kohë shumë të shpejtë. Paradoksit midis mallkimit të Lules dhe vuajtjes së rëndë që asaj i shkakton përmbushja e tij nga zoti, pa dijeninë dhe kundër dëshirës së saj, konsiderojmë se mund të ndriçohet me anë të konceptit panteist për raportin midis *ekzistencës* dhe *esencës* së zotit, dhe konceptit emotivist për të mirën dhe të keqen si kategori morale.

Raporti midis ekzistencës dhe esencës së zotit

Dallimin midis konceptit teist dhe atij panteist për raportin e zotit me botën qëndron në atë se konceptit teist skolastik *ekzistencën* dhe *esencën* e Zotit i trajton si kategori të veçuara dhe të ndryshme nga njëra tjetra. Ndërkaq, koncepti panteist këto kategori i trajton të pandara.

Spinoza, si një nga filozofët që mbanë lidhje me të përafërta me panteizmin e lashtë, konstaton:

“Ekzistenca dhe esenca e Zotit janë e njëjta gjë” (Etika, Pjesa I, Parashtr. XX).²¹

Qëndrimi ndaj marrëdhënies ontologjike të dimensionit të *ekzistencës* dhe të *esencës* e përcakton karakterin “hyjnor” apo “johyjnor” të zotit, të qeni e tij transcendentë apo immanentë, të qenit “i mirë” apo “i keq” etj.

Në konceptin e panteizmit spinozist, i cili tipologjikisht dhe përmbajtësish qëndron më afër panteizmi të lashtë, mendimi është atribut i zotit. Në kontekstin e baladës “Lula e shtatë vllazënve”, mund të themi se mallkimi i Lules është modus i të menduarit ose trajtë e afektit shpirtëror të saj që vjen nga “qenia menduese” - zoti. Zoti është gjë menduese dhe esencë e tij.

“Fuqi e zotit është vetë esenca e tij” (Etika I, Parashtr. XXXIV, fq. 45).

Si esencë, ai nuk mund t’i takojë qenies njerëzore, në rastin tonë, ai nuk mund t’i takojë Lules. Pse? Sepse ajo në atë mënyrë do ta shfaqej si esencës që e bart ekzistencën e zotit, si një entitet që e posedon qenien e substancës, gjë e cila atë do ta bënte të pa ndryshueshme dhe jo afektiv, pra do ta bënte qenie të ndërgjegjshme. Spinoza thotë:

“Esencës së njeriut nuk i përket qenia e substancës...” (Etika II, Parashtrimi X, fq. 64).

Po ta posedonte “qenien e substancës”, Lulja do të ishte e vetëdijshme për mallkimin dhe për ndëshkimin që do ta pësojnë vëllezërit e saj. Për rrjedhojë, logjikisht, si qenie e vetëdijshme, ajo nuk do të duhej të shfaqte as ndonjë lloj dhembje, e aq më pak që të vdiste nga trishtimi mbi varret e të vëllezërve.

Ekzistenca e dhe esenca e zotit, sipas Spinozës shfaqet përmes dy attributeve: *atributit të mendimit* (Etika, II, Parashtr. I.)²² dhe *atributit të shtrirjes*

²⁰ Spinoza, *Etika: demonstruar sipas rendit gjeometrik*, (përkth. Dritan Karadaku), Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 34.

²¹ Po aty, fq. 30.

(Etika, Pjesa II, Parasht. II.)²³. Mallkimi dhe dënimi i vëllezërve të Lules, sado që fillimisht duken si gjëra të përvetme, megjithatë ato përbëjnë dy shkallë modifikuese të shfaqjes së esencës së Zotit. Mallkimi i Lules, si modus, është afektim i substancës apo i zotit, e cila nuk është në vetvete të Lulja, por është tek substanca dhe konceptohet prej saj. Në terma të Spinozës, mallkimi i Lules është shfaqja e esencës së Zotit përmes *atributit të mendimit*, ndërsa vdekja e vëllezërve të Lules, është shfaqja e esencës së Zotit përmes *atributit të shtrirjes*.

Marrëdhënia e besës me të mirën dhe të keqen

Përkundër botëkuptimit monist-teist, ku “Njëshi” është i përsosur, pakundërti dhe pakundërthënie brenda vetes, “Uniteti panteist” konsiston në idenë e përfshirjes brenda vetes të tendencave të ndryshme që janë në kundërti njëra me tjetrën: si e mira – e keqja; jeta – vdekja; transcendenca- imanenca; bukura – e shëmtuara etj. Në filozofinë morale panteiste një veprim "i keq" konsiderohet ai që shkakton çarjen e “Uniteti hyjnor”²⁴, ndërsa e mira konsiston në të kuptuarit dhe në të bërit të çdo gjëje të drejtë që i shërben ruajtjes së Unitetit. Njeriu, si pjesë përbërëse e “Uniteti panteist”, ka rol të rëndësishëm në shkatërrimin apo në vendosjen e baraspeshës së kundërtive brenda “unitetit”. Njeriu, në botëkuptimin panteist, është element që merr pjesë në raportin që zoti vendos me kozmosin sipas logjikës së identitetit ose sipas logjikës së ndryshimit.

Parimi i uniteti të zotit dhe të botës si dhe vlerës së perceptuar të universit në baladën “Lula e shtatë vllaznëve” bazohen në tipin e modelit ontologjik e natyralist. Në këtë model ligjet e veprimit të zotit me ligjet e natyrës janë të njëjta. Zoti si parim dhe shkak i gjërave, në bazë të konceptit panteist, është realitet imanent dhe gjithëpërfshirës

Se a do t'i nënshtrohet logjikës së identitetit apo logjikës së ndryshimit raporti i zotit me kozmosin, një gjë e tillë në baladën “Lula e shtatë vllaznëve” del të përcaktohet prej marrëdhënies që njeriu (bashkësia njerëzore) do ta ketë me besën, si e mirë që e ruan Unitetin hyjnor apo e prishë atë.

Në baladën “Lula e shtatë vllaznëve”, zoti shfaqet në besë dhe në procesin e përmbushjes së besës. Besa në baladën shqiptare të ringjalljes, është një kategori morale që buron jo nga botëkuptimi i etikës utilitariste, por nga botëkuptimi emotivist (e assesit utilitarist) i etikës panteiste- moniste. Pse themi kështu?

Spinoza konsideron se virtyti, për aq sa lidhet me njeriun, ai është esenca apo natyra e njeriut. (Etika, IV, Përkufiz. VIII). Sipas tij, e mirë është ajo gjë që e ndihmon ekzistencën tonë (në kuadër të “Unitetit hyjnor”) dhe që e shton fuqinë tonë të veprimit dhe, anasjelltas, e keqe është ajo gjë që e zvogëlon fuqinë tonë të veprimit dhe e bën të dëmshëm veprimin tonë (kundrejt Unitetit). Që të njihet e

²² Spinoza, Etika: demonstruar sipas rendit gjeometrik, (përkth. Dritan Karadaku), Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 57.

²³ Po aty, fq. 58.

²⁴ Michael P. Levine, *Pantheism: A non-theistic concept of deity*, ROUTLEDGE, London New York, 2003, fq.209

mira apo e keqja njeriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm për atë se një gjë i ndihmon apo e dëmton ruajtjen e qenies së tij.

“Njohja e të mirës dhe e të keqes nuk është gjë tjetër veçse afekti i gëzimit ose trishtimit, për aq sa ne jemi të ndërgjegjshëm” (Etika. IV, Parashtrimi VIII.)

Etika që bazohet në pikëpamjen panteiste, të mirën dhe të keqen nuk i koncepton si kategori të karakterit transcendental. Besa është një e mirë që e përcakton ekzistencën e personazheve në baladë, për aq sa ata janë të aftë në të kuptuarit e rolit të saj për ruajtjen e “Unitetit hyjnor” përmes mendjes.

Personazhet e baladës “Lula e shtatë vllazënve” a e kuptojnë dhe e pranojnë besën përmes arsyes apo përmes pasionit?

Në baladën “Lula e shtatë vllazënve” personazhet që e shkelin besën jepen në situatën e konfliktit të natyrës së tyre midis arsyes dhe pasionit. Personazhet, fillimisht, udhëhiqen nga “ide adekuate”²⁵ për besën, si diçka thellësisht e mirë që atyre u siguron ekzistencën dhe rendin social brenda bashkësisë. Por, nën ndikimi e pasioneve, të cilat, siç thotë Spinoza varen nga “ide joadekuate”, e humbin idenë e besës, si e mirë për ekzistencën e tyre duke shkaktuar, në rend të parë, çarje brenda rendit social të bashkësisë, e më pas edhe çarje në marrëdhënien ndërmjet rendit social të bashkësisë me rendin hyjnor. Halili do t’ia japë fjalën për martesë me motrën e tij Allaj Beut duke e shkëmbyer besën si kundërvlerë me pasionin për siguri dhe pushtet. Kur vëllezërit e japin besën, besa shfaqet si “afekt aktivë” që bazohet në arsyen për ruajtjen e homogjinitet social të bashkësisë fisnore. Ndërsa, shkelja e besës vjen si rrjedhojë e veprimet të “afektit pasivë” që buron nga pasionet të Halilit për fuqi materiale.

Sikur në situatën kur e shkelin besën në kushtet e ndikimit të pasioneve ashtu edhe kur atë e pranojnë nën kushtet e arsyes, personazhet në baladën “Lula e shtatë vllazënve” nuk e kanë aftësinë mendore që besën, si virtyt moral, ta transcendojnë nga një gjendje e kushtëzuar në diçka të pakushtëzuar. Pse? Sepse personazhet e baladës na shfaqen si modus i të menduarit të Zotit dhe, për rrjedhojë, arsyes së tyre i mungon tipari totalizues, i cili do t’ua mundësonte që ta shohin domosdoshmërinë e vlefshmërisë së besës për ruajtjen e ekzistencës së tyre. Shprehur me terma spinoziste, besa në baladë përfaqëson “idenë e afektimit të mendjes që buron nga zoti; ndërsa, shkelja e besës përfaqëson idenë e afektimit të trupit” (E. IV.Para. VII. Rrjedhojë. Fq.212). Rënia tragjike e personazheve ndodhë kur ata kalojnë nga gjendja mendore, e cila është e vetëpërcaktuar nga “ide

²⁵Me ide adekuate Spinoza kupton “një ide e cila, për aq sa konsiderohet në vetvete pa lidhje me objektin, i ka të gjitha tiparet apo emërtimet e brendshme të idesë së vërtetë (Etika, II, Përkufi.4). Idenë Spinoza e përkufizon si përputhshmëri ose mospërputhshmëri e idesë me veten e saj, e jo me objektin. Pra ideja nuk është mjet që e përshkruan objektin. Shtrohet pyetja: pse ideja nuk e ka synim përshkrimin e objektit? Sipas interpretimit që i bën kësaj problematike Sylvian Zac, ideja te Spinoza “nuk e ka si shkak objektin që përshkruan, por zotin si gjë menduese” (Shih. Sylvian Zac, La morale de Spinoza, Puf, Paris, 1959, fq.23. cituar sipas Dritan Karadaku, *Një hyrje te Etika*, në “Spinoza, Etika: demonstruar sipas rendit gjeometrik, (përkth. Dritan Karadaku), Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 393.

adekuate” për besën si virtyt moral, në gjendjen mendore që përcaktohet nga ndikimi i gjërave për të cilat ata krijojnë “ide jo adekuate” (nevoja për të krijuar miqësi me të fuqishëm vetëm për hir të fuqisë) për besën si institucion moral. Kjo përbën dramën e çarjes të personazheve, çarje kjo e cila përçon raporte jo adekuate mes tyre, zotit dhe natyrës.

Në këtë baladë, besa dhe hakmarrja shfaqen si dy kategori reciprokisht të ndërlydhura. Pse?

Plotësia e përsosmëria e unitetit të të kundërtave nuk do të realizohet me aktin e përmbushjes së mallkimit të Lules. Në të vërtetë, mallkimi si akt etik, është instrumenti që mendjen njerëzore e rikthen në procesin e të bërit të ndërgegjeshme për të mirën e vetes së saj. Mallkimi i përmbushur e vendos drejtësinë në mes fisit, por ai është i pamjaftueshëm për ta vendosur qetësinë që sjellë drejtësia e vendosur në mes të rendit njerëzor dhe atij mbinjerëzor, në mes të botës transcendentë dhe asaj imanente. Vetëm përmbushja e besës së dhënë do ta siguroj vendosjen e atij rendi. Hakmarrja e zotit për të vendosur ekuilibrin do të jetë e përligjur dhe gjithëpërfshirëse vetëm kur të përmbushet besa e dhënë. Në hakmarrje dhe përmes hakmarrjes realizohet Uniteti i rendit hyjnor.

Në kontekstin e çarjes së rendit ndërmjet zotit, natyrës dhe njeriut, mallkimi, si “afekt pasivë” i Lules, dhe hakmarrja, si “afekt aktivë” i “gjësë së menduar”, i zotit, në baladën “Lula e shtatë vllaznëve” luajnë rolin e një fuqie unifikuese, e cila në këndvështrimin e modelit natyralist të panteizmit, krijon unitetin e ligjeve të natyrës me ato njerëzore. Në këtë unitet prishen kufijtë midis njerëzores dhe mbinjerëzores²⁶. Prandaj, mallkimi i Lules merr “fuqi mbinjerëzore”.

Uniteti i binomeve polare: jetë-vdekje / trup-shpirt

Nga subjekti i baladës kuptojmë se Lulja nuk është në dijeni për atë se çfarë u ka ndodhur të vëllezërve dhe nënës së saj pak orë pasi ajo do të niset me krushqitë tek burri i saj - Allaj Begu. Me kalimin e kohës, në shtëpinë e burrit ajo do të ndjejë mall për vëllezërit dhe për fisin e vetë. Lulja do ta kujtojë momentin kur vëllezërit, në përpjekjet e tyre për ta bindur se martesë me Allaj Begun do t’i sillte lumturi dhe për t’ia zbutur zemërimin e saj kundrejt tyre për besën e shkelur, asaj ia kishin dhënë fjalën se do ta vizitojnë shumë shpesh. Por, vëllezërit nuk po i vinin. Atëherë Lulja i lulet Zotit që t’ia sjellë vëllanë e vogël, Halilin, që ta shohë.

“Hak kyqmet-o zoti kish punua - / prej vorrit Halilin e kish çua. / Po i hyp gjokut, te Lula me shkua”²⁷.

Lulja i njofton njerëzit e shtëpisë së burrit se pas shtatë javësh pritjeje, Halili është nisë që ta marrë. Ata nuk e besojë, sepse e dinë gjëmën që u ka ndodhur të vëllezërve të saj, por asaj nuk i kanë treguar. Ata konsiderojnë se ardhja e Halilit është ndonjë vegim i saj. Por, Halili, i ngritur nga varri vjen, fletë me

²⁶ Michael P. Levine, *Pantheism: A non-theistic concept of deity*, ROUTLEDGE, London New York, 2003, fq. 38

²⁷ *Balada dhe legjenda*, (përgatitur nga Anton Çetta), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972, fq. 30.

miqtë dhe me motrën si të ishte i gjallë. Ai e merr të motrën dhe e dërgon në shtëpi. Para se të hyjë në shtëpi Halili i thotë të motrës që të niset e para në shtëpi ku e priste nëna, ndërsa ai do ta lëshonte kalin e tij në kullosë. Lulja kur takohet me të ëmën e kupton se të shtatë vëllezërit e saj kanë vdekur nga murtaja, dhe se atë e ka sjellë Halili i ngritur nga varri. Nga tronditja dhe vaji nënë e bije vdesin mbi varret e vëllezërve.

Si është e mundur që i vdekuri, trup e shpirt të ngrihet nga varri? A nuk është shpirti ai që, pas vdekjes së njeriut, duhet të lirohet nga trupi dhe të vendoset në hapësirën qiellore?

Koncepti i tillë për ndarjen e shpirtit nga trupi është koncept që i takon religjioneve monoteiste. Një koncept i tillë është tepër i vonshëm në kulturën perëndimore. Monizmi i panteizmit të lashtë nuk e njeh një ndarje të tillë. Sipas Fustel de Coulanges, në lashtësi besohej se “gjatë ekzistencës së dytë, shpirti qëndronte i bashkuar me trupin. I lindur bashkë me të, vdekja nuk e ndante prej tij; shpirti mbyllej bashkë me trupin në varr”²⁸. Varrosja e të vdekurit bashkë me sendet që konsiderohej se atij i nevojiteshin, është një provë tjetër që vërteton se njeriu bënte jetë në varrë ashtu si edhe kur ishte gjallë²⁹.

Ritet shqiptare të varrimit e dëshmojnë se sikur i vdekuri ashtu edhe toka, ku duhet të pushojë trupi i tij, konsiderohen qenie të gjalla. Këtë e dëshmon gjëma, si një rit vajtimi në vdekje ndër burra, me ç’rast burrat dhembjen për humbjen e të afërmit, e shprehin me të goditura në gjoks dhe me grithje të fytyrës deri në shpërthimin e gjakut. Në pjesën pothuajse përfundimtare të ceremonisë së varrimit, burrat i shtrijnë trupat e tyre në tokë dhe e ledhatojnë tokën sikur për ta marrë me të mirë, me qëllim që ajo të tregojë respekt dhe dashuri për të vdekurin³⁰.

Pse Halili për së gjalli e shkelë besën e dhënë, ndërsa për së vdekuri e mbanë besën – e kthen të motrën në shtëpi?

Shpjegimin duket kërkuar te koncepti unitet panteist të zotit me botën të tipit të identitetit ontologjik dhe atij dialektik apo identitetit në ndryshim, ku zoti është njëkohësisht identik dhe i ndryshëm me natyrën. Këtu kemi një përafrim me konceptin e Spinozës për Substancën, sipas të cilit Substanca nuk është individuale (siç ndodhë te Aristoteli), por është unike. “Trupi dhe shpirti janë një dhe e njëjta gjë, çka konceptohet herë me vetinë e mendimit, herë me vetinë e shtrirjes”³¹.

Halili në të gjallë të tij do ta shkelë besën sepse qenia e tij është vendosur në kontekstin kur gjendja e natyrës, e kozmosit nuk është identike me zoti. Zoti këtu na paraqitet në cilësinë e “dëshmitarit”, pra jo si esencë. Joidentiteti i natyrës me zoti e krijon hapësirën individuale të Halilit dhe vëllezërve të tij për shmangie nga detyra - për shkeljen e besës. Ndërkaq, Halili për së vdekuri do ta mbajë besën, sepse qenia e tij është vendosur në situatën ku zoti është në veprim për të qenë

²⁸ Fustel de Coulanges, *Qyteti antik*, Dituria, Tiranë, 2014, fq. 56.

²⁹ Fustel de Coulanges, *Po aty*, fq. 57.

³⁰ Mark Tirta, *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSH – Instituti i Kulturës Popullore, Dega e Etnologjisë, Tiranë, 2004, fq. 221.

³¹ Roger Scruton, *Historia e shkurtër e filozofisë moderne: nga Descartes-i tek Wittgenstein-i*, “Besa”, Tiranë, 2000, fq. 63.

identike me natyrën, kozmosin me qëllim që esenca dhe ekzistenca e saj të shfaqet e pandarë. Në një situatë të tillë nuk ka vend për “hapësirë individuale” veprimi të genies njerëzore.

Në qoftë se themi se në baladën “Lula e shtatë vllazënve” mallkimi përbën “*modusin* e fundmë të *substancës* së pafundme të konceptuar si mendim”, ndërkaq, mund të themi se ringjallja e vëllait prej së vdekuri përbën “*modusin* e fundmë të *substancës* së pafundme të konceptuar si shtrirje.”³²

Semantika e shenjave

Kuadri botëkuptimor panteist shpërfaqet edhe në nivelin e shenjave dhe simboleve të përmbajtura në baladën “Lula e shtatë vllazënve”. Dhe kjo është e kuptueshme meqenëse raporti i botëkuptimi me shenjat është analog me raportin që ka pjesa me tërësinë. Në dhe përmes shenjave dhe simboleve materializohet domethënia dhe kuptimi i materialit baladeskë.

Bashkë me besën, si një nga përbërësit e kuadrit botëkuptimor panteist, në baladën “Lula e shtatë vllazënve” raporti hierarkik i njeriut me botën dhe me zotin shpërfaqet edhe përmes shenjave mbizotëruese: shenjës së varrit, shenjës së shpirtit, shenjës së kalit dhe shenjës së Lules. Varri, shpirti, Lulja dhe kali janë figura të cilat e mishërojnë botëkuptimin, idenë panteiste për botën, si shtresim metafizikë i baladës “Lula e shtatë vllazënve”.

Varri, përgjithësisht, simbolizon lartësinë. Varri, bie fjala, në mitologjinë afrikane, përfaqëson shenjën materiale që e mbanë shpirtin e të vdekurit që të mos i ngacmoi të gjallët me hidhërimin e tij³³. Përkundër kësaj, në baladën “Lula e shtatë vllazënve” varri, si shenjë materiale, përfaqëson vendin prej nga detyrimet e të vdekurve ndaj të gjallëve marrin rrugën e përditësimit të tyre. Halili, me “fuqinë e zotit”, ngrihet nga varri për ta përmbushur besën e dhënë.

Duhet theksuar se në traditën e letërsisë gojore shqiptare ekziston një variant më i vjetër i të njëjtës baladë me titull “Halil Garrija”, ku, në vend të zotit, si genie transcendentale, përmendet zogu, si simbol i shpirtit që e mbanë lidhjen ndërmjet tokës dhe qiellit³⁴, e mbanë lidhjen e shpirtit të të vdekurit me jetën e të gjallëve. Zogu vendos komunikimin midis motrës dhe vëllait të vdekur. Si simbol i principit dinamik, zogu shfaqet në mitologjitë e popujve të ndryshëm. Kështu, bie fjala, në mitologjinë egjiptase figura e zogu me kokë njeriu quhet Ba dhe konsiderohet si komponent specifik i genies njerëzore, i cili krijohet nga personaliteti dhe individualiteti i një personi pas vdekjes së tij³⁵. Sipas mitologjisë

³² Roger Scruton, *Historia e shkurtër e filozofisë moderne: nga Descartes-i tek Wittgenstein-i*, “Besa”, Tiranë, 2000, fq. 63.

³³ J. Chavalier&A.Gheerbrant, *Rjecnik simbola*, Nakladni zavod MH, Zagreb, 1983, fq. 179.

³⁴ J. Chavalier&A.Gheerbrant, *Rjecnik simbola*, Nakladni zavod MH, Zagreb, 1983, fq. 540-542.

³⁵ <http://www.egyptianmyths.net/ba.htm>

egjiptase Ba (zogu me kokë njeriu), kthehej te varri i të vdekurit, sepse kufoma e personit të vdekur besohet të jetë shtëpia e tij³⁶.

Në vend të zotit, fillimisht si dëshmitar, e më pas si veprues që e vendos unitetin e botës me veten dhe natyrën, në baladën e variantit “Halil Garrija”, zogu shfaqet si fuqi nismëtare vepruese për të krijuar lidhjen ndërmjet botës së të gjallëve me të vdekurit.

Në bazë të kuptimit dhe domethënies së këtyre shenjave mund të konkludojmë se varianti i baladës me titullin “Lula e shtatë vllazënve” bazohet në botëkuptimin e një panteizmi që është në simbiozë me besimin hyjnor, d.m.th. me botëkuptimin se ekziston një zot që e vendos rendin e gjërave në botë, ndërsa varianti i dytë i baladës “Halil Garrija” bazohet në botëkuptimin e panteizmit johyjnor, në të cilin uniteti i botës me kozmosin mundësohet përmes zogut, si qenie jotranscendentale.

Përkundër kësaj, si në variantin “Lula e shtatë vllazënve” ashtu edhe në variantin “Halili e Garrija”, kali është shenja me anë të së cilit bëhet i mundur lidhja praktike dhe pragmatike e botës së të vdekurve me botën e të gjallëve, të vëllait të vdekur me motrën e gjallë. Kali është simboli nëpërmes të cilit shpërfaqe tërësia e botëkuptimit panteist që përmban balada “Lula e shtatë vllazënve”. Ashtu siç e hasim edhe në shumë qytetërime të tjera, figura e kalit mishëron domethënien simbolike të fuqisë dhe të fshehtësisë që del nga nevojat e tokës dhe mund të sjellë jetën dhe vdekjen³⁷. Në baladën “Lula e shtatë vllazënve” kali përfaqëson parimin dinamik të marrëdhënies së jetës dhe vdekjes, të bashkekzistencës së tyre.

Në qoftë se zogu, në variantin e baladës “Halil Garrija” është mishërim i parimit dinamik të marrëdhënies së tokës me qiellin, Lulja në variantin e baladës “Lulja e shtatë vllazënve” është mishërim i parimit të pasivitetit³⁸. Derisa emrat e personazheve, si Halili, Allaj Begu, janë dëshmi e shtresimit kulturor oriental të baladës, Lula është një emër tipik shqiptar. Vështruar semiologjikisht, Lula, si shenjë gjuhësore, e përmban lidhjen ndërmjet emrit dhe objektit, si dhe lidhjen e konceptit (të pasivitetit) me figurën vizuale (lulen, si qenie e botës bimore). Në kontekstin e tezës sonë, mund të themi se Lula shprehë marrëdhëniet që njeriu ka me natyrën. Lulja është shenja ku vendoset komunikimi i njeriut me natyrën dhe zotin. Ashtu sikur lulja, si bimë, e cila në mënyrë pasive i pret të reshura apo thatësira nga natyra apo të ujiturat nga njeriu, ashtu edhe jeta e Lules, si personazh në baladën “Lula e shtatë vllazënve”, përcaktohet nga shkeljen apo përmbushja e besës.

Siç mund të shihet, nga leximi dhe analiza semantike e shenjave dhe simboleve veç e veç dhe në ndërlidhjen e tyre, ne mund të krijojmë një pamje më të plotë për lidhjen që ekziston midis besës, si kategori morale dokesore, me botëkuptimin panteist për botën, si strukturë metafizike e përmbajtjes së baladës “Lula e shtatë vllazënve”.

³⁶ <http://www.egyptianmyths.net/ba.htm>

³⁷ J. Chavalier&A.Gheerbrant, *Po aty*, fq.270.

³⁸J. Chavalier&A.Gheerbrant, *Po aty*, fq. 81-83

Përfundim

Panteizmi përbën bazamentin metafizik mbi bazën e të cilit sistemohet dhe strukturohet i gjithë materiali i baladës “Lula e shtatë vllazënve”: situatat paradoksale të personazheve, emocionet dhe mendimet, gjendjet dhe veprimet e tyre.

Panteizmi është shtresa metafizike e baladës, e cila e krijon logjikën e lidhjes në mes koncepteve, të situatave, të arsytimeve, të mendimeve edhe të veprimeve të personazheve. Kuadri botëkuptimor panteist në baladën “Lula e shtatë vllazënve” prodhohet nga koncepte partikular panteiste, si: besa, mallkimi, hakmarrja e zotit etj.; dhe i prodhon ato. Nëpërmjet botëkuptimit panteist ne mund ta zotërojmë kuptimin e marrëdhënies që njeriu ka me zotin, me natyrën, me jetën dhe me vdekjen.

Kuptimi i dinamikës së marrëdhënies së njeriut me zotin, kozmosin dhe natyrën; kuptimi i marrëdhënies herë indiferente e herë “shkatërruese” të njërit ndaj tjetrit, mishërohet në konceptin e “unitetit panteist”. Sipas konceptit panteist e mira përcaktohet varësisht se sa një fuqi i shërben “unitetit hyjnor”, dhe, e kundërta, e keqe konsiderohet çdo gjë që e prishë “unitetin hyjnor”.

Në baladën “Lula shtatë vllazënve” besa del të jetë një kategori me fuqi vepruese qoftë për dëmtimin qoftë për mirëmbajtjen e ekuilibrave të kundërtive brenda “unitetit hyjnor”. Prandaj, si e tillë, besa i tejkalon kufijtë e një kategori etike dokesore, duke marrë përmbajtjen e një koncepti panteist për kuptimin e ekzistencës njerëzore si dhe për ruajtjen e rendit të gjërave në botë.

Bibliografia

Balada dhe legjenda, (përgatitur nga Anton Çetta), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1972.

Bruno, Gjordano: *Optimizmi i mendimit të lirë*, (përkth. Vehap Shita,) Rilindja, Prishtinë, 1990.

Clastres, Pierre: *Shoqëria kundër shtetit: kërkime në antropologji politike* (përkthyer nga frengjishtja: Orgest Azizi, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2014.

De Coulanges, Fustel: *Qyteti antik*, Dituria, Tiranë, 2014

Enoch Stumpf, Samuel: *Filozofia: Historia&Problemet*, (Përktheu: Kastriot Myftiu dhe Paqsor Shehu), Teoena, Tiranë.

Fetiu, Sadri: *Poetika e baladës popullore shqiptare*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1987.

Gjeçovi, Shtjefën: *Vepra I, Kanuni i Lekë Dukagjinit*, (përgatitur nga Ramiz Kelmendi dhe Faheredin Gunga), Rilindja, Prishtinë, 1985.

J. Chavalier&A.Gheerbrant, *Rjecnik simbola*, Nakladni zavod MH, Zagreb, 1983.

P. Levine, Michael: *Pantheism: A non-theistic concept of deity*, ROUTLEDGE, London New York, 2003.

Scruton, Roger: *Historia e shkurtër e filozofisë moderne: nga Descartes-i tek Wittgenstein-i*, “Besa”, Tiranë, 2000.

Spinoza: *Etika: demonstruar sipas rendit gjeometrik*, (përkth. Dritan Karadaku), Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015.

Tirta, Mark: *Mitologjia ndër shqiptarë*, ASHSH – Instituti i Kulturës Popullore, Dega e Etnologjisë, Tiranë, 2004.

Tirta, Mark :*Etnologjia e shqiptarëve*, GEER, Tiranë, 2006.

Yamamoto, Kazuhiko: “Struktura etike e shoqërisë homerike”, në “*Gjurmime albanologjike (seria Folklor&Etnologji)*”, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2004.

Yamamoto, Kazuhiko: “Struktura etike e kanunit: a e përbën ai formën fillestare në shoqërinë njerëzore”, në *Gjurmime Albanologjike (seria Folklor&Etnologji)*, Nr. 37/2007, Prishtinë, 2008.

Nga interneti:

- <http://plato.stanford.edu/entries/pantheism/>
- <http://www.egyptianmyths.net/ba.htm>

VIOLETË BARDHI-ZEQIRI

KODI LETRAR I GJUHËS SË AGIM DEVËS

Abstrakt: Në këtë punim trajtohet kodi letrar i gjuhës në veprën e Agim Devës. Studimi synon të vërojë aspektet letrare dhe gjuhën e autorit duke përzgjedhur veçantitë stilistike e gjuhësore.

Agim Deva është shkrimtari më produktiv dhe shkrimtari më i madh shqiptar për fëmijë. Ai është përfaqësuesi më i denjë i letërsisë shqipe për fëmijë edhe në hapësirat e ndryshme botërore letrare.

Letërsia për fëmijë ka kode tjera nga letërsia për të rritur. Gjuha e një vepre letrare për fëmijë së pari dallon në planin leksikor, semantik, fonetik, morfologjik, sintaksor e stilistik. Hulumtimi është bazuar në disa kërkesa e kritere që shtrohen para letërsisë për fëmijë e që e specifikojnë nga letërsia e përgjithshme. Një nga kriteret që shtrohet para letërsisë për fëmijë është gjuha, prandaj studimi ka të bëjë me gjuhën e autorit në shërbim të funksionit njohës, funksionit edukativ dhe në shërbim të funksionit zbavitës e estetik.

Analiza është përqendruar në qendrën e fushës gjuhësore dhe letrare të krijuesit për të shprehur rolin me vargun, strofën, ligjërimin dhe gjuhën e figurës.

Hyrje

Gjuha e një vepre letrare për fëmijë ka kode tjera nga gjuha e letërsisë për të rritur, gjuha e krijimit letrar për fëmijë së pari dallon në planin semantik, leksikor, fonetik, morfologjik e sintaksor; kështu që, përmes gjuhës mund të përcaktojmë llojin letrar, mesazhin, receptorin etj. Në fakt, gjuha është kriter i domosdoshëm që e bënë letërsinë për fëmijë të specifikohet nga letërsia për të rritur, ajo bëhet kriter dallues edhe mes veprave letrare të moshave të ndryshme për fëmijë, kështu, kemi krijime letrare për moshë të vogla (parashkollor, fillor e deri te letërsia për të rinj). Letërsia si art i fjalës e fisnikëron dhe e zgjon efektin e kënaqësisë në mënyrën e vet artistike te secili receptues si ai i rritur, po ashtu edhe te receptorin fëmijë. Te receptorin fëmijë përveç ndjenjës estetike, funksionon edhe të mësuarit, edukata, argëtimi, pra funksioni njohës-edukativ me tërë elementet, që janë: sasia e njohurive, vërtetësia, letërsia didaktike, edukata e punës, atdhetare, internacionale, estetike etj.

Kodi i gjuhës te receptorin fëmijë, kuptohet dhe funksionon ndryshe në shumë aspekte nga kodi i gjuhës te receptorin i rritur, pra gjithë sistemi gjuhësor shprehës është i veçantë në veprën letrare për fëmijë, duke filluar nga të kuptuarit ndryshe të nocioneve, fjalëve, fjalive dhe gjithë strukturës gjuhësore e stilistike. Shkrimtari për fëmijë e strukturon veprën letrare me një gjuhë të thjeshtë,

figurative, që ka shumë rrëfim, por para së gjithash ka qasjen estetike ndaj gjithë asaj që shkruan e që e realizon përmes gjuhës së personifikimit, metaforës, krahasimit, aluzionit, simbolit, metonimisë, pra ka një simbolikë të pasur, që me një fjalë mund ta përmbledhim si gjuhë figurative.

Krijimtarinë letrare të Agim Devës e karakterizon poezia, pothuajse mbi tetëdhjetë krijime letrare janë në vargje, përjashtim bën, një roman dhe disa skeçe, prandaj mund të thuhet se gjuha e veprave të Devës është gjuha e poezisë për fëmijë.

Letërsia për fëmijë është art i fjalës, dhe mjeti kryesor i artit të fjalës është gjuha, e në mënyrë të veçantë është gjuha poetike.¹

Poezia është shfaqje më eprore e organizimit dytësor, prandaj ajo edhe në shkrim dallohet nga të gjitha mënyrat e tjera për paraqitjen e gjuhës.²

Këndvështrimi dhe perceptimi si ai studimor, po ashtu edhe artistik i Devës mbështetet në formësimin e botëkonceptit të poezisë për fëmijë, duke e veçuar nga botëkoncepti i poezisë për të rritur. Këtë perceptim artistik autori e shpreh në poezinë *Kadareja-Kadare*. Duke apostrofuar Kadarenë dhe vetveten paraqet botëkrijuesin me dy pole, lindje-perëndim. Autori në mënyrë artistike rreket t'i shpjegojë veçantitë dhe specifikat e letërsisë për fëmijë dhe asaj për të rritur, në aspektin tematik, *të dy këndojnë një këngë, lumenjtë i ngasin në të njëjtin det, duke aluduar në letërsinë si art i fjalës, dhe duke e dalluar letërsinë për fëmijë me shprehjen metaforike: për secilin ujërat kanë tjetër kuptim*. Dy shkrimtarë, njëri për të rritur e tjetri për fëmijë me vargjet: *Ai shpëton nënën, unë shpëtoj një fëmijë*.

Duke i apostrofuar Ismail Kadarenë dhe Agim Devën

Një Kadare-Ismail, një Devë është Agim,

Kur i cakërojmë gotat-s'kërcasin njësoj,

Unë rroj këngën time, ai këngën e vet,

Ai shpëton nënën, unë shpëtoj një fëmijë

Për secilin ujërat kanë tjetër kuptim,

Kadareve vetëtinë, unë pak-bubullojë

Po lumenjtë na ngasin nga i njëjti det

Por nuk shpëtojmë jetëra për të bërë poezi...³

Shumë studiues të letërsisë për fëmijë kanë theksuar gjuhën si kriter dallues për të specifikuar letërsinë për fëmijë nga ajo për të rritur. Për një studiues, vepra me fond leksikor më të ngushtë i takon letërsisë për fëmijë të fazës së hershme. Me fond leksikor, brenda tekstit letrar, Sopa nënkupton fjalinë më të thjeshtë, larushinë ligjërimore, në përgjithësi teksturën letrare, kështu që, ky studiues vjen në përfundim se, gjuha e veprës letrare për fëmijë, në aspektin filozofik, është e një shkalle më të ultë, nga ajo e veprës letrare për të rritur.

¹. Berisha N. Anton, *Letërsia për fëmijë si art i fjalës*, Tiranë, 2013, fq. 18

². Lloshi Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, fq. 262, ndër të tjera Lloshi thotë se, *tipari themelor i ligjërimin poetik është se ai është i organizuar në të gjitha nivelet gjuhësore si: fonetike, prozodike, morfematike, leksikore, semantike, sintaksore e mbi sintaksore*.

³. Deva Agim, *Gurët fluturues*, Prishtinë, 2007, fq. 112

“Fjala, fjalia dhe ligjërata letrare të ndërtuara në iks veprën letrare për fëmijë, i zëvendësojnë fjalët didaktike, dhe pedagogjike të mësuesit shkollor në institucionin përkatës”⁴

Vlerësimi i studiuësit Sopa nxjerr në skenë dy komponentë të rëndësishme të letërsisë për fëmijë, funksionin njohës dhe edukativ, i cili gjithashtu është i bazuar në deduksionin e pararendësit, historianit, kritikut dhe studiuësit të letërsisë për fëmijë Astirt Bishqemi, i cili thotë: *shkrimtari për fëmijë duhet të jetë mësues, pedagog, udhërrëfyes...*⁵

Një teoricien i letërsisë, krijuesin e veprës letrare e sheh si faktorin kryesor, si një përçues të temave, problemeve, ideve, që ndikohet nga aftësitë perceptuese të receptorit, e ky korrelacion vërehet te aftësitë e përdorimit të gjuhës nga shkrimtari. Krijuesi gjuhën e shpërfaqë në shumë aspekte. Gjuha që funksionon si njohuri dhe mësim, në gjuhë nocionore, gjuhë frazeologjike, gjuhë ritmike, gjuhë amtare, gjuhë poetike, gjuhë prozaike, gjuhë dramatike (dialogjike), gjuhë e metrikës, gjuhë e figurës etj. Një studiuës tjetër, veçon gjuhën e personazheve, përmes së cilës shprehet tipizimi dhe karakteret e personazheve, individualizimi i gjuhës së personazheve, duke dalluar personazhe real, fantastik, të personifikuar etj.⁶

Gjuha në shërbim të funksionit edukativ nxjerr konkluzionin për studiuësin e letërsisë për fëmijë, si gjuhë amtare, gjuhë ritmike (muzikore), që është një kriter gjuhësor për moshat e vogla receptuese.⁷, apo gjuha mund të jetë e thjeshtë, gjuhë e elokuencës, gjuhë emocionale, gjuhë estetike.⁸

Pothuajse, të gjithë studiuësit, vlerësuesit dhe kritikët e letërsisë për fëmijë, gjuhën e nxjerrin si kriter të domosdoshëm për ta bërë ndarjen nga letërsia për të rritur.

Po ashtu, ata theksojnë edhe rëndësinë e receptorit në përcaktimin e gjuhës së veprës letrare për fëmijë, si dhe ndërlihdjet e pashmangshme të gjuhës me funksionet: njohës-arsimor, edukativ dhe zbavitës.

Gjuha e asociacioneve

Nocioni fëmijë në krijimet letrare të Devës ka një përmbajtje semantike të madhe si emër dhe një fushë të gjerë polisemantike. Fëmija si emër del në forma të shumta përdorimi dhe koncepti fëmijë bartë vlerat e një personi fizik, por bart edhe vlerat gjuhësore letrare e estetike. Fëmija del si personazh letrar, në dimensionin shkollor, në dimensionin edukativ, psikologjik dhe letrar të përfaqësuar si letërsi për fëmijë në planin studimor, në vjershë, në roman, në dramë, në studime, në aktivitete, fëmija si bartës i jetës, i gëzimit, fëmija si pjesëtar i familjes, i shkollës, i shoqërisë. Nocioni fëmijë ndërton fushën semantike të fjalës në veprat e Devës si:

⁴. Sopaj Nehas, *Letërsia për fëmijë, Shkup, 2007, fq. 25*

⁵. Bishqemi Astrit, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 1997*

⁶. Sadiku Neshyt, *Letërsia për fëmijë, Shkup, 2002.*

⁷. Shkurtaç Gjovalin, *Si të shkruajm shqip, Tiranë, 2008, fq. 160*

⁸. Gaçe Bardhosh, *Letërsia shqipe për fëmijë, Vlorë, 2005*

Libër për fëmijë, përmbledhje vjershave për fëmijë, roman për fëmijë, poemë për fëmijë, dramë për fëmijë, si studim monografie për fëmijë, si antologji për fëmijë etj.

Një nga veçantitë specifike për fëmijë është gjuha. Gjuha në veprën e Devës del në disa forma praktike, që ndërliken me funksionet e kësaj letërsie si forma shprehësie që nuk janë të njëjta si në letërsinë e përgjithshme. Deva e vështron fëmijën nga këndi i familjes dhe e ndërton gjuhën asociative si: babai nëna, gjyshi, gjyshja, motra, vëllai, halla, daja etj. Deva e vështron fëmijën nga këndi i shkollës dhe e ndërton gjuhën e asociacioneve si: nxënës, mësues, pedagog, ditar, dërrasë e zezë, zile e shkollës, drejtor, fletore, lapsi, libër historie etj. Nga këndi shoqëror Deva e ndërton këtë gjuhë asociative si: mik, mikeshë, shok, shoqe, simpati, miqësi, shoqëri, dashuri, xhelozitë etj.

Nocionin fëmijë Deva e ndërton estetikisht në vargje, në strofa, në poezi dhe në përmbledhje poetike. Struktura e çdo vjershe bart brenda nocionin fëmijë të kompozuar si personifikim, alegori, krahasim apo paralelizëm figurativ.

*Fëmijët, Si luftohet me fëmijët, Jam fëmijë që s'friksohem, Zog apo fëmijë, Si rriten fëmijët, Je fëmijë si unë dikur, Të gjithë jemi fëmijë, Nëna me mijëra fëmijë, Për një fëmijëri të vogël, Edhe ditën jam fëmijë, Si hanë fëmijët me lopatë, Fëmijët fëmijë, Më shumë se fëmijë etj.*⁹

Gjuha e sinonimisë

Trajtat e reja gjuhësore, fjalët e reja ngjallin krahnorizmat në tekstin poetik të Devës dhe kjo është gjuha e sinonimisë. Nocioni fëmijë në tekstin poetik të Devës është konceptuar si sinonim. Sinoniminë Deva e ndërton në gjithë veprën e tij, përmes nocioneve, vargjeve, strofave dhe vjershave. Deva përmes nocionit fëmijë sjell gjithë format e fjalëve për fëmijët si: vajzë, djalë, cucë, çupë, gocë, vashë, vogëlushe, çun, vogëlush, djalosh etj., duke ofruar edhe fjalët nga të folmet e ndryshme të shqipes. Këto sinonime klasifikohen në të ashtuquajturën sinonime ideografike ose nocionore.¹⁰

Konceptimet sinonimie të nocionit fëmijë, Deva i përdorë shpesh brenda një poezie p.sh.

E di shitësi ç'kërkon goca

Nxjerr një laps me zemër t'blertë

Kush di, çupa çka do t'shkruaj

Apo

Larg banon vogëlushja

Tri ditë rrugë me tren

Atë ujëvarë biluri

*Çupa dot s'e gjen.*¹¹

Në disa përmbledhje poetike, të periudhës së parë krijuese¹², Deva krijon variante sinonimike, si në përmbledhjet: *Trumbeta e artë, Zonja e livadheve, Midis yjve, Dhurata etj.* Këto përmbledhje poetike karakterizohen me përdorimin e disa

⁹. Deva Agim, *Mungon një zemër, Prishtinë, 2007, fq. 71*

¹⁰. Lloshi Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988, fq. 99.*

¹¹. Deva Agim, *Gishti ngjyrë vjollce, Prishtinë, 1973, ff. 20, 22*

¹². Shih, *një ndarje të krijimtarisë letrare të Agim Devës e kam bërë në punimin e doktoratës, Krijimtaria letrare e Agim Devës, Prishtinë, 2014*

vjershave në sinonimi. Poezitë janë ndërtuar me tituj të ndryshëm, por të përafërt për të mos thënë të njëjtë. Për një stinë të vitit, p.sh. pranverën janë krijuar pesëgjashtë poezi, variante sinonimie. Deva duke përdorur figura stilistike si: personifikimin, alegorinë, metaforën, antitezën, paralelizmin ndërton vjershat sinonimike: *Vogëlushja me dimi të blerta, Vjedhësi zemërmirë, Piktorja e livadheve, Treni i luleve* etj. Këtë dukuri të Devës mund ta kategorizojmë në sinoniminë kontekstuale, meqenëse autori ndërton një varg sinonimik të ri i cili nuk është në sistemin leksikor të gjuhës, por që është i kapshëm në kodin e tekstit (sepse lind tufa stilemore).¹³

Gjuha e antonimive

Gjuha si antonimi në veprën letrare të Devës del si ballafaqim i të kundërtave, kështu të dhënat, mësimet, mendimet, ndjenjat, situatat e pamjet e një rendi, në vargjet, në vjershat apo në poemat e tij, ndërtohen me të dhëna, mësimet, mendime, ndjenja, situata e pamje të një rendi tjetër duke i vënë përballë një ndjenje tjetër, përballë një mendimi tjetër, një pamje tjetër etj.

Kundërvënia shërben për të nxjerr në dukje anë të qenësishme antonimike të sendeve, dukurive, fenomeneve, ato që i interesojnë autorit. Përmes antonimeve në tekstin poetik të Devës shfaqet paralelizmi i trajtave në nivelin sintaksor, paralelizëm ndërtimi në nivelin semantik, paralelizmi i antitezës.¹⁴

Antiteza shfrytëzon kuptimet asociative ose situatën e krijuar në tekst, *i pasur me varfëri*, kasollja dhe pallati, si antonimi arkitekture me kuptimet asociative të fenomenit social. Përveç kuptimeve asociative antiteza shfrytëzon edhe situatat paralele si në poezitë: *Dy vocërrak, Çokolatat, Natë e autobusëve...* etj.

Gjuha e refuzimit estetik, del në funksion të kategorisë sociale në konceptet: *i pasur me varfëri*, kasollja dhe pallati si antonimi arkitekture. Ëndrra e zhgëndrra si antonimi të kategorive fikzionale. Gjuha si antonimi estetike: Deva – Kadare. Gjuha si antonimi skenike: *Një e martë qershori*.

Ecnin para meje
Dy vocërrak atë ditë.

Kurse tjetri djathtas
Me kokë n'kontejner...¹⁵

Njëri u ndal-majtas,
Dredhëza për të blerë,

Agim Deva përmes gjuhës së distikut e ndërton antoniminë skenike në dy pamje, njëri-tjetri, majtas-djathtas, pikat e gjakut në kontejner dhe ngjyra e kuqe e dredhëzës.

¹³. Lloshi Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1988, fq. 100.

¹⁴. Rrahmani Zejnullah, *Teoria e letërsisë*, Prishtinë, 1996, fq. 68.

¹⁵. Deva Agim, *Këtu dikush ka qenë*, Prishtinë, 2005, fq. 86

Gjuha onomatopeike

Kërkesat për ata që shkruajnë për të vegjlit nuk kanë të bëjnë vetëm për zbatimin e normës gjuhësore, por ato janë më të gjera stilistike, logjike e psikologjike.

Poeti rus për fëmijë Kornei Çukovski në librin e tij *Dy gjer në pesë*, jep disa porosi për shkrimtarët që shkruajnë për fëmijë, ndër to po veçojmë këtë: *Fëmija do vargje që këndohen e kërcenhen d.m.th. t'u ngjajnë vargjeve të tij onomatopeik.*¹⁶

Në krijimtarinë letrare të Devës, të shpeshta janë fjalitë nxitëse, pyetëse e habitore me pasthirrma të shumta, sepse kjo mënyrë e të shprehurit është në pajtim të plotë me një karakteristikë të fëmijëve, komunikimin emocional. Deva përdorë prapashtesa zvogëluese në fjalë të ndryshme si: çupëz, vogëlushe, picirruk, mikeshë, djalosh, vëllathi, vocërrak, blinoshi, natyreza, bletusha, kitërrusha, Panushi, Kadareshë, plakushë, nënëz etj.

Gjuha onomatopeike zgjon efekte tingullore dhe ka të bëjë me elemente të fonologjisë. Njësia më e vogël fonetike, tingulli, krijon njësi më të mëdha, rrokjen, dhe elemente tjera të intonacionit, theksin e ritmin, të cilat zgjojnë efekte të ndryshme emocionale, të gëzimit, hidhërimit, frikës, dhembjes, neverisë, keqardhjes etj. Këta tinguj në tekstin poetik japin vlera dhe zgjojnë asociacione të zhurmave të ndryshme, të objekteve, të veprimeve të personifikuara, të parat krijojnë pasthirrmat, ndërsa të dytat onomatopetë.

Deva në veprën e tij për ta bërë gjuhën më emocionale përdorë edhe pasthirrmat, që zgjojnë asociacione të keqardhjes:

O o o o oh, po ç'të bëra o njeri.¹⁷

Tingujt onomatopeik, zgjojnë asociacionin e krismave të një arme, imitimim e tingujve, zukatjen e bletës, cicërimat e zogut dhe bilbilit:

Pam - pam

Bam-bam

Pam-pam

Dhe dyert e gojës mbyllen disi.¹⁸

Zu, zu, zuuuuuu! U dëgjua një zukatje e lezetshme e një blete

Ciu, ciu, ciriliu... ci, ciu, ciriliu-oh, vetëm ta kishit dëgjuar.¹⁹

Gjuha e frazeologjisë

Frazeologjia është një fenomen i shprehur më shumë në gjuhën bisedore, ka më shumë ngarkesë emocionale dhe figurshmëri.

¹⁶. Cituar në librin e Astrit Bishqemit, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*, Elbasan, 1997, fq. 17

¹⁷. Deva Agim, *Natyreza, Prishtinë, 2002, fq. 50*

¹⁸. Deva Agim, *Gurët fluturues, Prishtinë, 2007, fq. 79*

¹⁹. Deva Agim, *Loni e Liraku në pyll, Prishtinë, 2000*

Ligjërimi bisedimor shfaqet në tekstet poetike në formë sentencash, fjalësh të urta dhe frazeologjish. Struktura gjuhësore sentenciale ngërthen në vete intertekstin popullor dhe citatësinë. Deva kur donë të rrëfej përdorë formulën hyrëse të përrallave: *Ishte, ç'na ishte një gonxhe e kësaj bote... Kah na qenkeni nisur o buburreca..., Thonë se një plak diku në malësi, prej zemrës së vet mbaroi saksi.*²⁰

Formula hyrëse e tekstit poetik ka traditë në folklorin tonë dhe kjo, *Na ishte...* shërben për ta vënë veprimin një kohë të pacaktuar, folja ishte vendoset në kohën e pakryer.

Ndonjëherë shprehjet frazeologjike, ose fjalët e urta mund të jenë një fjali p.sh.²¹

Kush ka miq më tepër vlen

Toja është tojë, me nervat e huaja bënë lojë.

Trimat e ruajnë natyrën, qyqarët e ndotin.

Atë që e ruan sot do ta kesh edhe nesër.

Po ta prej m një lisë, e prej m me gjithë hije.

Gjuha në shërbim të funksionit edukativ në veprën letrare të Devës del si gjuhë e mesazhit, e porosisë e këshillës. Gjuha nocionore fëmijë si gjuhë diturore²² shërben për moshën të vogla të fëmijëve dhe është në funksion të mësimin të njohurive shkollore.

Bota është shumë e madhe

Dhe në të të gjithë fëmijët

*Lindim të vegjël.*²³

Në veprën letrare të Devës dalin fjali në trajta ligjërimore që shquhen për intonacione të ndryshme sintaksore sikundër janë: intonacioni pyetës, bashkëbisedues, tregimtar (rrëfimi), përshtues, thirrës, habitës, kritik etj. Gjuha e të dhënave diturore është gjuhë që të bind me mjete të shprehësisë së gjuhës letrare artistike. Në vjershat e tij dalin vargjet si fjali dëftore (pohore):

Njerëzit që jetojnë në male,

Quhen-malësor dhe janë trima

Sepse nuk i frikësohen ujkut.

Bota jonë është plotë me male.²⁴

Babi e ka NJË kokë. 1.

Babi i ka DY këmbë. 2.

²⁰. *Shih: citatet janë nxjerr në veprat e Agim Devës Shoku im pa xhepa, Me temlik u nisa në botë, Merrrja lojës vetëm zemrën, Rrota e historisë, Koha e luleve, Natyreza etj.*

²¹. *Beci Bahri, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 2010, fq. 48.*

²². *Ky term është përdorur si rrjedhojë e konceptimit të poezisë për fëmijë në studimin Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi III, të Rexhep Qosjes, Prishtinë, 1986, fq. 166*

²³. *Deva Agim, Fëmijët, Prishtinë, 2001*

²⁴. *Deva Agim, Mali, Prishtinë, 2001*

.....
Babi e ka dorën me PESË gishtërinj 5.²⁵

Në botë ka lloj-lloj orësh.

Ora e xhepit.

Ora e dorës.

Ora e qafës.

Ora me kapak.

Ora me zile.²⁶

Deva del si subjekt lirik i cili në tekstin e tij poetik pohon, tregon, dëfton dhe pyet. Pyetjet nxisin dialogun mes autorit dhe reflektorit, autori këtë gjë e shfrytëzon shumë mirë në tekstin e tij poetik duke ditur se receptori fëmijë është kurioz të pyes për çdo gjë. Këtë mënyrë ligjërimi e realizon më së miri në stilin e pyetjeve retorike: *A i ndërrojmë sytë?, Pse peshqit kërcejnë mbi ujë?, Si rriten fëmijët?, Xhelë, qëlloja se kush jam?, A luftohet me natyrën?, A mërziçen lulet?, A vjen pranvera me një lule?, Si kuptohen fëmijët?, Si shkruhet pa shkronja?, Pse kërkon çanta dritare?, Përse banka përsëritë klasën?, Çka mban tavolina në shpinë, Pse të matet koha?, Lashtësi sa vite i ke?, I kujt jam unë?, Kënd e kërkon hëna?, Çka bënë dita natën?, Sa vite i kam?, etj.*²⁷, ndonjëherë vargjet në poezinë e Devës dalin si fjali nxitëse:

Sa më shumë hije
Më shumë fëmijë nën të,
Sa më shumë drunj,
Më shumë hije.

Sa më shumë fëmijë nën hije,
Më shumë lojë.
Sa më shumë lojë,
Më shumë diell.²⁸

²⁵. Deva Agim, *Numëroj, Prishtinë, 2001*

²⁶. Deva Agim, *Ora, Prishtinë, 2001*

²⁷. *Shih: janë nxjerr nga librat: Qyteti i pikëpyetjeve, Zonja e livadheve, Natyreza, Si shkruhet pa shkronja, Këtu dikush ka qenë, Shitet babi im etj.*

²⁸. Deva AGIM, *Sa më shumë drunj, Prishtinë, 2001*

Gjuha e figurës-vizatimit

Poezia duhet të jetë grafike, çdo strofë të ketë subjekt për ta vizatuar, pasi të vegjlit mendojnë me figura. Çdo grup prej pesë - gjashtë radhësh kërkon një figurë të re.²⁹

Për koincidençë kjo rregull i shërbeu Agim Devës për të krijuar dymbëdhjetë libra për fëmijët e moshës parashkollore, dhe intuita e tij prej krijuesi kishte hetuar hendikepin që ekzistonte në letërsinë për fëmijë për moshat e vogla³⁰, të cilat veç tekstit të shkurtër përmbajnë vizatime, ilustrime dhe figura që lidhen me tekstin.

Në librin, *Unë jam unë*,³¹, përmes foljeve *Dëgjoj... Shoh... Nuhas... Prek... Shijoj... Mendoj...* sugjeron një mundësi të veçantë të organizimit sintaksor të veprës letrare, të ndryshëm nga organizimi i zakonshëm, me qëllim të arritjes së efekteve të veçanta stilistike e kuptimore.

Pas çdo vargu që është ndërtuar vetëm me folje dhe me tri pika që sugjerojnë vazhdimin e fjalisë, mungojnë fjalët e tjera të cilat do të ishin të zakonshme për ndërtimin sintaksor normal; por këtu kemi të bëjmë me një varg poezie.

Imazhi poetik është shumë më i plotë e më i ndërlikuar, sepse në parafytyrimin e receptorit veprojnë elemente të kontekstit jashtë letrarë, vizatimi e fotografia.

Libri tjetër, *Numroj*,³² ka një strukturë të tillë gjuhësore: *Babi e ka NJË kokë, Babi i ka DY këmbë* etj. Në këtë rast ndërtimi sintaksor është i zakonshëm, kemi fjali të thjeshta. Imazhi poetik është i plotë, në parafytyrimin e receptorit veprojnë elementet e kontekstit jashtë letrarë, vizatimi, fotografia, por edhe elementi gjuhësor i shprehur me shenjën shkrimore NJË, DY, TRI, KATËR, PESË, me shkronja të mëdha në mes të fjalisë (që d.m.th. jashtë rregullave gramatikore) dhe simboli, si shenja matematikore 1, 2, 3, 4, 5.

Rëndësinë e figurës (ilustrimit) në krijimet letrare për fëmijë e kanë hetuar pedagogët e njohur Komenski, Pestaloci, etj, sidomos ata kanë vlerësuar domosdoshmërinë e figurës, dhe të krijimeve letrare në formën e bisedës për moshat më të vogla.³³

²⁹. Bishqemi Astrit, *Letërsia për fëmijë (Teoria)*, ...fq. 17.

³⁰. Numëroj, *Unë jam unë, Biçikleta prej çokolade, Shtrati i kaprollit, Sa më shumë drunjt, Ora, Mali, Topi, Loni e Liraku në pyll, Fëmijët, Duart e arta dhe Ditët e javës sime.*

³¹. Deva Agim, *Unë jam unë, Prishtinë, 2001.*

³². Deva Agim, *Numroj, Prishtinë, 2001*

³³. Bishqemi Astrit, *Letërsia për fëmijë (Teoria)*, ...fq. 15

Gjuha e personifikimit dhe alegorisë

Po të flitet për gjuhën e personifikimit në veprën letrare, duhet të flitet për gjuhën e fabulës. Gjuha e fabulës ngërthen në vete një sistem unik, që funksionon me elementet e gjuhës së metaforës, personifikimit, alegorisë, simbolit, në gjuhën e personifikuar të personazheve etj.

Se çfarë është gjuha e personifikimit më së miri e perifrizon në kuadër të vlerësimit teorik të letërsisë për fëmijë kritiku rus Bjelinski; *Krijimet për të vegjlit duhet të jenë të shkruara me gjuhë të lehtë, të lirë, lodruese... duhet t'i japësh shpirt gjithë botës e gjithë natyrës, duhet ta detyrosh të flasë me gjuhën e dashurisë e jetës edhe gurin memec, edhe lulen e fushës, edhe rrëkenë që gurgullon, edhe erën që fishkëllen.*³⁴

Ky studiues flet kështu për gjuhën e personifikimit të cilën Agim Deva e përdor shumë në veprën e tij letrare. Në poezinë e Devës flasin traktori (*Traktori në fushë*), karrigia (*Karrigia me fustan*), qershia (*Qershia në kandar*), era (*Derë më derë*), flasin kafshët (*Spitali në pyll*). Në përmbledhjen poetike *Reja që shet akullore*, reja e personifikuar aludon në një shitëse akulloresh, në poezinë *Pikniku i rrugës*, rruga vishet sikur të ishte njeri, dhe në poezinë e Devës, flet guri i cili bënë një monolog brenga në mur etj.

Periudha e parë e krijimtarisë letrare e Devës, karakterizohet me ndërtimin e poezisë fabulare, me mjete stilistike si; personifikimi, alegoria, krahasimi, onomatopeja, metafora etj, kjo periudhë lidhet me botën shtazore e bimore, natyrën, marrëdhënien e fëmijëve në raport me kafshët, dashurinë, miqësinë, njohjen me veset, virtytet, me vlerat reale dhe të personifikuara. Personifikimi është karakteristikë për fabulën, por edhe manifestimin e gjuhës së dialogut të cilin e zhvillojnë personazhet. Në tekstin poetik të Devës flasin, qeshin, këndojnë, bëjnë dialog kafshët, lulet, stinët, sendet me fëmijët.

Në poezitë e Devës personifikimi dhe alegoria dalin të gërshetuara p.sh. në vjershat: *Era kërkon punë, Vogëlushja mbi çikletë, Kur hidhërohen përroskat etj.* Me poezitë e tij si: *Spitali në pyll, Ari, Ujku, Bretkosa, Dreri, Deva* është krijues i gjuhës më të avancuar poetike, më inventive se sa pararendësit e tij.³⁵

³⁴. Bishqemi A, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 1997, fq. 15*

³⁵. Demiri-Frangu Qibrije, *Letërsia për fëmijë, Prishtinë, 2011, fq. 135*

Përfundim

Gjuha në shërbim të funksionit estetik realizohet përmes gjuhës së figurës, prandaj e quajmë gjuhë figurative. Figurat në poezi shërbejnë për të ngjallur ndjenjën estetike, dhe kanë forcë të madhe artistike. Interpretimi i figurave dhe roli i madh i tyre në letërsinë për fëmijë është bërë në monografinë e Agim Devës me një kapitull të veçantë, *Vlerat stilistike –figurative*.³⁶

Bota fikzionale e Devës del gjithnjë në përdorimin e gjuhës figurative. Kështu te Deva kemi: gjuhë sinonimie, gjuhë antonimie, gjuhë metonimie, gjuhë e ironisë, gjuhë frazeologjike, gjuhë onomatopeike, gjuhë alegorie, gjuhë e asociacioneve, gjuhë simbolike etj.

“Një fjalë bart në vete jo vetëm kuptimin e saj leksikor, po tërë një atmosferë të sinonimeve e të homonimeve, meqenëse fjalët nuk kanë vetëm kuptimin e tyre, po rikujtojnë kuptimin e fjalëve të ngjashme për tingëllim, ndjenjë e prejardhje e së fundit të fjalëve që kundërvihen dhe përjashtohen”.³⁷

Vepra letrare për fëmijë si dhe çdo vepër letrare përbërësin kryesor e ka gjuhën, shtjellimin gjuhësor poetik nga dalin mesazhet, përkatësisht nga marrëdhënia e fjalëve mes veti, nga shumësia dhe nuancimet kuptimore, ngjyrimet ndjenjësore e tingullore, për afrimi, ballafaqimi dhe përplasja ose kundërvënia nga humori dhe përmasa argëtuese – loja.

Deva përdor gjuhën si pasthirmë që del në nivelin artistik përmes tingujve që zgjojnë efekte gëzimi, hidhërimi, habie, lejimi, frike e cila realizohet përmes figurës së onomatopesë duke

personifikuar objekte, fenomene, kafshë e bimë. Kjo strukturë gjuhësore realizohet përmes tingujve, efekteve muzikore të ritmit e rimës dhe formojnë shtresën estetike të tekstit poetik.

³⁶. Deva Agim, *Poezia shqipe për fëmijë (1972-1980)*, Prishtinë, 1982, ff. 416-453.

³⁷. Velek Rene, *Voren Ostin, Teoria e letërsisë*, Tiranë, 1993, fq.?

Literatura

- [1]. Deva Agim, Gurët fluturues, Prishtinë, 2007
- [2]. Deva Agim, Gishti ngjyrë vjollce, Prishtinë, 1973
- [3]. Deva Agim, Këtu dikush ka qenë, Prishtinë, 2005
- [4]. Deva Agim, Natyreza, Prishtinë, 2002
- [5]. Deva Agim, Loni e Liraku në pyll, Prishtinë, 2000
- [6]. Deva Agim, Trumbeta e art, Prishtinë, 1968
- [7]. Deva Agim, Fëmijët, Prishtinë, 2001
- [8]. Deva Agim, Mali, Prishtinë, 2001
- [9]. Deva Agim, Numëroj, Prishtinë, 2001
- [10]. Deva Agim, Ora, Prishtinë, 2001
- [11]. Deva AGIM, Sa më shumë drunj, Prishtinë, 2001
- [12]. Deva Agim, Unë jam unë, Prishtinë, 2001
- [13]. Deva Agim, Poezia shqipe për fëmijë (1972-1980), Prishtinë, 1982
- [14]. Berisha N. Anton, Letërsia për fëmijë si art i fjalës, Tiranë, 2013
- [15]. Lloshi Xhevat, Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988
- [16]. Demiri-Frangu Qibrije, Letërsia për fëmijë, Prishtinë, 2011
- [17]. Beci Bahri, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë, 2010
- [18]. Qosja Rexhep, Historia e letërsisë shqipe-Romantizmi III, Prishtinë, 1986
- [19]. Rrahmani Zejnullah, Teoria e letërsisë, Prishtinë, 1996
- [20]. Sopaj Nehas, Letërsia për fëmijë, Shkup, 2007
- [21]. Bishqemi Astrit, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, Elbasan, 1997
- [22]. Bishqemi Astrit, Letërsia për fëmijë (Teoria)
- [23]. Sadiku Neshyt, Letërsia për fëmijë, Shkup, 2002.
- [24]. Shkurtaj Gjovalin, Si të shkruajm shqip, Tiranë, 2008
- [25]. Gaçe Bardhosh, Letërsia shqipe për fëmijë, Vlorë, 2005
- [26]. Bardhi Violetë, Krijimtaria letrare e Agim Devës, Prishtinë, 2014
- [27]. Velek Rene, Voren Ostin, Teoria e letërsisë, Tiranë, 1993

*XHON KUANRUD***SHOQËRIA BIBLIKE: VEPRIMTARIA E SAJ
NË SHQIPËRI GJATË SHEKULLIT XIX**

Parathënia në vijim, që jep një përshkrim të shkurtër për punën e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja në Shqipëri në shekullin XIX, është marrë nga libri “Pengu i kaçakëve” shkruar nga Gjerasim Qiriazit. Ky libër së shpejti pritet të ribotohet në gjuhën shqipe. Qiriazit ishte zënë peng nga një bandë kaçakësh nën drejtimin e Shahin Matrakut afër Qafës së Zvezdës në nëntor të vitit 1884, përgjatë një udhëtimit nga Manastiri deri në Korçë. Ai ishte mbajtur peng dhe kishte qenë i keqtrajtuar nga ana e banditëve për gjashtë muaj, më së shumti nëpër malet në perëndim të Korçës. Dhjetë vite pas ngjarjes, Qiriazit përmbledhi kujtimet e tij në një libër, duke përshkruar deri në detaj kohën që kaloi bashkë me kaçakët. Më vonë, pas vdekjes së Qiriazit në vitin 1894, kjo përmbledhje ishte përkthyer në gjuhën angleze nga ana e misionarit amerikan në Manastir, Xhon Berd. Shoqëria e Traktit Fetar (Religious Tract Society) në Londër e botoi përkthimin e Berdit në vitin 1902 të titulluar “Captured by Brigands” (I rrëmbyer nga kaçakët). Dr. Xhon Kuanrud e filloi hulumtimin e tij rreth historisë së familjes Qiriazit dhe periudhës së Rilindjes shqiptare përderisa studionte Gjuhë dhe Letërsi shqipe në Universitetin e Prishtinës në vitet 1988–90. Botimet e tij përmbajnë edhe një monografi të jetës së Gjerasim Qiriazit.

* * *

Në vitin 1884 Shoqëria Biblike ngarkoi Gjerasim Qiriazin që të drejtonte punën e saj për Shqipërinë, duke krijuar një bazë të re në qytetin e Manastirit. Por, vetëm disa muaj pasi filloi këtë detyrë, Qiriazit u zu rob nga një bandë kaçakësh. Ata kërkuan një shumë të madhe për lirinë e tij. Ky libër [*Pengu i kaçakëve*] është një përshkrim real i mundimeve që hoqi vetë autori gjatë gjashtë muajve që ishte peng në duart e tyre. Pas lirimit, Qiriazit vazhdoi të punonte me Shoqërinë Biblike dhe qëndroi në shërbim të saj deri kur vdiq, më 1894.

Për të ndriçuar sadopak punën që ka bërë kjo shoqëri në Shqipëri gjatë shek. XIX, po japim disa të dhëna për të, dhe për veprimtarinë e saj.

Shoqëria Biblike u formua në Angli në vitin 1804. Ajo e vendosi qendrën e saj në Londër, me qëllim që të realizonte përkthimin, shtypjen dhe shpërndarjen e Biblës në mbarë botën. Puna e Shoqatës u përhap me shpejtësi, duke përfshirë edhe gjuhë të cilat nuk e kishin të zhvilluar sistemin e të shkruarit. Aty nga viti 1825 ishin botuar 4.252.000 Bibla në 140 gjuhë dhe dialekte. Që prej fillimit, shoqata i zgjidhte me shumë kujdes njerëzit që dërgonte për të mbikëqyrur qendrat e

ndryshme. Në përgjithësi, ishin njerëz me arsim të lartë dhe ngandonjëherë, edhe gjuhëtarë të shquar. Përkthimi i Biblës shërbeu, në shumë vende, si nxitje për kristalizimin e gjuhës kombëtare.

Shoqëria Biblike nuk financohej fare nga shteti dhe, në shumë drejtime, funksiononte si çdo kompani tjetër. Në Londër kishte Komitetin e saj prej 36 anëtarësh, i cili mbante përgjegjësi për punën e Shoqatës. Sekretari merrej me transaksionet dhe me korrespondencën e përditshme, si edhe mbikëqyrte përfaqësuesit e shumtë që punonin në mbarë botën. Në çdo vend ngrihej një qendër operative, zakonisht në kryeqytet, nga ku drejtohej puna. Kryepërfaqësuesi i Shoqërisë Biblike të atij vendi ishte përgjegjës për të gjitha aspektet e punës së shoqatës atje. Ai duhej të kërkonte dhe të gjente përkthyes të aftë, që të bënin përkthimet e Biblës në gjuhët ose në dialektet e ndryshme që fliteshin në atë vend. Pastaj ishte puna e shtypjes, magazinimit, transportimit, llogaritjeve, si edhe ajo e librashitësve shëtitës. Gjithashtu, kërkohej edhe diplomaci, atëherë kur një qeveri përpiqej të kufizonte apo të ndalonte publikimin e literaturës në një gjuhë apo në një dialekt të caktuar për arsye politike ose fetare.

Shoqëria Biblike filloi të interesohej për Shqipërinë në një kohë kur Shqipëria dhe shqiptarët njiheshin shumë pak në botë. Ali Pashë Tepelena sundonte Jugun e Shqipërisë që nga Janina. Korfuzi dhe ishujt e Jonit ishin nën flamurin Britanik. Lord Bajroni sapo e kishte bërë udhëtimin e tij nëpër ato vise, udhëtim të cilin, më vonë, ai e përjetësoi në poemën epike *Çajld Harold*.

Në arkivat e Shoqërisë Biblike në Bibliotekën e Universitetit të Kembrixhit të dhënat më të hershme në lidhje me Shqipërinë janë nga një letër e shkruar më 28 gusht 1816. Dr. Robert Pinkerton, që kishte qenë përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike në Moskë, gjatë qëndrimit të tij në Vjenë ishte takuar me një grup shqiptarësh. Ata i kishin folur atij për kombin e tyre, si edhe për gjendjen e popullit. Pas këtij takimi Pinkertoni i raportoi Komitetit në Londër:

Pajisja e shqiptarëve, të paktën me një Dhiatë të Re në gjuhën e tyre, është një qëllim që meriton vëmendjen e Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja. Ky komb zë një pjesë të madhe të Ilirisë së lashtë e të Epirit dhe flet një gjuhë që, siç duket, nuk ka afërsi gramatikore me sllavishten, turqishten, greqishten ose latinishten. Shërbesat i bëjnë në gjuhën greke, e cila është krejt e pakuptueshme për popullin, madje edhe për shumë nga priftërinjtë.

Më 25 tetor 1818 Pinterkoni shkroi nga Stambolli:

Unë kam gjetur tani njeriun i cili, shpresoj, është i destinuar t'u japë vëllezërve të tij bekimin e madh, duke u dhënë atyre Dhiatën e Re në gjuhën amtare. Emri i tij është Vangjel Meksi... Ai njihet mirë nga Patriarku grek i Kostandinopojës, i cili... ka premtuar të gjejë dy klerikë që njihnin mirë gjuhën shqipe, me qëllim që ta ndihmojnë Dr. Maksin në punën e tij dhe për ta dhënë versionin sa më saktë që të jetë e mundur.

Më 1824 nga Shoqëria Biblike, nëpërmjet degës së Korfuzit, u botua *Ungjilli sipas Mateut* dhe më 1827 u botua e plotë *Dhjata e re*. Ecuria e përkthimit u ndoq

me interes të madh në Shqipëri. Në këtë kohë misionari britanik Isak Loundz (Isaac Lowndes) shkruante se “një prift i këtij kombi kishte shkuar tek ai për t’i kërkuar një kopje [të *Ungjillit sipas Mateut*], duke thënë, se ai kishte të dhëna nga vendi i tij që shumë veta mezi prisnin për ta pasur këtë vepër”.¹

Më 1860 Dr. Aleksandër Tomson u caktua kryepërfaqësues i Shoqërisë Biblike në Stamboll për gjithë Perandorinë Osmane. Puna e tij shtrihej në Vallaki, Moldavi, Siri, Palestinë, Egjipt dhe në Turqinë Aziatike. Ai e tregoi veten se ishte një punëtor i zellshëm. Në tridhjetë e gjashtë vitet e punës me Shoqërinë Biblike, nën drejtimin e tij u futën në qarkullim më shumë se një milion kopje të Biblës së plotë ose botime me pjesë të Biblës, në më shumë se njëzet gjuhë.

Tomsoni lindi në Skoci më 1820 dhe studioi greqisht, hebraisht dhe latinisht në universitetin e Edinburgut. Më 1845 ai u tërhoq nga detyra e profesorit të hebraishtes dhe u dërgua nga Kisha e Lirë e Skocisë si misionar në Budapest dhe pastaj në Stamboll. Një gjuhëtar me dhunti, ai fliste rrjedhshëm një numër gjuhësh.

Pasioni i tij për Shqipërinë filloi më 1863 kur vizitoi “qytetet kryesore të Shqipërisë, që ndodheshin më pranë bregdetit perëndimor”. Ai e ndjente fort se ai “duhej të bënte diçka për Shqipërinë, Hercegovinën, Bosnjën dhe, nëse ishte e mundur, edhe për Malin e Zi”. Ky udhëtim do të linte mbresa të pashlyeshme tek Tomsoni dhe ai shpesh do t’u referohej atyre vite më vonë.

Arritja në Shkodër e Dr. Aleksandër Tomsonit, xhentëlmeni skocez që shiste libra të paaprovuar nga klerikët lokalë dhe që bisedonte lirshëm në turqisht, italisht, gjermanisht, greqisht, frëngjisht, bile edhe në hebraisht, shkaktoi mjaft admirim dhe habi. Gjatë vizitës së tij tetëditëshe në Shqipëri ai vizitoi edhe Tiranën, Elbasanin dhe Beratin. Më vonë, nga Bari, ai raportonte se: “të gjithë librat e mi greqisht, italisht dhe turqisht u shitën — [më janë] lutur që të kthehem përsëri së shpejti”. Sidoqoftë, për librat shqip ishte e qartë se versioni toskë me alfabetin grek nuk ishte i përshtatshëm për përdorim në veri dhe ai raportonte se i kishin kërkuar të botonte një Bibël në “shqip, me germa romake”.

Ai filloi menjëherë të bënte përgatitjet për një çift të ri skocez, i cili do të vendosej në Shkodër për të ngritur atje një depo librash. Në një letër drejtuar Sebastiano Bellos nga Shkodra, më 19 mars 1864, Tomsoni shkruante: “Në vijim të qëllimit të vizitës sime të fundit, unë tani po dërgoj në Shkodër zotin H. Rajdel”. Në këtë letër ai gjithashtu thotë se “Shoqata ime do të përgatitet të shtypë në shqip dhe me germa romake një përkthim të mirë dhe besnik të Ungjijve dhe të Veprave”.

Gjithashtu, Tomsoni, për të botuar versionin e ri gegë, po kërkonte një gjuhëtar të përshtatshëm. Në Stamboll, një djalë i ri i quajtur Kosakas, i tregoi Tomsonit për një shqiptar me të cilin kishte studiuar në Maltë. Ai quhej Kostandin Kristoforidhi dhe ndodhej në Tunizi. Më 7 dhjetor 1864 Tomsoni i dërgon një letër Kristoforidhit, ku i tregon për dëshirën e shoqatës për të përgatitur Biblën në shqip me shkronja latine, “për Mirditorët”. Në këtë letër Tomsoni përmend edhe se ai kishte dëgjuar që Kristoforidhi “kishte pasur dikur pikëpamje misionare për popullin e tij”.

¹ D. M. Young, *The Gospel in Albania*, Reksam, Uells, 1991.

Më 7 janar 1865 Kristoforidhi, në përgjigjen që i kthen Tomsonit, shpreh kënaqësinë e tij “që Shoqëria Biblike, më në fund, vendosi të bëjë diçka për Shqipërinë”, duke i treguar Tomsonit se ai e “kishte përkthyer tashmë të gjithë Dhiatën e Re në të dy dialektet: në të veriut e në të jugut, me germa greke” dhe se “do të ishte shumë e lehtë për ta rishkruar atë me germa romake”. Më 12 prill 1865 Kristoforidhi i shkruan Tomsonit nga Tunizia dhe e njofton se i pranon kushtet. Në fund të majit nisjet për Stamboll.

Për të ndihmuar Kristoforidhin në punën e tij duhej edhe një ndihmës që fliste gegërisht. Rajdeli e informoi Tomsonin nga Shkodra për një shqiptar të ri të arsimuar të quajtur Nikolla Xhovani Seregji. Në maj 1865 ai arriti në Stamboll. Kristoforidhi u kënaq me aftësitë e tij dhe të dy filluan punën në fillim të qershorit.

Çështja se cili alfabet do të përdorej doli se ishte e vështirë. Që nga fillimi Tomsoni e ndjente nevojën e një alfabeti të vetëm për kombin, por më 1866 shqetësimi i tij kryesor ishte që përkthimi “të mos refuzohej nga popullsia e Shqipërisë së Veriut” për shkak se nuk mund të lexohej. Më 1867 ai udhëton përsëri në Shqipëri për t’u njohur më mirë me vendin dhe “për të gjykuar nëse ishte e këshillueshme që të vazhdohej me ortografinë e Lepsiusit”. Karl Lepsiusi, një profesor në universitetin e Berlinit, kishte hartuar një alfabet të bazuar në shkronja romake. Ky alfabet, duke i shtuar disa shkronja greke dhe disa shenja diakritike, ishte në gjendje të paraqiste tingujt e shqipes. Tomsoni udhëtoi nëpërmjet Sirës, ku takoi gjuhëtarin e shquar dhe autorin e *Albanesische Studien*, Johan Georg von Hahn, i cili e kishte studiuar shqipen me Kristoforidhin dhe fliste shumë mirë për të. Von Hahn i tha Tomsonit se ai “e aprovonte pa hezitim Lepsiusin”.²

Vite më vonë, Tomsoni i shkruan Kristoforidhit:

Juve do t’ju kujtohet gjithmonë se ishte mendimi im që, meqë toskët e gegët janë i njëjti komb, unë përdora dy alfabete të ndryshme vetëm që të dy ndarjet e kombit të ishin në gjendje të lexonin menjëherë Biblën me gerrat që ata njihnin, por, gjithashtu, unë shpresoja të shihja që një ditë i gjithë kombi do të përdorte një alfabet. Edhe në alfabetin grek për toskërishten ne kemi përdorur pikat, të cilat nuk janë të dëshirueshme, gjithashtu ne kemi pika të ndryshme edhe në alfabetin gegë të Lepsiusit. Tani alfabeti i ri, me gjithë format e tij të huaja, nuk ka pika apo shenja të tjera, megjithëse unë mendoj se theksi duhet të vihet gjithmonë mbi rrokjen e theksuar. Nëse do të bëhej kjo, unë mendoj se alfabeti i ri do t’i kënaqte të gjithë dhe do të ishte më i mirë se secili nga tanët, toskë apo gegë.³

Më 1866 doli nga shtypi *Katër Ungjillat e Zotit edhe Shërbyesit tynë Iesu Krishtit edhe Punët e Apostujvet*, i pari përkthim i botuar i Kristoforidhit. Për vite me radhë Shoqëria Biblike botoi përkthimet e Kristoforidhit — Dhiatën e Re të plotë, Psalmet dhe pjesët e tjera të Dhiatës së Vjetër — në të dy dialektet, gegë dhe toskë.

Më 1870 Kristoforidhi u kthye në Shqipëri në shërbim të Shoqërisë Biblike për të shitur librat, të cilat ai ishte munduar aq shumë t’i përkthente. Në një letër

² *Monthly Reporter* e Shoqërisë Biblike për vitin 1866, f. 560.

³ Letra e A. Tomsonit dërguar K. Kristoforidhit më 21 shtator 1893.

drejtuar Tomsonit nga Tirana, më 31 gusht 1870, ai shkruante se udhëtimi i shërbeu shumë punës së tij dhe se ai, “Po mban shënim theksin etj., në secilin qytet”, “gjithashtu jam duke mbledhur terma shqiptare”.

Kristoforidhi, i cili mezi priste që t’i çonte librat në duart e njerëzve, shpesh ua jepte atyre falas dhe pastaj i paguante vetë. Më 12 tetor 1870 ai i raportonte Tomsonit për shitje të mira në Durrës, Elbasan dhe Tiranë. “Qeveria ka ngritur dhjetë shkolla në Shqipëri”, shkruan ai, “ku mësohet arabisht, persisht dhe turqisht, — por nuk ka bërë asgjë për Shqipërinë — as gazeta, as libra shkolle. Populli po pret me padurim”.

Kristoforidhi e mbaroi punën si librashitës më 1874. Kjo përvojë i dha rastin që të mbledhë lëndë gjuhësore, të cilën e shfrytëzoi në fjalorin e tij, të botuar në Athinë më 1904. Nga 1879 deri më 1883, kur mbaroi përfundimisht punësimi i tij në Shoqërinë Biblike, Kristoforidhi vazhdoi të përkthente tekste Biblike.

Më 25 nëntor 1879, Tomsonin e vizituan dy përfaqësues të komitetit shqiptar të Stambollit:

Ata më falënderuan nga zemra dhe shprehën dëshirën t’i dërgojnë falënderime Shoqërisë për atë që ka bërë duke nxjerrë në pah gjuhën amtare të vendit. Ata, gjithashtu, lëvduan punën e zotit Kristoforidhi, i cili, në shërbim të Shoqërisë, ka hedhur poshtë shpifjet e përbuzura të grekëve dhe ka provuar që shqipja është një gjuhë e saktë dhe shprehëse, në mos edhe e pasur.⁴

Për shpërndarjen e Shkrimeve të Shenjta, të përkthyer nga Kristoforidhi, pati shumë pengesa, me gjithë cilësinë e mirë të tyre. Qeveria osmane ndiqte një politikë tepër antishqiptare, gjë që e bënte punën e shpërndarjes së librave të vështirë dhe të rrezikshme. Më 1882 Tomsoni dëgjoi për një shqiptar të ri nga Manastiri, i cili sapo kishte mbaruar studimet teologjike në Samokov të Bullgarisë. Më 18 janar 1883 Tomsoni i shkruan Gjerasim Qiriazit në Shkup:

Marr guximin t’ju shkruaj disa rreshta, sepse e di që jeni shqiptar dhe si i tillë dëshironi që Ungjilli i hirit të Perëndisë të futet tek bashkëkombësit tuaj. Për vite me radhë, që prej 1863-shit, kur vizitova për here të parë Shqipërinë dhe lexova historinë e kombit tuaj, ku mësova se si Skënderbeu luftoi për popullin e vet, kam qenë mjaft i brengosur për këtë popull dhe jam përpjekur që të përhap midis shqiptarëve Fjalën e Perëndisë si të vetmin mjet për të ndezur jetën shpirtërore tek ata... Kur mendoj për gjendjen në të cilën ndodhen shqiptarët, më duket se për ta është domosdoshmëri e madhe të kenë shkolla ku fëmijët të mësojnë gjuhën amtare me Fjalën e Perëndisë dhe ku ne t’u predikojmë atyre Shpëtimtarin Jezus, mikun e mëkatarëve... Do të kisha dëshirë të dija se ç’mendoni ju për këtë punë dhe nëse do të dëshironit të bëheshit ungjilltari i kombit tuaj. Ju lutemi na shkruani se ç’duhet të bëjmë për të vazhduar më tej.

⁴ Letra e A. Tomsonit dërguar Komitetit më 25 nëntor 1879, *Edited Correspondence Inbound*, vëll. XIV, f. 126–28.

Në fillim të punësimit të tij pranë Shoqërisë Biblike, bashkë me një librashitës shëtitës, Gjerasimi bëri një udhëtim nëpër Shqipëri. Ai filloi nga Manastiri dhe pastaj vizitoi Korçën, Përmetin, Beratin, Kavajën, Durrësin, Vlorën, Tiranën dhe Elbasanin. Në Kavajë i arrestuan sepse shisnin libra shqip dhe i dërguan në Durrës, ku i mbajtën disa ditë, derisa erdhi urdhri nga Stambolli për lirimin e tyre. Udhëtimet e Gjerasimit nëpër Shqipëri e ndihmuan të kuptonte nevojat e kombit të tij. Që nga shtatori i vitit 1883 deri në prill 1884 qëndroi në Stamboll për të mësuar për veprimtarinë e Shoqërisë Biblike dhe për të studiuar shqip nga Kristoforidhi, veçanërisht gegërishten.

Në pranverën e vitit 1884 Qiriazit kthehet në Manastir, bashkë me një librashitës shqiptar, Gjon Ciku. Atje krijoi një bazë, nga e cila do të përhapte punën e Shoqërisë Biblike në Shqipëri. Puna zhvillohej nën mbikëqyrjen e tij dhe më 1887, në një raport të Tomsonit, lexojmë për tre depo të Shoqërisë Biblike në Shqipëri: në Manastir, në Janinë dhe në Shkodër, me gjashtë librashitës shëtitës gjithsej.

Ndër detyrat e Qiriazit ishin edhe organizimi i udhëtimeve të shitësve, bërja e llogarive të Shoqërisë dhe puna gjuhësore e redaktimit dhe e rishikimit të botimeve. Shpesh herë, gjatë kësaj pune, ai pengohej nga autoritetet otomane. Gjithashtu, ditën, ai filloi të jepte mësimë shqip për nxënësit e shkollës amerikane në Manastir, kurse natën mësonte të rriturit.

Në shkollën e parë shqipe, të hapur në Korçë më 1887, si edhe në shkollën e parë shqipe për vajzat, të themeluar nga Gjerasimi dhe e motra, Sevastia, më 1891, janë përdorur botime të Shoqërisë Biblike.

Në vitet para Luftës së Parë Botërore janë marrë me punën e Shoqërisë Biblike edhe Gjergj Qiriazit, Nuçi Naçi, Grigor Cilka, dhe Athanas Sina. Aleksandër Tomsoni, si përfaqësues i Shoqërisë Biblike, njihet nga rilindasit më të njohur, duke përfshirë Naim Frashërin, Jani Vreton, Petro Nini Luarasin, Pandeli Sotirin, Thimi Mitkon, etj.

Shoqëria Biblike, me botimin, shitjen dhe shpërndarjen e literaturës shqipe nëpër të gjithë vendin, përkrahu dhe ndihmoi fuqimisht luftën kundër analfabetizmit në Shqipëri. Por vizioni që frymëzoi anëtarët e Shoqërisë Biblike, si Tomsoni, Qiriazët, Cilka dhe të tjerë, ishte më shumë se thjesht një program arsimor. Në shpalljen e themelimit të “Vëllazërisë Ungjillore” në vitin 1892, Gjerasim Qiriazit shkroi këto fjalë:

Fjalët e jetës, që ndriçojnë zemrat, që gëzojnë dhe shpien në udhë të mbarë kanë qenë për fat të keq fshehur nga sytë tanë edhe sot e kësaj dite. Të pakët janë ata që kupëtojnë ëmbëlsinë dhe fuqinë e fjalëve të ungjillit. Po, ndë qofshin mësimet e ungjillit kaq të vyera, pse të mos këndohen shqip ndë kishat ndë Shqipëri që t’i marrin vesh që të gjithë? Ndë daçim të sjellim qytetërimin e mirësinë dhe ditë të bardha për Shqipërinë, këto mësimë duhen mbjellë në çdo zemër që t’i dijë i madhi e i vogli. Ato mësimë na kanë për të sjellë dashurinë dhe vëllazërinë, se ato na mësojnë të duam jo vetëm miqtë por dhe asmëtë, na bëjnë të jemi të besës ndë çdo punë, na shpëtojnë nga

ankimet dhe nga mëria që gjenden ndërmest tonë dhe na ngasin të vemi mbroth ndë çdo punë të mirë si për vehte, kështu edhe për të tjerët.

Gjatë viteve të punës së saj në Shqipëri, Shoqëria Biblike ka dhënë një ndihmesë të madhe në shumë drejtime, veçanërisht për mësimin dhe përhapjen e gjuhës së shkruar shqipe. Rilindësit i njihnin mirë dhe i vlerësonin ndihmesat e saj në të mirë të çështjes shqiptare. Më 1912 patrioti i njohur Mit'hat Frashëri, e vlerësoi kështu këtë kontribut:

Para së gjithash jam i detyruar t'i drejtoj falënderimet e përzemërta Shoqërisë Biblike Britanike dhe për Vendet e Huaja, për shërbimet që i ka bërë vendit dhe letërsisë sonë duke përkthyer Librin e Shenjtë në shqip. Ç'është e vërteta, gjuha dhe letërsia shqipe janë pazgjidhshmërisht të lidhura me mundin dhe përkushtimin e atyre që, me gjithë vështirësitë e mëdha, e kanë vazhduar këtë punë fisnike për kaq kohë.⁵

⁵ Lumo Skendo, "Albania and the Bible Society", *The Bible and the World*, Londër, korrik 1912, f. 218.

DAVID HOSAFLOOK

EDITH DURHAM: “PSE U INTERESOVA PËR FATIN E SHQIPËRISË”

Ndihem i privilegjuar, si i huaj, të kem banuar mes shqiptarëve qysh në vitin 1992. Ndër pyetjet e para që më bëhen ende sot janë: “Përse keni ardhur në Shqipëri?” “Kur keni dëgjuar për Shqipërinë për herë të parë?” ose “Si jeni interesuar për popullin shqiptar?”.

Kur mendojmë për “Mbretëreshën” Edith Durham, na vijnë ndërmend pikërisht këto pyetje. Kur Durhami u këshillua nga mjeku i saj që të shkonte diku larg për t’u çlodhur nga barra e përkujdesjes së vazhdueshme për nënën e saj të sëmurë, ajo zgjodhi Ballkanin në përgjithësi, jo Shqipërinë.ⁱ Nga viti 1900-1903 ajo udhëtoi kryesisht në vendet sllave.

Në vitin 1900 Durhami vizitoi Malin e Zi si dhe kryeqytetin e tij, Cetinje. Aty u takua me ca shqiptarë dhe njoftimi i parë i saj për shqiptarët, që kam gjetur unë, ka qenë më 10 shtator 1900, kur i ka shkruar së ëmës: “Burrat shqiptarë janë ata që më bëjnë të qesh më shumë se të tjerët”.ⁱⁱ Pavarësisht se si mund të kuptohet kjo fjali, me siguri nuk shënoi ndonjë simpati ose vlerësim të madh për popullin shqiptar.

Në vitin 1901 Durhami e vizitoi edhe një herë Malin e Zi, por kësaj radhe vizitoi edhe Shkodrën.ⁱⁱⁱ Ajo do të rrëfejë më vonë në librin e saj “Ngatërresa ballkanike 20 vjeçare” se Shkodra i kishte bërë përshtypje. Sidoqoftë, interesi i saj për shqiptarët në vitin 1901 nuk ishte diçka për t’u shënuar, ndryshe nga interesimi i saj për popujt e tjerë.

Në vitin 1902 Durhami kthehet sërish në Malin e Zi, por kësaj radhe viziton edhe Serbinë. Pas këtij udhëtimi ajo do të shkruante librin e saj të parë “Përmes tokave të serbit” (*Through the Lands of the Serb*). Ky libër kishte material të mirë për shqiptarët, por studiuesi kanadez Medavari, në analizën e vet të librit, shprehet se Durhami më shumë mbështet pretendimet e popujve sllavë.^{iv} Vetë titulli i librit ngjall debat sepse lë për të kuptuar se tokat ku kishte udhëtuar Durhami (përfshirë edhe Kosovën dhe veriun e Shqipërisë) u përkisnin serbëve. Nuk është për t’u çuditur që Durhami, udhëtarja, do të ndikohej nga bindjet politike të udhërrëfyesve të saj sllavë në perceptimin e saj të realitetit.

Por më vonë, dukshëm, vëmendja e saj do t’i kalonte Shqipërisë dhe ajo do të krijonte një pasion të veçantë për shqiptarët dhe një bindje që pretendimet e tyre ishin të drejta. Ky pasion dhe këto bindje nuk do të shuheshin gjatë gjithë jetës së saj. Pse Edith? Si ndodhi që u bëre kaq e interesuar për popullin shqiptar? Si ishte fillesa e këtij shndërrimi?

Vetë Durhami na tregon në Raportet e Institucionit Mbretëror të Britanisë së Madhe në një botim rreth vitit 1940. Durhami ishte 77-vjeçe dhe po reflektonte mbi jetën e saj. Ajo shkruan: “U interesova për çështjen shqiptare më 1903.”^v Por pse dhe si?

Më 1903 nisi në Maqedoni një kryengritje kundër Perandorisë Osmane, e cila u shtyp ashpërsisht, duke krijuar kaos, varfëri të skajshme dhe zi buke. U caktua që Edith Durhami, bashkë me Henry dhe Jane Brailsford-in të shkonin me Komitetin Humanitar Britanik për Maqedoninë, për të udhëhequr projektin e ndihmave.^{vi} Kaluan kohë në Manastir dhe në Ohër. Manastiri ishte një qytet me shumë etni, madje Brejsfordi do të shkruante një libër për “racat e Maqedonisë”, ku ka shumë material edhe për shqiptarët. Puna humanitare e Durhamit u zhvillua mes një vuajtjeje njerëzore të tmerrshme. Komunikimi ishte një sfidë e veçantë për humanitarët anglezë, për shkak të etnive dhe gjuhëve të ndryshme në Ballkan. Durhami dhe Brejsfordi, në shkrimet e tyre thonë se shumica e përkthyesve dhe ndihmësve të tyre ishin shqiptarë të siguar nga shoqëria protestante “British Foreign and Bible Society” (Shoqëria Biblike), e cila kishte një qendër në Manastir. Shoqëria Biblike ishte marrë me përkthimin e Biblës në gjuhën shqipe që prej vitit 1816. Durhami shkruante se “Puna jonë u ndihmua jashtëzakonisht shumë nga ndihmësit shqiptarë që na rekomandoi Shoqëria Biblike Britanike”.^{vii} Madje shton se këta shqiptarë ishin të aftë dhe të ndershëm dhe pa ta, puna e tyre do të ishte tejet e vështirë. Pra, shohim se në Maqedoni Durhami fillon të krijojë përshtypje të reja për popullin shqiptar.

Manastiri ishte, gjithashtu, një bazë për Bordin Amerikan të Misionarëve protestantë-ungjillorë. Në vitin 1877 familja e famshme Qiriazit u takua me misionarët amerikanë dhe pranoi besimin ungjillor.^{viii} Gjerasimi u bë predikues dhe themeloi kishën e parë protestante në Shqipëri (në Korçë). Motra e tij Sevastia ka nderin të jetë femra e parë shqiptare e diplomuar në një shkollë të lartë (Kolegjin Amerikan në lagjen “Skutari” të Stambollit). Më 1903, vëllai i tyre, Gjergj Qiriazit, ishte drejtori i qendrës së Shoqërisë Biblike në Manastir, ku po punonte Durhami. Durhami do të shkruante më vonë për Gjergjin: “Ishte burrë shumë i kulturuar dhe shqiptar patriotik”. Madje Durhami do të shtonte: “Prej tyre kuptova frymën e fortë nacionaliste që po vepronte [ndër shqiptarë]”.^{ix}

Në pranverën e vitit 1904 u duk sikur po përgatitej një kryengritje e re në Maqedoni dhe për këtë arsye shteti britanik bëri thirrje që Durhami dhe punonjësit e tjerë të misionit humanitar të ktheheshin në Angli, për shkak të rreziqeve të mundshme. Por sipas Durhamit, miqtë e saj shqiptarë iu lutën që të mos largohej, por të rrinte dhe të bënte me ta një udhëtim në Shqipëri.^x

Madje si parantezë, dhjetë vjet më vonë, në vitin 1914, Durhami do t’ia bënte pikërisht këtë lutje Princ Vidit, i sapoardhur në Shqipëri, i mbyllur brenda pallatit të vet dhe i ndikuar vazhdimisht nga intrigat e Esad Pashë Toptanit. Durhami iu lut atij që të udhëtonte me të në gjithë Shqipërinë, por Vidi nuk e bëri një gjë të tillë.^{xi} Kurse më 1904, Durhami e bëri. Prandaj Durhami njihet ende sot si mbretëreshë e Shqipërisë, por jo Vidi. Durhami e dinte se shqiptarët kurorëzojnë ata që rrinë në sofër me ta, jo ata që mbajnë kurorën në kokë.

Por si do ta realizonte Durhami një udhëtim të tillë? Me kë do të shkonte? Si do të mbrohej? U propozua nga qeveritari i Ohrit, Mehdi Frashëri, patriot shqiptar e kushëri i Mid'hat Frashërit (Lumo Skëndo), që të udhëtonte me një punonjës të Shoqërisë Biblike. Së shpejti, Thanas Sina, predikues protestant, përkthyes i Biblës dhe patriot shqiptar do të nisej nga Leskoviku e do të udhëtonte nga andej deri në Shkodër. Do të merrnin Biblat me vete, në turqisht, greqisht dhe shqip – mision jo pa rreziqe për shkak të kaçakëve që kishin marrë peng protestantë, si Gjerasim Qiriazhi dhe Katerina Cilka, si dhe për shkak të luftës së qeverisë turke dhe kishës greke kundër përhapjes së gjuhës shqipe (luftë diku më e ashpër e diku më e butë, por gjithnjë e pranishme).

Pavarësisht nga rreziqet, Durhami, e guximshme, paksa kundërshtare dhe gjithmonë e gatshme për aventurë, pranoi. U nis për në Leskovik, ku do të takohej me Thanas Sinën dhe familjen e tij. Rrugës kaloi në Korçë dhe aty u takua me vajzën përparimtare, Sevasti Qiriazhi, në atë kohë beqare. Na duket sikur Durhami ka parë vetveten te Sevastia, për hir të guximit të saj përballë vështirësive. Sevastia ishte drejtoresha e Shkollës së Vashave, e cila tani kishte kaluar nën përkujdesjen e Bordit Amerikan për ta mbrojtur nga përpjekjet e qeverisë për ta mbyllur. Sipas Brejsfordit, veprimtaria e Sevastisë po zhvillohej sikur të ishte krim ose turp (p.sh. shpesh duke dhënë mësim natën ose duke fshehur librat) por në realitet – thotë ai – ishte shembull i ëmbëlsisë dhe i mirëdashjes. Shpesh herë hynte në oborr një polic turk dhe Sevastisë i duhej t'i dilte para, mu te dera, që ta ndalonte të hynte e t'i merrte librat. Kjo trimëri ia ka bërë përshtypje Durhamit.

Në këtë kontekst mund të kuptohet dashamirësia e Durhamit për Sevastinë dhe përse do të mbanin lidhjet për gjithë jetën. Madje na befason Durhami me një zbulësë që gjendet në Arkivin e Shtetit Shqiptar, një letër me datën 14 maj 1918, në të cilën Durhami i thotë Sevastisë: “Është kryesisht nëpërmjet teje dhe miqve tuaj që unë u interesova për fatin e Shqipërisë”.^{xii}

Pas Korçës, Durhami e vazhdoi udhëtimin në Leskovik dhe, me Thanas Sinën dhe ndihmësit e tij u nisën dhe udhëtuan në Tepelenë, Vlorë, Berat, Elbasan, Durrës, Lezhë, Shkodër etj. Sipas saj, ata shitën i librat “në të gjitha qytezat e Shqipërisë”.^{xiii} Madje në Berat Durhami u arrestua bashkë me Sinën dhe iu konfiskuan librat e tyre shqip, por jo librat turqisht e greqisht.

Ky udhëtim ishte rasti i përsosur për Durhamin për t'u njohur me shqiptarët dhe me terrenin shqiptar. Durhami do të shkruante: “Ishte udhëtim frymëzues!”. Pse? Sepse çdo paragjykim që mund të ketë trashëguar nga populli serb dhe nga padija e përgjithshme e shtypit anglez për çështjet shqiptare, u godit me realitetin e njohjes vetjake të shqiptarëve dhe të situatës reale në vend.

Në Shqipëri Durhami kishte parë një popull të zgjuar, një vend të mahnitshëm, një kulturë dhe gjuhë krejt të veçantë dhe një sundim të ashpër dhe të padrejtë. Tek shqiptarët kishte parë një karakter të fortë, ndjenjë kombëtare, një rilindje në arsim dhe fillet e një lëvizjeje feministe. Por ata ishin pa zë në Angli. Ndaj Durhami filloi të bërtiste dhe jehona e zërit të saj kumbon ende sot.

Veprimtaria e Edith Durham për popullin shqiptar ka qenë madhështore dhe duhet të hulumtohet më tepër. Por, si gjithmonë, gjysma e punës është fillimi i mbarë. Durhami dëshmon se fillimi i misionit të saj në mbështetje të çështjes së

shqiptarëve ka qenë kaq i mbarë falë ungjillorëve, sepse nuk dihet se si Durhami do të mund të udhëtonte ndryshe, aq gjatë e gjerë në gjithë territorin shqiptar, sikur të mos i ofrohej një dorë nga shqiptarët e ndershëm të lëvizjes protestante.

ISAMEDIN AZIZI

KONCESIONET E ITALISË NË SHQIPËRI

(dokument për koncesionet e vajgurit dhënë Italisë në vitin 1925 nga ana e Qeverisë së Shqipërisë)

Politikat agresive të shteteve fqinje, mbi të gjitha të Serbisë dhe Greqisë ndaj Shqipërisë, kanë filluar nga fundit i shek. XIX, për të vazhduar me një intensitet më të lartë në fillimi të shek. XX. Një politikë të tillë agresive ndaj Shqipërisë e ka përkrahur dhe promovuar edhe ministri italian për punë të jashtme, Sidnej Sonini. Ai gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, por edhe më vonë, e sidomos gjatë Konferencës Paqësore të Parisit, me këmbëngulje ka kërkuar realizimin e pikëve të Marrëveshjes së Fshehtë të Londrës, të vitit 1915, marrëveshje kjo e cila kishte të bënte me aneksimin e territoreve të Shqipërisë nga ana e Italisë. Ky ministër italian njëkohësisht ishte edhe kundërshtari më i madh i idesë së bashkimit të sllavëve të jugut në një shtet të përbashkët të quajtur Mbretëria e SKS-së, e aq më tepër që ky shtet të ishte edhe fqinj i Italisë.

Gjatë mbajtjes së Konferencës Paqësore në Paris, idetë për zgjerime territoriale në dëm të territoreve shqiptare, haptazi u shprehën nga të gjitha shtetet ballkanike. Italia, që nga viti 1917, me këmbëngulje ka mbrojtur kërkesat e saj për protektorat të plotë ndaj tërë territorit të Shqipërisë.¹

Rivaliteti ndërmjet Italisë dhe Jugosllavisë në detin Adriatik e përcaktoi edhe qëndrimin e delegacionit jugosllav në Konferencën Paqësore të Parisit në lidhje me Shqipërinë. Synimi kryesor i Beogradit ishte pengimi i depërtimit italian në Shqipëri. Nikolla Pashiqi, depërtimin italian në Ballkan e shihte si një kërcënim shumë serioz për Serbinë. Sipas tij, Italia nëpërmjet Shqipërisë do të futej thellë në zemrën e Ballkanit dhe me të drejtë do të kërkonte të merrte pjesë në të gjitha vendimet lidhur me fatin e Ballkanit, e me këtë, Mbretëria e SKS-së do të humbte pozicionin dhe ndikimin e saj në Ballkan si shtet më i madh, përkatësisht si shtet më i fuqishëm, pozicion që, sipas Beogradit, me të drejtë edhe i takonte.

Çështja e cila më së shumti nxiti debat dhe kundërshtime në mes të delegacionit jugosllav dhe atij italian në Konferencën Paqësore të Parisit ishte “Çështja e Adriatikut”, çështje kjo, e cila në mënyrë të drejtpërdrejt prekte edhe interesat vitale të Shqipërisë. Shqipëria, nga ana e Fuqive të Mëdha shihej si një monedhë për këmbim, ashtu siç ishte parë edhe më herët. Këtë e vërteton edhe mendimi i përfaqësuesit të delegacionit anglez në këtë konferencë, z. Krou, duke u

¹ Peter Bartl, *Albanci od sredweg veka do danas*. Превела Љубинка Миленковић, Београд 2001, 179.

shprehur se “Mbretëria e SKS-së përdorte Shqipërinë si një levë për të marrë koncesione nga Italia”.²

Në këto rrethana Serbia ishte jashtëzakonisht e interesuar për ndërtimin e vijës hekurudhore Danub-Adriatik, e cila do të lidhte Rusinë dhe Rumaninë nëpërmjet Serbisë me Detin Adriatik, prandaj edhe me çdo kusht ajo kërkonte pjesën veriore të Shqipërisë. Italia, nga ana tjetër, Shqipërinë e dëshironte të tërën, sepse e shihte si një vend me një potencial të veçantë natyror dhe ekonomik, prandaj edhe nuk dëshironte që Shqipërinë ta bëjë objekt këmbimi tregtar me Serbinë.

Mbretëria e SKS-së në vazhdimësi ka tentuar që në Shqipëri të marrë koncesione si në industri, bujqësi dhe në komunikacion, megjithatë interesi kryesor mbetej depërtimi në sferën bankare, sepse Shqipëria në këtë periudhë ende nuk kishte bankë kombëtare. Për sa i përket sferës bankare, banka Kombëtare në Shqipëri do të kishte vetëm emrin bankë shqiptare, ndërkohë që kapitalin në këtë bankë do ta kishin korporatat e huaja financiare. Këto korporata, sidomos ato me kapital italian, anglez dhe francez, mes veti zhvillonin një “luftë” të vërtetë për pozita udhëheqëse në këtë bankë. Jashtë kësaj lufte nuk kanë mbetur edhe disa shoqata të tjera bankare jugosllave të cilat janë përpjekur të hapin ekspozitura të tyre në Shqipëri. Në qershor të vitit 1922, lidhja aksionare “Banka Malazeze” i është drejtuar qeverisë shqiptare me një kërkesë për hapjen e një ekspoziture në Shkodër. Deri në vitin 1915, kjo bankë ka pasur filialen e vetë në Shkodër e cila ka premtuar se e njëjta do të jetë në shërbim të qeverisë shqiptare, duke mos kërkuar kurrfarë shërbimi nga qeveria shqiptare. Në vitet në vazhdim, edhe disa shoqëri bankare të tjera me kapital jugosllav kërkuan që të hapin filiale të tyre në Shqipëri, si bie fjala, në dhjetor të vitit 1922, “Banka e Bashkuar Serbe” nga Beogradi, kërkoi që të hapë filiale të saj në Tiranë; në janar të vitit 1923, shoqëria bankare nga Cetina kërkoi që në Shkodër të hapë filialen me emrin “Banka Kroato-Jugosllavo-Shqiptare”; në shkurt të po të njëjtit vit, një kërkesë të tillë dorëzoi edhe “Banka Sllovene” nga Zagrebi për hapjen e një filiale në Shkodër.³

Projekti më i rëndësishëm i Mbretërisë SKS-së për investime kapitale në Shqipëri ishte ai i rregullimit të kanalit të lumenjve Buna, Drini, Gjadri dhe Kiri. Mirëpo, pas qasjes agresive të politikës italiane në Shqipëri, dhe si pasojë e rrethanave dhe ngjarjeve politike në këtë periudhë edhe ky projekt i rëndësishëm në mars të vitit 1925 do të dështojë.⁴ Në fund të vitit 1923 dhe fillim të vitit 1924, në kohën kur Shqipëria ballafaqohej me konflikte të brendshme politike, qeveria e Romës, për të mbrojtur kapitalin e vet në Shqipëri do të kërkojë nga Shoqata e Kombeve që t’i mundësohej hyrja e kapitalit italian në sistemin monetar dhe kreditor të Shqipërisë.⁵ Nën mbikëqyrjen e Shoqatës së Kombeve, u formua Banka

² Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia, 1918-1927*, Tiranë, 1991, 73-74.

³ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, 176-177

⁴ Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, 178-179.

⁵ Avramovski Zivko, - *Prilog pitanju italijansko-albanske iredentističke propagande na Kosovu i Metohiju u vreme Minhenske Krize i okupacije Albanije*, "Istorijski Glasnik", br. 2-3, 1966., 14.

Popullore e Shqipërisë, në të cilën mbizotëronte kapitali italian. Nga ana tjetër, nevojat e qeverisë shqiptare shënonin rritje enorme, dhe për këtë arsye, Ahmet Zogu, për ndihmë financiare iu drejtua qeverisë së Beogradit. Pamundësia e Beogradit për t'i përgjigjur pozitivisht kërkesave financiare të qeverisë shqiptare, detyroi Zogun që të ndërmarrë hapa konkretë në përmirësimin dhe përforcimin e raporteve me Italinë, me bindjen se ai dhe qeveria e tij do të kenë përfitime politike dhe ekonomike. Në këtë mënyrë, Zogu heshturazi lejoi që kapitalit italian t'i mundësohen koncesione të favorshme.

Për sa i përket territorit shqiptar, rivaliteti ndërmjet Italisë dhe Serbisë ishte edhe më i theksuar, edhe përkundër faktit që Benito Musolini dhe Nikolla Pashiqi, si përfaqësues të qeverive të tyre, në fund të janarit të vitit 1924 në Romë nënshkruan marrëveshjen për bashkëpunim të ndërsjellë për një periudhë prej pesë vitesh.⁶ Në bazë të kësaj marrëveshjeje, parashihej që të dyja palët nuk do të ndërmerrnin kurrfarë hapash kundrejt Shqipërisë pa marrëveshje ose pëlqim paraprak prej palës tjetër. Me këtë marrëveshje, Italia u siguroi që Mbretëria e SKS-së nuk do të guxojë të ndërmarrë aktivitete konkrete në Shqipëri kokë në vete, ndërsa Mbretëria e SKS-së mori garancione se Italia nuk do të inkurajojë aktivitete irredentiste në Kosovë. Marrë në përgjithësi, pakti parashikonte abstenim nga veprimet e mëtutjeshme nga të dyja palët.⁷

Edhe përkundër kësaj marrëveshjeje, depërtimi italian në Shqipëri ishte shumë i dukshëm. Ky depërtim herë here, realizohej edhe pa pengesa edhe në të gjitha fushat e jetës së shoqërisë shqiptare, mu për faktin se raportet shqiptaro-jugosllave në këtë periudhë përcilleshin me konflikte dhe tensione të mëdha. Për shkak të kësaj politike të qeverisë shqiptare, në pranverë të vitit 1925, Beogradi fillon të provokojë dhe tensionojë situatën, me të vetmin qëllim, frikësimin e Zogut. Kjo politikë e Beogradit ishte kontraproduktive, për shkak se Zogu, duke e ditur që Beogradi mund t'i hakmerrej atij duke përdorur metoda të njëjta për ta rrëzuar atë nga pushteti, ashtu edhe siç e solli në pushtet, edhe më tepër iu afrua Italisë.

Italia duke dashur të shfrytëzojë situatën e krijuar, i mundësoi Zogut një kredi prej 2 milionë franga ari, për tejkalimin e situatës së rëndë financiare në të cilën gjendej regjimi i tij. Një ndihmeje të tillë italiane, Musolini ia bashkangjiti edhe propozimin ndaj Zogut për nënshkrimin e një pakti "miqësor" midis dy vendeve, e që në esencë nënkuptonte edhe fillimin e vendosjes së një protektorati italian në Shqipëri. Marrëveshja e parë ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë u bë me 26 gusht të vitit 1925, e nënshkruar nga Zogu dhe Musolini.

Edhe përkundër përkrahjes që kishte nga Italia, Zogu në parim u mundua që të udhëheqë një politikë të balancuar, karshi raporteve Itali-Mbretëri e SKS-së, për sa i përkiste interesave të tyre në Shqipëri. Zogu u mundua që si kompenzim ndaj Mbretërisë së SKS-së për koncesionet të cilat ia kishte dhënë Italisë, si bie fjala, koncesionet e naftës, si dhe koncesionet për Bankën Popullore të Shqipërisë

⁶ Carlo Sforza, Pierre I de Serbie et Nikola Pasic, "Le Monde Slave, II (avril) Paris 1937, 134.

⁷ Arben Puto, *Shqipëria Politike 1912-1939*, Tiranë, 2009, 400-401.

me kapital italian, të nënshkruaj “Marrëveshje për Shën Naumin dhe Vermoshin” në favor të Mbretërisë së SKS-së.⁸ I ballafaquar me rritjen e presioneve nga ana e qeverisë së Romës, nga njëra anë, dhe me politikën agresive të Beogradit, sidomos në brezin kufitar me Shqipërinë, nga ana tjetër, Zogu u detyrua që më datë 27 nëntor 1926, të nënshkruajë edhe marrëveshjen e njohur si “Pakti i parë i Tiranës”, marrëveshje kjo që, sipas Zogut, jep garancione të fuqishme për pavarësinë e Shqipërisë dhe për integritetin e saj territorial. Fuqizimi i marrëdhënieve ndërmjet Tiranës dhe Romës u arrit sidomos me nënshkrimin e paktit ushtarak, me 22 nëntor të vitit 1927, pakt i cili paraqet, jo vetëm fitore të politikës fashiste italiane në Shqipëri dhe në region, por njëkohësisht edhe humbjen e dytë të politikës së Mbretërisë së SKS-së karshi politikës agresive të Italisë në Ballkan.⁹

Nënshkrimi i “Paktit të Tiranës” paraqet një etapë të re të raporteve shqiptaro-jugosllave, etapë kjo e cila fillon me konfrontime të ashpra, dhe e cila reflektohet edhe në raportet ndërmjet Mbretërisë së SKS-së dhe Italisë. Beogradi në asnjë mënyrë nuk arrinte ta gëlltiste prezencën gjithnjë e më të madhe të Italisë në Shqipëri. Në disa qarqe të qeverisë së Beogradit, gjithnjë e më tepër, mbisundonte ideja se “...Zogu duhej të largohej nga pushteti me të njëjtat metoda me të cilat kishte ardhur në pushtet..”¹⁰ Ndërkohë që, Beogradi, si asnjëherë më parë, nuk ishte ndjerë i kërcënuar nga Italia, sikurse tani.

Se sa ka qenë me rëndësi Shqipëria për këto dy shtete, flet edhe vetë dokumenti të cilin do ta shpalojmë në vijim, dokument i cili paraqet pasqyrën reale të ndikimit italian në Shqipëri. Ky dokument gjendet në Arkivin Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, fondi 588, dhe ka të bëjë me koncesionin e dhënë Italisë nga ana e qeverisë shqiptare për hulumtimin dhe shfrytëzimin e vajgurit dhe të derivateve të saja në një pjesë të caktuar të Shqipërisë. Vetë fakti që dokumenti është i përkthyer në gjuhën serbe nga ana e legatës jugosllave në Tiranë, mjaftueshëm flet edhe për interesin e madh të Serbisë për Shqipërinë, fakt ky që tregon se për çdo koncesion që është marrë nga Italia ka qenë i informuar Beogradi.

Marrëveshja është e nënshkruar më 12 maj të vitit 1925, ndërmjet qeverisë shqiptare, e përfaqësuar nga Ministri për punë publike dhe bujqësi, z. Koço Kota dhe Hekurudhat Shtetërore të Mbretërisë së Italisë, përfaqësuar nga z. Ugo Piolti. Marrëveshja parasheh dhënien nën koncesion të një pjese të rëndësishme të territorit të Shqipërisë për hulumtime dhe eksploatimin e vajgurit dhe derivateve të saja, të gazit natyral dhe bitumit. Kjo marrëveshje, sipas dokumentit në fjalë është e ndarë në disa faza:

Faza e parë fillon nga neni 1 për të përfunduar me nenin 6, e cila përfshin periudhën e hulumtimit. Në këtë fazë, koncesioneri është i obliguar që në afat prej dy muaj t’i përcaktojë kufijtë e terreneve ku mendojnë të bëjnë hulumtime. Sipas marrëveshjes perimetri i hapësirës territoriale nuk guxon të jetë më i madh se

⁸ Muzafër Bislimi, *Kufiri me shqipërinë dhe çështja e Shën Naumit, 1912-1925 (dokumente)*, Shkup, 2015, 90-91.

⁹ Po aty, .

¹⁰ AQSH. Fondi 849, dosja 75.

50.000 hektarë. Në perimetrin e paracaktuar nuk do të hyjnë vendet e ndaluara me ligj, si dhe vende të dhëna më herët për veprimtari të njëjtë. Koncesioneri do të ketë të drejtën ekskluzive që në afat prej tre vitesh, nga dita e shpalljes së marrëveshjes, të fillojnë hulumtimin e saj në të gjitha vendet e shënuara, si në sipërfaqe, ashtu edhe në thellësi të tokës. Koncesioneri gjatë periudhës së hulumtimit nuk guxon t'i shfrytëzojë resurset natyrore, përveç për analizë dhe provë industriale, por jo më tepër se 100 ton. Në raste kur prodhimi e tejkalon sasinë e paraparë, atëherë shteti mund t'i japë leje koncesionerit që pjesën e tepër ta eksportojnë, nëse paraprakisht paguhet tatim prej 13, 5%. Koncesioneri është i obliguar, që në çdo gjashtë muaj t'i raportojë qeverisë.

Faza e dytë e marrëveshjes që fillon nga neni 7 e përfundon me nenin 14, është periudha e shfrytëzimit. Në këtë fazë, nëse koncesioneri konstaton se ka sasi të mjaftueshme të prodhimit të naftës dhe të derivateve të saj në perimetrin e përcaktuar, atëherë ai do të ketë të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin dhe eksploatimin e resurseve natyrore deri më datën 31 dhjetor të vitit 1985. Koncesioneri, gjatë gjithë kësaj kohe, për sa zëgjatë koncesioni, obligohet t'i paguajë taksë fikse shtetit në vlerë prej 1,50 franga ari për një hektarë, si dhe tatim prej 13,5% nga prodhimi i papërpunuar i vajgurit, duke përjashtuar ato sasi që janë shfrytëzuar për eksploatim. Në çdo tre muaj të eksploatimit, koncesioneri është i obliguar që t'i raportojë Ministrisë për Punë Publike dhe Bujqësi për sasi të prodhuara të vajgurit. Koncesioneri ka të drejtë që në çdo kohë të tërhiqet nga hapësira e caktuar për eksploatim dhe i njëjti lirohet nga të gjitha obligimet ndaj shtetit. Pas përfundimit të periudhës së eksploatimit, pra pas datës 31 dhjetor 1985, të gjitha sondat, puset, dhe instalimet tjera që gjenden në Shqipëri në pronësi të koncesionerit, do t'i jepen shtetit pa asnjë kompenzim.

Faza e tretë e marrëveshjes fillon nga neni 15 dhe përfundon me nenin 28-të. Në këtë fazë përcaktohen kushtet e përgjithshme për instalimin dhe ndërtimin e objekteve, sipas të cilave koncesioneri do të ketë të drejtë t'i ndërtojë dhe t'i mirëmbajë, si në vijim: rrugët e thjeshta, hekurudhat, kanalet me gypa për naftë, ujë dhe gaz, urat, rafineritë, lidhjet telefonike dhe telegrafike etj. Shteti është i obliguar që koncesionerit t'i ofrojë tokë pa kompenzim dhe qasje të lirë për instalimin dhe ndërtimin e objekteve të lartpërmendura. Në nenet e fundit të marrëveshjes flitet për formimin e një komisioni të përbashkët për arbitrazh, i cili do t'i zgjidhë të gjitha çështjet kontestuese, interpretimet e ndryshme të marrëveshjes, obligimet e pa kryera të koncesionerit etj. Marrëveshja është e shkruar në gjuhën frënge dhe në gjuhën shqipe, dhe për çdo paqartësi eventuale, për bazë do të merret versioni francez. Marrëveshja me propozim të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë duhet të ratifikohet edhe në Parlamentin e Shqipërisë.

Konventa është e nënshkruar në Tiranë, me datë 12 maj të vitit 1925. Në cilësinë e përfaqësuesit të Italisë marrëveshjen e ka nënshkruar Ugo Piolti, ndërsa në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë së Shqipërisë, marrëveshja është nënshkruar nga K. Kota.

Gazeta zyrtare shqiptare nga 24 mars 1925.

K o n v e n t ë

Ndërmjet shkëlqesisë së tij, Ministrit për Punë Publike dhe Bujqësisë, në cilësinë e përfaqësuesit të Qeverisë Shqiptare, në tekstin vijues i emërtuar si “Shteti”, nga njëra anë, dhe:

Hekurudhat Shtetërore të Mbretërisë së Italisë, të përfaqësuara nga z. Ugo Piolti, i autorizuar dhe i akredituar si “Koncesioner” (term i cili nënkupton Hekurudhat Shtetërore të mbretërisë italiane si dhe shoqëritë e formuara nga kjo sipërmarrje të përmendura në nenin 9 të kësaj Konvente), nga ana tjetër.

Është dakorduar dhe vendosur, si në vijim:

Neni 1. Shteti i jep Koncesionerit të drejtën ekskluzive për hulumtimin dhe shfrytëzimin e vajgurit, gazit natyror dhe bitumit për asfaltim i cili prodhon vajgur me anë të distilimit në terren, sipas kushteve të përcaktuara në këtë konventë.

Afati i hulumtimit

Neni 2. Koncesioneri obligohet që në afat prej dy muajsh nga dita e nënshkrimit të kësaj konvente, të përcaktojë kufijtë tokësor (perimetrit) ku konsideron që të bëjë hulumtime sipas kushteve në vijim:

a). Hapësira e perimetrit të përcaktuar për hulumtim nuk mund të përfshijë hapësirë më të madhe se 50.000 (pesëdhjetë mijë) hektarë.

b). Nga perimetri i përcaktuar do të përjashtohen ato vende të ndaluara me ligj, si dhe vende për të cilat persona të tretë më herët kanë fituar të drejtën për veprimtari të njëjtë për hulumtimin dhe shfrytëzimin e lëndëve të para për të cilat bëhet fjalë në nenin 1 të kësaj Konvente.

c). Numri i perimetrave nuk mund të jetë më i madh se katër.

Neni 3. Koncesioneri do të ketë të drejtën ekskluzive, që në afat prej tre vjetësh, duke filluar nga dita e shpalljes së ratifikimit të kësaj konvente në Gazetën Zyrtare, në të gjitha perimetrat e përcaktuara sipas neneve të lartpërmendura, të fillojnë me punë për hulumtimet, si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi të tokës, për gjetjen e lëndëve të përmendura në nenin 1. Kjo periudhë prej tre vjetësh, e që në të ardhmen do të emërtohet si “Periudha e hulumtimit”, me marrëveshje të përbashkët mund të zgjatet për një afat të përshtatshëm, nëse për këtë do të paraqitet nevoja, varësisht rrethanave të ndryshme.

Neni 4. Krahas punimeve sipërfaqësore dhe hulumtimit të puseve dhe galerive, Koncesioneri është i obliguar që gjatë periudhës së hulumtimit të hapë më

së paku shtatë puse nga të cilat tre duhet të jenë në thellësi prej 1000 metra, përveç rasteve kur vajguri gjendet në thellësi më të vogël.

Neni 5. Koncesioneri nuk do mund të disponojë me mineralet e nxjerra në periudhën e hulumtimit, përveç për analiza dhe për hetime industriale, edhe atë në sasi jo më të lartë se 100 ton për secilin mineral, për të cilat bëhet fjalë në nenin 1. Mirëpo mineralet lirisht mund të përdoren në sasi të mjaftueshme për nevojat e tyre gjatë hulumtimit.

Në rast se prodhimi, gjatë kësaj periudhe, është më i lartë se sa sasia e lartpërmendur, atëherë Shteti mund të japë leje për përdorim të lirë me të drejtë për eksport, nëse paraprakisht paguhet një taksë prej 13,5% nga sasia e dhënë në leje.

Neni 6. Koncesioneri në çdo gjashtë muaj obligohet t'i raportojë Shtetit për punët e kryera gjatë hulumtimeve, si dhe të arriturat në gjashtë mujorin e kaluar. Këtij raporti do t'i bashkëngjiten planet e ardhshme dhe hartat, ndërkohë që koncesioneri është i obliguar që t'i japë të gjitha informatat shtesë, nëse për këto kërkon Shteti.

Periudha e shfrytëzimit

Neni 7. Në cilëndo etapë të periudhës së hulumtimit ose në fund të kësaj periudhe, nëse Koncesioneri konsideron se ka sasi të mjaftueshme të vajgurit për shfrytëzim tregtar, do të ketë të drejtën të zgjedhë brenda perimetrit të përcaktuar në nenin 2, hapësirë në të cilën ai do të ketë të drejtën ekskluzive për hulumtime të mëtuftjeshme dhe për eksploatimin e mineraleve të përcaktuara në nenin 1, deri më 31 dhjetor 1985, sipas kushteve të përcaktuara në nenet vijuese. Periudha nga koha e përcaktimit të hapësirës dhe 31 dhjetorit të vitit 1985, do të shënohet si "Periudha e shfrytëzimit".

Neni 8. Hapësira e zgjedhur, të cilën Koncesioneri do ta shfrytëzojë për kryerjen e punimeve të cilat kanë të bëjnë me periudhën e eksploatimit, i nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a). Tërësia e hapësirës së zgjedhur nuk mund të jetë më e madhe se 30.000 hektarë.

b). Këto hapësira nuk mund t'i tejkalojnë kufijtë e perimetrit të përcaktuar në nenin 2.

Neni 9. Nëse shtetasve shqiptarë i jepet mundësia që të marrin pjesë në sipërmarrjen për të cilën flitet në këtë konventë, Koncesioneri obligohet që në afat prej katër muajve të parë të eksploatimit të formojë një ose më shumë shoqëri anonime të cilat do të kenë për qëllim zbatimin e programit eksploatues, dhe përfitime që dalin nga ky koncesion. Shoqërive të lartpërmendura, Koncesioneri ua jep të gjitha të drejtat të parapara me këtë konventë. Kapitali i këtyre shoqërive nuk

do të jetë më i vogël se 10.000.000. – (dhjetë milion) franka ari, të cilat edhe mund të rriten sipas kërkesave të sipërmarrjes.

Ky kapital do të ndahet në aksione me vlerë nominale, jo më tepër se 50 (pesëdhjetë) franga ari, prej të cilave 40% do të rezervohen për tre muaj radhazi, nënshkruesve shtetas shqiptarë. Në rast se në fund të periudhës tremujorëshe, të gjitha aksionet ose një pjesë e tyre, e rezervuar për regjistrim nacional, nuk regjistrohen, këto aksione ose një pjesë e tyre, që kanë mbetur pa u regjistruar, do t'i mbeten në dispozicion qeverisë shqiptare, për dy muaj që të mund të bëjë regjistrimin nga thesari shtetëror. Në fund të këtyre dy muajve aksionet e rezervuara të cilat nuk janë regjistruar nga ana e shtetit ose nga ana e shtetasve shqiptarë, mund t'i shfrytëzojë koncesioneri, varësisht nga dëshira e tij.

Shteti ka të drejtë të vendos një anëtarë në Këshillin Drejtues në ndërmarrjet e lartpërmendura. Një kopje e bilancit vjetor të këtyre ndërmarrjeve do t'i dorëzohet Shtetit.

Neni 10. Gjatë gjithë kohës, sa zgjat ky koncesion, Koncesioneri obligohet t'i paguajë shtetit për një vit një taksë fikse dhe qira proporcionale. Taksa e caktuar brenda vitit paguhet 1,50 franga ari për një hektar, i cili koncesionerit i jepet për shfrytëzim. Herën e parë kjo taksë paguhet parapagesë për dy vjet, gjatë muajit të ardhshëm pas ratifikimit të kësaj konvente.

Qiraja proporcionale paguhet në çdo tre muaj në mënyrë proporcionale me vlerë prej 13,50% të prodhimit të vajgurit të papërpunuar që është nxjerrë nga pusët dhe rezervuaret, duke minusuar sasinë që janë harxhuar për eksploatim. Shteti ka të drejtë që këtë qira ta kërkojë në naturë ose në të holla. Në fund të çdo tre muajve të periudhës së eksploatimit, Koncesioneri obligohet t'i raportojë Ministrisë për Punë Publike dhe Bujqësisë për sasinë e prodhuara të vajgurit të papërpunuar si dhe për mënyrën e shfrytëzimit të tyre. Qiraja do të përcaktohet në bazë të sasive të dhëna në këtë raport.

Neni 11. Gjatë periudhës së eksploatimit, Koncesioneri obligohet të zbatojë programin vijues të gërmimit të tokës:

- Në vitin e parë 1000 metra,
- Në vitin e dytë 2000 metra të tjera,
- Në vitin e tretë 3000 metra të tjera,
- Në vitin e katërt 4000 metra të tjera,
- Në vitin e pestë 4000 metra të tjera.

Nëse brenda këtyre viteve, gërmimi i tokës tejkalon thellësinë e parashikuar më lartë, atëherë thellësia e tejkaluar minusohet nga minimumi i parashikuar për vitin e ardhshëm. Programi i gërmimit minimal mund të ndërpritet në raste të situatave të jashtëzakonshme të cilat do të pengonin nxjerrjen e vajgurit nga sondat. Kjo vlen edhe për rastet kur prodhimi i vajgurit tejkalon sasinë prej 150.000 ton, sasi e parashikuar për një vit, me ç'rast prodhimi suspendohet deri sa i njëjti nuk bie nën sasinë e parashikuar. Në raste kur pengesa serioze pengojnë

zbatimin e programit të gërmimit minimal, çështja dërgohet deri te komisioni i përzier i ekspertëve (n.21) i cili ka të drejtën për zvogëlimin e thellësisë të parashikuar me programin e gërmimit të tokës.

Pas periudhës së parë pesëvjeçare të eksploatimit, Koncesioneri obligohet të vazhdojë dhe të zhvillojë në një shkallë më të lartë mundësinë e eksploatimit të derivateve të vajgurit, sipas principit dhe programit të lartpërmendur për gërmimin e tokës në konsultim me komisionin e përzier të ekspertëve.

Neni 12. Koncesioneri ka të drejtë të braktisë cilëndo pjesë të tokës të përfshirë në sipërfaqen për eksploatim. Kjo braktisje i mundëson Koncesionerit të lirohet nga të gjitha obligimet e parapara në këtë Konventë për tokat e braktisura.

Neni 13. Koncesioneri obligohet që në Shqipëri të ndërtojë një rafineri, nëse konstatohet se kapaciteti vjetor i prodhimit të puseve arrin sasinë prej 50.000 tonelatave vajgur të rafinuar dhe me një rentabilitet të lartë industrial.

Neni 14. Në fund të periudhës së eksploatimit (pas 31 dhjetorit 1985) të gjitha sondat, pusët, galeritë, instalimet dhe konstruksionet që gjenden në Shqipëri e të cilat janë në pronësi të Koncesionerit, do të mbeten në pronësi të Shtetit pa kurrfarë kompensimi.

Neni 15. Koncesioneri ka të drejtë të ndërtojë dhe të mirëmbajë: rrugë të rëndomta, hekurudha, ura hekurudhore, gypa për vajgur, për ujë ose për gaz, ura, vende për shkarkim të mallrave në porte, rezervuare, depo, stacione të pompave, rafineri, ndërtesa, linja telegrafike dhe telefonike etj., dhe në fund të gjitha këto instalime dhe ndërtime që do të jenë të nevojshme për punë sa më efektive të ndërmarrjes për të cilën bëhet fjalë në këtë konventë, mund të realizohen edhe jashtë hapësirave për eksploatim. Shteti obligohet që koncesionerit t'i mundësojë qarkullim të lirë nëpër hapësirat tokësore dhe ujore brenda shtetit si dhe t'i japë tokën e nevojshme për ndërtimet dhe instalimet e lartpërmendura, si dhe të bëjnë shpronësimin e tokave sipas ligjeve në fuqi nëse instalimet dhe ndërtimet përfshijnë prona dhe ujëra private ose që u janë dhënë personave të tretë për qëllime të tjera.

Të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe shpenzimet për shpronësim bien në kurriz të koncesionerit.

Kushtet e përgjithshme

Neni 16. Koncesioneri obligohet që në mënyrë të drejtë t'i shpërblejë personat e tretë të cilët mund të dëmtohen nga punët e parapara me këtë Konventë. Kompensimi përcaktohet në mënyrë miqësore ndërmjet palëve, e në rast të paraqitjeve të mosmarrëveshjeve midis palëve, çështja do të zgjidhet nga komisioni arbitrar. Nëse çështja nuk zgjidhet nga komisioni arbitrar, atëherë për këtë çështje do të vendosin gjykatat lokale.

Neni 17. Nëpunësit dhe punëtorët që Koncesioneri do t'i angazhojë në territorin shqiptar duhet pajtë të jenë shtetas shqiptarë përveç drejtorëve, teknikëve dhe specialistëve. Nëse në raste të pengesave serioze në punë për shkak të mungesës të punëtorëve lokalë, koncesionerit do t'i jepet e drejta të sjellë punëtorë të huaj në sasi të konsiderueshme në pajtueshmëri me mendimin e komisionit të përzier.

Neni 18. Në raste kur punimet pengohen ose ndërpriten me kërkesë të organeve të instancave me të larta, obligimet e Koncesionerit ndaj këtyre organeve ndërpriten për gjatë gjithë asaj kohe, dhe kjo kohë nuk llogaritet në periudhën e parashikuar maksimale të kësaj Konvente. Në raste të mosmarrëveshjeve për rëndësinë e kërkesës të organeve të instancave me të larta, çështja do t'i drejtohet kolegjiut arbitrar të paraparë në nenin 22.

Neni 19. Koncesioneri do të ketë të drejtën për importim të lirë të të gjitha makinerive dhe materialeve prodhuese të nevojshme për kryerjen e punëve të saj të parapara në këtë konventë, duke qenë i liruar nga të gjitha taksat doganore dhe taksat e tjera.

Neni 20. Koncesioneri do të lirohet nga të gjitha taksat e tanishme dhe të ardhshme për kapitalin e angazhuar, për interesin dhe për fitimet që dalin nga koncesionet e tyre, si dhe për prodhimin dhe importimin e tyre me përjashtim të atyre që janë të parapara me këtë konventë.

Neni 21. Do të formohet një komision i përzier i ekspertëve, i përbërë nga gjashtë anëtarë, nga të cilët tre i propozon Shteti dhe tre Koncesioneri. Komisioni në fjalë do të përcaktojë kushtet e tokës dhe do t'i monitorojë obligimet e koncesionerit. Komisioni ka të drejtë të zvogëlojë programin minimal të gërmimit të tokës, si gjatë hulumtimit, po ashtu edhe gjatë eksplotimit, kur rrethanat e jashtëzakonshme e arsyetojnë këtë zvogëlim. Komisioni ka të drejtën e vendosjes për të gjitha çështjet ligjore dhe teknike që do të paraqiten gjatë dyshimeve të interpretimit të kushteve të kësaj konvente, gjithashtu edhe për shumë çështje tjera që mund të paraqiten në raste të jashtëzakonshme e që nuk mund të zgjidhen në mënyrë paqësore. Vendimet e komisionit sillen me shumicë votash, e në raste kur shumica nuk mund të arrihet, atëherë çështja dërgohet në kolegjiut arbitrar të paraparë në nenin 24.

Neni 22. Nëse Koncesioneri nuk i kryen obligimet e veta që dalin nga kjo konventë, Shteti ka të drejtë ta paralajmërojë atë që në afat prej tre muajve t'i kryejë obligimet e marra. Nëse Koncesioneri nuk i kryen obligimet e veta deri në afatin e paraparë, atëherë Shteti i drejtohet kolegjiut arbitrar sipas nenit 24. Nëse edhe pas kolegjiut arbitrar Koncesioneri vazhdon me moskryerjen e obligimeve të veta, Shteti ka të drejtë të anulojë Konventën.

Neni 23. Nëse Koncesioneri në pajtueshmëri me nenin 13, instalon në Shqipëri një rafineri, atëherë obligohet që një pjesë të prodhimeve të veta t'i japë në shfrytëzim qeverisë shqiptare sipas çmimit ditor me një zbritje prej 10%.

Sasitë që Koncesioneri i jep sipas kushteve të lartpërmendura nuk do të tejkalojnë 20% e prodhimit të përgjithshëm të rafinerisë.

Neni 24. Në raste të mosmarrëveshjeve ndërmjet Shtetit dhe Koncesionerit për të drejtat dhe obligimet e tyre të dala nga kjo konventë, çështjet kontestuese i drejtohen kolegjiut arbitrar i përbërë nga tre anëtarë, nga të cilët, njërin e delegon Shteti, të dytin Koncesioneri dhe i treti delegohet me miratimin e dy arbitrarëve të parë. Nëse dy arbitrarët e parë nuk mund të merren vesh për arbitrin e tretë, atëherë formohet një kolegjiut i ri i arbitrarëve i përbërë nga pesë anëtarë, prej të cilëve dy i delegon shteti, dy koncesioneri dhe i pesti zgjidhet me votat e katër anëtarëve të zgjedhur. Nëse anëtari i pestë nuk zgjidhet me marrëveshje, atëherë atë e zgjedh Gjykata e Apelit e Shqipërisë. Vendimet e kolegjiut sillen me shumicë votash. Pritja nga vendimet e kolegjiut nuk mund të shkaktojë pezullimin e aktiviteteve të koncesionit.

Neni 25. Në mënyrë që të garantohet aplikimi sa ma i mirë i obligimeve nga kjo konventë, Koncesioneri duhet të paguajë në arkën e Ministrisë së Financave të Shqipërisë tridhjetë ditë pas nënshkrimit të kësaj konvente vlerën prej 150.000 – franka ari, vlerë e cila mund të shndërrohet në pronësi shtetërore në rast të anulimit të kësaj konvente për shkak të mos përmbushjes së obligimeve nga ana e Koncesionerit.

Kjo mund ti kthehet koncesionerit nëse:

- a) kjo konventë nuk ratifikohet,
- b) nëse koncesioneri largohet nga koncesionet dhe nga të drejtat përkatëse me kusht që t'i ketë kryer obligimet e parapara me këtë konventë.

Neni 26. Për zbatimin e kësaj konvente e cila bie nën juridiksionin e Ministrisë për Punë Publike dhe Bujqësisë, Koncesioneri selinë e saj do ta ketë në kryeqytetin e Shqipërisë dhe duhet t'i nënshtrohet ligjeve lokale, përderisa këto ligje nuk janë në kundërshtim me aktet e marrëveshjes në këtë konventë.

Neni 27. Kjo konventë është e shkruar në gjuhën shqipe dhe atë frënge në katër kopje të nënshkruara nga të dyja palët. Dy kopje (njëra në gjuhën shqipe dhe njëra në gjuhën frënge) deponohen në arkivin shtetëror, ndërsa dy kopjet e tjera (njëra në gjuhën shqipe dhe njëra në gjuhën frënge) i jepen koncesionerit. Është parashikuar dhe kontraktuar që në rast të mosmarrëveshjeve për shkak të interpretimeve të ndryshme, të merret parasysh teksti i shkruar në gjuhën frënge.

Neni 28. Kjo konventë vlen për periudhën 20 vjeçare, duke filluar nga dita e nënshkrimit të saj.

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE-SHKUP

Qeveria është e obliguar që t'i paraqesë Parlamentit Dekret–Ligjin për ratifikimin për zgjerimin e afatit kohor të kësaj konvente deri më 31 dhjetor të vitit 1985.

Në tekstin e kësaj konvente për ratifikim, nënkuptohet edhe ratifikimi e Dekret-Ligjit të përmendur më lart, për zgjatjen e koncesionit deri më 31 dhjetorë të vitit 1985.

Përpiluar në Tiranë me 12 mars të vitit 1925.

Për Hekurudhat Shtetërore
të Mbretërisë së Italisë
Ugo Piolti

Për qeverinë shqiptare
Ministri i Punëve Publike dhe Bujqësisë
K.Kotta

Kjo marrëveshje është identike me marrëveshjen e miratuar me dekret të Këshillit ministror dhe të Presidentit të Republikës së Shqipërisë me 9 mars të vitit 1925.

Ugo Piolti s.r.

K. Kotta s.r.

Albanske Sluzbene Novine od 24 marta 1925 godine.

K o n v e n c i j a

Između Njeg. Eksel. Ministra javnih radova o poljoprivrede koji deluje u ime i za račun Alba-nske države, u daljem tekstu nazvana "Država", s jedne strane:

I Drzavnih zeleznica Kraljevine Italije, koju pretstavljaju g. Ugo Piolti, narocito ovlascen i opunomocen, u daljem tekstu nazvan kao "Koncesionar" (termin koji oznacava Drzavne zeleznice kraljevine Italije kao i drustva organizovana od strane ovih zeleznica kako se to navodi u cl. 9 ove Konvencije), s druge strane:

Ugovoreno je i reseno sledece:

Cl. 1. Drzava ustupa Koncesionaru iskljucivo pravo istrazivanja i iskoriscavanja petroleja, prirodnog gasa, bituma asfaltstkih stena koje proizvode petrolej vršeci distilaciju na terenu a pod uslovima sadržanim u ovoj konvenciji.

Rok istrazivanja

Cl. 2. Koncesionar se obavezuje da pokaze u roku od dva meseca, od dana potpisivanja ove konvencije, granice terena (perimetra) koje smatra da vrši istrazivanje pod sledecim uslovima:

a) Opsta kolicina sadržanog perimetra ne moze da obuhvati vecu površinu od 50.000 (pedeset hiljada) hektara.

b) Od određivanja perimetra bice iskljucena mesta zabranjena zakonom, kao i zemlje na kojima su treće strane dobile pravo istrazivanja i iskoriscavanja materija o kojima je rec u I. clanu ove konvencije.

c) Broj perimetra ne moze biti veci od cetiri.

Cl. 3. Koncesionar ~~moze~~ ce imati iskljucivo pravo da u toku od tri godine, pocev od dana obnarodovanja ratifikacije ove konvencije u Sluzbenim novinama, izvrši po perimetrima oznacenim u prednjem clanu sve radove na istrazivanju kako na površini tako i u dubini u cilju da pronadje materije o kojima je rec u Cl. 1. Ova perioda od tri godine, koja ce se u buduće zvati "Perioda istrazivanja" zajednickim sporazumom moze biti ponovo produžena za pogodan rok, ako za to postoji potreba iz raznih okolnosti.

A.Q.SH. F. 588 v. 1825

D. 4

n. 1

-2-

Cl.4. Pored povrinskih radova i istrazivanja bunarina i gale-
izbuhi, u
rima, Koncesionar se ~~uvek~~ obavezuje da ~~u~~ toku periode istrazivanja,
najmanje sedam bunara od kojih tri treba da budu dubine od 1000metara,
osim slucaja da se petrolej pronadje na manjoj dubini.

Cl.5. Koncesionar nece moci da raspolaze sa rudama izvadjenim
u toku periode istrazivanja sem za analize i industrijske probe i to u me-
ri koja nece precu 100 tona za svaku materiju o kojoj je rec u Cl.1. Ali
Ali uvek ce on moci da ih upotrebi slobodu u onoj kolicini koliko je pot-
rebno za radove oko istrazivanja.

U slucaju da ce proizvodnja, u toku ove periode, biti veca ne-
go li gorepomenute kolicine, Drzava ce dati dozvolu ~~uz~~ slobodne ~~u~~
upotrebe sa pravom izvoza, posto se prethodno bude isplatila zakupnina
od 13,5 % ^{od} kolicine ~~iz~~ oznacenih u dozvoli.

Cl.6. Koncesionar ce podnositi Drzavi svakih sest meseci izves-
taj koji ce sadrzavati ispitivanje i izvrzene radove na istrazivanju i
ucinjeni napredak za protskih sest meseci. Ovom izvestaju bice priklju-
ceni ^{potrebni} planovi i karte i Koncesionar ce davati sve naknadne informacije
koje drzava bude zahtevala.

Perioda iskoriscavanja

Cl.7. U svako doba periode istrazivanja ili na kraju ove perio-
de, ako Koncesionar smatra da postoji petrolej u kolicini ~~na~~ trgovaacki
iskoriscavanja, imace pravo da bira medju ^{oznaceni} ~~u~~ povrshine
na kojima ce on imati iskljucivo pravo za kasnija istrazivanja i eksploa-
tisanje materija oznacenih u cl.1., do 31 decembra 1985 godine a pod uslo-
vima iznetim u narednim clancima. Perioda izmedju izbora povrshine i 31
decembar 1985 godine bice oznacena kao "Perioda iskoriscavanja".

Cl.8. Izabrana površina koju ce koncesionar ~~zadrzati~~ da nam
njom vrši radove, a koji se odnose na period eksploatacija, podleži sledeci
uslovima:

- a) Celokupna izabrana površina ne sme precu 30.000 hektara,
- b) Ove površine nece precu granice perimeta ~~u~~ oznacenih u cl.2.

-3-

3

Cl.9. U cilju da se da mogućnost albanskim državljanima da učes-
tvuju u preduzeću u koje je rec u ovoj konvenciji, Koncesionar se obavezu-
je da formira u toku prva četiri meseca eksploatacijem, jedno ili više
~~različitih~~ anonimnih društava koja će imati za cilj primenu programa eksplo-
atacije i veći razvitak koristi koje proizilaze od ove koncesije. Koncesio-
nar ustupice gorepomenutim društvima sva prava koja su mu dodeljena ovom
konvencijom. Kapital ovih društava neće biti manji od 10.000.000.- (deset
miliona) zlatnih franaka, a moći će se povećati prema potrebama preduze-
ća.

Ovaj kapital bice podelen na akcije nominalne vrednosti ne ve-
će od 50.- (pedeset) zlatnih franaka, od kojih 40% bice rezervisani, za
tri meseca uzastopce, potpisnicima albanskim državljanima. U slučaju da
se na kraju perioda od tri meseca sve akcije ili jedan deo njih, rezervisani
za nacionalni upis, ne bude upisao, te će se akcije, ili njihov deo, koji je
ostao neupisan, ostaviti na raspoloženje albanskoj vladi za dva meseca
da bi mogla izvršiti upis iz državnog trezora. Na kraju ova dva meseca,
rezervisane akcije koje nisu upisane od strane države ili albanskih držav-
ljana, bice oslobođene svakog prava izbora i Koncesionar će moći da sa
njima raspolaze po svojoj želji.

Država ima pravo da postavi jednog člana u Upravni odbor gore-
pomenutih društava. Kopija godišnjeg bilansa društava bice dostavljena
Državi.

Cl.10. Koncesionar se obavezuje da plati Državi, za celo vreme
~~različitih~~ vazenja ove koncesije jednu fiks taksu ~~tz~~ i proporcionalnu ~~tax~~
zakupninu. ~~U~~ Utvrđena taksa placa će se godišnje zl. fr. 1,50 za jedan
hektar zemlje izdate koncesionaru. Ova taksa platiće se prvi put unapred
za dve godine, u toku narednog meseca posle ratifikacije ove konvencije.

Proporcionalna zakupnina placace se svaka tri meseca propor-
cionalno ~~13,50%~~ 13,50 % proizvodnje nepreradjenog petroleja koji je pre-
net iz bunara u rezervoare, odbijajući količine koje su utrosene za eks-
ploataciju. Država imace pravo da ovu zakupninu zahteva u naturi ili nov-
cu. Na kraju svaka tri meseca periode eksploatacije, Koncesionar će pod-

-4-

nositi Ministarstvu javnih radova i poljoprivrede izveštaj o količini proizvedenog nepreradjenog petroleja i o načinu upotrebe. Zakupnina će se računati po količinama označenim u ovim izveštajima.

Cl.11. U toku periode eksploatacije Koncesionar se obavezuje da primeni sledeci program busenja:

- U prvoj godini 1000 metara,
- u drugoj godini drugih 2000 metara,
- u trecoj godini drugih 3000 metara,
- u cetertoj godini drugih 4000 metara
- u petoj godini drugih 4000 metara.

Ako u jednoj godini broj metara busenja predje goreoznaeni minimum, veći broj metara odbice se od minimuma metara koji će se busiti u narednim godinama. Program minimalnog busenja moći će se suspendovati u slucaju vanredne proizvodnje koja bi omela uzimanje jednog dela petroleja koji se vadi iz sona. Ovo vazi i onda kada proizvodnja petroleja dostigne cifru od 150.000 tona godišnje i sve do onog vremena dok proizvodnja ne bude opala ispod ove količine. U slucaju kada ozbiljne smetnje ometaju primenu minimalnog programa busenja, pitanje bice podneto mesovitoj komisiji eksperata (cl.21) koja će imati pravo da izvrši opravdano smanjenje programa.

Posle prvih pet godina periode eksploatacije, Koncesionar se obavezuje da nastavi i razvije na vecem stupnju mogućnosti eksploataciju petrolejskih naslaga ulazuci sve moguće napore i uredice na osnovu ovog principa program busenja, posle konsultovanja sa mesovitom komisijom.

Cl.12. Koncesionar imace pravo da napusti svaki deo zemljišta obuhvacenog u površini za eksploataciju. Ovo napustanje oslobodjava ga od svih obaveza označenim u ovoj Konvenciji u pogledu napustenih zemalja.

Cl.13. Koncesionar se obavezuje da podigne u Albaniji jednu rafineriju u slucaju ako se konstatuje da je godišnji kapacitet proizvodnje bunara u radu dostigao 50.000.- tona petroleja takvog kvaliteta koji će biti industrijski rentabilan za rafiniranje.

A.Q.S.H. F. 588 v. 1925

D. 4

n. 4

-5-

Cl.14. Na kraju periode eksploatacije (t.j. posle 31 decembra 1985 godine) sve sonde, bunari, galerije, instalacije i konstrukcije koje postoje u Albaniji a svojina su Koncesionara, bice besplatno ustupljene Drzavi bez ikakve obaveze.

~~xxxxx~~ Instalacije i gradjenje

Cl.15. Koncesionar imace pravo da gradi, vrsi i odrzava: obicne puteve, zeleznice, vazduzne zeleznice, cevne linije za petrolej (kanale) i za vodu ili gaz, mostove, mesta za istovar robe u pristanimista, rezervoare, depoa, stanice pompi, rafinerije, ~~xxxx~~ radionice i stanove, bezvratni telegraf, telefonske i telegrafске linije; na kraju sve instalacije i gradjevine koje ce biti potrebne za dobar tok upravljanja preduzeca a koje je res u ovoj Konvenciji, ako je potreba i van površina datih ~~xxxxxxx~~ besplatno za eksploataciju. Drzava se obavezuje da ~~odelji~~ ^{besplatno} Koncesionaru na drzavnim zemljama i vodama, koje nisu date trecim licima, slobodan prolaz i potrebne zemlje za gorenavedene instalacije i gradjenje, kao i da vrsi eksprioprijacije prema zakonima na snazi u slucaju da instalacije i gradjenja moraju zauzeti privatne zemlje ili vode ili ranije date trecim licima za druge ciljeve.

Svi potrebni troškovi kao i naknade eksprioprijacije padaju na teret Koncesionara.

Opsti uslovi

Cl.16. Koncesionar se obavezuje da na pravedan nacin nagradi treca lica koja mogu biti ostecena radovima dozvoljenim ovom Konvencijom. Nagrada ce se odredjivati na prijateljski nacin medju dvema strankama, a u slucaju nekog nesporazuma pitanje ce se resiti arbitragom. U slucaju da do arbitraze ne dođe pitanje bice podneto mesnim sudovima.

Cl.17. Cimovnici i radnici koje ce koncesionar ~~xxxxxxx~~ angkorovati na albanskoj teritoriji moraju biti albanski drzavljanini osim direktora, tehnicara i specijalista. I pored toga u slucaju da radovi mogu biti ozbiljno ometani zbog nedostatka mesnih radnika, Koncesionaru dace ~~xxxx~~ se dozvola da dovede strane radnike u ~~xxxx~~ dovoljnom broju a prema povoljnom misljenju mesovite komisije.

AQSH. F. 588 v. 1925

D. 4

15

Cl.18. U slucaju da se radovi budu omei, obustavili ili prekinuli usled vece sile obaveze Koncesionara bice obustavljene za celo ^{periodina} vreme trajanja vece sile, i ovaj rok nece se uracunavati u ~~periodu~~ ^{periodu} vremena predvidjen ~~koncesionaru~~ kao maksimum u ovoj Konvenciji. U slucaju da se dodje do nesporazuma o vaznosti slucajeva vece sile, pitanje bice podneto arbitraznom kolegijumu predvidjen cl.24.

Cl.19. Koncesionar ce imati pravo da uvozi u Albaniju slobodno od svih carinskih i drugih taksa, masinerije proizvodnje i materijal koji ce mu biti potreban za vršenje prava koja su mu priznata ovom Konvencijom.

Cl.20. Koncesionar bice oslobođen svih ~~taksa~~ sadašnjih i budućih ^{isporuka} taksa/na angazovanik kapital, interes i dobiti koje proizilaze, na zemlje koncesijom, na proizvod i izvoz proizvoda osim onih koje su predvidjene ovom konvencijom.

Cl.21. Jedna mesovita komisija eksperata formirace se, koju ce sadinjivati ~~sest~~ ^{sest} ~~clanova~~, od kojih trojicu ce postaviti Drzava i trojicu Koncesionar. Ova komisija ~~utvrdjivace~~ ^{utvrdjivace} uslove zemalja i pakice izvršenja obaveza Koncesionara. Komisija imace pravo da smanji minimalni program ~~ispolnjenja~~ ^{ispolnjenja} kako u toku periode istraživanja tako i u periodu eksploatacije, u slucajevima kada vanredne okolnosti opravdavaju ovo smanjenje. Komisija imace pravo da ~~resava~~ ^{resava} po svim tehnickim i zakonskim pitanjima ~~koja~~ ^{koja} ce se postaviti o sumnjivim tumačenjima uslova ove konvencije ili koja mogu iskrnuti iz nepredvidjenih slucajeva koji se mogu resiti na miran način. Resenja mesovite komisije donosice se vecinom glasova, ~~na~~ ^{na} u slucaju da se ova vecina ne moze stvoriti pitanje bice podneto arbitrazni predvidjena cl.24.

Cl.22. U slucaju da Koncesionar ne ispuni svoje duznosti koje proizilaze od ove konvencije, Drzava imace pravo da mu uputi opomenu obavestavajući ga da u roku od tri meseca izvrši preuzete obaveze.

U slucaju dak na kraju ovog roka Koncesionar nije ispunio obaveze, Drzava ce se odmah obratiti Arbitrazi, prema cl.24. U slucaju da i posle arbitraze Koncesionar nastavi sa neispunjavanjem svojih obaveza Drzava imace pravo dak poništi Konvenciju.

-7-

Cl.23. U slucaju da, shodno cl.13, Koncesionar instalira u Albaniji jednu rafineriju bice duzan da izdaje svoje proizvode albanskoj vladi, uz dnevnu cenu uz odbitak od 10 %.

Kolicine koje ce Koncesionar davati pod gore izlozenim uslovima nece nikada preci 20 % opste proizvodnje rafinerije.

Cl.24. U slucaju nekakvog nesporazuma izmedju Drzave i Koncesionara, o pravima i duznostima obeju ~~strana~~ ugovoravajućih strana koja proizilaze od odredaba ove konvencije, pitanje bice podastreto jednom arbitraznom kolegijumu koji sacinjavaju tri clana, od kojih jednog postavlja Drzava, drugog Koncesionar a treci bicek izabran sporazumno od strane prvih dvojicu arbitara. U slucaju da prvi arbitri ne dodju do sporazuma o izboru treceg arbitra, formirace se novi arbitrazni kolegijum sastavljen od pet clanova, od kojih dvojicu ~~na~~ imenovat Drazav,, dvojicu Koncesionar a peti bice naimenovan vecinom glasova od strane prva cetiri arbitra. U slucaju da u izboru petog arbitra ne dodje do sporazuma, njegovo naimenovanje bice podastreto Albanskom Apelacionom Sudu. Resenja arbitraznog kolegijuma donosice se vecinom glasova. Ocekivanje resenja arbitara ne moze prouzrokovati obustavu salatnosti koncesije.

Cl.25. Da bi se zagarantovala dobra primena obaveza koja proizilicu od ove konvencije Koncesionar platicen na blagajni albanskog Ministarstva finansija, trideset dana posle potpisivanja ove konvencije, sumu od 150.000.- zkatnih franaka koja ce suma postati Drzavnom svojinom u slucaju ponistenja ove konvencije zbog neizvršenja obaveza od strane Koncesionara.

Ova suma vratice se Koncesionaru:

- a) ako ova konvencija ne bude ratifikovana,
- b) U slucaju da Koncesionar napusti u na koje vreme koncesiju i odnosa prava ali pod uslovom da je ispunio sve obaveze predvidjene ovo konvencijom u ostalom vratice mu se na kraju koncesije.

Cl.26. Za primenu ove Konvencije koja podleze pod jurisdikcijom Ministarstva javnih radova i poljoprivrede, Koncesionar odredjuje za mesto stanovanja prestonicu Albanije i bice podvrgnut mesnim zakonima, do

ti zakoni ne budu u opreci sa onim sto je ugovoreno ovom konvencijom.

Gl. 27. Ova je konvencija sastavljena na albanskom i francuskom jeziku i cetiri primerka potpisani od dveju ugovoravajućih strana. Dva primerka (jedan na albanskom tekstu a drugi na francuskom) uvace se u državnoj arhivi, a dva druga primerka (jedan na albanskom tekstu a drugi na francuskom) predace se Kona sionaru. Narocito je predvidjeno i ugovoreno da u slucaju sumnje ili nesporazuma prouzrokovanih iz zbog razlike tumacenja ili redakcije, samo se francuskom tekstu moze verovati.

Gl. 28. Ova je konvencija vazna za periodu od 20 godina pocev od dana njenog potpisivanja.

I pored toga Vlada se obavezuje da za podnese Parlamentu na ratifikaciju Dekret-Zakona koji se produziti kakav valjanost produzenja ove konvencije do 31 decembra 1925 godine.

U tekstu ove konvencije za ratifikaciju, podrazumeva se ratifikacija Dekret-Zakona, o kome je gore rec, o produzenju koncesije do 31 decembra 1925 godine.

Sastavljeno u Tirani 12 marta 1925 godine.

Za Drzavne zelesnice
Kraljevine Italije
Ugo Piolti s.r.

Za albansku vladu
Ministar javnih radova i poljoprivred
K. Kotta s.r.

Ovaj je ugovor identican sa ugovorom ~~skretizix~~ odobrenim dekrtom Ministarskog saveta i Pretsednistva albanske republike 9 marta 1925 g dine.

Ugo Piolti s.r.

K. Kotta s.r.

JORINA VERLI

SHQIPËRIA – PRIORITET STRATEGJIK I POLITIKËS ITALIANE NË DEKADAT E PARA TË SHEK. XX

Shumë shpejt pas krijimit, në gjysmën e dytë të shek. XIX, nën kurorën e dinastisë së Piemontit, Italia përcaktoi prioritetet e politikës së vet të jashtme. Në procesin e rritjes ekonomike dhe konsolidimit politiko-administrativ, ajo i ktheu në krahun lindor të Adriatikut. Përballë shteteve të fuqishme të Francës në veri-perëndim dhe Austro-Hungarisë në veri e veri-lindje, për qarqet drejtuese të Romës, në kontinentin europian, i vetmi krah i depërtimit ekonomik e politik mbetej Ballkani perëndimor, përkatësisht ndonjë shtet i parëndësishëm si Mali i Zi, ku gjithsesi kishte edhe lob rus të rëndësishëm, apo territoret shqiptare të Perandorisë Osmane, ku duhej konkurruar me Austro-Hungarinë.

Orientimi i Italisë për ekspansion në drejtimin e përmendur, që do të vijonte edhe në shek. XX, është një temë e trajtuar në historiografinë shqiptare. Gjithsesi në këtë trajtesë, duke shfrytëzuar burime të ndryshme bibliografike e arkivore të dala në dritë kohët e fundit, do të përpiqemi t'i qasemi temës nga një këndvështrim i veçantë, për një periudhë 8 vjeçare, kur ngjarje të bujshme në rajon nxorën në pah thelbin e politikës italiane në Shqipëri.

1. Konferenca e Londrës. Italia, interesat mbi Shqipërinë dhe roli i veçantë i kujdestarisë mbi shtetin shqiptar të porsakrijuar

Nga fundi i shek. XIX dhe në dekadat e para të shek. XX, interesat e dukshme të Italisë në Shqipëri, në të gjithë sferat, (posaçërisht në angazhimin politik, ekonomik dhe në arsim-kulturë,) e detyruan Perandorinë e fuqishme Austro-Hungareze, t'i njohë pjesën e tij, shtetit të ri dhe madje agresiv përtej mundësive reale. Marrëveshje të veçanta konfirmuan ortakërinë strategjike që, nga njëra anë, ruante njëfarë baraspeshe midis dy rivalëve dhe, nga ana tjetër, siguronte aleancën konsensuale, e cila kishte për qëllim të pengonte synimet e shteteve të vogla të Ballkanit, satelite në orbitat e Rusisë (Serbia, Mali i Zi, Bullgaria) dhe Britanisë së Madhe.¹

¹*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi II, (Rilindja Kombëtare – Vitet 30 të shek. XIX – 1912), Botimet TOENA, Tiranë 2002, f. 29; Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Përmbledhje dokumentash me një vështrim historik*, Vëllimi II, (1912-1918), Tiranë 1987, f. 25; shih edhe *British Documents on the Origins of the War, 1898-1914*, London 1927-1938; *Documenti Diplomatici Italiani*, Roma 1952.

Aleanca midis Italisë dhe Austro-Hungarisë, për çështjen shqiptare, spikati veçanërisht në vitet 1912-1913. Pavarësisht nga nuancat e ndryshme, për aspekte të ndryshme të qëndrimeve politike, të dy shtetet që zotëronin brigjet e Adriatikut, mbajtën qëndrim thelbësisht të njëjtë, kur ishte fjala për muajt e zhvillimit të Luftës së Parë Ballkanike dhe më pas në Konferencën e Londrës.²

Sa kohë ishte në luftë me Perandorinë Osmane, në vitet 1911-1912, Italia prirej të nxiste turbullira në Ballkan, e në këtë kontekst, t'i frynte zjarrit kryengritës në Shqipëri, qëndrim ky i ndryshëm nga ai i Austro-Hungarisë. Por në tetor-nëntor, kur ushtritë e Portës së Lartë ishin shpartalluar dhe synimet e fitimtarëve të Luftës Ballkanike kishin dalë hapur në pah, qëndrimet e të dy shteteve ishin akorduar plotësisht. Italia iu bashkua këmbënguljes së Ministrit të Jashtëm të Austro-Hungarisë, kontit energjik Bertold (Leopold Berchtold), për të mos lejuar në asnjë rrethanë, e duke mënjanuar me çdo kusht, daljen e Serbisë në Adriatik, madje nëse lindte nevoja edhe duke u angazhuar në një luftë rajonale.³ Projekti serb, në të gjitha variantet, qoftë për aneksimin e territoreve shqiptare, qoftë për sigurimin e një korridori simbolik, u kundërshtua nga të dy zotëruesit e pellgut të Adriatikut, sepse dalja portuale e Serbisë në bregdet, do të thoshte jo vetëm dalje në Mesdhe e Perandorisë Ruse, por edhe sepse depërtimi tokësor serb e përjashtonte krijimin e një shteti shqiptar të qëndrueshëm, që supozohej të ndalte dyndjet sllave drejt Perëndimit. Kryeministri italian San Xhuliano (Antonio Petero Costello, marchese di San Giuliano) vlerësoi realiste politikën kundërshtuese të Vjenës, duke konkluduar se dalja e Serbisë në Adriatik, do të sillte jo vetëm asfiksi për Vjenën, por edhe paqëndrueshmëri për Romën dhe asgjësim të synimeve të kësaj të fundit për ekspansion drejt Lindjes, e konkretisht drejt Ballkanit, në të ardhmen.⁴

Në Konferencën e Ambasadorëve, që filloi punimet më 17 Dhjetor 1912 në Londër, organizuar nga Fuqitë e Mëdha (Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Austro-Hungari, Rusi dhe Itali), praktikisht ambasadorët përfaqësues të Austro-Hungarisë dhe Italisë, të përkrahur pa ndonjë pasion, për shkak të mungesës së interesit të drejtpërdrejtë edhe nga Gjermania, mbajtën të njëjtën linjë që shtetet e tyre kishin ndjekur gjatë muajve të fundit (tetor-dhjetor 1912). Si pasojë, interesat e tyre të posaçme në rajon, u detyruan t'i merrnin në konsideratë edhe fuqitë e tjera.

²*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, (*Periudha e Pavarësisë – 28 Nëntor 1912 – 7 Prill 1939*), Botimet TOENA, Tiranë 2007, f. 19, 21, 27; shih edhe *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimi VI, Botimet Albanologjike, Tiranë 2012, Vëllimi VII, Tiranë 2014; Muhamet Shatri, *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, Vëllimi II, Botimet TOENA, Tiranë 2012; Muhamet Shatri, *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913*, Botimet TOENA, Tiranë 2012.

³*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze...*, Vëllimi II, Raporte dhe deklarata rreth bisedave e qëndrimeve austro-hungareze e italiane në tetor-nëntor 1912.

⁴*Arkivi i Institutit të Historisë (më tej AIH)*, Fondi (më tej F.) Arkiv i Vjenës, shih: *Dokumente të muajve nëntor-dhjetor 1912*. Dokumentet e sipërpërmendura janë botuar në *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, Vëllimet V, VI, Tiranë 2012, Vëllimi VII, Tiranë 2014; M. Shatri, *Dokumente britanike...*, Qëndrimi i përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha më 17 dhjetor 1912 – 29 korrik 1913.

Në këtë mënyrë, u shmang dalja e Serbisë në Adriatik, duke marrë territore bregdetare shqiptare (fillimisht i njoh një dalje ekonomiko-tregtare, përmes një skele shqiptare “të lirë dhe asnjëanëse”, që do të shfrytëzohej përmes një hekurudhe ndërkombëtare dhe do të mbikëqyrej, po ashtu, nga një forcë ndërkombëtare). U miratua krijimi i një shteti shqiptar, fillimisht autonom nën varësinë e Turqisë, por që më 29 korrik 1913, u përcaktua se ky shtet do të ishte i pavarur.⁵ U debatua gjatë për kufijtë, që më në fund, më 22 mars 1913 dhe 11 gusht 1913, u përcaktuan, me lëshimet dy-palëshe të Austro-Hungarisë dhe Rusisë mbi projektet e tyre fillestare. Si përfundim, brenda kufijve të shtetit shqiptar u përfshinë rreth 28.000 km², pra vetëm gjysma e sipërfaqes tokësore dhe gjysma e numrit të popullsisë. Përcaktimet territoriale nuk mund të ndryshonin pa një ligj, i cili do të kërkonte paraprakisht aprovimin e gjashtë Fuqive të Mëdha. Megjithatë, ato e njohën Shqipërinë si shtet *de jure*, e për pasojë si të tillë e njohën edhe Rumania, Bullgaria, Serbia dhe Greqia.⁶

Pikërisht, Konferenca e Londrës (17.12.1912 - 12.08.1913), që në seancën e parë të 17 dhjetorit, në kohën që ishte vendosur krijimi i “Shqipërisë autonome e asnjëanëse, nën garancinë dhe kontrollin ekskluziv të Fuqive të Mëdha”, ngarkoi Austro-Hungarinë dhe Italinë me “detyrën” e hartimit dhe paraqitjes së një projekti të hollësishëm për organizimin e shtetit të ri autonom, duke njohur kështu “interesat e tyre të posaçme” mbi trevat shqiptare. Pra, ndonëse nuk iu dha zgjidhje asnjërit prej aspekteve të rëndësishëm për çështjen shqiptare, Italia u bë njëri nga dy shtetet që siguroi miratimin ndërkombëtar për përgatitjen e projektit për organizimin e shtetit shqiptar.⁷ Likuidimi i Austro-Hungarisë pas Luftës së Parë Botërore, do ta bënte Italinë protektoren e vetme të Shqipërisë në periudhën midis dy luftërave.

⁵*Po aty*, Sipas vendimit të 29 korrikut 1913, Shqipëria shpallej principatë autonome, sovranë dhe e trashëgueshme (Neni 1); çdo lidhje sovraniteti me Turqinë përjashtohej (Neni 2); Shqipëria bëhej shtet asnjëanës nën garancinë e Fuqive të Mëdha (Neni 3). Por, nga ana tjetër shteti shqiptar vihej nën kontrollin e tyre, që nënkuptonte kontroll mbi administratën civile dhe mbi financat e Shqipërisë. Mbikqyrja do të ushtrohej me anën e një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë nga delegatët e Gjashtë Fuqive të Mëdha dhe nga një deputet i Shqipërisë... KNK do t'i vazhdonte funksionet e kontrollit për 10 vjet, që në rast nevojë do të përsëriteshin (nenet 4,5,6). Në krye të Shqipërisë vendosej një princ, i cili do të caktohej nga Fuqitë e Mëdha, brenda jo më shumë se 6 muajve (Neni 7). Qetësia dhe rendi publik do të siguroheshin nga xhandarmëria, organizimi dhe drejtimi i së cilës do t'u besohej oficerëve të huaj (Neni 8), që do të vinin nga rradhët e ushtrisë suedeze (Neni 9).

⁶Amedeo Giannini, *L'Albania dall' indipendenza all' unione con l'Italia 1913-1939*, 4^o Edizione, Istituto per gli Studi di Politica Internazionale, Milano 1940, p. 16, 17.

⁷*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III..., f. 20; Nicola C. Guy, *Lindja e Shqipërisë, (Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare)*, Botimet PEGI, Tiranë 2012, f. 55.

2. Nga Traktati i Fshehtë i Londrës, në Konferencën e Paqes dhe në Luftën e Vlorës

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, qeveria e parë shqiptare e Ismail Qemalit ndërmoi hapa që tregonin se donte të dilte nga kornizat ala-osmane në fushën ligjore dhe të shkonte drejt Europës së qytetëruar. Mund të konsiderohet këtu një përpjekje “Kanuni i Përtashëm (i përkohshëm) i administratës civile” të Shqipërisë, i cili u shpall më 22 nëntor 1913. Në të, përcaktoheshin parimet e centralizimit të pushtetit, të organizimit administrativ të vendit në prefektura, nënprefektura dhe krahina, të pjesëmarrjes së popullit në organet përfaqësuese, krijohet Këshilli i Përgjithshëm si instanca më e lartë etj. Të gjitha këto së bashku, ishin një hap për organizimin e administratës shqiptare dhe për bashkimin e të gjithë vendit nën pushtetin e Qeverisë së Vlorës. Në Kanun gjenin shprehje parimet e shqyrtimit të buxhetit, trajtimit të çështjeve ekonomiko-financiare, parashikohej ndërtimi i rrugëve, skelave, hekurudhave, bonofikimi i kënetave, zhvillimi i tregtisë, minierave, industrisë etj.⁸

Këto synime e të tjera, nuk mundën të realizohen për shkak të jetës së shkurtër dhe koniunkturave të disfavorshme të brendshme dhe ndërkombëtare. Megjithatë, Qeveria e Vlorës gjatë vitit 1913, kreu shtetëzimin dhe konfiskimin e 175 çifligjeve (në total 56.287 ha tokë) të Sulltanit dhe Portës së Lartë, nxori ligjin për kontrollimin e dokumenteve të pronësisë së tokës, përcaktoi detyrat dhe kompetencat e administratës civile, vendosi kontrollin mbi doganat dhe monopolet osmane të duhanit, kripës, peshkimit në dajlane, etj.⁹

Vlen të përmendet, veçanërisht përpjekja për të hedhur bazat e sistemit monetar e të kreditit kombëtar, duke tërhequr oferta për dhënie konçesionesh ndaj kapitalit austro-hungarez dhe italian, dy fuqive objektivisht të interesuara në atë kohë për ekzistencën e shtetit shqiptar.

Dihet se më 4 tetor 1913, u lidh marrëveshja mjaft e favorshme, me afat 60 vjeçar, për krijimin e Bankës Shqiptare, me “Wiener Bank Berein” (Vjenë) dhe me “Banca Commerciale Italiana” (Milano), marrëveshje, e cila u vlerësua nga Ismail Qemali, si “një i dytë fitim, pas lirisë”.¹⁰ Banka nuk pati kohë, as kushte, që të dimensiononte punën e vet dhe e mbylli veprimtarinë me çështje të kufizuara, që kishin lidhje me administratën shqiptare e me disa persona privatë.¹¹ Gjithsesi, preferenca për t’ua bërë përpjekjen sa më të lehtë, investimeve të kapitalit austro-hungarez dhe italian, tregonte se këtyre fuqive, si në plan ndërkombëtar, ashtu edhe në plan të brendshëm, të lidhur me faktorin politik shqiptar, u ishin njohur pozitat preferenciale.

Periudha 22 janar 1913 – 3 shtator 1913, e cila ka brenda 6 javë qeverisjeje të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit dhe 6 muaj qeverisjeje të Princit gjerman Vilhelm Vid (William of Wied ose në gjermanisht, Wilhelm Friedrich Heinrich von

⁸Banka Kombëtare e Shqipërisë, Vlorë 1914.

⁹Historia e Shqipërisë, Vëllimi III, 1912-1944, Botim i Institutit të Historisë së Akademisë së Shkencave, Tiranë 1984, f. 68.

¹⁰Gazeta “Përlindja e Shqipërisë”, Vlorë 1913, Nr. 23.

¹¹Haxhi Shkoza, *Financat e Shqipërisë (1839-1934)*, Tiranë 1935, f.779-780.

Wied), së bashku me KNK-në, dëshmojnë ndikimin parësor të Vjenës dhe Romës në Shqipëri, njëherësh edhe politikën e konkurrencës dhe rivalitetit që ato rifilluan të zbatonin midis tyre.¹² Është koha kur Roma vlerësoi forcën e Esat pashë Toptanit, si shumë të rëndësishme dhe të vlefshme për të minuar pozitat e Vjenës në Shqipëri. Investimi i saj shumëplanësh i dokumentuar në aspektin financiar me sponsorizimin e jashtëzakonshëm të pashait toptanas, është i njohur e faktuar historikisht.¹³

Kur Vidi ishte larguar dhe, qoftë rebelimi në Shqipërinë e Mesme, qoftë “lëvizja vorio-epirote”, e kishin zhytur vendin në anarki, Roma ende asnjëherë në konfliktin botëror, duke u kapur pas “rezikut” të pushtimit të Vlorës nga forcat “vorio-epirote” dhe duke propaganduar qëllime “humanitare” dhe respektimin e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, lëshoi ultimatumin “kush e prek Vlorën, prek Italinë”.¹⁴ Sikurse nënvizonte Sër Xhorxh Klark (Sir George Clark), atëherë funksionar i lartë në Forin Ofis (Foreign Office), edhe pse çështja shqiptare kishte kaluar në plan dytësor në marrëdhëniet ndërkombëtare europiane, “Vlora mund të përbënte shkas për fillimin e një luftë midis Italisë dhe Austrisë”.¹⁵

Athina, ndërkohë, miratoi vendosjen e përkohshme të Italisë në Vlorë, e bindur se pa pranuar interesat italiane në Shqipëri, nuk do të mund të realizonte synimet e saj lidhur me Jugun e vendit. Këtë e miratuan edhe Fuqitë e tjera të Mëdha, pjesëmarrëse në të dy blloqet, që po përipiqeshin të joshnin Italinë drejt anës së tyre.

Më 29 tetor 1914, Italia zbarkoi fillimisht në Vlorë me një “mision sanitar”, (për të ndihmuar refugjatët e grumbulluar në ullishtat e Vlorës); më 30 tetor, pushtoi ishullin e Sazanit (prej nga grekët ishin larguar qysh në qershor); kurse më 25 dhjetor 1914, zbarkoi forca të marinës ushtarake në skelën e qytetit. Tri ditë më pas, pasoi zbarkimi në Vlorë i forcave tokësore.¹⁶ Në linjën e akordit të paracaktuar, “qeveria” e Esat Toptanit, përkatësisht Këshilli i Senatit të Durrësit, i parapriu zbarkimit italian me një dokument të datës 20 dhjetor, që u lejonte trupave italiane të zbarkonin lirisht “në çdo pikë të Shqipërisë” për të ndihmuar në zhdukjen e anarkisë. Reagimi lokal, që erdhi nga Prefekti i Vlorës, Osman Haxhiu dhe Zv. Kryetari i Bashkisë, Ali Asllani, duke i dorëzuar një notë proteste me shkrim konsullit italian, ose ndonjë protestë tjetër nga disa koloni shqiptare jashtë Shqipërisë,¹⁷ kishin vetëm efekt protokollar.

Ndërkohë, në rrjedhat e Luftës së Parë Botërore, Italia peshoi interesat e shanset dhe zgjodhi krahun e Antantës, për të likuiduar si rivale Austro-Hungarinë. Në Traktatin e Fshehtë të Londrës (29 prill 1915), ajo do të siguronte protektoratin

¹²N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 82.

¹³Gazeta “*Shqiptarja.com*”, Tiranë, 4 shtator 2012, Dokumente të viteve 1914-1915, të Arkivit të Ministrisë së Jashtme të Italisë, të publikuara nga Ledia Dushku; *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 65.

¹⁴*Po aty*, f. 76.

¹⁵Rodd për Grey, 27/9/1914, FO371/2171/53584, dokument i cituar nga N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 128.

¹⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 77.

¹⁷*Po aty*, f. 78.

mbi Shqipërinë Qendrore, (që do të duhej të përcaktohej, pas një vlerësimi të mëvonshëm nga ana e Antantës, në veri e në jug për të shpërblyer përkatësisht Serbinë e Greqinë,) si dhe ishullin e Sazanit, Vlorën dhe krahinën përreth, si territore që do të kishte të drejtë t'i aneksonte.¹⁸

Italia tashmë e larguar nga aleatët e dikurshëm (Austro-Hungari dhe Gjermani) dhe e rreshtuar përkrah Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë, nënshkroi Traktatin e Fshehtë të Londrës (26 prill 1915) duke i dhënë fund asnjësisë së vitit 1914-1915. Pikërisht në dhjetor 1915, trupat e saj zbarkuan në Vlorë dhe më pas u përhapën edhe në vise të tjera të Shqipërisë së Jugut.¹⁹

Marsi i vitit 1915, kishte qenë muaj veprimesh intensive nga diplomacia e Romës, me Austro-Hungarinë nga njëra anë dhe qeveritë e Antantës nga ana tjetër. Nga cili bllok anoi Italia dhe arsyet se përse veproi në atë mënyrë, janë çështje të njohura tashmë. Në pikat 5, 6 dhe 7, ndër 16 pikat e Traktatit, trajtoheshin pretendimet ndaj Shqipërisë, të Italisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë asnjësisë, e cila ishte gjithashtu në fazën e joshjes. Në pikën 6, Vlora, ishulli i Sazanit dhe një territor toke mjaft i gjerë në lindje të Vlorës, do të kalonin nën sovranitetin e plotë të Italisë. Territori në fjalë në veri dhe në lindje do të kishte si kufi lumin Vjosa. Kufiri jugor do të niste nga Tepelena për të dalë në Himarë, nëpërmjet Kurveleshit. Pjesëtimin e Shqipërisë me fqinjët ballkanas, Roma e pranoi me kusht që kjo të ndodhte pasi ajo të merrte krahinën e Vlorës dhe tokat e pretenduara dhe të premtuara në veri të bregdetit Adriatik. Kusht tjetër i Romës ishte që shteti shqiptar i cinguar, autonom e neutral, që do të formohej në Shqipërinë e Mesme, të mos kishte marrëdhënie diplomatike të pavarura, por të përfaqësohej nga Italia. Kjo do të thoshte, që ai të vihej nën protektoratin italian.

Traktati i Londrës i 26 prillit 1915, me fuqi veprimi pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, zhvlerësonte vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), të marra me konsensusin e 6 Fuqive të Mëdha. Traktati i realizuar prej katër fuqive (Britani e Madhe, Francë, Rusi dhe Itali), parashikonte likuidimin e pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimin e plotë të saj.²⁰ Në fund të vitit 1916, frontet e luftës në Ballkan ndryshuan dukshëm. Trupat austro-hungareze dhe bullgare shpartalluan ushtrinë serbe dhe malazeze, kurse anglo-francezët rritën territoret nën kontrollin e tyre në frontin e Selanikut.

Në viset shqiptare, kufiri i zonave austro-hungareze dhe italiane të pushtimit u fiksua në Vjosë. Bullgarët kishin pushtuar një pjesë të Kosovës dhe Maqedoninë Perëndimore, përkatësisht trevat shqiptare lindore, që iu shkëputën shtetit shqiptar me vendimet e Konferencës së Londrës (1913). Francezët zotëruan Korçën dhe Pogradecin, prej nga dëbuan forcat greke të Mbretit Kostandin, i cili

¹⁸Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë, nga zanafilla deri në ditët tona*, Botimet SHLK (Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit), Tiranë 2000, f. 133.

¹⁹Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005, Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93 vjeçare të tij*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2006, f. 64.

²⁰N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 145.

anonte nga Blloku Qendror. Italianët mbajtën Tepelenën, Gjirokastrën dhe Përmetin.²¹

Ndryshe nga zona franceze e pushtimit, ajo italiane, përgjithësisht, është anashkaluar nga historiografia shqiptare. Të dhëna të përgjithshme për situatën në këtë zonë, për qëndrimin e forcave italiane ndaj popullsisë, për organizimin e administratës, veprimtarive publike, aktet politike etj.; i gjejmë në vëllimin e III të Historisë së Popullit Shqiptar, në një monografi e disa artikuj të profesorëve Muin Çami, Arben Puto, e ndonjë autori tjetër, por detajet e hollësishme të kësaj periudhe disa vjeçare janë të rralla.²² Për të mësuar rreth tyre, shërbejnë disa vëllime me dokumente të botuara, ku përsëri Prof. M. Çami spikat ndër studiuesit shqiptarë, dhe Spiro Kosova ndër autorët e memoaristikës, që kanë qenë të pranishëm në ato vise në vitet e Luftës së Parë Botërore.²³

Nga burimet që kemi konsultuar, mund të nxjerrim përfundime lidhur me qëndrimin që ka mbajtur Italia, si pjesë e Antantës, në organizimin e pushtetit ushtarak në territorin e pushtuar, në sjelljet e saj ndaj problemeve të kohës në trevat shqiptare, që lidheshin me mbajtjen e rendit dhe sigurimin e burimeve njerëzore e materiale vendase në shërbim të luftës, në mënyrën e organizimit dhe shpërblimit të forcave të rregullta ose të parregullta të armatosura vendase, në prononcimet politike në raste të domosdoshme, si proklamata e gjeneralit Ferrero (Giacinto Ferrero), kryekomandantit të trupave italiane në Shqipëri, e datës 3 qershor 1917, etj.²⁴

Vihet re përpjekja për të mos krijuar probleme me shqiptarët, për të fituar mundësisht simpatinë e tyre dhe për të përgatitur situatën për zotërimin me çdo kusht, të paktën të Vlorës, pas Luftës. Gjithsesi, shqiptarët e zonës italiane të pushtimit patën rast gjatë viteve 1915-1918 e më pas, krahas privimeve e sakrificave që impononte situata e luftës dhe kërkesave të okupatorit për zbatimin e politikës së vet, të shikonin si ky shtet europian organizonte e stërviste ushtrinë, si qeveriste, si përzgjidhte e kultivonte administratën, me çfarë legjislacioni vepronte, si ndërtonte, si nxiste prodhimin e tregtinë, etj.²⁵ Ishte kjo, një përvojë tjetër, për ata që kishin rast të udhëtonin, të kujtonin e të krahasonin, e ngjashme me rastet

²¹*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 83.

²²Arben Puto, *Shqipëria politike 1912-1939*, Botimet TOENA, Tiranë 2009; Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918)*, Botim i Akademisë së Shkencave të RPSH të Shqipërisë, Tiranë 1987; etj.

²³*Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918 – 1920 (Përmbledhje dokumentesh)*, red.përgj. Muin Çami, vëllimi I, II, Tiranë, 1975-1976; Marenglen Verli, *Historia e Shqipërisë në kujtimet e Spiro Kosovës*, Botimet KLEAN, Vëllimi I, Tiranë 2008.

²⁴A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 180; Lef Nosi, *Dokumente historike për t'i shërbyer historisë sonë kombëtare*, Botim i dytë, Tiranë 2007, f. 276.

²⁵*Archivio Storico Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri d'Italia* (më tej ASDMAEI), Fondo (më tej F.) Serie Politica 1919-1930, Albania, Anno (më tej A.) 1930, Pacco (më tej P.) 695, Xhandarmëria dhe policia 1920, Milicia shqiptare, e organizuar nga italianët, numëronte rreth 4000 vetë, ndër të cilët 300 italianë. Shumica e 480 shqiptarëve të graduar ishin nënoficerë e kapterë; shih edhe raportin e G. Vitalit, komandant i Legjionit shqiptar (Gjirokastrë më, 4 shtator 1919).

franceze e austro-hungareze në Korçë apo në veri të lumit Vjosa, por mjaft e ndryshme nga përvoja pararendëse e njohur e qeverisjes osmane.²⁶

Në gusht 1916, nisur nga Vlora, ushtria italiane zbriti drejt jugut, pushtoi Tepelenën dhe gjithë trevën që i njihte Traktati i Fshehtë i Londrës. Në këtë kohë ndodhi edhe ndalimi i ngritjes së flamurit kombëtar shqiptar, i cili prej gati dy vjetësh shoqëronte paralelisht flamurin italian. Gjithsesi, veprimi francez në Korçë, në 10 dhjetor 1916, për të fituar përkrahjen e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke sfiduar për hir të politikës së ditës, jo vetëm esadistët dhe venizelistët, por edhe qëndrimin italian, e detyruan Romën të lejonte autoritetet e veta civile e ushtarake në Shqipëri të vepronin në mënyrë të ngjashme në trevën e Gjirokastrës. Ndryshe nga veprimi që ndërmerën në Vlorë, më 1 janar 1917, komanda italiane shpalli se për Gjirokastrën do të përdorej emërtimi “Shqipëri e Jugut” e jo “Vorio-Epir”, dhe se aty lejohej të ngrihej flamuri kombëtar shqiptar. Njëkohësisht, u organizua një Këshill Administrativ prej 6 anëtarësh, gjysma myslimanë e gjysma të krishterë, u larguan nga administrata elementët grekofilë, u hapën shkollat shqipe, në të cilat u angazhuan shumë mësimdhënës italianë, etj.²⁷

Deklarimi më 23 janar 1917, i austro-hungarezëve për të ardhmen e Shqipërisë (nga Komandanti i përgjithshëm Trollman në Shkodër), i dha të kuptojë Romës se kishte mbetur pas të tjerëve “për të fituar zemrat” e shqiptarëve. Duke dashur t’ua kalonte aleatëve francezë dhe armiqve austro-hungarezë në premtime, më 10 maj 1917, gjenerali Ferrero, komandanti i Korpusit XVI të pushtimit, u rekomandoi eprorëve të shpallej një “proklamatë” ku të njihej “në mënyrë solemne... pavarësia shqiptare”, çka edhe u bë më 3 qershor 1917, me rastin e përvjetorit të kushtetutës italiane. Solemnisht, shoqëruar me 21 të shtëna artilerie, Ferrero lexoi në kalanë e Gjirokastrës, proklamatën që u drejtohej gjithë shqiptarëve dhe shpallte “unitetin dhe pavarësinë e gjithë Shqipërisë”, ndonëse “nën hijen dhe nën mbrojtjen e Mbretërisë së Italisë”.²⁸ Me sa duket, veprimin italian e kushtëzoi edhe avantazhi që krijuan venizelistët në konfliktin politik në Greqi, dhe futja e tyre në luftë përkrah Antantës.²⁹ Në këtë kohë, italianët i shtynë trupat e tyre edhe më në jug, duke zbritur deri në lumin Kalamas, e duke vënë në zotërim Janinën dhe gjithë Epirin. Ky veprim duket se kishte vetëm synim diversiv të dyfishtë. Të sigurt se pas futjes së Greqisë në luftë përkrah Antantës, Britania e Madhe dhe Franca, do të përkrahnin edhe aspiratat e saj në periudhën e pasluftës; italianët, nga njëra anë u jepnin grekëve leksionin e fuqisë së madhe, që duhej respektuar, ndërsa nga ana tjetër fitonin simpati të shqiptarët, posaçërisht te

²⁶ Marenglen Verli, Elemente të integritimit në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e Europës Perëndimore deri në vitin 1944, *Shqipëria dhe Kosova, Historia e një aspirate*, Vëllimi II, BOTIMPEX, Tiranë 2007.

²⁷ Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, Vëllimi I, (1912-1939), Botimet TOENA, Tiranë 2013, f. 279; shih edhe *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 93.

²⁸ L. Nosi, *Dokumente historike...*; Joseph Swire, *Shqipëria, Ngritja e një mbretërie*, Shtëpia Botuese DITURIA, Tiranë 2005, f. 224, 225; M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare...*, f. 298; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 81, 82; etj.

²⁹ J. Swire, *Shqipëria...*, f. 223.

popullsia çame e keqtrajtuar prej disa vitesh, çka ishte investim për politikën e ardhme italiane në Ballkan.

Në Romë llogaritej përjashtimi i zbatimit të Traktatit të Londrës në favor të Greqisë, në Shqipërinë e Jugut. Në historiografi është paraqitur pikëpamja se, proklamata italiane e 3 qershorit ishte një reagim edhe ndaj deklaratës së Presidentit të SHBA-ve, U. Uillson (Woodrow Wilson), pas hyrjes në luftë të këtij vendi të përtej Atlantikut, në prill 1917, se bashkimi i armëve me Antantën bëhej “për vendosjen e një paqeje të drejtë, dhe se nuk do të njiheshin traktatet e fshehta”,³⁰ deklaratë kjo, që fitoi simpati sidomos në radhët e emigrantëve shqiptarë në Amerikë. Kur po atë muaj, Ministri i Marinës i SHBA-ve, i bëri thirrje Federatës Panshqiptare “Vatra”, që të dërgonte marinarë shqiptarë në flotën e Shteteve të Bashkuara në brigjet e Adriatikut, mbi 60.000 shqiptarë që jetonin në SHBA, nëpërmjet nje telegrami dërguar Presidentit Uillson, iu përgjigjën pozitivisht kësaj thirrjeje. Mbi 3.000 prej tyre e bënë këtë premtim realitet.³¹

Por, proklamata italiane solli pasoja të kundërta nga ato që synonte Roma. Vet burimet italiane pohojnë se proklamata, jo vetëm që nuk ngjalli ndonjë interesim tek popullsia, por përkundrazi i shtoi antipatitë ndaj Italisë.³² Dyshimet dhe reagimet kundërshtuese nga shqiptarët u forcuan veçanërisht pas nëntorit 1917, kur qeveria sovjetike botoi traktatet e fshehta të Rusisë me Fuqitë e tjera të Mëdha për ndarjen e botës, e midis tyre u publikua edhe Traktati i Fshehtë i Londrës i 26 prillit 1915.³³ Në të njëjtin moment, në fund-vitin 1917, Austro-Hungaria, gjithashtu shpërndau në të gjithë Shqipërinë tekstin e përkthyer të Traktatit të Fshehtë të Londrës, pa pjesën ku flitej për copëtimin e Shqipërisë. Një përlllogaritje dinake kjo, për të kompromentuar qarqet drejtuese kundërshtare të Italisë dhe Francës.³⁴

Në Itali ndjehej se Shqipëria ishte një terren i rrëshqitshëm, prandaj në fund te vitit 1918, kur ushtarakisht kontrollohej shumica e territorit të vendit (kufijtë e vitit 1913), Roma u përpoq të ndikonte përmes lobit të vet në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, për të forcuar pozitën. Në Kongresin e organizuar nga shqiptarët në Durrës, më 25 dhjetor 1918, ajo arriti diçka, por raportet me shqiptarët nuk ishin raporte besimi ose bindjeje, pesha në arenën ndërkombëtare nuk ishte e padiskutueshme dhe situata sociale e politike në Itali, kishte krijuar destabilitet frenues për synimet ekspansioniste të qeverisë së Romës.³⁵

Gjithsesi, Konferenca e Paqes e mbledhur më 18 janar 1919 në Paris, nga 5 Fuqitë e Mëdha fituese, (Britani e Madhe, Francë, Itali, SHBA dhe Japoni,) duket

³⁰*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 94.

³¹Beqir Meta, *Federata Panshqiptare Vatra*, Shtëpia Botuese GLOBUS R, Tiranë 2002, f. 139.

³²Massimo Borgogni, *Tra continuità e incertezza. Italia e Albania (1914-1939)*, Franco Angeli Edizioni, Milano 2007, p. 37.

³³N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, fq. 174.

³⁴Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shek. XX*, Botimet IDEART, Tiranë 2004, f. 89.

³⁵Marenglen Verli, Kongresi i Lushnjës akt kulmor në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, *Kosova, sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, BOTIMPEX, Tiranë 2007, f. 86, 89.

se ishte një përplasje midis: filozofisë së vjetër të diktatit të fortë të fituesve mbi të mundurit (Austro-Hungari, Gjermani, Turqi, Bullgari), pa respektuar as interesat e tyre jetike, ndërkohë që respektoheshin të gjitha traktatet e lidhura midis fituesve, (përfshi Traktatin e Fshehtë të Londrës të 26 prillit 1915,) nga njëra anë; dhe përpjekjeve të SHBA-ve, që shfaqeshin pa sigurinë e duhur apo me hezitimin e të angazhuarit rishtaz në Europë, për të diktuar rregulla të reja loje.

Idetë e presidentit Udrou Uillon, të sintetizuara në 14 pikat e njohura, të shpalosura në janar 1918, që premtonin për një pozicion të paanshëm dhe veprime “sipas traditës amerikane të drejtësisë dhe zemërgjerësisë”³⁶, ngjallën shpresa edhe te populli shqiptar. Pika kryesore e programit të tij ishte goditja e diplomacisë së fshehtë. Në Konferencën e Paqes së Parisit (1919), ai denoncoi ashpër Traktatin e Fshehtë të Londrës (prill 1915). Në pikën 9 të programit të tij, Uillsoni, duke iu referuar pretendimeve të Italisë, për “korrigjime kufijsh”, ripohoi parimin e përcaktimit të kufijve sipas kombësisë.³⁷

Por çështja nuk ishte e thjeshtë. Dy memorandumet e paraqitura nga delegacioni shqiptar, në Konferencën e Paqes në Paris, nuk gjetën mirëkuptim. Ato e trajtonin çështje të mbyllur pavarësinë e Shqipërisë, të fituar e të njohur ndërkombëtarisht qysh më 1913; dhe mbronin idenë se shtetit shqiptar duhej t’i ktheheshin territoret e copëtuara nga vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) dhe të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913).³⁸ Por shqiptarët nuk u respektuan dhe nuk u morën seriozisht.

Pa u ndalur në evoluimin e kërkesave e të situatës në Konferencë, duhet theksuar qysh në fillim se kërkesat e shqiptarëve u hodhën poshtë, ndërkohë që u morën në shqyrtim pretendimet greke mbi Korçën dhe Gjirokastrën, gjithashtu kërkesa që të respektohej Traktati i Londrës (1915), çështje këto të paraqitura përmes kryeministrit Venizelos.³⁹

Qëndrimi i dyzuar i delegacionit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllave), në dukje i favorshëm për Shqipërinë, sepse nuk paraqiti drejtpërdrejt kërkesa për territore, u përcaktua nga rivaliteti i ashpër italo-jugosllav në Adriatik dhe në Shqipëri.⁴⁰ Në Beograd, shpresonin të diktonin lojën tek fqinji i vogël jug-perëndimor, përmes Esat Toptanit, që ishte riorientuar politikisht gjatë kohës së bashkëpunimit me serbët e francezët në frontin e Selanikut (1916-1918), por

³⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 129.

³⁷N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 233; shih edhe M. Çami, *Lufta çlirimtare anti-imperialiste e popullit shqiptar në vitet 1918-1920*, Tiranë 1969.

³⁸P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, (1912-1939), f. 380; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 91, 92.

³⁹Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, KRISTALINA-KH, Tiranë 2013, f. 248-257; Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, ALBIN, Tiranë 2003, f. 286-291; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, (1912-1939), f. 378.

⁴⁰Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Shtëpia Botuese ENCIKLOPEDIKE, Tiranë 1992, f. 85-93.

kryesorja ishin gati për “lëshime”, që mund të zmbrahnin matanë Otrantos Italinë e rrezikshme.⁴¹

Roma, nga ana e saj kishte synime të palëkundura drejt Vlorës, që e konsideronte prej kohësh si pikë të rëndësishme strategjike në Adriatikun Jugor dhe përpiqej të ngulte rrënjë të thella në Ballkan përmes protektoratit mbi “shtetin autonom shqiptar”, i cili do të krijohet në Shqipërinë e Mesme “myslimane”, sipas Traktatit të Fshehtë të vitit 1915, por që Italia e kërkonte me shtrirje në kufijtë e vitit 1913.⁴²

Në morinë e kontradiktave midis të vegjëlve, por edhe midis Fuqive të Mëdha, Italia që kishte siguruar qysh më 1915, premtimin për pjesën e luanit, ndoqi taktikën e veprimit jo të nxituar, duke studiuar situatat. Pikëpamja e Londrës dhe Parisit, sipas së cilës pavarësia e Shqipërisë dhe tërësia territoriale e saj duheshin sakrifikuar për interesat e vendeve fqinje, aleate të tyre e fituese të Luftës, me kohë u pranua edhe nga SHBA-të, që duhet thënë se nuk kishin njohuritë e dhura për Ballkanin, dhe as peshën për të zbatuar drejtësinë e premtuar me 14 pikat e Uillonit.⁴³

Duke e konsideruar të parakohshme, pavarësinë e njohur të Shqipërisë më 1913, të tre Fuqitë e Mëdha, (ndoshta edhe nën efektin e një propagande të shfrenuar të fqinjëve, që i paraqisnin shqiptarët si të organizuar në fise, të pacivilizuar, pa kohezion, pa aftësi shtetformuese,) e përfshinë atë në sistemin e mandateve, ndërkohë që në këtë sistem futeshin vetëm vende e popuj, të cilët nuk e kishin fituar ende pavarësinë, përkatësisht ish-teritore të Perandorisë Osmane, ose koloni të Gjermanisë së mundur.⁴⁴

Ishte sërish rasti për Italinë të kërkonte e të përfitonte. Të mëdhenjtë e tjerë, që në mars 1919, u treguan të gatshëm për t'i dhënë asaj mandatin mbi Shqipërinë, duke plotësuar kështu edhe kërkesën për protektorat, që Italia kishte paraqitur qysh gjatë Luftës. Kjo gatishmëri u përsërit në shtator 1919, pas kërkesës zyrtare që paraqiti në fund të gushtit në forumet e Konferencës, ministri i ri i jashtëm i Italisë, Tomazo Titoni (Tommaso Titoni).⁴⁵

Miratimi për mandatin në fjalë u parashtrua në memorandumun e 9 dhjetorit 1919, të firmosur nga përfaqësuesit e Britanisë së Madhe, Francës dhe SHBA-ve. Në përkujtesën bashkëngjitur memorandumit thuhej se tri fuqive nuk u mungonte dëshira për të njohur pavarësinë e shtetit shqiptar, por se “ky shtet do të ketë nevojë për këshillat dhe për ndihmën administrative të ndonjëres prej Fuqive

⁴¹P. Milo, *Po aty*, f. 67-84; K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar...*, f. 94, 95, 104, 105; Muin Çami, Kompromisi i Nittit i janarit 1920 dhe qëndrimi i Jugosllavisë ndaj problemit shqiptar, *Studime historike*, Nr. 1-4, 1992, Tiranë 1995; M. Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare...*, f. 187.

⁴²M. Verli, Vështrim për raportet e shqiptarëve me fqinjët e tyre dhe me Europën në periudhën midis dy luftërave botërore, *Kosova, sfida shqiptare...*, f. 102.

⁴³A. Puto, *Historia diplomatike...*, f. 310; N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 221.

⁴⁴J. Swire, *Shqipëria...*, f. 250, 252.

⁴⁵*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 132; Muin Çami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes*, Monografi në proces botimi, f. 134.

të Mëdha. Nga pozita e saj gjeografike dhe nga kapaciteti ekonomik, Italia është shteti më i përshtatshëm për të përmbushur këtë detyrë”.⁴⁶

Dispozitat konkrete të mandatit dhe Statuti themeltar i shtetit shqiptar do të përgatiteshin nga një komision i përbërë nga tre autorë, prej të cilëve njëri do të ishte përfaqësues i qeverisë italiane, tjetri përfaqësues i Lidhjes së Kombeve dhe i treti përfaqësues i shtetit shqiptar. Megjithatë, ky i fundit do të zgjidhej dhe caktohej nga Fuqitë e Mëdha. Dispozitat e sipërpërmendura do të miratoheshin nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, organizatë e njohur e krijuar në mbarim të Luftës së Parë Botërore për të ruajtur paqen në botë.

Projektet për vendosjen e Shqipërisë nën mandatin e Italisë, jo vetëm shkelnin pavarësinë dhe sovranitetin që ajo kishte fituar disa vjet më parë, por nuk respektonin as procedurën e parashikuar nga Karta e Lidhjes së Kombeve për vënien nën mandat. Shqiptarët nuk u pyetën për të dhënë miratimin e tyre lidhur me shtetin të cilit do t’i ngarkohej mandati, sikurse parashikohej në nenin 22 të Kartës.

Të tre Fuqitë e Mëdha u dakorduan edhe për ngushtimin territorial të shtetit shqiptar. Ata miratuan vënien e Vlorës nën sovranitetin e Italisë dhe aneksimin e Gjirokastrës nga Greqia. Ndërkohë historia e kontradiktave italo-jugosllave në Konferencën e Paqes, e njohur në historiografi me tog-fjalëshin “Çështja e Adriatikut”, ripozicionoi disa herë qëndrimet e Fuqive të Mëdha për fatin e Shqipërisë.⁴⁷

SHBA-të përgjithësisht toleronin vetëm copëtimin e krahinës së Gjirokastrës, në favor të Greqisë. Me disa rezerva, mund të pranonin edhe vënien e Vlorës nën sovranitetin italian dhe mandatin mbi Shqipërinë e paprekur, në kufijtë e tjerë. Ky qëndrim që favorizonte politikën italiane, ndër të tjera, ndoshta ishte edhe një tentativë për të frenuar sadopak fuqinë e padiskutueshme të Britanisë së Madhe në Mesdhe, por edhe kontrollimin e forcës kontinentale të Francës, që pas gjunjëzimit të Gjermanisë dhe krijimit të shtetit serbo-kroato-sllloven, ishte fuqia e parë në Europë, dhe jo më dashamirëse dhe përkrahëse e SHBA-ve, si në kohën e Revolucionit Amerikan të shek. XVIII.⁴⁸

Memorandumi i 9 dhjetorit 1919 nuk kënaqi as Italinë, për shkak të zgjidhjes që i jepte çështjes së Fiumes në veri të Adriatikut, as Greqinë që nuk siguronte Korçën, e aq më pak Jugosllavinë, që nuk përfitonte asgjë në Shqipëri. Kryeministri serb, Nikolla Pashiç (Nikola P. Pašić), u kundërpërgjigj më 8 Janar 1920, duke përsëritur kërkesën e shkurtit 1919, me të cilën kërkonte një shtet shqiptar të pavarur, në kufijtë e vitit 1913, ose aneksimin e territoreve veriore shqiptare, deri në lumin Drin.

Në një kompromis të 13 janarit 1920, në mungesë të përfaqësuesit të SHBA-ve, kryeministrat e Britanisë së Madhe (David Lloyd George), Francës (Georges Clemenceau) dhe Italisë (Francesco Saverio Nitti), vendosën që Shqipëria

⁴⁶Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore*, Vëllimi III, Tiranë 2001, f. 42.

⁴⁷P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, f. 73, 74.

⁴⁸Margareth MacMillan, *Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*, Botimet PLEJAD, Tiranë 2006, f. 154, 155.

të copëtohej midis tri fuqive fqinje, gati sikurse parashikohej në Traktatin e Fshehtë të Londrës (prill 1915). Kundërshtimi i SHBA-ve, për të miratuar një dokument në hartimin e të cilit nuk kishin marrë pjesë, u dha kohë shqiptarëve të organizonin një qëndresë të brendshme, themelet e së cilës u hodhën në Kongresin e Lushnjës, më 21 janar (28-31 janar 1920).⁴⁹

Italia i kishte konsumuar energjitë duke synuar shumë dhe kishte fituar jo pak. Duke u treguar e paskrupullt, ajo kishte fituar antipatinë e shqiptarëve dhe të Jugosllavisë, por, me sa duket, edhe të Francës e sidomos të Britanisë së Madhe.⁵⁰ Shqiptarët e shfrytëzuan këtë rast. Pas Kongresit të Lushnjës, lobi proballkanas dhe qeveria e Sulejman Delvinës u orientuan në veprime konstruktive, që garantuan prapavijat kufitare, morën nën kontroll situatën, nxitën e mbështetën kryengritjen çlirimtare në Vlorë (5 qershor 1920 – 2 gusht 1920), dhe më në fund duke larguar Italinë, konfirmuan e garantuan përgjithësisht arritjet e vitit 1913.⁵¹

Shqipëria e pasluftës së Parë Botërore, humbi disa territore në kufijtë juglindorë e verilindorë, i mbeti Italia në hyrje të gjirit të Vlorës, në ishullin e Sazanit, por ishte përsëri një shtet i pavarur. Gjithashtu mundi të vinte nën kontroll gjithë territorin, çka nuk e kishte arritur në vitet 1913-1914; dhe në 17 dhjetor 1920 me përkrahjen e britanikëve, ishte pranuar anëtare e Lidhjes së Kombeve.⁵²

Anëtarësimi në Lidhjen e Kombeve kishte rëndësi të trefishtë për Shqipërinë. Së pari, me këtë veprim ripohohej njohja ndërkombëtare e shtetit shqiptar. Së dyti, realizohej akti i njohjes kolektive të qeverisë së Tiranës. Së treti, krijoheshin mundësi për të shqyrtuar nga ky forum ndërkombëtar çështjet e mbetura pezull me shtetet fqinje. Megjithatë, çështjet e diskutueshme kufitare me fqinjët, me këmbënguljen dhe argumentin e tyre se vendimet e Konferencës së Londrës për kufijtë nuk ishin më në fuqi, i kaluan Konferencës së Ambasadorëve në Paris, vëzhguese kjo e Konferencës së Paqes.⁵³ Për të kaluar diskutimin e çështjeve të mbetura nga ky organizëm, u prononcua edhe qeveria e Romës. Ajo nuk kishte çështje territoriale për të diskutuar, por synonte të siguronte me çdo kusht një pozitë “të veçantë” në Shqipëri, krahasuar me fuqitë e tjera. Tërheqjen nga aneksimi i Vlorës dhe nga marrja e mandatit mbi Shqipërinë, Roma e shihte si veprim që duhej të kompensohej nga Fuqitë e Mëdha, për t’i njohur asaj të drejtën e ndërhyrjes për mbrojtjen e tërësisë tokësore dhe sovranitetin e Shqipërisë, në rast se këto kërcënoheshin.⁵⁴

⁴⁹ *Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës*, Tiranë 1974, f. 43, 51; Francesco Jacomoni, *Politika e Italisë në Shqipëri*, Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2005, f. 9.

⁵⁰ *ASDMAEI*, F. Serie Politica 1919-1930, Albania, A. 1920, P. 695, Xhandarmëria dhe policia, Raport rezervat i komisar Penneta-s, dërguar nga Vlora më 25 nëntor 1920.

⁵¹ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 151, 165.

⁵² *Po aty*, f. 167, 171; Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë 1996, Botimet ÇABEJ, f. 36.

⁵³ A. Puto, *Historia diplomatike...*, f. 348.

⁵⁴ A. Biagini, *Historia e Shqipërisë...*, f. 147; *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 173.

Kështu, kërkesat e qeverisë shqiptare të 29 prillit dhe 21 qershorit 1921, drejtuar Lidhjes së Kombeve, për rinjohjen e kufijve të vitit 1913 dhe për tërheqjen e forcave jugosllave e greke tej këtij kufiri, Këshilli i Lidhjes së Kombeve, me vendimin e 26 qershorit 1921, ia kaloi për diskutim Konferencës së Ambasadorëve. Kjo konferencë në përfundimet që shpalli më 9 nëntor 1921*, rikonfirmoi nga njëra anë kufijtë e vitit 1913, (caktuar nga Protokollin e Firences i 17 dhjetorit 1913) me disa ndryshime në favor të Jugosllavisë; dhe nga ana tjetër sanksionoi ruajtjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të Shqipërisë, por duke i njohur Italisë një pozitë të veçantë. U pranua kështu teza italiane se, dhunimi i kufijve dhe i pavarësisë së Shqipërisë, “mund të përbënte një kërcënim për sigurimin strategjik të Italisë”.⁵⁵

Konferenca vendosi, që nëse Shqipëria nuk do të ruante dot vetë tërësinë tokësore, qeveria shqiptare mund t’i drejtohej për ndihmë Lidhjes së Kombeve. Në këtë rast Britania e Madhe, Franca dhe Japonia do t’i rekomandonin Këshillit të Lidhjes, që t’ia besonte Italisë rivendosjen e kufijve shqiptarë. Po kështu do të vepronin këto fuqi edhe në rast se do të kërcënohej “pavarësia ekonomike e Shqipërisë”.⁵⁶ Gjithsesi, qeveritë shqiptare asnjëherë nuk e njohën këtë vendim. Por edhe qeveritë italiane nuk iu referuan ndonjëherë kësaj formule. U mbyll kështu, në vitin 1921, një etapë e rëndësishme historike, që u kurorëzua me rifitimin e pavarësisë kombëtare dhe ruajtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar.⁵⁷

3. Këmbëngulja e Italisë për të shmangur konkurrentët në Shqipëri në vitet 1921-1924

Ndonëse me pozita të tronditura në Shqipëri nga humbja e Vlorës dhe e mandatit mbi shtetin shqiptar, Roma nuk hoqi dorë nga përpjekjet për të realizuar synimet e saj. Në situatën e turbullt politike të viteve 1921-1924, kur forca e grupime të ndryshme politike u ballafaquan ashpër, deri edhe me armë në Shqipëri, ajo do të angazhohej thelbësisht për të siguruar një qeveri pro-italiane në Tiranë.

Diplomati i Britanisë së Madhe në Shqipëri, Aires* (Sir Harry Eyres), njëherësh kuadër i Intelligence Service, u angazhua përkrah forcave qeveritare dhe për shtypjen e lëvizjes së marsit 1922,⁵⁸ duke vlerësuar se fitorja e kryengritësve do

* Vendimi i 9 dhjetorit u shoqërua me vendosjen, më 10-12 nëntor 1920, të marrëdhënieve diplomatike të tri Fuqive të Mëdha, nënshkruese të këtij vendimi, (të Britanisë së Madhe, Francës dhe Italisë) me Shqipërinë.

⁵⁵M. Verli, Vështrim për raportet e shqiptarëve..., *Kosova, sfida shqiptare...*, f. 104, 105; Vuk Vinaver, Anglia dhe pozita ndërkombëtare e Shqipërisë midis dy luftërave botërore, *Gjurmime Albanologjike*, Nr. 1, Prishtinë 1968; shih edhe Haris Silajdžić, *Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Washingtonit*, Tiranë 1999.

⁵⁶*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 174.

⁵⁷*Po aty*, f. 174.

* Më 24 janar 1922, pas njohjes së qeverisë shqiptare nga Britania e Madhe, Franca dhe Italia (në nëntor 1921), H. Eyres do të ishte përfaqësuesi i parë diplomatik britanik në Shqipëri.

të sillte forcim të ndikimit të Romës në dëm të atij të Londrës, duke kërcënuar edhe sigurinë e shoqërive britanike të koncesioneve të shfrytëzimit të naftës në Shqipëri. Një kryengritje e re, në janar 1923, në prefekturën e Kosovës e nxitur nga Bajram Curri, Hasan Prishtina e Hysni Curri, gjithashtu nuk pati rezultat.⁵⁹ Por Roma ishte konsekuente në politikën e saj drejt Shqipërisë.

Qysh në 1921, për të kompensuar humbjen e Vlorës, ajo këmbënguli në Konferencën e Ambasadorëve që t'i njihej një pozitë e veçantë politike dhe ekonomike në Shqipëri. Britania e Madhe dhe Franca e toleruan vetëm në fushën politike. Ndonëse njohja e Shqipërisë në vitin 1922 nga një varg shtetesh (13 të tilla, përfshi SHBA-të) dhe lidhja e marrëdhënieve diplomatike midis tyre dhe Shqipërisë, i lanë të kuptojë Romës se do të duhej kohë për të arritur ambiciet e veta. Megjithatë, ajo e shfrytëzoi përparësinë që iu dha.

Në janar 1923, në krye të Komisionit Ndërkombëtar të Kufijve, u caktua gjenerali italian Enriko Telini (Enrico Tellini). Ky komision me përfaqësues të tri Fuqive të Mëdha, ishte caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve me vendimin e 9 nëntorit 1921, për përcaktimin e kufijve të Shqipërisë me fqinjët.⁶⁰ Të gjitha protokollat e KNK-së duhet t'iu paraqiteshin për miratim shteteve të fuqishme kryesore.⁶¹

Më 27 gusht 1923, gjeneral Telini, përfaqësuesi i Italisë dhe kryetari i Komisionit, u sulmua ndërsa udhëtonte në makinën e tij, nga persona të panjohur dhe u vra, së bashku me përkthyesin e tij dhe tre italianë të tjerë. Që krimi ishte rezultat i një komploti të organizuar nga autoritetet greke, kjo nuk u vu asnjëherë në dyshim.⁶² Qeveria e Benito Musolinit iu kundërpërgjigj këtij akti me pushtimin e përkohshëm të ishullit të Korfuzit. Vdekja e gjeneralit, me sa duket, u shfrytëzua nga Italia për të shkaktuar tension të dyfishtë në Ballkan. Ajo u tregoi si shqiptarëve, ashtu edhe fqinjëve të tyre dhe Fuqive të tjera europiane, se e kishte marrë seriozisht “kujdestarinë” mbi Shqipërinë.⁶³

Në vijim, edhe pse nga Konferenca e Ambasadorëve, nuk iu njoh ndonjë përparësi në depërtimin ekonomik në Shqipëri, Italia u përpoq t'arrinte vetë këtë, duke akaparuar sa më shumë koncesione në ekonominë shqiptare. Deri në fundin e vitit 1924, edhe pse koncesionet që u miratuan nga Këshilli Kombëtar (Parlamenti) ishin të kufizuara, Italia mbajti minierën e Serës në Selenicë të Vlorës (“Societa Italiana Miniere di Selenizza”), të cilën e kishte blerë nga një firmë franceze, qysh më 1920*. Ajo rriti gjithashtu investimet në shfrytëzimin e pyjeve të Mamurrasit

⁵⁸Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy, 1908-1939*, Volume One, The Centre For Albanian Studies in association with I B TAURIS Publishers, New York 2004, p. 190.

⁵⁹*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 186.

⁶⁰B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar...*, f. 62-65.

⁶¹N. C. Guy, *Lindja e Shqipërisë...*, f. 288.

⁶²J. Swire, *Shqipëria...*, f. 333; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 572.

⁶³*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 207.

* marrëveshja midis shoqërisë italiane dhe qeverisë shqiptare u nënshkrua në qershor 1922.

** sipas *Historisë së Popullit Shqiptar...*, f. 211, për 25 vjet, gjithsesi marrëveshja nuk u finalizua.

(Shoqëria Italiane e Pyjeve në Shqipëri - SIFA), koncesionin e të cilave e gëzonte që prej vitit 1920. Italia fitoi për disa dekada^{**}, të drejtën e shfrytëzimit të çifligjeve të shtetit nga Shkumbini deri në Vjosë (grupi italian “Adriatico”), por nuk arriti të futet në rrethin e parë të lojës, përkrah anglezëve dhe amerikanëve, për të siguruar naftën shqiptare, me gjithë përpjekjet e lobistëve të saj, midis të cilëve mesa duket bënin pjesë edhe figura potenciale të politikës shqiptare, si Luigi Gurakuqi.⁶⁴

Pas disa përpjekjeve, Italia arriti në mars 1924, të siguronte nga Lidhja e Kombeve, të drejtën që së bashku me qeverinë shqiptare, të themelonin Bankën e Shqipërisë, për të dirigjuar sistemin monetar dhe të kreditit në Shqipëri, ku fitimi konsiderohej i sigurt e pa risk.⁶⁵

Gjithsesi, lufta e konkurrencës midis koncesionarëve të mëdhenj, ku u përzje edhe politika shtetërore, nuk i rreshti presionet mbi palën shqiptare. Në një kohë kur Italisë nuk i ishte njohur përparësia mbi ekonominë mbi Shqipërinë, këto presione, sollën disbalancime që ndikuan në lënien pezull të miratimit të shumë projekteve koncesionare. Në këtë proces ndikoi edhe debati në elitën politike shqiptare, ku personalitete të ndryshëm mbrojtën pikëpamjet që koncesionet të mos jepeshin në kushte monopoli, që të rritej përqindja e përfitimit në dobi të shtetit shqiptar, që fushat naftëmbajtëse të mos jepeshin njëherësh në koncesion, që koncesionarët të jepnin garanci për seriozitetin e tyre, që marrëveshjet të formuloheshin të studiuara dhe me kushte të përcaktuara qartë, që prodhimi ose kapitali vendas të ruhej e të nxitej me një politikë të kujdesshme proteksioniste etj.⁶⁶

Në periudhën qershor-dhjetor 1924, Italia u shfaq favorizuese për opozitën e ardhur në pushtet.⁶⁷ Nisur nga llogaritjet e interesave ekonomike dhe të kontradiktave të Italisë me Britaninë e Madhe dhe Mbretërinë SKS (Jugosllavinë), si dhe nga prania e një lobi të konsiderueshëm proitalian në rradhët e opozitës kryengritëse, komiteti administrativ i formuar në Vlorë në fillim të kryengritjes, më 26 maj 1924 i kërkon Romës, t’u tërhiqte vëmendjen shteteve fqinje për Shqipërinë, që të mos ndërhyjnë në punët e saj të brendshme.

“Na pëlqen të besojmë, shkruan Noli me shokë, se në rradhët e opozitës së tanishme, Italia ka miq të zjarrtë, sinjeriteti i të cilëve nuk mund të vihet në dyshim...”⁶⁸ Roma, nga ana e saj, më 9 qershor, një ditë para se të hynin në Tiranë forcat kryengritëse, i imponoi Beogradit publikimin e një deklarate të përbashkët ku theksohej se dy qeveritë nuk do të ndërmerrnin “asgjë që të ndalojë ose të

⁶⁴*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 212; *ASDMAEI*, F. Serie Politica 1919-1930, Albania, A. 1920, P. 695, Xhandarmëria dhe policia, Raport për pasuritë e naftës në Shqipëri, 16 qershor 1919.

⁶⁵ Iljaz Fishta, Veniamin Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912-1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, Tiranë 1983, f. 39,40.

⁶⁶ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942 (Kujtime dhe vlerësime historike)*, Botim i dytë i plotësuar me foto, Shtëpia Botuese NERAIDA, Tiranë 2000, f. 7.

⁶⁷A. Biagini, *Historia e Shqipërisë...*, f. 152.

⁶⁸*Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëllimi III, f. 233.

pengojë zhvillimin e Shqipërisë së pavarur” dhe se “ata i konsiderojnë trazirat në Shqipëri, punë të brendshme të saj”.⁶⁹

Këto sinjale të para dhanë shpresë se qeveria e Benito Musolinit do t'i njihte forcat kryengritëse pas marrjes së pushtetit. Këto shpresa ushqeheshin sidomos nga disa anëtare të qeverisë Noli, që kishin prirje te pranonin firmat koncesionare italiane në Shqipëri, ndërkohë që Ahmet Zogu kishte preferuar projektet e shoqërive britanike.

Strehimi i A. Zogut në Jugosllavi, rivalja më e madhe kjo e Italisë në Shqipëri, ishte një arsye tjetër, me rëndësi politike, që ushqente shpresat e kabinetit Noli ndaj sigurimit të mbështetjes së Romës. Diplomacia italiane, në fakt, bëri edhe nje hap tjetër. Ajo kontaktoi me Londrën, Parisin, Uashingtonin dhe vendet e Ballkanit, që të merreshin vesh për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me qeverinë e re shqiptare. Por kur këto përçapje dolën të pasuksesshme, Roma zgjodhi të ecte në një hap me qeveritë e vendeve të tjera.⁷⁰ Ende nuk kishte ardhur koha e saj, dhe në diplomacinë e lartë italiane, me sa duket, u kristalizua ideja se kjo nuk mund të bëhej me Nolin e kundërshtuar fort nga Britania. Por duhej investuar te A. Zogu, për të mos e lënë atë plotësisht në duar të Jugosllavisë. Pasi dështoi në ditët e para të tetorit, në bisedimet direkte me Nolin dhe L. Gurakuqin, kur këta në kthimin nga Gjeneva, ku kishin marrë pjesë në sesionin e Lidhjes së Kombeve, qëndruan disa ditë në Romë, që t'u impononte miratimin e një pakti politik që e vinte Shqipërinë nën një lloj kujdestarie, Musolini e braktisi krejtësisht qeverinë shqiptare të qershorit. Aq më tepër se përmes emisarëve të fshehtë, mori nga A. Zogu premtimin se po të kthehej në pushtet, do t'a orientonte Shqipërinë drejt Italisë.⁷¹ Misioni i togerit italian, Alessandro Lessona dhe veprimtaria e vëllezërve tregtarë, Aldo dhe Gildo Pagni, të cilët furnizuan me armë e municione luftëtarët e “legalitetit”⁷², janë dëshmi e lojës së re të Italisë në kuadrin e konfliktit politik në Shqipëri.

Roma nuk ishte tashmë e interesuar për qeverinë e Fan Nolit, e cila në tetor 1924, refuzoi të pranonte platformën e saj për të marrë nën “tutelë”, apo për të “mbrojtur” Shqipërinë nga çdo ndërhyrje e jashtme.⁷³ Ditën e fillimit të sulmit të forcave të A. Zogut nga Jugosllavia, më 10 dhjetor 1924, B. Musolini i shkruante përfaqësuesit italian në Shqipëri “që Shqipëria do të arrinte një ditë në një gjendje kritike, kjo duhej pritur, përderisa ky shtet, për hir të ndjeshmërisë së tepruar (për ruajtjen e pavarësisë), deshi të sakrifikonte mbështetjen efektive që, në një situatë të veçantë si kjo, do të ishte në gjendje t'i jepte Italia”. Disa ditë më pas, më 20 dhjetor, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, S. Contarini, i deklaroi të ngarkuarit me punë apo kryediplomatit shqiptar në Romë,

⁶⁹*Po aty*, f. 233.

⁷⁰A. Puto, *Shqipëria politike...*, f. 365; P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 608.

⁷¹Robert C. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit, Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924*, Botimet ALBIN, Tiranë 2000, f. 179.

⁷²Marenglen Verli, Rreth një marrëveshjeje të A. Zogut të vitit 1924, *Studime Historike*, Nr. 3, Tiranë 1986; Marenglen Verli, Ndërhyrja jugosllave për përmbysjen e qeverisë së Nolit, *Kosova në fokusin e historisë*, BOTIMPEX, Tiranë 2002, f. 206.

⁷³P. Milo, *Politika e jashtme...*, Vëllimi I, f. 629.

Tefik Mborjes: “Duke na dëbuar nga Vlora (më 1920), ju na hoqët mundësinë për t’ju ndihmuar në mënyrë efikase. Në situatën e tanishme ne nuk mund të bëjmë asgjë për ju...”⁷⁴

Beogradi kishte marrë kështu miratimim e heshtur për të ndihmuar A. Zogun të rimerrte pushtetin. Deklarata e 13 dhjetorit 1924, Musolini-Ninçiq, për “mosndërhyrjen” e të dy vendeve në punët e brendshme të Shqipërisë, një përsëritje kjo e deklaratës italo-jugosllave të 9 qershorit, kur në elitën politike shqiptare ndodhte konflikti i radhës për pushtet, ishte formaliteti i radhës i fqinjëve, që kishte të bënte me ruajtjen e ekuilibrit midis tyre.⁷⁵ Afërsisht në këtë kohë (në mesin e dhjetorit), qeveria e Romës refuzoi kërkesën e qeverisë shqiptare për të blerë municione, ndërkohë që forcat zogiste furnizoheshin me gjithçka nga Jugosllavia.⁷⁶

⁷⁴*Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej AMPJ), Viti (më tej V.) 1924, Dosja (më tej D.) 225. Telegram i Tefik Mborjes nga Roma për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Tiranë, 20 dhjetor 1924.*

⁷⁵*Historia e Popullit Shqiptar..., Vëllimi III, f. 242; P. Milo, Politika e jashtme..., Vëllimi I, f. 661.*

⁷⁶*Historia e Popullit Shqiptar..., Vëllimi III, f. 243.*

SONILA BOÇI

MINORITETET NË SHQIPËRI NË NJË ANALIZË HISTORIKE-JURIDIKE

Diskutimet rreth termit “minoritet” dhe tipologjia e minoriteteve

Fjala “minoritet” është përdorur historikisht që nga lindja e shteteve e, megjithatë, deri më sot mungon një marrëveshje se çfarë do të kuptohet me temin “minoritet”. Në rrethet shkencore botërore është shprehur herë pas here mendimi se kjo mungesë ka kushtëzuar në një masë të konsiderueshme edhe sjelljet e shteteve ndaj tyre. Studimet për të përcaktuar termin “minoritet” kanë hasur në shumë pengesa, një pjesë e të cilave rrjedh nga shumëllojshmëria e identiteteve të individëve që përbëjnë komunitetet minoritare, dhe nga faktorët që ndikojnë mbi secilin prej tyre. Pengesa të tjera shkaktohen nga këndvështrimet e shumta doktrinare. Për kompleksitetin e tyre këto çështje mund dhe duhet të studiohen:

si çështje të jurisprudencës, pasi minoritetet përbëhen nga individë, të cilët si të tillë, por dhe si qytetarë të një shteti, kanë të drejtat e tyre;

si çështje të shkencave politike, pasi minoriteti si një grup, i cili ndryshon nga shumica e popullsisë për shkak të disa karakteristikave etnike apo kombëtare, ka problematika që lidhen me kombin, identitetin kombëtar dhe ndërgjegjen kombëtare;

si çështje të marrëdhënieve ndërkombëtare, pasi minoritetet mund të jenë ura lidhëse në marrëdhëniet ndërmjet shteteve fqinje ose shkak mosmarrëveshjes dhe konfliktesh ndërmjet shtetit ku jetojnë dhe shtetit të tyre amë;

si çështje me karakter historik, pasi minoritetet janë një bashkësi individësh, që u nënshtrohen ndryshimeve gjatë periudhave të ndryshme kohore. Si e tillë, kjo bashkësi krijon historinë e saj, e cila lidhet si me historinë e shtetit në të cilin jeton, ashtu edhe me historinë e shtetit amë.

Pra, është lehtësisht e konstatueshme se shkenca të veçanta i japin konceptit “minoritet” kuptime të ndryshme. Kështu, në kuptimin gjuhësor, fjala minoritet vjen nga fjala latine *minor*, që në shqip përkthehet pakicë, pra, *më pak se e tëra* apo *një pjesë e së tërës*¹. Në fjalorin politik me “minoritet” kuptohet një pjesë e popullsisë që nuk ka mjaftueshëm vota për të fituar zgjedhjet. Shkencat politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare me termin “minoritet” kuptojnë gjithashtu, një pjesë të popullsisë, një grup njerëzish, brenda një shoqërie, anëtarët e të cilit kanë karakteristika etnike, racore, kombëtare, fetare, seksuale, politike, gjuhësore

¹ Microsoft® Encarta® Dictionary Tools 2006 Redmond, WA: Microsoft Corporation, 2005.

etj., të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë². Në shkencat sociale të qenët minoritetet nuk ka të bëjë me numrin e popullsisë, por me statusin social të një grupi të caktuar, pavarësisht nga numri i tij. Kështu, për shkencat sociale, popullsia me ngjyrë në Afrikën e Jugut gjatë kohës së Aparteidit, për shkak të diskriminimit dhe pozitës inferiore sociale dhe politike të saj, përbënte minoritetet, megjithëse nga pikëpamja numerike ajo përbënte 89% të popullsisë³.

Në pjesën më të madhe të shteteve, termi “minoritetet” ngjall reagime, të cilat përgjithësisht janë negative. Në shumë shtete minoritetet janë konsideruar si mbartëse të pikëpamjeve irredente të shteteve të tyre amë dhe, si rrjedhojë, janë parë si rrezik për integritetin territorial të shtetit ku përfshihen. Politikat shtetërore, në një mënyrë apo në një tjetër, kanë tentuar të shmangin diskutimin mbi minoritetet. Për këtë arsye, dhënia e një përcaktimi të plotë dhe përfundimtar se çfarë kuptojmë me minoritetet në përgjithësi, si dhe ndarja midis minoriteteve etnike dhe kombëtare në veçanti, nuk është arritur ende si në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ashtu dhe në atë juridike. E për rrjedhojë, në terminologjinë politike, diplomatike dhe historike na ndodh shpesh të dëgjojmë për minoritete etnike, kombëtare, fetare, kulturore, gjuhësore apo të hasim termat racë, grup etnik, komunitet gjuhësor apo kulturor, çka shpesh krijon konfuzion në jo pak njerëz.

Studiues të ndryshëm, me gjithë mungesën e kritereve të sakta juridike të përcaktimit, kanë bërë përpjekje për të krijuar një *tipologji* për minoritetet. Studiuesi maqedonas, Vladimir Ortakovski, mendon se ka dy mënyra për krijimin e minoriteteve: nga lëvizjet e popullsisë për shkak të pushtimeve të ndryshme ose për shkak të bashkimit paqësor të komuniteteve të ndryshme⁴. Nisur nga mënyra e krijimit, V. Ortakovski jep këtë tipologji për minoritetet, duke i ndarë në tri grupe:

- *minoritete autoktone* ose popuj që historikisht jetojnë në një territor të caktuar si mbartës të ngulimeve të popujve të tyre. Këtyre autori u referohet si “minoritete territoriale”⁵. Këto minoritete janë ndarë nga shtet-kombet për shkak të ravijëzimit të kufijve;
- *minoritete joautoktone*, të krijuara nga emigrimi për shkak të ngatërresave fetare, politike dhe ekonomike;
- *minoritete të reja autoktone*, të krijuara në proceset e reja të segmentimit etnik dhe rilindjes së gjuhëve dhe kulturave të harruara, të cilat bëhen elemente përcaktuese të disa grupeve⁶.

Një tipologji për minoritetet ka dhënë dhe studiuesi hungarez, Istvan Zalatnaj në “Minorities in Central and Eastern Europe”⁷. Ai i ndan minoritetet në:

- *minoritet komb*, i cili krijohet nga popullsi autoktone, e ndarë nga shteti mëmë për shkak të ravijëzimit të kufijve. Për autorin, një nga kushtet e

² Po aty.

³ H. Paul Chalfant & Emili Labeff, *Understanding People and Social Life – Introduction to Sociology*, USA: West Publishing Company, 1988, f. 161.

⁴ Vladimir Ortakovski, *Minority in the Balkan*, New York: Transnational Publisher Inc: Ardsley, 2004, f. 7.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

⁷ Arqile Bërçxoli, *Minoritetet në Shqipëri: studim demografik*, Tiranë: 2005, f. 22.

përfshirjes së një popullsie në kategorinë e minoritetit komb është pesha e tij numerike.

- *minoritet i fuqishëm*, i cili, mbledh si popullsinë autoktone, ashtu dhe atë joautoktone, pra ngulime popullsisë të ndryshme, të formuara si pasojë e emigrimeve. Tipar dallues i këtij minoriteti është shkalla e avancuar e ndërgjegjes së tij kombëtare.

- *minoritet i paformuar*⁸, në të cilin autori përfshin atë që quhet “grup etnik” apo “minoritet etnik”, i cili në “evoluimin e tij etnologjik nuk ka arritur deri te formimi i etnosit dhe fazat e tjera të kombësisë dhe të kombit i ka kaluar në kuadër të një mjedisi të ndryshëm social”⁹. Tipar dallues i këtij minoriteti është se ai nuk ka komb apo shtet-amë.

Tipologjitë e dhëna kanë gjëra të përbashkëta, por dhe dallime të dukshme. Minoritetet kombe dhe minoritetet autoktone të dyja këto u referohen popullsisë, të cilat kanë jetuar historikisht në territorin e tyre dhe kanë karakteristika të njëjta me një komb-shtet. Për shumë studiues homogjeniteti territorial është, në të vërtetë, tipari themelor i kombit. Por, ndërsa studiuesi Ortakovski, i jep më shumë rëndësi territorit dhe jo peshës numerike të popullsisë minoritare, për Istvan Zalatnaj, kjo e fundit është më e rëndësishme. Përveç kësaj, koncepti “minoritet komb”, duket disi i diskutueshëm, sepse ka një përplasje konceptesh. Në përcaktimin që i bëjnë minoritetit, ai konsiderohet “një pjesë e së tërës”, ndërsa kombi ka disa tipare dalluese që e veçojnë atë nga kombe të tjera dhe jo nga pjesë të tjera brenda një shteti apo shoqërie. Ky lloj koncepti mund të aplikohet vetëm për shtetet shumëkombëshe, por, dhe në këtë rast, mund të flasim për kombe shtetformuese dhe jo për minoritete. Terminologjia më e saktë në këtë rast, mendoj se do të ishte minoritet kombëtar, i cili është i ngjashëm me konceptin e dhënë nga V. Ortakovski për minoritetin autokton, i cili është shkëputur nga trangu kombëtar për shkak të ravijëzimit të kufijve. Në këtë kategori përfshihet p.sh. edhe minoriteti shqiptar në Greqi, i cili, sipas tipologjisë së I. Zalatnaj, i përket kategorisë së minoritetit të fuqishëm.

Ngjashmëri ka dhe midis koncepteve “minoritet autokton” dhe “minoritet i fuqishëm”. Të dyja tipologjitë u referohen minoriteteve të krijuara për shkak të zhvendosjeve dhe instalimeve të popullsisë të ndryshme nga një vend në tjetrin, për arsye të ndryshme politike, ekonomike apo fetare. Por, edhe në këtë rast, duke iu referuar madhësisë numerike të minoriteteve, I. Zalatnaj, përfshin te minoriteti i fuqishëm si minoritetin autokton, i cili numerikisht është i vogël, ashtu dhe minoritetin joautokton, por nuk qartësohet kriteri i këtij klasifikimi.

Për kategorinë e tretë, të dy autorët u referohen minoriteteve, të cilat kanë filluar të ndërgjegjësohen për diferencat e tyre në gjuhë dhe në kulturë nga pjesa tjetër e popullsisë. Ajo që ndryshon tek autorët është terminologjia. Ndërsa, Ortakovski i konsideron këto grupe minoritare në një proces rilindjeje, I. Zalatnaj i

⁸ *Po aty.*

⁹ *Po aty*, f. 24.

trajton ato si minoritete të paformuara¹⁰. Tipologjia e dhënë nga Ortakovski është më e thjeshtë në të kuptuar, por nga ana tjetër nuk bën dallimin mes minoriteteve etnike, kombëtare dhe linguistike, gjë që bëhet më e qartë në tipologjinë e dhënë nga I. Zalatnaj.

“Minoriteti kombëtar” në këndvështrimin doktrinar, juridik, politik

Përkufizimi i termit minoritet është i rëndësishëm, pasi në bazë të përcaktimit të grupeve minoritare do të ishte më e lehtë për të përcaktuar shkallën e të drejtave që duhet të gëzonin këto grupe.

Në periudhën midis dy Luftërave, një sërë përpjekjesh u bënë nga studiues të ndryshëm për të dhënë një përcaktim të pranueshëm nga të gjithë të termit “minoritet”. Në vitin 1920, kryetari për 12 vjet i Seksionit për Çështjen e Minoriteteve në Lidhjen e Kombeve, De Askarat (De Azcárate) i përcaktonte kështu minoritetet: “Eksperienca ime personale, ... më çon në përfundimin ... që një minoritet kombëtar është ekzistenca e një ndërgjegjeje kombëtare, e shoqëruar nga ndryshime gjuhësore dhe kulturore. Në terma të përgjithshëm, shprehja minoritet kombëtar i referohet një numri pak a shumë të konsiderueshëm të qytetarëve të një shteti, të cilët kanë një kombësi të ndryshme nga ajo e shumicës”¹¹. Siç del qartë, në këtë përcaktim u jepet rëndësi e dorës së parë kriterëve subjektive, si: ndjenja kombëtare, të cilat ndërthuren me kriteret objektive: territori, gjuha etj.

Edhe studiues të pas Luftës së Dytë Botërore kanë vazhduar debatin për kriteret e përcaktimit dhe për gjetjen e një përkufizimi për termin “minoritet”, në përgjithësi, por edhe për të diferencuar minoritetet kombëtare dhe etnike, në veçanti. Por, ndërsa në periudhën midis dy Luftërave, duket se u jepej përparësi më e madhe kriterëve subjektive, më pas ky raport ndryshoi. Në vitin 1974, në Seminarin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të drejtat e minoriteteve, të mbajtur në Ohër (ish-Jugosllavi), një nga pjesëmarrësit dha këtë përkufizim: “Një grup qytetarësh, i mjaftueshëm në numër për të ndjekur qëllimet e grupit, por numerikisht më i vogël se pjesa tjetër e popullit, të lidhur së bashku nga lidhje historike, etnike, kulturore, fetare ose gjuhësore dhe me dëshirën për t’i ruajtur këto lidhje, të cilat janë të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të popullsisë”¹².

¹⁰ Termi i përdorur “minoritet i paformuar”, është disi i paqartë. Në kuptimin që vetë autori u jep minoriteteve, si një pjesë e së tërës, e cila *dallon* nga pjesa tjetër nga disa tipare etnike, gjuhësore, fetare etj. dhe krijon në vartësi të këtyre dallimeve disa kategori minoritetesh. Nëse një grup brenda një shoqërie shfaq karakteristika të veçanta dhe të dallueshme nga pjesa tjetër e popullsisë, ai përbën një minoritet. Nëse grupi etnik, kulturor apo fetar do të ishte i paformuar, atëherë ai nuk do t’i shfaqte këto dallime. Në konceptin që jep autori për minoritetin e paformuar, duket se ai vetë nuk e tejkalon dot konceptin paksa të gabuar, sipas të cilit minoritetet janë vetëm pjesë e një kombi e shkëputur nga ai, qoftë për shkak të ravijëzimit të kufijve, qoftë për shkak të emigrimeve.

¹¹ Nicola Girasoli, *National Minorities: Who are they?*, Budapest: Akademiai Kiado, 1995, f. 90-91.

¹² *Po aty*, f. 92.

Duke u mbështetur në këtë përcaktim, në vitin 1978 raportuesi special i Nënkomisionit për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve dhe ekspert në shkencat juridike, Françesko Kapotorti (Francesco Capotorti), u përpoq të jepte një përcaktim më të plotë për termin “minoritet”, i cili, sipas tij: “është një grup numerikisht inferior nga pjesa tjetër e popullsisë të një shteti, në një pozitë jozotëruese, anëtarët e të cilit, duke qenë bashkëkombës të shtetit – zotërojnë karakteristika etnike, fetare dhe gjuhësore, që i dallojnë ata nga pjesa tjetër e popullsisë, dhe tregojnë, një ndjenjë solidariteti, që drejtohet nga ruajtja e kulturës, traditave, fesë ose gjuhës”¹³. Propozimi i prof. Kapotortit u diskutua në qarqet politike, por nuk gjeti miratimin e tyre.

Disa vite më vonë një tjetër raportues i Nënkomisionit për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve, si dhe profesor i së drejtës, Xhul Deshëné (Jul Deschênes), duke u mbështetur në propozimin e Seminarit të Ohrit dhe punën e prof. Kapotortit, dha një përcaktim të ri se ç’do të kuptohej me termin minoritet. Sipas tij, me këtë term duhej kuptuar: “një grup qytetarësh të një vendi, që përbëjnë një pakicë numerike në një pozicion jozotërues në këtë shtet, të pajisur me karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore, të cilat ndryshojnë nga pjesa tjetër e popullsisë, që kanë një ndjenjë solidariteti me njëri-tjetrin, të motivuar, edhe pse jo në mënyrë të shprehur, nga një dëshirë kolektive për të mbijetuar, dhe qëllimi i tyre është të arrijnë barazinë me shumicën e popullsisë në fakt dhe me ligj”¹⁴.

Të tria propozimet i bashkon ndërthurja e kriterëve objektive dhe subjektive të përcaktimit. Të përbashkëta janë kriteret objektive. Në të tria propozimet kërkohet që një grup të konsiderohej minoritet duhej: *së pari*, të kishte numër më të vogël se pjesa tjetër e popullsisë; *së dyti*, anëtarët e grupit të kishin disa karakteristika të përbashkëta etnike, fetare ose gjuhësore, ndërkohë që propozimi i Ohrit shprehej edhe për kujtesë historike të përbashkët; *së treti*, grupi të kishte pozitë politike dhe sociale jozotëruese¹⁵ dhe *së katërti*, të ishin shtetas të një shteti. Propozimet nuk lënë mënjane dhe kriteret subjektive të përcaktimit. Në këto propozime flitet për “dëshirë” për të ruajtur karakteristikat e veçanta (Seminari i Ohrit); apo “ndjenjë solidariteti”, e cila mund të shërbejë për të ruajtur kulturën, traditat, fenë apo gjuhën e tyre (Kapotorti); apo “dëshirë kolektive” për të mbijetuar (Deshëné).

Mungesa e një përcaktimi doktrinar ka sjellë si pasojë përdorimin e terminologjive të shumëllojshme nga shtete të ndryshme për të dalluar minoritetet nga pjesa tjetër e popullsisë. Kështu p.sh. kushtetutat greke të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore, duke u mbështetur në doktrinën politike të liberalizmit civil nuk i

¹³ Gaetano Pentassuglia, *Minorities in International Law*, Council of Europe Publishing, 2002, f. 57; N. Girasoli, *National minorities...*, f. 93; V. Ortakovski, *Minority in the Balkan ...*, f. 12.

¹⁴ G. Pentassuglia, *Minorities in International Law ...*, f. 58; V. Ortakovski, *Minority in the Balkan ...*, f. 12; N. Girasoli, *National minorities...*, f. 93.

¹⁵ Të gjitha përcaktimet e termit “minoritet” vënë në dukje faktin se pozita politike dhe shoqërore e minoriteteve duhet të jetë jozotëruese. Kjo kërkesë është plotësisht e justifikuar, meqë flasim për grupe njerëzish, të cilat kanë nevojë për t’u mbrojtur nga diskriminimi.

përmendin fare minoritetet, por vetëm termin “qytetarë helenë” dhe në kushtetutën e fundit është shtuar termi “emigrantët”¹⁶. Në Kushtetutën e RP Federative të Jugosllavisë pas vitit 1963, është përdorur termi “kombësi”, ashtu si në pjesën më të madhe të ish-shteteve komuniste të Evropës Lindore. Ky term, mendoj se duhet të jetë përdorur për të shmangur konotacionin jo gjithmonë pozitiv që ka koncepti “minoritet” ose “pakicë kombëtare” që përdorej më parë.

Edhe në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore nuk ka njëtrajtshmëri në terminologjinë ligjore për minoritetet. Kështu, në marrëveshjen italo-austriake të vitit 1946, për Tirolin e Jugut, është përdorur termi “banorët gjermanishtfolës”. Në vitin 1975, në marrëveshjen jugosllavo-italiane të Osimit, për minoritetin slloven, është përdorur termi “grup etnik”, ndërsa për italianët në Jugosllavi është përdorur termi “minoritet”¹⁷. Kushtetuta italiane përmend “minoritetet gjuhësore”, ndërkohë që kushtetuta belge flet për tri “komunitete kulturore”.

Arsyet që studiues të shkencave politike dhe juridike, ende nuk kanë mundur të japin një përcaktim të plotë dhe të aplikueshëm se çfarë do të kuptojmë me minoritet, janë edhe praktike. Në Evropë dhe në Botë jetojnë një shumëllojshmëri grupesh minoritare. Ka grupe që janë vendosur në një territor të mirëpërcaktuar, por ka dhe grupe që janë shpërndarë përgjatë territorit shtetëror apo ndërmjet disa shteteve, ashtu siç ka dhe grupe që vazhdojnë të jenë nomade¹⁸. Gjithashtu, ka vështirësi në identifikimin e elementeve të përbashkëta, të cilat bëjnë të mundur kapërcimin e pluralizmit që ekziston midis grupeve të mëdha brenda një vendi, dhe krijojnë idenë që ekzistenca e një grupi minoritar, por dhe koherenca e brendshme e tij, është një çështje faktike¹⁹.

E vështirë është të kapërcehet edhe debati se cilit prej kriterëve: objektive apo subjektive, i duhet dhënë më shumë rëndësi në përcaktimin e termit²⁰. Shumica e përcaktimeve të deritanishme i mësojnë kriterëve objektive, por nuk kanë lënë

¹⁶ “Constitution of Greece 1998”. Internet, 1. 06. 2008. adresa:

<http://www.cecl.gr/rigasnetwork/databank/constitutions/Greece.html>

¹⁷ V. Ortakovski, *Minority in the Balkan ...*, f. 8-9.

¹⁸ N. Girasoli, *National Minorities ...*, f. 87.

¹⁹ G. Pentassuglia, *Minorities in International Law ...*, f. 55.

²⁰ Studiues të së drejtës ndërkombëtare kanë dhënë përcaktimet e tyre për termin “minoritet”. Claude dha një përcaktim të mbështetur tërësisht në kriterë subjektive vlerësimi, si: bindja dhe ndjenja. “Një grup minoritar – shkruan ai, - ekziston kur një grup njerëzish, brenda një shteti, shfaq bindjen që formon një komb ose pjesë të një kombi, i cili është i dallueshëm nga trupi kombëtar (national body), të cilit i përket pjesa më e madhe e popullsisë ose kur elementët e shumicës së popullsisë, ndiejnë që zotërojnë një karakter kombëtar, të cilin grupet minoritare nuk duan apo nuk mundën ta bëjnë të tyre”. Përkundrazi, Laponce u përpoq t’i kombinonte kriteret objektive, si: tiparet e përbashkëta gjuhësore, kulturore, racore etj. me ato subjektive. Për Laponce-n minoriteti përbënte: “një grup njerëzish, i cili, për shkak të trashëgimisë së përbashkët racore, gjuhësore apo kombëtare, diferencohen nga grupet zotëruese kulturalisht dhe politikisht [dhe] kanë frikë se ato mund të mos lejohen të integrohen në komunitetin kombëtar sipas zgjedhjes së tyre ose të detyrohen ta bëjnë këtë në dëm të identitetit të tyre”.

pa evidentuar dhe ato subjektive, pavarësisht se këto të fundit paraqesin vështirësi në vlerësim.

Edhe organizmat e ndryshëm ndërkombëtarë, që nga Lidhja e Kombeve e deri te këta më të vonët, kanë qenë të dëshiruar për të dhënë një përcaktim të termit “minoritet”. Një përcaktim i tillë nga pikëpamja juridike do t’u mundësonte këtyre organizmave të identifikonin më mirë grupet minoritare brenda shteteve, në mënyrë që, nga njëra anë, aktet ndërkombëtare të miratuara për mbrojtjen e minoriteteve, të kishin më shumë fuqi detyruese për shtetet dhe, nga ana tjetër, mundësi më të mira kontrolli.

Në vitin 1930, Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Hagës, në opinionin e saj këshillimor në lidhje me interpretimin e Konventës greko-bullgare për të respektuar emigracionin reciprok (komunitetin greko-bullgar), jep këtë përcaktim për termin “minoritet”: “grupe njerëzish, që jetojnë në një vend të dhënë ose lokalitet, që kanë një racë, një besim, një gjuhë dhe tradita me një ndjenjë solidariteti, të fokusuar për t’i ruajtur traditat, të mbajnë praktikatat fetare, të sigurojnë arsimimin dhe të rritin fëmijët e tyre në përputhje me shpirtin e traditave të racës së tyre dhe të ndihmojnë në mënyrë reciproke njëri-tjetrin”²¹.

Në vitin 1950, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, bëri një propozim për përkufizimin e termit “minoritet”. Në këtë propozim, një nga kriteret për t’u konsideruar minoritet ishte: “kërkesa për të ruajtur identitetin e tyre kulturor dhe besnikëria e tij ndaj shtetit”. Sipas tij, ky term duhej të përfshinte “grupe jozotëruese të një popullsie, që zotërojnë dhe dëshirojnë të ruajnë tradita apo karakteristika të qëndrueshme etnike, fetare dhe gjuhësore dukshëm të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë”. Ky propozim theksin e vë në disa tipare kryesore të minoriteteve: grupe jozotëruese, specifika të dallueshme, dëshira për t’i ruajtur këto specifika, të qenit shtetas të një shteti dhe besnikëria ndaj tij.

Pas Konferencës së Helsinkit (1975), çështja e mbrojtjes ligjore të minoriteteve filloi gjithnjë e më shumë të kishte përparësi në legjislacionin ndërkombëtar. Gjatë viteve ’80 dhe në vazhdim një sërë normash për mbrojtjen e minoriteteve janë ndërmarrë nga forume të ndryshme ndërkombëtare, si: OKB-ja, Këshilli i Evropës, Konferenca e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian (KSBE, sot OSBE). Pavarësisht nga kjo, ende nuk është arritur një përkufizim për termin “minoritet”, gjë që i bën aktet ligjore, të vështira për t’u zbatuar në terren.

Minoritetet në Shqipëri – cilat janë, ku gjenden dhe ç’numër kanë

Konferenca e Londrës e vitit 1913, e cila njohu pavarësinë e Shqipërisë, të shpallur më 28 nëntor 1912, nuk zbatoi parimin etnik në përcaktimin e kufijve të shtetit të ri. Kufijtë e shtetit të ri përfshinë vetëm gjysmën e territorit të banuar nga shqiptarë, me një sipërfaqe prej afërsisht 28 000 km² dhe një popullsi prej 800 000 vetash²². Shkëputja e Kosovës dhe e Çamërisë ishte një humbje e madhe për

²¹ G. Pentassuglia, *Minorities in International Law* ..., f. 32.

²² *Historia e Popullit Shqiptar: Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939*, Vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë,

shqiptarët, pasi pothuajse gjysma e kombit shqiptar mbeti jashtë kufijve shtetërorë. Por, ashtu siç ka ndodhur shpesh në Ballkan, për shkak të lëvizjeve të popullsisë, edhe Shqipëria e cunguar nuk arriti të ishte tërësisht homogjene nga pikëpamja etnike. Pas Luftës së Parë Botërore, shtetit shqiptar iu bashkua dhe minoriteti bullgar/maqedonas e malazez. Të gjitha këto minoritete tashmë janë bërë pjesë integrale e shtetit shqiptar dhe e historisë së tij.

Minoriteti grek. Vazhdimisht ka ekzistuar një debat i fortë midis studiuesve grekë dhe shqiptarë mbi origjinën dhe numrin e minoritetit grek. Debati buron nga kuptimi i ndryshëm i përcaktimit të minoritetit grek. Për historiografinë greke, minoriteti grek duhet të përcaktohet jo nga karakteristikat objektive, si gjuha, zakonet etj., por nga ato subjektive, siç është ndërgjegjja kombëtare. Pas krijimit të shtetit grek, duke shfrytëzuar sistemin e mileteve të Perandorisë Osmane, i cili e ndante popullsinë sipas besimit dhe jo sipas përkatësisë etnike, qeveria greke deklaroi se popullsia e krishterë e besimit ortodoks, që jetonte në territoret jugore shqiptare, ishte greke në ndërgjegjen e saj. Ajo, sipas studiuesve e diplomatëve grekë, jetonte në rajonin e quajtur Vorio-Epir (Epiri i Veriut), i cili shtrihet nga pjesa juglindore e Manastirit deri në malet Akrokeraune²³. Ka dhe qarqe të caktuara politike dhe akademike nacionaliste, të cilat e shtynë territorin e banuar nga grekët deri në lumin Shkumbin. Pjesa më e madhe e studiuesve grekë i referohet regjistrimit osman të vitit 1908, sipas të cilit në kazatë e Gjirokastrës, Delvinës, Himarës, Kolonjës, Korçës, Përmetit (pjesërisht), Tepelenës (pjesërisht), Leskovikut (pjesërisht), Starovës (pjesërisht), të cilat, sipas tyre, përfshihen në rajonin e “Vorio-Epirit”, banonin 107 380 grekë ose 51% e popullsisë dhe 103 013 myslimanë ose 49% e popullsisë. Gjithashtu kishte dhe 2 500 vllahë që jetonin në rajonin e Korçës²⁴. Në vitin 1912, sipas shifrave të dhëna nga grekët, popullsia e “Vorio-Epirit”, përbëhej nga 80 000 shqiptarë dhe 120 000 grekë²⁵. Edhe më pas, studiues e politikanë grekë kanë vazhduar të pretendojnë se në këtë rajon, sipas tyre, jeton një popullsi me identitet të qartë helen numri i së cilës ndryshon nga 150 000 - 200000 veta, për studiuesit më të moderuarit, deri tek 350 000 veta për ata nacionalistë²⁶.

Tiranë: “Toena”, 2007, f. 30; si dhe Arben Puto, *Shqipëria Politike (1912-1939)*, Tiranë: “Toena”, 2009, f. 81.

²³ Basil Kondis, *Greqia dhe Shqipëria gjatë shek. XX*, Selanik: Paratiritis 1997, f. 198. Këtë rajon ka kërkuar qeveria greke si në Konferencën e Londrës (1913), në atë të Parisit (1919), në memorandumet e shumta gjatë Luftës së Dytë Botërore, në Konferencën e Paqes në Paris (1946) dhe, mesa duket, nuk ka hequr ende dorë nga një pretendim i tillë.

²⁴ Për më tepër mbi numrin e popullsisë së çdo kazaje shih: *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme* (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1946, Dosja (më tej: D.) 128/1, fleta (më tej: fl.) 34, të dhëna statistikore të paraqitura në memorandumin grek për kufijtë e Epirit, të paraqitura në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës, (janar 1913); si dhe N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference 1919*, Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1978, f. 346.

²⁵ N. Petsalis-Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference 1919*, ..., f. 124.

²⁶ AMPJ, V. 1945, D. 59/8, fl. 144, Pjesë artikulli me titull “Pa humbur kohë”, marrë nga gazeta “Vorio-Epirus”, Janinë, 17 qershor 1945.

Studiuesit shqiptarë i kanë hedhur poshtë këto pikëpamje të historiografisë greke. Ata u referohen autorëve antikë, si Tuqididi, Herodoti, Straboni e Plutarku, në shkrimet e të cilëve theksohet qartë se në këto territore ka jetuar një popullsi, të cilën grekët e konsideronin barbare, pra, jo greke. Rezultatet e gërmimeve arkeologjike në territorin e kësaj krahine provojnë ekzistencën e pandërprerë të kulturës ilire në këtë krahinë²⁷. Sipas defterëve osmanë të shek. XVI, të botuar nga prof. Ferit Duka, “krahina me emrin gjeografik “Dropull” ishte ndarë asokohe prej pushtetit osman në dy njësi administrative: në nahijen e Dropullit dhe atë të vllahëve²⁸, që të dyja të varura nga një qendër e vetme: kazaja e Gjirokastrës²⁹. Sipas dokumenteve osmane të botuara nga ky studiues dhe nga analiza e bërë prej tij për antroponiminë e Dropullit, ai arrin në përfundimin se popullsia e kësaj krahine në fillim të shek. XVI banohej nga popullsi shqiptare dhe vllahë³⁰. Sipas disa studiuesve të tjerë shqiptarë, grekët që banojnë sot në Shqipërinë e Jugut kanë emigruar rreth tre shekuj më parë për arsye ekonomike, për të punuar si bujq në tokat e fisnikëve shqiptarë³¹.

Studiuesit shqiptarë në përcaktimin e kombësisë së Shqipërisë së Jugut bazohen në kritere objektive dhe qartësisht të verifikueshme, më të rëndësishmet prej të cilave janë gjuha dhe prejardhja. Mit’hat Frashëri në studimin e tij “Popullsia e Epirit”, jep këtë shpjegim për regjistrimin osman të vitit 190, aq të referuar nga studiuesit grekë: “Nga 201 876 banorë që përfshihen në tetë kazatë [të Gjirokastrës, Delvinës, Himarës, Kolonjës, Korçës, Përmetit (pjesërisht), Tepelenës (pjesërisht), Leskovikut (pjesërisht), Starovës (pjesërisht)], vetëm 29 274 janë grekofonë, ... të tjerët janë shqiptarë qoftë të besimit mysliman, qoftë të besimit të krishterë”³².

Këtë përbërje etnike të Shqipërisë së Jugut e pranonin shumë nga konsujt e Fuqive të Mëdha të vendosur në Shqipëri gjatë viteve 1912-1914. Ata bënë diferencën ndërmjet ortodoksëve të Shqipërisë së Jugut, të cilët ishin shqiptarë dhe

²⁷ Ferit Duka, “Realiteti etnik i Dropullit në burimet historike të shek. XVI (defteri osman i regjistrimit të pronave dhe të popullsisë të sanxhakut të Vlorës i vitit 1520)”, në *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1991, f. 167. Autori u referohet studimeve të Frano Prendit dhe Dhimitër Budinës.

²⁸ Duhet vënë në dukje se termi vllah nuk përcakton domosdoshmërisht karakterin etnik të kësaj popullsie. Në Perandorinë Osmane termi vllah përdorej gjerësisht për identifikimin social të popullsisë nomade baritore.

²⁹ F. Duka, “Realiteti etnik i Dropullit ...”, f. 168-169. Për më tepër gjithashtu shih: “Defteri i hollësishëm i Sanxhakut të Vlorës i vitit 1519-1520”, dokumente të botuara nga Ferit Duka, në *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1991, f. 171-199.

³⁰ Po aty.

³¹ Peter R. Prifti, *The Land of Albanians, a Crossroad of Pain and Pride*, Tiranë: “Horizont”, 2002, f. 174, si dhe Sami Repishti “Populli shqiptar në Jugosllavi dhe minoriteti grek në Shqipëri”, në *Studime Historike*, nr. 1-2, Tiranë: 1992, f. 120. Autori argumenton se paraardhësit e grekëve që banojnë sot në Shqipërinë e Jugut, janë vendosur aty në dy dekadat e para të shek. XIX.

³² Mit’hat Frashëri, *Popullsia e Epirit*, Sofie: Shtypshkronja e Pavarësisë së Shqipërisë, 1915, f. 24.

popullsisë greqishtfolëse të këtij rajon, e cila përbënte një pakicë. Këtë e vërtetojnë dhe regjistrimet e popullsisë të bëra gjatë viteve 1923, 1930, 1945 në Shqipëri. Sipas rezultateve të këtyre regjistrimeve del se në vitin 1923 në Shqipërinë e Jugut jetonin 33 791 persona, që deklarorin se ishin me kombësi greke, në vitin 1930 kishte 40 846 grekë. Në vitin 1945, numri i personave që deklaroheshin me kombësi greke në të gjithë Shqipërinë ishte 36 338, nga të cilët 31 560 vetë jetonin në Prefek- turën e Gjirokastrës³³.

Për regjistrimin e vitit 1945 në krahinat greqishtfolëse u përdorën nëpunës minoritarë që e njihnin gjuhën shqipe³⁴. Raporti që shoqëron këtë regjistrim e shpjegon kështu rënien e popullsisë minoritare nga regjistrimi i vitit 1930 me atë të 1945. Së pari, ai vë në dukje se ka një rënie të popullsisë së Shqipërisë së Jugut në përgjithësi për shkak të luftës³⁵. Në regjistrim nuk u morën parasysh shtetasit e mërguar dhe, sipas raportit shoqërues, popullsia ortodokse përbënte pjesën më të madhe të shtetasve të mërguar³⁶.

Sipas këtyre regjistrimeve minoriteti grek banonte në mënyrë të përqendruar në 84 fshatra të prefekturës së Gjirokastrës, në nënprefekturat e Qendrës (Gjirokastrë), Delvinës, Konispolit, Libohovës, Sarandës dhe një pakicë shumë e vogël në nënprefekturën e Përmetit (330 veta sipas regjistrimit të vitit 1945)³⁷. Në prefekturën e Vlorës, sipas regjistrimit të vitit 1945, ka rezultuar se janë deklaruar me kombësi greke 4 778 veta. Të gjithë këta banonin në nënprefekturën e Himarës, por raporti nuk e specifikon se cilat fshatra të kësaj nënprefekturë janë deklaruar si të tillë³⁸. Mendoj se këtu ia vlen të ndalesh për të bërë një sqarim. Regjistrimi i popullsisë i 30 shtatorit të vitit 1945, kishte si qëllim “të vërtetonte gjendjen numerike të popullsisë të ndarë sipas gjinisë, moshës, gjendjes civile, profesionit etj.; të krijonte regjistrat themeltarë të popullsisë, të cilët ishin djegur nga lufta, si dhe të përcaktonte popullsinë faktike të ndarë sipas qarqeve”³⁹. Duke qenë se qëllimi i regjistrimit ishte krijimi i regjistrave të gjendjes civile, pra jo thjesht për efekt statistikor, popullsisë iu kërkua që të vërtetonte deklaratimet me dokumentet përkatëse. Mesa duket popullsia e disa fshatrave të Himarës, e nxitur nga propaganda e qarqeve “vorio-epirote”, ishte deklaruar greke, por pa mundur që të siguronte dokumente të besueshme që ta vërtetonin këtë gjë. Për këtë arsye, në raportin përfundimtar të këtij regjistrimi këto shifra janë fshirë nga kolonat e

³³ AMPJ, V. 1945, D. 59/6, fl. 12.

³⁴ Po aty, V. 1946, D. 128/5, fl. 1, Të dhëna statistikore të Shqipërisë së Jugut (duke u nisur nga Shkumbini), sipas kombësisë.

³⁵ Po aty, V. 1945, D. 59/6, fl. 134, Sipas të dhënave, popullsia e përgjithshme e Shqipërisë së Jugut në vitin 1930 ka qenë 291 851 veta, ndërsa në vitin 1945 ishte 272 081 veta.

³⁶ Po aty.

³⁷ Po aty, fl. 12.

³⁸ Po aty, V. 1946, D. 128/5, fl. 8, Të dhëna statistikore të prefekturës së Vlorës sipas fesë dhe kombësisë.

³⁹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 490/Këshilli i Ministrave, viti (më tej: V.) 1945, dosja (më tej: D.) 333, fl. 59, Udhëzues i Këshillit të Ministrave mbi regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë.

tabelave që tregonin popullsitë minoritare dhe i janë shtuar popullsisë shqiptare të besimit ortodoks të krahinës.

Minoriteti maqedonas. Minoriteti maqedonas në Shqipëri për nga pesha numerike zë vendin e dytë pas atij grek. Edhe mbi numrin dhe shtrirjen e minoritetit maqedonas në territorin e shtetit shqiptar ka pasur një debat midis studiuesve të ndryshëm. Në shtetin shqiptar ka pasur një dinamikë shumë interesante të numrit të popullsisë, shtrirjes, madje dhe përkatësisë etnike të minoritetit maqedonas.

Rajonet ku banonte minoriteti maqedonas iu bashkuan shtetit shqiptar pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Nëntë fshatrat e Prespës së Madhe (Cerje, Shulin, Pustec, Zaroshkë, Lajthizë, Gollomboç, Goricë e madhe, Goricë e Vogël, Bezmisht, si dhe Vërniku, (në rajonin e Devollit)⁴⁰, ishin pjesë e grupit prej 26 fshatrash të ish-kazasë së Korçës, të cilat u shqyrtuan nga Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve. Vendimi për kalimin e tyre në përbërje të shtetit shqiptar u mor në gusht 1923, por ky vendim nuk u zbatua deri më 6 tetor 1924⁴¹. Popullsia sllavishtfolëse e fshatrave të Prespës së Madhe, për shkak të konfigurimit gjeopolitik të Ballkanit në atë kohë, konsiderohej bullgare. Për këtë arsye, në vitin 1932, sipas statistikave të Ministrisë së Arsimit, kishte 6 833 persona që u konsideruan bullgarofolës. Ndërsa në regjistrimin e vitit 1945, u bë diferencimi midis popullsisë maqedonishtfolëse dhe asaj me kombësi maqedonase. Sipas këtij regjistrimi, në territorin e shtetit shqiptar kishte 2 572 persona me kombësi maqedonase, të vendosur plotësisht në prefekturën e Korçës, në zonën e Prespës së Madhe.

⁴⁰ Për më tepër për statistikën në lidhje me numrin e popullsisë, numrin e shtëpive, gjuhën që flisnin dhe besimin fetar shih: *AQSH*, F. 317/Prefektura e Korçës, V. 1924, D. 208, fl. 72-73.

⁴¹ Grupi prej 26 fshatrash në verilindje të Korçës u bë shkak për një tjetër konflikt midis Greqisë dhe Shqipërisë në periudhën pas Luftës së Parë Botërore. Komisioni i Caktimit të Kufijve që veproi në vitin 1913, nuk kishte përcaktuar qartë se kujt i përkisnin këto fshatra. Në përfundim të Luftës së Parë Botërore kjo zonë vazhdonte të mbahej arbitrarisht nga trupat greke. Komisioni Ndërkombëtar i Kufijve kërkoi që një grup ekspertësh të shprehej mbi përkatësinë e këtyre fshatrave. Në prill 1923 një komision ekspertësh, i drejtuar nga gjenerali italian Enriko Telini (Enrico Tellini), mbërriti në jug për të zgjidhur çështjen e 26 fshatrave të ish-kazasë së Korçës. Në gusht 1923 komisioni i caktoi Shqipërisë 14 prej 26 fshatrave të zonës, por qeveria greke për më shumë se një vit nuk pranoi të zbatonte vendimin e komisionit. Madje, ajo organizoi vrasjen e gjeneral Telinit dhe grupit që e shoqëronte. Pas ndërhyrjes së vazhdueshme të politikanëve shqiptarë, e veçanërisht Fan Nolit, atëherë kryeministër i vendit, çështja u shtrua në Lidhjen e Kombeve, e cila ia kaloi për shqyrtim Konferencës së Ambasadorëve. Në tetor 1924 kjo çështje, së bashku me atë të Shën Naumit, u diskutua nga Konferenca dhe u vendos përfundimisht në favor të Shqipërisë. E gjendur nën presionin ndërkombëtar, qeveria greke pranoi që t'i largonte trupat ushtarake nga këto fshatra, të cilat u vendosën nën administrimin e shtetit shqiptar. Për më tepër në lidhje me çështjen e 26 fshatrave të kazasë së Korçës shih: A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 303-304; si dhe *Historia e Popullit Shqiptar ...*, Vëll.III, f. 207.

Gjithashtu, i njëjti regjistrim popullsie, tregoi se kishte 6 489 persona që kishin deklaruar maqedonishten si gjuhë amtare⁴².

Ashtu siç ka ndodhur shpesh në Ballkan, ku ngatërrohen territore, popullsi dhe identitete, edhe për minoritetin maqedonas në Shqipëri ka pasur një sërë debatesh. Debati më i nxehtë lidhet me përkatësinë etnike të minoritetit maqedonas në Shqipëri: është etnikisht bullgare apo maqedonase. Ndonëse ky debat u takon studiuesve bullgarë dhe maqedonas dhe lidhet me dilemën nëse ekziston kombi maqedonas apo jo, ai prek në të njëjtën kohë dhe minoritetin sllavishtfolës në Shqipëri⁴³. Debati, gjithashtu ka përfshirë dhe një popullsi dygjuhëshe në Shqipërinë Verilindore. Është fjala për popullsinë që jeton në krahinën e Gollobordës. Kjo krahinë nga pikëpamja gjeografike është ndarë në tri krahina dhe më vonë administrativisht në nënprefekturat: Trebishtë, Ostren dhe Steblevë. Pjesa më e madhe e banorëve të Gollobordës, rreth 60%, ishin të besimit mysliman.

⁴² A. Bërçoli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 105.

⁴³ Debati për ekzistencën e kombit maqedonas ka një histori të gjatë. Ai ka filluar menjëherë pas Krizës Lindore 1875-1878 dhe ka përfshirë tri shtete: Bullgarinë, Greqinë dhe Serbinë. Traktati i Shën Stefanit (1878) krijoi Bullgarinë e Madhe duke i akorduar Bullgarisë pjesën më të madhe të territoreve të banuara nga maqedonas dhe shqiptarë. Kongresi i Berlinit (1878) nuk e njohu të drejtën e Bullgarisë mbi territorin ku jetonin maqedonasit.

Politikanët dhe studiuesit bullgarë nuk e pranojnë ekzistencën e një kombi të veçantë maqedonas. Sipas tyre, duke qenë se bullgarët dhe maqedonasit kanë gjuhë, fe dhe histori të përafërt ata përbëjnë një komb. Por, sipas Prof. Viktor Fridman-it, ishte pikërisht diferencimi në gjuhë që zgjoi te popullsia maqedonase ndërgegjen se zotëronte një identitet të ndryshëm kombëtar. Deri nga mesi i shek. XIX, maqedonasit identifikoheshin me bullgarët, si pjesë e të njëjtit komb. Ndryshimi filloi me caktimin e gjuhës standarde në Serbi dhe Bullgari. Ndryshimi midis dialekteve të përdorura në tekstet shkollore në Bullgari dhe Serbi, me ato të përdorura në Maqedoni i bëri disa intelektualë maqedonas të kuptonin ndryshimin mes tyre dhe serbëve, bullgarëve dhe grekëve. Kjo shënoi, sipas prof. Fridman-it, lindjen e konceptit të maqedonishtes “si kundërshtuese të bullgarishtes, serbishtes dhe greqishtes. Për më tepër në lidhje me këtë shih: Victor Friedman, “Languages and Ethnicity in Balkan Politics: Macedonian, Bulgarian and Albanian” in: *EES seminar entitled "Languages and Ethnicity in the Balkans"* on April 11, 2000.

http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?topic_id=1422&fuseaction=topics.publications&doc_id=17939&group_id=7427). Ishte pikërisht në këtë kohë që popullsia që jetonte në territoret maqedonase të Vardarit filloi të organizonte lëvizjen kombëtare antiosmane. Gjatë kësaj lëvizjeje vetë maqedonasit ishin të ndarë në lidhje me identitetin e tyre kombëtar. Në gjirin e lëvizjes kombëtare maqedonase pati dy rryma. Njëra, që përfaqësohej nga Organizata për Çlirimin e finançohej nga Bullgaria, kërkonte bashkimin e territoreve maqedonase me shtetin bullgar. Rryma tjetër kishte parullën “Maqedoni për maqedonasit”. Mbeshtetësin e saj kërkonin një shtet të pavarur maqedonas. Kundër ekzistencës së kombit maqedonas ishte dhe Greqia, e cila pretendonte dhe, më pas arriti të aneksonte territoret sllavofolëse të Maqedonisë Perëndimore. Ajo, rrjedhimisht, nuk ka pranuar të njohë dhe minoritetin sllavofolës në Greqi si minoritet kombëtar.

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore, Traktati i Paqes i akordoi Serbisë territoret e Maqedonisë së Vardarit, duke i bërë ato pjesë të Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene (jugosllave). Gjatë kësaj kohe, maqedonasve nuk iu njoh ndonjë kombësi e veçantë.

Studiuesi Arqile Bërxioli, duke iu referuar statistikave të periudhës midis dy Luftërave, i përmend ata si një “minoritet bullgarofolës, i cili jetonte në 20 vendbanime në krahinën e Gollobordës”⁴⁴.

Për prejardhjen e kësaj popullsie nuk ka ndonjë studim të mirëfilltë dhe kjo çështje mbetet ende në kuadër të hipotezave. Një hipotezë e hedhur dhe e mbështetur nga studiues bullgarë është se popullsia sllavishtfolëse, e cila praktikonte besimin ortodoks, të ketë qenë bullgaro/maqedonase, ndërsa popullsia myslimane të jetë shqiptare e sllavizuar në kontakt me të parën⁴⁵. Në kundërshtim me hipotezat, mund të gjenden shumë dokumente në arkivat shqiptare që theksojnë identitetin shqiptar të popullsisë sllavofone të besimit mysliman të Gollobordës. Në telegramin e 21 shtatorit 1922, që Ministria e Punëve të Brendshme i dërgoi Ministrisë së Jashtme, thuhej se popullsia e Gollobordës dëshiron bashkimin me Shqipërinë “dhe këto mendime i kanë shfaqur dhe para Komisionit të Kufijve ... këto ditët e fundit”⁴⁶. Në një analizë të Ministrisë së Brendshme të vitit 1935, thuhej se “myslimanët e qarkut të Dibrës, ndonëse i deklarojnë bullgarofonë, e konsiderojnë veten shqiptarë dhe nuk duan të konsiderohen si pakicë bullgare”⁴⁷. Kjo popullsi pas Luftës së Dytë Botërore u konsiderua si shqiptare dhe, përveç trajtimit të saj si minoritare në periudhën 1945-1946, nuk është konsideruar më e tillë.

Ka dhe një debat tjetër ndërmjet studiuesve maqedonas dhe atyre bullgarë, nga njëra anë, dhe atyre shqiptarë nga ana tjetër, mbi numrin e minoritetit maqedonas në Shqipëri. Për një pjesë të studiuesve bullgarë, në Shqipëri jetojnë 30 000 bullgarë, prej të cilëve 11 000 janë të besimit të krishterë të ritit ortodoks dhe afro 19 000 vetë praktikojnë besimin mysliman⁴⁸. Pjesa tjetër, “më të moderuarit”, mendojnë se në Shqipëri jetojnë 15 000 persona që i përkasin minoritetit bullgar prej të cilëve 5 000 vetë ndjekin besimin e krishterë të ritit ortodoks dhe 10 000 praktikojnë besimin mysliman⁴⁹.

Nga ana tjetër, janë studiuesit maqedonas të cilët gjithashtu japin shifra tejet të tepruara për minoritetin maqedonas në Shqipëri. Në mendimin më të lartë akademik maqedonas, “gjithë zona kufitare shqiptaro-maqedonase (në të dyja anët e saj) nga Gora në Strugë banohet nga popullsi maqedonase, pjesa më e madhe e së cilës është islamizuar”⁵⁰. Sipas këtyre studiuesve, minoriteti maqedonas në Shqipëri

⁴⁴ A. Bërxioli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 104.

⁴⁵ *Po aty*, f. 105.

⁴⁶ *AMPJ*, V. 1922, D. 39, fl. 23.

⁴⁷ A. Bërxioli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 104.

⁴⁸ Svetlozar Eldarov, “Easter Orthodox Christians and Roman Catholics in Albania”, në *Albania and the Albanian identities*, edited by Antonina Zhelyazkova, Sofia: International Center for Minority Studies and Intercultural Relations, 2000, f. 92.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ The Presidency of Macedonian Academy of Science and Arts, “Address in the occasion of the publication of the “Platform on the Resolution of the Albanian National Question” by the Macedonian Academy of Science”, Skopje, 13th May 1999, në:

<http://www.manu.edu.mk/englverson/obrananje.nun>

kap një shifër prej 50 000 vetash, gjë, që siç u dëshmuva më lart, nuk i përgjigjet aspak përbërjes etnike faktike të shtetit shqiptar.

Minoriteti malazez. Minoriteti etnik malazez është minoriteti më i vogël në numër dhe më pak i diskutuar në studimet shqiptare. Gjithashtu është dhe minoriteti më pak i prezantuar në dokumentacionin shqiptar të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Ai jeton në tri fshatra në zonën e Vrakës: Boriç i Vogël, Omaraj dhe Gril. Në periudhën pas Luftës së Parë Botërore, një numër i kufizuar serb-malazezësh ka jetuar dhe në qytetin e Shkodrës, të cilët, sipas dokumentacionit të kohës, ishin shtetas jugosllavë, pra mund të konsiderohen emigrantë dhe jo minoritet⁵¹. Pjesëtarët e këtij minoriteti kanë ardhur në rajonin e Shkodrës aty nga mesi i shek. XIX si refugjatë politikë⁵².

Në punën përgatitore për raportin që shteti shqiptar duhet të paraqiste për Lidhjen e Kombeve në vitin 1922 rezultoi kjo gjendje e minoritetit malazez në Shqipëri: Shkodra 82 familje me 352 frymë “të ardhë prej Malit të Zi”; katundi Kamibë 14 familje me 89 frymë; katundi Vrakë 117 familje me 897 frymë, katundi Dragjat 10 familje me 71 frymë⁵³. Në vitin 1922, një dokument i Ministrisë së Arsimit, jep këto informacione mbi numrin e popullsisë malazeze në Shqipëri: katundi Vrakë ka 151 shtëpi me 1 855 vetë “që flasin ndër familjet e tyre sllavisht, por dinë dhe shqip”⁵⁴.

Në periudhën midis dy Luftërave Botërore, numri i popullsisë malazeze i regjistruar në dokumentacionin shqiptar varion nga 1037 persona në vitin 1926 në 1550 persona në vitet 1935-1936⁵⁵. Sipas regjistrimit të vitit 1945, në Shqipëri jetonin 998 persona me kombësi malazeze dhe 1695 persona në krahinën e Vrakës me gjuhë amtare serbo-kroate⁵⁶.

Luftës së shifrave nuk i ka shpëtuar as minoriteti malazez në Shqipëri. Studiuesi serb Spiridon Gopçeviç shton në mënyrë fantastike numrin e minoriteteve sllave në Shqipëri duke deklaruar se në vend jetojnë 63 300 serbë⁵⁷. Përveç numrit tejet të ekzagjuar, studiuesi serb kërkon në Shqipëri një minoritetet që nuk ekziston. Popullsia sllave që jeton në zonën e Vrakës, ashtu siç u fol më sipër, dokumentohet si e ardhur nga Mali i Zi. Ajo, për më tepër, vazhdimisht e ka identifikuar veten si malazeze.

Minoritetet në dy dekadat e para të shtetit të pavarur shqiptar

Shqipëria fitoi pavarësinë në një kohë kur fqinjët e saj ballkanikë, jo vetëm kishin krijuar shtete të pavarura, por dhe kishin përpiluar platformat e tyre

⁵¹ AMPJ, V. 1922, D. 164, fl. 13.

⁵² A. Bërxioli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 107.

⁵³ AMPJ, V. 1922, D. 101, fl. 17.

⁵⁴ *Po aty*, V. 1922, D. 164, fl. 13.

⁵⁵ A. Bërxioli, *Minoritetet në Shqipëri ...*, f. 107.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ S. Eldarov, “Easter Orthodox Christians ...”, f. 92.

nacionaliste, të cilat nëpërkëmbnin interesat kombëtarë të shqiptarëve. Kjo e vuri nacionalizmin shqiptar në pozita mbrojtëse. Shteti shqiptar, që në krijimin e tij, duke qenë i dobët ekonomikisht dhe politikisht, u përpoq të shmangte mosmarrëveshjet dhe konfliktet e brendshme etnike. Politikanët shqiptarë u përpoqën t'u garantonin minoriteteve të drejtat e pranuar ndërkombëtarisht, me shpresë se vetëm kështu do të pengonin shtetet e tyre amë të destabilizonin vendin.

Kështu, pas shpalljes së Shqipërisë si “principatë autonome e pavarur, e trashëgueshme dhe neutrale, nën garancinë e Fuqive të Mëdha”⁵⁸ nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (29 korrik 1913) dhe vendosjes së vendit nën kontrollin e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, u hartua dhe u miratua Statuti Organik i Shqipërisë. Minoritetet nuk përmendeshin në mënyrë specifike në të. Statuti njihete si gjuhë zyrtare gjuhën shqipe, por lejonte përdorimin dhe të gjuhëve të tjera që fliteshin në vend⁵⁹, duke i dhënë kështu *de facto* të drejtën edhe minoritetit grek, i cili ishte i vetmi që kishte kaluar në përbërje të territorit shqiptar, të përdorte lirshëm gjuhën e tij për arsimim, në administratë dhe në jetën e përditshme. Statuti njihete gjithashtu dhe regjimin e “kapitulacioneve”⁶⁰, i cili ishte një reminishencë e sundimit osman në Shqipëri që dëmtonte sovranitetin e shtetit shqiptar.

Qeveria e Turhan pashë Përmetit, e krijuar pas ardhjes së princ Vedit, kishte si qëllim dhe detyrë kryesore të shtrinte juridiksionin e saj në të gjitha territoret që i ishin njohur shtetit shqiptar nga Konferenca e Londrës. Ndër vështirësitë e shumta që qeverisë iu desh të përballonte, ishte ndërhyrja e fqinjës së saj jugore, Greqisë. Qeveria greke organizoi në krahinat jugore të vendit të ashtuquajturën “Lëvizje të autonomisë vorio-epirote”. Si rezultat i kësaj ndërhyrjeje, më 2 mars 1914, “Asambleja Panepirote”, shpalli Republikën Autonome të Vorio-Epirit, të kryesuar nga ish-ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Jorgo Zografos, nga Qestorati i Gjirokastrës. Sipas propagandës greke, kjo qeveri ishte krijuar në përputhje me dëshirat e popullit të krahinave jugore të shtetit shqiptar, që, sipas tij, “ishin krejtësisht greke nga ndjenjat”⁶¹. Në të njëjtën kohë, Spiro Spiromilo, një major i ushtrisë greke nga Himara, shpalli autonominë e 7 fshatrave të Himarës. Krijimi i Republikës “vorio-epirote” u shoqërua me një fushatë dhune dhe presioni të andartëve grekë ndaj popullsisë shqiptare, veçanërisht asaj të besimit mysliman në përpjekje “për ta spastruar” këtë zonë nga shqiptarët.

Përpjekjet e princ Vedit dhe administratës shqiptare për ta përfshirë rajonin e kontrolluar nga “vorio-epirotët” në përbërje të shtetit shqiptar përfunduan me nënshkrimin e Protokollit të Korfuzit, më 17 maj 1914. Ndër të tjera, protokollit parashikonte që dy prefekturat jugore të Shqipërisë (e Korçës dhe e Gjirokastrës) do të kishin një administratë gjysmë-autonome, e cila do të organizohej nga KNK-

⁵⁸ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 61.

⁵⁹ *Po aty*, f. 128.

⁶⁰ Regjimi i kapitulacioneve ishte trashëguar nga Perandoria Osmane. Ai u jepte të drejtën shteteve, si Austro-Hungaria dhe Italia, të luanin rolin e mbrojtësve të besimtarëve katolikë në Perandorinë Osmane. Ky regjim ishte pranuar edhe në Statutin Organik të Principatës Shqiptare të drejtuar nga princ Vidi.

⁶¹ Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Tiranë: SHBLU, 2007, f. 64.

ja. Institucionet fetare do të gëzonin statusin e personit juridik. Gjuha shqipe dhe greke do të ishin të barasvlershme në administratë. Shkollimi i ortodoksëve do të bëhej në gjuhën greke, ndërsa gjuha shqipe do të mësohej në tri vitet e para të filllores⁶². Protokollin e Korfuzit, sipas studiuesit shqiptar prof. Arben Puto, i cili ka bërë një analizë të hollësishme të këtij protokollin, vendosi një shkëputje të mbuluar keq të Shqipërisë së Jugut⁶³. Një masë ekstreme e parashikuar në të ishte imponimi i mësimin të greqishtes popullsisë shqiptare të besimit ortodoks në krahinat e Jugut, pra helenizimi i saj. Shpallja e autonomisë së krahinave të Shqipërisë së Jugut, rebelimi i popullsisë së Shqipërisë së Mesme, e cila kërkonte një princ mysliman, shkolla turke dhe gjuhën turke në administratë, krijuan një situatë të nderë dhe ndikuan negativisht në procesin e shtetformimit në Shqipëri.

Lufta e Parë Botërore zbehu edhe ato suksese të brishta që kishte arritur shteti shqiptar. Gjatë zhvillimit të saj, territori shqiptar u nda midis ushtrive austro-hungareze, franceze, italiane dhe greke. Fuqitë e Mëdha, anëtare të Antantës dhe pjesëmarrëse në Traktatin e Fshehtë të Londrës (1915), e konsideronin njohjen e pavarësisë së Shqipërisë nga Konferenca e Londrës (korrik 1913), si të parakohshme. Më 18 shkurt 1918, ministri i Jashtëm britanik Balfur (Arthur James Balfour) deklaroi se “sistemimet e bëra më 1913, në të cilat Shqipëria nuk ishte palë nënshkruese, kanë pushuar së ekzistuari si akt detyrues, për sa kohë që palët nënshkruese janë të angazhuara në luftë. Për sa i takon së ardhmes, për sa të jetë e mundur, Qeveria e Madhërisë së Tij [Mbretit të Britanisë së Madhe] do të jetë e lumtur të shikojë që parimet e kombësive dhe çështje të tjera të vështira të zgjidhen nga Konferenca e Paqes”⁶⁴. Kjo do të thoshte që Shqipëria do të paguante haraçin e radhës ndaj Fuqive të Mëdha që e kishin prishur ekuilibrin që garantonte “Koncerti Evropian” dhe kishin hyrë në Luftën e Parë Botërore, duke u bërë jo garante të pavarësisë dhe asnjësisë së Shqipërisë, por shkelëse të saj. Kështu, në Konferencën e Paqes, Shqipëria duhej të rikonfirmonte statusin ndërkombëtar (pavarësinë dhe njohjen e qeverisë) dhe kufijtë e saj⁶⁵.

⁶² *Po aty*, f. 67.

⁶³ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 136.

⁶⁴ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe Çështja Shqiptare pas Luftës së Parë Botërore (1 nëntor 1918 – 9 nëntor 1921) – statusi, kufijtë dhe rindërtimi shtetëror*, Shkodër: “Camaj-Pipa”, 2007, f. 16.

⁶⁵ Në tetor 1918, në bazë të vendimeve të marra nga Këshilli Suprem Aleat, i gjithë territori shqiptar, me përjashtim të Shkodrës, do të pushtohej nga ushtria italiane, ndërkohë ushtria franceze kishte trupat e saj në Korçë dhe në qytetin e Shkodrës, i cili u vendos në kontrollin italo-franko-anglez. Trupave greke dhe serbe iu kërkua të tërhiqeshin nga territori shqiptar i 1913. Ata, duke shpresuar të vinin në zbatim ndarjen e Shqipërisë sipas Traktatit të Fshehtë të Londrës të vitit 1915, mbajtën të pushtuar një pjesë të tij. Italia, nga ana e saj, kërkonte të vendoste mandatin e saj në të gjithë territorin shqiptar. Ajo nxiti krijimin e një qeverie shqiptare. Mesa duket qeveria italiane arriti të vendoste kontakte me Konventën Shqiptare të Zvicrës, madje t’i bindte ata që të dërgonin një memorandum në kancelaritë e fuqive kryesore të Antantës, ku të kërkonin vënien e Shqipërisë nën protektoratin italian.

Më 25 dhjetor 1918, një Asamble e Përgjithshme Kombëtare, e mbështetur edhe nga Italia, krijoi në Durrës një qeveri të përkohshme nën drejtimin e Turhan pashë Përmetit, ish kryeministrit të qeverisë gjatë mbretërimit të princit Vilhelm Vid. Në programin e saj qeverisë, qeveria e Turhan Pashës kishte dy synime kryesore: të vendoste rendin e të ngrinte administratën shqiptare; të mbronte pavarësinë dhe tërësinë territoriale të shtetit shqiptar, si dhe të drejtat sovraane të popullit shqiptar në kufijtë etnikë. Ndër masat e para që mori qeveria shqiptare, krahas atyre për ngritjen e një milicie, për rregullimin e problemit monetar etj., ishte dhe sigurimi i të drejtave të minoriteteve, në mënyrë të pajtueshme me të drejtat e sovranitetit të shtetit shqiptar⁶⁶. Kjo do të thoshte që shteti shqiptar, pa cenuar pavarësinë, integritetin dhe sovranitetin e tij, do të merrte të gjitha masat t'u garantonte minoriteteve të drejtat e tyre. Qeveria e Durrësit nuk u njoh prej asnjë nga Fuqitë e Mëdha, të cilat mendonin se për çështjen e statusit të Shqipërisë do të vendoste Konferenca e Paqes.

Në Konferencën e Paqes, të mbledhur në Sallën e Pasqyrave në Versajë, pozita ndërkombëtare e shtetit shqiptar ishte tejte e vështirë. Në punimet paraprake për Konferencën e Paqes, Shqipëria nuk u konsiderua si shtet i pavarur. Traktati i Londrës i vitit 1913, i cili kishte njohur pavarësinë e Shqipërisë, u konsiderua i pavlefshëm nga pikëpamja juridike, “*për shkak të ndryshimit thelbësor të rrethanave*”⁶⁷.

Në kushtet kur shteti shqiptar rrezikonte të humbte gjithçka⁶⁸, të flisje për minoritetet në Shqipëri, dukej si diçka absurde. Por, siç do ta shohim më poshtë, gjatë zhvillimit të Konferencës, delegacioni zyrtar shqiptar që përfaqësonte

⁶⁶ R. Gurakuqi, *Shqipëria dhe Çështja Shqiptare ...*, f. 29

⁶⁷ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 218

⁶⁸ Shtetit shqiptar i mungonte në përfundim të Luftës së Parë Botërore mbështetja ndërkombëtare. Anglia dhe Franca ishin deklaruar se nuk kishin interesa në territorin shqiptar dhe do të ishin të kënaqura ta linin Shqipërinë në kujdesin italian (në formë mandati apo protektorati). SHBA-ja, në udhëzimet që përgatiti për delegacionin e saj për në Konferencën e Paqes në Paris shprehej se “*një Shqipëri e pavarur është një entitet politik pothuajse i padëshirueshëm*”. Italia ishte fuqia më e interesuar për Shqipërinë. Ajo kërkonte sovranitet të plotë të Vlorës dhe hinterlandit të saj, si dhe mandatin për pjesën tjetër të Shqipërisë të krijuar nga Konferenca e Londrës në vitin 1913. Në një takim të zhvilluar mes kryeministrit italian, Orlando (Vittorio Emanuele Orlando), kolonelit Hauz (Edward Manda House), anëtar i delegacionit amerikan në Konferencë dhe ministrit të Jashtëm britanik, Lloid Xhorxh (David Lloyd George), në rezidencën e këtij të fundit, Italia kërkoi të kishte mandatin mbi Shqipërinë, e cila në Veri do të shtrihej në kufijtë e 1913 dhe në Jug në kufijtë që do të vendoste Konferenca. Madje, qeveria italiane në fillimet e Konferencës pati dhe simpatinë e Fuqive të Mëdha, duke përfshirë dhe SHBA-në, për këtë kërkesë të saj. Greqia ishte shteti që, pas Italisë, rrezikonte më shumë pavarësinë dhe integritetin territorial të vendit. Që në punimet paraprake të Konferencës ajo kishte bërë presion për të kënaqur pretendimet e saj në Shqipërinë e Jugut. Duke përfituar nga mungesa e interesit dhe informacionit të SHBA-së mbi Shqipërinë dhe mbështetjen që po i jepnin Anglia dhe Franca si nënshkruese të Traktatit të Fshehtë të Londrës, delegacioni grek i kryesuar nga kryeministri Elefteros Venizellos, arriti të ketë simpatinë e të Mëdhenjve mbi pretendimet greke.

qeverinë e Durrësit, disa herë u ndodh përballë situatave, në të cilat duhet të merrte angazhime ndaj minoriteteve.

Kështu, në përballjen greko-shqiptare gjatë Konferencës së Paqes në Paris, minoriteti u shndërrua në kryefjalën e ditës. Memorandumi grek mbi pretendimet ndaj shteteve fqinje iu paraqit Konferencës që në janar 1919, ndërsa pretendimet greke u dëgjuan në seancën e 3 shkurtit 1919. Në parashtresën e tij para Këshillit të të Dhjetëve, kryeministri grek, Elefteros Venizellosi, kërkoi të zhvillonte bisedime me Italinë, në mënyrë që të gjenin një marrëveshje për pretendimet greke në Shqipërinë e Jugut, apo, siç i referohej ai, Epirin e Veriut⁶⁹. Pretendimet greke në Shqipërinë e Jugut, sipas kryeministrit grek, bazoheshin në kritere etnike. Venizellosi u shpreh se “atje [në Shqipërinë e Jugut] ka 120 000 grekë dhe 80 000 shqiptarë”⁷⁰. Ai e pranoi hapur se pjesa më e madhe e këtyre “grekëve” flisnin vetëm shqip, por për qeverinë greke “as raca, as gjuha nuk mund të jenë përcaktuese të kombësisë, vetëm ndërgjegjia kombëtare mund të vendosë”⁷¹. Z. Venizellosi i mëshoi veçanërisht karakterit grek të Korçës, e cila sipas tij, kishte pasur gjithmonë shkolla greke, të cilat ndiqeshin nga 2 500 fëmijë dhe që tashmë ishin mbyllur nga qeveria shqiptare. Në parashtresën greke u përmend dhe fakti që muhamedanët dhe të krishterët e Shqipërisë së Jugut kishin tre shekuj që ishin në luftë civile me njëri-tjetrin, dhe se, gjoja, për shkak të persekutimit nga ana e muhamedanëve, shumë nga të krishterët kishin emigruar në jug, madje kishin zënë dhe poste të larta drejtuese në administratën, ushtrinë dhe flotën greke⁷². Siç mund të kuptohet, parashtresa e Venizellosit kishte gërshetuar parimin e kombësisë me gjoja shpëtimin e “minoritetit të persekutuar” nga ajo që kryeministri grek e konsideronte “një shumicë me qytetërim më të ulët”.

Delegacioni zyrtar shqiptar i kryesuar nga Turhan pashë Përmeti, në memorandumin e dorëzuar për Konferencën më 15 shkurt 1919, vinte në dukje të gjitha padrejtësitë historike që Fuqitë e Mëdha kishin kryer ndaj territorit shqiptar, duke e copëtuar atë. Ai kërkonte që të viheshin në vend këto padrejtësi, duke ia bashkuar shtetit shqiptar të gjitha territoret ku flitej shqip si në Veri, ashtu dhe në Jug. Në memorandum hidheshin poshtë me fakte dhe argumente të gjitha pretendimet e pabaza të kryeministrit grek, duke përmendur se: “Të gjitha statistikatat që kanë paraqitur grekët për të mbështetur kërkesat e tyre në Shqipëri kanë një bazë të gabuar. Në aktet e lindjes të qeverisë turke të gjithë të krishterët ortodoksë të mbretërisë ishin quajtur *rumë* (grekë). Ky gabim rridhte nga fakti që të gjithë këta të krishterë vareshin fetarisht nga Patriarkana e Stambollit. Por kjo nuk do të thoshte se të gjithë këta të krishterë ishin prej farës greke. Duke nxjerrë si

⁶⁹ Foreign Relation of United State (më tej: FRUS), The Paris Peace Conference, 1919, vol. III, f. 859, Procesverballi i mbledhjeve të Këshillit të të Dhjetëve nga 12 janari deri në 14 shkurt 1919.

⁷⁰ Po aty.

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty, f. 860.

grekë të gjithë të krishterët, pra, e vetëm kështu, qeveria helene po ia arrin të gjejë një farë shumice në disa pjesë të Shqipërisë”⁷³.

Këto argumente kryeministri shqiptar Turhan pasha, i përforcoi në parashtresën e tij, në emër të qeverisë shqiptare para Këshillit të të Dhjetëve, më 24 shkurt 1919. Ai kundërshtoi pikëpamjen greke, sipas së cilës nuk mund të lejohej që një shumicë me qytetari të lartë [të krishterët], t’i nënshtroheshin një pakice më pak të qytetëruar. Në lidhje me këtë, Turhan pasha argumentoi se “s’mund të bëhet fjalë për ndryshim qytetarie ndërmjet bijve të një fare që jetojnë bashkë pa ndryshim konditash, që flasin një gjuhë dhe pa ndryshim zakonesh. Në qoftë se shqiptarët ortodoksë janë mësuar në shkolla greke, shqiptarët myslimanë dhe katolikë, të cilëve u ishte ndaluar e drejta e mësimit në gjuhën kombëtare, kanë studiuar në shkolla turke, italiane, frënge, angleze dhe amerikane”⁷⁴. Ai i kujtoi qeverisë greke se masakrat e bëra nga ushtria e tyre në këto troje gjatë viteve 1913-1914, nuk mund të ishin shprehje e një niveli të lartë qytetërimi.

Në parashtresën e tij, Turhan Pasha nuk harroi të përmendte dhe kujdesin e shtetit shqiptar për minoritetet. Ai garantoj Konferencën se Shqipëria, e cila kishte vuajtur shumë të këqija, “do të bënte detyrë të vetën që të jetojë në bashkim të plotë e me një shpirt tolerance sa më të gjerë, duke u dhënë minoriteteve të huaja të gjitha të drejtat që u njihen në vendet më të përparuara në qytetërim”⁷⁵.

Për të shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga qeveria greke u ngrit një komision, i cili pas parashtrimit të kërkesave shqiptare u ngarkua të studionte dhe pretendimet e shtetit shqiptar dhe për këtë u quajt Komisioni për Çështjet Greke dhe Shqiptare. Në të merrnin pjesë dy përfaqësues nga secila prej Fuqive të Mëdha (ShBA, Britania e Madhe, Franca, Italia) dhe kryesohej nga përfaqësuesi francez, Jules Cambon. Në të vërtetë, Komisioni u mor kryesisht me pretendimet greke dhe shpenzoi pjesën më të madhe të kohës duke u përpjekur të zgjidhte kërkesat konkurruese të Italisë dhe Greqisë⁷⁶ ndaj Shqipërisë.

Komisioni për çështjet greke dhe shqiptare punoi gjatë muajit shkurt duke mbledhur të dhëna dhe duke dëgjuar palët e interesuara. Komisioni ridëgjoi pretendimet greke të parashtruara përsëri nga Venizellosi. Argumentet e tij qëndruan në linjën e memorandumit dhe parashtresës greke në Këshillin e të Dhjetëve. Qeveria shqiptare gjithashtu, kërkoi që komisioni të dëgjonte dhe pretendimet e saj, kërkesë që u mbështet nga përfaqësuesi i SHBA-së. Përfaqësuesit e Francës dhe të Anglisë kërkuan që të dëgjoreshin dhe vetë vorio-epirotët.

Peshën kryesore për palën shqiptare para Komisionit për Çështjet Greke dhe Shqiptare e mbajti Dr. Mihal Turtulli. Ai foli si i krishterë, si korçar dhe si shqiptar i mirë. Ai hodhi poshtë pretendimet se ndërjegjija e banorëve të krishterë të Korçës

⁷³ Turhan pashë Përmeti, *Shqipëria përballë Konferencës së Paqes (Dokumente zyrtare të paraqitura nga ana e dërgatës shqiptare qysh prej 12 shkurtit - 5 qershor 1919 e të botuara nga Qeveria e Përkohshme)* Bleu I, Roma: Cooperativa sociale, 1919, f. 29.

⁷⁴ Po aty, f. 41.

⁷⁵ Po aty, f. 45.

⁷⁶ R. Gurakuqi, *Shqipëria dhe Çështja Shqiptare ...*, f. 43.

ishte greke. Ai ishte shembull i gjallë që e kundërshtonte këtë. Ai ishte i krishterë, i shkolluar në shkollat greke, por ndihej shqiptar, ashtu si të gjithë bashkëqytetarët e tij të krishterë. Dr. Turtulli, i kujtoi delegatit francez, i cili ishte, mesa duket, mbështetësi më i fortë i pretendimeve greke, Protokollin e Korçës të vitit 1916⁷⁷. Sipas studiuesit A. Puto, argumentet dhe dëshmitë e drejtpërdrejta të paraqitura nga Dr. Turtulli vunë në dyshim tezën greke se Vorio-Epiri, pavarësisht nga gjuha që flet, ka ndërgjegje greke⁷⁸. Kryetari i seancës pyeti delegatët shqiptarë “se cilat ishin garancitë që do t’u jepeshin popullsisë jo shqiptare të Vorio-Epirit ose Shqipërisë së Jugut”⁷⁹. Delegacioni shqiptar përsëriti deklaratën e bërë nga Turhan pasha, se minoriteteve do t’u jepeshin të gjitha garancitë që vendet e qytetëruara u jepnin minoriteteve në vendet e tyre.

Mehmet Konica, anëtari tjetër i delegacionit shqiptar, kundërshtoi vlefshmërinë juridike të Protokollit të Korfuzit, të cilën përfaqësuesit grekë e kishin përmendur shpesh gjatë seancave. Ai theksoi se Protokollin e Korfuzit nuk mund të ishte dokumenti ku do të bazohej mbrojtja e minoriteteve në Shqipëri. Baza juridike e regjimit të minoriteteve do të lidhej me Lidhjen e Kombeve. Delegacioni shqiptar ripërsëriti dhe kërkesat e Shqipërisë për krahinën e Çamërisë. Dr. Turtulli vërejti se, nëse bëhej fjalë për parimin e kombësisë, Greqia jo vetëm nuk duhej të “merrte kaq shumë, por dhe të rikthente atë që nuk i përkiste”⁸⁰.

Delegacioni i të vetëquajturve vorio-epirotë u përfaqësua nga Aleksandros Karapanos dhe Dr. Adamidis⁸¹. Karapanos në fjalën e tij mbështeti tezat e Venizellosit, sipas të cilave elementi shqiptar në jug nuk ishte autokton dhe se marrëdhëniet shoqërore në këtë kishin qenë karakterizuar nga një antagonizëm i thellë mes të krishterëve dhe myslimanëve⁸².

Më 4 dhe 6 mars 1919 u zhvilluan dy mbledhje të komisionit me qëllim përpilimin e një raporti përfundimtar. Në lidhje me kufijtë mes Shqipërisë dhe Greqisë, komisioni kishte arritur në përfundimin se statistikave të disponueshme ofronin pak kritere praktike për të mbështetur dëshirat e popujve të interesuar. Të tilla statistika, në bazë të raportit, mund të mbështeten vetëm mbi provën e besimit fetar ose mbi atë të gjuhës, “testi i parë është i pafavorshëm për shqiptarët, i dyti

⁷⁷ Protokollin e Korçës u nënshkrua më 10 dhjetor 1916 nga përfaqësuesit shqiptarë të qytetit dhe autoriteteve franceze të pushtimit. Sipas këtij Protokollin, qyteti i Korçës dhe rrethet Bilisht, Kolonjë, Gorë-Opar formonin një krahinë autonome, që do të administrohej nga shqiptarët, nën mbrojtjen e autoriteteve ushtarake franceze. Sipas Protokollit, gjuha zyrtare do të ishte shqipja dhe flamuri ai shqiptar. Ky Protokoll ishte dëshmia më e mirë e përbërjes etnike shqiptare të popullsisë së krahinës së Korçës. Shih: *Historia e Popullit Shqiptar ...*, Vëll. III, f. 89.

⁷⁸ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 237.

⁷⁹ *Po aty*.

⁸⁰ *Po aty*, f. 238.

⁸¹ Është fjala për korçarin Jani Adhamidhi, i cili ishte një nga aktivistët e lëvizjes vorio-epirote.

⁸² FRUS, The Paris Peace Conference, 1919, vol. III, f. 859, Procesverbali i mbledhjeve të Këshillit të të Dhjetëve nga 12 janari deri në 14 shkurt 1919

është i pandershëm për grekët”⁸³. Për përfaqësuesit e Francës dhe Anglisë në Komision kufiri i caktuar në vitin 1913 nuk kishte gjetur miratimin e palëve të interesuara. Në raport paraqitej mendimi i përfaqësuesve anglezë dhe francezë, të cilët “kishin mbetur të impresionuar nga faktet e dhëna nga z. Venizellos dhe Karapanos për sa u përket ndjenjave helenofile të pjesës më të madhe të popullsisë dhe për vartësinë ekonomike të rajonit të Korçës me rrugën kryesore që të shpie në Sarandë”⁸⁴.

Përfaqësuesit e SHBA-së mendonin se argumentet greke për karakterin helen të Shqipërisë së Jugut ishin pa baza. Sipas SHBA-së, ishte e vërtetë se në krahinat në jugperëndim të lumit Vjosa kishte popullsi greke, por në krahinat në verilindje të këtij lumi pjesa më e madhe e popullsisë është shqiptare, jo vetëm sa i përket gjuhës, por dhe ndërgjegjes kombëtare. Përfaqësuesi italian, gjithashtu, e kundërshtoi këtë raport dhe paraqiti një raport të vetin të përmbledhur në 11 pika. Ai shprehej për ruajtjen e kufijve të vitit 1913, me përjashtim të Vlorës dhe rrethinave të saj, të cilat duhet t’i kalonin në zotërim Italisë, për arsye “strategjike dhe sigurimi në Adriatik”⁸⁵. Raporti i hartuar nga përfaqësuesit e Francës dhe Britanisë së Madhe iu paraqit Këshillit të të Dhjetëve, pavarësisht objeksioneve amerikane dhe kundërshtimit italian. Të dyja këto iu shtuan si shtojca raportit të Komisionit, i cili u dërgua për t’u shqyrtuar dhe për të marrë vendimet përkatëse nga Këshilli i Lartë i Konferencës. Çështja e kufirit shqiptaro-grek u diskutua vetëm në mënyrë periferike nga konferenca në maj 1919, por për shkak të kundërshtimit të SHBA-së dhe Italisë nuk u vendos asnjë kufi përfundimtar midis dy vendeve.

Ndryshe nga Greqia, Mbretëria e sapokrijuar Serbo-Kroato-Slllovene (MSKS), nuk parashtrroi në fillim të Konferencës së Paqes së Parisit ndonjë pretendim territorial ndaj territorit shqiptar, pavarësisht se ushtritë serbë ende mbanin të pushtuara territore edhe brenda Shqipërisë së krijuar më 1913. Ajo gjithashtu, nuk parashtrroi ndonjë pretendim për minoritetin e vogël malazez, që ishte pjesë e shtetit shqiptar.

Konferenca e Paqes i mbylli punimet pa dhënë vendime për statusin dhe kufijtë e shtetit shqiptar. U vendos se të gjitha çështjet e lëna pezull do të diskutoheshin dhe vendoseshin në marrëveshje dypalëshe apo në një nga organizmat që u krijuan nga Konferenca e Paqes: Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadorëve.

Ndërkohë që Konferenca e Paqes po vazhdonte ende punimet dhe shqiptarët me çështjen e tyre kombëtare po bëheshin gjithnjë e më shumë një mjet kompensimi për politikën e të Mëdhenjve, faktori shqiptar brenda vendit po ndërgjegjësohej gjithnjë e më shumë për rolin që duhet të luante në këtë situatë. Marrëveshja Titoni-Venizellos e 29 korrikut 1919, e cila në thelb sanksiononte ndarjen e Shqipërisë së Jugut ndërmjet Italisë dhe Greqisë, i la të kuptonte faktorit politik shqiptar se politika italiane në Shqipëri ishte po aq e rrezikshme për të

⁸³ R. Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare ...*, f. 45.

⁸⁴ *Po aty*.

⁸⁵ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 243.

ardhmen, sa dhe ajo greke⁸⁶. Indinjata e shqiptarëve u shtua veçanërisht gjatë nëntorit 1919, kur trupat ushtarakë italianë e francezë, zbrazën rajonin mes Korçës dhe Gjirokastrës, për t'ua lënë atë trupave ushtarakë grekë.

Vullnetin e shqiptarëve për një shtet tërësisht sovran e shprehu Kongresi i Lushnjës (janar 1920). Të 58 delegatët, të ardhur nga të gjitha krahinat shqiptare, miratuan programin bazë të Kongresit: rimëkëmbje të shtetit të pavarur shqiptar të krijuar më 28 nëntor 1912. Kongresi miratoi organet qeverisëse dhe Kushtetutën e shtetit shqiptar. Arritja më e madhe e qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës ishte marrja në dorëzim e të gjitha territoreve të shtetit shqiptar të krijuar më 1913, përfshirë dhe Korçën, dhe Shkodrën që mbaheshin nga ushtritë franceze, si dhe organizimi i Luftës së Vlorës, që shënoi fundin e ëndrrës italiane për një mandat në Shqipëri. Por, pavarësisht këtyre sukseseve të arritura nga qeveria e Lushnjës në planin e brendshëm, zgjidhja e çështjeve madhore të shtetit shqiptar, ai i statusit ndërkombëtar dhe përcaktimit të kufijve ishte ende larg.

Qeveria shqiptare i kushtoi vëmendjen e duhur situatës së krijuar. Krahas vazhdimit të përpjekjeve për mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit territorial shqiptar në Konferencën e Paqes, qeveria e Sulejman Delvinës në nëntor 1920 paraqiti kërkesën për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve. Kjo do t'i jepte shtetit shqiptar njohje kolektive dhe do të ndihmonte në zgjidhjen përfundimtare të statusit të tij ndërkombëtar⁸⁷. Ndërsa në Konferencën e Paqes, minoritetet ishin një çështje periferike, në Lidhjen e Kombeve Shqipërisë iu desh të përballlej më fuqishëm me këtë çështje.

Në frymën e përgjithshme ndërkombëtare, minoritetet u shtruan si çështje për t'u diskutuar dhe për qeverinë shqiptare. Në sesionin e 15 dhjetorit 1920, Asambleja e Lidhjes së Kombeve u kishte kërkuar shteteve kaukaziane dhe ballkanike, midis të cilave dhe Shqipërisë, të cilat pretendonin të bëheshin anëtare të saj, të merrnin masat e domosdoshme që, në frymën e traktateve të Lidhjes së Kombeve mbi minoritetet, të rregullonin legjislacionin e brendshëm⁸⁸. Qeveria shqiptare u tregua menjëherë e gatshme ta pranonte këtë kusht. Tiranës zyrtare nuk iu kërkuar vetëm rregullimi i legjislacionit të brendshëm, por dhe nënshkrimi i një deklarate për mbrojtjen e minoriteteve para Lidhjes së Kombeve. Si rregull, imponimi i këtyre detyrimeve u bëhej shteteve që ishin krijuar nga Sistemi i Versajës ose atyre që në përfundim të Luftës së Parë Botërore e kishin zgjeruar dukshëm territorin⁸⁹. Shteti shqiptar nuk hynte në asnjërën nga këto kategori.

⁸⁶ *Po aty*, f. 249.

⁸⁷ Sipas studiuesit A. Puto argumentimi i kërkesës së Shqipërisë për t'u pranuar në Lidhjen e Kombeve mbështetej në faktin se Shqipëria nuk ishte një shtet i ri i krijuar pas Luftës së Parë Botërore, ai ekzistonte si shtet i pavarur që në vitin 1913, në bazë të vendimeve të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe se këto vendime nuk i kishte denoncuar asnjë prej palëve nënshkruese. A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 287.

⁸⁸ Ledia Dushku, "Debatet shqiptaro-greke dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922)", në *Studime Historike*, 3-4, Tiranë: 2006, f. 76.

⁸⁹ Për më tepër në lidhje me këtë shih: Michael Burns, "Disturbed Spirit: Minority Rights and New World Order, 1919 and the 1990s" në: *New European Order 1919 and 1991*,

Detyrimet e veçanta të Shqipërisë në lidhje me minoritetet rridhnin nga një rezolutë e Asamblesë së Lidhjes së Kombeve⁹⁰.

Dhimitër Berati, në librin e tij *Qëllimi dhe organizimi i Lidhjes së Kombeve*, shprehet se nënshkrimi i një deklarate për mbrojtjen e minoriteteve nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, por “Shqipëria i plotësoi pa asnjë kundërshtim gjithë ato të drejta që vetë Lidhja e Kombeve i ka gjetur të arsyeshme”⁹¹. Ky konstatim lë të nënkuptohet se nënshkrimi i kësaj deklarate për mbrojtjen e minoriteteve ishte lënë në vullnetin e qeverisë shqiptare.

Në të vërtetë, Deklarata u nënshkrua më 2 tetor 1921, pra, gati 10 muaj më vonë se Shqipëria të anëtarësohej në Lidhjen e Kombeve. Kështu, juristi dhe diplomati Dh. Berati pohon me të drejtë se nënshkrimi i Deklaratës nuk ishte kusht për pranimin e Shqipërisë, por, nga ana tjetër, nuk mendoj se ishte thjesht dhe vetëm akt i një vullneti të mirë nga ana e qeverisë shqiptare. Gjatë zhvillimit të Konferencës së Paqes, delegacionit shqiptar që përfaqësonte qeverinë e Durrësit, i ishte dashur disa herë të theksonte vullnetin e qeverisë shqiptare për t’u garantuar minoriteteve të gjitha të drejtat që u njiheshin nga e drejta ndërkombëtare.

Edhe nëse kjo kërkesë e Lidhjes së Kombeve të mos kishte karakter detyrues, Shqipëria ishte e interesuar ta nënshkruante një deklaratë për mbrojtjen e minoriteteve dhe kjo për shumë arsye.

Së pari, një gjë të tillë e diktonte situata ndërkombëtare, në të cilën gjendej shteti shqiptar. Me pranimin në Lidhjen e Kombeve, vërtet Shqipërisë i sigurohej njohje kolektive e ekzistencës së saj si shtet i pavarur, por qeveria shqiptare nuk ishte njohur ende ndërkombëtarisht. Për më tepër, në Konferencën e Ambasadorëve pritej të thuhej fjala e fundit edhe për kufijtë e shtetit shqiptar. Në këtë situatë shtetit shqiptar i duhej të dëshmonte bindje të plotë dhe luajalitet maksimal ndaj legjislacionit të Lidhjes, duke përfshirë edhe atë për mbrojtjen e minoriteteve. Një qëndrim i tillë në mbështetje të standardeve të Lidhjes së Kombeve për minoritetet do të krijonte siguri dhe do të ndihmonte në rikonfirmimin e kufijve të shtetit shqiptar të vitit 1913. Në fund të fundit, përfaqësuesit shqiptarë në Konferencën e Paqes, disa herë ishin shprehur se ishin të gatshëm t’u akordonin minoriteteve të gjitha të drejtat që shtetet e qytetëruara u japin atyre. Tashmë ishte kohë të ndërmerreshin disa angazhime konkrete.

Së dyti, nënshkrimi i Deklaratës së Lidhjes së Kombeve për Mbrojtjen e Minoriteteve ishte një hap përpara në krahasim me regjimin e kapitulacioneve. Në ndryshim nga ky regjim, Deklarata parashikonte që të drejtat e minoriteteve në Shqipëri të siguroheshin nga shteti shqiptar dhe të garantoheshin nga organizmat e Lidhjes së Kombeve. Statuti i Lidhjes së Kombeve nuk lejonte asnjë shtet, që nuk ishte anëtar i Këshillit të saj, të ngrinte çështje që lidheshin me minoritetet. Kjo pengonte ndërhyrjen e shteteve fqinje të Shqipërisë, të cilat, kinse në mbrojtje të minoriteteve, vazhdonin politikën e tyre irredentiste në territorin shqiptar.

edited by Samuel F. Wells Jr. and Paula Bailey Smith, Washington: Woodrow Wilson International Center, 1996, f. 46.

⁹⁰ L. Dushku, “Debatet shqiptaro-greke ...”, f. 76.

⁹¹ Dhimitër Berati, *Qëllimi dhe Organizimi i Lidhjes së Kombeve*, Tiranë: 1931, f. 16.

Më 2 tetor 1921, përfaqësuesi i qeverisë shqiptare pranë Lidhjes së Kombeve, Fan Noli, nënshkroi Deklaratën për Mbrojtjen e Minoriteteve. Ai deklaroi se qeveria e tij “do të merrte parasysh çdo rekomandim që mund t’i bëhej për minoritetet nga Lidhja e Kombeve”⁹². Para nënshkrimit të kësaj deklarate, qeveria greke i kërkoi Lidhjes së Kombeve ta detyronte qeverinë shqiptare të njihte të drejtën e Greqisë për të folur në forumet e Lidhjes në emër të minoritetit grek në Shqipëri, kërkesë kjo që nuk u pranua⁹³. Një atribut i tillë në bazë të Deklaratës u takonte vetëm anëtarëve të Këshillit të Lidhjes së Kombeve. Në nenin e parë të Deklaratës thuhej se dispozitat e kësaj deklarate do të njihen si ligj bazë në Shqipëri⁹⁴.

Deklarata e 2 tetorit 1921 parashikonte që qeveria shqiptare t’u njihte minoriteteve që jetonin në Shqipëri, të drejta të barabarta “me ligj dhe në fakt” me të gjithë shtetasit e tjerë. Ajo gjithashtu përmbante dispozita për garantimin e së drejtës së minoriteteve për të përdorur dhe mësuar gjuhën e tyre amtare, lirinë e besimit dhe të ndërgjegjes, si dhe mbajtjen e shoqatave të tyre të bamirësisë⁹⁵. Në Deklaratë parashikohej, gjithashtu, që qeveria shqiptare, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga nënshkrimi i saj, do t’i paraqiste Këshillit të Lidhjes së Kombeve të dhëna të detajuara mbi komunitetet fetare, kishat, manastiret, shkollat, shoqatat e bamirësisë të minoriteteve të racës, të fesë dhe të gjuhës⁹⁶. Duke qenë se çështjet në lidhje me pakicat rregulloheshin me këtë Deklaratë, e cila si akt ndërkombëtar kishte përparësi ndaj atyre kombëtare, në Statutet themeltare si të Republikës Shqiptare, ashtu dhe të Monarkisë nuk u përfshinë norma specifike për minoritetet⁹⁷, gjë që do të thoshte që çështjet që lidheshin me statusin e minoriteteve rregulloheshin në bazë të parimeve të Deklaratës.

Historia e shtetit shqiptar në periudhën midis dy Luftërave do të dëshmonte se vetëm vullneti i qeverisë shqiptare për të garantuar të drejtat e minoriteteve nuk do të mjaftonte. Të drejtat që parashikonte deklarata për mbrojtjen e minoriteteve, veçanërisht ato për arsimimin dhe besimin do të keqpërdoreshin nga shtetet ballkanike fqinje. Në jo pak raste, ato e shfrytëzuan vullnetin pozitiv të shtetit shqiptar ndaj minoriteteve, por dhe dobësinë e tij si shtet i ri dhe i pakonsoliduar, për të krijuar vatra të politikës së tyre antishqiptare.

Në një kohë kur shtetet fqinje ushtronin trysni mbi qeveritë shqiptare për të siguruar të drejta maksimale për minoritetet e tyre në Shqipëri, popullsisë shqiptare në Jugosllavi e Greqi nuk i ishin garantuar as të drejtat minimale të jetës dhe të pronës. Në këto kushte, minoritetet u bënë shpesh objekt diskutimi dhe fërkimesh në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me qeveritë fqinje. Kjo ka qenë veçanërisht më e theksuar gjatë viteve 1920-1924, kur çështja e kufijve shqiptarë nuk ishte

⁹² *Po aty*, f. 18.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *École Minoritaire en Albanie*, documents transmis par le Secrétaire General de la Société des Nations, janvier 1935, Cour Permanente de Justice Internationale, f. 11.

⁹⁵ *Po aty*, f. 13.

⁹⁶ *Po aty*.

⁹⁷ Luan Omari, “Kushtetuta e Shqipërisë dhe pakicat kombëtare”, në *Tribuna Juridike*, Nr. 40 (1), 2003, f. 8.

përfunduar plotësisht dhe nuk ishin vendosur ende marrëdhëniet diplomatike mes Shqipërisë dhe fqinjëve ballkanikë. Shkak për këtë situatë fërkimesh nuk ishte dëshira e minoriteteve për t'u bashkuar me shtetet e tyre amë. Madje, minoriteti maqedonas i zonës së Prespës, por dhe popullsia maqedonisht-folëse e Gollobordës shprehën vullnetin e tyre përballë Komisionit për Kaktimin e Kufijve, që të ishin pjesë e shtetit shqiptar⁹⁸. Acarimet në marrëdhëniet ndërshtetërore vinin si pasojë e politikave të shteteve fqinje ndaj shtetit shqiptar, si dhe sjelljes së tyre ndaj minoriteteve shqiptare.

Gjatë vitit 1922, qeveria shqiptare ndërmori një studim për të parë gjendjen e minoriteteve dhe shkallën e të drejtave të tyre. Studimi përmblihte të dhëna për numrin e minoriteteve dhe të institucioneve arsimore, fetare, bamirëse etj. Rezultatet e përgjithshme të këtij studimi ishin se në Shqipëri jetonin minoritete greke, malazeze dhe vllahe, të cilat, në përputhje me dispozitat e deklaratës së 2 tetorit 1921, kishin shkolla në gjuhën e tyre amtare, si dhe institucione fetare të pavarura⁹⁹. Anëtarëve të minoritetit u ishin dhënë mundësi të barabarta për punësim në institucionet shtetërore, madje dhe e drejta e përfaqësimit në parlamentin shqiptar¹⁰⁰.

Qeveria greke e kundërshtoi fuqishëm këtë raport. Ajo vazhdonte të konsideronte grekë të gjithë të krishterët e Shqipërisë së Jugut. Për shkak të synimeve të saj për të aneksuar pjesën jugore të Shqipërisë, Athina zyrtare e vendosi shpeshherë në pozita mbrojtëse përfaqësuesin shqiptar në Lidhjen e Kombeve për çështjen e trajtimit të minoritetit grek në Shqipëri. Qeverisë shqiptare i është dashur të mbledhë statistika dhe t'i paraqesë ato para Lidhjes së Kombeve, me qëllim që të vërtetonte numrin e shkollave në gjuhën greke; institucionet e kultit etj.¹⁰¹ Në këto kushte, shteti shqiptar duhej të merrte masa për të ndaluar këtë propagandë, duke respektuar njëkohësisht angazhimet e marra kundrejt Lidhjes së Kombeve. Kjo detyrë nuk ishte gjithmonë e lehtë në kushtet e vështirësive ekonomike dhe politike të shtetit të ri shqiptar në periudhën mes dy luftërave.

Qeveria e Tiranës, nga ana tjetër, ka dëshmuar përpara forumeve ndërkombëtare të kohës qëndrimin e njëanshëm dhe jo konform marrëveshjeve ndërkombëtare të qeverisë greke ndaj shqiptarëve në Greqi, lidhur me të drejtën e arsimimit apo institucionet e kultit. Ajo nuk ka munguar të vërë në dukje se shteti i varfër shqiptar, në vitin 1923, kishte hapur për minoritetin në qarkun e Gjirokastrës 37 shkolla në gjuhën greke. Ndërkohë, për minoritetin shqiptar në Greqi, i cili jetonte në krahinën e Çamërisë e gjetkë, nuk kishte asnjë shkollë, megjithëse popullsia ishte shumë më e madhe.

Çështja e minoriteteve ndikoi mjaft në marrëdhëniet shqiptaro-greke gjatë periudhës midis dy Luftërave. Pas një periudhe të shkurtër qetësie, e cila çoi në vendosjen e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Greqisë në shkurt 1923, gjatë

⁹⁸ *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Koleksioni i dokumenteve britanike, A. VI. 96.

⁹⁹ Dh. Berati, *Qëllimi ...*, f. 26.

¹⁰⁰ *Po aty*.

¹⁰¹ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, Vëll. III, f. 208.

viteve 1923-1926, marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Greqisë u acaruan përsëri. Shkak kryesor për këtë u bënë përpjekjet e qeverisë greke për të zbatuar dispozitat e Traktatit të Lozanës¹⁰² për shkëmbimin e popullsisë dhe përfshirjen në këtë proces të “myslimanëve të Epirit”, pra minoritetin shqiptar që jetonte në rajonin e Çamërisë.

Në janar të vitit 1923 përfaqësuesi grek në Konferencën e Lozanës, N. Kaklamanos, deklaroi se Greqia nuk do të përfshinte në shkëmbim “myslimanët që banonin në Epir”¹⁰³, të njëjtën gjë premtoi nga ana e tyre dhe përfaqësuesi turq¹⁰⁴. Disa muaj më vonë, kryeministri grek E. Venizellosi e përsëriti këtë sigurim me anë të një deklaratë të bërë para Lidhjes së Kombeve. Por në realitet Greqia e konsideroi Traktatin e Lozanës si një mundësi për të larguar një popullsi të padëshiruar, e cila jetonte në një krahinë të pasur. Në mënyrë që të mund ta përfshinte dhe minoritetin mysliman shqiptar në shkëmbim, qeveria greke vazhdoi në pikëpamjen e saj për barazimin e fesë me kombësinë dhe i konsideroi të gjithë myslimanët si turq. Kështu ndodhi me myslimanët shqiptarë të Kosturit, Follorinës, Janinës, Konicës e pjesërisht të Çamërisë. Grekët zunë pronat dhe shtëpitë e tyre. Edhe ata pak që mbetën u kthyen në qytetarë të rangut dytë¹⁰⁵.

Për shkak të politikave të pakujdesshme të Greqisë minoritetet do të bëheshin dhe një herë mollë shërri në marrëdhëniet ndërshtetërore. Duke parë situatën tejet të rëndë të minoritetit shqiptar në Greqi, qeveria shqiptare protestoi disa herë në Lidhjen e Kombeve kundër përfshirjes së tij në shkëmbimin e popullsisë. Madje, në fund të dhjetorit 1923, Mehdi Frashëri, kryetar i delegacionit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, i dërgoi një notë Sekretariatit të saj. Ai kërcënoi se, nëse Greqia do t'i dëbonte çamët në Turqi, atëherë qeveria shqiptare do të ndërhynte dhe do t'i sillte çamët në Shqipëri dhe do t'i vendoste ata në fshatrat ku jetonte minoriteti grek¹⁰⁶.

Në vitin 1924 qeveria përsëriti protestën dhe kërcënimin se mund të merrte masa reciproke duke dëbuar grekët nga Shqipëria. Më 30 shtator 1924, Këshilli i Lidhjes vendosi ta mbante në rend të ditës çështjen e shkëmbimit të popullsisë shqiptare në Çamëri, si çështje në zbatim të Traktatit të Lidhjes së Kombeve për Mbrojtjen e Pakicave¹⁰⁷. Përfaqësuesi shqiptar në Lidhjen e Kombeve, Mehdi Frashëri, solli një varg argumentesh në mbështetje të minoritetit shqiptar në Greqi.

¹⁰² Traktati i Lozanës i 30 janarit 1923, i jepte fund Luftës Greko-Turke për Anadollin. Turqia mundi Greqinë, por bashkë me të edhe Megali-idenë greke. Greqia humbi të gjitha territoret e Azisë së Vogël, të cilat Konferenca e Paqes ia kishte njohur asaj, të cilat i rimori Turqia. Traktati kishte një grup dispozitash, të cilat parashikonin shkëmbimin e popullsisë turke në Greqi me atë greke në Turqi. Bëhej fjalë për një popullsi afërsisht prej 1,5 milionë banorësh në të dyja shtetet.

¹⁰³ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 339.

¹⁰⁴ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, Vëll. III, f. 500.

¹⁰⁵ Në lidhje me zbatimin e Traktatit të Lozanës dhe politikën greke ndaj minoritetit shqiptar në Greqi shih: *Historia e Popullit Shqiptar ...*, Vëll. III, f. 499-506.

¹⁰⁶ A. Puto, *Shqipëria Politike ...*, f. 340.

¹⁰⁷ Fatmira Rama, “Problemi çam në Lidhjen e Kombeve (1923-1926)”, në: *Studime Historike*, 3-4, Tiranë: 2007, f. 127.

Ndërsa çështja ishte shtruar për diskutim në Lidhjen e Kombeve, Mithat Frashëri, ministri shqiptar në Athinë, bëri një punë të lavdërueshme duke udhëtuar në të gjithë rajonin e Çamërisë për të mbledhur të dhëna dhe për të informuar qeverinë dhe përfaqësuesit shqiptarë pranë Lidhjes së Kombeve për gjendjen reale të popullsisë shqiptare në Greqi.

Minoritetet u bënë objekt akuzash dhe kundërakuzash edhe gjatë periudhës së shkurtër të qeverisjes së Fan Nolit (qershor-dhjetor 1924). Në tetor 1924, F. Noli me cilësinë e kryetarit të qeverisë shqiptare, ngriti zërin para Asamblesë së Lidhjes së Kombeve për çështjet që shqetësonin Shqipërinë në marrëdhëniet me fqinjët. Në lidhje me Greqinë, krahas problemit të minoritetit shqiptar në Greqi, ai ngriti zërin edhe për çështjen e 14 fshatrave të ish-kazasë së Korçës, të cilat sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve duhej t'i kishin kaluar Shqipërisë, por që ende mbaheshin nga ushtria greke¹⁰⁸. Athina iu kundërpërgjigj duke e akuzuar qeverinë shqiptare për “organizim bandash sulmuese kundër fqinjëve”¹⁰⁹. Madje, shtypi grek filloi të bënte thirrje për një front të përbashkët të vendeve ballkanike kundër asaj që konsiderohej “fqinjë e pakorrigjueshme”¹¹⁰.

Këtyre qëndrimeve dhe akuzave, Noli, do t'u kundërvinte gjendjen e minoritarëve grekë në Shqipëri, të cilëve, sipas tij, u ishin garantuar të drejtat për arsimim në gjuhën e tyre¹¹¹. Ndërsa akuzave greke dhe jugosllave për irredentizmin shqiptar, ai iu përgjigj në një intervistë që dha për gazetën “Vreme” të Beogradit, ku u shpreh se irredentizmi shqiptar do të zhdukej krejt, në qoftë se bashkatdhetarët tanë jashtë kufijve do të gëzonin të drejtat e duhura kombëtare¹¹².

Minoritetet vazhduan të ishin një çështje problematike dhe gjatë periudhës kur shteti shqiptar drejtohej nga Ahmet Zogu, qoftë si president apo si mbret. Ahmet Zogu si president, që në janar 1925, rikonfirmoi deklaratën zyrtare që kishte bërë në vitin 1921 para Lidhjes së Kombeve se njihnte minoritetin grek në Shqipëri dhe u angazhua që sipas normave juridike ndërkombëtare të respektonte, në bazë të reciprocitetit, të drejtat e tij. Minoriteti grek vazhdoi të kishte të drejtën të zgjidhte

¹⁰⁸ Më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve, e cila po shqyrtonte çështjen e kufijve dhe kërkesën italiane për disa të drejta të posaçme ekonomike dhe strategjike në Shqipëri, shpalli vendimin e saj. Sipas tij, qeveria shqiptare u njoh si qeveri e një shteti të pavarur dhe sovran. U vendos të bëheshin disa rektifikime në kufirin verior dhe verilindor dhe për këtë u krijua një komision, të cilit iu ngarkua detyra për të hetuar edhe situatën në kufirin jugor të Shqipërisë, pra atë me Greqinë. Në raportin paraprak që ky komision i paraqiti Konferencës së Ambasadorëve dhe Lidhjes së Kombeve, pasi fliste për ndërgjegjen shqiptare të banorëve të Korçës dhe pjesës dërmuese të Shqipërisë së Jugut, ndalej tek 26 fshatrat e ish-kazasë së Korçës, për të cilat Komisioni i Kufijve i vitit 1913 nuk ishte shprehur. Komisioni vendosi që nga 26 fshatrat në shqyrtim, 14 të kalonin brenda kufijve të Shqipërisë. Por, deri në vitin 1924 ushtria greke ende nuk ishte tërhequr nga këto fshatra.

¹⁰⁹ A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 369.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Nasho Jorgaqi, *Jeta e Fan S. Nolit*, Vëllimi I (1882-1924), Tiranë: “Ombra GVG”, 2005, f. 543.

¹¹² Po aty, f. 538.

deputetët e tij në parlamentin shqiptar; të hapte shkolla në gjuhën greke, mësuesit e të cilave paguheshin nga qeveria shqiptare; të ushtronte lirisht fenë e tij etj.

Qeveria greke, edhe në këtë periudhë, ndërsa ishte shumë e kujdesshme për të ngritur zërin në mbrojtje të minoritetit grek në Shqipëri, ishte shumë larg plotësimit të angazhimeve që kishte marrë në mbrojtje të minoriteteve në aktet ndërkombëtare, pjesë e të cilave ishte (Traktati i Sevres). Keqtrajtimi i minoritetit shqiptar në Greqi dhe pretendimet deri në absurditet për trajtimin e të gjithë të krishterëve shqiptarë si grekë, do të krijonin situata të pakëndshme në marrëdhëniet shqiptaro-greke, si dhe do të ndikonin në marrëdhëniet e shtetit shqiptar me minoritetin grek.

Në fund të vitit 1925 dhe në fillim të 1926-ës, marrëdhëniet shqiptare-greke vazhduan të ishin të acaruara. Shkak u bë përsëri politika greke ndaj minoritetit shqiptar në Greqi. Qeveria shqiptare protestoi disa herë në Lidhjen e Kombeve, pasi qeveria greke nuk i lejonte përfaqësuesit e popullsisë shqiptare të Çamërisë të merrnin pjesë në parlamentin grek; nuk hapte atje shkolla në gjuhën shqipe, për më tepër ajo ende vazhdonte të përdorte një sërë mënyrash për shkombëtarizimin e tyre, një nga të cilat ishte shpronësimi dhe shpërngulja e tyre. Me gjithë protestat e vazhdueshme të qeverisë shqiptare në Lidhjen e Kombeve, edhe pasi kjo e fundit ishte shprehur kundër përfshirjes së popullsisë shqiptare të Çamërisë në shkëmbimin e popullsisë mes Greqisë e Turqisë, Athina zyrtare vazhdoi të njëjtën politikë. Këtu ndikoi dhe fakti se në Komisionin Miks të Lidhjes së Kombeve, që u krijua për të kontrolluar këtë shkëmbim, nuk kishte përfaqësues nga Shqipëria dhe Çamëria. Një mungesë e tillë u linte dorë të lirë autoriteteve greke ta thellonin më tej këtë politikë.

Situata pati një përmirësim të përkohshëm nga fundi i shkurtit 1926, pas ardhjes në fuqi, si kryeministër, të gjeneralit me origjinë shqiptare Teodor Pangallos. Ai kishte vizion më realist se Shqipëria nuk ishte rreziku i Ballkanit (siç e kishin paraqitur qeveritë paraardhëse greke), dhe marrëdhëniet shtetërore shqiptaro-greke hynë në fazën e normalizimit. Madje, kryeministri Pangallos bëri një deklaratë zyrtare para Lidhjes së Kombeve, sipas së cilës Republika greke njihte minoritetin shqiptar në Greqi dhe nuk i konsideronte më shqiptarët myslimanë si popullsi turke. “Teza që është mbrojtur nga ne deri me sot se ortodoksët shqiptarë janë grekë është e gabuar dhe e shkëlmuar nga të gjithë. Meqë ajo ka marrë tatëpjetën dhe arriti pikën e rraskapitjes, mora masat e duhura dhe shpërndava të gjitha shoqëritë vorio-epirote që mishëronin skajet më ekstreme të këtij mentaliteti të sëmurë”¹¹³, u shpreh ai. Në atmosferën e re të krijuar, Komisioni Miks i Lidhjes së Kombeve për shkëmbimin e popullsisë midis Greqisë dhe Turqisë, deklaroi se myslimanët e Epirit nuk ishin të shkëmbyeshëm me grekët e Anadollit, veçse në raste të veçanta¹¹⁴.

Qeverisja e Pangallosit ishte e shkurtër. Në gusht 1926, Pangallosi u rrëzua nga pushteti, ashtu siç kishte ardhur, me grusht shteti të organizuar nga vetë oficerët e tij republikanë. Pas rrëzimit të tij rifilloi largimi me forcë i popullsisë

¹¹³ A. Puto, *Shqipëria Politike...*, f. 511.

¹¹⁴ *Historia e Popullit Shqiptar...*, Vëll. III, f. 505.

shqiptare nga Çamëria. Në këtë situatë, qeveria shqiptare i kërkoi disa herë qeverisë greke të zbatonte detyrimet që ajo kishte marrë me Traktatin e Servës (1921) për mbrojtjen dhe respektimin e minoriteteve. Në janar të vitit 1928, Milto Tutulani, deputet i Parlamentit shqiptar dhe Xhafer Vila, sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare, u dërguan në Athinë për t'i sugjeruar qeverisë greke të plotësonte detyrimet e marra në traktatet e nënshkruara me Shqipërinë dhe të shihnin në vend se si zbatoheshin të drejtat e popullsisë shqiptare çame¹¹⁵. Sipas raportit të Ministrisë së Jashtme shqiptare, vizita ishte e pasuksesshme. Të dërguarit e qeverisë shqiptare konstatuan se Greqia nuk zbatonte asnjë nga angazhimet e marra dhe e thellonte edhe më tej politikën shkombëtarizuese ndaj popullsisë çame¹¹⁶.

Në prill 1928, Iliaz bej Vrioni i dërgoi një letër sekretarit të Lidhjes së Kombeve Xhejms E. Drumond (James Eric Drummond). Krahas të tjerave, në të ngrihej dhe çështja e minoriteteve. Qeveria shqiptare i kujtonte Lidhjes së Kombeve se Athina zyrtare kishte nënshkruar traktatin e propozuar prej saj për minoritetet, por nuk po e zbatonte. Ajo ankohej se gjendja e popullsisë shqiptare në Greqi ishte keqësuar dhe vetë ekzistenca e saj ndodhej në rrezik. Për shkak të presionit të autoriteteve greke popullsia çame ishte e detyruar të emigronte në Shqipëri, duke krijuar shqetësime të mëdha ekonomike qeverisë shqiptare dhe hidhërim mbarë popullit për fatet e tyre. Minoriteti shqiptar në Greqi vazhdonte të mos kishte asnjë shkollë në gjuhën shqipe në një kohë që ai grek në Shqipëri gëzonte të gjitha të drejtat politike, ekonomike dhe kulturore. Për fëmijët e minoritetit grek ishin hapur mbi 65 shkolla në gjuhën e tyre. Parlamenti shqiptar kishte 2 deputetë nga minoriteti. Në fund të letrës bëhej me dije se, nëse qeveria greke nuk do t'i merrte parasysh këto kërkesa, atëherë qeveria shqiptare, sipas nenit 2 të Konventës së Lidhjes së Kombeve, do ta shtronte çështjen për zgjidhje në sesionin e qershorit të Këshillit të saj¹¹⁷. Athina zyrtare jo vetëm i la në heshtje propozimet e qeverisë shqiptare, por në shtypin grek rifilloi fushatën për bashkimin e të ashtuquajturit Vorio-Epir me Greqinë, duke pretenduar Korçën e Gjirokastrën¹¹⁸.

Kjo situatë detyroi qeverinë shqiptare ta ngrinte përsëri këtë çështje në Lidhjen e Kombeve. Më 5 qershor 1928, kryetari i delegacionit shqiptar Mehdi bej Frashëri, i shtroi kërkesat e qeverisë së tij. “Kjo zënkë ka filluar - tha ai, - që në vitin 1923 ... Shqipëria e ka konsideruar Greqinë si motrën e saj më të madhe... Është radha që Greqia të tregohet e arsyeshme në zgjidhjen e problemeve...”. Përfaqësuesi i Greqisë, z. Politis (Nikolaos Politis), kundërshtoi pretendimet e palës shqiptare, madje e kritikoi atë për ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit të tij. Mehdi Frashëri u përgjigj se faktet ishin fakte dhe ekzistonin pavarësisht nga dëshira e qeverisë greke. M. Frashëri për të disatën herë përsëriti deklaratën që

¹¹⁵ *Dokumente mbi Çamërinë 1912-1939 ...*, f. 561.

¹¹⁶ *Po aty*.

¹¹⁷ *Ethnic Minorities in the Balkan Studies, 1860-1971, Volume 5, 1918-1971*, edited by Bejtullah Detani, London: Archive Edition, 2003, f. 456.

¹¹⁸ *Po aty*.

ministri i Jashtëm, Iljaz Vrioni kishte shqiptuar një vit më parë se, në qoftë se qeveria greke do të vazhdonte në qëndrimin e saj të vjetër, atëherë edhe qeveria shqiptare për reciprocitet do ta trajtonte minoritetin grek në Shqipëri ashtu siç trajtohej ai shqiptar në Greqi. Me anë të kësaj deklarate qeveria shqiptare përpqej t'i tregonte asaj greke se, në çështjen e trajtimit të minoriteteve, ashtu si në të gjitha çështjet e tjera, duhet të zbatohet parimi i reciprocitetit dhe i barazisë.

Situata në minoritetin shqiptar në Greqi vazhdoi të ishte e vështirë dhe gjatë viteve '30. Vazhdimisht përfaqësuesit shqiptarë në Lidhjen e Kombeve, por dhe në kontakte dypalëshe vazhduan t'i kërkonin Greqisë reciprocitet në respektimin e të drejtave të minoriteteve.

MURTEZAN IDRIZI

KRONOLOGJIA DHE SHKAQET E DEPËRTIMIT TË ISLAMIT NË TROJET SHQIPTARE

Në këtë punim synojmë të bëjmë një përshkrim të shkurtër kronologjik rreth shqiptarëve dhe fesë së tyre. Në fakt deri në vitin 731 Kisha shqiptare ishte nën juridiksionin e Kishës së Romës. Pas skizmës së madhe Kisha shqiptare kaloi nën juridiksion të Kishës së Konstantinopojës. Ky kalim i Kishës bëri që identiteti shqiptar të rrezikohet nga asimilimi sllav dhe grek. Për këtë arsye shqiptarët filluan të ndahen nga Kisha e Konstantinopojës, me qëllim që t'i shmangen asimilimit. Në favor të fatit të shqiptarëve ishte edhe rënia e Konstantinopojës nën sundimin Venedikas në vitin 1204, me çka ¼ e tokave bizantine, përfshirë edhe tokat shqiptare, ranë nën pushtetin venedikas, andaj për një periudhë identiteti i shqiptarëve u mbrojt nga asimilimi sllavo-grek.¹

Në mesjetë në krahinat e Arbrit shqiptarët nga Prizreni deri në Tivar dhe nga Ohri deri në Vlorë, mbronin idenë se nuk ishin pjesë e kishës greke. Ata e llogaritin veten si një njësi politike administrative e porsakrijuar. Pjesa tjetër ishte e organizuar si njësi administrative por kishte ngelur nën udhëheqjen e Kishës Bizantine. Fjala është për banorët nga pjesa e Prizrenit, Nishit, Velesit, Kumanovës deri në Shtip.²

Në vitin 1054 me skizmën e madhe Kisha ndahet në dy pjesë: në atë lindjes dhe të perëndimit. Nga kjo ndarje vala e mëhershme në brendësinë e kishës mori përsëri hov. Shkaku kryesor i përleshjeve mes dy kishave në mesjetën e vonshme, ishte lufta për sundimin e tokave Arbërore. Edhe Kisha perëndimore latine edhe ajo lindore bizantine dëshironte të krijojë një epërsi tek Arbrit. Nëse analizojmë çështjen shqiptare do të vërejmë ndarjen e tyre në tri dogma fetare. Kisha katolike e Tivarit ishte nën juridiksionin e Romës. Kisha ortodokse e Durrësit ishte e lidhur me Kishën e Konstantinopojës.

Gjuha zyrtare e kishës ishte gjuha greke, mirëpo me forcimin e sllavëve në tokat e arbrit gjuhë zyrtare bëhet gjuha sllave.³ Kjo do të thotë se në tokat arbërore Kisha katolike nuk kishte shtrirje të duhur. Pra as shqiptarët katolik nuk kishin ndonjë aktivitet fetarë. Popullata shqiptare ortodokse detyrohej t'i ndiqte meshat në kishat ortodokse. Në këta rrethana kohore Ballkani kaloi nën sundimin Osman.

¹ Sherif Delvina, Tentativë e Pasuksesshme Dhune Fetare, “Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997. fq. 43 – 65.

² Iliaz Rexha, Antagonizmi Ndërmjet Dy Kishave Për Dominim Në Tokat e Arbërisë (I Hapi Rugë Fesë Islame), “Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997. fq. 67 – 74.

³ Po aty, fq. 67 – 74.

Tani shqiptarët filluan ta braktisin krishterimin dhe ta pranojnë fenë islame.⁴ Sidoqoftë kjo temë mund të trajtohet edhe më gjerë në punime tjera. Me ndarjen e kishës në vitin 1054, integriteti kulturor dhe kombëtar i shqiptarëve pësoi një goditje të rëndë. Brenda kishës kishte përleshje për epërsi politike. Kisha bizantine në lindje e forconte identitetin grekë, ndërsa Kisha perëndimore synonte ta favorizonte komunitetin latino-romake.⁵

Në vitin 1186 në trevat Arbënore në veçanti në fushë Kosovë, feja katolik mori hov të madh dhe njëkohësisht ishte në përkrahje të integritimit kulturor të identitetit shqiptarë. Në fakt katolicizmi ishte i veçantë dhe dallohej nga të tjerët.⁶ Me qëllim të asimilimit, më vonë do të fillojë fushata e tmerrshme Bizantine greko-serbe e drejtuar kundër kishës latine-katolike.⁷

Rrugët e depërtimit të Islamit në trevat Ilire-Shqiptare

Rruga ushtarake

Ekspansioni Arab në drejtim të Evropës ka filluar shumë herët. Në vitin 674 dhe 678 në drejtim të Konstantinopojës ekspedita ushtarake arab përfundoi pa sukses. Njashtu në vitin 717 Konstantinopoja u rrethua, por përsëri nuk e dha frytin e duhur.⁸ Nga ky moment, apo që në vitin 717–718 Islami u bë fe e shtrirë edhe në Evropë. Halifi Mesleme e rrethoi Konstantinopojën nën flamurin islam. Në bazë të burimeve arabe ushtria e Meslemes arriti deri në Edrene dhe Selanik. Nga ky relacion mund të themi se ballafaqimi i ushtrisë myslimane me popujt e Ballkanit ndodhi në këtë moment. Gjithashtu mund të themi se kjo ishte pikënisja e ndikimit të Islamit në këto troje.⁹ Ekspansioni ushtarak arab i filluar më herët në vitin 732 përfundoi në Francë.¹⁰ Në vitin 711 Arabët e morën Spanjën.¹¹ Pra mund të themi se gjurmët e fesë islame në Ballkan ishin edhe para ardhjes së Osmanlinjve. Kjo do të thotë se kontaktet e para të Islamit me tokat e Ballkanit datojnë nga çlirimi i Spanjës. Kjo periudhë vazhdoi, prej vitit 711 deri në vitin 1492-i.¹²

⁴ Iliaz Rexha, fq. 67 – 74.

⁵ Muhamet Pirraku, Shkaqet e Kalimit në Islam te Shqiptarët, sempozyum “Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997. fq. 25 – 35.

⁶ Po aty, fq. 25 – 35.

⁷ Iliaz Rexha, fq. 67 – 74.

⁸ Tarik Kulenoviç, Islami Politik, Logos-A, Shkup, 2012, fq. 57.

⁹ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 47. Ali M. Basha, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Titanë, 2000, fq. 37. Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 14.

¹⁰ Tarik Kulenoviç, Islami Politik, Logos-A, Shkup, 2012, fq. 57.

¹¹ Po aty, fq. 58.

¹² Qemajl Morina, E Vërteta dhe Paragjykimet Për Islamit në Botë dhe Ndër Shqiptarët, “Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997, fq. 115 – 129.

Sipas Tarik Kulenoviçit në vitin 827 Arabët e morën edhe Sicilinë.¹³ Për dallim nga ky Qemajl Morina thotë se Arabët në shek X-të e morën Sicilinë dhe atëherë e sollën kulturën Islame në këtë vend.¹⁴ Pushtimi i jugut të Italisë në vitin 846, nga arabët në një farë mënyre nënkuptonte edhe përgatitje ose sinjal të një ekspedite kryqtarë të Evropës ndaj arabëve.¹⁵ Ballafaqimet kryqtar me arabët mes shekujve XII dhe XIV-të rezultoi me paraqitjen e kulturës islame në këto troje.¹⁶

Euforia e shpejtë arabe në Evropë mes viteve 717–741 ishte e ndihmuar edhe nga problematika e brendshme e shtetit Bizantinë. Ikonoklasita edhe më tepër e favorizonte fushatën arabe. Kjo tollovi e brendshme, ushtarëve Arab ju solli epërsi të volitshme.¹⁷ Grupi që i refuzonte ikonat dhe tempujt, kërkoi ndihmë nga ushtria myslimane, madje pasi erdhi ndihma nga ana e myslimanëve, ky grup më vonë edhe u konvertua në fenë Islame. Emri i grupit i cili bashkëpunoi me ushtrinë myslimane ishte saracen.¹⁸ Duke u bazuar në këtë argument dhe në argumentet që do t'i radhisim në vijim, arrijmë në përfundim të prerë se kultura Islame në brigjet e Adriatikut ishte prezente që nga shekulli VIII.¹⁹

Me këtë nënkuptojmë se Islami në trojet Iliro-Shqiptare ishte që nga shekulli VIII. Kjo do të thotë se popullata ballkanase njiheshte me Islamin.²⁰ Pra me këtë mposhten idetë se Islami në trojet Shqiptare erdhi me ardhjen e Osmanlinjve. Andaj duhet të llogaritet si normale përhapja e shpejtë e Islamit në shekullin XIV, për shkak se kishte një shtresë të mëhershëm,²¹ në fakt ardhjen e Osmanlinjve nuk e priste me padurim vetëm grupi i vogël i myslimanëve, por edhe ata që akoma nuk e kishin pranuar këtë fe.²²

Do të sjellim edhe një argument për kulturën Islame në trojet Ilire-Shqiptare që nga shekulli VIII, që sollën Peçenekët. Kufijtë e tyre ishin në jug të Maqedonisë, në veri perëndim me sllavët ishte lumi Struma, në lindje Deti i Zi, dhe në veri Hungarezët. Sipas Rade Bojeviçit “kulturën Islame në Ballkan së pari e përfaqësuan Peçenekët”. Kurse Viljem Tirski thotë “aktin e sunetimit e kryenin ardhacakët Peçenekët”. Që do të thotë se sunetimi është një traditë islame.²³ Njashtu, në kohën e Car Teofilit (829-842) turqit Vardarian me pranimin e Islamit

¹³ Tarik Kulenoviç, *Islami Politik*, Logos-A, Shkup, 2012, fq. 58.

¹⁴ Qemajl Morina, fq. 115 – 129.

¹⁵ Tarik Kulenoviç, fq. 58.

¹⁶ Qemajl Morina, fq. 115 – 129.

¹⁷ Ali M. Basha, fq. 37.

¹⁸ Nexhat Ibrahim, *Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane*, Prizren, 1990, fq. 15.

¹⁹ Ali M. Basha, fq. 35.

²⁰ Nexhat Ibrahim, *Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve*, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 180.

²¹ Po aty, fq. 180.

²² Po aty, fq. 193.

²³ Nexhat Ibrahim, *Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve*, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 210.

u internuan në krahinën e Maqedonisë.²⁴ Teofili këta grupe nga Anadulli i dëboi në Maqedoni, por si duket këta ishin prezent edhe në Selanik.²⁵

Sipas Thomas Arnoldit nga fundi i shekullit IX, popullata Peçenekte banonte mes Danubit dhe Donës. Kurse Muhamed Haxhijahiç thotë se Peçenekët në shekullin e XI erdhën në Ballkan si pjesëtar të konfesionit mysliman.²⁶ Është e qartë se Peçenekët janë ardhacak në Ballkan, por ajo që lë hapësirë të diskutohet është nëse ata erdhën në fund të shekullit VIII apo në fillim të shekullit IX. Megjithatë më me rëndësi është të thuhet se ata ishin të arsimuar dhe e dinin shumë mirë kulturën Islame.²⁷

Mes vitit 840-841 depërtimi i myslimanëve në trojet shqiptare la gjurmë ta thella. Ata njiheshin si sarenë²⁸. Saracenët e morën Tarantën, pastaj Budvën, Kotorin dhe Rjekën. Në vitin 866 rrethuan Dubrovnikun (Raguzën).²⁹ Në bazë të shkrimtarëve serb, rrënjët e saracenët ishin nga populli Aarab. Sipas tyre arabët në shekullin X sulmuan jugun e Dalmacisë.³⁰

Numri i myslimanëve që gjatë mesjetës bënë pjesë në mbretërinë bullgare ishte i konsiderueshëm. Në fakt mes viteve 815-1018 mbretëria Bullgare sundonte në tokat Ilire-Shqiptare. Madje në vitin 864 pati një mosmarrëveshje në lidhje me literaturën Islame.³¹ Maurët (arabët e Spanjës) luajtën rol pozitiv në shtrirjen e Islamit. Librat e tyre kishin arritur deri te Papa Nikolla I (858-867), andaj në lidhje me pyetjen se çfarë duhet të veprohet me këto libra, përgjigjja ishte “hidhni ato në zjarr”.³² Gjatë mbretërisë Bullgare në Ballkan, ndizet e gjithë literatura myslimane.³³

Paraprakisht kur arabët e pushtuan Andaluzinë krijuan raporte të reja me popujt e Ballkanit. Në atë kohë sllovenët në historinë e orientit, njiheshin si sakalib. Rojtarët që mbronin Kalifin, ishin njerëz që vinin nga Dalmacia të popullit slloven apo kroat. Arabët këtë detyrë nuk e kryen vetëm në Spanjë, por të njëjtën e bënë edhe në Sicili. Ky grup njerëzish duke jetuar në mesin e popullit mysliman, pranuan fenë Islame. Sa për ilustrim, në Sicili në qytetin e Palermos ku jetonin

²⁴ Po aty, fq. 210.

²⁵ Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 21.

²⁶ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997, fq.50. Nexhat Ibrahim, Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 248.

²⁷ Nexhat Ibrahim, Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 251.

²⁸ Dallimi është shumë i vogël, vetëm a është shëndruar në e.

²⁹ Ali M. Basha, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Titanë, 2000, fq. 37. Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 15.

³⁰ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997, fq. 62.

³¹ Ali M. Basha, fq. 40.

³² Ali M. Basha, fq. 41. Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 25.

³³ Qemajl Morina, fq. 115 – 129.

“slovenët sakalib” ishte e ndërtuar një xhami. Megjithatë sot nuk e dimë a ekziston apo jo ky kult Islam.³⁴

Në periudhën para Osmanlinjve, populli ishte i ndikuar shumë nga sjellja e ushtarëve mysliman që erdhën në trevat Ballkanike. Shkaku kryesor që disa Princa Bizantinë e zgjodhën Islamin ishte madhështia dhe toleranca e myslimanëve gjatë kontaktit me këta popuj. Kemi shembullin e vitit 1140-të, nipi i perandorit Xhon Komneni kur pranoi Islamin. Ky personalitet u martua me vajzën e Ibni Mesutit sundimtar i Konjës në atë kohë.³⁵ Ebu Hamid el Endelusi rrëfen “ndër vendet e para të Ballkanit, që ia hapën derën myslimanëve ishte verilindja e Bosnjës dhe Hungaria”. Në librin e Endelusit, myslimanët në Hungari ishin dy lloj:³⁶ haptazi që dukeshin si krishterë, por në fshehtësi manifestonin Islamin dhe grupi i dytë, të cilët në luftë iu ndihmonin të krishterëve, por në paqë haptazi e manifestonin Islamin. Autori në fjalë rrëfen për luftën që ndodhi mes Hungarisë dhe Bizantit gjatë viteve 1151-1155, në krahun e Hungarezëve luftuan një numër i konsiderueshëm i ushtarëve mysliman, të cilët obligimet ditore fetare i zbatonin në formë normale pa asnjë pengesë.³⁷

Ofensivat e vazhdueshme arabe në vitin 1023 në Sicili, synonin depërtimin drejt lindjes së bregdetit Adriatik. Këto invazione ishin ushtarake, diplomatike dhe misionare.³⁸ Vlerësimi i gjendjes së shqiptarëve nga ata që erdhën nëpërmes këtyre rrugëve është se këto treva nuk e kishin zhvilluar diplomacinë politike me popujt mysliman. Shkaku kryesor është se trevat Ilire-Shqiptare ishin vazhdimisht nën okupimin e tjerëve, duke filluar nga Roma, Bizanti, Sllavët, Venediku e kështu me radhë. Mund të themi se në këtë drejtim literatura është mungesa më madhe.³⁹

Rruga Misionare

Nëse ndalemi dhe analizojmë do të vërejmë se Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe vendet tjera Ballkanike ishin destinacione kryesore për udhëpërshkruesit, sufitë dhe misionarët myslimanë. Kjo ka ngjarë para osmanlinjve.⁴⁰ Rruga kryesore e përhapjes së Islamit në Ballkan është suksesi i paskajshëm i misionarëve mysliman.⁴¹ Personalitetet që erdhën me qëllim biznesi apo me qëllim misionar në Ballkan, nëse gjenin toka pjellore vendoseshin menjëherë.

³⁴ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 51. Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 18. Ali M. Basha, fq. 38.

³⁵ Thomas W. Arnold, Historia e Përhapjes së Islamit, Dituria Islame, Prishtinë, 2004, fq. 154.

³⁶ Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 23.

³⁷ Ali M. Basha, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Titanë, 2000, fq. 39.

³⁸ Po aty, fq. 35.

³⁹ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 52-3.

⁴⁰ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 53.

⁴¹ Qemajl Morina, fq. 115 – 129.

Në lidhje me këtë thuhet se tregtarët dhe misionarët arabë u vendosën në qytetin e Beratit. Ekzistimi i toponimeve të fshatrave Arapaj dhe Arabaj njëri në Duresë e tjetri në Roskovec këtë gjë e qartëson edhe më mirë.⁴² Gjithashtu erdhën edhe dervishët e asaj kohe, të cilët në fillim përcaktoheshin për vendin ku do të vendosen e pastaj ndërtonin zavijet dhe teqetë e tyre.⁴³ Njëri nga këto ishte edhe figura e njohur Sari Sulltuku i cili erdhi në trevat Ballkanike dhe në përhapjen e Islamit luajti rol qenësor. E kemi të njohur se ky personalitet erdhi para Osmanlinjve në Ballkan. Në bazë të Halil Inalxhikut, në vitin 1241 Sari Sulltuku me 40 familje turkmene vendoset në Dobruxa të Bullgarisë. Për këtë arsye edhe njihet si dervish⁴⁴ i madh i kohës. Rrëfëhet se kishte veshur mantelin e murgjve dhe nëpër kisha shpjegonte Islamin. Pra roli i madh i dervishëve, siç ishte Sari Sulltuku ishte kyç në trevat Ilire-Shqiptare.⁴⁵

Në udhëpërshkrimin e Evlija Çelebiut, Ahmet Jeseviu thotë: “i nderuari Salltuk, ti të dërgoj në tokat Romake, shko në tokat e shtat mbretërve dhe bëhu personalitet i njohur” pas këtij urdhri Sari Sulltuku me 700 persona vendoset në Anadoll.⁴⁶ Dihet se në atë kohë Anadulli ishte pjesë e Romakëve. Në bazë të rrëfimeve të Sulltuku vinin njerëz nga krahina të ndryshme qëllimi i tyre ishte mësimi i fesë islame fshehurazi dhe pastaj përsëri të ktheheshin në vendet nga vinin.⁴⁷ Shqiptarët në shekullin XVII, të ndikuar nga veprimtaria e Sari Sulltukut pranuan bektashizmin. Nga mesi i shekullit XVII, gjysma e Shqiptarëve pranuan bektashizmin mysliman.⁴⁸ Njashtu në vitin 1291 nga Halebi i Sirisë erdhi një familje dhe u vendosë në Dragash të Kosovës në fshatin Milk të Gorës. Familja thirrej me ofiqin El-Aga, e cila familje menjëherë ndërtoj një xhami.⁴⁹

Sipas orientalistit serb Rade Bojeviçit ardhja në Ballkan e familjeve peçeneke, bashkurde dhe këpçake nga lindja dhe juglindja ishte një paralajmërim për fenë Islame.⁵⁰ Në vitin 1212-të kur Spanjën e humbën myslimanët, atëherë “spanjollët-maur” i shpërndan myslimanët nëpër Evropë.⁵¹ Në atë kohë në duart e myslimanëve ishte vetëm qyteti i Granadës. Në vitin 1498-të, myslimanët e humbin pushtetin në Spanjë. Nga ky moment, myslimanët duhej të zgjedhin njërin nga dy opsionet, t’i kthehen krishterimit ose të lënë vendlindjen dhe të shpërngulen. Duke

⁴² Ali M. Basha, fq. 36-7. Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 19.

⁴³ Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 20.

⁴⁴ Dervishët e asaj kohe ishin njerëz më të drejtë dhe nënshtruesit ndaj Zotit.

⁴⁵ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997, fq. 54.

⁴⁶ Nexhat Ibrahim, Islami në Trojet Iliro-Shqiptare Gjatë Shekujve, Logos-A, Shkup, 1999, fq. 237.

⁴⁷ Po aty, fq. 238.

⁴⁸ Necip P. ALPAN, Prizren Birligi ve Arnavutlar, Ankara, 1978, fq. 24.

⁴⁹ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997, fq. 55.

⁵⁰ Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997, fq. 61.

⁵¹ Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 27.

mos arritur të gjejë njohuri të mjaftueshme në lidhje me këtë, do të ju referohem fjalëve të Nexhat Ibrahimit, një pjesë e myslimanëve të Spanjës u vendosën në mbarë bregdetin e Adriatikut, në bregdetin kroat dhe atë shqiptarë.⁵² Në bazë të të dhënave çifute, nga debimi spanjoll vendin e lëshuan 300 000 njerëz, shumica e të cilëve ishin myslimanë.⁵³

Rruga tregtare e përhapjes së Islamit

Rruga e tretë e përhapjes së Islamit në krahinat ballkanike është tregu tokësor dhe detarë.⁵⁴ Faktori që bëri popullatën ballkanase të pranojnë fenë islame ishte rruga tokësore dhe detare. Në tokë ishte rruga e mëndafshit, rruga e cila e lidh Evropën me Ballkanin dhe Iranin me Kinën. Njashtu kemi edhe rrugën detare, kontributi i së cilës është kulturor, ekonomik dhe politik. Kjo lidhje ishte deti Mesdhe me Adriatikon dhe deti Egje me fushën e Lumit Vardar.⁵⁵ Në shekullin XI lidhja mes Evropës dhe Lindjes së Mesme bëhej nëpërmjet detit Mesdhe. Populli Arabë me popullin e bregdetit Adriatik kishte bashkëpunim tregtarë. Kjo lidhje tregtare u zgjerua deri në brigjet shqiptare, mund të themi deri në trevat Ilire-Shqiptare që ishin më herët.⁵⁶

Në shekullin XII-të në udhëpërshkrimin e El Idrisit dhe Ibni Havkalit, në brigjet e Adriatikut, kryesisht në brigjet shqiptare dhe greke shiheshin gjurmët e Islamit. Si shembull në Palermo kishte mëhallë myslimane, një numër shkollash dhe biblioteka etj.⁵⁷ El Idrisi këtë rrugë tregtare e shpjegon kështu: ata zgjeroheshin gjatë gjithë brigjeve të Adriatikut deri në Trieste, apo nga brigjet jugore shqiptare deri në brigjet greke.⁵⁸ Evropianët me qëllim tregtarë arrinin në Lindjen e Mesme, nëpërmes Egjiptit dhe Sirisë. Prodhimet Evropiane dërgoheshin atje, ndërsa prodhimet që nuk ishin këtu sillleshin nga atje. Kjo rrugë tregtare e njoftoj Evropën me kulturën Lindore.⁵⁹

Nga tri rrugët që përmendëm, kultura dhe civilizimi Islam arriti edhe në ujdhesën Ballkanike. Nga Andaluzia në detin Mesdhe, nga Sicilia dhe Hungaria në Evropë ose në Ballkan. Nga ky qarkullim detar, politik dhe diplomatik kishte edhe misionar, por edhe grupe emigrante që vendoseshin në këta treva.⁶⁰ Në shekullin e

⁵² Nexhat Ibrahimit, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 63.

⁵³ Po aty, fq. 64.

⁵⁴ Qemajl Morina, fq. 115 – 129.

⁵⁵ Nexhat Ibrahimit, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 18.

⁵⁶ Ali M. Basha, fq. 35.

⁵⁷ Po aty, fq. 36.

⁵⁸ Nexhat Ibrahimit, Muslimanët në Ballkan në Periodën Paraosmane, Prizren, 1990, fq. 12.

⁵⁹ Po aty, fq. 11.

⁶⁰ Nexhat Ibrahimit, Kontaktet e para të Islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997. fq. 43.

XI-të në bregdetin Adriatik shihen kontaktet tregtare të familjeve turkmene dhe arabe me pjesën e brendshme të bregut Ilir-Shqiptar.⁶¹

Në shekullin XIII Anadoli shfrytëzohej si urë lidhëse. Ai lidhte tokat arabe me Evropën lindore, me Ballkanin. Tregtarët që erdhën nga lindja, kur gjenin toka pjellore të përshtatshme i blinin dhe vendoseshin aty. Në këtë mënyrë i vazhdonin aktivitetet e tyre. Më vonë banorët vendas nën ndikimin e këtyre tregtarëve pranuan Islamin.⁶²

Vendosja e Osmanlinjve në Ballkan përshpejtoj përhapjen e Islamit

Atë që dua ta theksoj në këtë artikull është se përhapja masive e Islamit në Ballkan, fillon pasi vendoset plotësisht administrata osmane në Ballkan. Populli ballkanas këtë fe e perceptoi ndryshe nga të tjerat. Kemi shembullin e boshnjakëve, të cilët përnjëherë pranuan Islamin.⁶³ Që të jemi edhe më të qartë, në përparimin e Shtetit Osman në Ballkan rol të madh luajti vet Islami. Jo rastësisht në literaturën islame nuk përmendet fjala pushtim, por përdoret termi çlirim. Bazat e Shtetit Osman ishin të ndërtuar në bazë të Islamit. Por atë që duhet të pranojmë, është se tortura e tmerrshme ndaj myslimanëve ishte e ndërtuar mbi bazat e koalicionit krishterë.⁶⁴

Përsëri duhet të potencojmë se në përhapjen e Islamit rol të madh luajti vet Islami si religjion. Ideali më i madh i kësaj bashkësie myslimane ishte vëllazërimi. Islami formoj shoqëri të mrekullueshme pavarësisht nga vendi, gjuha, kombi, dhe etnia. Ekspozimin e gjithë kësaj shoqërie të shëndoshë e bënte vëllazërimi dhe barazia. Kjo do të thotë se edhe barazia edhe ndihma reciproke ishin prioritet i të gjithëve. Po ashtu nënkuptohet se nuk kishte konvertim të dhunshëm fetar tek osmanlinjtë. Ky shtet kishte besim të plotë në institucionet fetare dhe drejtohej në bazë të këtij parimi. Gjithandej njihej thënia e klerikëve (hoxhallarëve) “nuk ka dhunë në fe.”⁶⁵ Kjo vlen edhe për shqiptarët, të cilët e pranuan Islamin dhe së bashku me të tjerët e drejtuan administratën e shtetit. Vetëm posti i sulltanit iu ngeli turqve.⁶⁶

⁶¹ Po aty, fq. 44.

⁶² Po aty, fq. 46.

⁶³ Skender Riza, Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Rilindja, Tiranë 1987, fq. 420.

⁶⁴ Ali M. Basha, fq. 26.

⁶⁵ Gasper Gjini, Ipeshkvia e shkup prizeren nëpër shekuj, Drita K S, Ferizaj, 1992, fq.138.

⁶⁶ Muhamet Pirraku, Roli i Islamit në Integrimin e Shqipërisë Etnike dhe të Kombit Shqiptar, “Rreth Përhapjes së Islamit Ndër Shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfı, Shkodër, 1997. fq. 75 – 101.

LITERATURË E KONSULTUAR:

- Ali M. Basha, Islami në Shqipëri gjatë shekujve, Titanë, 2000.
- Gasper Gjini, Ipeshkvia e Shkup dhe Prizrenit nëpër shekuj, Drita K S, Ferizaj, 1992.
- Iliaz Rexha, Antagonizmi ndërmjet dy kishave për dominim në tokat e Arbërisë (i hapi rrugë fesë islame), “Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997.
- Muhamet Pirraku, Shkaqet e kalimit në islam te shqiptarët, Simpozium “Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997.
- Muhamet Pirraku, Roli i islamit në integrimin e Shqipërisë etnike dhe të kombit shqiptar, “Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997.
- Nexhat Ibrahim, Muslimanët në Ballkan në periodën paraosmane, Prizren, 1990.
- Nexhat Ibrahim, Kontaktet e para të islamit me popujt ballkanikë në periudhën paraosmane, Logos-A, Shkup, 1997.
- Nexhat Ibrahim, Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve, Logos-A, Shkup, 1999.
- Necip P. Alpan, Prizren Birligi ve Arnavutlar, Ankara, 1978.
- Qemajl Morina, E Vërteta dhe paragjykimet për islamit në botë dhe ndër shqiptarët, “Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997.
- Skender Riza, Kosova gjatë shekujve XV, XVI dhe XVII, Rilindja, Tiranë 1987.
- Sherif Delvina, Tentativë e pasuksesshme dhune fetare, “Rreth përhapjes së islamit ndër shqiptarët”, haz: Muhidin Ahmeti, Aziz Mahmud Hudaji Vakfi, Shkodër, 1997.
- Tarik Kulenović, Islami politik, për: Skënder Latifi, Logos-A, Shkup, 2012.
- Thomas W. Arnold, Historia e përhapjes së islamit, Dituria Islame, Prishtinë, 2004.

*SEVDAIL DEMIRI***RRETH HISTORISË SË SHTYPIT SHQIPTAR NË MAQEDONI (1945-1991)¹**

Periodha e viteve 1945-1991 paraqet një kornizë të një sistemi politik dhe shoqëror nëpër të cilin kaluan fatet e shumë njerëzve me identitete të ndryshme kulturore, gjuhësore e nacionale.

Edhe pse me një ngarkesë të madhe ideologjike të socializmit, përkatësisht komunizmit, në shtypin shqiptar të kohës në periudhën e viteve 1945 – 1991, pasqyrohet i gjithë zhvillimi kulturor, arsimor, edukativ, ekonomik, social e politik i qytetarëve të Maqedonisë, e veçanërisht i shqiptarëve. Në qindra-mijëra e miliona fletë të këtij shtypi, është shkruar fati, e kaluara dhe shpeshherë edhe perceptimi për të ardhmen e shqiptarëve, por dhe i popujve të tjerë që jetonin në atë periudhë, dhe ende jetojnë e gjallërojnë në Republikën e Maqedonisë.

Kur flitet për shtypin shqiptar në Maqedoni në periudhën 1945-1991, mendohet për gazetën e vetme të kohës “Flaka e vëllazërimit“, si dhe revistat që dolën nga gjiri i saj, siç ishin ato për shkollarë “Gëzimi” e “Fatosi”, dhe revista kulturore për të rritur “Jehona”.

Gazeta “Flaka e vëllazërimit“ u paraqit në kohën kur ende në disa pjesë të Ballkanit dhe më gjerë zhvilloheshin luftëra për largimin definitiv të nazizmit. Ishte organ i Shtabit Kryesor të Frontit Popullor të Maqedonisë, e më vonë i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Maqedonisë. Numri i parë i kësaj gazete doli më 4 prill të vitit 1945, kurse rol të madh në arritjen e këtij botimi i përshkruhet Dr. Nexhat Agollit, i cili ishte edhe ministër i Politikës Sociale në Qeverinë e Maqedonisë. Ndërsa, drejtor dhe kryeredaktor i parë i kësaj gazete ishte Dr. Petro Janura, deri kah fundi i vitit 1946. Pas tij, deri në vitin 1991, gazeta u udhëhoq nga punëtorë të tjerë të dalluar shoqëror dhe kulturor, siç ishin: Murteza Peza (në vitet 1946-1962), Resul Shaqiri (1962-1965), Lutfi Rusi (1965-1972), Sejfedin Sulejmani (1972-1974), Xhevat Gega (1974-1978), Rexhep Zllatku (1978-1990), dhe Fejzi Bojku (1990-1991). Ndërsa, deri në mbylljen e saj më 2004, kryeredaktorë të “Flakës” ishin edhe: Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Ahmet Selmani dhe Daut Dauti.

Në fillim gazeta kishte probleme të shumta gjatë procesit të shtypit, me botim jo të rregullt. Duhej të dilte nga shtypi një herë javë, kurse shpeshherë vonohej nga dhjetë ditë, madje edhe deri në dy javë. Që nga viti 1971, “Flaka...” filloi botohej tri herë në javë, por me kalimin e viteve, filloi të rritet numri i lexuesve, sikurse edhe nevoja për përhapjen e informacioneve, dhe bashkë me të

¹ Sevdail Demiri, *Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor*, ITSHKSH, Shkup, 2015.

edhe propagandës politike në mesin e popullatës shqiptare në Maqedoni. Në fillim të botimit, tirazhi i gazetës “Flaka...” ishte 2 - 3.000 copë për numër, kurse në pesëvjetorin e botimit, arriti deri në 7.000 copë. Varësisht nga kushtet dhe rrethanat e krijuara, edhe tirazhi do të pësojë ndryshime të herëpashershme.

Meqë ishte organ i pushtetit, “Flaka...” i ndiqte dhe i prezantonte me kujdes politikat e Partisë Komuniste të Maqedonisë, përkatësisht Jugosllavisë. Por, në periudha të caktuara kohore, veçanërisht pas vitit 1948 (koha e Informbyrosë dhe e diferencimeve ideopolitike), më 1968 dhe 1981 (protestat e shqiptarëve në Kosovë për më shumë të drejta kombëtare), shumë gazetarë e redaktorë u ndeshën me parimet e pushtetit totalitar komunist, dhe mbaruan si viktima nëpër burgje dhe kampe të përqendrimit. Nëpër këto periudha, censura e pushtetit ndaj mendimit të lirë në gazetë, ishte e shprehur jashtëzakonisht shumë në të gjitha fushat.

Por, megjithatë, nëse merret çështja në përgjithësi, në gazetën “Flaka e vëllazërimit” vazhdimisht shkruhej historia e qytetarit shqiptar të Maqedonisë, problemet e tij, nevojat, kërkesat, idetë dhe shpresat për një të nesërme më të mirë. Për këtë, gazeta ishte e pasur me rubrika dhe materialet të llojllojshme, të cilat preknin thellësisht në qenien e shqiptarit. Veçanërisht dallohej rubrika e kulturës dhe e arsimit, e cila ndodhej në një nivel të lartë artistik dhe profesional. Për të shkruanin gazetarë, shkrimtarë, profesorë universitarë e intelektualë të njohur të kohës, siç ishin: Petro Janura, Murteza Peza, Lutfi Rusi, Ali Aliu, Luan Starova, Ramiz Kelmendi, Adem Gajtani, Rexhep Zllatku, Teki Dervishi, Nehas Sopaj, Fejzi Bojku, Jusuf Gërvalla, Xhabir Ahmeti, Shkëlzen Halimi, Nazif Zejnullahu, Ahmet Selmani, Daut Dauti, etj.

Një pjesë e konsiderueshme e gazetës, veçanërisht në pjesën e parë të fillimit të funksionimit të saj, ishte derivat përkthimit të materialeve të ndryshme nga gjuhët që fliteshin në hapësirën jugosllave, si gjuha maqedonase, serbo-kroate, sllovene, boshnjake, turke, etj.

Nga analiza jonë e bërë ndaj përmbajtjes së gati gjithë materialit të botuar shkrimor të gazetës “Flaka e vëllazërimit”, si dhe revistave të saj, gjatë periudhës 1945-1991, kemi vërejtur se këto organe të shtypit kishin një përgatitje të lakmueshme artistike, profesionale dhe obektive, që edhe sot e kësaj dite vështirë se tejkalohej nga gazetatat e revistat tona, të cilat botohen në rrethana dhe kushte shumë herë më të mira dhe më të volitshme.

Më konkretisht, rolin dhe rëndësinë e gazetës “Flaka e vëllazërimit” dhe revistave, për ngritjen kulturore-arsimore të popullatës shqiptare në Maqedoni në periudhën e viteve 1945-1991, mund ta përmbledhim në disa pika:

1. “Flaka e vëllazërimit” ishte ndër institucionet e para dhe të vetme gazetare-botuese të shqiptarëve të Maqedonisë menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, pavarësisht nga korniza e saj ideologjike komuniste;
2. Kronikë shembullore e kohës, dhe shpeshherë zëdhënëse dhe avokate publike e shqiptarëve në Maqedoni;
3. Luftëtare e pakompromis kundër analfabetizmit, si dhe promotore e zhvillimit arsimor-kulturor të shqiptarëve në Maqedoni;
4. Një nga shtyllat kryesore të përdorimit masiv të gjuhës standarde shqipe të shqiptarët e Maqedonisë, madje edhe para Kongresit të Drejtshkrimit të

- Gjuhës Shqipe të mbajtur në Tiranë më 1972, përkatësisht Konsultës Gjuhësore të Prishtinës (1968);
5. Institucion ku lindën dhe u zhvilluan idetë për themelimin e disa institucioneve të rëndësishme kulturore - arsimore shqiptare në Maqedoni, siç ishin: shkollat, shoqëritë kulturo-artistike, klubet, seminarët, teatri, etj.;
 6. Përmes materialeve të ndryshme edukativo-arsimore, përmes rubrikave “Pedagogu” e “Shkollari” të gazetës, e veçanërisht përmes revistave “Gëzimi” e “Fatosi”, ndikoi fuqishëm në edukimin dhe në zhvillimin kulturor, arsimor e intelektual të gjeneratave të reja;
 7. Ndërprerja e botimit të kësaj gazete pas gjashtë dekadave (nëntor 2004), paraqet humbje të madhe për historinë e shtypin shqiptar në Maqedoni, dhe në përgjithësi për historinë e shqiptarëve të këtyre hapësirave.

Si rezultat i zhvillimit pozitiv të gazetës “Flaka e vëllazërimit”, si dhe nga nevoja gjithnjë e më e madhe e gjeneratave më të reja për të pasur në duart e tyre gazetë ose revistë, në vitin 1950, filloi botimin revista për fëmijë “Gazeta e pionierëve”, e cila një vit më vonë u quajt “Gëzimi”, dhe këtë emër do ta bartë deri në fund. Pesë vjet më vonë, përkatësisht më 1955, botohet revista tjetër për shkollarë “Fatosi”. Me këtë konsolidim të revistave për fëmijë – shkollarë, “Fatosi” filloi më tepër t’u shërbejë nxënësve të ciklit të ulët të arsimit fillor (klasa I-IV), ndërsa “Gëzimi” nxënësve të ciklit të lartë të arsimit fillor (klasa V-VIII).

“Gëzimi” ishte revista kryesore, e cila shërbente si literaturë ndihmëse në të gjitha shkollat me mësim në gjuhën shqipe, jo vetëm se në Maqedoni, ku kishte më së shumti shtrirje dhe lexues, por edhe në Kosovë, në Serbi, në Mal të Zi, etj. Në fillim botohej në kuadër të redaksisë së “Detska radost” në Shkup, ndërsa më vonë nga njësia “Flaka e vëllazërimit”. Botohej një apo dy herë në muaj gjatë vitit shkollor. Në këtë revistë u botuan qindra e mijëra krijime letrare e artistike për shkollarë, në një nivel të lartë artistik, andaj kur të shfletohet nga perspektiva e sotme, të lë të mendosh se bëhet fjalë për një antiologji të vërtetë të letërsisë shkollore. Shumë nga ata nxënës – lexues, përkatësisht bashkëpunëtorë të “Gëzimi”-t, më vonë u bënë gazetarë të njohur, shkrimtarë e punëtorë shoqëror. Pra, kjo revistë u bë një fushë-veprimi, ku u përgatitën gjeneratat e ardhshme në profesionet e tyre të ndryshme.

Drejtor i parë dhe kryeredaktor shumëvjeçar i revistës “Gëzimi”, ishte gazetari e shkrimtari i njohur Mehmedali Hoxha, i ndihmuar gjithashtu nga gazetari dhe shkrimtari i njohur Fejzi Bojku. Deri në mbylljen e saj në vitin 2004, kjo revistë u udhëhoq edhe nga Rexhep Zllatku, Resul Shabani, Naxhi Osmani, Shaip Emërllahu, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Islam Saliu, Ahmet Selmani e Lumturije Zajazi. Puna profesionale e bërë me shumë përkushtim, pa dyshim se reflektohej edhe në tirazhin e kësaj gazete, e cila në disa periudha kohore arriti të shtypej madje edhe deri në 20.000 copë.

Në vitin 1955, paraqitet revista e dytë për shkollarë në gjuhën shqipe në Maqedoni, me emrin “Fatosi”. Edhe kjo revistë luajti rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit kulturor-arsimor të popullatës më të re shqiptare në Maqedoni. Botohej një apo dy herë në muaj, dhe dalëngadalë u bë revista më e lexuar shqipe për fëmijë në Maqedoni dhe jashtë saj. “Fatosi” gjatë viteve të shtatëdhjeta të

shkullit të kaluar, arriti tirazh rekord prej 25.000 copësh për një numër, dhe ky tirazh edhe sot e kësaj dite ka mbetur i patejkaluar.

Revista “Fatosi”, në periudhën më të gjatë u udhëhoq dhe u redaktua gjithashtu nga gazetarët e shkrimtarët e dalluar për fëmijë, Mehmedali Hoxha dhe Fejzi Bojku. Pos tyre, si kryeredaktorë (deri në vitin 1999), figurojnë edhe: Lutfi Rusi, Sejfedin Sulejmani, Xhevat Gega, Rexhep Zllatku, Eshref Aliu, Abdylhadi Zylfiqari, Halil Zendeli, Selvie Qoku, dhe Luljeta Jusufi. Në “Fatosi” shkruanin gjithashtu pena të njohura të letrave shqipe, ndërsa shpeshherë linte përshtypjen se madje ishte më e hapur se “Gëzimi” në aspekt të bashkëpunimit me lexuesit e vegjël, të cilët rregullisht i botonin punimet e tyre amatoreske. Kështu, “Fatosi” u shndërrua në një lloj enciklopedi të vërtetë letrare e artistike shqiptare për fëmijë në Maqedoni për shumë vite e dekada.

Më 1962 filloi të botohet revista e njohur për art, shkencë e kulturë “Jehona”, e cila edhe më tepër e begatoi hapësirën gazetarske, duke plotësuar një boshllëk të madh në këtë sferë. Ajo u shndërrua në një agorë të vërtetë të shtjellimit të mendimeve shkencore e profesionale për shumë intelektualë të kohës. “Jehona” arriti që shumë shpejtë të imponohet në rrethet intelektuale shqiptare, andaj edhe fakturoi një tirazh të lakmueshëm ndërmjet 1.000 dhe 1.800 ekzemplarësh, duke u botuar nga 10 herë brenda vitit, në formatin e librit të vogël.

Revista “Jehona” luajti rol të madh në afirmimin e kulturës, letërsisë dhe shkencës ndër shqiptarët e Maqedonisë dhe më gjerë. Në të punuan dhe shkruan intelektualë të njohur, artistë, shkrimtarë e profesorë universitarë, të cilët dhanë kontributin e tyre profesional në fushat përkatëse. Ndër emrat më frekuentues të faqeve të kësaj reviste, dallojmë: Murteza Pezën, Murat Isakun, Petro Janurën, Shukri Rahimin, Mateja Matevskin, Shaban Shehun, Luan Starovën, Ali Aliun, Fejzi Bojkun, Teki Dervishin, Beqir Musliun, Xhevat Gegën, Sejfedin Sulejmanin, Rexhep Zllatkun, etj. Prandaj, edhe mund të thuhet se “Jehona” edhe pse ishte revista e vetme e atij formati në Maqedoni, kishte vlerën e një reviste elitare, dhe me një nivel të kënaqshëm artistik, kulturor e shkencor, e cila kishte një rreth të gjerë të lexuesve dhe bashkëpunëtorëve edhe në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi.

Marrë në përgjithësi, libri me titull “Shtypi shqiptar në Maqedoni 1945-1991, (aspekti kuturor-arsimor)“, paraqet një përpjekje serioze për të pasqyruar historikun e shtypit shqiptar në këto hapësira. Konkretisht, me këtë nënkuptojmë një përpjekje për zbardhjen e rrugës zhvillimore të gazetës “Flaka e vëllazërimit” dhe revistave “Gëzimi”, “Fatosi” e “Jehona”, të cilat për gjashtë dekada me radhë, ishin ndër shtyllat më të forta zhvillimore të të proceseve kulturo-arsimore te shqiptarët e Maqedonisë.

Nëpër faqet e këtij shtypi, është shkruar një variant i gjatë e i gjerë i historisë së shqiptarëve të Maqedonisë, prandaj ato gjithmonë do të na shërbejnë, jo vetëm si pasqyrë, por edhe si udhëzues për shumë e shumë ngjarje, procese e fate njerëzish në ato dekada.

MARENGLËN KASMI**KONICA, LETRA E RRALLË PËR PRINC VIDIN:
MBAJ LARG HAJDUTËT**

Periudha e qeverisjes së Wied-it në Shqipëri (7 mars – 3 shtator 1914) u mbizotërua nga kontradikta të mëdha të brendshme dhe të jashtme.

Konfliktet e brendshme buronin nga heterogjeniteti fetar i popullsisë shqiptare, politikat personale të figurave politike dhe po ashtu edhe nga tentativa e instalimit në Shqipëri të një pushteti ksenokrat. Rivalitetet dhe interesat e ndryshme të Fuqive të Mëdha gjatë Konferencës së Ambasadorëve, para së gjithash të Austro-Hungarisë dhe Italisë, e kishin kthyer Shqipërinë në një «kukull loje».

Këtë gjë e dëshmon edhe përzgjedhja e një figure të panjohur gjermane në krye të shtetit të ri shqiptar, siç ishte Wilhelm zu Wied.

Kushtet dhe situata në të cilën Fuqitë e Mëdha vendosën të krijojnë Shqipërinë ishin shumë më të pafavorshme sesa në vendet e tjera të Ballkanit. Zhvillimi i vonuar social-ekonomik i vendit, niveli i lartë i analfabetizmit, heterogjeniteti fetar, një elitë shqiptare e brumosur me mentalitet turk, mungesa e infrastrukturës dhe prapambetja e shoqërisë shqiptare si edhe konfliktet e armatosura me vendet fqinjë e vështirësonin ngritjen e shtetit shqiptar.

Kandidaturat e paraqitura nga Austria dhe Italia për fronin shqiptar ishin të shumta. Edhe patriotët shqiptarë ishin fillimisht të ndarë mes tyre se cili duhej të ishte mbreti i tyre i ardhshëm.

Një nga mbështetësit e Wied-it ishte edhe Faik Konica. Sipas tij, Wied-i krijonte një përshtypje korrekte, por ajo që për atë dhe shumë të tjerë nuk kuptohej ishte ngadalësia që ai vepronte gjatë përgatitjes për të ardhur në Shqipëri. Ndër të tjera Konica shprehej në një intervistë të dhënë në gazetën “Freie Presse” më 27 janar 1914 se: “[...] Popullit shqiptar i pëlqen Princ Wied-i, si pasojë e cilësive të tij si ushtarak. Le të shpresojmë që, këto cilësi, nuk do të mposhten nga pasiguria dhe hezitimet e një diplomati”.

Konica shkoi në Potsdam [Berlin] në fundvitin 1913 për t’u takuar me Wied-in dhe për ta këshilluar personalisht atë për detyrën e vështirë që ai kishte marrë përsipër. Çfarë e këshillonte ai Wied-in dhe si e vlerësonte Konica Shqipërinë e viteve 1913, del qartë në Kujtesën që ai i dërgoi Wied-it më 9 dhjetor 1913 nga Potsdami, të cilën po e botojmë të plotë:

Kujtesë

***për Lartësinë e tij, Princin Wilhelm zu Wied,
nga Faik Konica, në Potsdam [Berlin] më 9 dhjetor 1913***

Lartësia juaj, Princi Wilhelm zu Wied, që prej momentit që u përzgjedhët sovran i Shqipërisë nga gjashtë Fuqitë e Mëdha, të gjithë patriotët shqiptarë janë gati për t'ju shërbyer me besnikëri e për t'ju ndihmuar në realizimin e detyrës së lavdishme të konsolidimit dhe zhvillimit të kombit shqiptar. Së pari, është shumë e nevojshme që, familja mbretërore, të bëhet e njohur në popull dhe sovranit t'i jepet një autoritet moral që nxit respektin dhe bindjen [përruljen] e popullit ndaj tij. Populli shqiptar, si një nga popujt më monarkikë të Ballkanit, ka tashmë besim të plotë të sovranit të tij i ardhshëm dhe e pret ardhjen e tij si Udhëheqës i domosdoshëm e shpëtimtar, i cili do të dijë ta drejtojë atë [popullin] në rrugën e duhur.

Por, suksesi i kësaj dinastie të re do të varet nga realizimi i idealeve që populli ka krijuar për këtë Princ, gjë që mund të përmblihet me disa fjalë.

Nëse gjatë regjimit turk triumfuan më të shkathtët e më të shpejtët, me regjimin e ri, populli shpreson se do të jetë koha e njerëzve të ndershëm dhe të drejtë. Princi do të bënte mirë të vendoste sinqeritetin në themel të qeverisjes së tij. Pa diskutim, duhet të lihen mënjatë e të largohen gjithë intrigantët që nuk janë të aftë t'i futen punës. Këta njerëz, në vend që të përpiqen për zgjidhjen e problemeve të mëdha të kombit, preferojnë të fshihen në prapaskenat e oborrit mbretëror dhe në momentet e vështira, janë të parët që dezertojnë dhe rendin drejt padronëve të rinj. Favorizimi duhet të zhduket një herë e mirë nga Shqipëria.

Të njohësh njerëzit, ashtu si janë realisht dhe jo si mundohen ta shfaqin veten te miqtë apo armiqtë e tyre, përmbush gjysmën e asaj që anglezët e quajnë "King craft", ose arti i të mbretëruarit. Dhe gjysma tjetër e këtij arti përkon në zgjedhjen e burrave të zotë e të drejtë dhe që bota i njeh si të tillë.

Analfabetët, hajdutët, vrasësit dhe tradhtarët duhen mënjatuar nga shërbimi publik. Kjo vërejtje duket e padobishme, por për fat të keq është e nevojshme. Në mesin e funksionarëve dhe xhandarëve të qeverisë provizore që vuan sot Shqipëria, pjesa e tyre më e madhe nuk di të shkruajë dhe të lexojë. Pothuajse të gjithë janë hajdutë ose vrasës të njohur dhe madje, disa prej tyre, janë kundërshtarë të ashpër të mëmëdheut shqiptar. Mbajtja e tyre në pushtet, ndërkohë që në Shqipëri ka elementë të arsimuar, të ndershëm dhe patriotë të gatshëm për t'i shërbyer atdheut, do të çonte drejt një katastrofë të madhe. Një studim i detajuar mbi lëvizjen tonë kombëtare gjatë këtyre 18 viteve të fundit, duke



Pritja në Durrës për monarkun e ri të Shqipërisë

përfshirë në të goftë personat që kanë luajtur një rol të rëndësishëm për atdheun, goftë spiunët e administratës turke, është më se i nevojshëm për të krijuar një ide të saktë mbi karakteret e shqiptarëve.

Është e rëndësishme të mos harrojmë 2 fakte:

– së pari, vetëm në sajë të nacionalistëve, të cilët arritën të zgjojnë ndërgjegjen kombëtare shqiptare dhe të krijojnë një lëvizje pavarësie duke e paguar këtë me mijëra sakrificë, u bë e mundur që Austria të mbrojtë përpara Evropës tezën e ekzistencës së një kombi shqiptar;

– së dyti, zgjedhja e princ Wied-it u bë e mundur nëpërmjet veprimtarisë aktive përditshme të nacionalistëve, në gazeta, takime si dhe në kongresin e njohur të Triestes të marsit 1913, të cilët mbrojtën dhe forcuan parimin se, princi i zgjedhur, duhej të ishte evropian dhe i krishterë. Pra, populli pret që të jenë nacionalistët ata që gëzojnë vlerësimin dhe besimin e sovranit dhe jo turqit e vjetër apo të rinj.

Tre pika kryesore vihen re në programin e nacionalistëve:

1. Gjuha shqipe si e vetmja gjuhë zyrtare në administratën e vendit.
2. Qeverisja e vendit nga parlamenti.
3. Garantimi i lirisë absolute të shtypit.

Çështja e parë nuk ka nevojë të mbrohet, kuptohet vetvetiu.

Ndërsa për çështjen e dytë, mund t'i trembemi faktit se, Austria dhe Italia, edhe pse nisur nga qëllime të mira, mund të japin këshilla të gabuara, të bazuara në frikën e rremë se në Shqipëri nuk ekziston një opinion publik; dhe për rrjedhojë

mund të krijohet një qeverisje despotike. Sigurisht, këto do të ishin këshilla të mjerueshme, por njëkohësisht dhe shumë të rrezikshme. Absolutisht që Shqipëria ka nevojë për drejtësi dhe vendosmëri në qeverisje dhe jo për despotizëm. Është e vërtetë që, gjatë viteve të para të qeverisjes, një senat, ose asamble këshillimore, i emëruar nga Princi, por i përzgjedhur me kujdes, mund të zëvendësojë dhe të krijojë kushtet për ngritjen e një regjimi parlamentar. Me të gjitha defektet e njohura që mbart, kjo është e vetmja mënyrë për të kanalizuar pakënaqësitë dhe për të ofruar një garanci serioze për dinastinë.



Ceremonia publike e ardhjes së sovranit gjerman në Durrës

Në lidhje me çështjen e tretë, atë të lirisë së shtypit, është për t'u patur parasysh që, çdo përpjekje për ta kufizuar këtë liri do të çonte në krijimin dhe publikimin e gazetave opozitare në kryeqytetet e disa shteteve të vogla fqinje. Kjo opozitë e organizuar tek armiqtë e Shqipërisë, do të ishte shumë herë më e rrezikshme, në krahasim me atë që do të krijohet brenda vendit, pasi kjo e fundit do të ishte më e lehtë për t'u mbajtur brenda kufijve normalë. Kuptohet që ajo [liria e shtypit] duhet të qeveriset nga një ligj serioz mbi shpifjet, siç ndodh edhe në Angli. Nëse sovranin i merr në konsideratë këto pikëpamje, atëherë dinastia do të jetë e sigurt dhe me një popullaritet të qëndrueshëm dhe jetëgjatë. Por, për momentin, ka disa probleme të ngutshme. Është shumë e rëndësishme që Princi të mos zbarkojë në Shqipëri pa qenë i ftuar më parë nga vendi dhe të mos vijë vetëm si një zgjedhje e Fuqive të Mëdha, pasi autoriteti i tij moral mund të vuante pasojë.

Ftesa e popullit shqiptar është e sigurt, por në kushtet aktuale ajo mund të marrë një formë tjetër, në trajtën e një delegacioni të përzierë, me përfaqësues të

gjashtë rajoneve administrative autonome, të cilat janë edhe ndarjet e përkohshme [qeveritë lokale] në Shqipëri.

Thirrja e një asambleje kombëtare për të miratuar përzgjedhjen e Fuqive të Mëdha, do të ishte e rrezikshme për shkak të karakterit anti-katolik që fatkeqësisht, shtypi dhe agjentët italianë, misionarët protestante shqiptarë dhe vetë Esat Pasha, i kanë veshur kandidaturës së Princ Wied-it. Pas pritjes që do i bëhet delegacionit gjithëpërfshirës, Princi duhet të udhëtojë për një periudhë të shkurtër në Krujë, kryeqytetin historik të Shqipërisë, për t'u prezantuar si princi mbretërues, ose më saktë mbreti i vendit, pasi populli shqiptar parapëlqen këtë titull që e mbart prej një kohe të gjatë edhe mbreti i Malit të Zi.

Për sa i përket karakterit prestigjioz, zbarkimi i princit duhet të shoqërohet me shumë shkëlqim dhe pompozitet. Është shumë e domosdoshme gjithashtu, që anijet austriake dhe italiane të shoqërohen të paktën nga një luftanije angleze. Pas një vizite 2-3 ditore në Krujë, Princi mund të zgjedhë lirshëm kryeqytetin e përkohshëm të Shqipërisë. Për këtë, Durrësi është një qytet që i rekomandohet në mënyrë të veçantë Lartësisë Tuaj për shkak të pozicionit gjeografik qendror të tij. Për çdo rast, nëse Princi nuk dëshiron të bëhet lojë në duart e disa intrigantëve dhe kryehajdutëve, të cilët kanë mbushur me njerëzit e tyre radhët e policisë dhe xhandarmërisë, i duhet kërkuar Fuqive të Mëdha që të vendosin në kryeqytetin e përkohshëm shqiptar një garnizon të trupave ndërkombëtare të Shkodrës. Mendoj që një batalion është i mjaftueshëm.



Wiedi në Durrës, në qendër Esat Pasha

Pasi të gjitha këto të jenë vënë në vijë, Princi duhet të emërojë personalisht dhe individualisht disa ministra, për secilin departament. Për disa arsye, të cilat pata nderin t'i paraqes gojarisht dhe mendoj se janë të tepërta për t'i përsëritur këtu, për momentin është e pamundur të ngarkosh një njeri të vetëm për formimin e një

kabinet homogjen. Emërimi i një kryeministri do të sillte shumë vështirësi. Për momentin do të ishte e preferueshme të zgjidhen ministra pa lidhje direkte me njëri-tjetrin, të kryesuar nga shefi i shtetit, siç është rasti i SHBA-së.

Në rast se kjo ide nuk ju duket praktike, atëherë mund të përzgjidhet si kryeministër pa portofol një njeri i njohur si i paanshëm, siç është pronari i madh, Omer Pashë Vrioni. Për të thuhet se është i ndershëm, por paaftësia e tij është e njohur dhe këshillat e tij në përzgjedhjen e ministrave do të ishin pa vlerë.

Nuk do t'ju kujtoj argumentet e mia në favor të përzgjedhjes së një kryeqyteti tërësisht të ri. Kjo çështje do të diskutohet në thellësi kur të vijë momenti i duhur dhe do të jetë objekt i një kujtese speciale që do të kem nderin t'i parashtrij Lartësisë Tuaj.

Berlin, 9 dhjetor 1913

Nënshkruar nga Faik Konica

Kush ishte Wilhelm zu Wied?

Wilhelm zu Wied lindi më 26 Mars 1876 në Neu Wied. Më 3 Qershor 1897, në moshën 21 vjeçare, ai nisi karrierën ushtarake si nëntoger në regjimentin e 3-të të kalorësisë së Gardës Prusiane, në Potsdam. Ky regjiment ishte i njohur për numrin e tij të madh të oficerëve me origjinë nga familjet e larta aristokrate gjermane. Madje edhe vetë Perandori Wilhelm II kishte shërbyer në të.

Wied-i u përshtat shumë shpejt në jetën ushtarake. Ai gëzonte respektin e shokëve dhe vartësve të tij. Po ashtu edhe në jetën civile, ai shfaqej i matur, i kujdesshëm dhe shquhej për drejtësinë e tij.

Më 30 nëntor 1906 ai u martua me Princeshën Sophie von Schönburg-Waldenburg (*Sofi fon Shënbürg-Valdenburg*). Martesa dhe detyrat e tij në regjiment, nuk e penguan atë të përgatitej dhe të kalonte me sukses provimin e pranimit në Akademinë e Luftës. Më 19 Dhjetor 1907, Wied-i mori gradën e togerit dhe më 20 Mars 1911 gradën e kapitenit. Në Potsdam lindën edhe dy trashëgimtarët e familjes Marie Eleonore (*Mari Eleonore*) dhe Carol Viktor (*Karl Viktor*).

Pas përfundimit me sukses së Akademisë së Luftës në Berlin, e cila zgjati tre vjet, Wied-i u kthye përsëri në regjimentin e tij. Pak kohë më vonë, pasi u gradua kapiten, ai u emërua në Shtabin e Përgjithshëm në Berlin.

Pas disa vitesh shërbimi në Shtabin e Përgjithshëm, ai u kthye përsëri në Potsdam si «*Rittmeister*» (*kapiten i kavalerisë*) dhe u emërua komandanti i një skuadroni në po të njëjtin regjiment që kishte qenë dikur. Propozimi për të marrë kurorën e Shqipërisë e gjeti Wied-in në këtë detyrë.

Gjatë ceremonisë së largimit nga regjimenti, Wied-it ju dha grada «*Major à la suite*». Kjo do të thoshte që Wied-it i lejohej të vishte uniformën ushtarake, por që nuk ishte më pjesë organike e repartit të tij. Më tepër ky ishte një titull nderi që jepej për aristokracinë gjermane, të cilët, në raste të caktuara, pas largimit nga shërbimi aktiv, u lejohej të vishnin uniformën e tyre.

100 THËNIET MË TË BUKURA TË FAIK KONICËS

Se Faik Konica ishte intelektual i papërsëritshëm shqiptar, dëshmi janë edhe thënie e mëposhtme, që u mblohdën, u përkthyen dhe u përgatitën për botim nga Fotaq Andrea.

1. Njeriu fillimisht i sheh gjërat ashtu siç janë, dhe më pas u jep pamjen e asaj çka ai do dëshironte të ishin (Albania 4, 1906).
2. Të verbrit do të mbeten të verbër in sæcula sæculorum (gjer në fund të botës); edhe sikur t'u shtini perona në sy, ata prapë nuk do shohin kurrgjë. (Albania 1, 1897).
3. Grekët kanë një armë të frikshme: pabesinë (Albania 2, 1897).
4. E vërteta nuk ka nevojë për stil gjarpërues e të yndyrshëm të shkrimeve akademike. (Albania 2, 1897).
5. Ka qenie tek të cilat ndjenja e humorit nuk e ka forcën e duhur (Albania 2, 1897).
6. Fisnikëria dhe thjeshtësia mund të jenë cilësi kudo gjetkë, kurse në poezi janë antipasta të dëmshme. Çka i kërkohet poetit, poetit të vërtetë, është të shkaktojë një dridhmë të re, të flasë një gjuhë që të tjerë nuk e kanë folur, të ngacmojë ndijime që të tjerë nuk i kanë. (Albania 2, 1897).
7. Bijtë e shqipes nuk merren vesh me bijtë e gjarprit (Albania 2, 1897).
8. Gazetarët janë njerëz spiritualë dhe të dashur (Albania 5, 1897).
9. Xhelat je se të pëlqen të jesh (Albania 8, 1897).
10. Një i mbushur me mllef e mëri, në mendjen e tij anemike, rrokullis mendime të tmerrshme (Albania 9, 1898).
11. Nga lartësia e pedestalit ku zuzarët kapardisen me poza gjysmë-perëndish, ne do t'i asgjësojmë me një të goditur. A bon entendeur, salut! (Kush të dojë, le ta kuptojë) (Albania 9, 1898).

12. Drejtësia i takon fushës së ëndrrave; vetëm forca mbisundon (Albania 11, 1898).
13. Politika e vërtetë qëndron në kapjen e drejtimit të një evolucioni të caktuar dhe në përpjekjen për të ndihmuar në përsheptimin e fundit të tij (Albania 11, 1898).
14. Një shkrimtar duhet gjykuar më shumë nga cilësia se sa nga sasia (Albania 11, 1898).
15. Popujt që ushqehen me perime e produkte qumështi kanë përgjithësisht zakone shumë të buta. (Albania 11, 1898).
16. Një popull që është i paaftë të afirmojë vitalitetin e vet, është në rrugë të pashmangshme tatëpjete (Albania 16, 15-30 korrik 1898).
17. Ka mënyra të ndryshme për t'i shërbyer një vendi dhe gjithkush i shërben në mënyrën që i përshtatet më mirë karakterit të tij. (Albania 16, 15-30 korrik 1898).
18. Të përpiqemi me të gjitha forcat tona të shërojmë shqiptarët nga dashuria për individët. Ata duhet të mësojnë të duan Shqipërinë – jo për t'i bërë qejfin këtij apo atij shqiptari (Albania 16, 15-30 korrik 1898).
19. Sharjet e kundërshtarit të nderojnë (Albania 16,15-31 korrik 1889).
20. Ka njerëz që shiten tek një qeveri për të pështyrë gënjeshtër. (Albania 16,15-31 korrik 1898).
21. Ai që i bën vërejtje dikujt si i edukuar keq, tregon nga ana e tij një edukim të paktën po aq të keq. (Albania 16,15-31 korrik 1898).
22. Mund të jesh njeri vulgar e të thuash do gjëra të arsyeshme (Albania 16,15-31 korrik 1898).
23. Më mirë të jesh një i egër i ndershëm, se sa një i qytetëruar i poshtër (Albania 16,15-31 korrik 1898).
24. Të gjitha vendet kanë tradhtarët e tyre të ndyrë (Albania 24, 15-28 shkurt 1898).
25. Lëvdata shpesh e ka brenda prapamendimin. (Albania 26, suplement 4, 5-30 prill 1899).

26. Pakorrigjueshmëria e një alkooliku është simptoma më e njohur e një çrregullimi mendor (Albania, 15-30 qershor 1899).
27. Ka shpesh personazhe vlera e të cilëve, zmadhuar nga larg, shfaqet më e vogël tek shihet nga afër. (Albania, 10 shtator 1900).
28. Nuk mund të gjykohet për tokën para se të mbjellësh (domethënë: toka e mirë njihet kur hedh farën (Albania, 31 maj 1901).
29. Shumë broçkulla edhe u falen politikanëve, por pa kaluar kufijtë (Albania 20 qershor 1901).
30. Sa më shumë të mbahen fjalime parlamentare aq më i paktë është zotimi (Albania 20 qershor 1901).
31. Historia nuk është veçse një rifillim i përjetshëm (Albania, 10 korrik 1901).
32. Historia na mëson se gjithë ndryshimet politike kanë pasur përherë këta dy faktorë: emigrantët dhe një elitë të vogël, e lindur apo intelektuale, brenda vendit (Albania, 15 shtator 1901).
33. E sa ia vlen të vazhdosh një diskutim të rëndomtë përpara një qëndrimi kokëfortë? (Albania, 15 tetor 1901).
34. Është krim të trazosh lumturinë e budallait (Albania, 9janar 1902 f. 24 G).
35. Kush jeton me fjalë dhe përkundet me ninulla fjalësh, s'ka pse ankohet e të na lëshojë britmat e veta të zakonta prej palloi (Albania, prill-maj 1902, G, f. 113).
36. Popujt e Ballkanit janë të gjithë me mentalitet të kufizuar (Albania, shkurt 1903).
37. Urrejtja partiake shpesh merr përparësi ndaj instinktit kombëtar (Albania 2, 1904).
38. Për të gjykuar mirë një njeri që ka pjesë në histori, duhet t'a gjykojmë jo mbas mendimeve të kohës së sotme, po mbas kohës ku ay vetë u rrit, u suall e roiti (Albania, nr.2, 1902).
39. Koha kur rrojmë është koha e reklamës, dhe nuk duhet të çuditemi kur shohim mediokritetet e vëndit t'onë të hidhen përpara, dhe përpara, dhe përpara, duke mos bërë vënt përveç për shokë në shkallë (të caktuar) mëndore të tyre. (Albania 1, 1909).

40. Njerëzit e paditur, në shumicë, rrojnë më tepër se të diturit, se këtyre u punon nat' e ditë mëndja, e ashtu u priset më shpejt organizmi (Albania 5, 1899).
41. Ka njerëz që shitën në guverna për të pështyrë gënjeshtër. Ka të tjerë që marrin ndihmë nga një guvernë për të thënë të vërteta që ndryshe nuk mund t'i thonë (Albania 2, 1899).
42. Kur e nget një njeri, s'ke të drejtë t'i thuash pse më nget (Albania 2, 1899).
43. Frika të bën të thuash broçkulla (Albania 4, 25 qershor 1897).
44. Instinkti kombëtar është konkluzioni që një popull nxjerr nga shumë shekuj përvojë. Ky instinkt nuk të gabon asnjëherë (Albania 3, 1904).
45. Kur nuk ka vepra konkrete, ka retorikë (Albania, 4 prill 1904).
46. Atje ku nuk ka as forcë të brendshme në lëvizje, as interesa të jashtme në lojë, thashethemet e disa gazetarëve të huaj nuk mund ta çojnë përpara as edhe një jota zgjidhjen e një problemi politik (Albania 5, 1905).
47. Frikacaku i ka tërë karakteristikat, dhe kryesisht këtë: hakmerret ndaj përbuzjes së tjetrit nëpërmjet sharjes. I pafuqishëm, veç flet keq e shan poshtërsisht të tjerët (Albania 5, 1905).
48. Rinia është e çiltër dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve (Albania 5, 1905).
49. Padurimi shoqërohet gjithnjë nga dështimi (Albania 5, 1905).
50. Më mirë shtrëngo rripin denjësisht, se sa të pëllasësh nga uria (Albania 5, 1905).
51. Kur tinzarinë e përdor si diplomaci, poshtërsinë si shkathtësi, harbutërinë si forcë, domosdo të duket vetja i papërballueshëm. Por betohem për kamxhikun e Skënderbeut se në rastin më të parë do të bëj të ndërrosh mendim! (Albania 5, 1905).
52. Rrallë mund të jesh profet i keq po qe se parathua vetëm gjëra me shumë gjasa (Albania 6, 1905).
53. Gjërat tepër qesharake zbavitin edhe më budallain (Albania 6, 1905).

54. Ka pasur në çdo kohë, dhe përherë do ketë individë të gatshëm për të folur e shkruar lidhur me çështje për të cilat nuk ia kanë haberin të shprehin as fjalën e parë. Por për mendjet e matura, të etura për të studiuar seriozisht një vend e një popull, nuk ka dhe nuk do të ketë veçse dy metoda në përdorim, jashtë së cilave gjithçka tjetër nuk është veçse mashtrim: metoda e parë ka të bëjë me ndërmarrjen e udhëtimeve për të bërë anketime të hollësishme e sistematike drejtpërdrejt në vend; e dyta, me leximin sa më shumë që të jetë e mundur të broshurave e librave të lidhura me çështjen konkrete, me qëllim që të arrihet nëpërmjet induksionit – përmes një morie dokumentesh, faktesh dhe pohimesh kontradiktore – të veçohet e vërteta dhe të koordinohet një tërësi pikëpamjesh të qarta e objektive (Albania 6, 1905).
55. Cilësitë që zakonisht shoqërojnë pafajësinë janë natyrshmëria, mosinteresimi dhe butësia (Albana 4, 1906).
56. Besimi është aritmetika e idealistëve, që i bën të besojnë se gjashtë egoizma të forta janë baras me një bujari të plotë (Albana 4, 1906).
57. Çlirim i një populli nuk do të thotë liri e tij duke skllavëruar një tjetër (Albania 11, 1907).
58. Nuk mund të lexohet nëpër rreshta ajo çka nuk ekziston (Albania 11, 1907).
59. Pa dyshim, çdo parti ka të drejtën, madje dhe detyrën të shtojë radhët e veta në dëm të atyre që i kundërvihen (Albania 5, 1907).
60. Nuk mund të pretendosh të përfitosh nga tërë dobitë e lirisë, duke ruajtur njëkohësisht tërë privilegjet e tiranisë. Për të pasur institucione të lira, duhen luftuar mendimet nëpërmjet mendimeve (Albania 5, 1907).
61. Dallimi në kulturë shpjegon dallimin në mendime (Albania 5, 1907).
62. Koncepti i turqve për qytetërimin kufizohet thjesht në përdorim pomdash dhe në spërdredhje çupëlinash (Albania 12, 1909).
63. Urrejtja nuk çarmatoset nëpërmjet heshtjes e asnjësisë (Albania 12, 1909).
64. Fjala e urtë e njohur : “gjithkush sipas shijes së vet”, mbetet përjetësisht e vërtetë (Albania 7, 1905).
65. “Patriotët” e aty-këtushëm janë duke e bërë qesharak patriotizmin me lloj-lloj maskarallëqesh e lloj-lloj teprimesh të shpëlara (Albania 1, 1905).

66. Botëkuptimi i një patrioti të vërtetë : të ngjallësh tek kombit tënd – me shijen e mendimit intelektual dhe me ndjenjë të fuqishme dinjiteti kombëtar – dëshirën e zjarrtë për përparimin e shoqërisë në kuptimin e plotë të fjalës. Ksenofobia, as që ishte pjesë e natyrës së patriotit. Ashpërsia dhe poshtërsia s’kanë si të jenë detyra patriotike. E megjithatë, gjithkush është i lirë të dojë a të urrejë, ose thjesht të jetë moskokëçarës (Albania 1, 1905).

67. Rinia është në sytë e injorantëve kërcënim për të ardhmen; por është edhe është rrezik për të tashmen, sepse rinia është e çiltër, ndërkohë që dhe çiltërsia është armiku i natyrshëm i sharlatanëve (Albania 5, 1905).

68. Përsosuria absolute nuk ekziston në një gjuhë që vetëm flitet; u takon shkrimtarëve për ta përpunuar (Albania 5, 1905).

69. Guximi i tepruar shkon gjer në krim (Albania 6, 1905).

70. Shumica e atyre që kanë marrë mbi vete misionin modest “të ndriçojnë opinionin publik” as që kanë ndjesinë më elementare ta nisin fillimisht nga vetvetja për t’u mirinformuar. Venë e vënë në përdorim mënyra hulumentimi të cilat, sikur të zbatoheshin në çdo shkencë, do bënin për të qeshur edhe një nxënës shkolle (Albania 6, 1905).

71. Ka pasur në çdo kohë, dhe përherë do ketë individë të gatshëm për të folur e shkruar lidhur me çështje për të cilat nuk ia kanë haberin të shprehin as fjalën e parë (Albania 6, 1905).

72. Nëse shfaqem se mbaj ndonjë rezervë, do thosha se të mbash rezerva në disa raste, do të thotë gjithashtu edhe të lëvdosh. Ndaj një shkrimtari me nivel intelektual dhe talent, paanshmëria është një formë epërsie e nderimit (Albania 4, 1906).

73. Për mungese kulture, besimet, ashtu si dhe idetë, vdesin (Albania 4, 1906).

74. Respekti ndaj pronës private është një virtyt i vështirë, zbatimi i të cilit gjithmonë ka kërkuar ndërhyrjen dhe ndihmën e mirëmbajtësit të rregullit (Albania 4, 1906).

75. Turqit janë një popull oriental e teokratik, nomadë dhe pushtues. Brenda këtij karakteri të katërfishtë ndodhet çelësi i krejt historisë së tyre (Albania 4, 1906).

76. Nuk ka despotizëm më të keq se sa njëfarë idealizmi dogmatik, që përbuz si përvojën, si faktet dhe gjithçka tjetër që prish simetrinë e thjeshtë të koncepteve a priori (Albania 4, 1906).

77. Cilësitë që zakonisht shoqërojnë pafajësinë janë natyrshmëria, shpërfillja dhe butësia (Albania 4, 1906).

78. Të lehtësosh mjerimin e kundërshtarëve tanë është një veprim i meritueshëm. Të mbështetësh pretendimet e tyre politike është të bëhesh bashkëfajtor i një pabarazie. Të nxitësh lëvizjen tonë është të ndihmosh për një vepër nga më fisniket: çlirim i një populli nuk do të thotë liri e tij duke skllavëruar një tjetër (Albania, vëll XI, 1907).

79. Dëshira për hakmarrje është susta më e fuqishme e shpirtit shqiptar (Albania 4, 1907).

80. Zgjidhja ideale do të ishte për shqiptarët të zhduknin njëherë e mirë ndikimet orientale, duke shkëputur çdo lidhje, fetare, morale apo letrare qoftë me bizantinët, qoftë me turqit. Mirëpo, gjë e bukur të ndodhte kjo në çast. Zgjidhja do ishte e realizueshme po qe se stërgjyshërit tanë do ta kishin përgatitur me kohë për ne; atëherë neve do të na duhet ta përgatisim këtë zgjidhje për nipat tanë të ardhshëm (Albania 2, 1907).

81. Çdo aleancë duhet të bëhet mbi bazën e parimit do ut des (më jep, të të jap) (Albania 2, 1907).

82. Urrejti nuk çarmatoset nëpërmjet heshtjes e asnjësisë (Albania 12, 1909).

83. Shkenca e edukimit është shkenca e së ardhmes, e para nga të gjitha, duke qenë se është motori i krejt të tjerave (Ese për edukimin hyrje).

84. Individë të dënuar me sëmundje të pashërueshme, të çfarëdo natyre qofshin, nuk ka si ta shohin veten të zhveshur nga një epush që ndez instinkti (Ese për edukimin).

85. Fëmija qan dhe bërtet për dy arsye: herë ngaqë ka gjumë a vuan, dhe vihet re kollaj duke përdorur këtë apo atë ilaç që i përshtatet, herë ngaqë nuk bën gjë tjetër – falë një instinkti të mrekullueshëm – veçse ushtron zërin e tij. Dhe në këtë rast të fundit duhet lënë të vazhdojë në punë të vet.

86. Një nga detyrat më të vështira të edukimit ka të bëjë me atë që unë do ta quaja pa frikë kundër-trashëgimia. Ashtu sikurse ka kundërhelme, ka në fakt edhe një trajtim psikik për të zbutur apo zhdukur – sipas shkallës së qëndresës që shfaqin– të metat, pasionet apo veset e trashëguara. (Ese për edukimin).

87. Mendimi i lirë nuk i nënshtrohet asnjë sektarizmi; pasioni antifetar, më shumë nga ateizëm, nuk është veçse një devotshmëri zvetënuese. Ateizmi është asnjësisia. (Ese për edukimin).

88. Zotërimi i shumë gjuhëve është për një të njeri të shkretë një armë e mirë dhe municion shumë i mirë... Gjuha njihet vetëm kur mund të mendohet nëpërmjet saj. (Ese mbi edukimin).

89. Edukimi është shkencë, shkenca e parimeve më të përgjithshme për zhvillimin e plotë të mendimit njerëzor. (Ese për edukimin).

90. Qartësia apo paqartësia, saktësia apo pasaktësia e ideve dhe e mendimeve, qëndrimi ndaj veprimeve të jetës varen shpesh nga metoda e mirë apo e keqe e të menduarit, ose thjesht, nga mungesa e çdo lloj metode. Edukimi, me një fjalë, s'është gjë tjetër veçse si t'i mësohet fëmijës të veprojë në jetë vetëm pasi të mendojë, të mendojë vetëm pasi të arsyetojë dhe të arsyetojë vetëm metodikisht dhe nëpërmjet një metode të mirë, domethënë shkencore. (Ese për edukimin).

91. Qeni tund bishtin, kurse njeriu duartroket. Është, si tek njëri dhe tek tjetri, një mënyrë për ta bërë të dukshme kënaqësinë që ndjejnë. (Skice metode për t'u duartrokitur).

92. Moda, sot, është drejt artificiales. (Ese për gjuhët artificiale).

93. Gjuha përfaqëson, me një besnikëri të përkryer, metodën mendore të një populli, mënyrën e tij të zakonit për të përcjellë idetë. (Ese për gjuhët artificiale).

94. Tek harrojnë të djeshmen, tek përbuzin të ardhmen, bohemët jetojnë të përditshmen dhe vetëm e tashmja u intereson. (Ese për gjuhët artificiale).

95. Jeta e njeriut nuk është veçse një vijimësi mendimesh dhe veprimesh, të drejtuara qoftë mendimet, qoftë veprimet në një mënyrë të caktuar. (Ese për gjuhët artificiale).

96. Gjuha është një tregues i sigurt i gjendjes qytetëruese të një populli... sa më shumë përgjithësohen tek një popull mirësjellja, takti dhe ai qëndrim i përmbajtur për të respektuar rregullat e vendosura në një shoqëri të zhvilluar, aq më shumë pasthirrat priren drejt zhdukjes. Si të tilla, tek formonin fjalorin e njeriut të egër primitiv, teksa i shohim në përdorim aq të dendur midis popullatave të Afrikës moderne, teksa ende çmohen në letërsinë e racave të ngrohta dhe komunikuese të Jugut, pasthirrat nuk janë më veç një kujtim disi qesharak ndër shkrimtarët gjithë elegancë të shumicës së vendeve të Veriut. (Ese për gjuhët artificiale).

97. Detyra parësore, detyra e vetme e përkthyesit është të ketë një dije dhe një ndjeshmëri të tillë sa të mund të shohë e të ndjejë krejt mprehtësitë dhe ngjyrimet e tekstit origjinal, të shohë e të ndjejë idenë e autorit, as më lart e as më poshtë, si dhe ta japë përkthimin në mënyrë të tillë që të veprojë në trurin dhe nervat e lexuesit në masë të njëtrajtshme. (Ese për gjuhët artificiale).

98. Arti për të depërtuar në ndjeshmërinë e lexuesit është stili. (Ese për gjuhët artificiale).

99. Ironia, kjo bimë me aromë të këndshme e të lehtë. (Ese për gjuhët artificiale).

100. Ritmi ndihmon më shumë se gjithçka për t'i dhënë stilit shfaqjen e lëvizjes dhe të jetës. Është qarkullimi i gjakut dhe rrahja e zemrës. Andaj dhe është karakteristika më vendimtare e shkrimtarit të vërtetë

*NAZI NELAJ***EMRAT E NJERËZVE DHE SIMBOLET E TYRE**

Si kudo, edhe në Kalivaç të Tepelenës, emrat e burrave e të grave janë domethënëse e të ndryshëm. Në çdo rast, emrat e njerëzve simbolizojnë diçka, evokojnë e i bëjnë jehonë një gjëje. Në kohë të ndryshme, edhe emrat nuk kanë qenë të njëjtët. Me zhvillimin e shoqërisë njerëzore edhe emrat e tyre kanë evoluar e janë përsosur. Kësisoj, mund të thuhet se emrat e njerëzve mbajnë vulën e kohës. Ata, në fund të fundit pasqyrojnë një realitet të caktuar e diçka të thonë.

Gjithsesi, emrat e njerëzve, në Kalivaç, u përshtaten nivelit, dëshirave, mentalitetit e psikologjisë të banorëve të trevës. Kalivaçiotët, në tërësi janë njerëz me vizion e interesa të gjëra; në çështjen e emërtimeve ata e hedhin vështrimin përtej “gardhit të tyre”. Prandaj në këtë çështje, ata kanë qenë origjinalë e të larmishëm. Në lashtësi, të paktën para pushtimit të gjatë osman, emrat e njerëzve në Kalivaç kanë qenë thjesht shqiptarë ose me domethënie pagane. Më pas, nën pushtimin e huaj, edhe emrat e njerëzve nuk mund tu shpëtonin influencave anadollake. Në vitet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare e në kohën e luftërave të pareshtura për pavarësinë e vendit, emrat e njerëzve janë dominuar nga simbolika atdhetare e fryma luftarake e vendasve. Në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, e, pas saj, emrat kanë shprehur besnikërisht cilësitë luftarake të protagonistëve të atyre ngjarjeve të mëdha. Më pas, gradualisht me ecjen përpara të jetës dhe me evoluimin e shoqërisë, në Kalivaç, simbolika e emrave të njerëzve i është nënshtruar procesit të zgjerimit e përsosjes.

Një emër njeriu mund të pasqyrojë një dëshirë të familjarëve të porsalindurit, të jetë një urim për më të mirën, të jetë pasqyrim i një vetie a virtyti njerëzor, mund ti bëjë jehonë bukurisë apo pamjes së jashtme të hijshme njerëzore, të simbolizojë një vend të mirënjohur, një pemë, një lule etj. Në ditët tona, emrat e njerëzve, gjithashtu janë simbole e mbajnë vulën e kohës, të një kohe tjetër, ku jeta gëlon me të gjithë larmishmërinë e saj e me gëzimet që sjell. Pa harruar faktin se, edhe në ditët tona, ndikimet e huaja nuk janë të shmangura.

Parë në tërësinë e tyre, emrat e femrave në Kalivaç të Tepelenës i kanë bërë e i bëjnë jehonë bukurisë dhe brishtësisë të seksit delikat. Në fund të fundit, kur lind vajzë, familjarët e saj e emërtojnë me atë emër, i cili tregon si e duan të jetë ajo. Sa i përket simbolizimit të bukurisë femërore, të preferuar janë emrat; Perri, Bukuri, Nuriye, Nurisha, Nure, Inxhi, Diliko, Stoli, Xhikëetj. Ose vajza krahasohet me monedhat të përgatitura nga metale të rrallë, si; Florie, Floreshë, Florika, Florina, Rubije, Inxhi, Mexhite, Lirë, Esmë etj. Shumë prindër i kanë personifikuar bijat e tyre si lule. Në fshatin tonë nuk janë të paktë emrat që i bëjnë jehonë mbretërisë të luleve. Më të përhapur janë emrat; Gonxhe, Burbuqe, Lule, Lulushe, Trëndelinë, Manushaqe, Trëndafille, Zymbyle, Menekshe, Vjollcë, etj. Kur është fjala për t'i bërë jehonë shtatit të femrës, kalivaçiotët e kanë krahasuar këtë

me një pemë. Më së shumti bien në sy emrat; Selvi, Hava, Bajame, Dafinë, Shegë, Nerënxë, etj. Të pëlqyer janë emrat me simbolikë shpendë të bukur si; Thëllëzë, Dallëndyshe, Pëllumbeshë, Flutur, Shqiponjë, Gjeraqinë etj. Nuk janë të paktë emrat e femrave që shprehin një dëshirë të mirë apo një synim që duhet arritur në jetë. Në mjaft raste synohet të arrihet një pasuri, një mirëqënie e caktuar, Kjo dëshirë është një urim që i bëhet gruas së ardhshme, e cila nuk duhet ta kalojë jetën në skamje, si paraardhësit e saj. Në dukje dalin emrat; Bejlere, Zengjine, Bejushe, Bejeko, Bejaze, Xhiko, Xhane, Zonjë, Balle, Shpresë, Rronjë, Jetë, etj. Në këtë simbolikë janë emrat; Fatbardhë, Fatmirë, Fatime, Fati, Haire, Gëzime, Behare etj. Pas çlirimit të vendit, në vitet e Diktaturës së Proletariatit, morën përparësi emrat; Liri, Lavdije, Lumturi, Lutfije, Lana, etj.

Në ditët tona, disa emra të vjetëruar, të cilët ishin rezultat i presionit të kulturës dhe mënyrës së jetesës të pushtuesve të huaj, tashmë janë kapërcyer e braktisur. Sot, rrallë gjen emra të tillë si; Merushe, Shajbi, Avize, Zybë, Fetije, Hançe, Ruhije, Melaize, Zadeko, Hanko, Xhipe, Tajane, Sado, Tabene, Zylfi, etj. Në vend të tyre kemi disa emra të rinj si; Lejla, Behije, Aishe, Eranda, Silvana, Shpresa, Miranda, Marcela, Elima, Deko, Liljana, etj. Në Kalivaç gjen dhe emra femrash të sjella nga lashtësia. Mund të përmëndim emrat Donikë, Teutë, etj. Ose emra të cilët tregojnë prejardhjen të krishtere të trevës, si; Sofije, Vitori, etj. Krahas emrave të burrave si Gjonlekë, Sotir, Vasil, etj.

Me interes për tu interpretuar janë disa emra femrash me të cilët familjarët, të mërzitur nga prania e shumë femrave në familje, urojnë që lindja e re të jetë e fundit e këtij lloji. Të tillë simbolikë kanë emrat; Sose, Mjaftoni, Mbetë etj.

Tjetër simbolikë kanë emrat e meshkujve në Kalivaç. Në mënyrë të pakundërshtueshme, emrat e burrave “meshkujve”, evokojnë tipare burrërore. Kalivaçiotët i duan meshkujt të fortë, të shëndetshëm, të ashpër, trima, guximtarë, të pamposhtur, dhe krenarë. Në simbolikën e emrave mashkullorë bie në sy krahasimi i tyre me malet, si; Malo, Golik, Gramoz, Shkëlzen, etj. Të shumtë janë ata që uvenë djemve të sapolindur emra trimash, si; Kastriot, Skënder, Gjergj, BAFTJAR “ PëR Bato”, ose emra drurësh, si; Rrapo e sendesh të fortë si; Guri, çelnik, Hekuran, etj. Disa i krahasojnë fëmijët e tyre me planetë, si; Ylli, Hëno, etj. Të tjerë i duan djemtë tu bëhen të fuqishëm e të shkathët, si kafshë të egra, të fuqishme ose si shpendë grabitqarë, gjithashtu të tillë, si; Asllan, Luan, Sokol, Petrit, Fatos, Levend, etj. Nuk mund të lëmë jashtë vemendjes disa emra meshkujsh që shprehin një udim apo dëshirë të mirë, si; Gëzim, Bashkim, Kujtim, ëngjëll, Fatmir, Besnik, Vezir, Besim, Lavdosh, Hajri, Sajmir, etj.

Sot, në fshatin Kalivaç të Tepelenës, me ndryshimet që ka pësuar jeta e njerëzve janë bërë simbole të këtij ndryshimi. Ndryshe nga emrat e së kaluarës, të cilët ishin influenca të mentalitetit të pushtuesve të ndryshëm, disa emra nuk preferohen më. Si të thuash, ata janë harruar e njerëzit, në të përditshmen nuk u referohen më. Të tillë janë emrat; Mehmet, Kamber, Banush, Brahush, Adush, Jashar, Kahreman, Muhedin, Sadedin, Durkë, Cano, Caush, Sherif, Xhevit, Aqif, Pasho, Selim, Manxhar, BAJRAM, Novruz, Hydai, Xheladin, Xhaferr, etj, emra, të cilët, haptazi janë rezultat i ndikimeve osmane, më vonë, nën pushtimin sllav të trevës u dukën dhe emra të tillë si; Vladimir, etj. Në kohën e afrimit me sovjetikët

ishin të shpeshtë emrat BASHKIM, Çapajev, Natasha, Katjusha, Tatjana, Svjetllana etj. Por, dhe në emrat e kohës së sotme, në mjaft emra ndihet influenca e emigracionit. Tek emrat mashkullorë si Ledio, Fredi, Arian, Orion, Edmond, Armando, Silvio, Franko, Franc, Toni “ Elton” etj, kjo influencë është e dukshme. Emigracioni ku kalivaçiotët janë ndodhur shpesh, ka pas ndikimin e vet, pozitiv e negativ edhe për sa u përket emrave. Por, sita e njerëzve ka bërë e bën seleksionimin e nevojshëm. Sot, emrat e meshkujve që dominojnë skenën janë; Agim, Ilir, Dritan, Alban, Arbër, Ermir, Ermal, Ervin, Astrit, Pëllumb, Pajtim, Besim, Besnik, Bekim, Karafil, etj. Këta jenë emra të mirëfilltë shqiptarë. Në Kalivaç të Tepelenës, si dhe në treva të tjera ku është shtrirë ndikimi i fesë myslimane, edhe emrat e burrave e të grave trashëgoheshin, si pasuria. Në qoftë se në mëhallë ose dh3e më gjerë nenjë familje, kur lindte një fëmijë i vihej një emër, i cili ekzistonte tek gjitoni, këtij të fundit i mbetej hatri. Trashëgimia e emrit, në fshatin tonë, dikur “ sot është e kapërcyer”, merrte këtë lloj përhapje; Emrin e të parit “ të parës “ së një familje e merrnin pasardhësit e brezit që pasonte. Psh; Musa Mehmeti dhe Mehmet Musai, Muharrem Kamberi dhe Kamber muharremi, Mehmet Qazua dhe Qazo Mehmeti, Rexhep Selfua dhe Selfo Rexhepi, Hamit Caushi dhe Caush Hamiti, Ali Xhelili dhe Xhelil Aliu, Malo Bajrami dhe Bajram Malua. Kjo lloj vazhdimësie në vijë të drejtë e emrave mashkullorë në Kalivaç të Tepelenës lidhet me atë praktikë unikale ku burrave, kur i thërriste dikush, u përmendte emrin dhe emrin e babait, psh; O Dine Xhelali, jo O Dine Behaj. etj. Gjithsesi, si çdo gjë edhe çështja e emrave është në ndryshim e zhvillim të vazhdueshëm. Etheksomë këtë se kandodhur që një njeri ka shkuar në emigracion, ka punuar e jetuar me një tjetër i cili i ka hyrë në zemër e, kur është kthyer në shtëpi, për të përjetësuar emrin e shokut” shoqes “ i ka thirrur jo me emrin që kishte por me emrin e të dashurit “ të dashurës “ së tij. Gjithsesi larmia e jetës na dikton dhe larmishmëri emrash. Mirë thonë në Korçë; emri është kapistall.

ESE MBI EDUKIMIN

TAJAR ZAVALANI**IDEALI I NJERIUT TË MËSUAR**

Ideali i njeriut të mësuar është në ditët tona specializimi në një degë. Disa vjet shkollë të mesme, pak vjet në universitet, një periudhë studimi të ethshëm për të kaluar provimet dhe, me të vënë diplomën në xhep, puna merr fund për shumicën tonë. U bëmë specialistë, mësuam një zanat, siguroam një mjet jetese dhe qëllimi u arrit. Kush u bë nëpunës, kush çeli një zyrë private, kush një klinikë, kush një dyqan.

Nëpunësin, që e kanë halë në sy të gjithë ata që kanë punë me shtetin, e cilësojnë si burokrat dhe me këtë fjalë duan të shprehin përbuzjen e mëshirueshme për këtë njeri të zhytur në pluhurin e akteve. Me fjalën burokratizëm theksohet mendësia e atij që i janë mykur trutë së bëri gjithmonë po atë punë. Aty përmblihet gjykimi i cekët dhe mendja, “me qoshe” e atij që nuk sheh më tutje nga nenet e ligjit dhe paragrafët e rregullores.

Por atë tharje të shpirtit dhe ngjyrosje të mendjes që pëson nëpunësi duke u kthyer në burokrat, mund ta pësojë specialisti i çdo dege tjetër. Edhe profesori i shkollës së mesme që përsërit në klasë gjithmonë po atë mësim mund të bëhet një farë burokrati në degën e tij. Kjo mund t’i ndodhë gjithashtu edhe kimistit që nuk ngre kryet nga mikroskopi, ose avokati që nuk çel libër tjetër përveç kodit a mehelesë.

Kushdo që bën një punë të përditshme për të fituar krodhën e bukës është në rrezik të bëhet skllav i punës së tij, të katandiset në një farë makine që punon pa u menduar, po të jetë se nuk e shtrin interesimin e tij intelektual jashtë degës ku është specializuar. Herë- herë kur ndodhet në një bisedim ku preket një çështje diturie të përgjithshme ay e ndjen se ka ngelur prapa, vuan në sedrën e tij pse nuk mund të shfaqë një mendim të vlefshëm që t’i shërbejë sqarimit të çështjes. Për një kohë ai e humbet qetësinë e shpirtit, sukseset e vogla në punën e tij nuk e kënaqin më, shikon mjetin për të dalë nga pellgu i monotonisë dhe automatmës profesionale ku është zhytur. Këtu në Shqipëri zakonisht fajin i a hedhin ambientit që të thëthnin si balta e moçalit dhe të shuan çdo energji. Duke parë gjithë këta njerëz, të katandisur nga pikëpamja intelektuale si kufoma të gjalla, që dergjen kafeve dhe “vrasin” kohën me letra e bisedime të zbrazëta, edhe ata që vijnë nga jashtë me një farë entuziazmi humbasin dal nga dale çdo interes për çështjet e përgjithshme dhe i pllakos apatia. Është e vërtetë se deri diku konditat e veçanta të vendit tonë bëjnë më të vështirë përpjekjen që duhet të bëjmë për të shpëtuar veten nga rreziku i burokratizmit. Por gabohen ata që kujtojnë se kjo ngjet vetëm në Shqipëri. Edhe në viset më të qytetëruara të botës çoroditja mendore e specialistit është një plagë që bën kërdrinë. Për të luftuar formimin burokratik të mendjes ka një mjet të sigurt. Këtë mjet e gjejmë në Shqipëri aq lehtë sa edhe në çdo vend të botës. Mjeti është

kultura, ay grumbull njohurish eprore që njeriu mëson për kënaqësinë e vet, pa ndonjë qëllim përfitimi material.

Çdo njeri prej nesh e ka në dorë të shpëtojë nga automatizmi i specialistit duke u bërë njeri me kulturë. Kultura është thesari më i çmueshëm i njeriut të qytetëruar; ajo është stolia e mendjes, lartësimi i shpirtit, shkathhtësia e ndjenjave, freskia e spiritës...

Themelet e kulturës hidhen qysh në bankat e shkollës. Nxënësi pesëmbëdhjetë vjeçar që shkon të vizitojë një muze ose shkon në bibliotekë të lexojë një libër jashtë programit, hedh çapin e parë në botën e kulturës. Ky pasurim i shpirtit që do të jetë burim begatie të panjohur në të ardhmen, s'kushton veçse pak mundim edhe kohë. Por sa e lartë është ajo prirje që e shtyn njeriun të zmadhojë personalitetin e tij duke gjurmuar çdo mendim të lartë, çdo vepër të madhe, çdo krijim të bukur që është bërë përmes botës dhe gjatë shekujve.

Por kultivimi i vetvetes nuk është një send që mësohet në shkollë. Secili duhet ta gjejë vetë mënyrën më të mirë për të mos e humbur interesimin për çështjet e mëdha që kanë lidhje me fatin e njeriut dhe zhvillimin e shoqërisë, për të mos vdekur për së gjalli në rutinën e një pune mekanike.

Rruga më e provuar që kanë ndjekur titanët e mendimit është kureshtja e gjallë që nuk na len të kënaqemi me atë që dimë. Asgjë nuk duhet të na lërë indiferentë. Të kemi syrin e çelur dhe një etje të pashuar për dituri. Të mos kërkojmë zhurmën e poteren për të hutuar veten dhe për të harruar andrallat. Të mos kemi frikë të ngelim vetëm me veten tonë, të shqyrtojmë vetveten deri në thellësinë e instinkteve që buçasin atje brenda, të analizojmë ndjenjat tona, të ndjekim një mendim, të radhitim në një çip të mendjes ose mbi një copë letër përshtypjet që na kanë lënë leximet, udhëtimet, kontakti me njerëzit. Të kontrollojmë veten duke parë se si kanë menduar, kane ndjerë, kane jetuar njerëzit e shquar të çdo kohe, të dimë të shijojmë ëndjen që ndjen njeriu me kulture kur ndjek rrymën e mendimeve që i kalojnë nëpër mendje jashtë vullnetit të tij, si një film sinematografik.

Kjo është rruga. Mjetet janë gjithë aq të lehta për atë që ka vendosur ta ndjekë përnjëmend. Baza e kulturës është leximi. Nuk është puna të lexosh shumë, por si e si të lexosh mirë. Substanca e ushqimit të mendjes duhet të përbëhet sidomos nga veprat e pavdekshme të atyre që janë munduar t'i japin një kuptim jetës në këtë botë. Pastaj vinë bisedat me njerëz të kulturës dhe udhëtimet e bëra me qëllim që të mësosh diçka. Nuk është nevoja të shkosh me doemos deri në "Çin ma Çin" për të mësuar diçka. Edhe nëpër Shqipërinë tonë të vogël ka shumë sende që vlejnë të mësohen.

Abuzimi i kulturës është gjithë aq i dëmshëm sa dhe haja e tepërt për llupësin e babëzitur. Qëllimi nuk është të ngarkojmë trurin me çdo lloj diturie. Kulturën duhet ta kundrojmë si një mjet për të lartësuar veten nga pikëpamja intelektuale e morale, ashtu edhe për t'u bërë një mis së më i vlefshëm i shoqërisë. Kultura është kondita e domosdoshme e çdo përparimi të vërtetë të individit në lidhje me kolektivitetin. Ajo është zana hyjnore që i jep kuptimin lirisë. Të kesh dijeni për shumë sende nuk është vetëm një kënaqësi në vetvete, një mjet ideal për të mos u mërëzitur, por edhe një mjet për të mos e ndjerë veten si të huaj, si të

izoluar në botën ku jetojmë. Njeriu me kulturë nuk është vetëm ai që interesohet për literaturë, për muzikë, për tablo e skalitje të stërholluar. Kultura e vërtetë na çel rrugën e së vërtetës. Ajo na jep kuptimin e thellë të relativitetit që është ligja e çdo ekuilibri në këtë jetë. Në vend që ta qullojë e t'i shuajë energjinë, kultura i ngjall njeriut në shpirt pasionet më të zjarrta. Përmes kulturës neve çmojmë vlerën e mendjes që është e para nga vlerat shpirtërore; shohim se nëpër çfarë kallëpe kalon e vërteta për të triumfuar, stërvitemi të urrejmë gënjeshtren e falsitetin në të gjitha petkat që i vesh moda e ditës: konformizëm, rutinë, snobizëm dhe shumë... izme kësilloji.

Kultura ndofta nuk të bën të lumtur, por të jep ndërgjegjen e cilësisë sate si njeri, të largon nga shqetësime e vuajtje të kota, të jep fuqi të luftosh kundër lakmive që vënë nderin dhe dinjitetin në rrezik. Nuk duhen shumë të ardhura për t'u bërë njeri me kulturë. Këtë luks mund t'ia lejojë vetes edhe më i varfri njeri, mjafton të ketë pak zgjim edhe vullnet. Sepse nuk është nevoja të mplakesh nëpër bibliotekat e muzetë. Mjafton të këqyrësh rreth e rrotull, të vëzhgosh, të krahasosh, të vrasësh mendjen për të kuptuar si është ndërruar kjo gjë, pse punon kjo makinë, e tjera. Vetëm se interesimi për të tilla çështje hyp një farë modestie. Prandaj kultura e vërtetë duhet të jetë modeste, mbasi ajo nënkupton që çdo njeri për veten e tij të ndjejë nevojën për të ditur gjithçka kanë vepruar dhe kanë menduar të gjithë njerëzit e tjerë.

Botuar më 1938

*ISMET AZIZI***KARAGJORGJE, SHQIPTAR NGA SANXHAKU!**

Lufta mes Austro-Hungarisë dhe Turqisë, e njohur si Lufta e Vjenës – e cila ka zgjatur nga viti 1683 deri në vitin 1699 – ka shkaktuar ndryshim të madh në strukturën etnike të popullsisë së Sanxhakut. Lufta ka shkaktuar shumë viktima dhe shkatërrime, ku si rrjedhojë pason shpërngulja e popullsisë së Sanxhakut në shumë drejtime. Në drejtim të Bullgarisë dhe Azisë së Vogël është shpërngulur popullsia e besimit islam. Popullsia katolike e fisit Kelmend është shpërngulur në drejtim të veriut, në Srem, dhe është vendosur në fshatrat: Hrtkovci, Nikinci, Pllatiçevo dhe Jarak. Një degë e të shpërngulurve në drejtim të Shumadisë është vendosur në fshatin Rudnik. Në këtë fshat është vendosur gjyshi i Karagjorgjes, Jovan (Gjon) Marash Klimenti (Kelmendi).

Ekzistojnë kontradikta në lidhje me origjinën Karagjorgjes. Burimet serbe thonë se Gjorgje (Gjergji) Petroviq (Pjetri) ka prejardhje malazeze nga fisi Vasojeviq (që po ashtu ka origjinë shqiptare e që kanë luftuar gjithnjë kundër shqiptarëve – v.j.). Atje ka lindur gjyshi i Karagjorgjes (Gjergji i Zi), Jovani (Gjoni) dhe katër vëllezërit e tij. Dy nga të tjerët u shpërngulën në Serbi. Jovani (Gjon) me bijtë e tij Petrin (Pjetrin) dhe Mirkon u vendosën në fshatin Vishevc, qarku i Lepeniçkit të Kragujevcit. Karagjorgje është djali i Petrit dhe i ëmës Marica (Maria).

Origjina shqiptare e familjes mbretërore serbe

Gjyshi nga babai i Karagjorgj Petroviqit, udhëheqësi i kryengritjes së parë serbe, ishte një Gjin Marash Klimenti, thuhet në librin "Karagjorgjeviqët - historia e fshehur". Autorë të librit janë Milorad Boshnjak, gazetar, dhe Slobodan Jakovleviq, inxhinier i mekanikës, i cili është pasardhës i drejtpërdrejtë i Jakov Obrenoviçit, gjysmë-vëlla i princit serb Milosh Obrenoviq.

Botues i librit është shtëpia botuese "Lio" nga Gornji Milanovaci, ndërsa autorët kanë publikuar dokumente të ndryshme, dorëshkrime dhe korrespondenca që tregojnë se Karagjorgjët e kanë prejardhjen nga fisi Kelmendi i rrethinës së Shkodrës, shkruan Sandzak Vijesti, duke rikthyer në debat temën që trajton kjo vepër e botuar para disa vitesh.

Autorët e librit mbështeten te "Zhurnal i Muzeut Kombëtar të Bosnjës dhe Hercegovinës", të vitit 1910, Nr. 22, ku thuhet se një pjesë e fisit Kelmendi arriti rreth vitit 1737 në rrethinën e Rudnikut, gjatë tërheqjes së ushtrisë austriake nga Novi Pazari (Pazari i Ri), transmeton Telegrafi.

Shtohet se në atë kohë kanë arritur rreth 500 familje shqiptare të cilët mezi flisnin shqip, ndërsa merreshin me blegtori dhe kishin karakter të fortë. Boshnjak

dhe Jakovleviqi për këtë bazohen edhe në veprën e Andrija Luburiqit, të botuar në vitin 1937.

Ata pohojnë se mbreti Petar I (1844-1921), i ashtuquajtur “Çlirimtari”, që sundon nga viti 1903, e dinte se është shqiptar.

Telegrafi kujton se Petar I, që ka kryer krime mizore ndaj shqiptarëve gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore, në shtypin beogradas të kohës së ardhjes së tij në pushtet citohet të ketë thënë se ka prejardhjen nga fisi i njohur shqiptar Kelmendi. Po ashtu, thuhet se Kelmendët e kanë mbrojtur atë gjatë tërheqjes së ushtrisë serbe nëpër Shqipëri më 1915, ku kryhen po ashtu krime të mëdha, ngase e konsideronin trashëgimtar të tyre.

Se Karagjorgjët kanë origjinë shqiptare, ju kujtojmë veprën “Serbia dhe Shqipëria”, të botuar më 1914, ku përmendet pikërisht ky fakt. Të njëjtën e ka thënë edhe profesori i njohur serb, Jovan Tomiq.

Akademiku dhe shkrimtari malazez, Jevrem Bërkoviç, që është nga malazezët e rrallë që pranon se ka origjinë shqiptare, thotë se Millosh Obiliq dhe Karagjorgjët janë shqiptarë.

“Milloshi ishte shqiptar në shërbimin e mbretit serb Lazarit. Babai i Karagjorgjit ishte shqiptar nga veriu i Shqipërisë, e nëna nga fisi i Vasojeviqve”, thotë ai. Ndërsa, po ashtu dihet se edhe Vasojeviqët, një fis antishqiptar, po ashtu janë me origjinë shqiptare. /Telegrafi/

Autorët në librin “Historia e fshehtë – Karagjorgjët” (“Sakrivena istorija – Karadordeviçi”) me të dhëna të argumentuara, kanë sistematizuar prejardhjen e familjes nga fisi Kelmend (Kliment, siç thonë ata), nga veriu i Shkodrës, nga e ashtuquajtura Shqipëria e Epërme apo Shqipëria e Lartë. Të dhënat arkivore vërtetojnë se për prejardhjen e tyre kanë pasur njohuri të shkëlqyeshme edhe vetë Karagjorgjët. Edhe më tepër, mbreti Petar i Parë dhe princi Pavle – i cili më së shumti hulumtoi nëpërmjet kërkuesve të cilët i pagoi oborri mbretëror.

Bashkautorë të këtij publikimi janë gazetari i kompanisë “Novosti”, Milorad Boshnjak, dhe hulumtuesi i pavarur Slobodan Jakovleviq, ndërsa botues janë shtëpitë “LIO” dhe “Dositej” nga Gornji Milanovci.

Një burim tjetër thotë se Karagjorgje ishte i biri i Petrit dhe nip i vojvodës Jovan (Gjon) Mrshiq (Marash) Klimentit (Kelmendi). Babai i Gjorgjës, Petar Jovanoviq Klementi, u shpërngul nga Kelmendi i Malësisë së Shqipërisë dhe u vendos në Malësinë e Sanxhakut e më pas, në vitin 1756, në rrethin e Kragujevcit. Aty i ka lindur djali i tij Gjorgje (Gjergji).

Pra, nga këto fakte del që shqiptari i konvertuar në ortodoks dhe i serbizuar, është themelues i dinastisë sunduese serbe. Para se të arrijë në këtë pozitë të lartë, ai kishte ekzekutuar në Ostruzhnicë, në rrethana të tmerrshme, të atin e tij, e më pas në Topolla edhe vëllanë e tij.

Karagjorgje, udhëheqësi i kryengritjes së I-rë Serbe të vitit 1804, pas thyerjes së kryengritjes largohet nëpërmes Zemunit në Austro-Hungari. Pas katër viteve në mërgim, udhëheqësi përsëri vjen në Serbi (1817), ku edhe përfundon tragjikisht. Ai u vra me urdhër të rivalit të tij Millosh Obrenoviq, i cili në këtë mënyrë është përpjekur të arrijë favore te autoritetet turke.

Autorët e librit “*Karagjorgjeviqët – historia e fshehur*”, i referohen “Glasnik Zemaljskog muzeja Bosne i Hercegovine”, të vitit 1910, Nr 22, në të cilin thuhet se një pjesë e fisit Kliment (Kelmend) ka arritur rreth vitit 1737, në rrethinën e vendbanimit Rudnik, gjatë tërheqjes së Ushtrisë austriake nga Sanxhaku. Aty thuhet se në atë kohë arritën rreth 500 familje shqiptare të cilët ishin “shtatshkurtër, të vrazhdë dhe mizorë”, të cilët mezi flisnin serbisht, donin blegtorinë dhe ishin me karakter të qëndrueshëm.

Autorët Bosnjak dhe Jakovleviq, veçanërisht u referohen veprave të Andrija Luburiqit, botuar në vitin 1937, në të cilat potencohet se fisi ortodoks i Kelmendasve feston Shën Klementin e Romës, të cilën festë gjoja e kanë kremtuar edhe Karagjorgjët.

Autorët argumentojnë se këtë festë e kanë festuar Kragjorgje, biri i tij Aleksandri dhe nipi Petri, i cili “papritmas, në Cetinjë mohoi krsne slave” (“kryqëzimin e shenjtë”).

Boshnjak dhe Jakovleviq pretendojnë se Mbreti Petri e dinte origjinën e paraardhësve të tij. Mandej, mbreti Petri kishte vlerësuar lart ndihmën që i ofruan Kelmendasit, gjatë tërheqjes së ushtrisë serbe nëpër Shqipëri në fillim të Luftës së Parë Botërore. Sipas tyre, Kelmendasit e konsideronin mbretin serb pasardhës të tyre.

Këtë fakt më së miri e ka përshkruar Dr. Jovan Tomiq, profesor në Universitetin e Beogradit, mik i madh i Peter Karagjorgjeviqit. Ai, studentëve të tij këtë të vërtetë ua ka prezantuar dhe nga ta ka kërkuar ta mësojnë këtë histori. Megjithatë, historianët serbë këtë të vërtetë mundohen ta fshehin nga opinioni. Thuhet se kur u ekzekutua Karagjorgje, bashkë me të u ekzekutua edhe shoku i tij besnik Naumi, i cili nuk u nda nga ai. Prandaj, populli serb e kanë një thënie, “besnik si Naumi”.

Ekziston edhe një shpjegim për “Naumin grek nga Argirorokastra”. Argirorokastra është Gjirorokastra në Shqipëri dhe se emri Naum nuk është i shpeshtë te grekët. Ndërsa, te shqiptarët është shumë i shpeshtë.

Se historianët serbë janë manipulues të shquar, flet edhe një histori interesante për Konda Bimbashin. Fjala është për një shqiptar të dëshmuar dhe një mik i dëshmuar edhe nga serbët, i cili ka rrugën e vet në Beograd, por që me shekuj fshihet origjina e tij shqiptare.

Petrit Imami, në librin e tij “Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj” (Samizdat B92, 1998), për Kond Bimbashin thotë se ai ishte komandant i “trupave ‘Epirote’, shqiptar ortodoks nga Epiri”. Bile, edhe historiani tejet i njëanshëm, siç është Vladimir Stojançeviq, i cili në librin e tij botuar nga SANU në vitin 1994 shqiptarët i quajti Albanci (jo Arbanasi apo Arnauti), thotë: “nga beqarët në mesin e kryengritjes serbe ishte Kond-Bajraktari, shqiptari ortodoks nga kufiri i Toskërisë dhe Epirit”, dhe shton se me Kondon serbë të ikur ka “më shumë nga bashkatdhetarët e tij”.

Një bashkëkohës i këtyre ngjarjeve, Llazar Arsenijeviq Batallaka, thotë: “Unë kam njohur shumë të krishterë, në mesin e tyre bullgarë, greko-shqiptarë (grekoarnauta) dhe cincaro-shqiptarë (cincaroarnauta) që kanë mbetur me serbët kur Gushanac u largua nga Beogradi...”!

Këto raste nuk janë të vetme. Kontribut Kryengritjes së Parë serbe i kanë dhënë jo vetëm shqiptarët, të ikur nga ushtria turke, por edhe disa fise të krishtera shqiptare (Kelmend, Grudë, Hot...), ndërsa kryengritësit armët i kanë siguruar nga Rrafshi i Dukagjinit, të prodhuar kryesisht nga shqiptarët të përkatësisë fetare islame, kështu që një pushkë e gdhendur me emrin e mjeshtrit “Osman”, e cila ruhet në Muzeun e Kryengritjes së Parë serbe, mendohet se i përkiste Karagjorgjes.

JOVAN BIZHYTI

VLLEHTË NË HAPËSIRAT MYZEQARE

Studiuesi Ilo Qafzezi shkruan se, sipas vendbanimeve vllehtë emërtohen në, vllëh voskopojarë, vllëhë frashërrjotë dhe vllëhë myzeqarë, ku, këta të fundit, përmenden pas arratisë që shkaktoi shkatërrimi i qytetërimit të Voskopojës, Frashërit dhe rrethinave të tyre, që përfshinë periudhën e fundit të shekullit të XVIII-të dhe fillimet e shekullit të XIX-të, pra fillimi i së cilës ishte viti 1769. Territoret perëndimore të Shqipërisë e kryesisht ultësira e Myzeqesë ishin vende të njohura për etninë vllahe, për faktin se tregtarët voskopojarë, gurgdhendësit e ndërtuesit grabovarë, si dhe vllehtë blegtorë frashërrjotë, mbanin lidhje me këto zona fushore si për tregti, për ndërtime objektesh të kultit, ura e tjera dhe për kullota për shtegtimin dimëror të blegtorisë.

Në ultësirën e Myzeqesë që përfshin hapësirën nga Kavaja, Lushnja, ultësirat fushore të Beratit, Fierit e deri në Myzeqenë e Vogël pranë Selenicës së Vlorës, fiset e vllëve sipas të dhënave studimore shtriheshin në rreth 60 fshatra të kësaj treve, si dhe në qytetet përkatëse. Shtegtimi i tyre u bë në mënyrë të grupuar sipas fiseve, por dhe sipas vendbanimeve, duke krijuar lagje të veçanta në qytete apo në fshatrat ekzistues, pa përjashtuar dhe rastet e krijimit të vendbanimeve të reja.

Ky komunitet nuk erdhi në këto anë si refugjatë apo muhaxhirë për t'u strehuar nga përndjekjet, por erdhën me dinjitet e me gjithë kapitalet e tyre. Ata sollën dhe kulturën e qytetërimit të territoreve nga vinin, siç ishte Voskopoja, Grabova, Llënga, Niça, Shipska, Frashëri e tjera, që rrezatonin zhvillim e shkëlqim të dukshëm. Lagja "Stan" në qytetin e Lushnjës ishte lagja që solli qytetërimin e parë në këtë qytet, që në fund të shekullit të XVIII-të kishte ende pamjen e një fshati kryesisht me bujq e blegtorë, si dhe me hane për strehimin e karvanëve.

Myzeqeja në fundin e shekullit të XVIII-të dhe fillimet e shekullit të XIX-të, ishte shumë e rënduar nga masat shtypëse të politikës së bejlerëve dhe administratës turke. Ekonomia ishte e varfër, me toka djerrë e moçalore të përmbytura nga vërshimet e lumenjve. Edhe konvertimi në fenë islame kish krijuar diferencime e lëvizje të popullatës, duke krijuar zona e territore të braktisura e të varfra me një ekonomi feudale të prapambetur. Kjo kish krijuar terren që emigrimi i popullsisë vllahe nga zonat juglindore, gjeti terren dhe një mikpritje të ngrohtë nga banorët vendas.

Pikërisht në këtë periudhë tregtia mori hov në Myzeqe, ku bashkë me iniciativën sipërmarrëse, tregtarët voskopojarë sollën dhe kapitalet e tyre. Në fillimet e shekullit të XIX-të e në vazhdim, veç zhvillimit të tregtisë në qytetet myzeqare të Lushnjës dhe të Fierit, tregtia u shtri dhe në fshatrat e Myzeqesë me

dyqane e tregti ambulante. Vllehtë Loni e Jorgji Bozo kishin dyqane tregtie në fshatrat Krutje, Bubullimë, Ngurrëz e Halilaj, ndërsa vllahu Llazar Bozo veç dyqaneve të tregtisë në Lushnje e në fshatra, kishte dhe mulli bloje, ndërsa vllahu Mina Bizhyti zhvillonte tregti ambulante në fshatrat Verri, Kallm, Halilaj Bubullimë, Ardenicë dhe dyqan tregtie në fshatin Kolonjë.

Disa familje vllahe investuan me kapitalet e tyre dhe në kishat orthodhokse të Myzeqesë dhe në shkollat e ngritura pranë objekteve të kultit. Kështu nga dokumentet historike mësojmë se vllahu grabovarë Mihal Bozo, ishte administrator dhe mësues në gjimnazin e Manastirit të Ardenicës, detyrë të cilën e vazhduan më pas dhe djemtë e tij Jakovi dhe Llazar Bozo. Po ashtu kjo familje vllahe Bozo nga katundi Kolonjë, ka investuar si bamirësi dhe për ndërtimin e kambanores së Manastirit, po ashtu dhe për ushqimin e nxënësve në internatin (konviktin) e kësaj shkolle për nxënësit e vobektë nga Myzeqeja. Edhe vllahu frashërrjot Kosta Robo po nga fshati Kolonjë, ka investuar për rikonstruksionin e kishës së Shën Gjonit në fshatin Bitaj të Myzeqesë e të tjerë.

Një nga pionierët e lëvizjes patriotike në Myzeqe ka qenë vllahu Llazar Bozo, që ishte dhe në krye të një çete me luftëtarë patriotë nga Myzeqeja në luftën kundër pushtuesve osman. Llazari mori pjesë aktive dhe në Komisionin organizator për thirrjen e Kongresit Historik të Lushnjes në 1920, ku ai ishte dhe një nga tre delegatët e Myzeqesë së bashku me Ferit Vokopolën dhe Sheh Ibrahim Karbunarën. Llazar Bozo u shqua dhe në kryengritjen e Fierit 1935 kundër qeverisë së Zogut dhe më pas, megjithëse në moshë të thyer, mori pjesë dhe në radhët e partizanëve në Operacionin e Madh të Dimrit kundër nazi-fashistëve 1943-44 së bashku dhe 5 djemtë e tij e me dy vajzat. Pra gjithë fa-miljen e hodhi në radhët e partizanëve.

Në Myzeqe janë shquar dhe shumë patriotë e intelektualë me origjinë vllahe siç janë shkrimtari i dëgjuar Jakov Xoxa, piktori Vilson Kilica, studiuesi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqi, aktorët Margarita Prifti (Xhepa) dhe Albert Verria, diplomatët Soktat Bufi dhe Xhorxhi Robo, historiani Koli Xoxi, gazetari Tashko Lako, juristi Irakli Bozo, inxhinieri Pirro Bozo nga pedagogët e parë të Universitetit të Tiranës, kineasti Todi Bozo, e shumë intelektualë të tjerë nga radhët e kësaj etnie në Myzeqe.

Është për t'u theksuar fakti që etnia vllahe në Myzeqe kanë qenë mbështetës të flaktë si në lëvizjen patriotike për pavarësi kombëtare dhe në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare për kundër okupatorit nazifashistë. Asnjë figurë e kësaj etnie në Myzeqe nuk u bashkua me pushtetin fashist dhe me përkrahësit e tyre. Djemtë e vajzat e shumë familjeve vllahe në Myzeqe, u rreshtuan në radhët partizane, ku disa prej tyre dhanë dhe jetën si dëshmorë të atdheut. Figura të tilla nga radhët e kësaj etnie ishin, Heroina e Popullit Liri Gero, Penellopi Piro, dëshmorët Loni Papuçiu, Janaq Kilica, Mihal Jano, Nako Bozo, Uan Gogu, Vasil dhe Petri Bozo dhe shumë dëshmorë të tjerë.

Në jetën e vllëve të Myzeqesë, pavarësisht shekujve që kanë kaluar, pavarësisht asimilimit me etninë tjetër ortodokse vendase, ata e ruajnë ende në familje frymën e shenjtë ortodokse, ruajnë ende gjuhën, zakonet, traditat, ku në

fshatra të veçanta me shumicë vllahe, gjuhën dhe zakonet vazhdojnë ti transmetojnë dhe në brezat më të rinj.

Vllehtë civilizojnë Lushnjen, Fierin dhe Kavajën

Vllehtë e “Stanit” në Lushnjë ndërtuan një lagje rrëzë kodrave që i dha qytetërim dhe qytetit, me shtëpi një dhe dy kate të ndërtuara me gurë, me dyqane tregtie, me rrugë të shtruara me kalldrëm e tjera. Tregtarët vlllehë të Lushnjes ishin nga familje të ardhura nga Voskopoja dhe Grabova si: Papai, Bozo, Gogu, Spiro, Bano, Shandro, Lipe, Dimashi, Xhoxhi, Prifti, Tushe, Bello, Durri e tjerë. Komuniteti vllah jo më pak kanë kontribuar dhe në qytetërimin e qytetit të Fierit, ku pikërisht fillimet e shekullit të XIX-të e bënë të njohur atë qytet, ku dhanë kontributin e tyre tregtarët e intelektualët vlllehë nga Voskopoja e Grabova, që ishin 24 shtëpitë e para që u ngulitën aty në dy anët e lumit Gjanicë. Sipas studiuësit Jakov Milaj thuhet se, “Për t’i dhënë më tepër hov tregtisë e zejtarisë, Vrionasit si pronarë tokash të kësaj zone të Fierit, sollën me kontratë tregtarë e zejtarë nga Voskopoja e Grabova disa familje si: Xoxa, Kilica, Pogaçe, Tiço, Verria, Bozo, Papuçiu, Bufi, Jorgaçi, Lako, Moçi e të tjerë. Pas vitit 1864 nisi rritja demografike e Fierit dhe nga banorë të territoreve për rreth, që së bashku i dhanë atij pamjen e një qyteti në qendër të Myzeqesë”.

Historia e vllëve

Pushtimi romak i gadishullit Ilirë, krijoi dhe fiset e romanizuara që pretendohet për prejardhjen e vllëve. Këta janë quajtur dhe romano-vllëh që lëvronin latinishten e vjetër e quajtur “Volskja”, latinishtja ballkanike me dialekt popullorë. Volskët kanë qenë ndër fiset më të lashta bashkë me Umbrët, Oskët, Dakët e tjerë që iu nënshtruan pushtimit romak rreth viteve 338 para e.s. Straboni thekson se, rreth vitit 168 para e.s., veç romanizimit të fiseve Ilire, në atë periudhë u shpërngulën në një eksod masiv rreth 150 mijë banorë e kryefamiljarë nga Iliria për në gadishullin Apenin të Italisë. Në vend të tyre perandoria dërgoi romakë dhe këta romenë u quajtën romano-vllëh.

Po ashtu, kësaj popullsie iu bashkëngjitën dhe mbeturinat e ushtrive romake nga lufta midis Pompeit dhe Çezarit në betejën e famshme të Frasalës, ku këto mbeturina të ushtrive u quajtën vllëh-farserotë dhe që dallohen nga vllehtë e tjerë nga theksi freng i germs “R” dhe për të përballuar mbijetesën e tyre, u morën kryesisht me blegtori duke bërë dhe një jetë nomade.

Dihet nga historia që vendbanimet e vllëhëve ishin kryesisht territoret e Epirit, që nga Maqedonia perëndimore në territoret malore të Pindit, Thesalia, Voskopoja me rrethinat e saj, Mecova dhe Frashëri. Në këto troje pellazgjike, pas pushtimeve të Perandorisë Romake, popullsisë Ilire iu bashkëngjit dhe një popullsi e romanizuar, Volskët (vllëhtë e sotëm), të cilët në gjithë këto troje që në shekujt e parë të erës sonë, kanë qenë popullsia e dytë pas shqiptarëve.

Historiani francez Zhak-Klod Faverial shkruan në librin e tij “Histoire de l’Albania” në gjysmën e dytë të shekullit të XIX-të se, “Popullsia në territoret e

Maqedonisë rreth shpateve të Pindit ishin Pellazgë”. Ndërsa Strebani shkruan: “Maqedonasit e Greqisë, flisnin të njëjtën gjuhë me epirotët. Pra, nuk flisnin greqisht dhe për t;u marr vesh me grekët, ishte i nevojshëm një përkthyes. Pellazgjishtja e tyre ishte më e ngjashme me latinishten se sa me greqishten”. Në këto territore që quhej Thesali dhe në veçanti në territoret e Pindit që quhej Maqedoni, kanë jetuar fise shqiptarë e vllleh. Këta i përkisnin bërthamave të ndryshme, por ishin të së njëjtës racë, Ilirë.

Në vitin 1878 Kongresi i Berlinit shkëputi shumë krahina nga shtete të ndryshme që ia aneksoi vendeve të tjera, duke ndryshuar hartën e Europës. Kështu u aneksua dhe Epiri e Thesalia që i kaluan Greqisë. Historiani Zhan-Klod Faverial në veprën e tij shkruan : “Po aq sa dhe Epiri e Thesalia kurrë ndonjë herë si kanë përkatur Greqisë”! Vllehtë iu kundërvunë aneksimit të kë- tyre krahinave me po ato arsye të drejta si dhe shqiptarët ndaj aneksimit të Epirit.

Një delegacion vllah shkoi në Kostandinopojë për tu ankuar tek ambasadorët e shteteve të mëdha ku protestuan se, “T’u lihen tokat tona grekëve, do të thotë të lemë në dorë të tyre kombësinë, gjuhën e zakonet tona, me një fjalë ajo çka është më e shtrenjtë për ne”! E rëndësishme është dhe Proklamata që vllehtë i drejtuan shqiptarëve në 4 gusht 1888 ku shkruhet : “...dhe t’i dëshmojmë botës së qytetëruar, se shumica e popullsisë në Shqipëri e Maqedoni janë shqiptarë e vllleh e aspak grekë”. Edhe Kongresi i vlllehve i mbajtur në Frajburg të Gjermanisë në vitin 1993, e deklaroi me argumente shkencore definitivisht se, “Vllehtë nuk janë as rumunë e as grekë”.

Voskopoja, kryeqendra e qytetërimit vllah



Qytetërimi i Voskopojës lindi nga fundi i shekullit të XVII-të dhe fillimet e shekullit të XVIII-të. Ajo mori një zhvillim jo vetëm ekonomik, por dhe arsimorë e

kulturorë, duke rrezatuar ide iluministe dhe një kulturë të re kundër skolastikës mesjetare. Ky qytetërim dhe zhvillim i gjithanshëm, ngjalli lakminë në krahinat e tjera dhe në rrethinat që përjetonin varfërinë. Kjo çoi në atë fund tragjik të sulmeve vandale, plaçkitjes e djegies nga bandat e dhunshme të Kolonjës e Dangëllisë, të mbështetura dhe nga feudalët e rrethinave, si dhe nga kreditorët voskopojarë.

Voskopoja ishte ato kohë kryeqendra e vllahëve të Pindit të sipërm, ndërsa Mecova ishte kryeqendra e vllahëve të Pindit të poshtëm. Të dy këto kryeqendra vllahe nuk patën të njëjtin fat e rëndësi. Mecova ekziston edhe sot, ndërsa Voskopoja u dogj e u shkatërru! Ja çfarë shkruan historiani francez Zhan-Klod Faverial për Voskopoje : “Po çfarë nuk do kish shkruar Pukëvili mbi Voskopoje, në se do kish arritur ta vizitonte këtë qytet kur ishte me rreth 45 mijë banorë, i pari i atyre kohëve në gjithë Shqipërinë para se të plaçkitesj e të katandisej në një fshat me 250 familje”.

“Stanet”, vendbanimet e para të vllahëve në Myzeqe

Lagjet e populluara me vllah u emërtuan “Stane”, ku në Myzeqe janë shumë vendbanime të tilla si:

Lagja “Stan” në qendër të qytetit të Leshnjes

Lagje “Stan” në fshatrat Bubullimë

“Stan” i Libofshës, që më pas mori emrin “Pazari”

“Stan” i Divjakës

“Stan” i Pojanit

“Stani” në qytetin e Fierit

Stan Manastiri

Stan Karbunara

Stani i Kavajës

Stani i Bobos pranë bashkimit të lumenjve Osum dhe Devoll në afërsi të Urës Vajgurore të Kuçovës

Vendbanime të reja me vllah ishin edhe fshatrat Kolonjë, Driza e Fierit etj

MAN POGA

“THE NATIONAL GEOGRAPHIC” MË 1912: JA SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT

Këtë verë më ra në dorë një koleksion mjaft i rrallë i revistës së njohur Amerikane, "*The National Geographic Magazine*", në brendinë e të cilave flinin shumë shkrime të hershme për Shqipërinë që nga 1912-ta, 18-ta, 31-shi, e në vijim. Shumë prej tyre ishin të panjohura për mua, e jo më t'i kisha në dorë, origjinale.

E gjithë kjo, qe falë bujarisë së mikut tim nga Hasi, fotografit profesionist Azem Koleci, i cili i shkëputi nga biblioteka e tij në Irlandë dhe i solli në Tiranë këtë verë. Azemi, krahas aktivitetit në diasporën shqiptare është autor i disa ekspozitave, vlen të përmendet ekspozita që çeli në nëntor të 2012-tës në Cork të Irlandës, me fondet e veta, për nder të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Revista "*The National Geographic Magazine*" ka botuar shumë reportazhe mbi Shqipërinë, shkrime që hidhnin dritë tek lexuesi amerikan e perëndimor, mbi jetën dhe historinë e panjohur shqiptare. Për nga rëndësia e tematikës që trajton, kohës së shkrimit dhe ilustrimet e rralla që na vijnë, dua të ndaj me lexuesit e Rilindësit së pari, shkrimin me titull: "The Albanians", botuar në nëntor të 1912-tës, me autor shkrimtarit dhe biografën e njohur Theron J. Damon. Megjithëse botimi i shkrimit daton fiks me kohën e mëvetësimit të Shqipërisë, në nëntor të 1912-tës, nga situata social politike që përshkruan artikullshkruesi, ilustrimet, të dhënat historike që jep, etj., kuptojmë se ka qenë në Shqipëri shumë kohë më parë, kohë e cila përkon me kryengritjen e Mbishkodrës, në prag të pavarësisë. Pothuajse të gjitha fotot që ai ka botuar në ilustrim të shkrimit janë nga ky rajon.

“As rrahjet me thupra, as arma, as topi, as mërgimi, as burgimi, as edhe vetë vdekja, nuk i tund nga vendi”.

Kështu e fillon shkrimin e tij "The Albanians" Theron J. Damon, fjali të cilat i vë në gojën e një shqiptari të ri në moshë, por që siç sqaron ai, një pjesë të arsimit të kishte bërë në Shtetet e Bashkuara. Duket se me këtë hyrje, që në nisje, autori kërkon të njohë lexuesit perëndimorë me patundshmërinë e Kombit Shqiptar, në rrugëtimin për liri dhe pavarësi. Damonit i bën përshtypje ky djalë i ri idealist që është rikthyer në Shqipëri, për fat të keq nuk na bën të njohur emrin e tij, por veçse të dhëna për të: “Ai është rikthyer tani në vendin e tij, ku po punon me zell të madh për popullin e tij. Është një prej të paktëve njerëz të arsimuar në Shqipëri, por synon që brezi i ardhshëm të mos i numërojë me gishta burrat dhe gratë e arsimuara të Shqipërisë”- shton ai.

Nga biseda me të, është impresionuese fjala e djaloshit të zgjuar, i cili i shprehet Demonit se shqiptarët kanë një etje të madhe për arsimim në gjuhën amtare, e se fuqia e shqiptarëve do vijë vetën nëpërmjet arsimit, fjalëve të cituara

në hyrje ai ju kishte paraprirë me këto: “Për momentin, nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim të Shqipërisë, të gjithë klasat e njerëzve -myslimanë dhe të krishterë qofshin - kanë një dëshirë, pothuajse një pasion për arsimin kombëtar. Të gjithë ata e kuptojnë që, ashtu sikurse në të kaluarën shpata ishte simbol i fuqisë, sot arsimi është perëndesha e fuqisë, dhe ata do të arsimohen, pavarësisht persekutimit.”

Nga biseda me arsimtarin e ri, por dhe nga sa sheh nëpër terren autori mbushet me bindje se shqiptarët janë vetëdijuesuar për nevojën që kanë për progres perëndimor, por pengesë për këtë përparim ai e sheh tek vendosmëria e turqve të rinj, të cilët edhe nëpërmjet Kushtetutës së Re Otomane kërkojnë që qytetërimi tek shqiptarët të kalojë nga sita Turke dhe feja Muhamedane...:“Shqiptarët janë vetëdijuesuar për nevojën që kanë për qytetërimin dhe progresin perëndimor.

Por, që nga dita e parë e miratimit të Kushtetutës së re otomane, turqit e rinj ishin të vendosur që qytetërimi duhej të vinte tek shqiptarët, vetëm pasi të kishte kaluar në një sitë turke dhe muhamedane. Ky program nuk mund të pranohej nga shqiptarët, edhe sikur turqit e rinj të kishin qenë në gjendje ta vinin në zbatim.” Më tej, gjatë gjithë përshkrimi të tij, u referohet shqiptarëve natyrshëm si europianë, për më tepër, ai nje lexuesin e gjerë amerikan dhe perëndimor me tezën e autoktonisë së shqiptarëve në Ballkan, konfirmon gjithashtu dhe faktin e njohur, por që është kontestuar gjatë gjithë shek. XX nga politika nacionaliste greke, të përkatësisë së etnisë shqiptare të Marko Boçarit, dhe rolin e arvanitëve në pavarësimin e Greqisë: “Shqiptari është europian: për më shumë se dy mijë vjet ka jetuar atje ku jeton tani – në fortesat e Epirit dhe Ilirisë, përtej Adriatikut paralel me thembrën e Italisë. Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, shqiptarët u përzien me fqinjët e tyre jugorë, grekët, dhe ishin shtylla kurrizore e luftës për pavarësinë e Greqisë. Bashkatdhetarët e Marko Boçarit emigruan të gjithë në Cefaloni, në brigjet e Greqisë, por afro 2 milionë shqiptarë më të pafat jetojnë tashmë nën sundimin turk.”

Ai kujton se përpara pushtimin Osman, shqiptarët ishin në kontakt me qytetërimin perëndimor, nëpërmjet marrëdhënieve ekonomike, sociale e kulturore me supermacinë e kohës, Venedikun. Pas rënies së Shkodrës, dhe dëbimit të Venecianëve nga Osmanët ai sheh veçse rrënim dhe kthim mbrapa. “Gjatë 125 viteve para zbulimit të Amerikës, republika krenare e Venecias kishte një supremaci dashamirëse mbi qytetet shqiptarë të bregdetit, dhe kështu që e vonoi me një shekull dominimin turk. Me rënien e Skutarit në Shqipëri dhe dëbimin e venecianëve nga turqit në vitin 1478, këta të fundit filluan sundimin e tyre: shekuj të tërë mashtrimi, bese të thyer dhe mizorie. Rezultati i sundimit turk mund të përmbledhet me zhytjen më thellë të shqiptarëve në varfëri, supersticion, dhe etje për gjak, për shkak të terrenit pjellor që garantonin historia malore dhe tiparet primitive.”

Personalitet i pathyeshëm

Si shumë të huaj që kanë vizituar Shqipërinë, as Demonit nuk i shpëtojnë cilësitë piktoreske të shqiptarëve. Ai thekson se vetëdija kombëtare tek shqiptarët

shquhet. Nga kontakti që ka me prijësit e liderët ai citon se liderët e kuptojnë se nuk janë racë orientale, por perëndimore. Tiparet e tyre turko-muhamedane janë një lustër, do mjaftonte një brez me arsimin e duhur dhe shqiptarët do bënin kapërcimin e madh, dhe do zinin vendin e tyre mes racave të qytetëruara të Ballkanit-shton ai.

“Sot, shqiptari është personaliteti më piktoresk në Europë. Megjithatë, po aq interesante sa tiparet e tij, është edhe e ardhmja e tij politike. Kohët e fundit është shfaqur vetëdija kombëtare shqiptare që refuzon të shtyhet. Nën qeverisjen jonormale të turqve, racat e ndryshme të krishtera të Perandorisë, si armenët otomanë, bullgarët otomanë dhe grekët otomanë, kanë secila ekzistencën e tyre kombëtare, një shtet brenda shtetit, ndonëse gjithmonë të nënshtuar vullnetit të turqve. Shqiptarët, ndonëse në përgjithësi kanë zhvilluar një lloj besnikërie myslimane që u jep një pothuajse solidaritet me turqit, janë të vendosur që të kenë edhe ata një entitet kombëtar. Ndonëse janë të mallkuar me prapambetjen që ka shoqëruar pak a shumë kudo besimin muhamedian, liderët e tyre e kuptojnë se nuk janë një racë orientale, por perëndimore. Se tiparet e tyre turko-muhamediane janë një lustër, dhe se do të mjaftojë një brez me arsimin e duhur për të bërë kërcimin e madh përpara dhe për të zënë vendin e tyre mes racave të qytetëruara të gadishullit të Ballkanit.”

Shqiptari është individualist i madh, ndoshta prej kësaj cilësie ai nuk ka humbur identitetin e tij, dhe nuk është shkrirë me popujt e tjerë që i kanë ardhur rrotull thekson Demon, po përsëri aty e shikon dhe anën negative. Mosgatishmëria ose paaftësia e shqiptarëve për të ndryshuar individualitetin e tyre, reflektoi tragjikisht në ekzistencën e vazhdueshme të sistemit fisnor dhe grindje të përhershme mes fiseve, gjë që sipas tij ka pamundësuar ngritjen e një fronti të bashkuar të shqiptarëve kundër armikut të përbashkët. Vetëm një hero i madh i bashkoi thotë ai, duke kujtuar Skënderbeun. Megjithëse nuk harron t’u kujtojë botës se një nga njëzërit më të shquar Italisë, Crispi, ka qenë me prejardhje shqiptare. Në fund, pas rënies së Skënderbeut, pushtuesi i Kostandinopojës, Mehmeti, mundi t’i shtypte, por jo t’i nënshtonte shqiptarët.

“Jo i papajtueshëm me nacionalizmin e ri shqiptar, madje mund të jetë arsyeja e tij, është fakti që shqiptari është një prej anëtarëve më individualistë të racës njerëzore. Po të mos kish qenë i tillë, ai do e kishte humbur shumë kohë më parë identitetin e tij, duke u shkrirë me popujt e ndryshëm që përgjatë kohërave u kanë ardhur rrotull maleve shqiptare. Pavarësisht sulmeve të vazhdueshëm të romakëve, gotëve, serbëve dhe bullgarëve dhe 350 viteve dominim të Turqisë, shqiptari e ka ruajtur individualitetin e tij të pathyeshëm.”

“Crispi, burri i shtetit italian ka qenë me prejardhje shqiptare. Ai ishte pjesëtar i kolonisë së madhe të shqiptarëve në Sicili dhe Italinë e jugut, paraardhësit e të cilit, afro njëqind mijë, emigruan kur Turqia pushtoi Shqipërinë. Edhe sot e kësaj dite, shqiptarët e Italisë e ruajnë prejardhjen e tyre. Mosgatishmëria ose paaftësia e shqiptarëve për të ndryshuar individualitetin e tyre reflektohet tragjikisht në ekzistencën e vazhdueshme të sistemit fisnor shqiptar dhe grindjet e përhershme mes fiseve. Si rezultat, Shqipëria nuk ka mundur të paraqesë një front të bashkuar kundër një armiku të përbashkët.

Vetëm një hero i madh bashkues kombëtar ka dalë për shqiptarët – Skënderbeu. Ai vdiq në vitin 1467, pasi fitoi 21 beteja kundër turqve. Vdekja e tij e la Shqipërinë pa udhëheqës, dhe shqiptarët trima që nuk njihnin besnikëri apo ligj tjetër përtej atij të familjes dhe klanit, ranë në sundimin e Mehmetit II, pushtues i Kostandinopojës. Mehmeti mundi t'i shtypte, por jo t'i nënshtronte shqiptarët. As edhe sulltanët e mëvonshëm nuk kanë arritur ta plotësojnë këtë dëshirë të madhe.

Më e mira që mund të bënin ishte t'i bënin për vete, dhe deri në ditën e fundit të tiranisë së Abdyl Hamitit, shqiptarët trajtoheshin si popull i veçantë. Hamiti ua bleu besnikërinë duke mos u vënë taksa, duke frenuar rekrutimin ushtarak dhe duke përzgjedhur më të mirët e këtyre malësorëve të ashpër si truprojat e tij personale.”

RECENSIONE**VEPËR E RRALLË PËR ARBNESHËT E ZARËS**

*Aleksandër Stipçeviq, "Kultura tradicionale e arbnesheve të Zarës",
Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2014*

Aleksandër Stipçeviq, dijetar i rrallë i historisë së lashtësisë ilire, dashamirës dhe adhurues i diturisë dhe i librit, për të cilin e ka shkruar një histori të plotë, e cila është përkthyer në shumë gjuhë të botës, bibliograf që ka punuar me një përkushtim mahnitës dhe i ka kontribuar shumë shkencës dhe kulturës kroate dhe asaj botërore, në prag të pleqërisë, siç pohon profesor Katiqiçi, "u është qasur shumë seriozisht rrënjëve të veta, fort vetjake, të familjes dhe të fisit" dhe na ka dhuruar një vepër fort të rrallë. Monografia e tij "*Kultura tradicionale e arbnesheve të Zarës*" është me të vërtetë një studim fundamental në fushën antropologjisë kulturore dhe sociale. Si e tillë kjo vepër që do të jetë model për të gjithë studiuesit e kësaj fushe, pa marrë parasysh se me kulturën e cilit komunitet apo etnitet do të merren. Është krejt e kuptueshme rëndësia e veçantë e këtij libri për zhvillimin e shkencave humanitare: etnologjinë, gjuhësinë, folkloristikën, kroatologjinë dhe albanologjinë.

Libri i profesor Stipçeviqit, shikuar përgjithësisht, siç thuhet në parathënien e prof. Katiqiçit, do të mbetet "përmendore e një trashëgimie tradicionale shumë specifike të arbnesheve të Zarës". Dimensioni i vlerave studimore të këtij libri shtrihen në tri rrafshje të veçanta. Së pari "*Kultura tradicionale e arbnesheve të Zarës*" është një vepër gjithëpërfshirëse në fushën e antropologjisë, sepse autori nuk ka lënë asnjë përbërës karakteristikë të jetës së arbnesheve të kulturës materiale dhe të botës shpirtërore, si në sferën e përjetimeve reale, ashtu edhe në atë të shtresave të parafytyrimeve imagjinative - mitike e mitologjizuese - pa e përfshirë dhe pa e shpjeguar deri në hollësitë më të imta. Së dyti, gjatë trajtimit të marrëdhënieve jetësore, sociale e kulturore të popullatës arbneshe, autori e ka trajtuar me saktësi të plotë shkencore funksionin e kësaj popullate për kulturën dhe jetën sociale e historike, sidomos në zhvillimet e përgjithshme të lëvizjes nacionale kroate, dhe për jetën e përditshme arsimore e fetare në Dalmacinë Veriore. Çështja e tretë, që ia shton vlerën veprës së prof. Stipçeviqit është studimi i shtresave kulturore në planin krahasimtar ballkanik dhe evropian, si në rrafshin përditshmërisë vijuese me kulturat e popullatave fqinje, ashtu edhe brenda dimensionit historik të lidhjeve me të kaluarën e përbashkët të popujve, në mënyrë të veçantë edhe me vazhdimësinë e pashkëputshme me paraardhësit e shqiptarëve, me kulturën e lashtë ilire. Duhet pohuar, gjithashtu, se kjo vepër shquhet edhe për metodologjinë e qasjes ndaj problematikës së trajtuar dhe të mënyrës së veçantë të mbledhjes dhe të përpunimit të të dhënave nga subjektet e shumta midis njerëzve rrëfimtari të moshuar, që kishin ruajtur në kujtesën e tyre shumë gjera nga e kaluara, doket e zakonet tradicionale, besëtytnitë e besimet popullore, vlerat e dëshmuara të krijimtaria folklorike të arbnesheve dhe i tregonin me gjuhë të saktë dhe me besueshmëri të lartë.

Unë e pata fatin dhe kënaqësinë që librin ”*Kultura tradicionale e arbneshëve të Zarës*” të prof. Aleksandër Stipçeviqit, të shkruar kroatisht, ta përktheja në gjuhën shqipe. Në fillim, duke çmuar lart punën e madhe të profesorit të nderuar dhe nga dëshira që libri të jetë i suksesshëm dhe i lexueshëm edhe në shqipe, pata pak ngurrim dhe ndrojtje se a do të mund t’i dalë me sukses kësaj pune. Pastaj, gjatë punës m’u duk se e hetova një të vërtetë të madhe se prof. Aleksandër Stipçeviqi, njohës i mirë i së folmes arbneshë të vendlindjes, i lindur dhe i krijuar intelektualisht që nga zanafilla në traditën kulturore të arbneshëve të Zarës, gjatë hartimit të kësaj vepre të shkëlqyeshme në nënvetëvijen e tij kishte menduar shqip, prandaj besova se e gjeta indin e kodit gjuhësor me të cilin ishte hartuar tërësia e kësaj vepre madhore dhe puna e përkthimit eci krejt natyrshëm drejt përfundimit të suksesshëm.

Në një letër, që atëherë ia pata dërguar profesorit, ia pohova këtë bindje dhe, sipas të gjitha gjasave, edhe ai e pranonte se për ta hartuar veprën, përveç punës shumëvjeçare në mbledhjen e lëndës, ishte thelluar intelektualisht deri në maksimum dhe ishte angazhuar emocionalisht deri në skutat më të thella të shpirtit të tij krijues. Falë kësaj bindjeje, ende besoj se libri i përkthyer shqip, është i njëjtë, i barabartë me të gjithë përbërësit e vlerave të veta, me origjinalin kroatisht.

Libri shqip nuk përcillet me kurrfarë parathënie apo pasthënie të veçantë për këtë, dhe ka mbetur jo vetëm në pamjen e jashtme, por edhe me tërë përmbajtjen e tij, si origjinali në kroatisht.

Pas parathënies së mrekullueshme të profesor Radosllav Katiqiçit, të hartuar me saktësi të lartë shkencore dhe me dashamirësi të ngrohtë njerëzore, na u duk e panevojshme të hartohet ndonjë tekst i parathënies për botimin shqip të librit, që do të ishte gjithsesi i pakrahasueshëm me nivelin e intelektual të teksti të profesorit të nderuar kroat.

Libri në gjuhën shqipe nuk i ka edhe disa sqarime që autori ua drejtonte lexuesve kroatë për alfabetin e gjuhës shqipe e, madje, as tekstet origjinale në të folmen e arbneshëve të krijimeve popullore e kthyer në gjuhën letrare shqipe, të cilat në origjinal janë përkthyer kroatisht. Për këtë arsye vëllimi i tekstit shqip është pak më i vogël, por vlera shkencore e librit, mendojmë se është ruajtur edhe më mirë, mu në sajë të teksteve origjinale, të cilat lexuesi shqiptar ka mundësi që t’i kuptoj edhe ashtu siç janë mbledhur nga linguistët, historianët, folkloristët dhe studiuesit e ndryshëm dhe janë përfshirë si të tilla në kapitullin e tretë të këtij libri.

Siç e thashë pak më sipër, veprës i paraprin parathënia brilante e profesor Katiqiçit, në të cilën janë sqaruar me një gjuhë të saktë, të qartë e të kuptueshme, të gjitha nyjat lidhëse apo shtyllat mbajtëse të kësaj vepre madhore, duke filluar nga metodologjia e punës së autorit, historia e qëndesës kulturore, të “arbneshëve kroatë”, siç i quante me të drejtë popullsinë kroate e vendit, dhe rolin të tyre për kulturën dhe për historinë e Kroacisë e deri të vlerat e përgjithshme gjuhësore e folklorike të arbëreshëve të Zarës. Dhe këto vlera historike dhe aktuale, edhe sot e kësaj dite, brenda procesit të kroatizimit, i kanë ruajtur veçanësitë e tyre për të cilat, profesor Katiqiçi në fund të parathënies pohon se “arbëreshët kanë ardhur deri në ditët e sotme si tërësi e veçantë jetësore” dhe se edhe në Arbëreshin e sotëm

“atmosfera është krejtësisht tjetër nga ajo e qytetit...jeta është krejtësisht tjetër dhe nevojat e njerëzve janë krejt të tjera.”

Libri *”Kultura tradicionale e arbëneshëve të Zarës”* i Aleksandër Stipçeviqit, ka një strukturë shkencore të krijuar me kujdes shumë të madh. Lënda shumë e gjerë, pasuria e përgjithshme kulturore, jetësore dhe historike është ndërthurë me mjeshtri të rrallë vetëm brenda tri kapitave kryesore të kësaj vepre. Në to, pas parathënies, prologut dhe hyrjes trajtohen: jeta dhe doket, besimet popullore dhe letërsia popullore.

Prologu i shkurtër, si fjalë paraprijëse e autorit, përmban disa sqarime rreth zhvillimeve të traditës kulturore me zanafillë në lashtësinë e besimeve të kota dhe të besëtytnive të pranishme më dendur te arbëneshët deri në luftën e Parë Botërore dhe pastaj në rrjedhat jetësore të periudhave të mëvonshme historike deri në kohën tonë. Aty shprehet edhe mirënjohja e respekti i veçantë për subjektet nga të cilat është mbledhur lënda; për rrëfimtaret dhe informatorët e dalluar nga radhët e arbëneshëve me të cilët kishte punuar për një kohë relativisht të gjatë professor Stipçeviqi, si edhe jepen disa shpjegime lidhur me gjuhën e banorëve të Arbëneshit të Zarës.

Në hyrje, e cila titullohet *“Mbi arbëneshët e Zarës”* kemi një histori të mirëfilltë për shpërnguljen e arbëneshëve nga fshatrat e rrethinës së Shkodrës dhe vendosjen e tyre pranë qytetit të Zarës dhe rrjedhën e tërësishme historike të jetës së kësaj popullate deri në kohën tonë. Po këtu jepen të dhëna të rëndësishme për personalitet e shumta nga radhët e arbëneshëve, të cilët kanë luajtur rol të veçantë në rrjedhat shoqërore, politike, kulturore, artistike dhe sportive të Kroacisë . Të gjitha konstatimet autori i bazon në të dhënat e shkruara - në dokumente arkivore - dhe në traditën rrëfimtare, që vetë kjo popullatë, e shkëputur për shumë kohë nga lidhjet me vendin e origjinës, e ka ruajtur në kujtesën e vet historike.

Kaptina e parë *“Jeta dhe doket”* i ka 24 nënkaptina me zberthim edhe të mëtutjeshëm të njërive të veçanta në të cilat nuk mbetet asnjë çështje jetësore e kulturore pa u trajtuar në hollësi. Në këtë pjesë të librit zgjerohet kuptimi i aspekteve etnologjike, sepse në formë gjithëpërfshirëse janë trajtuar tradicionalja dhe bashkëkohorja në sferat e ndryshme të jetës, në mënyrë të veçantë jeta familjare me të gjitha situatat rituale e reale jetësore, doket e zakonet që lidhën jo vetëm me familjen, por edhe me format e ndryshme të prodhimit dhe të marrëdhënieve shoqërore, mënyra e kryerjes së punëve të fushës, organizimi i jetës së përbashkët ekonomike e kulturore, mjekësia e veterinarja popullore, festat fetare, rituali fetar glagolist i zbatuar nga kisha e famullisë së Arbëneshit, veshja popullore , profesionet e ndryshme, mjetet e prodhimit deri të gjuha e antroponimia, toponimia dhe onomastika në përgjithësi. Me një fjalë, në këtë kaptinë trajtohet në mënyrë enciklopedike tërësia e jetës dhe e veprimtarisë së kësaj bashkësie etnike në të kaluarën dhe në të sotmen.

Po ashtu, gjithëpërfshirëse është edhe kaptina e dytë *“Besimet popullore”*, që ka më shumë se 50 tërësi tematike. Brenda kësaj kaptine paraqiten figurat shumta të besimeve e popullore, shtrigat e lugetërit, mitet e magjitë, ndalesat, mësyshët e tabutë, besëtytnitë, simbolet dhe amuletet, bota e mistershme e të vdekurve, shpirtrat dhe totemizmi, mënyrat e shumta bestyete të mbrojtjes nga të

këqija, urimet e mallkimet e shumë çështje të tjera nga sfera e botës ireale, misterioze të pasvdekjes.

Me rëndësi të veçantë për antropologjinë kulturore është nënkuptina e fundit e kësaj kaptine, në të cilën janë trajtuar përbërësit e trashëgimisë së lashtë ballkanase, e cila është ruajtur brenda besimeve popullore të arbneshëve të Zarës, me anë të së cilës dëshmohej edhe një segment i veçantë i lidhjes së shqiptarëve në përgjithësi me traditën e paradržësve të tyre, ilirëve të Siujdhesës Ballkanike.

Kaptina e fundit e librit të prof. Aleksandër Stipçeviqit përmban pothuajse trashëgiminë e plotë nga letërsia popullore e arbneshëve të Zarës, që është mbledhur në të kaluarën dhe është ruajtur deri në kohën tonë. Në të vërtetë, këtu janë mbledhur dhe radhitur të gjitha ato njësi folklorike, të cilat gjuhëtarët, folkloristët vizitorët apo udhëpërshkruesit e ndryshëm evropianë i kanë shënuar në Arbnesht të Zarës. Këto njësi janë radhitur brenda katër tërësive. Në fillim i kemi vlerat e mirëfillta të poezisë popullore, tekstet e llojeve të ndryshme të këngëve popullore arbëneshë, duke filluar nga këngët fetare, këngët e dasmës, këngët e luftës, poezia humoristike, këngët e dashurisë, këngët për vendlindjen e të tjera. Të gjitha këto shquhen për ritmin e veçantë që kushtëzohet nga mundësia për ruajtje dhe konservim brenda procesit të zhvillimit të shkëputur nga tradita gjithëkombëtare e shqiptarëve. Me interes për traditën janë edhe krijimet në prozë, në mënyrë të veçantë kallëzimet dhe anekdotat që shquhen si për përbërës mitikomagjikë Brenda një pjesë të kallëzimeve, ashtu edhe për struktura humoristike të anekdotave dhe të rrëfimeve të ndryshme të ndodhive reale jetësore të banorëve të Arbëneshit të Zarës. Libri përmban edhe një numër fjalësh të urta, në të cilat, ashtu si edhe tek njësitë e tjera folklorike të përfshira në këtë vepër, dëshmohej edhe ngjashmëria me traditën e përgjithshme shqiptare.

Vepra “*Kultura tradicionale e arbneshëve të Zarës*” e Aleksandër Stipçeviqit shuhet për vlerat e përgjithshme të një studimi të rrallë monografik nga fusha e shkencave humanitare. Ajo ka një rrezatim të gjerë në këto shkencë, sidomos sa i përket etnologjisë, folkloristikës, kroatologjisë dhe albanologjisë, sepse, pos të dhënave të përgjithshme kulturore e shoqërore, ajo dëshmon edhe për procese dhe dukuri të zhvillimit dhe të shpërndërimeve të ndryshme kulturore të popullatës në rrethana të një shkëputjeje të një tërësie të vogël etnike nga mjedisi i vet jetësor, duke luftuar që të mbetet subjekt i vetvetes në përpjekje të vazhdueshme për të ekzistuar si i tillë. Vepra është një përmendore e gjallë e arbëreshëve të Zarës në procesin e pashmangshëm të kroatizimit të tyre që ka zënë fill herët meqë ata që nga fillimi kanë zënë ta mësojnë gjuhën kroate, e pjesa e madhe e tyre dhe atë italiane, kështu që krijojnë përshtypje për një popullatë trilinguale.

Kjo vepër e profesor Aleksandër Stipçeviqit me përmbajtjen e pasur dhe interesante dhe me ligjërimin e shkëlqyeshëm të autorit me një përvojë të gjatë shkencore e krijuese do të jetë një dhuratë e vlefshme për lexuesit kroate, siç pohon prof. Katiqiçi, një mundësi për të mësuar “më shumë për vetveten, për kulturën kroate, për shtresëzimin e veçantive të saj”. Vepra do të jetë, po ashtu, dhuratë shumë e vlefshme edhe për lexuesin e rëndomtë shqiptar, i cili me anë të saj ka mundësi të mësojë më shumë për jetën dhe përvojën jetësore të arbneshëve të

Zarës, si shqiptarë të vërtetë, që kaluan nëpër shekuj të qëndresës së tyre. Me dimensionin e veçantë të një vepre të rrallë shkencore “*Kultura tradicionale e arbnesëve të Zarës*” do të jetë model, se si duhet të punohet në fushë kaq të begatshme të shkencës, jo vetëm për fillestarët si lexues të rëndomtë, por edhe për të gjithë ata që synojnë që të merren seriozisht me shkencat humanitare, sidomos me studime në fushën e antropologjisë kulturore, të folkloristikës dhe të albanologjisë në përgjithësi.

Për punën e tij të madhe në hartimin e kësaj vepre, profesor Stipçeviqi meriton një mirënjohje dhe respekt të veçantë, jo vetëm nga të gjithë shqiptarët dhe kroatët, por edhe nga të gjithë adhuruesit e vlerave njerëzore, sidomos të diturisë dhe lirisë. Prandaj, në fund, duke përfunduar këtë fjalë të rastit, duke mbyllur këtë vështrim të shkurtër për këtë vepër madhore, këtë enciklopedi për Arbneshin e Zarës, si edhe për kënaqësinë që kam përjetuar gjatë përkthimit të kësaj vepre të mrekullueshme, e falënderoj nga zemra profesorin Aleksandër Stipçeviq. Njëkohësisht, ju falënderoj edhe juve, pjesëmarrës të nderuar të këtij përrurimi, që me dëgjuat me vëmendje e durim.

Sadri FETIU

NJË STUDIM ME VLERA SHKENCORE PËR TOPONIMET DHE RITET PAGANE NË BRESANË TË OPOJËS

Ismail Abazi – Milazim Garipi, Bresana në monografi, Prizren, 1999-2000, f. 212.

Punimi studimor «*Bresana në monografi*» i bashkautorëve Ismail Abazi – Milazim Garipi është një studim origjinal me vlera kulturore e shkencore për trevën e Opojës e veçanërisht për Bresanën (dikur Brodosanën), fshatin e lashtë e më të madh të kësaj treve.

Bashkautorët e veprës në shqyrtim, me punën e tyre të gjatë e këmbëngulëse, kanë arritur të nxjerrin rezultate të qëndrueshme shkencore duke paraqitur saktësisht pozitën gjeografike të Bresanës në kuadër të Opojës dhe të Kosovës në tërësi si dhe mënyrën e jetesës së banorëve bresanas, historinë e këtij fshati mandej doket, zakonet, ritet, emërvendet etj.

Bresana shtrihet rrëzë Bjeshkës së Sharrit, në verilindje të Dragashit e në pjesën lindore të Opojës. Kufizohet me fshatrat Kuklibeg e Kuk në jug, me fshatin Buzez në perëndim, me fshatin Brrut në veriperëndim, në veri ka fshatin Zgatar e në verilindje kufizohet me fshatrat Blaç e Zaplluxhë, ndërsa në lindje, përtej Bjeshkës së Sharrit ka fshatrat e Tetovës, Veshallën dhe Buzovcin. (Vep. e cit. f. 9).

Lënda e veprës është trajtuar në 212 faqe prej 32-33 njësive-tituj që janë ndarë mandej në tituj e nëntituj të shumtë që formojnë së bashku një tërësi logjike-kuptimore për Bresanën dhe banorët e saj në një prerje të caktuar sinkronike. Në fillim të kësaj vepre është dhënë një Vlerësim i recensentit prof. dr. Asllan Pushka, një vlerësim i ngjeshur e objektiv; në fund të veprës është vënë një Pashënie prej dy faqesh, një resime (Afternom) prej dy faqesh, Literatura e përdorur prej dy faqesh dhe, në fund, Përmbajtja e lëndës prej tri faqesh.

Në vazhden e këtij shkrimi do të përpiqem të paraqes trajtën e veprës në shqyrtim, strukturën dhe përmbajtjen e saj, vetëm aq sa për ta informuar lexuesin e nderuar me këtë vepër origjinale e serioze që sjellë shumë faktografi e informacion për temën në shqyrtim.

Unë do t'i vëzhgoj emërvendet (toponimet) si dhe festat e motmotit e ritet rreth tyre, por pa hyrë thellë në transmetimin e dukurive gjuhësore në aspektin etimologjik apo në çështje teorike për gnoseologjinë e toponimeve a termave të tjera shkencore të përdorura në veprën në shqyrtim.

Autorët e veprës në shqyrtim konsiderojnë se emërtimi i fshatit përbëhet nga kompozita **breu** dhe **sana** (= Bresana). Si banorë të këtij fshati dhe njohës të mirë të terrenit si dhe të gjendjes e rrethanave jetësore të kësaj ane, kanë mbledhur shumë toponime (mikrotoponime) dhe i kanë sistemuar ashtu siç duhet. Këto toponime kanë edhe karakter praktik, sepse ato janë shenja gjuhësore për të veçuar objektet në natyrë si dhe morfologjinë e një vendi që, siç dihet, mund të jetë breg, lug, kodër, shpat, gërrellë, maje, qafë, shpellë etj.

Me një kujdes të veçantë, duke i përdorur kriteret e caktuara shkencore në veprën «*Bresana në monografi*», autorët kanë konstatuar se «... tërë peizazhi natyror i Bresanës me emërvendet e veta krijojnë një kolorit shumë tërheqës

toponomastik me përmbajtje dhe elemente shumë të vjetra dhe me karakteristika gjuhësore kryekëput iliro-shqiptare... që përmbushin bazën shkencore të autoktonisë dhe lashtësisë së bresanasve». (Vep. e cit. f. 14).

Emërvendet (toponimet) e fshatit Bresanë dalin me domethënie të ndryshme, si p.sh.: 1. Toponime antroponimike (patronimike): *Kodra e Lisit Gashit, Kroj i Pervizit, Guri i Ketës, Guri Reçit, Lisi Marashit* etj., që ruajnë një vjetërsi të patronimeve e fiseve shqiptare. Në këtë vazhdë është përdorur edhe toponimi TE KCEN UJIT, që do ketë dalë nga forma Te (ku) Kcen Ujt, toponim perifrastik sipas strukturës gramatikore parafjalë + folje + emër; 2. Toponime të emërtuara sipas pronarit: Livadhi Kases, Guri Sinanit, Arat e Mehes etj. që janë më tepër ara e livadhe; 3. Toponime të emërtuara sipas botës bimore-florës: Qershizat, Murrizet, Verri Madh, Kroj i Ferres etj.; 4. Toponime me prejardhje nga emrat e shtazëve, si: Guri Dhive, Gavra Ukit, Udha e Love etj.; 5. Toponime me prejardhje nga emrat e shpezëve, si: Rrasa Shqipes, Guri Korbit etj.; 6. Toponime sipas ngjyrës dhe konfiguracionit të vendit, si: Rrasa e Kokës, Guri Spic, Guri Bardh, Lugi Kuq etj.; mandej ka në këtë vepër edhe toponime të tjera të formuara sipas rregullave të fjalëformimit sikurse edhe në të folmet tjera të shqipes si: Udha e Pllajnikit, Reka e Kukit, Livadhi Madh, Arat e Gata, Kroni Nxetë (Vep. e cit. f. 22-23); Hurdhat, Brijat, Topillat, Lugjet e Gurit Dhive, Nerfushat, Miudhset, Rrafshinat e Poshta, Rrafshinat e Nalta (po aty, f. 24-25); Mivijat, Nervijat, Shullani (po aty, f. 26).

Përveç toponimeve që u përmenden, dalin këtu edhe shumë mikrotoponime të tjera, hidronime – emra lumenjsh e krojesh si dhe etnonime të shumta siç janë emërtimet e lagjeve (mëhallëve) të Bresanës. Në Bresanë, autorët e Monografisë në shqyrtim, përmendin këto lagje:

Mëhalla e Beçirajve – në krye të fshatit e përbërë nga dy vëllazëri: Dedaj e Balaj. Mëhallët (lagjet) tjera janë: Xhyzelajt, Durajt, Qaperlakajt, Danajt, Kërdhaçajt, Tushajt, Bilajt, Babëhasanajt, Dashajt, Shabajt, Qenanajt dhe Imamajt (Vep. e cit. 76-92). Duke trajtuar lagjet dhe banorët e tyre dalin këtu edhe shumë antroponime e patronime (mbiemra familjarë - llagape) që janë me interes për gjuhësinë shqiptare dhe historinë e saj, si, bie fjala, Vesaj (Ivezaj), Çoçaj, Kupajt, Osajt, Sallajt, Bardhajt etj.

Nga onomastika e Bresanës si dhe e fshatrave të tjera të këtij regjioni malor del se treva e Opojës përmendet që moti në dokumentet latine, në shkrimet kishtarë të Mesjetës serbe dhe në defterët osman-turq si territor i Pultit katolik, përkatësisht i Principatës së Arbërit që do të ketë qenë e besimit të krishterë të ritit katolik-romak. Nga fundi i shek. XV gjithë popullata e Opojës, të drejtuar nga zotërinjtë bresanas, e përqaftuan fenë islame. Qysh në atë kohë Bresana ishte qendër e kulturës islame në Opojë. Thonë historianët se shkollat e para në Bresanë i organizoi Mehmet Hajrudini «Kuklibegu» që ishte burrë me famë dhe njëri ndër pasanikët e dalluar të Prizrenit në vitin 1516 e më vonë. Janë ruajtur në të folmen shqipe të Bresanës dhe të fshatrave përreth disa mikrotoponime latine-ballkanike si, bie fjala, Udha Pukë, nga emri latino-ballkanik «Via Publika», që haset në katundin e sotëm Zgatar të Opojës, mandej emri Blaç nga latinishtja «Blasius» si dhe fjala kurt në Bresanë e gjithandej në Opojë nga latinishtja ballkanike curtis «oborr,

kopsht»; mandej fjala burg-u nga latinishtja burgus me kuptimin «mal, kurriz mali, gungë shkëmbore» etj.

Do theksuar se hidronimet Sheu i Madh, Sheu i Vogël, që përdoren në Bresanë, dalin po me këtë trajtë edhe në disa të folme të Malësisë së Mbishkodrës e sidomos në krahinën e Plavë – Gucisë.

Festat e motmotit në Bresanë si dhe ritet e tyre përdoren shumë e festohen për çdo vjet në mënyrë tradicionale.

Dita e parë e pranverës që festohet më 13 mars quhet «Verëza», që ka kuptimin «Vera e Vogël». Të rinjtë e fshatit, djem e vajza bashkë, ziejnë vezë dhe i ngjyrosin ato me ngjyra të ndryshme dhe dalin në vende të caktuara, ku ndezin edhe zjarre; ndezin edhe ndonjë degë dëllinje. Atje jehon kënga dhe hidhet vallja; i bien edhe defit (dahires). Gratë qesin flija dhe pastrojnë oxhakun me një degë dëllinje që, sipas simbolikës së vendit, pastrohen të këqijat e asaj shtëpie. Të rinjtë futen nëpër oborre të shtëpive dhe iu drejtohen zonjave të shtëpive me këto vargje:

«Oj e zoja e shpisë

A kije bukë e gjizë?

Ajo u përgjigjet:

-Kam po qysh nuk kam», etj. (Vep. e cit. f. 96)

Festat tjera të motmotit që festohen në Bresanë (dhe në tërë Opojën) janë Shëngjergji «Dita e Shëngjergjit» e gjashta ditë e muajit maj; Shënkolli që festohet këtu më 25 maj. Dikur është festuar «Jeremija», që sot e festojnë vetëm vajzat.

Ritet rreth festave familjare janë shumë të pranishme në Bresanë. Këto janë lindja, ceremoniali i kumarisë (nunrisë), synetia, fejesa, dasma që përcillen me këngë e valle. (Shih gjërësisht vep. e cit. f. 95-128).

Doket e vjetra rreth lindjes përdoren rregullisht në Bresanë. Ceremoniali kryesor i lindjes kryhet pas disa ditësh ose javësh nga lindja e fëmijës. Ky ceremonial quhet Përgim, që ka dalë nga shprehja «Përgëzim» me kuptimin «Shkojmë në vizitë për gëzime» etj.

Vallet në fshatrat e Opojës janë karakteristikë dalluese e banorëve të këtij terreni. Ahengjet në Opojë, përkatësisht në Bresanë, përfshihen në dasma, fejesa, syneti, përgëzime dhe festa të ndryshme. Të gjitha këto festa përcillen me valle dhe lojëra. Në valle marrin pjesë persona të përgatitur, profesionist të vërtetë që janë artistë (e artiste) të lindur. Trinomi dahire (defi), vallja dhe kënga formojnë një gërshetim artistik shumë të bukur që rrallë mund t'i gjendet modeli në Siujdhesën Ilirike. Çdo valle e femrave të Bresanës përcillet me këngë, ku dallohen edhe këto vargje:

«Ka ra dilli n'gardh e n'gardh

Hajde luj me ne mori bofqe bardhë;

Ka ra dilli bjeshkë e n'bjeshkë

Hajde hiqe vallen moj vetullë kaleshë»

(Vep. e cit. f. 125).

Në manifestime familjare ka raste kur përzihen meshkuj e femra dhe vallet përcillen me zurlë e tupan. Në Bresanë është traditë e moçme që profesionistët për zurlë e tupan, siç ishin mjeshtrit «Usta Sala e usta Sahiti», siç i quante popullata në

mesin e viteve '50-ta të shek. XX, e ruanin këtë traditë këtu, në Bresanë që nga kohët e lashta e këndej, për ç'gjë ka të dhëna të sigurta historike e gjuhësore.

Tradita e lashtë ilire-shqiptare për festat pagane, si Verzat, Jeremija, Shëngjergji, Shmitri si dhe ritet rreth tyre që përcillen me këngë e valle, përdoren dendur në Bresanë dhe në tërë Opojën. Për ndonjë festë të motmotit si dhe për sportet e vjetra, pos të tjerash, ka qenë i caktuar Mejdani i Buzezit, që kishte një hapësirë shumë të madhe. Aty mbaheshin garat e vrapimit të kuajve, lojërat e pelivanëve (mundësit), hedhja e grurapeshit etj. Lojërat e pelivanëve që mbaheshin për çdo vjet në Mejdani të Buzezit përcilleshin me zurlë (surlë) e tupan. Kanë qenë të njohur pelivanët e Bresanës si dhe vëllezërit Idrizi e Ramadani nga Veshalla e Tetovës, të cilët, me trupin e tyre të bukur e shumë të zhvilluar, u përngjanin spartanëve të botës antikë. Ishin të parët në këtë sport antik si në Evropë ashtu edhe në Azi. Gjithë popullata e Opojës mblidhej në Mejdani e Buzezit. I tërë vendi kishte hare të madhe dhe i përngjante parajsës. Vajzat e Opojës me veshjet e bukura të tyre, ashtu si nënat e hallat e tyre ilire-shqiptare, u përngjanin amazonave të Greqisë së lashtë. Sjelljet e tyre, morali i lartë që kanë si dhe dashuria për vendlindjen është karakteristikë dalluese e femrës së Opojës. Me këngët e vallet e tyre në gazmendet e mëdha kombëtare, që organizoheshin dikur në Mejdani e Buzezit, i jepnin vendit një pamje aq madhështore sa përtonin njerëzit të shkëputeshin nga ai ambjent e të shpërndareshin.

Vepra «*Bresana në monografi*» e bashkautorëve Ismail Abazi e Milazim Garipi, është vepër e parë, me sa di unë, e këtij lloji. Autorët e shquar e patriotë të dalluar kanë dhënë një kontribut me vlera të shumta kulturore e shkencore. Kjo monografi paraqet një pasqyrim origjinal dhe autokton të Bresanës së Opojës që mund të shërbejë si model edhe për ambientet tjera. Janë përdorur këtu edhe disa harta topografike, grafikone e skica që ia shtojnë vlerën punimit dhe që sjellin shumë faktografi. Kjo vepër mund t'u hyjë në punë gjeografëve, historianëve, etnografëve e veçmas gjuhëtarëve.

Treva e Opojës është një terren i banuar që moti dhe i ka disa karakteristika të veçanta gjuhësore. Për këtë është e udhës, kujtoj, që onomastika e trevës së Opojës si dhe e folmja e saj të trajtohen ose të ritrajtohen thellësisht nga studiues të sinqertë e të përgatitur shkencërisht.

Bajram MEHMETAJ

KRONIKA SHKENCORE**ITSHKSH ME REZULTATE TË LAKMUESHME SHKENCORE NË VITIN 2015**

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup (ITSHKSH), duke qenë tashmë një institucion i etabluar që përpiqet me të gjitha energjitë e veta krijuese dhe potencialet hulumtuese të kontribuojë në zhvillimin dhe avancimin e shkencës ndër shqiptarët e Maqedonisë dhe jo vetëm, në vitin 2015 ka dhënë kontribut të çmuar në shumë segmente. Në vijë të këtij konstatimi është përmbushja me sukses dhe përpikëri e planit të punës, i hartuar në fillim të vitit që lamë pas.

Për dallim nga vitet e kaluara, kur objektivisht ka munguar mbështetja financiare nga Ministria e Arsimit, këtë vit ky dikaster së bashku me Ministrinë e Kulturës kanë qenë mbështetësit kryesorë të projekteve dhe aktiviteteve shkencore të ITSHKSH-së përgjatë vitit, ndërsa duhet cekur edhe ndihma e pamohueshme e Komunës së Çairit, por edhe e organizatës së respektuar ZFD nga Gjermania.

PROJEKTE TË SHUMTA NË VITIN 2015

Në vitin 2015 kanë vijuar me sukses të plotë studimet pasdiplomike në programin studimor Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Gjenerata e parë ka ndjekur semestrin e tretë, ndërsa gjenerata e dytë ka ndjekur semestrin e parë. Në mesin e kandidatëve ka kapacitete nga të cilat priten rezultate shumë pozitive shkencore-hulumtuese.

Më 12 mars Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, organizoi tribunën shkencore në 100- vjetorin e Luftës së përgjakshme të Çanakkalasë, ku edhe shqiptarët dhanë kontributin e tyre me pjesëmarrje masive. Historiani i njohur shqiptar Nebi Dervishi dhe historiani nga Turqia Ebu Bekër Sofleu paraqitën pikëvështrime të ndryshme mbi këtë luftë. Sipas të dhënave të prezantuara, në këtë luftë morën pjesë rreth 35 mijë shqiptarë. Historiani turk sqaroi se 90% prej tyre humbën jetën në luftë, ndërsa atyre që mbijetuan iu ofruan pasuri dhe tokë, por ata nuk pranuan, sepse lufta e tyre ishte luftë për ideale, që dëshmon madhësinë e shqiptarëve si popull.

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup, në bashkëpunim me Shoqatën e Gazetarëve të Maqedonisë dhe Shoqatën e Historianëve Shqiptarë të Maqedonisë, më 4 prill të vitit të kaluar shënuan 70-vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës shqipe “Flaka e Vëllazërimit”. Me këtë rast, në ambientin e Institutit, u hap ekspozita me disa fotografi – imazhe të gazetës "Flaka" ndër vite, ku edhe u zhvillua një debat i ngjeshur lidhur me kontributin e kësaj gazete. Në pjesë e madhe e protagonistëve kryesorë të gazetës “Flaka” iu përgjigjën ftesës së ITSHKSH-Shkup për pjesëmarrje në tribunë.

Skender Asani, drejtor i ITSHKSH, tha se gazeta “Flaka” është kontinuitet i zhvillimit të shtypit shqiptar dhe se kjo gazetë është trashëgimi kulturore e historike e shqiptarëve të këtyre trojeve.

Një referat historik për 70 vjetorin e botimit të numrit të parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”, në emër të Këshillit organizativ paraqiti punonjësi shkencor

i ITSHKSH, Sevdail Demiri, i cili tha se në vend se ky përvjetor i 70-të të shënohej me akademi solemne dhe me një format më festiv nga vetë udhëheqja e gazetës, sot po shënohet në mënyrë modeste – përkujtimore nga Instituti dhe dy shoqata respektive.

Ndërsa Naser Selmani, në emër të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, i dorëzoi mirënjohje post mortum Petro Janurës – kryeredaktorit të parë të gazetës, të cilën e pranoi i nipi i tij, Petro Janura.

Më pas, në debat morën pjesë ish- kryeredaktorët e gazetës, Fejzi Bojku, Abdylhadi Zylfiqari, Faik Mustafa, Zeqirja Rexhepi, Daut Dauti, ish-redaktorët e gazetarët Halil Zendeli, Shkëlzen Halimi, Nazif Zejnullahu, Mixhait Pollozhani, Tahir Zajazi, Xheladin Murati, Mustafa Peza, Enver Shala, Abdurrahman Kurtishi, studiuesi Blerton Sulejmani, etj. Gazeta “Flaka e Vëllazërimit” dhe revistat e saj “Fatosi” dhe “Gëzimi”, u vlerësuan si trashëgimi kulturore e historike e shqiptarëve të Maqedonisë. Një nga konkluzat e debatit ishte që të shqyrtohet seriozisht mundësia e ruajtjes së asaj që ka mbetur pa u zhdukur deri tani. Një punë shumë e rëndësishme dhe e mundur të realizohet, është dixhitalizimi i plotë i gazetës, për ta parandaluar shkatërrimin e plotë të arkivit të saj që në gjendje jo shumë të mirë gjendet në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Shkupit. Çështja e rikthimit në jetë të emrit të “Flakës”, gjithashtu ishte një impenjim serioz, që kërkon njerëz të fortë dhe të vendosur për të ruajtur vlerat tona.

Prilli ka qenë muaj i frytshëm për Institutin. Më 20 prill në Gjimnazin e Tetovës, para gjimnazistëve u zhvillua punëtorja “Promovimi i trashëgimisë kulturore të shqiptarëve para të rinjve”.

Udhëheqësi i projektit, Dr. Sefer Tahiri, theksoi rëndësinë e njohjes të rinisë sonë me pjesë shumë të rëndësishme të trashëgimisë tonë kulturore e shpirtërore, të cilat dita – ditës po humbin gjurmë.

Më pastaj para gjimnazistëve të vitit të katërt, u referuan këto tema:

–Dr. Sevdail Demiri- “SHTYPI SHQIPTAR NË MAQEDONI, SI TRASHËGIMI KULTURORE”;

–Dr. Zeqirja Ibrahim- “GJUHA DHE LETËRSIA SHQIPE, PJESE E RËNDËSISHME E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE IDENTITETIT TË SHQIPTARËVE”;

– Prof. dr. Bukuriye Mustafa- “LOJËRAT POPULLORE”;

– Prof.dr. Izaim Murtezani- “KARNEVALI I BOZOVCËS”, dhe

– Dr. Hidajete Azizi- “RËNDËSIA E EMRAVE VETJAKË”.

Po ashtu u shfaq edhe filmi dokumentar “NJË JETË NË IKJE” (ZEJET NË MAQEDONI).

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar që ka me Institutin gjerman “Georg Eckert” dhe Institutin e Historisë Nacionale të Shkupit, më 3 dhe 4 qershor organizoi konferencën shkencore “Historiografia dhe mësimdhënia e historisë në rajonet gjuhësore të sllavishtes jugore dhe shqipes”.

Konferenca, e para e këtij lloji në rajon, kishte për qëllim hulumtimin, studimin dhe identifikimin e problemeve në lëmin e historiografisë dhe mësimdhënien e lëndës së historisë në rajonet sllavofolëse dhe shqipfolëse. Në

mesin e shumë studiuesve të njohur të historisë nga rajoni e bota, mori pjesë edhe Prof. dr. Natali Klajer nga Parisi. Nga ITSHKSH, në këtë konferencë, punimet e tyre i prezantuan Dr. Skender Asani dhe Dr. Besnik Emini.

Nën patronatin e Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Prishtinë më 5 qershor u organizua konferenca shkencore: “Isa Boletini në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare”. Bashkorganizatorë të kësaj konference ishin tre institutet shqiptare në trekëndëshin Prishtinë-Tiranë-Shkup: Instituti i Historisë i Prishtinës, Instituti i Historisë i Tiranës dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Kjo ishte hera e parë që në këtë format bashkëpunuan tre institucionet shkencore në hapësirën shqiptare. Në këtë konferencë morën pjesë gjithsej 24 studiues të njohur të historisë sonë kombëtare, ndërsa nga ITSHKSH me kumtesë u paraqit Dr. Sevdail Demiri. Drejtori i ITSHKSH-së, Dr. Skender Asani ishte pjesë e Këshillit organizues të konferencës.

Më 26 gusht të vitit 2015 në ITSHKSH-Shkup u mbajt tribuna shkencore me temë "Shqiptarja nga Shkupi - Nënë Tereza". Punimet e tyre shkencore në këtë tribunë i paraqitën:

- Dr. Don Lush Gjergji: Fuqia e fesë dhe frymëzimi i dashurisë – NËNA TEREZE
- Dr. Skender Asani: Pronësia e shtëpisë së Gonxhe Bojaxhiut (Nënë Terezës) – dëshmi për shqiptarësinë e sheshit të Shkupit (dokument)
- Prof. dr. Nebi Dervishi: Nënë Tereza– nobelistja shqiptare nga Shkupi (me rastin e 105- vjetorit të lindjes - 26 gusht 1910-2015)
- Dr. Sefer Tahiri: Tendencat për zvetënimin e identitetit etnik shqiptar të Gonxhe Bojaxhiut
- Fadil Curri: Pse po struket historia shqiptare e Shkupit?
- Don Viktor Sopi: Nënë Tereza në vizionin e personaliteteve botërore

Shtatori si zakonisht pas muajve të verës, gjithmonë është produktiv në planin e realizimit të aktiviteteve të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup. Më 11 shtator, në ditën e tragjedisë së popullit amerikan dhe luftës kundër terrorizmit global, në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, u shfaq njëri nga projeksionet më të mira dokumentare – filmike, që flet për kontributin e madh të shqiptarëve në shpëtimin e mijëra familjeve hebreje gjatë Luftës së Dytë Botërore - filmi “BESA: Premtimi”. Atë e ndoqën ambasadori amerikan, Xhes Bejli, i cili edhe pati një fjalë rasti, ku çmoi lart virtytin e hershëm të shqiptarëve për fjalën e dhënë, si dhe shumë ambasadorë të tjerë, krerë fetarë, politikë dhe shtetërorë. Të pranishmit u përshëndetën edhe nga drejtori i ITSHKSH-së, Skender Asani, drejtori i Qendrës Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, Goran Sadikario, kryetarja e Komunitetit Hebraik në Maqedoni, Berta Romano-Nikoliq, dhe nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilqim Ademi. Mjaft emocionale ishte paraqitja e znj. Ita Faraxhi nga Izraeli, familja e së cilës ishte nga Shkupi, ndërsa kishte ikur në Shkodër të Shqipërisë për të shpëtuar nga nazistët. Atje kishte lindur, ishte pagëzuar me emrin Drita dhe kishte jetuar dy vjet në një familje shqiptare. Ngjarja u organizua nga Qendra Memoriale e Holokaustit të Hebrenjve në Shkup dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit e Shkencës dhe Komunës së Çairit.

Në vazhden e bashkëpunimit midis ITSHKSH dhe Qendrës Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve në Shkup, në muajin tetor drejtori i Institutit, Dr. Skender Asani, i dorëzoi Qendrës gjithsej 729 dokumente dhe 49 fotografi. Materiali i pasur arkivor është hulumtuar në Arkivin Qendror të Shqipërisë në Tiranë, nga një ekip i studiuesve të këtyre dy institucioneve nga Shkupi. Dokumentet dhe fotografitë në fjalë flasin për historinë e shpëtimit të hebrenjve nga ana e shqiptarëve të Shkupit e Kosovës, gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore. Ato paraqesin një thesar të çmuar të historiografisë shqiptare e botërore, duke dëshmuar për një virtut të lartë dhe shumë të çmuar për shqiptarët historikisht, siç është besa, e cila i shpëtoi qindra e mijëra hebrenj nga nazizmi. Ndryshe, shqiptarët shpëtuan të paktën 3280 hebrenj gjatë Holokaustit. Gjatë viteve 1933-1944, Shqipëria shpëtoi jo vetëm hebrenjtë vendës, por edhe të gjithë ata që mundën ta arrinin Shqipërinë nga vendet e tjera të Europës. Andaj, si mirënjohje për këtë, Institucioni “Yad Vashem” në Jeruzalem deri më tani ka njohur zyrtarisht 69 shqiptarë si “Fisnikë të Kombeve” në shpëtimin e hebrenjve gjatë Holokaustit.

Më 1 dhjetor në Qendrën Memoriale të Holokaustit të Hebrenjve nga Maqedonia u hap ekspozita me temë: “Ballafaqimi me të kaluarën – guximi qytetar në kohë të vështira”. Përmes kësaj ekspozite me 34 fotografi dhe dokumente, për herë të parë u pasqyruan realitetet e bashkëpunimit mes komuniteteve në Maqedoni, në rrafshin human, në periudhat para, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Më 14 dhe 15 shtator në Shkup u mbajtën punimet e konferencës shkencore me temë: “*Jeta shoqërore e shqiptarëve në Shkup dhe rrethinë ndërmjet dy luftërave botërore*”. Konferenca u mbështet financiarisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Konferencën e hapi ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilajim Ademi, i cili tha se mbështetja e kësaj konferencë shkencore kishte synimin që të dalin në pah të vërteta të reja historike që do ta begatojnë mozaikun historiografik për Shkupin. Ndërsa drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, Dr. Skender Asani, tha se kjo është hera e parë që në mënyrë shkencore hulumtohet kjo periudhë e ndjeshme historike. Fjalë përshëndetëse patën edhe drejtori i Institutit të Historisë në Tiranë, Akademik Beqir Meta, drejtori i Institutit të Historisë në Prishtinë, Prof. dr. Sabit Syla, dhe drejtori i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof. dr. Hysen Matoshi.

Punimet e tyre i prezantuan 33 studiues të njohur nga shumë qendra shkencore të vendit dhe jashtë. Në sesionin e parë u paraqitën me kumtesa këta studiues: Beqir Meta, Nebi Dervishi, Marenglen Verli, Daut Bislimi, Avzi Mustafa, Qerim Lita, Shinazi Memedi, Adnan Ismaili, Viktor Sopi, Naim Halimi, Metin Izeti, Nuridin Ahmeti, Skender Asani dhe Mehmet Prishtina. Kurse, në sesionin e dytë, me kumtesa u paraqitën këta studiues: Qemal Murati, Zeqirija Ibrahim, Albert Ramaj, Mixhait Pollozhani, Isamedin Azizi & Agron Saliu, Lidija Gjurovska & Gabriela Topuzovska, Fadil Curri, Natasha Didenko & Albert Hani, Izaim Murtezani, Skender Lutfiu, Sefer Tahiri, Sevdail Demiri, Besnik Emini, Ardian Limani, Naser Ramadani, Taxhedin Bislimi, Murtezan Idrizi, Islam Islami & Muhamed Ali, Afet Jashari dhe Rini Useini. Në kuadër të këtij aktiviteti u

prezantua projekti: “Veshja popullore në rajonin e Karshiakës” nga Dr. Bukurije Mustafa, mbështetur nga Ministria e Kulturës e Maqedonisë.

Me rastin e festave të nëntorit dhe 50- vjetorit të vdekjes së Fan S. Nolit, Instituti më 20 nëntor organizoi tribunën shkencore me temë “*Fan S. Noli – figurë emblematike për shqipen dhe shqiptarët*”. Mysafir special në këtë aktivitet ishte prijësi i Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare me seli në Elbasan, At Nikollë Marku, njëri nga pasuesit e frymës kombëtare të Nolit. Ai tha se ndjehet krenar që figura e Nolit vazhdon të nderohet e kujtohet gjithkrah ku ka shqiptarë, si një njeri që gjatë gjithë jetës së tij punoi dhe veproi në shërbim të popullit të tij që aq shumë e deshë. Në këtë tribunë, me kontributet e tyre shkencore u paraqitën studiues të njohur të veprës së Nolit:

Ali Jashari: “Për Fan Nolin dhe visarin e tij frazeologjik popullor”;

Qemal Murati: “Fan Noli – ky lëvrues i madh i fjalës shqipe”;

Avzi Mustafa: “Noli në mesin e shqiptarëve të Ukrainës”;

Zeqirja Neziri: “Noli dhe epika gojore shqiptare”;

Olger Brame: “Përdorimi i simboleve në veprën e Fan Nolit”;

Mirlinda Krifca: “Noli mes mitit dhe realitetit”;

Myrvete Dreshaj – Baliu & Begzad Baliu: “Studimi i Nolit dhe veprës së tij në Kosovë”;

Avni Spahiu: “Vatra e shqiptarëve të Amerikës dhe Noli”;

Shpëtim Çuçka: “Noli – simboli i përkthimit shqiptar” dhe

Zeqirija Ibrahim: “Prifti kryeministër Fan S. Noli”.

BOTIMI I VEPRAVE DHE REVISTAVE SHKENCORE -VEPRIMTARI BAZIKE E ITSHKSH-së

Në vitin 2015 dolën nga shtypi botimet e reja të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup. Bëhet fjalë për numrin e 11-të me radhë të revistës shkencore “Studime albanologjike”, katër numra të revistës periodike “Scupi”, “*Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*” me autor Qemal Muratin, dhe “*Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991)*”, aspekti kulturor-arsimor” me autor Sevdail Demirin.

Në këtë edicion të revistës “Studime albanologjike” mund të lexohen punime shkencore nga 26 studiues të ndryshëm nga të gjitha trevat shqiptare, por dhe nga disa autorë të huaj nga fusha e historisë, gjuhës, letërsisë, folklorit, etj. Numri 8 i botimit periodik të Institutit “SCUPI” përfshin punimet e konferencës shkencore “*Shaban Demiraj – figurë e shquar e albanologjisë dhe ballkanologjisë*”, e mbajtur më 21 nëntor 2014. SCUPI-9 boton punimet e konferencës shkencore “Sfidat e trashëgimisë kulturore në Maqedoni”, e mbajtur më 30 shtator 2014.

Numri 10 i botimit “SCUPI” ngërthen në vete kumtesat shkencore të tribunës shkencore së mbajtur më 4 prill 2015 me rastin e 70- vjetorit të botimit të numrit të parë të gazetës “Flaka e Vëllazërimit”. Ndërsa numri më i ri i revistës periodike “SCUPI”-11, i kushtohet shqiptares nga Shkupi - Nënë Tereza. Ky botim përmban punimet e konferencës shkencore të mbajtur më 26 gusht 2015 në ITSHKSH-Shkup kushtuar kësaj figure të madhe kombëtare dhe universale.

Botimi “*Fjalor i fjalëve dhe shprehjeve nga trojet e shqipes në Maqedoni*” me autor Qemal Muratin, me gjithsej 860 faqe, përmban mbi 20.000 leksema, frazeologji dhe topeleksema të mbledhura nëpër vendbanimet shqiptare të Maqedonisë. Ky fjalor është i thurur edhe me lëndë të leksikut toponimik, me emra të vendeve (rreth 5.000 topeleksema). Në lëndën e këtij Fjalori janë arkivuar dhe rreth 1.000 njësi frazeologjike, fraza idiomatike, eufemizma etj., me vlera të veçanta etnolinguistike.

Kurse libri “*Shtypi shqiptar në Maqedoni (1945-1991), aspekti kulturor-arsimor*” me autor Sevdail Demirin, përbën një botim të veçantë shkencor të historisë së shtypit shqiptar në Maqedoni, ku sidomos është hulumtuar aspekti kulturor-arsimor. Këtu në radhë të parë flitet për gazetën “Flaka e Vëllazërimit”, e cila ishte shenjë dalluese me të cilën identifikohesh jo vetëm shtypi dhe gazetaria shqiptare në Maqedoni në periudhën e caktuar, por gati se i gjithë zhvillimi kulturor-arsimor i shqiptarëve, i cili pasqyrohet në këtë gazetë. Pjesë e hulumtimit në këtë libër janë edhe revistat për fëmijë “Gëzimi” dhe “Fatosi”, si dhe revista për art, për shkencë dhe për kulturë “Jehona”.

Këto tre botime janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, në bazë të programit nacional për kulturë të vitit 2015.

PROMOVOHEN VEPRAT TË NDRYSHME NË ITSHKSH

Më 15 prill 2015 Instituti promovoi librin për gjenin e gjeodezisë evropiane e botërore, me origjinë shqiptare, Karl Gega nga historiani austriak Wolfgang Straub, i përkthyer në gjuhën shqipe. Ndryshe, Karl Gega, ishte inxhinier i talentuar, i cili i kaloi kufijtë e fantazisë së njerëzimit. Karl Gega ishte me origjinë shqiptare. U lind në Venedik më 10 janar 1802. Prindërit i kishin lindur në Kallmet të Lezhës. Vdiq në Vjenë, më 14 mars 1860.

Më 11 qershor u promovuan dy veprat shkencore të Don Viktor Sopit: “*Fishta, dëshmi e identitetit shqiptar*”, dhe “*Gjeçovi – tradita dhe qytetërimi shqiptar*”. Recensionet e tyre rreth këtyre dy veprave i paraqitën studiuesit: Prof. dr. Emin Kabashi – këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, dhe Dr. Zeqirija Ibrahim – studiues dhe punonjës shkencor i ITSHKSH-së. Po ashtu, një sintezë të përmbajtjes dhe rëndësisë së këtyre veprave paraqitën edhe poeti e studiuesi Sarë Gjergji dhe shkrimtari e publicisti Fadil Curri.

Më datën 17 nëntor të vitit 2015 Ministria e Arsimit dhe Shkencës promovoi 14 tituj të rinj të librave universitarë të përkthyer dhe të botuar në gjuhën shqipe. Titujt e rinj të cilët u promovuan në ambientet e Institutit janë nga lëmi i turizmit, arteve figurative, shkencave matematiko- natyrore, transportit dhe telekomunikacionit dhe shkencave të makinerisë dhe elektroteknikës, pjesë e projektit “Përkthimi i 1000 librave shkencor dhe profesional me të cilat studiohet në universitetet më të mira dhe më me renome në SHBA dhe Angli, kurse nga lëmi i drejtësisë edhe në Francë dhe Gjermani”.

Më 25 nëntor 2015 u promovua projekti i parë i përbashkët në mes dy instituteve shkencore të Shkupit e Tiranës, përkatësisht Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore Të Shqiptarëve dhe Institutit të Historisë së Qendrës së Studimeve Albanologjike në Tiranë. Bëhet fjalë për botimin e librit “S H K U P I” -

Konsiderata etnografike, historike, ekonomike (1942), të studiuesit dhe diplomatit të mirënjohur Hamit Kokalari, të cilin libër e redaktoi dhe përgatiti për botim Akademik Marenglen Verli. Burimi i materialit në këtë libër historik është Arkivi i Institutit të Historisë së Tiranës, fondi etnografik. Botimin e këtij projekti e mbështeti Kryetari i Komunës Çair të Shkupit, Izet Mexhiti.

Pikërisht në datën e njëjtë, pra më 25 nëntor, në shenjë të manifestimeve me rastin e festës së flamurit shqiptar, Posta e Maqedonisë dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup promovuan pullat e reja postare me dy figurat e shquara të historisë kombëtare shqiptare, Ali Pashë Tepelena dhe Dr. Ibrahim Temo. Dy pullat postare publikohen në shumë letra, kartolina dhe dërgesa postare.

Në dhjetor të vitit 2015 u ngrit nisma për licencimin e lektorëve të gjuhës shqipe, nismë kjo e kamotshme e ITSHKSH-së. Me këtë rast ministri i Arsimit dhe Shkencës, Abdilqam Ademi vizitoi Institutin, ku u bisedua për kërkesën e Institutit për licencimin e lektorëve të gjuhës shqipe, që është një hap shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e trashëgimisë sonë kulturore e shpirtërore, ku bie edhe gjuha shqipe, e cila duhet të mbrohet në mënyrë institucionale. U arrit pajtim të formohet një grup punues me përfaqësues të Institutit, MASH-it, Ministrisë së Kulturës dhe Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, të cilët do të hartojnë një plan për zbatimin e kësaj ideje, që pritet të realizohet në vitin 2016.

Në vitin 2015 ITSHKSH-së iu shtuan edhe dy doktorë shkencash. Në fushën e historisë, në Universitetin Publik në Shkup doktoroi Besnik Emmini, ndërsa etnomuzikologu dhe violinisti i njohur Ermal Mehmeti doktori në studimet kulturore, duke mbrojtur doktoraturën në Universitetin privat "Evrobalkan".

SYNIMET E ITSHKSH NË VITIN 2016

Para Institutit, menaxhmentit, punonjësve shkencorë dhe administratës së tij edhe në vitin 2016 qëndrojnë shumë projekte, realizimi i së cilave nuk mund të kalojë pa sfida.

Në planin hulumtues-shkencor do të synojmë të realizojmë sa më shumë ekspedita hulumtuese në rajone të ndryshme të vendit për të gjurmuar trashëgiminë tonë kulturore, shpirtërore, materiale dhe historike, por edhe do të organizojmë konferenca shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në planin arsimor synojmë dhe po përqipemi maksimalisht që të organizojmë studime sa më cilësore pasdiplomike, duke krijuar kuadro nga lëmenjtë që kultivojnë identitetin tonë kulturor, gjuhësor dhe etnik të shqiptarëve. Në planin e botimeve synojmë që këtë vit të rrisim numrin e veprave shkencore, që do të botohen nga punonjësit shkencorë të Institutit. Edhe këtë vit konsiderojmë se në këtë mënyrë, duke hedhur nga një pikë në oqeanin e madh dhe të pafund të botimeve shqiptare, do të njohim vetveten, qenien tonë, kush jemi ne dhe më pas edhe tjetrin në kufijtë e Maqedonisë dhe me gjerë.

(Ky referim u lexua në promovimin e punës njëvjeçare të ITSHKSH-së që u organizua më 17 janar të vitit 2016)

Dr. SEFER TAHIRI, sekretar shkencor i ITSHKSH-së

INICIATIVAT PËR UNIVERSITET SHTETËROR SHQIP NË SHKUP¹

Jo njëherë herë është dëshmuar se gjërat nuk ndodhin rastësisht në këtë botë. Për këtë flet edhe kjo histori e parrëfyer. Meqenëse për të nuk ka shkruar kush deri më sot, ndaj si pasojë janë sajuar shumë rrëfime dhe anekdota, deri sa disa prej tyre edhe u mistifikuan. Pasi rasti e deshi që për këtë histori të shkruajmë pikërisht tani kur është intensifikuar projekti edhe për një universitet tjetër publik shqip në Maqedoni, si rrjedhojë, vetvetiu shtrohet pyetja, nëse vallë do të bëhet realitet kjo ëndërr e kamotshme?

Por, sidoqoftë, po i kthehemi subjektit dhe qëllimit të temës së këtij artikulli. Në pamundësi për të siguruar dëshmi të shkruara, (edhe pse nëpër arkiva ekzistojnë kërkesat e hartuara me shkrim dhe shënime të përditshmes së atëhershme “Rilindja”), artikullin e ndërtoam mbi dëshmitë e disa protagonistëve të atij aktivitetit. Të vetëdijshëm se artikulli edhe mund t’i ketë mungesat e tij, (edhe pse kam qenë edhe vetë i inkuadruar në atë aktivitet), megjithatë e lëmë të hapur mundësinë për ata që kanë për të shtuar apo përmirësuar le ta bëjnë këtë lirisht pa u hamendur. Sepse kështu do të ishim më pranë të vërtetës, por njëherësh edhe nuk do t’u mbeteshim borxh as bartësve dhe as historisë së kësaj iniciative.

Nisma nga Prishtina

Të përkujtojmë se bëhet fjalë për një nismë të vjetër që lindi 35 vjet më parë, e cila nisi në Prishtinë dhe përfundoi në Shkup. Rinia përparimtare shqiptare nga Maqedonia e cila studionte në Universitetin e Prishtinës, asokohe ndërmori një hap tejet të guximshëm dhe të rëndësishëm që si lajtmotiv pati misionin e lartë iluminist, atë të hapjes së studimeve universitare në gjuhën shqipe në Shkup.

Kjo nismë sigurisht që nuk lindi aty për aty, pasi që ajo në të vërtetë kishte parahistorinë e saj. Procesi në fjalë ishte motivuar nga nevoja imediate për shkollim universitar në gjuhën amtare të shqiptarëve në Maqedoni. Por lindi edhe si rezultat i ngritjes së vetëdijes kombëtare të gjeneratave të reja. Në përshpejtimin e këtij procesi kishin ndikuar edhe përvjetorët e dy ngjarjeve historike të rëndësishme për shqiptarët. Pra, ishte periudha kur kishte marrë hov të madh lëvizja ilegale për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, para se gjithash në Kosovë, Maqedoni, Perëndim. Pikërisht në atë atmosferë studentët shqiptarë nga Maqedonia vendosën që hapur të paraqesin të drejtën e tyre legjitime për shkollim universitar në gjuhën amtare në Shkup.

Në kërkim të zgjidhjes së çështjes të shkollimit universitar ishin sensibilizuar pothuajse të gjithë studentët shqiptarë nga Maqedonia. Për veprim më efikas studentët kishin formuar një grup më të gjerë organizativ, nga i cili ka dalë një grup koordinues që ka marrë për obligim jetësimin e kësaj kërkese. Në grupin

¹ Artikulli është huazuar nga revista “Shenja”, Shkup, gusht 2015. Botohet me rastin e miratimit të vendimit në Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në dhjetor 2015, për hapjen e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

nismëtar ishin përfshirë përfaqësues nga të gjitha komunat me shumicë shqiptare nga Maqedonia.

Sipas pohimeve të disa nga veprimtarët e atëhershëm grupi në fjalë përbëhej nga këta persona: Bedri Ademi (ish-student i elektroteknikës) nga Tetova, Ismail Bajrami (ish-student i mjekësisë) nga Kumanova, Xhelil Rufati (ish-student i artit figurativ) nga Gostivari, Ali Ahmeti (ish-student i pedagogjisë) dhe Halil Halili (ish-studenti i drejtësisë) nga Kërçova, Atip Sela (ish-student i elektroteknikës) dhe Baki Koleci (ish-student i ekonomisë) nga Dibra, Ida Trena (ish-student i ekonomisë) nga Struga, Aziz Pollozhani (ish-student i mjekësisë) nga Ohri, ndërkohë që na mungojnë emrat e përfaqësuesve nga Shkupi dhe Prespa. Që pastaj secili nga përfaqësuesit në fjalë e kishin shtrirë aktivitetin nëpër komunat nga vinin duke ua parashtruar kërkesën edhe para strukturave të atëhershme partiake dhe komunale.

Motivi i nismës

Për shumë biseda dhe debate konstruktive dhe të ashpra që janë zhvilluar për mënyrën e organizimit, si dhe për dilemat e shumta që e përcollën atë aktivitet, na përkujtojnë dëshmitarët e kohës. Ndonëse, motivet e kësaj nisme kanë qenë të ndryshme, megjithatë, numri i madh i studentëve nga Maqedonia u bë shkak kryesor për ndërmarrjen e asaj iniciative. Flitet për një numër prej rreth 2600 studentësh nga Maqedonia që asokohe studionin në Kosovë. “Meqenëse, kërkesa e maurantëve nga Maqedonia për regjistrim ishte shumë e madhe, për këtë arsye, Rektorati i Universitetit të Prishtinës kishte sjellë një vendim për reduktimin e numrit të pranimit të studentëve jashtë Kosovës. Me këtë vendim parashihej që nga 10% të pranohen vetëm 5 % nga Maqedonia, numër ky që as për së afërmi nuk i plotësonte kërkesat për regjistrim. Krahas edhe motiveve të tjera, sigurisht që ky ishte motivi kryesor që i nxiti studentët për t’u mobilizuar”, përkujton Aziz Pollozhani.

Edhe njëri nga bashkëbiseduesit, Hatib Sela, na konfirmoi se shkas për iniciativën në fjalë ka qenë reduktimi i numrit të pranimit të studentëve nga Maqedonia në Universitetin e Kosovës. “Kryetari i Lidhjes së Rinisë Socialiste së Maqedonisë, pasi e dëgjoji kërkesën tonë, e lëshoi në shenjë refuzimi takimin”, tha Sela.

Këtij procesi i kishin paraprirë 10- vjetori i demonstratave të vitit 1968 në Prishtinë dhe në Tetovë, si dhe krenimi i 100- vjetorit të Lidhjes së Prizrenit, që ndikuan dukshëm në zgjimin e ndejave kombëtare të gjeneratave tona, përkujton njëri ndër studentët më aktiv gjatë atij procesi, Ida Trena. “Fillimisht, aktiviteti nisi si një lëvizje ilegale që kishte filluar që në vitin 1978 dhe me kalimin e kohës nisma u legalizua gjatë vitit 1980 duke marrë përmasa të gjera ndër studentët shqiptarë nga Maqedonia, të cilët kishin bërë një vërsim të vërtetë në kuptimin pozitiv të fjalës në Universitetin e Prishtinës”, përkujton bashkëbiseduesi Ida Trena.

Njëri nga anëtarët e këshillit, Xhelil Rufati, na pohoi se ajo nuk ishte vetëm një iniciativë për arsim universitar, por mori përmasa më të gjera kulturore.

“Iniciativës për hapjen universitetit shqip në Shkup i parapriu iniciativa për formimin e një shoqate të studentëve nga Maqedonia të cilin e quajtëm “Valët e Jugut”. Por edhe kjo iniciativë nuk u jetësua, duke pësuar fatin e njëjtë si kërkesa për universitetin”, veçoi nga kujtimet e tij Xhelil Rufati.

Jehona në Shkup

Ndonëse nuk pati shtrirje të formës së organizuar, megjithatë ky aktivitet pati jehonën e tij. Kjo nismë pothuajse me po të njëjtin vullnet u përqaftua edhe nga studentët shqiptarë që studionin në Universitetin “Kirili dhe Metodij” dhe në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup. Ashtu si studentët e Prishtinës, edhe studentët e Shkupit krijuan një grup më të gjerë ku përfshiheshin një numër i madh studentësh. Nga grupi më i gjerë doli grupi prej katër anëtarësh i përbërë nga Bajram Limani (ish-student i mjekësisë) nga Kumanova, Axhi Limani (ish-student i ekonomisë) nga Kërçova, Urim Kondri (ish-student i ndërtimtarisë) nga Struga dhe Nuran Korça (ish-student i gjeografisë në Shkollën e Lartë Pedagogjike) nga Struga.

Duhet potencuar se mjaft aktiv në sensibilizimin e opinionit studentor, por edhe në jetësimin e tij, dhe ishte grupi i studentëve nga Kumanova, Kërçova dhe Struga. Prej tyre, vlen të veçohen: Bashkim Pollozhani (ish-student i farmacisë) dhe Fitni Dalipi, (ish-student i historisë së artit me arkeologji) nga Struga, Hatip Beshiri (ish-student i mjekësisë), Imer Rrahmani (ish-student i stomatologjisë), Bajram Zenku (ish-student i psikologjisë) nga Kërçova. Kontribut të theksuar dha sidomos grupi i studentëve të mjekësisë nga Kumanova. Në këtë proces kanë qenë të inkuadruar edhe nxënësit e shkollave të mesme, dhe se përfaqësues ka qenë Naser Ziberi. Nxënës në Gjumnazin “Zef Lush Marku” në Shkup.

Takimet dhe kërkesat

Përfaqësuesit e grupeve të studentëve patën realizuar një varg takimesh me struktura të ndryshme shoqërore – politike të atëhershme në Prishtinë dhe në Shkup. Më shumë takime pati realizuar grupi i studentëve të Prishtinës, i cili takimin e parë e ka bërë me Prorektorin për Arsim të Universitetit të Prishtinës, Prof .dr. Halil Turku, i cili i ka udhëzuar studentët që të realizojnë takime me instancat politike në Kosovë dhe sidomos me ato në Maqedoni. Pastaj vlen të përmendet edhe takimi me sekretarin në komitetin komunal për arsim të Prishtinës, Fatmir Fehmiu.

Kështu pastaj pasuan takimet, në Lidhjen e Popullit Punonjës së Maqedonisë, Lidhjen e Rinisë Socialiste të Republikës së Maqedonisë. Lidhjen e Rinisë së Universitetit, etj. Sidomos duhet veçuar takimi me Rektorin e Universitetit “Kirili dhe Metodij” në Shkup, ku studentët ishin pritur nga një strukturë e gjerë e cila nuk ka pasur vetëm drejtues të rektoratit, por, siç kujtohen bashkëbiseduesit tanë, aty kanë qenë të pranishëm edhe punonjës policorë.

Sigurisht që kërkesa bartëse ishte mundësimi i arsimimit universitar në gjuhën amtare për shqiptarët në Maqedoni, e cila ka qenë e parashtruar nëpërmjet

disa alternativave. Njëra alternativë ishte që drejtimet në kuadër të Shkollës së Lartë Pedagogjike të avancoheshin në fakultete. Tjetra parashihte hapjen e disa programeve studimore në gjuhën shqipe në kuadër të Universitetit “Kirili dhe Metodij” të Shkupit. Ndërkaq, si opsioni tretë mbetej hapja e një Universiteti në gjuhën shqipe në Shkup.

Epilogu i iniciativës

Fatkeqësisht, hovin e asaj nisme e pat ndërprerë fushata e egër pas demonstratave të studentëve të Universitetit të Prishtinës në vitin 1981, e ndërmarrë nga regjimi i atëhershëm komunist jugosllav, ndaj gjithçka që ishte shqiptare. Fatin e njëjtë e përjetuan edhe studentët e lartpërmendur të cilët u shpallën nacionalistë, irredentistë dhe të papërshtatshëm nga regjimi i kohës. Nuk ishin pak edhe ata të cilët e paguan me karrierën profesionale. Disa përfunduan në burg. Por, ka pasur edhe të infiltruar, të cilët, për shërbimet e tyre ndaj regjimit janë shpërblyer në forma të ndryshme!

Megjithatë, ajo nismë sigurisht që nuk u shuajt përgjithmonë. Efekti i saj u reflektua katërmbëdhjetë vjet më vonë, që u kurorëzua me themelimin e Universitetin e Tetovës. Me sa duket kjo iniciativë po merr edhe një epilog tjetër pozitiv! Me gjasë edhe Shkupi do të ketë universitetin shtetëror shqip. Themelimi i universitetit shqip në kryeqendër nuk do të ketë karakterin dhe motivacionin e këndvështrimit politik, por vjen si qasje tjetër, i cili kryesisht do të shërbejë për nevojat zhvillimore, duke e bashkërenduar pra komponentin arsimor me atë shkencor për të mirën e shoqërisë.

Mixhait POLLOZHANI

*IN MEMORIAM***TË GJITHË MBETËM PA JORGO BULON!**

1.

Qytetarët e Përmetit ishin të fundit që e panë, dëgjuan dhe shijuan urtësinë dhe oratorinë e tij. Pasditen e 25 nëntorit, kreu udhëtimin e fundit, mbajti fjalën e fundit dhe përmbushi misionin e fundit. Të tria këto, udhëtimi, fjala dhe misioni ishin për Dritëro Agollin. Por në fakt, më shumë ishin për qytetarët e kulturuar të Përmetit. Nëse dikush do të kishte guxuar ta pyeste ndonjëherë cila do të ishte dëshira e tij e fundit, në stacionin e fundit të jetës, nuk do të çuditej nëse do të merrte një përgjigje që ose lidhej me Naimin, ose do të ishte në stilin naimian. Dhe kështu ndodhi. I shqiptoi fjalët e fundit 39 kilometra larg Frashërit, vendit ku Naimi para 169 vjetësh, kishte shqiptuar fjalët e para. Përmetarët dhe frashërllinjët e pritën të fundit, por e përcollën të parët për në rrugëtimin e fundit. Ata nuk e fshehën dhimbjen. Mbetën pa Jorgo Bulon!

2.

Nuk i ishte numëruar asnjëherë studentët për të cilët kishte ligjëruar. Por ata janë ndoshta disa mijëra, ndoshta edhe më shumë. Nuk mburrej asnjëherë që ish studentët i shfaqeshin kudo, edhe aty ku nuk e priste. Dy dekadat e fundit gjeografia e tyre u zgjerua shumë, madje pushtoi të pesë kontinentet. Të gjithë nuk ngopeshin duke e takuar: dikush për zemërsisht në skriuaninë e tij në Akademi; dikush i shkonte për vizitë në shtëpinë gjithnjë plot ngrohtësi; dikush duke e sjellë në bisedë me respekt dhe nostalgji; dikush me një e-mail të përmallshëm; Të gjithë nga dita e djeshme kanë mbetur pa Jorgo Bulon!

Shkencëtarët, shkrimtarët, poetët, historianët e letërsisë, ata që profesori i quante sinqerisht kolegë, por që në fakt janë udhëhequr dhe inspiruar prej tij në karrierën dhe pasionin e tyre për historinë dhe krijimtarinë letrare, nuk do ta gjejnë më në zyrën e katit të dytë të Akademisë, atë, profesorin e përhershëm. Disave do t'u pakësohet entuziazmi, të tjerëve do t'u mbeten faqe krijimtarie të pashkruara, disa të tjerë do të mbledhin forcat dhe mendjen për të shkruar. Por pa frymëzimin me të cilin e kishin nisur procesin letrar dhe krijues. Kur plaga që hapi do të fillojë të ftohet, edhe dhimbja do të shtohet. Dhe kur dhimbja apo rrethana të tjera do tua bëjnë vazhdimin e punës të pamundur, nuk do të munden më të telefonojnë në numrin 0682055337 për të marrë këshillat e tij. Atëherë do ta ndjejnë deri në palcë se çdo të thotë të mbetesh pa Jorgo Bulon!

4.

Ndër të parat telefonata të Myzafer Korkutit mëngjesin e djeshëm, ishin ato drejt Kosovës. Rexhep Qoses dhe akademikëve kosovarë, por edhe Myzaferit dhe akademikëve të këtushëm, nga mëngjesi i djeshëm u mungon ura që lidhte të dy akademitë, kolegu që bashkonte dy komunitetet e shkencëtarëve, jo vetëm albanologët, por të gjithë. Madje dy botët shqiptare. Kur nuk e gjeje në studjon e tij, mendimi i parë që të vinte ndërmend ishte: "Me siguri, do jetë nisur për në Prishtinë". Por nga dje, Jorgua nuk do të mundet të shkojë më në Prishtinë. Akademikët, krijuesit dhe shkencëtarët nga Kosova nuk do ta shohin më, as atje dhe as këtu, në Tiranë. Dhe kur kjo mungesë të fillojë të përsëritet, të gjithë do ta kuptojmë se sa të humbur jemi ngaqë humbën Jorgo Bulon!

5.

Familja, natyrisht është më e humbura. Pjesa më e dhimbsur për të, Anila, por sidomos dobësia e tij më e madhe, mbesa, Antea, u ndodhën ato çaste të rënda në distancën më të largët të mundshme, në Kanada. Por edhe Kristina, zonja e vërtetë që i qëndroi në krah gjithë jetën e gjallë, në momentet e fundit nuk mundi ta bënte këtë. Profesori vendosi të ikte si akademik në krye të detyrës dhe në përmbushje të misionit: pasi kreu ligjërimin e fundit në Përmet.

6.

Ne të gjithë mbetëm pa Jorgo Bulon. Por shumica e shqiptarëve, në fakt, nuk e kanë humbur Jorgo Bulon. Këta janë lexuesit e tij. Dhe këta janë shumica. Ata, po. Nuk do të mbeten kurrë pa Jorgo Bulon!

Kosta BARJABA

NJERIU, DIJETARI, ATDHETARI

(kujtimit të Jorgo Bulos)

*...për ringjalljen e kombit
dhe të shpirtit të shenjtë të tij, gjuhës shqipe.
Jorgo Bulo*

Është e natyrshme që, kur kujtohen njerëzit që i kanë shërbyer pa kursim vendit dhe popullit të tyre, të renditen vlerat dhe meritat e tyre të përgjithshme, ato vlera dhe merita, të cilat me kalimin e kohës nisin të zbehen, ndërsa vetë figura shkon duke fituar një dritë, një domethënie, gjithnjë e më të qartë, më të pastër, më të plotë.

Por ndryshe shkruan dora për një njeri, me të cilin sapo je ndarë pas një bisede thjesht shoqërore, për një njeri, me të cilin ke pasur një njohje të drejtpërdrejtë, të krijuar në rrjedhën e viteve, një njohje të zhveshur nga rrethanat kalimtare dhe nga interesat e ditës. Dhe kjo gjithashtu është e natyrshme për njerëzit e të njëjtës periudhë, të të njëjtit brez historik.

Jorgo Bulo është një figurë e jetës sonë, e shoqërisë sonë, që më së shumti e kërkon diçka të tillë. Humbja është e freskët, të freskëta janë jo aq kujtimet sa përjetimet tona me të. Dhe në këto përjetime, po të hetohet me vëmendje, gjenden të gjitha tharmet e veprës së Jorgo Bulos, gjendet thelbi i thelbit të saj, rron shpirti – fjalë kyçe kjo në botën e tij – i kësaj vepre.

Jorgo Bulo ishte njeriu i shoqërimit, i të qëndruarit në shoqëri, i të kuptuarit të jetës si dukuri shoqërore. Veçse nocionet “shoqërim”, “të qëndruarit në shoqëri”, “jeta si dukuri shoqërore” për Jorgo Bulon ishin në nivelin më të lartë të kuptimit të tyre dhe jo në atë të rëndomtën, sikurse mund të jetë në mendjen e shumëkujt. Për Jorgon shoqërimi ishte thelbi i shoqërisë. Dhe shoqërimi, shoqëria donin të thonin për të një të tillë organizim shoqëror, një të tillë mënyrë të të jetuarit shoqëror, ku mbizotëron rregulli dhe mirësia. Jorgua ishte njeri i shoqërimit, i rregullit, i mirësisë. Ishte i tillë në pamje dhe në të sjellë. Kush ka qëndruar qoftë edhe një herë të vetme në prani të tij, në shoqëri të tij, ka vënë re patjetër që atje ku ishte Jorgua kishte qetësi e jo zhurmë, kishte rregull në të biseduar e në të dëgjuar, kishte bisedë e jo debat. Të gjithë e kemi të qartë se ç’do të thotë sot “debat” në jetën tonë. Jorgua dinte të dëgjonte dhe dinte ta merrte fjalën në bisedë. Arsyetimi ishte xhadeja e vetme e të shprehurit të tij, ashtu si qetësia ishte mënyra se si lëvizet në këtë xhade: qartë, thjesht, urtë. Në jetë Jorgo Bulo ishte më parë se gjithçka njeri.

Te kjo natyrë shoqërore e Jorgo Bulos, te kjo edukatë e tij shoqërore, ku mbizotëronin e përbashkëta, e përgjithshmja, rregulli, mirësia, urtësia dhe thjeshtësia (a mund të ketë shoqëri pa mbizotërim të së përbashkëtës, të rregullit, të mirësisë, të urtësisë dhe të thjeshtësisë?), qëndron edhe thelbi i gjithë asaj që ai bëri në jetë. Ai i kushtoi jetën studimit të letërsisë shqipe dhe kjo buroi nga vetë qenia e tij. Për të letërsia, fjala letrare, fjala e thënë me mirësi e art, ishte mënyra e të jetuarit dhe e të përjetuarit, ishte mënyra e të ndierit mirë me veten dhe me mjedisin përreth. Jorgo Bulo u mor me letërsinë shqipe të traditës dhe kjo gjithashtu buroi

nga vetë natyra e tij. Tek e kaluara e letërsisë shqiptare ai gjurmonte dhe gjente atë që ishte më e mira në shpirtin e shqiptarit, pra, edhe në shpirtin e tij. Kjo i mjaftonte për të jetuar në paqe me veten. Kjo i mjaftoi gjithë jetën. Fjalën e fundit si dijetar Jorgo Bullo ia kushtoi Dritëro Agollit, një poeti e një krijuesi që më shumë se kushdo nga të gjallët mishëronte për të lidhjen me popullin dhe me traditën, domethënë me të mirën, se për Jorgon populli dhe tradita ishin vetë e mira. Dhe vajti e ia kushtoi këtë fjalë në Përmetin e Naimit, i cili për Jorgon ishte barabar me një perëndi, në Përmetin e traditave të mira, e njerëzve të shtruar, e gjuhës së pastër e të shtruar shqipe. Jorgo Bullo ishte një besimtar i popullit, i traditës, i fjalës së buruar nga shpirti. Jo më kot librin e fundit e titulloi “Shpirti i fjalës”.

Dhe nëse duam të gjejmë shpirtin e Jorgos të derdhur në fjalë, nuk kemi asgjë më mirë se ky shembull: *“Naimi u dha jetë artistike shpirtit dhe ndjenjave të kombit të vet, duke krijuar imazhin poetik të Mëmëdheut që u mungonte shqiptarëve, si një tokë e premtuar që e kishin dhe nuk e kishin, që e kishin dhe nuk e shikonin ose nuk e ndienin se e kishin aq të bukur e të vlerë, të ringjallur me një dashuri të përgjyruar prej fjalës poetike.”*

Ose ky shembull: *“Sterjo Spasse ishte rilindës idealist në kuptimin më të mirë të fjalës, idealist në përgjërimit ndaj dashurisë dhe fisnikërisë njerëzore, idealist në nderimin për traditën historike dhe kulturore të këtij vendi, idealist në besimin tek e ardhmja dhe të mirësia njerëzore.”*

Shpaloset kështu edhe një shtresë tjetër e shpirtit të njeriut dijetar Jorgo Bullo: atdhedashuria, atdhetaria. Një shpalosje e gërshetuar kjo, shpalosje pothuaj e njëhershme në të tria shtresat. Njeriu u formua përmes formimit të ndjenjës së dashurisë për atdheun dhe ndjenja e atdhedashurisë u formua përmes mësimit, përmes dritës së dijes. Në të gjitha shkrimet e Jorgo Bullos, në të gjitha hulumtimet dhe studimet e tij, ashtu si në frymën e çdo bisede shoqërore të tij, jeton njeriu, dijetari, atdhetari, jeton ai përmes fjalës së bukur të gjuhës amtare. Nuk janë të shumtë ata shqiptarë që i kanë shfaqur me anë të fjalës këto tri vlera të mëdha: njerëzinë, dijen, atdhedashurinë. Janë të paktë ata që te fjala vunë shpirtin, dhe te shpirti kishin dashurinë për njerëzit, për dijen, për atdheun.

Një ndër këta të paktë ishte Jorgo Bullo. Ndaj dhe do të na mungojë. Mbetet të urojmë që fryma e tij në këto kohëra të trazuara do të rrojë, do të rrojë pikërisht për të mirën tonë. Se jemi ne që kemi nevojë për këtë frymë, me të cilën u mbrujt veprimtaria shoqërore e Jorgo Bullos, kemi aq nevojë. Dhe duhet të betohemi se do ta ruajmë e ta trashëgojmë në brezat pasardhës këtë frymë të shenjtë. Do ta ruajmë nëse duam ta ruajmë shqiptarinë.

Shpëtim ÇUÇKA

Tiranë, 29 nëntor 2015

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP

STUDIME ALBANOLOGJIKE

12

2015

*Kopertina
Imer Bajrami*

*Përpunimi kompjuterik
Besnik Emini*

*Shtypi
Shtypshkronja
“Focus Print” – Shkup*